

**Jai Shri Mataji Nirmala Devi!**

**Translations - Albanian 2024-0601**

1972-0101, Shri Mataji's Letter, Usa 1972 . . . . .	3
1972-0601, Guru Purnima, Mumbai 1972 . . . . .	4
1976-1012, Letter about Dharma 1976 . . . . .	5
1977-0127, Attention and Joy, Bordi 1977 . . . . .	6
1977-0731, Kundalini and Self-Realisation . . . . .	11
1978-0408, Satya Yuga: The Unconscious . . . . .	14
1978-1218, Agnya Chakra, Caxton Hall 1978 . . . . .	23
1981-0207, Introduction to Nabhi-Void, New Delhi 1981 . . . . .	31
1981-0325, Mooladhara and Swadishthan, Sydney 1981 . . . . .	43
1982-0704, Guru Puja, Establishing the Guru Principle . . . . .	53
1983-0131, Nabhi Chakra, Delhi 1983 . . . . .	59
1983-0202, The Vishuddhi Chakra, Delhi 1983 . . . . .	72
1983-0204, Sahasrara Chakra, Delhi, 1983 . . . . .	87
1985-0317, Birthday Puja, Our maryadas . . . . .	95
1985-0420, Mooladhara Chakra, Birmingham 1985 . . . . .	107
1985-0804, Shri Ganesha Puja, The Importance of Chastity . . . . .	112
1985-0901, Shri Vishnumaya Puja . . . . .	120
1986-0101, Shri Mahaganesha Puja . . . . .	127
1986-0713, Shri Kartikeya Puja . . . . .	129
1988-1014, 4e Jour du Navaratri . . . . .	135
1989-0817, Devi puja, 1989 . . . . .	137
1990-0831, Shri Hanumana Puja, Frankfurt 1990 . . . . .	139
1991-1206, Shri Raja Rajeshwari Puja . . . . .	145
1992-0531, Shri Buddha Puja, The Search for the Absolute . . . . .	149
1993-0411, Easter Puja . . . . .	155
1999-0318, Gudi Padwa puja, 1999 . . . . .	161
2002-0317, Mahashivaratri Puja 2002 . . . . .	162
2003-0320, Birthday Felicitations 2003 . . . . .	167
2004-0215, Mahashivaratri Puja 2004 . . . . .	168
2004-0606, Adi Shakti Puja, 2004 . . . . .	170

## 1972-0101, Shri Mataji's Letter, Usa 1972

View [online](#).

Fëmijët e mi të dashur,

Çfarë po kërkon?

Pse jeni duke vrapuar pas te paqellmishmes (kuturu) dhe papercaktueshmes?

Gëzimi që ju keni kërkuar në fitimet materiale, gëzimi që ju jeni duke kërkuar në pushtet, gëzimi që është zhdukur në fjalët e librave – e ashtu-quajtura- Njohuri është humbur e gjitha në veten tuaj, dhe ju jeni ende në kërkim dhe duke e kërkuar!

Ju mund ti kushtoni vëmendje çdo gjëje jashtë vetes suaj! Ju jeni të humbur në mendimet tuaja, si foshnja në pyll! Por ka nje shpresë te madhe që ju mund të ngriheni në Parajsën e vetëdijes "pamendime", të cilën ne e quajmë Vetë-Realizim.

Unë ju ftoj në këtë festë të Lumturisë Hyjnore, e cila është derdhur rreth jush, edhe në këtë Kali të YUGA, në këto kohë moderne Perëndi-braktisur.

Unë shpresoj se ju do të vini dhe të gëzoni përvojën shpirtërore të Jetës së Përjetshme.

Me gjithë dashurinë time dhe bekimet.

Nëna juaj, Nirmala

## 1972-0601, Guru Purnima, Mumbai 1972

View [online](#).

Unë duhej te behesha Guru në këtë jetë, pasi kjo nuk ishte bërë në ndonjë jetë tjetër. Për herë të parë, puna e një Guru duhej bërë. Ndoshta sepse edhe një nënë duhej te behej Guru.

Kjo është menduar të jetë Kali YUGA dhe ndoshta vecanerisht për këtë arsye, të gjitha shaktis e Hyjnores vënë së bashku duhej të rrjedhin nga zemra e nënës ..... Eshhtë e gjitha në fatin tonë dhe kjo është arsyeja pse në këtë jetë pozita e Guruse duhej te ishte pranuar.

Nëse një nënë duhet te behet nje Guru, krijohet një situatë tepër e vështirë, sepse një nënë supozohet të jetë e një natyre shumë të butë.

Një Guru mund të godase ose qelloje ose mund të jetë shumë i ashpër ndonjehere. Por për një nënë, madje edhe në qoftë se ajo duhet te flase ashpër, lendohet në zemër dhe është shumë e dhimbshme për të. Dhe kur ajo e kupton sa kanë luftuar fëmijët e saj të rriten pasi të ketë arritur të gjitha Sadhana (ndershkimet dhe kerkimet shpirtërore), ajo shqetësohet se si ti ushqeje ata me gjithë dashurinë dhe kujdesin ne menyre qe ti shpëtoje ata ....

Ramdas Swami, njeherë duke folur mbi cilësitë e një Guru, tha se njeriu duhet të pranojë një guru i cili në cilësitë e tij të është me te vertete po aq i çmuar si një Paras [si Midas qe shnderron gurin në ar]. Prekja e tij Midas nuk l kthen të tjerët në ar, por i transformon ata në një tjetër Midas si veten e tij. Dhe kjo është arsyeja pse është ne formën e një nënë. Një nënë është brenda fëmijëve të saj. Ajo ndjehet krenare në krenarinë e fëmijëve të saj. Ndoshta kjo është arsyeja pse Zoti i Plotfuqishëm ka pasur dëshirën qe ju te merrni këtë dashuri dhe dije nëpërmjet një nënë .... Mundohuni tua jepni të tjerëve. Mundohuni ti bëni ata ta kuptojnë .... Ata janë të gjithë fëmijët e mi.

## 1976-1012, Letter about Dharma 1976

View [online](#).

Kjo është se si unë e përshkruaj Dharma shkurtimisht. Dharma është i mbështetja e të gjitha gjërave që janë lindur ose krijuar. Është fuqia e natyrës që i jep valences së atomeve në një element. Është Dharma që është e shprehur si cilësi e këtyre elementeve. Për shembull, ari ka një cilësi që nuk nxihet. Qeniet njerëzore janë si instrumente të përsosura, si kompjutera. Sigurisht, në qoftë se Dharma e tyre është në ekuilibër, ata janë receptorët më të mirë. Ju mund të kuptoni se vetëdija hyjnore është si rryma kryesore elektrike e cila bën të punojë një kompjuter (Vetë-realizimi). Nëse Dharma në instrument mungon, vetë-realizimi nuk jep rezultate të plota. Ajo bëhet si një makinë e dorës së dytë. Dharma është pikëmbështetja (boshti) dhe ai që është në Dharma nuk e humbet asnjëherë ekuilibrin. Pra, vëmendja duhet të jetë në "Dharma", pika ku graviteti i mëkatit nuk vepron.

Informacioni i Dharma vjen nga pavetëdija, por lëvizja nga boshti mund të marrë vëmendjen e njeriut aq shumë në një dimension ose aq shumë si një sharrë deti që në fund të fundit rrezja e jetës anon nga njëra anë, ose drejt ferrit ose drejt shkatërrimit. Sepse, nëse lëvizjet ekstreme janë si një sharrë deti, lulja delikate e vetëdijes njerëzore bëhet më konfuzë dhe njerëzit vuajnë nga të gjitha llojet esëmundjeve.

Pra, çfarë duhet të bëjmë?

Qeniet njerëzore kanë për të ardhur në gjendjen e Gautama i cili u bë Buddha. Ai kërkoi me të gjithë sinqeritetin dhe ndershmërinë. Ai hoqi dorë së pari nga të gjitha shqetësimet e rreme të kësaj bote. Kjo nuk është e nevojshme, por kur ai u dorëzua nga të gjitha shpresat e kërkimit, (për pushtimin e mendjes), ai pranoi humbjen e tij. Ai u ndje i lodhur dhe ra në këmbët e Frymës së Shenjtë.

Buddha kishte Dharma. Trupi i tij ishte i pastër, mendja e tij, vëmendja, nuk gjeti asnjë gëzim në lakminë e kësaj bote apo dëshirës. Kupa e tij ishte e mbushur dhe u zbraz kur ai u lodh dhe i dorëzuar dhe se ishte momenti: si rrebesh shiu, Shakti mbushi kupën e Tij dhe e bëri atë Shakta, Të Ndriçuarin. Pra, kur ju jeni duke folur për virtytin, ju jeni duke paralajmëruar ata për të mbajtur kupën të paprekur dhe të pastër.

Sahaja Yoga është dëshmi e të gjitha shkrimeve të shenjta që janë sfiduar (kundërshtuar). Por unë kam për të ardhur për të shpjeguar, për të dhënë realizimin dhe të ju them "e di se si".

## 1977-0127, Attention and Joy, Bordi 1977

View [online](#).

Bordi Shibir 27 janar 1977

Cilesia e vemendjes ndryshon ne varesi te gjendjes sone. Pra, ku eshte vendosur vemendja ne qenien njerezore? Nuk ka nje pike fikse. Mund te themi qe vemendja eshte sipërfaqja ose kufiri i vetedijes; per cfaredo qe mendojme, atje eshte pozicionuar vemendja jone. Le te bejme nje analogji: Gjithe thermijat e hekurit kane fuqine per t'u terhequr me magnetin, por se ku ndodhet kjo fuqi nuk mundemi t'a percaktojme. Ajo eshte kudo. Kudo qe te vendoset magneti thermijat terhiqen. Keshtu ndodh edhe me vemendjen tone; per cfaredo qe te mendojme, vemendja jone shkon atje. Ajo ekziston ne te gjithë trupin dhe mund te zhvendoset edhe jashte trupit, edhe brenda trupit (ne rastet kur kemi ndonje dhimbje apo shqetesim. Ajo pluskon mbi nervat, pluskon mbi gjithë sistemin nervor, por ka nje qender kontrolli ne tru. Nese kjo goditet, atehere ne mbesim te vetedijshem por pa vemendje. Gjithashtu kjo mund te ndodhe edhe nese dikush goditet ne Çakren Vishuddhi. Mund te ndodhe edhe ne Cakrat me te poshtme. Nese dikush goditet, ajo pjese do t'a humbase vemendjen e saj sepse ka humbur ndjeshmerine. Diferenca eshte se ne mund t'u kushtojme vemendje atyre pikave, nese duam, edhe nese ato jane te mpira (te pandjeshme). Per shembull, nese dora ime eshte e pandjeshme une mund te drejtoj aty vemendjen time, dmth mund t'a shikoj, te mendoj per te. Por eshte nje pike ne qenien tone, e cila nese goditet, ne as te mendojme nuk mundemi. Ne vetem shtrihemi te pavetedijshem, por syte i kemi te hapur, duart mund t'i levizim, kembet mund t'i levizim. Kjo pike eshte ne Piken e Cakres Vishuddhi. Nese heqim nje vije nga Çakra Vishuddhi deri ne Piken e Cakres Vishuddhit brenda trurit tone, nese goditemi diku pergjate kesaj vije ne behemi te pavemendshem, nuk mundemi te drejtojme vemendjen asgjekundi. Kjo vije kalon edhe neper Cakren Agnia sepse kur kjo pike lidhet me Cakren Vishuddhi ne pjesen e prapme, dhe tek Pita brenda trurit formohet nje trekendesh, dhe gjitha kjo linje ne kete zone mundet te ndikojë ne vemendjen tuaj. Zemra juaj leviz, gjymtyret tuaja levizin, por ju nuk mund ta perqendroni vemendjen askund. Pra, kur i kushtojme vemendje dickaje, ne fakt i kushtojme vemendje normalisht me ane te qendrave te trurit, nese nuk jemi te realizuar. Pasi jemi realizuar, mund te kushtojme vemendje edhe me ane te qendrave te tjera. Kjo eshte nje diference e madhe midis nje personi te realizuar dhe nje personi te parealizuar, ose mund te themi se mund te fillojme te veprojme edhe me qendrat e tjera duke u kushtuar vemendje atyre. Mund te ndiejme qendrat qe jane te bllokuara ne trupin tone, te cilat nuk i kemi ndjere kurre me pare. Jo vetem kaq, por mund te ndiejme edhe qendrat e njerezve te tjere, gje qe do te thote se sistemi yne nervor qendror po bekohet me nje dije me te cilen mund te na transportoje, te na transmetoje Vemendjen e kushtuar nga qendrat tona, por edhe t'a dergoje Vemendjen tone ne nje menyre te rrafinur ne qendrat e te tjereve. Pra, gjeja e pare qe na ndodh eshte qe Vemendja jone behet me e rafinuar. Rafinimi, mprehtesia e Vemendjes domethene qe ne fillojme te kuptojme gjera me te thella. Per shembull nje zog mund ta shohe nje lule por nuk mund te ndije bukurine e saj. Po keshtu, nje njeri i parealizuar mund te shohe bukurine e nje luleje por nuk mund te shohe vibrimet e saj. Keshtu pra, ne behemi me te rafinuar, me te zgjuar. Padyshim qe jemi ne nje nivel evolucionar me te larte sesa njerzit e tjere.

Tani duhet te shohim se si e perdorim ne Vemendjen tone. Edhe nese jemi njerez te parealizuar, kur e kemi ushtruar nje art qysh nga femijeria, arrijme nje thellesi ne ate art sepse nje lloj Milinge (cilesie, aftesie) rritet ne nervat tuaja. Ne te njejten menyre, kur ne Realizohemi, do te kisha thene edhe « kur ne rilindemi », nese fillojme te respektojme Vemendjen tone, atehere pak nga pak arrijme nje thellesi per Jogen Sahaja. Por shume njerez kur realizohen, rralle vijne perseri, edhe nese vijne perseri ata nuk e arrijne me ndjesine e vibrimeve. Vazhdojne te jene te zene me punet e tyre te perditshme duke e cuar dem Vemendjen e tyre ne gjera qe nuk na japin ndjesite e rafinuara. Keshtu, rafinimi, thellesia e Artit te Joges Sahaja, nuk arrihet. Per shembull nje person qe ka lexuar shume, fillon ta perputhe ate me ate cfare ka lexuar. Kjo ben perseri qe vemendja e tij te shkoje dem. Vemendja e tij ka ngecur ne keto ide tradicionale, disa nga te cilat jane te sakta, disa te pasakta dhe disa te tjera jane absolutisht te genjeshtra, disa jane te padobishme, disa jane vetem per te bere para. Sapo arrijme Realizimin ne kthehemi ne dijen tone trashanike dhe fillojme te perputhim kete rafinim me trashaniken. Fillojme t'i humbim perseri vibrimet. Ne fakt, kam pare qe femijet e vegjel pasi arrijne Realizimin flene gjume per nje kohe te gjate. Behen pak te ploget per pak kohe, ndersa kur nje me i rritur e arrin ate, ai menjehere shkon tek stenda e librave, blen nje liber mbi Kundalinin dhe fillon te lexoje rreth saj. Atehere disa nga ju, pa e kuptuar qe jeni bere dikush tjetër, e merreni te mireqene ate, tashme,

"Mataji ka qene shume e dashur, Ajo thoshte,

Une jam e realizuar, por si arrij une ta besoj kete." Ashtu sikurse duke besuar ne te , ata do te me japin disa mua para ose nuk e di se cfare tjetër mund te me japin ,“ Une mund te shikoj vibrimet qe vijne, por kush eshte dobia e keture vibrimeve, pse Ajo na jep ne Vibrime ?

Dhe perseri kthehen tek ideja trashanike e leverdise sepse kjo ka qene deri tani natyra njerezore, te beje gjithcka qe i sjell leverdi. Gjithcka duhet te shfrytezohet. Njeriu fillon te vere ne shfrytezim edhe realizimin e tij. « Cfare leverdie ka ? Sa njerez do ta marrin kete ? Cfare do te ndodhe ? Cili eshte plani ? C'eshte kjo ? C'eshte ajo ? » Ky rafinim na jepet per ta shijuar, ashtu sic shijojme bukurine e nje luleje, vetem kenaqemi. A shkojme neper libra te marrim vesh se c'duhet te bejme me kete kenaqesi, si te kenaqemi me kete lule, cfare te bejme, kush ka shkruar per lulet, ne menyre qe te shohim se a perputhen keto ? Por kjo ka ndodhur shume shpesh dhe vertet qe nuk di si ta them ndryshe por kjo eshte nje sjellje e pakuptimte, pa dashur te lendoj askend. Femijet jane shume te mencur ne kete drejtim. Kur realizohen ata fillojne ta shijojne kete, vetem kenaqen, nuk e vrasin mendjen, nuk bezdisen. Ata mendojne se nese dicka eshte e kendshme, vetem sa duhet marre kenaqesi prej saj. Keshtu, ne fillim fare, ndodh keshtu dhe njeriu nuk e kupton se si e ka bere veten edhe me trashanik nga sa ishte ne kete Kali Juga, ne keto kohe moderne. Duke i organizuar gjerat sipas koncepteve dhe ideve te tij, ai eshte bere i panatyrshem, aq i pamend sa nuk e dallon dot gezimin nga shemtia. Eshte shume konfuz. Pra, para se gjithash, nuk ka vetem nje por shume arsye dhe, sic j'ua kam pershkruar pa ndalim, eshte aktivizimi trashanik i njeriut para Realizimit. Nese e kupton se cfare semundje ka patur eshte me lehte te sherohet prej saj. Nuk mundesh ta sherosh nje semundje pa e kuptuar historikun e saj. Nese je nje student historie e di se si eshte sjelle qenia njerezore. Fillon te pyesesh veten se c'kane keta njerez qe nuk shkon. Zoti krijoi nje bote. Mendo per nje njeri si une qe vjen ne kete bote ; papritur do te zbulosh se jane krijuar shume shtete. Dhe lufterat vazhdojne e njerzit vrasin njeri tjetrin. Gjithe keto probleme per hicgje. Dua te them se eshte nje shtepi e cmendur. Keshtu qe, nese kuptojme se si eshte cmendur specia njerezore, nuk eshte e thjeshte ta shpjegojme gjithe kete vetem ne nje leksion. Do te na duhej te shkruanim vellime te tera. Une mendoj se ka tashme vellime te shkruara. Pra, eshte nje sfond i tere historik qe j'ua ka cuar dem vemendjen.

Fizikisht, ata qe vijne per shqetesime e pamundesi fizike, meqe jane te semure, ndonjehere jane me mire sesa ata qe jane te shendetshem, sepse marrin edhe lehtesim prej kenaqesise. Nese marrin lehtesimin ata kenaqen dhe fillojne ta kuptojne qe gjithe kjo eshte per te marre kenaqesi. Por do te thoja qe edhe ata, sapo lehtesohen, zhduken, pa e kuptuar se ka dicka me te madhe sesa kjo per t'u shijuar. Dhe kenaqesia fizike tek vete Sahaja Joga eshte e mjaftueshme per te mbajtur vemendjen te rafinuar. Nuk kemi pse fiksojme vemendjen por duhet ta rafinojme sa me shume ate. Fiksimi i vemendjes, sic e dime, eshte nje metode e gabuar. Kjo eshte bere nga disa aspirante te Jogas dhe e dime se cfare rezultati kane patur. Cakrat e tyre u demtuan perfundimisht. Kur e fiksonin vemendjen tek Cakra Agnia, ajo demtohej. Nuk duhet te fiksosh vemendjen por duhet ta rafinosh vemendjen sa me shume. Sic thashe se nje magnet kur e afrojme me guret asgje nuk ndodh me ta sido qe ta levizim magnetin, por kur e afrojme me therrmijat e hekurit vetem ato terhiqen nga magneti. Ne te njejten menyre, vemendja e Sahaja Jogistit duhet te jete aq e mprehte sa ai te ndjeje vibrimet, duhet te mendoje per vibrimet, duhet te haje vibrime, te pije vibrime, dhe te kenaqet me to. Ne aspektin fizik, shume njerez me thone se une shkova ne shtepine e tyre dhe « ata me ofruan laddoos dhe une duhet t'i haja, cfare mund te beja Mataji ? » Ne fakt ata u terhoqen nga forma e laddoos dhe e hengren. Por nuk pane vibrimet e ketyre laddoos -ve . E hengren dhe paten shqetesime stomaku. Kur paten shqetesime thane : « C'mund te bejme tani, se i humbem vibrimet. Kemi ngrene laddoos ». Por nese e kishit pare qe nuk kishte vibrime tek laddoos , duhet te kishit thene «Sot nuk duhet te ha asgje » ose dicka si kjo, dhe nuk duhet te kishit ngrene. Nese shihni nje femije qe ka lindur i realizuar, ai nuk do ta hante kurre. Edhe nese e rreh e ema, ai pranon te rrihet por nuk e ha. Sepse ata nuk hane felliqesira. Femije te tille te tjeret i quajne kokeforte. Ata e dine qe nuk ka vibrime ne to prandaj pse te hane kur nuk do ta pelqejne ate ? Pra , ne aspektin fizik, ka shume gabime si keto qe bejne njerzit. Te themi se kemi ves te shkulum floket. Ishte nje vajze qe kishte ves te shkulte floket dhe erdhi tek une per trajtim. E pyeta se pse e bente kete. Me tha se keshtu i thoshte mendja. Motra me e madhe e godiste ne dore sa here qe e conte doren tek floket. E semura i thoshte se nese nuk e godiste, atehere ajo do ta godiste ate. Por kjo pune vazhdonte keshtu por problemi nuk po zgjidhej. Gjithe veset jane si ky bataçiklek . Te gjitha jane si ky, sepse materia perpiqet te terheqe vemendjen tone gjate gjithe kohes dhe keshtu ne krijojme vese. A e dini qe disa njerez, per te mposhtur veset thone : « Nuk do te ulemi as pertoke, as ne karrige. Do te marrim ne nje pozicion uljeje. » Nuk ka pse t'ia fusim kaq kot. Dua te them se disa gjera jane te mira, por pa shkuar ne ekstreme. Disa zakone qe krijojme ne jane kryesisht per shkak te modes. Dikush psh na shtyn te pijme nje cigare dhe ne pranojme. Nje ves i keq eshte te mos thuash « jo ». « Po si te thosha jo ? Ata po pinin te gjithe e na ofruan

edhe neve. Ne thame « jo » ne fillim por ata ngulen kembe dhe une e morra goten sa ta ktheja njehere. » Ose « Me erdhen shoket e me ftuan per darke dhe duhet te shkoja. Pastaj ata filluan kercimin kabare dhe duhej te shihja, se do te dukej shume keq po te mos shihja femrat e zhveshura ». Ne jemi njerez shume te pafajshem, e keshtu vazhdojme te themi « C'ti bej une ? Keshtu eshte shoqeria. Keshtu eshte moda ». Por nje Sahaja Jogsist eshte nje njeri i vecante. Ai eshte i zgjedhur.

Sepse ju nuk keni marre vleresimin tuaj ju nuk e keni vleresuar vetveten ashtu sic ju kam vleresuar une juve. Eshte nje fakt qe shume pak e kuptojne me te vertete. Per te patur realizim te tille Mataji duhet te kete bere dicka te llahtarshme. Duhet t'i jete dashur nje pune shume e madhe. Duhet te kete bere Tapasja te tmershme ne gjithë jetet e saj si edhe ne kete jete. Duhet te jete perpjekur shume nga mengjesi deri ne darke, dhe ne e marrim gjithë kete si dicka te rendomte. Une mendova se duke iu dhene realizim, ju do te shihnit menjehere vleren tuaj dhe do te mendonit se jeni dicka e mrekullueshme dhe qe keni realizimin dhe Sakshatkarin. Por nuk eshte keshtu dhe ju filloni te genjeheni nga gjerat vulgare te jetes. Eshte nje turme e madhe qe duhet te udhehiqet nga njeri nga ju. Njeri nga ju mund t'i udheheqe te gjithë ata. Udheheqesit nuk bejne kompromise, ata nuk zgjidhin problemet e njerezve kur udheheqin, por u japin atyre probleme per t'i zgjidhur. Ata qendrojne mbi te tjeret, shume mbi ta. Ata nuk perulen, te tjeret u perulen atyre. Ju jeni te gjithë si pishtarë por se cfare jete beni dhe cfare personaliteti keni, kete do ta vendosni vete ju. Kur vemendja behet paresore, kur kuptojme se si shfaqet qenia jone fizike, trupi yne duhet te purifikohet, duhet te zbukurohet, duhet te jete i bute, i kendshem, elegant, dinjitoz. Kam pare njerez ne grupet kur mblidhemi duke u sjelle ne nje menyre qe as nje njeri me edukate te zakonshme nuk do te sillej. Arsyeya eshte se ju akoma nuk e keni kuptuar qe ju jeni udheheqesit dhe qe njerzit po ju vezhgojne. Duhet te kete nje lloj « Masti » brenda jush, sic i thone ndryshe, duhet te jeni te kenaqur me veten. Pra, ne aspektin fizik, ajo qe hani, ajo qe shikoni, ajo qe pelqeni, gjithë perparësite duhet te ndryshojne. Ajo qe duhet te jete me e rendesishmja eshte Sahaja, ne cdo rrethane, ne cdo zakon – Sahaja. Sahaja do te thote « Ka lindur me ty ». Sahaja nuk do te thote e lehte. Shume njerez ngaterohen. Ju duhet ta dini qe jeni nje Sahaja dhe qe nuk duhet te pranoni asgje qe eshte Asahaja. Asahaja do te thote qe ju taconi driten e Sahajas mbi gjithëcka tjeter mbi erresire dhe jo te pranoni erresiren qe eshte Asahaja. Pra, si mund te keni zakone qe ju japin varesi simpatetike? Sahaja do te thote se ju keni nje vetedije te rafinuar te vecante. Nje mbret nuk fshin rruget. Ne aspektin fizik vemendja juaj humbet ashtu sepse ju vazhdoni te silleni sipas metodave Asahaja qe keni patur me pare, qe kane te tjeret, humbisni ne sistemin Asahaja te jetes. Ju duhet te ndryshoni gjithë sistemin e botes qe njerezit te behen Sahaja dhe jo Asahaja. Ekziston nje keqkuptim i madh rreth Sahaja Jogistëve. Ata mendojne « Oh ! Kur te vije Sahaja atehere do ta bejme kete pune, atehere do te dalim te flasim me njerezit. Te mos besh asgje eshte nje sjellje shume e gabuar. Sahaja do te thote qe ju e keni driten e Sahajas brenda jush, atehere si mund te toleroni dicka tjeter? Do te thote se ju duhet te dini se si te visheni, si te flisni, ku te shkoni, ke te takoni. Kush jane nenat tuaja, kush jane motrat tuaja, kush jane bijte tuaj dhe kush jane prindrit tuaj. Ashtu humbet vemendja. Pastaj zakonet tuaja vulgare, jeta juaj e vjeter qe duhet te gdhendet nga e para. Dhe nuk mund te vazhdoni, sepse nese vazhdoni, do te hutoheni ketu, do te hutoheni atje, do te thyni qafen dhe do te vini tek une te me thoni « O nene ! Kam thyer qafen. Me ndodhi kjo. Me ndodhi ajo. » " Deri ne momentin qe ju jeni bere nje Sahaja Jogist ajo do te vazhdoj te punoj me ju. Pse te mos beheni vetvetja.

Per shembull, nje njeri nuk mund te fleje si qente. Nese fillon te fleje si qen sepse kudo rreth tij ka qene, atehere do te kete dhimbje. Ne te njejtën menyre, nese do te jeni Sahaja sepse te tjeret rreth jush jane Sahaja, do te hyni ne telashe ; sepse qeni nuk ndjen dhimbje, megjithese ai mund te kete demtim por nuk e ndjen ate. Por ju patjeter qe e ndjeni. Nje njeri qe nuk ka rilindur ende nuk ndjen, e ka problemin por nuk e ndjen. Kurse ju e ndjeni, ju duhet te hiqni dore, sa me shpejt aq me mire. Nese nuk hiqni dore, atehere po ktheheni perseri ne te njejtën erresire dhe kjo erresire e re mund te jete e sketerrshme, e tmerrshme. Eshte me mire te vdesesh si qenie njerezore sepse keshtu mund te lindni perseri si kafshe. Por te lindesh perseri dhe te dish qe po kthehesh ne te njejtat zakone te vjetra te tuat, kjo mund te jete shume e rezikshme. Kjo eshte si une efiksoj vemendjen tuaj

Nga nje shqetesim, frike e vogel brenda trurit tuaj ne nje qenje Subtler ( superjore). Dhe kjo qenje duhet vetem ta gezoje ate Ate mengjes qe ju pelqeu meditimi, u bete te mprehte, une ju shtyva ta benit. Por ju duhet ta mbani veten te mprehte duke mos harruar se cfare ndodhi, se si u ndjete mire fizikisht. Nje nga zakonet e keqija qe kane njerezit eshte te shohin oren. Merzitem shume kur jam duke folur me njerez dhe shoh ndonjerin qe shikon oren. Kete nuk e duroj dot. Nese tani ju jeni pertej kohes, pertej hapesires, c'do te fitoni duke kursyer kohe ? Cfare keni bere deri tani? Kjo tregon prioritetet tuaja. Prioritetet tona duhet te ndryshojne dhe mund t'i ndryshojme lehte sapo te kemi filluar te kenaqemi, sapo te kemi shijuar nektarin e Dashurise Hyjnore (Amrit), atehere nuk do te pime me uje te papaster. Por mbi te gjitha ju nuk duhet te harroni kenaqesine qe merrni. Kjo eshte nje menyre per te fiksuar rafinimin tuaj. Eshte pikerisht vemendja qe mbulohet nga gjerat vulgare te jetes edhe ne anes emocionale



te saj. Per shembull ju keni marrdhenie. Kemi pare shume jogiste qe perhumben keshtu. Kishin ca lidhje shume vulgare me njerez, edhe Mesues dhe disa nga ata ishin shoke e disa te tjera mund t'i quajme edhe lidhje te ndyra, nuk mund te hiqnin dore prej tyre dhe humben. Atehere ju duhet te uleni dhe te zbuloni pse nuk jeni te kenaqur me veten? Ju jeni humbes per shkak te ketyre gjerave. Nese do t'ju kenaqin, nuk do te rendnit nga njera tek tjetra. Ato kurre nuk ju kane kenaqur plotesisht, atehere pse te ktheheni tek to perseri? Edhe kenaqesite emocionale, te cilave i referoheni si dicka shume e rendesishme, duhet te peshohen sipas dimensionit te ri te vemendjes dhe rafinimit tuaj. Ju e konsideroni dike si shume te shtrenjte e te afert dhe keni nje lloj marredhenie me te. Duhet te dini se kjo eshte shume siperfaqesore dhe ju nuk mund te kenaqeni prej kesaj, sic pini uje nga nje gota. Ne fakt, vete gota eshte siperfaqesore, uji eshte siperfaqesor, gjeja me e rendesishme eshte gjuha juaj qe mund te shijojë ujin. Nese gjuha nuk mund ta shijojë ujin e nese uji shijon si gure, c'kuptim ka te pijme uje ? Keshtu qe, ne thelb, gjeja me e rendesishme eshte shija ne gjuhe. Ne te njejten menyre, thelbi i kenaqesise tone eshte ne te ndjerit e vibrimeve. Por kjo vetedije e re nuk shkon shume me qenjet tuaja, prandaj del ky problem, ndryshe per qenjet njerezore, nuk eshte e veshtire per ti thene atij qe « eshte e mire pijeni ». Ai e pi dhe e di qe eshte e mire. Ai nuk e ha dicka qe eshte e hidhur. Nese do t'i jepnit dicka me shije te tmerrshme, para kesaj dhe pas kesaj duhet t'i jepnit cokollate. Por qeniet njerezore kur evolojne, kam pare se jane me te prirura drejt ketyre gjerave te tmerrshme, per shkak te terheqjeve te dikurshme te tyre. Pra, cojeni vemendjen plotesisht drejt Hyjnores, qe te mos ngele aspak vemendje per gjerat vulgare. Edhe sot ka njerez qe vijne e me pyesin « Mataji, kam nje problem, dua nje pune, cfare te bej ? Duhet te bej kete, duhet te bej ate. » Sigurisht qe ketu nuk ka asgje te keqe, por nese kjo ju terheq vemendjen, do te thote se keni humbur sensin e te qenit nje jogist Sahaja qe kenaqesine e merr ne nje forme te rafinuar. Pra, keto gjera vulgare nuk do t'ju japin kurre kenaqesi, prandaj pse te mos kerkoni dicka qe do t'ju jape ate kenaqesi te rafinuar, te cilen vetem ju mund ta shijoni ? Pra, kjo gje i ndodh vemendjes sone, ne humbim per shkak te ideve tona te meparshme dhe lidhjeve tona emocionale ose te ashtuquajtura shpirtore. Ne jemi hindu, muslimane, kristiane. Jemi vegjetariane, jo-vegjetariane. Jemi brahmine, jo-brahmine, e plot gjera te tjera, por nuk jemi ata qe jemi me te vertete dhe te gjitha keto gjera ju bejne ju te mendoni qe ju jeni njerez gjeni dhe madheshtor. Ju gjeni shume . Gjени ne cdo vend, ose cdokush nga cdovend. E ai ai sensin e vibrimeve? Atehere si mundet ky njeri te behet Guruja yt e te te mesoje mbi keto gjera ? Ti tashme je nje mjeshter. A shkon nje kryemjeshter te mesoje nga nxenesit qe sapo jane pranuar ? Kam pare edhe nje te sapoardhur qe meqe kishte badha-n, mundi te joshte lehte te pakten 5% te jogistevе Sahaja. Fliste me ze te larte, mburrej dhe minimumi 5% vrapuan pas tij. Si e shpjegoni kete ? Puna eshte se ju nuk duhet te jeni nje nga ata. Gjithesecili duhet te mendoje per veten e vet dhe jo per te tjeret. Duhet te mendosh nese e keni te mundur kete apo jo. Pra, edhe ne lidhjet shpirtore vemendja juaj humbet keshtu dhe te gjitha keto dimensione jane te jashtme. Tani, ne pershkrim te Gokulit te Vrindavanit, duhet te keni lexuar qe kur Krishna i binte fyellit, gjithë grate qe ishin duke punuar, Gopite neper shtepia, do te linin cdo pune, linin ne zjarr gjellen qe po gatuanin, linin ne tavoline ushqimin qe po hanin, te gjitha punet i linin pergjysme e coheshin e vraponin drejt atij fyelli (Murali). Dhe kur shkonin atje, qendronin ne kembe si te ngrira. Asnje levizje ne trup, asgje fare, vetem rrinin me kembe e degjonin me vemendje te plote. Ai as nuk fliste fare, vetem i binte Muralit (fyellit) dhe te gjitha ato degjonin si te ngurosura. Cfare ishte kjo? Kenaqesine qe po ndjenin ato e shijonin brenda vetes, gezimi qe derdhej brenda tyre me ane te ketij Murali. Vetem rrinin dhe degjonin, vetem kaq. Cfare eshte kjo ? Ky eshte rafinimi i asaj kenaqesie tamam si meditim. Ne te njejten menyre, vemendja juaj duhet te jete tek Sahaja, ne qendrimin tuaj prane Zotit. Ju jeni njesh me Zotin, cojini forcat tuaja centrifugale drejt Zotit plotesisht. Vendoseni veten ne lidhje me Zotin gjate gjithë kohes dhe pjesa tjetere e punes behet vete. Gjithcka do te filloje te funksionojë. Mendja njerezore eshte mesuar t'i beje gjerat ne forme rituali, psh ne mendojme qe nese duhet te ngrejme nje shtepi, duhet te germojme njehere themelin, pastaj te derdhim betonin ne themel, kolona e trare, pastaj te ngreme muret, pastaj te ndertojme catine dhe keshtu, njera pas tjetres ne planifikojme gjerat. Por ne Mbreterine e Zotit nuk ka planifikim. Vetem mund te rrish e te kenaqesh. Nese gjithë vemendja jone eshte atje, gjithë puna eshte kryer. Vemendje e plote, dhe pastaji ai fillon te punoje ,dhe ju jep ju prioritetin maksimal, per kete , mos kompromentoni rrugen tuaj permes saj. Duhet te ndihmohet edhe te tjeret te ngjiten dhe per kete duhet te mbash mend qe vemendja jote duhet te jete tek Atma jote, tek shpirti yt, tek Zoti, plotesisht njesh me te ne kete gezim. E gjithë zemra eshte atje, dhe me te dyja duart dhe te dyja kembet e tua, me gjithë vemendjen tende mund t'i terheqesh njerzit, sepse vemendja jote eshte e ushqyer gjithë kohes, atehere do te shijosh ngritjen e njerezve.

Asgje nuk mund te shkoje mire nese nuk zhvillon mprehtesine e mendjes. Dhe ky zhvillohet duke e larguar vemendjen nga gjithcka vulgare. Terhiqe vemendjen kurdohere qe shkon se tepermi tek nje mendim, ne kete menyre « Oh, harroje » . Por vibrimeve kushtoji vemendje te plote, vibrimeve te tua kushtoji vemendje te plote, per gjerat e tjera mos u bej merak se do te rregullohen. Keshtu mprehtesohet vemendja juaj ne mbreterine e Zotit. Kur zambaku eshte ne balte dhe duhet te dale, ai e gjen rrugen permes shume plasave dhe shume vrimave ne balte, por kur dej prej saj, totalisht i cliruar, atehere nuk hidhet andej-kendej

por vetem hapet dhe merr piklat e bukura te veses, dhe vesa e tret aroren tek zambaku. Vetvetiu aroma fillon te rrjedhe. Eshte nje metode e ndryshme, eshte nje menyre jetese e ndryshme. Kjo do te thote te jesh Sahaja.

## 1977-0731, Kundalini and Self-Realisation

View [online](#).

1977-07-31, Kundalini and Self-Realisation, London

Pra, kur ju merrni Realizimin tuaj, së pari dhe gjëja më kryesore që ju duhet të dini është për veten tuaj fizike, i cila nuk ishte e njohur për ju deri tani. Sa më shpejt që të shkoni në pandërgjegjshmen ju keni dëshmuar se keni mundur të mësoni rreth qenies tuaj fizike, së pari për veten. Keni marrë dijeninë se cili është problemi juaj fizik, nga çfarë vuani. Automatikisht ju e dini se ky është nga i cili ju vuani. Ju nuk duhet të shkoni tek një mjek për të pyetur atë se nga çfarë jeni duke vuajtur. Supozojmë se çakra Nabhi e juaj është e zënë, ju e dini se ka probleme në stomak. Nëse ju përparoni pak më shumë me frekuencat menjëherë ju do të dini se ajo është në këtë pjesë. Edhe në gisht, në anën e djathtë në qoftë se ju ndjeni djegie më shumë në anën e majtë të gishtit, atëherë ju duhet ta dini që problemi është më shumë në anën e majtë se në anën e djathtë. Nga praktika ju e kuptoni saktësisht se çfarë lloj problemi është. Por pas disa kohësh ju thjesht thoni se ky është problemi, dhe se [kjo?] është ajo që është. Ju bëheni ngjashëm me një kompjuter.

Pra Vetënjohja, e cila së pari është përjetuar, bëhet aktualizim. Kjo mund të themi është faza e dytë. Por patjetër në fazën e parë ju merrni eksperiencën e qenies tuaj fizike. Tani tëshohim bukurinë e saj, se si është bërë bukur. Kur ju vini duart tuaja drejt meje ju e kuptoni pozicionin tuaj, para së gjithash. Ju nuk më kuptoni Mua, por ju e kuptoni veten tuaj. Menjëherë ju ndjeni djegien ose ju ndjeni ftohje, apo ju ndjeni dhëmbje therëse, apo ndjesi shpimi gjilpërash, apo çfarëdo qoftë ajo. E gjitha kjo nuk është tregues për Mua, por është e gjitha [tregues ose treguar] për ju. Pastaj nga vibracionet që rrjedh përmes meje [fjale e panjohur - qënie] ato korrigjohen. Të gjitha këto probleme korrigjohen. Pastaj kur mekanizmi (sistemi i brëndshëm) i juaj është korrigjuar, atëherë të njëjtën gjë [fjale e panjohur - larë?] mekanizmi që është Vetja ime lëshon vibracionet (valet) ose ju merrni vibracionet (valet) të cilat janë me të vërtetë Unë. Por, që në një masë ...deri në atë masë, në të cilën ju keni arritur qartësi dhe ndjeshmëri.

Nga ana tjetër, kur të doni të dini për shëndetin e njerëzve të tjerë, atëherë mekanizmi juaj nuk do të ndjejë problemet tuaja, por do të ndjejë më shumë problemet e një personi tjetër. Dhe kur ju të keni korrigjuar problemet e personit tjetër atëherë ju do të filloni të ndjeni problemet tuaja. Sa bukur është e rregulluar, e shihni, në mënyrë që ju [jeni ose duhet të] ju jeni të detyruar për të kuruar një person tjetër. Nëse ju nuk kuroni personin tjetër ju nuk mund të ndjeni veten tuaj. Kjo është se si pandërgjegjshmja është duke u përpjekur që të ju udhëzojë, si të jeni në mënyrë universale i vetëdijshëm. Kjo është e bukura.

Tani, që të dimë në lidhje me sistemin tonë nervor autonom, në lidhje me sistemin nervor simpatik, madje edhe mjekët duhet të përdorin të paktën njëqind ditë për të marrë kardiogramën tuaj, për të marrë presionet tuaja të gjakut dhe për të ju kaluar ju përmes të gjitha testeve patologjike, dhe këtë test, dhe atë test, ju duhet të bëni të gjitha llojet e gjërave dhe shumë para duhet që të shpenzohen, ende [fjalë të panjohura - nuk?] nuk e dihet nëse ata vërtetë mund të thonë se kjo është gjëja e vërtetë. Por Dijenia e Vetes është aq e saktë, sa që edhe një fëmijë mund të thotë se kjo është gjëja. Tani ajo nuk është vetëm njohuri ... Për shembull tani, nëse ju keni sy, në qoftë se ne mund të shohim diçka - nuk është se ne mund ta shohim atë, por duke parë atë, ne mund të korrigjojmë lëvizjen tonë, ne mund të korrigjojmë vizionin tonë. supozojmë se diçka është e shtrirë atje dhe ne kemi marrë dritë në sytë tanë - ne mund ta shohim atë. Pra, ne nuk do të ishim rrëzuar poshtë mbi atë. Në të njëjtën mënyrë, në Sahaja Yoga, kur ju të dini rreth elementeve tuaja fizike dhe problemeve fizike edhe ju gjithashtu keni një fuqi për të korrigjuar ato. Ju mund të korrigjuar një problem vetëm duke i kushtuar vëmendje në atë pjesë, për shkak se vëmendja juaj është e ndriçuar tani nga dashuria e Perëndisë. Ju vetëm kushtojini vëmendjen tuaj për këtë dhe ju mund ta bëni këtë. Kjo ndoshta në një fazë të mëvonshme, mund të thoni. Por në fazat e hershme, madje edhe në qoftë se ju lëvizni gishtat simbas drejtimit të akrepave të sahatit në atë pjesë, nëse ju përpiqeni që ta nxirni jashtë atë problem që mundeni, me metoda të ndryshme të vini atë problem në këtë materie (lëndë), e cila është krijuar nga pesë elemente. Dhe problemi edhe pengimi juaj është gjithashtu nga kjo gjë. Kur të gjitha këto elemente janë në ekuilibër nuk ka asnjë problem. Por kur ekuilibri është i humbur në to ju do të keni probleme. Pra, kur në trupin tuaj ekuilibri është humbur çfarëdo qoftë ai problem është hedhur jashtë në këtë element, dhe kjo është mënyra se si ekuilibri është vendosur dhe ndiheni tërësisht mire. Pra, ju keni njohuri të qenies tuaj fizike, për të cilën ju nuk keni nevojë për një mjek ose ju nuk keni nevojë të shkoni në një laborator që të jeni një derr nga Guinea.

Së dyti, ju e dini rreth qenies tuaj mendore. Mendërisht e kuptoni se ju pëlqen dikush apo ju e urreni dikë. Por ju nuk e dini pse. Por pas realizimit ju mund ta thoni përmes vibracioneve se ju disi [fjale e panjohur - në vend] nuk mund ta duroni atë person tjetër. Pse? Sepse ai është duke ju dhënë vibracione (vala) të xehta. Në fillim pëlqimi ishte në një formë abstrakte që ju nuk mund ta kuptoni pse ju thjesht nuk mund ta duroni atë person, edhe pse ai është një person i këndshëm. Por ju nuk e pëlqeni atë

person për shkak se personi është duke trasmetuar vibracionet e tilla dhe të tilla, të cilat janë kundër vibracioneve (valeve,energjisë) hyjnore, nëse keni pasur ndonjë. Ose, nëse ju keni qenë i të njëjtit lloj ju do ta pelqeni. Pra, mendërisht edhe ju e kuptoni fjalë [fjale e panjohur - emocionalisht?] se pse ju disi nga brenda - intuitivisht ju e quani atë - ju nuk e pëlqen një person. Ose shkoni në ndonje shtëpi ... Ju nuk e pëlqen atë shtëpi në të gjitha. Ju ndjeheni shume keq në atë shtëpi, por ju nuk e dini pse ju ndiheni jashtë ashtu kur shtëpia është kaq e bukur.Pastaj përmes vibracioneve (valeve) ju menjëherë mund të gjeni se cila është arsyeja dhe ju do ta gjeni në duart tuaja se [gjendet apo ajo e tyre] Agnya është djegur (ka probleme).Pra, ju e dini se çfarë është problemi aty. Tani ... tani ju mund të korrigjoni atë. Nëse personi është bashkëpunues, ju mund t'i thoni atij person që një gjë e tillë është aty le të shpëtojëprej saj. Dhe nëse ju bëheni një ekspert, edhe pa i thënë atij ju mund të hiqni qafe problemin. Pra njohja e sjelljes tuaj jashtë sjelljes emocionale ose shpërthimit emocional për asgjë me vlere kuptohet përmes Vetë realizimit , që ju e kuptoni pse vetë, ju jeni të sjellë në një mënyrë të veçantë. Për më tepër, duke supozuar se jeni një person i çmendur, ju merrni një ndjenjë posedimi. Ju shkoni jashtë, ju dhemb koka, ndjeheni qesharak, ju bëheni [fjalë e panjohur - i dobët], ju filloni të luftoni, ju bëheni i frikshëm, njerëzit nuk ju kuptojnë, ju nuk kuptoni, ju bëheni hutuar. Por me Vetë Realizimin ju e dini se ju keni qenë të pushtuar nga një lloj shpirti dhe ju e dini se si ta nxirrni atë. Dhe kur ju e nxirrni atë nga ju ndjeheni të liruar plotësisht dhe kjo është se si ju ekuptoni veten tuaj emocionale në qoftë se ajo është duke u sulmuar.

Në dorë, për shembull, pas realizimit, ju merrni vibracione më shumë në anën e djathtë dhe më pak në anën e majtë. Menjëherë kuptoni se zotëri Ego është duke u përpjekur që të shtypë superego. Kështu që ju mund të ekuilibroni atë duke vënë dorën tua Ego (te djathte) në kokën tuaj dhe duke vënë dorën e majtë në drejtim të forcës Hyjnore që ju të jepni forcë më shumë në këtë dhe ju mund të ekuilibroni atë. Pra, ju e kuptoni Egon tuaj dhe superegon më shumë. Kjo është se si ju e kuptoni qenien tuaj të brendshme. Kjo është ende në formë bruto, ende në formë bruto ju jeni duke kuptuar veten fizikisht dhe mendërisht.

Tani [fjale e panjohur - intelekt] gjithashtu është i magjepsur ose ne do të themi i ndriçuar me Vetë Realizimin. Çfarëdo që ju lexoni para Vetë Realizimit që ju të merrni një ide shumë sipërfaqësore të gjithçkaje. Por kur ju jeni Vetë Realizuar mendoni "oh, kjo është gjëja që ata ishin duke thënë për" dhe se ju duhet të keni vënë re me veten se çdo gjë që ju lexoni ju e dini që është për t'u pranuar dhe cila është për t'u hedhur poshtë si false. Qeshni në deklaratat e papeshuara dhe ju i pranoni ato gjëra, të cilat konsiderohen [fjalë të panjohura - si naive dhe budallalleqe?] si të vërteta absolute. Prioritetet tuaja, [fjale e panjohur? - gjykimet] tuaja ndryshojnë dhe ju bëheni një person absolutisht një me realitetin absolut. Sepse nëse ju përpiqeni të pranoni ndonje falsitet ju menjëherë filloni të keni djegie në dorën tuaj. [Deri në çfarë mase OSE në një masë?] Kjo ju ndihmon në një masë, sepse ajo ka për të ruajtur lirinë tuaj. Pra Vetë Realizimi ju ndihmon në një masë shumë të madhe. Derisa, me qëllim, ju [fjale e panjohur - doni] te refuzoni të gjitha mesazhet nga realiteti, ajo shkon për të ju ndihmuar ju. Por, ende ju vazhdoni, duke e sfiduar atë, atëherë natyrisht kjo zhduket, ju humbni fuqinë e marrjes se mesazheve. Por kjo është arsyeja pse është Vetë Realizimi sepse jo vetëm që ju merrni Njohjen e Vetes, por ju e dini se si të korrigjoni veten.

Tani, njerëzit krijojnë. Ata krijojnë gjëra, ata mendojnë se janë artistë të mëdhenj ... Ata nuk mund të shpjegojnë se si ndodh. Dhe ka njerëz të cilët i vlerësojnë edhe - ata nuk e kuptojnë se pse ata e vlerësojnë një art të veçantë apo pse ata nuk e bëjnë, një lloj gjëje të veçantë. Por kur ju shihni [fjale e panjohur - universalisht?] kur [fjale e panjohur? - njohësit] medhenj ulen dhe e vlerësojnë një art, atëherë një Sahaja Yogi i zakonshëm mund të shkojë dhe të shohë dhe të thojë saktësisht nëse arti është estetikisht i pasur apo jo, sepsevibracionet menjëherë do të ju tregojnë. Nëse nuk do të ishte edhe gjëja më e vogël nga ajo pjesë [ju do ose ne do] të shikoni vibracione shume te këqia qe vijnë. Në qoftë se kjo është plotësisht harmonike, plotësisht e intonuar me realitetin, që është gëzim, që jep cilësi të plotë gëzimi e nëse ajo ka marrë në përsosjen e tij, atëherë ju merrni vibracionet që janë të pëlqyeshme për ju - jo vetëm te pëlqyeshme, por janë ndjesi shume te fuqishme që japin gëzim. Ndonjëherë ndiheni në përmbytjen e gëzimit që vjen mbi ju, duke rënë në të gjithë dhe rrjedh mbi qenien tuaj, krejtësisht i fresket dhe qetësues. Dhe kjo është se si ne vendosim në lidhje me një art, artist apo një pjese të artit që nëse ajo është krijimtaria e vërtetë apo jo.

Pra, ju e kuptoni artin e krijuar nga të tjerët. Por duke menduar se doni të krijoni ... Nëse tashmë keni teknikën, mirë ... Pastaj artisti do të shohë se ai do të fillojë duke krijuar disa gjëra fantastike të që ai kurrë nuk mund t'i ketë ëndërruar dhe vazhdimisht ai do të vazhdojë duke krijuar. Pra, ai prek ose ne mund të themi se arrin burimin. Sepse në qoftë se ju gjeni edhe më të madhin e artistëve më të mëdhenj, ata do të krijojnë, të themi, dhjetë punë të bukura, por në të tridhjetat e tij do të jetë i kotë. Por në qoftë se ai bëhet një Sahaja Yogi as edhe një krijim i tij nuk do të jetë i kotë. Të gjithë ata do të jenë të klasit të parë, arsyeja është se ai është një me burimin, kështu që nuk ka shans për të bërë gabime. Por njerëzit që të merrni vetëm një paraqitje e shkurtër, një herë, dy herë, tre herë, mund të jetë e gabuar dhe kështu ata mund të bëjnë gabime.

Por një artist i cili është Sahaja Yogi është atje me buriminn dhe plotësisht me teknikën. Duke bërë ndonjë punë jashtë, thonë në biznesin tuaj, përmes Vetë Realizimit ju do të keni besimin ne veten tuaj. Ju ndiheni të sigurt, sepse ju jeni pjesë e asaj jete,dritës dhe ju ndiheni kështu të relaksuar, sepse ju jeni vetëm një pikë në oqean. Pra, ju nuk jeni duke menduar të mashtroni të

tjerët. Ju nuk jeni duke menduar për të aktruar. Ju nuk jeni duke menduar për të gjitha këto aktivitete të padobishme në të cilat njerëzit kënaqen dhe shkatërrojnë shëndetin e tyre dhe shkatërrojnë shëndetin e njerëzve të tjerë të cilët vijnë në kontakt me ta. Ata kurrë nuk kanë një marrëdhënie shumë të shëndetshme në mes të njerëzve të tillë. Ju mund të mashtroni një person për një ditë, ju mund të mashtroni atë për tri ditë, por më vonë marrëdhënia bëhet shumë e sëmurë. Pra, edhe në marrëdhënien me biznesin tuaj ju do të gjeni se ju e kuptoni fuqinë e vetes. Ju përjetoni fuqinë e Vetes dhe për shkak të kesaj përvoje ju rriteni në Dharman tuaj, në mbështetjen tuaj. Dhe kur një person qëndron në mbështetjen e tij, e shihni, një njeri i tillë ka një personalitet shumë të fuqishëm. Dhe ai, kur ai përpiqet të bëjë biznes, atëherë njerëzit varen nga ai, mbështeten mbi të, dhe ai është biznesmeni më i mirë, sepse ai nuk është i ndihmuar vetëm nga fuqitë e tij, por në kohë të gjitha fuqitë e të pandërgjegjshmes janë në dispozicionin e tij. Pra duke e njohur veten, ju do të zhvilloni besimin tuaj dhe ju njihni të tjerët dhe të tjerët që kanë të bëjnë me ta. Edhe nëse ju kanë mashtruar, të themi, një herë e dy herë, ju do të dini se ju kurrë nuk jeni mashtruar. Nga ana tjetër, personi tjetër i cili mundohet të ju mashtrojë ju do ta pësojë vetë. funksionon kështu, kjo është magjia e të pandërgjegjshmes! Tani, çfarë është dituria në një biznes? Që ju të merrni njohuritë e krijimit të pasurisë nga hiçi. Kjo është bukuria e Vetë Realizimit - që ju mund të krijoni pasuri nga asgjëja, si një artist e bën. Nga pak [fjale e panjohur - duke anuar?], këtu dhe atje, befaz ju do të gjeni të njëjtën gjë, e cila nuk mund të materializohet në pasuri, është duke bërë mrekullira. Në Indi ka qenë një zotëri i cili mori Realizimi tij dhe ai e kuptoi disi që ne bëjmë shporta të vogla - në Indi, ata nuk vlejnë asgjë - dhe ai mendonte se në Amerikë ata do të shiten si ëmbëlsira të nxehta. [fjale te panjohura - apo disi tjetër], e shihni, atij i erdhi në kokën e tij, dhe kur ai filloi eksportimin e tyre, sot ai është një nga njerëzit më të pasur në Indi dhe ai filloi me gjëra shumë të zakonshme. Për shkak të Vete Realizimit, e shihni, ju mund të depërtoni në ekzistencën tuaj dhe të shihni në një gjë si të tjerët do ta vlerësojnë. Për shembull, me Vete Realizimin tani unë, edhe pse unë jam indiane e lindur, unë mund të bëhem angleze përmes vetëdijes kolektive. Unë mund të di se çfarë dëshiron një anglez, por normalisht një indian nuk mundet. Tani [gjendja ose krenaria] e eksportit indian është se ato janë duke eksportuar gjëra në Angli, duke menduar se ju jeni të gjithë indianë. [Fjale e panjohur - Edhe pse?] ata mund të jenë në anglez nga ndonjë shans, ata [mund ose nuk mund?] të eksportojnë gjërat që ju duhen vërtetë këtu. Pra, ata do të ju dërgoj [Fjale epanjohur - gjashtë jard] Saris [janë të padobishme ose te dobishme?] me ngjyra të tilla të frikshme, të cilat ju mendoni se janë te tilla, dhe që indianët mendojnë se janë shume te mira.. Kështu që ju mund të identifikoni veten me një person tjetër, me ideologjitë e tij, me idetë e tij, dhe mund të trajtoni nevojat e kombeve të tjera, njerëz të tjerë shumë të mirë. Ju shikoni, ne shesim diçka, kur të tjerët kanë nevojë për diçka. Normalisht njerëzit shesin atë, sepse ata mendojnë se kjo është për t'u shitur. Por vetem ju Sahaja Yogi mund ta bëni këtë lloj gjëje edhe në anën materiale të saj. Eshte nje shembull si Sahaja Yoga ndihmon [Fjale te panjohura - se ju?] si ju i kuptoni ambientet rrethuese që, të cilat më parë nuk ishit në gjendje t'i kuptoni, por tani me Vete realizimin ju i kuptoni, sepse ju mund të identifikoni veten me një tjetër personalitet [i?] .

## 1978-0408, Satya Yuga: The Unconscious

View [online](#).

Fjalim rreth Çakres se Zemres dhe Omkaras. Londër (UK), Shkurt 1978. Tani, kjo ane e majte e zemres është e lidhur me nënën tuaj dhe Shivën, ekzistenca, ju e arrini ekzistencën tuaj nëpërmjet nënës tuaj dhe Shivës dhe Parvati. Ata janë prindërit tuaj, të dy ata janë prindërit tuaj, për aq kohë sa ekzistenca juaj është e interesuar në të ajo është një qender kaq e bukur, është qendra e zemres tuaj. Ju doni që dikush të behet me i matur ose ju ndeshni dike që shumë kokëfortë, mire, unë ju kam thënë që mund ti gjuani ata me këpucë (shoes-beat), bëjini të gjithë këto gjëra, por është një mënyrë shumë e thjeshtë nëse ju dini si ta bëni atë, Vetem mendoni për zemrën e tyre dhe vendosni një bandhanë në të dhe ju mund ta bëni atë aq bukur, ju mund ta zbusni një person pa ndonjë vështirësi nëse ju dini si ta trajtoni zemrën e tyre. Ju duhet ta therrisni zemrën e tyre dhe kjo është tërheqja më e mire, unë po ja u tregoj, dhe metoda sekrete e përdimit përmes së cilës ju mund të sillni mirësi kur ju jeni duke folur me dikë. Duke supozuar se tani unë intelektualisht filloj të grindem me ju, ju do hiqni dorë prej meje shumë shpejt por unë do duhet të përdor fuqinë e zemrës tuaj dhe unë duhet të hyj në zemrën tuaj dhe kjo është se si funksionon. Kështu gjithmonë kur ju doni të bëni dicka të tillë, vetem peruleni veten brenda në zemrën tuaj, kjo është e para. E para mbi të gjitha ju duhet ta përlini veten tuaj në zemrën tuaj dhe më pas punoni në zemrën e të tjerëve. Vetem vendosni një bandhanë dhe do shikoni, që personi do të shkrihet fare. Në shkrijmë inteligjencën tonë, egon tonë, çdo gjë, madje dhe super egon tonë, në zemrën tuaj. Kështu kjo është një gjë shumë e lehtë nëse ju dini se si ta afroni njerëzit nëpërmjet zemrës së tyre dhe kjo është e mundur vetëm nëse ju jeni i vertete, sepse e vertetesia është diçka që zemra e njej. Ju mund të mashtroni një person me metodat tuaja dinake, por zemra do ta kuptojë atë më vonë dhe personi do t'ju urrejë. Edhe nëse flisni me dikë: "Oh, shumë mirë, oh, shumë lezetshëm, faleminderit shumë, shumë mire"..... dhe zemra e di: "Oh ai po mundohet të më mashtojë dhe është shumë dinak". Zemra do ta urrejë një person të tillë dhe zemra ka sy për të parë dhe ndjere personin, kështu nëse ju doni të therrisni zemrën e dikujt dhe vendosni një bandhanë në zemër, ju mund ta bëni për vetë atë person dhe nëse ju doni dikë dhe dëshironi që ai person të korrigjohet. Duke supozuar se i tillë person është pijanec ose një person që ju rreh dhe është duke ju torturuar sepse është në ndikimin e disa drogave ose të ndonjë lloji gjeje të huaj, më pas ju vetem vendosni bandhanë në zemrën e tij, dhe do e shikoni, ato do ta ndryshojnë, ato do e ndryshojnë atë shumë shpejt, dhe kjo është pse ju thoni ndryshimi i zemrës, do shihni gjithandej, në çdo shkrim, është e shkruar, një ndryshim i zemrës është i nevojshëm jo një ndryshim i rrobave, pra nuk është ndryshim intelektual, por është ndryshimi i zemrës, dhe kjo behet duke e levizur çakren e zemres në të djathtë në drejtim të akrepave të ores, kjo është vete zemra duke levizur në mënyrën e lëvizjes së akrepave të orës. Nëse ju mund ta bëni këtë, ju realisht mund të bëni mrekulli, dhe kjo është se si në baza kolektive, zemra është një lloj thellësie, një varg i thellë kolektiv, një varg që është duke kaluar përmes të gjithëve në. Kështu nëse ju mund të arrini tek me e thella, sepse në një qark 3 ½ është pjesa më e thellë. Nëse ju e prekni atje, ajo kalon p=mbi (...). Supozojmë se ju e prekni diku tjetër ajo mund të thyhet, por në fillim nëse ju filloni ta arrini atë, ajo vazhdon shumë këndshëm dhe kalon brenda një qarkoreje të plotë. Tani njera nga qendrat që unë ju kam thënë ju është pleksusi i zemrës të cilin në e quajmë pleksusi kardial i cili ka dymbëdhjetë nën-pleksuse dhe emrat e tyre në Anglisht janë, për të cilat unë do t'ju jap një listë të plote, Nuk e di se kur mund të kemi kohë të shikojmë revistat mjekësore, por unë do ti gjej, dhe do t'ju them se si quhen ato në terminologjinë mjekësore. Por ata e dinë që janë dymbëdhjetë nën-pleksuse të cilat furnizojnë muskujt e zemrës, të mushkërisë, anën e djathtë të mushkrise dhe kjo është menyrë se si ndahen. Por ata nuk e dinë që ajo është në tre pjesë dhe që janë dymbëdhjetë petale që i bëjnë ato të funksionojnë, i suportojnë. Do të flas më vonë rreth tyre. Pra tre pjesë në ndarë në dymbëdhjetë bëjnë katër nën-pleksuse për secilën pjesë. Por aktualisht nuk është kështu. Dymbëdhjetë petalet janë se bashku në qender, dhe qendra është njohur si "zemra e shenjtë". Në bibël është quajtur një "zemra e shenjtë" dhe ky shenjtërim i zemrës në formën abstrakte është dashuria memesore e Zotit. Për këtë arsye Jagadamba[1], Nëna e Universit, qendron atje. Dhe këto dymbëdhjetë petale veprojnë në përputhje me Nënën Tokë, zemrën dhe kjo është pse në nuk mund ti lejojmë ato në këtë anë apo në atë anë, sepse ajo është ajo e cila i bën ato të pulsojnë, kështu ajo bëhet një person dominant, dhe jo zemra, aty udheheq Shpirti. Kështu Shpirti udheheq vete, dhe ai udheheq me ndihmën e reflektimit të vete Zotit të Plotfuqishëm. Kjo është sipas menyrës së tij, është arbitrare. Ai shikon, vëzhgon, behet dëshmitar. Ai veshtron lojën e këtyre dymbëdhjetë petalëve, por nëse zbulon se ka shumë tendosje në qender, ajo mbyllet, dhe kur ajo mbyllet, i gjithë mekanizmi ndalon. E shihni, ju duhet të kuptoni diferencën midis çakrave të tjetëra dhe kësaj çakre, në të qendron Shpirti në një anë dhe Nëna në anën tjetër dhe në anën tjetër është një qënie, një personalitet perfekt, të treja gjërat të vendosura së bashku. Tani, nëse ju i ktheni ato në tre fuqitë tuaja, ju do e kuptoni. Në një anë është instrumenti ose mund të thoni berthama për funksionimin e anës së majtë. Në qender është, ose mund të themi ana e majtë, Mahakali[2] duke punuar në qender, mund të

themi eshte per funksionimin e Swaddha Mahalakshmit dhe berthama per funksionimin e anes se djathte ku Rama qendron, Arsyeya perse ne mund ta quajmë atë nje bërthamë eshte sepse Ai nuk ishte aktiv. Ai ishte aktiv pa ndjenja, pa ndjenja, Ai e deshmoi kete. Tani kombinimi ketu ku Krishna erdhi dhe Ai ndjeu, e deshmoi ate dhe e quajti Leela, gjithesi. Rama asnjehere nuk e quajti ate Leela, por e quajti asplain. Kjo eshte pse Krishna eshte i kompletuar dhe kjo eshte pse ne e quajme ate Sampurna, qe eshte rimisherimi total Adi. E dini që Krishti ishte këtu dhe sic ju kam folur rreth Tij në kete libër, une ja u kam lexuar, Devi Mahatmyam, se çfarë kanë pershkruar rreth Tij, si u krijua dhe si u soll ketu. Ai ishte Mahavishnu dhe se si..... Ai u vendos ketu, por kjo nuk eshte, dhe pikerisht tani ne jemi duke diskutuar rreth ketyre tre fuqive te zemres. Tani cila është lidhja e këtyre tre fuqive? Pse duhet të vendoseshin në ate kohë? Sepse ne kete nderthurje kemi tre bërthama qe punonje se bashku në tre kanale të ndryshme dhe ato duhet të lidhen në një lloj mënyre. Ato duhet të lidhen, përndryshe, mund te shihni një qënie njerëzore e cila nuk ka nje lidhje të stabilizuar dhe kjo per arsye se Kundalini i saj nuk eshte zgjuar. Aty parasimpatetiku varet, perkulet në gjysem të rrugës dhe se si mund te lidhen ato me zemrën e cila është ekzistenca ne mes te zemrës, e cila është evoluimi, e cila është zemra, e cila është aktiviteti. Keshtu ne kete nyje, e cila mbahet e lidhur, në momentin që zemra ndalon ndalon gjithshka ne te njeten kohe. Por kur ju jeni në këtë nivel, ju parashikoni zemren tuaj.Parashikimi mund te funksionojte vetem ne kete pike, sepse nese ju parashikoni se nje njero do te vdese. Tani thone, ata thone ao do te vdese, le te themi nesor, por ai vdes shume me vone. Ose ai do te vdese kur te ndjeje se eshte duke ndaluar se jetuari dhe kjo ka ndodhur, sepse ai shkon me tej ketij limiti kur te tre keto gjera jane te lidhura. Keshtu sic e shihni , ne themi se ju keni nje numer te kufizuar frymemerrjesh. Frymemarrja behet kaq e ngadalte mbas realizimit, ritmi saj behet aq i ngadalte. Kjo meqenese sa me i realizuar ai eshte aq me shume ajo zgjatet dhe lidhja behet shume me ndryshe, sepse zemra ndalon, ne momentin kur ju e ndaloni ate, ajo nuk mund te ndaloje per shkak te aktiviteteve te tjera qe jane ende. Mbi te gjitha , kur nje shpirt i realizuar vdes, kundalini duhet te kaloje qe ketu dhe pastaj zemra e tij ndalon.Eshte nje fenomen ndryshe dhe kjo sepse kur nje shpirt i realizuar vdes ata zbulojne se prana, shpirti nuk kalon nepermjet gojes apo hundes, por ai kalon ketu, dhe ju mund te gjeni ne mpiksje gjaku, por kjo eshte shenja qe ky person ka qene i realizuar ne nje lartesi te madhe, por ata qe vdesin perpara se nje arritje te tille,ata nuk vdesin me sy te hapur, dhe as me hunde te gjakosur apo me goje hapur ose thjesht pa asnje gjakosje. Dhe ka mundesi qe ata te marrin analiza gjaku tek ata. Perndryshe, ne cdo vdekje tjeter ka..... Syte ne disa njerëz mund te jene te hapur, por nese ata jane plotesishte te realizuar ato do te jene te mbyllur. Keshtu ky eshte ndryshimi, por ne kete nivel cdo gje funksionon prej jush , sepse ju jeni akoma ne nivelin ne te cilin nuk e keni arritur gjendjen e deshmitarit dhe kjo eshte arsyeja qe parashikimet funksionojne prej jush, te gjithë gjerat materiale jane duke funksionuar ne kete nivel dhe kjo eshte si ju beheni mrekullisht ndryshe. Do ju jap një shembull tjetër të kësaj, se si ju bëheni të mrekulliberes. Për shembull, një shpirt i realizuar po udhëtonë në një tren, treni u përplas, duke bere shume saltro por asnje nuk vdiq. Askush nuk mundi ta shpjegonte. Ndodhi një aksident me makine, nje shpirt i realizuar, po ecte me ate makine, ishte një makinë shumë e madhe, atje ndodheshin shumë djem dhe disa prej tyre ishin rrembyer me njeri tjetrin dhe ata te gjithë ishin të dehur, ata ishin duke kënduar dhe ai nuk dinte cfare të bënte, por ai ishte atje në nje mënyre apo tjetër dhe kur perplasia ndodhi askush nuk vdiq, njerëzit ishin shumë të habitur se si ndodhi kjo. Nese një shpirt i realizuar është duke ecur dhe nëse aty eshte duke ndodhur ndonje aksident ai papritmas do ta beje dicka dhe ky aksident do te shmangej. Nëse ju do te mundnit të vendosnit një bandhan ne ata kohë, ju menjëherë do ta shmangnit aksidentin. E shihni, një person i tille cili është i realizuar dhe ka kaluar përtej kësaj gjendje dhe është bërë dëshmitar ne kete, jo vetëm shpëton veten por edhe të tjerët, te gjithë fatet tuaja dhete gjitha keto gjera, ju futeni në kategori te tjera, për një person të realizuar të gjitha gjërat ndryshojnë. Të gjitha gjërat ndryshojnë, absolutisht ndryshojnë dhe ai bëhet një person tjetër. Duart e tij ndryshojnë, linjat e tij, dhe njerëzit fillojnë te thonë, "Oh ju duhet të keni bërë këtë, ju duhet të këni bërë atë" dhe ju i takoni keta njerëzit të cilët nuk janë të realizuar, nëse ata ju shikojne duart ata mund te pershkruajne spiritualitetin që është futur brenda tyre, por ende ata ngecin ne disa gjëra, megjithate ata thone disa gjëra, e shihni, ata nuk mund të shohin qarte. Por nëse është një shpirt i realizuar, ai mund t'ju thote ju menjëherë se në çfarë moshë do e arrini realizimin e plotë, çfarë do ndodhë, të gjitha llojet e gjërave te gjitha keto nëse ai është një person plotesisht i realizuar. Por aktualisht, njerëzit pas realizimit nuk kanë asnjë interes te mbetur ne gjera, dhe rrallë pyesin. Nuk kam njohur askend i cili eshte nje shpirt i realizuar i cili te mos jete i gatshem per te shpjeguar duart edhe gjera te tjera te tilla. Ai eshte pa asnjë interes. Por tani, kthehemi përsëri tek zemëra. Në anën e djathtë të dorës ne kemi vendin e Rama-s. Rama eshte shquar për bindjen e tij ndaj Swaddha-s, nëse e dini historinë. Babai i tij ishte në Ayodhya, ai po drejtonte atje, dhe ai kishte tre gra. Gruaja e tretë kishte dy djem, por ajo nuk mundi ta shihte Rama-n në fron. Ajo ishte një nënë shumë e mirë, por dikush, disa gra vajten dhe i thane dicka asaj , ajo i degjoi ato dhe i tha bashkëshortit të saj se, "Nëse ju dëshironi të më bëni nje nder, nderin e premtuar, ju duhet ta çoni Rama-n në xhungël për 14 vjet, dhe tja jepni fronin djalit tim Bara" Por kur ai e dëgjoi këtë, atij i ra të fikët, i ra të fikët prej kësaj kërkese, por Rama ndodhej aty. Ai e dëgjoi atë dhe menjëherë i tregoi asaj se unë po shkoj në pyll, une e pranoj kete.Une e pranoj kete propozim ne lidhje me djalin tuaj. Ne rregull. Dhe keshtu Ai shkoi, e shihni thjesht për t'ju bindur

urdhërit të babait të Tij, edhe pse babai as nuk e kishte urdhëruar, por sepse ai ishte i detyruar. Ai i kishte premtuar gruas se Tij dy favore, sepse dikur ajo i kishte shpëtuar jetën në luftë, dhe ai i pat thënë që kurdo qofte mund ti kerkosh keto favore, dhe ajo e beri, ajo kurre nuk do ta kishte menduar mund ti përdorte ato ne nje mënyrë kaq qesharake. Më vonë ajo u pendua, sepse.....

Ai refuzoi të pranonte fronin dhe vendosi vetëm pantoflat e Rama-s atje dhe çdo gjë ndryshoi, Dasaratha vdiq, kur Rama u largua, ai thjesh vdiq. Pra e shikoni, jeta e Rama-s tregon se sa i bindur ishte ai ndaj prindërve të Tij. Ai vuajti shumë. Ju e shikoni, kur prindërit tuaj bëhen të rrepte, ju keni çdo të drejtë ti thoni atyre se ata nuk duhen të jenë të rrepte me ju dhe se ju ndjeheni të lënduar, por ju nuk duhet ti ktheni atyre përgjigje ju duhet ti respektoni. Ju duhet të jeni të respektueshëm sepse ata perfaqesojne prindërit tuaj te hershem. Ju nuk duhet ti bërtisni atyre apo të silleni keq me ta. Ju duhet ti respektoni ata. Ata mund të jenë njerëz të këqinj, por ju duhet ti respektoni ata, sepse ju i keni zgjedhur ata. Kur ju keni lindur, ju i keni zgjedhur ata. Ju vërtetë i keni zgjedhur ata dhe keni thënë, "Këta do jenë prindërit e mi". Kështu nëse ata janë prindërit tuaj janë për shkak të nje arsyeje te caktuar. Sepse ju i keni kerkuar ata ne jetet tuaja te meparshme, dhe kjo eshte arsyeja pse ju jeni femijet e tyre. Për shembull tani, ju takoni disa prindër dhe ju mendoni se ata janë prindër shumë të mirë me fëmijët e tyre. Ajo tha, "Oh Zot, a mund ti kem unë ata si prindër?" Oh.. duke kerkuar, i merrini ata. Nëse i zgjidhni ata, ju e dini se çfarë është qe te jeni fëmijët e tyre. Më pas ju filloni të silleni keq me ta, nuk është kjo mënyra. Tani mos i bëni me këto lloj gabimesh qe te zgjidhni prindërit e gabuar, por bëhuni të respektuar ndaj tyre dhe do t'ju kthehet si një bekim. Është gjithmonë shume e pelqyeshme, pindërit tuaj mund te jenë shumë të vështirë, perjudha disiplinimi, keqkuptimesh, e di që është shumë e vështirë dhe me edukimin që keni dhe me botekuptimin qe keni per boten ne teresi ju mendoni se ata janë absoutisht qesharak, foshnjarak dhe të pamatur dhe veçanërisht kur ju keni vibrime, ju ndjeheni dhe më keq ne lidhje me ta, të varur pas gjerave, dhe mund te jene bere pothuajse robër, por ju duhet të kuptoni se ata kanë probleme, ju mund te ishit njesoj si ata nëse nuk do te kishit ardhur ne Sahaja Yoga, ju mund të bëheshit edhe më keq, prandaj le ti kuptojmë ata, mundohuni ti ndihmoni ata dhe nëse ju jeni i respektueshëm po ju them se, dhe te jeni shumë të sigurtë, nëse jeni të respektueshëm mund ti ndryshoni ata. Ju nuk mund ti ndryshoni kurrë të vjetrit duke i kthyer atyre kurrizin, kjo nuk është mënyra për te ndryshuar të moshuarit tuaj, filloni të silleni në një mënyrë që ata ate jene te respektuar. Kjo është, po ju them sekretin si ti trajtoni prinderit tuaj, duhet të beheni ekstremisht te respektueshëm ndaj tyre ne kete menyre ata do ta kuptojne, "Oh Zot, kur ai më respekton mua kaq shumë si mund te guxoj une te sillem keq ne pranine e tyre." Ky është sekretin si ti trajtoni prindërit tuaj, jo duke i bërtitur atyre, me te moshuarit tuaj, ju duhet të krijoni tek ata, ndjesinë se ata do te respektohen. Ndosht, e keni pare, ju përpiqeni, ju përpiqeni ti bëni këto gjëra me prindërit tuaj. Nëse ju dëshiron që prindrit tuaj të sillen mire me ju, perpiquni te beheni ekstremisht i respektushem dhe personi fillon te pyese, "Tani çfarë duhet të bëj unë që ta ruaj respekton e mos ta humbas atë?." Dhe ajo çfarë ata vlerësojnë më tepër është respekti. Te moshuarit më tepër vlerësojnë respektin. Dhe nëse ju tregoni respekt ndaj tyre ata nuk do duan ta humbasin ate per asnje lloj gjeje. Ju mund ti beni ata te bejne cfaredo qe ju doni nese ju vertet tregoni respect per ta. Dhe ata do te luftojne per ta mbajtur ate edhe nese duhet te heqin dore nga cdo gje, i mbajne ato larg nga ju vetem per te ruajtur respektin. Por sic e shihni, kështu ndodh, ju zbuloni se prindërit tuaj nuk po bëjnë gjënë e duhur, dhe filloni të dyshoni për ta, më pas ata mendojnë, "Kjo ishte,, ne e humbëm respektin, çfarë do fitojmë tani ne?" Sepse sic e shihni e shikoni, këto gjëra nuk krijojnë ndonje, ndonje gjurme në trurin e tyre. Ne patem një rast, një djalë, ai më tha rreth babait të tij, që ai kishtë qenë ashtu dhe se ishte sjellë ne te tille mënyrë, dhe ishte gabuar shume ne lidhje me të. Unë thashë, "Jam dakord se është shumë gabim dhe ai nuk duhet ta bente" dhe gjithashtu i thashë, "Çfarë jeni duke bërë?" Ai tha, "Ne po e godasim atë, po e godasim, po abuzojmë me të." Dhe unë i thashë, "Nuk eshte kjo menyra. Kur ai të vijë në shtëpi perpiquni të beheni shume të respektueshëm. Përpiquni." Funkcionoi. Ai e la gruan. Sepse per te ka rendesi respekti. Dhe ju e dini se sa i madh është respekti? Pas te gjithavej, shumica e njerëzve që ju shihni në kete botë, kerkojne respekt. Nëse ju respektoni dikë, ai personi është i predispozuar të heqë dorë nga gjithçka për kete respekt. Dhe një baba e meriton atë, sepse ai është babai juaj dhe sapo ju ta pranoni këtë, "Po, baba, po, po," dhe në një mënyrë të respektueshme, ju vetem provojeni, dhe do shihni se do të funksionojë. E shihni, nëse ju dëshironi diçka, në rregull, çfarëdo të keni, thjesht pyesni, por a mund ta ndalojmë atë në kete pikë, le te flasim rreth diçkaje, ju mund ta drejtoni vëmendjen e babait tuaj vetëm nëpërmjet te qenit i respektueshem, ju vetem provojeni me nenen dhe babain tuaj. Ju nuk duhet ti drejtoni ata, është e vërtetë, po ju them sekretin. Nuk është ndonje gje, e shihni, ti ndryshoni menyrat , metodat apo cdogje tjeter, por une jam duke ja u thene sekretin sepse ju e keni humbur idenë e menyrave secrete të të fituarit mbi njerëzit, duke i kuptuar dhe manaxhuar ata, ju vërtetë do te jeni ne rrugen tuaj. E vetmja gjë është ti respektoni ata. Mendoj se mund të kemi disa pyetje. (Muzikë) Bibla është një libër i cili është përpiluar nga njerëz të ndryshëm në vende të ndryshme në faza të ndryshme dhe tek te gjithë kjo është zbuluar nëpërmjet Pavetedijes. Te gjithë njohurite qe ju gjeni ne Bibel jane zbuluar tek ata nga Pavetedija dhe ata me te vertete nuk munden ta kuptonin tekstin e plotë të saj. Çfarëdo ata kuptuan apo mblodhen, e hodhën poshtë. Një pjesë e saj humbi sepse nuk u regjistrua menjëherë dhe sepse vete Bibla origjinale humbi, kështu të gjitha shpjegimet, të gjitha gjërat u lane mbas dhe kjo eshte pse njerëzit paten dore te lire



per te bere cfardo te ata ndjene sikurse me te gjithë fjalet e bukura qe jane ne Bibel. Për shembull 'Fjala' – çfarë është fjala? Eshte Krishti apo diçka tjetër? Nga çfarë është eshte e perbere? Çfare kuptimi ka, si filloi, nga erdhi? Ajo është OM. OM vjen nga tre fjalë: UH, OOH, MUH. UH, OOH, MUH. UH perfaqeson krijimin e parë të kanalit së majtë, ate qe ne quajmë fuqia Mahakalit. E para qe zuri vend ne manifestimin boteror te superegos, kështu ne mund të themi se kjo UH perfaqeson fillimin vetem deri tek etapa kur jeta nuk ishte krijuar. OOOH perfaqeson etapan tjetër, ku, tingulli tani është i njëjtë. Tingulli është i njëjtë, manifestimi është ndryshe. Zëri është i njëjtë, tingulli Im është i njëjtë, për shembull cilido të jetë tingulli Im, ju mund ta kuptoni kudo qe Une te flas, ky është fjalimi i Shri Mataji. Ndoshta manifestimi është ndryshe tek UH, OOH, MUH, kështu fillimisht UH fillon, pastaj vazhdon OOH, e cila është fuqia Mahasaraswati[3]. Ne mund te themi të treja notat qe kemi si, SAH, UH SAH..... tre notat bazë, kështu nota e dytë është Mahasaraswati nga e cila jeta, jeta Diellore filloi te funksiononte. Dhe e treta është MUH nëpërmjet së cilës filloi të zërë vend evolucioni. Kështu kjo është etapa Mahalakshmi[4]. Kështu ju i keni këto tre fuqi qe punojne së bashku dhe kjo është, nje forme te shkurtuar, ne themi eshte OM. Por nuk eshte thënë vetëm nga qëniet njerëzore. Kur ju meditoni ju keni parë kete OMMMMMMMMMMMM. Unë po them së këto tre fuqi kanë një të tretë, këto tre tinguj dhe ne kete menyre është krijuar kjo fjalë, OM. Për një shpirt të realizuar, OM është gjeja me e fuqishme. Për shembull, nëse ju dëshironi të mbronni veten tuaj, fjala OM ne vetevete mund te mbroj dhe kur këto tre fuqi kombinohen si një OM ne themi se eshte vetëm fëmija ose Djali Zot qe përfaqësohet në formën e tij me të pastër të OM. Prandaj në jetën e Krishtit ose mund të themi në jetën e një personaliteti që përfaqësoi djalin e Zotit, OM është shumë e rëndësishme sepse ai e mishëron këtë OM brenda Vetvetes. Të gjitha këto tre fuqi janë tek Ai në formën më të pafajshme. Ajo çfarë po përpiqem të them është kjo mënyrë, tani zgjidhni ndonje hyjni tjetër, hyjni te tjera, përveç kësaj ketu. Zgjidhni ndonje tjetër hyjni, ju do zbuloni se ata kanë më shume fuqi se kjo fuqi. Për shembull, nëse ju zgjidhni Vishnu, ai perfaqeson evolucionin, nëse ju zgjidhni Brahmadevan, ai perfaqeson krijimin. Nëse ju zgjidhni Mahesha, ai perfaqeson atë që ju quani ana e superegos. Edhe nëse zgjidhni Krishnan, ai perfaqeson evolucionin. Por kur ju ngriheni këtu, vetem atehere ju zbuloni se këto tre fuqi kombinohen këtu tek Agnya. Deri te Agnya ata janë të ndara. Tek Agnya ato bashkohen. Prandaj është shumë e rëndësishme se te tre keto forca kontrollohen nga Krishti dhe prandaj Jezu Krishti është hyjnia më e rëndësishme për sa kohë Sahaja Yogistët janë të shqetesuar, sepse evolimi është në rregull, por koordinimi dhe mbrojtja totale e një qenie humane është e mundur vetëm nëse ju keni këto tre fuqi në duart tuaja. Ajo e arriti evolimin e saj pothuajse ne rregull, ajo e arriti realizimin e saj, por më pas ajo zbuloi se ana e saj e majtë është thyer. Por të supozojmë se edhe nëse ajo ka evoluar, çfarë do të bëjë ajo nëse ana e majtë po e mbytur atë? Vetëm Krishti mund ta shpëtojë. Tani të supozojmë se ana e djathtë është hiperaktive, tek disa njerëz është, ju e dini shumë mirë kete, ana e djathtë e shume njerëzve është aktive kur ju shikoni se ego e tyre është shumë e forte. Për ata gjithashtu, të supozojmë se ata jane evoluar, çfarë do të ndodhë ata do te na qellojne të gjithve. Por nëse ata janë të sulmuar nga egoja e tyre, vetëm Krishti është personi që mund ti japë atyre balance. Dhe nëse ju e shihni Krishtin, Krishti eshte një balancë e plotë. Është një balancë e plotë e nje pozite të lartë. Keni parë një balancë, si është ajo? Balance e cila qendron ne nje pozicion me te larte se qendra. Dhe keshtu Ai eshte, Ai balancon dhe kjo eshte pse Ai eshte vete Omkara, mishërimi i Omkarës sepse siç e dimë Ai është Ganesha dhe Ganesha është personifikimi i Omkaras. Në këtë tingull të Omkarës, te gjithë tingujt e botes ndodhet aty. Të gjitha ndryshimet dhe kombinimet, melodia e plotë e këtyre universeve brenda këtyre tre tingujve: UH, OOH, MUH. Eshte bazuar në OM. Gjithashtu kur Kundalini lëviz , lëviz në tre mënyra: UH, OOH, MUH, sepse në një pjesë më të ulet te saj është UH. Në pjesën qendrore është OOH, dhe ketu është MUH. Do të thotë se në pjesën e ulët e qënies njerëzore ne jemi ajo qe eshte krijuar si nje lende e vdekshme. Në qendër ne jemi çfarë është krijimi, do të thotë kreativiteti dhe në të tretën është evolucioni, keshtu edhe pse ne jemi të ndarë në tre pjese, te cilat jane, pjesa jonë më e lartë është MUH, pjesa qendrore është OOH dhe pjesa me e ulët është UH. Kjo eshte se si ne jemi, dhe kur ju thoni OM në mënyrën e duhur, ju ndjeni se Kundalini është duke u ngritur. Nuk na asnje dallim ne lidhje me ato qe shqetesojne Biblen, Sahaja Yogen, Kuranin apo Giten. Vetëm njerëzit me vizion të limituar mund te shikojnë diferenca. Ai që ka parë brendësinë e saj nuk mund t'i shohë ndonje diference, sepse ajo eshte e njëjta. E vetmja gjë është për shkak të rrethanave, për shkak të metodave të ndryshme me te cilat u manifestua, ju mund te gjeni diferenca te vogla tek ato, por për sa kohë lenda eshte e interesuar dhe substanca eshte e interesuar, është e njëjta. Une nuk mund të gjej qoftë edhe një fjalë te cilen nuk mund ta shpjegoj në Bibël, në Kuran apo në Gita. Çdo gjë mund të shpjegohet shumë qartë, por problemi me njerezit është se ata nuk mund të mendojnë në mënyrë unifikuar, qëniet njerëzore nuk munden. Ata do të përpiqen të gjejnë nje guacke apo ndonje lloj pellgu për të ngecur. Kjo është natyra humane. Ata duan të bëhen krimba, gjithë kohës, sepse ata ishin dikur, ata duan përsëri të bëhen krimba dhe amoeba, unë mendoj se ata do i japin fund kesaj gjendje, nuk di çfarë të them. Kjo eshte pse, ata nuk mund ta shohin të vërtetën e vetme universale e cila po rrjedh tek ata, dhe kjo është arsyeja e cila ka vuarë fetë, kudo, sepse sapo ju te dini që eshte i njeti tingull që po kalon nëpërmjet gjithë këtyre feve të bukura, lulet e krijimit universal, më pas nuk mund të ketë asnjë problem apo lufte dhe duke krijuar këtë lloj vdekje për të gjitha fetë që ata kanë lejuar keta njerëz te tmerrshëm të vijne dhe të pushtojne fazen

tani, kështu ju silluni me ta me miresjellje, dhe lini pas të gjitha problemet tona fizike, emocionale dhe mendore. OM funksionon si gjithçka. Tani ju mund të thoni se ku është fjala OM ne fene e Krishterë? Ajo është tek Amen. Amen nuk është asgjë tjetër veçse OM, sepse MUH do të thotë një tingull hundor fund i një tingulli hundor dhe NUH gjithashtu do të thotë tingull hundor, sepse në gjuhën Arabe është e shkruar si NEE, e shihni, dhe NEE bashke me emrin Tim, ju thoni, NOOH, me emrin Tim fillon NUH, gjithashtu e shkruar me një pikë, të gjitha ato kane marre nga nje pikë. Është kjo pikë që tregon se është një NUH. Dhe në gjuhën e Sanskritisht, pike do të thotë NUH. Dhe prandaj është MUH dhe NUH. Amen është e njëjta si OM. Tani problemi është cdo gje, sic evolimi po perparon, ka ndryshuar dhe kjo eshte arsyeja qe OM është sjellë në nivelin e Amen. UH u bë AH dhe OOH u bë MUH, dhe MUH u bë NUH. Siç ju thashë Krishti erdhi si qenie njerëzore, por Ai ishte Ganesha. Dhe swastika u be kryqi. Ne te njeten menyre, OM është Amen. Kështu pas çdo lutjeje ju duhet të thoni Amen. Pse jo Amen? Çfarë do të thotë ajo? Nga këtu fjala OM mbaron në gjuhën Angleze. Nëse e shihni, madje edhe në fjalë, në gjuhë, universaliteti tingëllon por ne nuk kemi sy ta shohim universalitetin. Ne mendojmë, "Oh ne jemi Kristianë. Ne besojmë tek Krishti. Ne nuk besojmë tek të gjitha këto te pakuptimtat". Sepse të gjitha te tjerat jane te pakuptimta. Por nese jeni të lidhur me Krishtin? Sa shume dini ju për Krishtin? Askush nuk di, e shikoni. Dhe kjo eshte se si të gjitha problemet e feve tani jane duke u shfaqur përpara jush, dhe se njerëzit nuk besojnë më në asgjë. Ata thonë se të besosh në fe është marrëzi. Dhe gjithë kjo marrëzi vazhdon. Pse ka aq shumë para nëpër kisha? Pse duhet të kemi ndonje papë dhe pse duhet të kemi keto organizata të mëdha në emër të Zotit? Pse duhet të kemi tempuj, pse duhet? Dua të them, ka, si këtu, kemi kudo njerëz që revoltohen kundër të gjitha këtyre të ashtuquajtura fe, por çdo gjë ka ardhur tek qëniet në emër të Zotit, në pastërtinë e zemrës së tyre ka ardhur tek ata nga vete Zoti. Problemi i vetëm është, kur i është komunikuar një qenieje njerëzore i cili nuk është akoma i realizuar, mjaft i realizuar, sa shume mund te kuptojne ata? Ju e keni pare tashme, sa shumë di Kevin dhe sa shumë dini ju. Kështu edhe ata qe janë pak të realizuar, sa shume po perpiqen ata per te ditur cfare deshiron Ai do të komunikojë? Dhe prandaj kjo lloj ndarje qesharake filloi nder qëniet njerëzore dhe ne momentin qe ju e shpërbëni fenë tek fetë, mbaroi. Kjo ka qene rruga më e mirë për ti dhene fund fesë, sepse ata nuk dhanë thelbesoren, rëndësine e thelbesores. Ata thjesht u përpoqën ti japin rëndësi diçkaje që është kaq sipërfaqesore dhe kjo sipërfaqesi gjithashtu u krijua nga ata njerëz të tmerrshëm, të cilët thjesht donin të përdornin Krishtin si kuletën e tyre. Krishnan sikur Ai te ishte vatra e tyre. Kjo Om është përdorur në të gjithë botën në një mënyrë shumë delikate dhe fjala MUH do të thotë Ma, dhe ju e dini që të gjithë ne për nënën përdorim fjalën Ma. Kudo që të shkoni në të gjithë botën ata e kuptojne fjalën Ma. Askush s'ka problem sa kohë qe perdoret fjala Ma, sepse ajo perfundon brenda saj, kjo do të thotë se i gjithë krijimi mbaron tek këmbët e Nënës, edhe Krishtërimi ju mund ta kuptoni se ai është Nëna, eshte edhe dashuri. Kur ata flasin për Mahommed Sahib, ata duhet të dinë se Ai duhet të ndihmohej nga e pesë gra për të qenë atje. Dhe ato ishin njera me e mire se tjetra, të gjitha ato ishin UH OOH MUIH, me te, fuqite. Ato ishin fuqitë që ai kishte, dhe prandaj ai duhet të martohej me kaq shumë. Askush nuk e kuptoi se çfarë ishte kjo, për shembull gruaja e tij e parë Hadjia nuk ishte askush tjetër veçse Mahasaraswati. Vajza e tij nuk ishte askush tjetër veçse Mahalakshmi. Kështu te gjitha fuqite e tij ishin te shprehura tek gruaja e tij, motra, ose vajza të cilat e ndihmuan atë në jetën e tij, per te mbajtur fuqitë e tij. Tani e njëjta fjalë Om është përdorur edhe nga forcat negative gjithashtu. Si ata e përdorin atë? Ata do ja japin këtë emër disa djajve, normalisht ata nuk e bëjnë, sepse kjo është një nga fjalët më të pastra e cila nuk mund të ndotet. Normalisht ata nuk munden. Nuk kam takuar asnjë deri më tani që ka brenda tij ndonje djall me këtë emer OM, dhe asnjëri deri tani nuk i ka vene këtë emër askujt, por kam parë njerëz që të vene emra si ..... Këto janë emra, të ndryshëm – "imee" perfaqeson Mahakalin, "glee" Mahasaraswatin, "ree" Mahalakshmi. Kështu ata mund ti vene këto emra, vec e vec tek djajte qe ata duan te vendosin. Për shembull do marr emrin e nje xhentelmeni, ju e njihni atë, i cili e quan veten i jashtëzakonshëm, ai i përdor këto emra. Patjetër, i pari prej tyre Imee tashme është lidhur diku. Tani keto Imee bree glee, megjithese janë emra te Hyjnive. Ai mund ti përdorë, por ai nuk mund të përdorë emrin OM, dhe ai nuk mund të përdorë emrin e Jezusit. Ai nuk mund të vendosi emrin e Shri Ganeshes. Këto emra janë përtej .....te tyre. Ju e shihni sepse ata janë të tmerrshëm, një Nënë mund të falë, por këta njerëz janë, ata thjesht i djegin ata dhe prandaj ata nuk guxojne ti vënë këto emra. Ju nuk mund te gjeni, megjithate ata mund ti thone ato keshtu, kjo ne emer te Jezusit, e shihni, mund te thone ata. Ata mund të përdorin emrin Jezus: në emër të Jezusit unë ju jap juve këtë, keshtu, ata thonë fotografia e Jezusit, ata madje mund të përdorin edhe kryqin. Sepse ju mund ta shihni kryqin e bere vetem nga këta njerëz. Ata mund ti vënë ato. Por ata nuk mund ti vene emrin e Jezusit këtyre djajve, ata nuk mund t'ju kerkojne juve, "Thuaj Jezus, Jezus". Ata kurrë nuk do të thonë këtë. Por ata thonë..... Ata mund të thonë nga të gjitha llojet e OOHM-s dhe çdo gjë. Por me të gjitha këto ata mund të sulmojnë ndonje, ne kete menyre, ata thonë, "OM Namoh Shivaya," është në rregull. OM Namoh Shiva, tani, OM-in ju tani e keni vendosur, keshtu ajo neutralizon, ata ndoshta nuk e dinë që ajo neutralizohet pak."OM Namoh Shivaya." (Fund i njërës anë) Kështu emri i dikujt është Namoh Shivaya dhe ai vjen permes tij. Dhe do të thotë kaq mrekullueshem, do të thotë se ju përkuleni tek Shiva. Atij aspekti te Zotit i cili është i perjetshem. Por ata do të thonë se ju moret emrin "OM Namoh Shivaya" sepse me të gjërat mbifuqizohen nga Shiva dhe kështu

ata do ta perdorin OM-in, por ata kurrë nuk do perdorin OM si nje fjale te vetme , sepse asnjë djall nuk do ta zotërojë atë emër, eshte shume madheshtor. Dhe këto janë hilet me te cilat njerëzit luajne me fjalën OM dhe ju duhet të luani njesoj. Kurdo që të ndjeheni keshtu, ju thjesht thoni OM. Mos thoni asgjë tjetër, thoni OM. Për ju, çdo fjali ka një fund. Edhe nëse ju thoni “OM Namoh Shivaya” ..... Por edhe nëse thoni “OM Jesus,” është mjaftueshëm. Tani në një rreth, nëse ju thoni universin e plotë në një rreth, më pas ju bëni tre pjesë të saj, ju perftoni tre harqe. Themi njëri është UH, tjetri OOH, tjetri MUH. Kur ju përpiqeni ti rindertoni ato, ju perftoni UH, OOH dhe MUH, këto janë tre harqe, ju rindërtoni ato. Harku i parë është i vendosur kështu, UH, OOH, i dyti po kështu dhe i treti është MUH. Dhe pika në të është pika qendrore. Është pika qendrore e rrethit, pika në të. Tani ju keni parë se si fjala OM është shkruar dhe kjo eshte se si ajo eshte të tre harqet janë përshkruar njesoj, kështu i gjithë krijimi dhe pika qendrore, e cila është vete Zoti, të gjitha të vendosura së bashku bëjnë OM-in, dhe kjo eshte se si ajo eshte duke u quajtur. Mendoj se ju tregova tani se pari kur krijimi ndodhi, si ne fillim OM u formua. Nuk ju them me parabola, me vizatime, kështu tingulli i parë, tingulli i parë që filloi për shkak të ndarjes, ndarjes se parë, kur ai u vendos midis dy identiteteve, Zoti dhe Fuqia e Tij, kjo ishte koha kur tingulli filloi dhe ai tingull nuk është asgjë tjetër veç se OM. Ai tingull do të jetë aty dhe do të funksionojë derisa këto dy identitete të bëhen një, më pas nuk do te kete relativitet të mbetur, kështu aty nuk do te kete asgjë, kështu njerëzit mendojnë se bota është krijuar nga asgjëja, sepse aty nuk ka relativitet, kur ato bëhen dy atëherë ka diçka, per ndryshe ato jane një dhe absolutë dhe kështu aty nuk ka asgjë, kur tingulli bashkohet ose perfundon, ose sic themi zhduket..... (i padëgjueshëm). Kjo është koha kur i gjithë krijimi bashkohet në një veprim. Pra kjo është pika kur cdonjeri i duhet të shkoje. Tani, brenda qenjes tuaj kjo ndodh. Në fillim ju ndjeni OM, ju ndonjehere ndjeni tingullin qe vjen, ndonjehere disa lloj shpimesh duke ndodhur, sepse jane shtatë tinguj, të cilët janë lehtësisht te dallueshëm jashtë kesaj OM. Lehtësisht. Por aty jane shume, por unë po them të paktën shtatë prej tyre mund ti gjeni lehte. Nëse bini ne qetesi ndonjehere ju mund të dëgjoni disa lloje zilesh duke tingelluar, ndonjëherë ju do të mund të dëgjoni si tingull e ujit qe bie dhe ndonjëherë mund të dëgjoni sikur se gjate natës kengen e bulkthit. Ju shihni të gjitha llojet e tingujve jane duke ardhur, ju ndjeni që ato janë atje, dicka po ndodh, gjate nates, e shihni, kete lloj ndjesie do te keni, të gjitha llojet e tingujve janë aty, por shtatë tingujt ju mund ti dalloni lehtësisht dhe të gjitha ato te vendosura se bashku formojnë OM. Kështu, nëse i luani të gjitha ato në mënyrën e duhur, në një mënyrë melodioze, mire mund të themi në një mënyrë harmonike, më pas ju do dëgjoni tingullin OM. Tani, nese një sygjerim eshte duke ardhur tek ju nga diku, ju gjithmoni do ndjeni një tingull në veshët tuaj, kështu ju duhet te beheni vigjilent. Ju jeni paralajmëruar dhe thjesht ju duhet beheni te vëmendshem cfare ideshe jane duke ardhur dhe papritur ju vjen nje ide. Kushtoini vemendje asaj. Këto janë ide që vijnë nga e pavetedijshmja. Vetem prisni, tingulli do të vijë. Dhe tingull do të sugjerojë se po eshte një sugjerim duke ardhur, shënojeni ate. Por me djallin, një gjë e tillë nuk do të kurre ndodhë, ju kurrë nuk do ta arrini te degjoni tingullin, ju gjithashtu do të arrini Ad ose dicka..... me fragmente të vogla ndoshta sepse ata mbajne fragmente, tamam..... Por më tepër ju ndjeni nje ere shume te keqe, si te nje lekure te djegur, ose dicka si vezë e prishur, ju ndjeni nje ere te tmerrshme nga ata njerëz të cilet jane te posesuar. Kështu kjo OM është një tingull që kupton, qe flet, qe organizon, qe informon dhe ky është tingulli i dashurisë Hyjnore. Kjo është ndjenja elektrike që ju e ndjeni në duart tuaja. Por ky është tingulli. Gjithashtu ne kemi pesë lloje shume delikate te te shprehurit të pesë elementëve dhe ato janë tingujt fin e te persosur te OM-it. Vibrimet janë elektrike, është një magnet në atë tingull ose në atë fuqi për një person që është i realizuar. Personi që është i bekuar nga Zoti ka një fuqi magnetike. Ai person tërheq. Ky person mund edhe të mos flasë, por njerëzit e kuptojne. Ata e dinë që ai është një njëri i realizuar, ka diçka te vecante ne lidhje me te. Ju mund ta zbuloni kete menjëherë, se çfarë është ai. Është për shkak të këtij tingulli dhe magnetit. Ju duhet ta keni dëgjuar kete tingull kur ne u konvertuam ne materie. Në të njëjtën mënyrë, të gjitha gjërat janë konvertuar, tingulli bëhet magnet, magneti bëhet vibrime, vibrimet mund të bëhen Shpirt. Kështu te gjitha janë të konvertueshme dhe pjesë perberse te te njetes gje, e njëjta energji e cila është dashuria Hyjnore, e cila është dashuri. Dashuria ka një tingull dhe dashuria ka elektricitet, ajo ka magnetizëm dhe ajo ka fuqine. Kur të gjitha këto fuqi delikate jane derdhur brenda cdo qenie humane, ajo vepron, vepron dhe njerëzit fillojnë te përmiresohen ne shëndetin e tyre. Ju duhet të keni dëgjuar për eksperimentet ku njerëzit kanë provuar muzikën në disa njerëz te cilet nuk kane qene mire dhe ata janë shëruar. Dhe ajo çfarë ndodh është se delikatja, fuqia delikate e tingullit që ne po manifestojmë qe eshte mbas tij, fuqia qe e manifeston ate, futet ne veprim. E cila eshte një gjë shumë e vogël këtu por me ju njerëz, kur ju vendosni doren tuaj ky është tingulli OM i cili eshte duke vibruar, eshte është I vogel , mikrovale vibrimesh, të cilat ju nuk mund ta shihni me një lupe, ju nuk do ti shihni. Gishtat e mij jane duke u shkundur fare, ju mund te thoni se ato jane shume te qendrueshme, por ato jane vale shume te vogla. Dhe kur mikrovalët kalojnë në trupin e qënies njerëzore, atje ato zgjojnë mikrovalët që jane duke fjetur në trupin e qënies njerëzore ose çfarëdo gjëje ju te përdorni ato fillojnë te gjenerojnë te dyten, atë që ju e quani, faze..... e te jashtmes..... Për shembull, do ju a tregoj se si. Tani, unë e vendos dorën tek një person që është i sëmurë. Tani une e vendos ate ketu dhe ai është i sëmurë ne kete pjese, ai ka disa probleme, çfarë ndodh? Këto valë, jane duke kaluar në të dhe çfarëdo që është duke fjetur aty, ato e rigjenerojne. Dhe ato fillojnë zgjohen dhe fillojnë bëhen më të forta. Tani,

ato gjenerojnë pjeset te tjera , ato më të dukshmet, prej të cilave njeriu ndihet i shëruar Për shembull, ne bejme kështu, tani gjaku është i mpiksuar ketu, aty nuk ka qarkullim te gjakut. Ju i vendosni vibrimet tuaja aty, çfarë ndodh, mpiksja e gjakut fillon shpërndahet, sepse fuqia shpërberese e gjakut është Vitamina K. Dhe prodhimi i vitaminës K është e ngacmuar nga keto vibrime qe kalojnë permes kësaj pjese dhe Vitamina K është e ngacmuar aty. Më pas nëpërmjet mikrovalëve të cilat e largojne ate dhe kështu funksionon. Por ju nuk mund ta shihni atë. Ajo Thjesht funksionojnë. Ato janë abrusha (?) Ato janë të padukshme. Por ato janë aty. Ti regjistrosht ato eshte e pamundur. Sepse qëniet njerëzore nuk kanë ndonje instrument te tille. Tani mee pakta, falë Zotit, shkencëtarët e kanë pranuar se ne nuk kemi veshë të regjistrojmë çdo gjë që është brenda tingull. Kështu, në të njëjtën mënyrë, ata nuk paten rregjistruer per të regjistruar vibrimet e këtyre mikrovalëve. Tani, kur ju o njerëz thoni OM, njerëz te realizuar, kur ju thoni OM, valët e tingullit te OM, ju vetem provojeni tek një person i cili është, pikerisht tani ju jeni duke patur dhimbje aty. Në rregull. Pikërisht tani vendoseni doren atje dhe thoni OM. Provojeni. (muzikë) Une dëshiroj se pari tju flas ne lidhje me takimin Tim dhe pse Gandhi eshte kaq i rendesishem. Ndoshta ju kurrë nuk e keni kuptuar se çfarë instrumenti i fuqishem Gandhi ishte. Në moshën shtatë vjeçare ai më mori nga familja Ime, dhe Unë qëndrova me të, shumë, shumë afër, ekstremisht afër dhe ai filloi të më quante Nepali. Ky ishte emri Im. Dhe të gjithë më njihnin me kete emër. Pas 40 vitesh, ose pak a shume 45 vitesh, papritur unë e takova në dasmën e djalit të tij. Unë shkova tek ai, ai më njohu menjëherë. Ai tha "Oooh, Nepali, si eshte e mundur qe jeni ketu "" Lotet filluan te me rridhnin poshte syve. Ai ishte Gandhi. Ai ishte një mjeshtër shume i rrepte gjithashtu, dhe unë gjithmonë i thosha se ai mund te ishte i ashper por si mund te jesh i ashper me te gjithë keta njerez? Ai na zgjonte ne në orën 4 te mengjesit. Për Mua ishte e shume e lehte të zgjohesha në katër sepse trupi Im s'ka zakone, kushtezime, Unë mund të zgjohem në çdo kohë dhe mund të fle në çdo kohë, por unë flas për të tjerët.....të zgjohesh në orën katër, dhe ata duhet të pastronin tempujt e tyre, ata ndonjëherë duhej të pastronin, të pastronin banjot dhe lavamanet dhe çdo gjë me duart e tyre. Ai ishte një mjeshtër shume i ashper, por gjithashtu një person ekstremisht i dashur dhe i mëshirshëm. Ai, tamam si tani, siç thoshin të gjithë, ai gjithmonë më drejtohej shume pozitivisht dhe në një mënyrë sikur unë të isha gjyshe, dhe ai bisedonte me Mua gjëra, në një mënyrë që habiteshin të gjithë, ne nje menyre sikur une te isha me e madhe dhe me e mencur se cdonjeri, dhe ai më bënte të thosha (?). Dhe ai thoshte se udheheqja mund te jete me mire nga disa femije se sa nga njerezit e moshuar Edhe kur unë isha në Gamlasha (?) kesaj here, bashkëshorti Im më tha të njëjtën gjë, "E mban mënd , keshtu e kishte zakon te thoshte " Unë i thashë, "Po e mbaj mend ate" Por në një fare mënyrë ai më kishte njohur mua dhe ai kishte marre vesh rreth Meje nga.....i cili me kishte njohur dhe nga te tjere te cilet ne nuk i njihnim Ai ishte një personalitet i jashtëzakonshëm. Dhe gjëja që unë mësova nga ai, duhet ta them se ishte një nga gjërat që nuk do e kisha kuptuar kurrë, është kuptimi i parasë publike. Në te vertete nuk e kam fare sensin parave, Nuk e di së çfarë është banka, nuk di si të arketoj nje cek. Une akoma, Une mund te kem arkeluar shume ceqe por akoma nuk e di se si behet, edhe nëse ndonjeri përpiqet të më mësoje unë thjesht nuk mundem. Nuk jam e afte per kete. Por kam parë sensin e Gandhiji't për paranë publike, ai ishte aq i prirur, me i prirur dhe me i zgjuar se çdokush tjetër që ka jetuar me të, Une nuk mund ta kuptoj se si munden ata të bëjnë te tilla marrveshje të lira me paratë publike. Një herë patem një takim me të gjithë liderët e mëdhenj dhe ata erdhën në Nandi ashram ku të gjitha ne vajzat po qëndronin dhe disa djem ishin atje, duke i pare ato, dukë i dhënë atyre broshura dhe gjëra, dhe papritur Gandhiji vuri re se ishte bërë shumë vonë dhe se ata duhet të hanin drekën në ashramet e tyre . Kështu ai tha,"Pse te mos e hani dreken këtu." Ata thanë,"Në rregull, nëse ju mendoni kështu, në rregull." Kështu ai u ngrit., a gjithmone kishte..... me vete sepse..... nuk ishte atje kështu ai zbriti poshte dhe na tha, "Lë ta ndajme ushqimin edhe për ta" Kështu ne na u desh ta rraciononim sipas numrit të njerëzve që ndodheshin atje. Ai tha unë jam një bakhta pavya, ju duhet ta ndani ne menyren e duhur dhe te peshoni gjithcka, ai e mori ate dhe më pas atij ju deshën 15 minuta për ta bërë kete, pastaj serisht mori nje rracion..., e vuri prap ne vend dhe vazhdoi ne punën e tij. Unë mendoj se ishte Maulana Azad ose dikush tjetër që ishte atje cili tha, "Babu unë kurrë nuk jap, ne nuk menduam se do te hapje kaq shumë telashe për shkakun tone. Ne mund të ishim kthyer pak me vone dhe te kishim..... Ai tha, "Telash, çfarë telashi? Jo." Mënyra se si ju u ngritët dhe deshët te largoheshit (?), ju jeni kaq i matur dhe i kujdesshëm ne lidhje me kete. Ju e dini cfare fjale ai perdori, ju e dini."Ky është gjaku i njerëzve të mi nuk mund ta lejoj atë të shkoj dem apo të derdhet ne ndonje lloj menyre." Vetem imagjinojeni, ai tha,"Nibhani dani mira droga" dua të them, nuk mund ta harroj sensin e tij të te mirkuptuarit. Edhe pse kam parë z. Shastri duke bërë të njëjtën. Dua të them, nuk ishte aspak e nje standarti të dyfishtë. Perkundrazi, sa me afer tyre te jeni, ju do ti respektoni ata më shume, sepse ata janë kaq të pastër, kaq te paster, dhe ata mendonin se me kete ata do ta ruanin ate pastërti dhe atë standart. Ne jemi vërtet shumë me fat që kemi te tille njerez te medhenj të lindur vendin tonë. I vetmi shqetësim është se kemi harruar se çfarë kontributi të madh kanë dhene ata, se Gandhiji ishte njëri nga ata që erdhi në këtë tokë për të na shpëtuar ne nga ky dominim i degraduar , në nje mënyrë kaq unike ai hodhi themelet e Sahaja Yoges. Në te vertete ai hodhi themelet ne cdo drejtim. Për shembull nëse shihni idetë e tij, idetë ekonomike, janë absolutisht në përputhje me Sahaja. Pas Revolucionit Industrial siç e quajnë në perëndim, njerëzit kanë përparuar kaq shumë në krijimin e nje ekonomie agresive saqë ata

jane te shtangur me menyren se si gjerat jane duke funksionuar ne keto vende. Agresioni qe filloi me industrine, makinerine, eshte drejtuar tani drejt vetë qenieve njerëzore. Ne Angli ju do te mahniteni, kush eshte vendi me esell nder te tjeret. Në Angli, çdo javë vriten dy fëmijë nga prindërit e tyre sipas statistikave. Mund ta imagjinoni? Fëmijë të mirë. Ata nuk janë fëmijë të paligjshëm. Asnjë familje nuk është e sigurtë nga ky agresion. Agresioni tani është kundrejt vetes, është absolutisht vetë-shkatërrues. Makinaria, fëmija që filloi të krijojë gjëra, gjithashtu edhe qenie njerëzore makineri dhe këto makineri nuk kanë ndjenja brenda tyre dhe ndjenjat filluan të thahen dhe te thahen aq shume saqe qëniet njerëzore filluan të bëhen pa ndjenja. Ata nuk kane emocione. Nuk e di nëse Gandhiji e kishte ndjere ate ne te tilla permasa, sepse sic e dini, është e vështirë për një të shenjtë të shikojë forcat e djallit, sa shume mund te demtojne, është një gjë shumë e vështirë. Ai pa diçka, kështu ai paralajmeroi: mos hyni ne industries e rendë. Industritë e rënda janë shumë të rrezikshme, dhe ai e hodhi poshtë..... dhe u përpoq te mbante.....vend në industri. Me gjithë këtë ecuri në perëndim, ju do të habiteni se kushti është se ju nuk mund të merrni asgjë të freskët. Ushqimi që ju merrni është asgjë por nje Zot e di se çfarë lloj kimie kane adaptuar ata, dhe gjate gjithë kohës ju ndjeni sikur po hani kimikate. Ju nuk ndjeni skur po hani ndonjë ushqim. Nëse ju i flisni njerëzve, ju ndjeni se ata janë të habitur (?), janë të shokuar dhe të frikësuar nga njëri tjetri. Nuk ka dashuri, nuk ka besim, nuk ka dhenje dhe marrje. Është një shoqëri kaq qesharake absurde kjo që është krijuar, dhe eshte e rëndësishme për ne te shohim se ku kane rene keto te ashtuquajtura vende ne zhvillim , se nga çfarë kanalesh kanë shkuar dhe po qendrojnë, dhe shihni per veten tuaj se ndonese jeni duke u perpjekur te perdorni shkencen, te perdorni keto arritje industriale te ketyre vendeve te tjera si nje mjet per progresin tuaj, ju duhet ta dini se ato mund te na shkatërojne ne totalisht, sikurse kane shkatërruar keta njerëz . Shkatërimi nuk vjen nga jashtë dhe aq shume. Natyrisht është në një farë mënyre, mënyra së si ne krijuam Hiroshimën dhe të gjitha këto, por shkatërimi vjen nga brenda dhe ky shkatërim është duke marre permasa shume te medha, dhe është e pamundur ta ndalosh tani. E vetmja menyre është ta kthesh të gjithë gjënë në një dimension të ri nëpërmjet të cilit ju mund ta kontrolloni atë dhe kjo është e mundur vetem nëpërmjet Sahaja Yoges. Falë Zotit, bashkëshorti im u zgjodh dhe unë shkova në Londër, kështu ne kemi nje baze tani. Gandhi është njeriu i cili ka krijuar themelin e dharmes në këtë vend të koheve moderne. Nëse ju shihni Bajanawin e tij (?) e tij ju do të mahniteni, ai është i teri i bazuar në Çakra të ndryshme, njëra pas tjetres dhe i gjithë ky Bajanawi do të fillojë nga njëra tek tjetra. Është thjesht ashtu siç veprojmë për zgjimin e Kundalinit. Eshte bazuar njera pas tjetres, nga nje Çaker ne nje tjetër Çaker, ne nje tjetër Çaker, ne nje tjetër Çaker, edhe pse ai nuk ka permendur asgje Përveç kësaj, ne tek Sahaja Yoga, ne duhet të marrim ne konsderate të gjithë mishërimet, të gjithë profetët, të gjithë mjeshtërit e lashtë, të cilët erdhen në këtë tokë dhe rregulluan ne lidhje me veprime te ndryshme te Kundalinit. Sepse sipas Sahaja Yoges të gjitha keto mishërimet janë brenda nesh dhe ata na ndihmojnë dhe ne duhet ti zgjojmë ata. Gandhiji ka bërë të njëjtën gjë duke na treguar neve se duhet të shikojmë përreth, duhet të njohim Biblën, duhet të njohim Gitan, duhet te njohim te gjitha shkrimet e shenjta, njerëzit e mëdhenj dhe të integrohemi. Natyrisht, kjo pjesë më është lënë Mua, është aktualizimi i asaj qe ai donte te të bënte. Megjithese padyshim ai hodhi bazat ekonomike, më pas gjithashtu edhe ato politike. Ai kurrë nuk besoi në agresion. Kurrë. Dhe ai tha se kjo ndarje duhet të sillte. Ai gjithmonë besoi se edhe kapitalizmi duhet të mposhtet nëpërmjet ndricimit. Megjithese ishte ai shumë i zënë me punën emergjente te shpëtimit te gjithë kombit, ai nuk mund ti kushtonte shumë vëmendje anës delikate të Sahaja Yoges, të cilën unë e quaj zgjimi i Kundalinit i Vetërealizimit. Por ai gjithmonë fliste për, ai gjithmone thoshte ne lidhje me të, më e çuditshmja, ai është i vetmi që kam parë deri tani që nuk po bënte Vetërealizimin, por ishte kaq afër me të dhë mudi të shihte qartë se Vetërealizimi është e vetmja rrugë për emancipimin e qenieve njerëzore. Vlerat e tij dhe menyrat e tij ishin kaq korrekte. Si një nënë gjithashtu, unë isha një fëmijë por unë isha një nënë gjithmone dhe unë e ndieja se Gandhiji ishte pak si shume strikt dhe zakonisht i thosha: “Ju jeni shumë strikt, unë thjesht nuk e duroj dot” dhe lotët me rridhnin nga sytë. Unë i thashë, “Kjo është pak shumë.” Ai tha, “Jo. Ne jemi në emergjencë. Ne duhet të disiplinohemi. Ne duhet te disiplinohemi dhe duhet ti themi atyre.” Një herë une i thashe, “Babu, nëse ju doni ti disiplinoni njerëzit, pse te mos i jepni discipline nga brenda?” Ai tha, “Si të arrij tek vendi i tyre?” Unë thashë, “Është shumë e lehtë. Ju mund ta bësh atë.” Ai tha, “Jo pikërisht tani. Jo pikërisht tani. Mbi të gjitha, të jemi të lirë. Nëse ne nuk jemi te lirë, çfarë mund të gëzojmë ne? Ne nuk mund të flasim rreth saj. Njerëzit do të thonë se ne as te lire nuk jemi. Si mundemi të flasim për lirinë e Shpirtit? Ne duhet të lirohemi nga dominimi i te huajve.” Do të thoja ne emergjencë, të supozojmë se po përdorim një varkë për të kaluar matanë. Pastaj ne nuk arrijme ta mbajmë varkën me mendjet tona, por ne mbajmë eksperiencën e kalimit dhe këto eksperiencia janë shumë të mëdha. Dhe madhështia rreth Gandhit ishte se ai krijoi madhështi vetëm nëpërmjet karakterit të tij personal dinamizmit te tij, absolutisht nje lidershipit dinamik. Dhe vendi ku kjo ka ndodhur, une i kam parë këta njerëz ishin absolutisht të rigjeneruar. Nuk mund ta besoni se sa te sakrifices ishin ata. Une kam parë vetë babain Tim, dhe sot besoj se ai ishte një burrë legjendar, nëse ju them se sa i madh ai ishte. Dua të them, ne çdo gje, nuk mund të gjej një gabim të vetëm ne jetën e tij si lider. Por sot është shumë ndryshe dhe shumë e trishtueshme dhe se ata që supozoheshin të ishin njerëzit e Gandhijit, ndjekësit tij. Ditën qe kaloi, unë fola me dikë që pse te mos fillosh me edukimin bazë, sepse ne nuk jetojmë në qytete,

pse duhet ta kemi këtë edukim? Ai nuk i shkon fshatit. Dhe tha ai, "Është shumë ndryshe, është një sygjerim shumë ndryshe" dhe te gjitha keto. Une u habita, ai ishte një Gandhini, si mund të fliste ai kështu? Nuk është aspak e vështirë të adoptosh mënyrën e Gandhiji-t në Indi. Ashtu siç ju tha Gregoire, une kam qenë në Kinë dhe Mo padyshim e ka ndjekur Gandhin. Ai ka kopjuar cdo gjë që ka bërë Gandhi. Unë u mahnita sepse kur isha atje pashë edhe..... qe ishte praktikuar nga ai. Të gjitha gjërat që kishte menduar Gandhi, ai i kishte bërë dhe i kishte sjelle përparim Kinës. Dhe sot, Kina është si një tigër. Njerëzit janë frikësuar. E shihni, ky tigër tani është zgjuar. Tani çfarë do të ndodhe? Ajo po zoteron vete fuqine e saj. Dhe kjo është ajo që Gandhi ka ëndërruar, imagjinoni që Mao e ka përdorur atë dhe pse jo njerëzit tanë? Nuk e di. Duhet të fajësoj burokratët ose kongresmenët ose politikanët të cilët kurrë nuk e kuptuan se Gandhi ishte njeriu më praktik dhe tani Sahaja Yoga jam e sigurtë që do të rivendosi menyrat e tij. Padyshim duhet të vendosen. Pyetjet e teperta, zhvillimet e teperta, materialism i tepert ju bën ju skllav të materialit. Ju do të habiteni. Në jemi supozuar për te qene njerëz të varfër, jemi supozuar, por nuk jemi. Në Londër apo në Amerikë, njerëzit Amerikanë janë njerëz kaq doreshtrenguar aq sa jam absolutisht e shokuar. Absolutisht kopraci shokuese. Të shpenzosh pesë rupi për, dikë që vjen në shtëpinë tone, për ne nuk është asgjë, por Amerikanët janë njerëz kaq te doreshtrenguar, edhe nese ata duhet të shpenzojnë një rupi ata do të mendohen dhjetë herë. Te njëjten gjë kam parë në Angli. Te njëjten në disa vende të tjera. Tmerresisht njerëz të llogaritur dhe doreshtrenguar. Kam njohur disa njerëz, nese shkoni në shtëpitë e tyre do tju numërojnë kokat dhe do ju japin sanduicën që ju takon. E temerrshme! Dhe ata sillen në një mënyrë aq qesharake. Gjate gjithë kohës ata mendojnë për parate, si ti fitojne keto para, si ti mbajne ato. Ju nuk mund ta imagjinoni, ky bollek, i ka bërë ata kaq të varfër. Absolutisht absurde. Une gjithmone kam ndjere se nëpërmjet këtyre fitimeve materiale ata mund të bëheshin një lloj i kënaqur njerëzish dhe do merreshin me pak me materializëm. Por nuk është kështu. Është pikërisht e kundërta. Njerëzit e kanë marrë materializmin si një fe, dhe është kaq acaruese, kaq acaruese sa që ju nuk e kuptoni dot. Jeni absolutisht vetëm nga idete materialiste që keni, vlerat (?). Është një bote kaq e çmendur sa që vetëm nese qëndroni këtu, mund ta kuptoni se sa materialist ata janë. Kështu si përfundim, njerëzit që janë këtu, mund ti shihni ata, ata revoltohen. Ata nuk mund ta durojne dot më. Ata thonë, "Ne do të dalim jashtë kesaj." Por ende kthetrat e materializmit janë kaq të mëdha sa që atyre i duhet të jetojnë me to dhe ata e kanë shumë të vështirë kete, vetëm nëpërmjet Sahaja Yoges ata kanë bërë të aftë të stabilizojnë veten e tyre dhe te jene vetvetja. Do të thoja se këta janë pionerët e mëdhenj të cilët do të ndryshojnë të gjithë perëndimin. Ata janë burimi i së ardhmes së bukur të perëndimit, në të kundërt perëndimi tani është një tokë e konsumuar, asgjë përveç se një tokë e konsumuar. Shpresoj se këta njerëz do ta marrin Sahaja Yogen me seriozitetin e duhur dhe do ta përhapin mesazhin e Sahaja Yoga dhe do krijojnë kete atmosphere si pikërisht si tani Dr..... po thoshte, e zbukuruara atmosphere, e transformuara atmosfere. Në të gjitha vendet perëndimore, përhapet, funksionon dhe sjell agimin e një bote të re në të cilën ne të gjithë jetojmë së bashku si qenie njerëzore dhe si motra dhe vëllezër të vërtetë. Sahaja Yoga i ka bërë një shërbim të madh njerëzimit dhe ju ka dhënë juve antar yogen brenda vetes tuaj, ju ka dhënë antar yogen midis Sahaja Yogisteve dhe është kaq e madheshore sa disa prej këtyre njerëzve kanë qenë në Indi disa herë, ata kurrë nuk kanë qenë të aftë të afrohen me njerëzit Indianë, sepse të gjithë Indianët, ata të cilët kanë takuar, ishin të gjithë të perëndimuar pa..... Ata kishin të njëjtat ide, të njëjtën filozofi, çdo gjë të njëjtë, dhe ata ishin, ata ishin të dashuruar me perëndimin dhe ata po çmonin kulturën perëndimore dhe menyrat perëndimore. Por për here te pare ata thanë, kur ata u kthyen tani, ata shkuan tek besimet Indiane, dhe menyra se si ata perqafuan te gjithë fshataret dhe menyra se si kerccyen sebashku dhe menyra se si u gezuan, kjo është antar yoga e vërtetë, dashuria e vërtetë midis tyre. Gëzimi i vërtetë, unteti i vërtetë që cdokush ndjen. Nuk është thjesht të flasësh apo thuash gjëra ideale, që ne jemi motra dhe vëllezër dhe ju po dëgjoni, që ju të gjithë jeni motra dhe vëllezër, dhe asgjë që është, ju thjesht beheni, është aktualizimi ju nuk mundeni vetëm ta ndihmoni atë, duke ndihmuar një person tjetër. Për shembull tani. Nëse jam e ulur këtu dhe nese them se kam shëruar, nuk po bëj mirë, nuk po e bëj atë për ndonje nga ju, po e bëj atë sepse ju jeni pjese perberese e gjithësisë Time (?). Unë duhet t'ju tju mbaj mire tju kuroj nese une dua te ndjej veten time. Une mund tju ndjej ju brenda vetes. Ky është aktualizimi i vetëdijes kolektive. Dhe sa here që ndodh, ju thjesht filloni të ndjeni uniken dhe sot do ju flas për vetëdijen kolektive, nëpërmjet Sahaja Yoges, si ta arrijmë atë, është një aktualizim, jo shpëlarje truri apo leksion. Kjo është diferenca midis mënyrës se si njerëzit kanë folur, ne flasim përpara se ajo të ndodhë, por tani koha ka ardhur, duhet të ndodhë.

## 1978-1218, Agnya Chakra, Caxton Hall 1978

View [online](#).

Cakra Agnya, Caxton Hall, Londër (Mbretëri e Bashkuar) 18 Dhjetor 1978. Sot do flasim rreth cakres së gjashtë të quajtur Cakra Agnya. Agnya, fjala "gnya" do të thotë të dish. Gnya është të njohësh. Dhe "A" do të thotë të gjithën. Cakra Agnya ka gjithashtu edhe një tjetër kuptim. Agnya - agnya do të thotë ti bindesh një urdhëri. Mund ti nënkuptojë të dyja. Nëse ti urdhëron dikë është një agnya dhe ai që ju bindet është një agnya kari, ai që bën agnya. Kjo Cakër e gjashtë është krijuar në qënien njerëzore kur ai filloi të mendojë. Të menduarit është gjuha e shprehjes. Nëse nuk ke një gjuhë nuk mund të mendosh. Por kjo s'do të thotë që nuk ka proces të menduarit tek ne, por ajo gjëndje delikate kur mendimet vijnë tek ne nuk janë në ndonjë gjuhë kështu që nuk janë duke komunikuar me ne, dhe prandaj nëse nuk kemi gjuhët nuk mund të kuptojmë se çfarë po mendojmë. Për këtë arsye keni parë fëmijë që s'mund të komunikojnë me ne, çfarë duan sepse nuk mund të thonë se çfarë duan. Ata ndjejnë shtrëngime në stomak e duan të kërkojnë për ujë ose diçka tjetër, por nuk mund të na e thonë. Prandaj ata s'mund të mendojnë se çfarë duan të thonë. Por panvarësisht se kur filloni të flisni dhe të vini fjalët sipas gjuhës, kjo gjuhë është depozituar në trurin tonë siç tregohet në figurën në dorën e anës së majtë dhe gjithashtu dorën e anës së djathtë më të zezë dhe të verdhë, më pas kthehet tek ne më vonë si valë mendimi. Sikur dikush na flet. Por para se gjuha të fillojë, mund ta quajmë si frymëzim apo proces mendimi, në fazën më të hershme vjen tek ne në një formë të caktuar. Dhe këto forma janë të qarta ose të zbehta, nuk janë në gjuhë por në dritë dhe hije. Dhe pas ardhjes në Sahaja Yoga nëse futeni thellë në mendime do të kuptoni se ato nuk janë asgjë por dritë dhe hije që mbulojnë Cakrën tuaj Agnya. Njëra pas tjetrës një dritë e një hije si një far rrethor, japin një lloj modeli (strukture) në kokën tuaj. Tani këto modele formëzohen në gjuhë nga ne, në një fazë shumë të hershme dhe janë lloje mbushjesh në kupat (gota) e gjuhës dhe më pas këto kupa mbahen të rezervuara në tru dhe na vijnë në këtë mënyrë. Kur mendojmë vërtet e kuptojmë sepse është gjuha që vjen tek ne. Po ç'ndodh me kafshët? A mendojnë apo jo? Ata e kanë një mendim, një frymëzim por ata s'mund të mendojnë për të. Tani këto frymëzime vijnë tek ata si fjalë vetëm kur fillojnë të jetojnë me qëniet njerëzore. Kështu që këto frymëzime futen përsëri në mendime siç bëjmë ne për shembull ju I jepni dikujt një emër, themi ju e quani atë Tom, ose ju thirrni një qen. Kështu që ai tani e di që kjo fjalë do të thotë po "më thërret". Pra ai e lidh veten me këtë fjalë. Por kur ai nuk e ka fjalën, kur është Thjesht një kafshë, ai veç rrin aty, nuk mendon. Prandaj ata janë kaq spontane dhe ne jo. Kafshët janë jashtëzakonisht spontane sepse nuk mendojnë në mënyrën që bëjmë ne. Kjo ka krijuar problemin me të madhe për qëniet njerëzore - si të jenë (shkujnë) përtej mendimeve! Është një ngatërresë e vogël sepse unë ndoshta e shoh më qartë se ju meqë ju nuk e shihni dritën, dhe më pas drita bëhet gjuha. Dhe sipas nesh gjuha (e folura) bëhet mendimet tona. Por këto mendime janë kushtëzime për ne dhe s'janë gjëra frymëzuese. Nuk vijnë nga brenda dhe për këtë s'janë spontane. Për shembull nëse unë jam ulur këtu, nuk mund të rri e qetë si një qenie njerëzore. Do të mendoj për diçka. Do mendoj se ç'është të them. Më pas a duhet ta them a jo? Po nëse e them, do të jetë mirë apo jo? A do futet në kokat e tyre apo jo? Gjithë llojet e mendimeve do vijnë në kokën Time. Kështu nga një anë do pyes Vetën Time, nga ana tjetër do jenë përgjigjet. Në rregull thuaji kështu dhe mbase të tjerët do ju vlerësojnë, mbase nga kjo rrugë që të tjerët ta kuptojnë. Kështu do kuptoni. Pra zgjidhja vazhdon në trurin tonë përmes përvojave tona në këtë jetë tonë. Cilatdo të kenë qenë përvojat tona në këtë jetë që kanë të bëjnë me njerëzit, marrjen e përvojës nga të tjerët, gjithë këto janë kushtëzuar brenda trurit tonë dhe e gjitha bëhet një proces mendimi, që vjen tek ne nëpërmjet këtij ndërveprimi të mendimit dhe veprimit, veprim dhe mendim, cili është I pari? Cilin veprim të bësh, çfarë të mendosh, si ta zgjidhësh dhe në mendojmë se po analizojmë veten. Është një gjë sipërfaqësore. Në fakt nuk duhet të analizoni asgjë deri tani, mos e bëni. Siç ju thashë dje ju nuk bëni asgjë. Të menduarit tuaj nuk është asgjë veç një flluckë në vazhdim e sipër. Sepse, kur një det edhe në qoftë shumë I thellë dhe I qetë kur prek bregun e ka një veprim dhe reagim. Në të njëjtën mënyrë kur ju shihni dicka (sepse vëmendja juaj është jashtë) menjëherë një valë mendimi krijohet nga kjo e kthehet duke ju dhënë gjithë imazhet rreth saj, çfarëdo të dini rreth kësaj gjëje të caktuar e kthehet tek si një proces mendimi. Vazhdon gjithë kohës. Dhe mund t'ju japë, mund të jetë kaq acaruese sa s'mund të ndalojmë dot mendimet tona. Thjesht na çmend. Nuk kuptoni, nuk mund të flini sepse ju vijnë mendime. Ndonjëherë mund të jenë të tmerrshme, ndonjëherë të këndshme, ndonjëherë romantike, ndonjëherë tërësisht negative, ndonjëherë tërësisht positive. Ndonjëherë ndiheni "Unë duhet ta bëj këtë", ndonjëherë e ndjeni "nuk duhet ta bëj këtë". Por në fakt kur jeni duke e bërë ju nuk mendoni. Cuditërisht ne asnjëherë s'e kemi vënë re këtë, që kur jemi duke bërë një gjë në veçanti, hamendësojmë unë them se do të flas këto gjëra. Tani kur unë mendova rreth kësaj që unë mendoj të them këtë 10 minuta para se të flas, kur jam duke folur unë s'jam duke menduar që unë do të flas. Sepse koha që ngrita në këtë proces të të menduarit në Trurin Tim dhe e regjistrua njëherë, më pas kur e nis këtë rrjedhë të foluri vjen direkt. Pra qëniet njerëzore kanë krijuar mund të them një proces, që mund të jetë një gjë shumë e pështirë. Shumë shumë e pështirë. Dhe kjo vjen nga të dyja këto [1], njëra është

ana e majtë që e quajmë ego, që shkon në këtë anë, dhe në anën e djathtë e quajmë super-ego. Të gjitha kushtëzimet në anën e hemisferës së djathtë të Superegos na japin frikë, rrezik, mundësitë e çdo gjëje që kemi përjetuar përpara. Siç thuhet ata që janë djegur nga qumështi I fryjnë edhe një pijeje të ftohtë (digjesh nga qulli I fryn kosit). Sepse pasi je djegur e di që një lëng të ka djegur kështu që mendon se edhe kjo mund të të djegë gjuhën. Pra mund të provoni ta bëni këtë. Është kaq spontane kur ndodh sa ju duket se "Oh është shumë spontane", por nuk është. Është regjistruar më parë në eksperiencat tuaja dhe është diçka që i druhesh prandaj e bën. Sikur të arrini të kuptoni që ky proces I të menduarit është krejt I panevojshëm për ne. S'është nevoja të mendoni për të ardhmen apo për të shkuarën nëse doni të ekzistoni si qenie njerëzore. Kafshët nuk e vrasin mendjen. Për shembull kafshët e dinë që do të shkojnë në xhungël. Tani papritur ata shohin disa kafshë të tjera që vijnë prej andej dhe e dinë që ti po shkon për atje. Tani c'dobi ka të mendosh rreth kafshës që është duke ardhur? Hamendësojmë që nuk do të vijë, atëherë është e kotë. Por ata kanë një vrimë këtu dhe nuk kanë problemet si ne sepse kanë vrimën dhe gjithçka del jashtë. Nuk qëndron më shumë se një minutë. Por ju mund të kushtëzoni edhe ata. Prej përvojave ata janë të kushtëzuar. Prej eksperiencave që ata kanë patur deri tani me kafshët e tjera dhe gjërave janë të kushtëzuar. Dhe sillen në varësi të tyre. Pra është një diferencë shumë e madhe mes nesh dhe atyre(kafshëve), që ne mendojmë për çdo gjë. Dua të them që ne mendojmë se është një gjë shumë e mirë që të ulesh përtokë dhe të mendosh për këtë, dhe mendojmë se është diçka shumë e zgjuar. Çdo lloj problemi që ju vjen në kokë uluni më mirë dhe mendoni rreth tij. Por tani çfarë bëjmë ne kur një problem vjen? E mendojmë në lidhje me gjithçka që kemi bërë më parë dhe me përvojën që kemi patur. Në të njëjtën mënyrë ata duan të mendojnë për Sahaja Yoga. Tani ju s'mund të mendoni për Sahaja Yoga. Para së gjithash fillimisht ju shndërroheni në gjëndjen pamendime. Nuk mund të mendoni. Por është një ngjarje për të cilën ju nuk mund të mos mendoni. Është një proces jetësor, të mendosh është një lëvizje e vdekur, s'është një lëvizje e gjallë. Çfarëdo të jetë vdekja vjen tek ne si mendim. Frymëzimi është të jetosh, jo të mendosh. Frymëzimi është shumë ndryshe nga mendimi. Për shembull librat janë në librari, çdo gjë që keni menduar ose keni apo përjetuar është në këta libra. Ajo që është një ardhje e re tek ne është frymëzimi. Tani Thjesht gjeni sa gjëra të reja jeni duke menduar. Mbase as edhe një fjali. Më së shumti thoni që ky njeri tha kështu, ky zotëri tha kështu ose unë thashë kështu. Unë nënkupton Tha. Nëse mund të mendoni për atë që është duke ardhur vetëm tani tek ju, nuk ju duhet të mendoni për të, ajo Thjesht vjen. Është brenda jush, ajo Thjesht del dhe shpreh veten. Pra kjo është një jetesë spontane. Kjo është ajo që ne e quajmë si frymëzim. Është një paraqitje e papritur e shkurtër e njohurive që kemi marrë. Ose çfarëdo që keni menduar rreth saj është e gjitha lojë e vdekjes. Pra kjo është qender e Krishtit. Ai qëndron në qendër të Agnya. Dhe nëse lexoni në Devi Purana ai është lindur shumë shumë kohë më parë. Është krijuar shumë më herët dhe se si u zhvilluar brenda Maha Vishnu mund ta lexoni edhe vetë sepse është një kapitull I gjatë dhe unë dua që të të gjithë ju të lexoni rreth tij dhe të kuptoni si u zhvillua Ai në Maha Vishnu. Është shumë interesante sepse gjithë këto gjëra u vunë në gjuhën Sanskrit por nuk mund të themi që Maha Vishnu nuk ishte në Bibël. Nuk u shkrua e gjitha nga një person. Pra kjo pjesë është pjesa e krijimit të Krishtit para se Ai se të vinte në këtë tokë si Krishti. Verifikimi final fillon Këtu. Në fakt Kristianët nuk dinë gjithçka rreth ardhjes së Tij. Si u bë Ai Krishti ose cila ishte nevoja të kishte Krishtin ose djalin këtu poshtë (tokë). Ai është Tattwa. Ganesha, që ndodhet në Mooladhara[2] që gradualisht evoluohet në Krisht në këtë fazë. Nga kjo Cakra e kuqe lart tek kjo Cakër Ai bëhet Krisht. Ai është parimi. Tani çfarë është parimi? Cili është parimi brenda nesh? A është Kundalini mund të thoni? Në këtë energji elektrike është parimi I tij. Në të njëjtën mënyrë krijimi, I gjithë krijimi nëse do e marrim të tillë, është parimi dhe mbështetja e këtij krijimi. Ai përfaqëson thelbësoren, thelbin e krijimit. Siç mund të themi se kemi një familje, burrë grua dhe fëmijë. Tani fëmija është esenca e burrit dhe gruas, është esenca e gjithë familjes, e shtëpisë. Gjithcka mbështetet tek ai, krijohet për të. Derisa nuk kishin fëmijë shtëpia nuk kishte kuptim, s'kishte kuptim për jetën e tyre. Por kur patën një fëmijë patën kuptim. Në të njëjtën mënyrë Krishti është esenca, është vetë Tattwa. Ai është Omkara siç e quajmë. Është tingulli I parë, tingulli I parë që u krijua AUM kur Babai I Hershem dhe Mamaja e Hershme u ndanë, Ata krijuan këtë tingull. Dhe Ai është tingulli që mbushet brenda Fuqisë Gjithë Përhapëse dhe kujdeset dhe mbështet. Në fakt është më shumë mbështetje sepse kujdesja është bërë mund të themi nga babai ose nga mamaja. Por është mbështetja e gjithë universit dhe sepse Ai është vetë esenca (thelbi), esenca nuk vdes kurrë. Them esenca Ime është Shpirti im, ai nuk do të vdesë kurrë. Trupi vdes ose krijimi do të vdesë por esenca duhet të jetë aty. Nëse esenca humb atëherë asgjë nuk ka aty, prandaj Ai është rimishërimi më I rëndësishëm. Sepse Ai është mbështetja. Tani ky rimishërim është vendosur në Cakrën tonë Agnya. Këtu në qendër ku nervi optik apo thalamus optic[3] kryqëzohet me njëri tjetrin kështu. Në qendër është një pikë shumë delikate që I lëviz në dy anët kështu dhe ashtu dhe krijon dy tinguj Ham Ksham, Ham Ksham, Ham Ksham. Ham është në anën e hemisferës të djathtë aty ku ju keni parë superego, dhe Ksham është në anën e hemisferës së majtë ku ndodhet ego. Tani këta dy tinguj krijojnë dy llojë vibrimesh. Tingulli Ham krijon vibrime të cilat të bëjnë të mendosh "Unë jam, Unë jam, Ham, Unë jam". Kjo vjen nga fuqia e përvojës që e dimë se duhet të jetojmë në këtë botë, ne nuk do të vdesim. Çdo qenie njerëzore që provon të vrasë veten është anormal. Normalisht çdo qenie njerëzore, sepse çdo kafshë apo çdo gjë e gjallë përipiqet të ruajë jetën e saj. Kjo vjen nëpërmjet



fuqisë së Ham se Unë jam. Tani supergo në anën e krahut të majtë dhe ego në anën e krahut të djathtë është Ksham. Por tani unë do ju tregoj rreth hemisferës së djathtë të superego. Në këtë superego kur ju jeni I kushtëzuar nga shumë gjëra, jeni të frikësuar dhe shqetësuar për shkak të këtyre eksperiencave që ju bëjnë juve ky lloj personi që ka frikë në mendje. Dhe e gjithë kjo frikë është vendosur në superegon tuaj. Kjo fillon mund të thuash që nga faza juaj amoebë[4] dhe akoma dhe sot është e depozituar aty. Jeni të frikësuar nga policia, të frikësuar nga kjo apo ajo, disa nuk kanë frikë nga këto por nga gjëra të tjera. Sepse cilatdo qofshin kushtëzimet tuaja, cilatdo qofshin përjetimet tuaja janë të gjitha vendosur këtu poshtë. Për më tepër kur dikush lexon librin "Drakula" është I frikësuar nga fjala Drakula por fëmijët që nuk lexojnë nuk e dinë ç'është Drakula. Nëse do I thoni ka ardhur Drakula do thonë: "Mirë hajt ta shohim njëherë". Por ata fëmijë që e kanë lexuar Drakulën të frikësuar në plotë kuptimin e fjalës do thonë: "O zot, po vjen Drakula, diçka e tmerrshme do të ndodhë". Pra ju shikoni ato që keni lexuar, çfarëdo keni kaluar çfarëdo përjetimesh të keni pasur e gjitha është në superego. Kështu kjo supergo në këtë qendër dërgon mesazhe, Unë jam, ju jeni, ju jeni Ham, Ham mos ki frikë, mos ki frikë ti je. Pra njerëzit që vijnë tek Unë, ju e këni parë që njerëzit që vijnë tek unë janë viktimat të kushtëzimit të superegos Dhe këta njerëz, në fakt në këtë fazë vetëm ju mundeni të diskriminoheni midis këtyre dy tipeve. Njëri që është shumë agresiv, tjetri që është absolutisht mund të them I varur I frikësuar. Këta njerëz kur vijnë tek Unë, I kam parë duke qarë dhe lotuar : "Nënë më ka ndodhur kjo, më ka ndodhur ajo", dhe unë vërtet lodhem duke folur me ta. Dhe ka kaq shumë të tillë dhe vërtet që duhet t'u kushtosh vëmendje si Sahaja Yogis sepse të duhet të merresh me ta, si ti menaxhosh dhe si t'ia dalësh. Tani nëse një Sahaja Yoga thotë, fillo thuaj Ham, Ham, Ham, Ham, nëse je një Sahaja Yogi vibrimet e dëbojnë frikën. Edhe nëse jeni nën frikën e diçkaje dhe silleni vërdallë dhe ndjeheni të frikësuar, Thjesht thoni Ham, Ham, Ham. Tani me këtë fjalë vibrimet do të pastrojnë këtë anë shumë mirë. Përveç kësaj, që është rruga që mund të gjeni ndihmë nga Hyjnorja duke thënë Ham, ka shumë gjëra rreth Ham dhe Ksham por meqë koha është e dini [5]nuk dua të futem në shumë detaje rreth saj. Por do thoja që mantra për anën e krahut të djathtë është Ham dhe atë të majtën është Ksham. Ana e krahut të djathtë është ego, që është vërtet problem e kuptoni këtë, është vërtet problem shumë I madh e ju them që duhet të përballemi me të. Them diçka të vogël këtu dhe gjej gjithë këtë gjë që vjen brenda kokës sime kështu. Pra cila është zgjidhja për një ego shumë të madhe (kolosale)? Egoja kolosale mund të mundet vetëm duke falur të tjerët. Ata që kanë ego duhet të mësojnë që nëse ndjehen të lënduar duhet të thonë "fal". Edhe nëse një tjetër person ju lëndon, thoni "fal". Dhe jo vetëm fal por kërkoni për falje-zemërbutësi. Duhet bërë të dyja, më shumë kërkoni për falje. Duhet të kërkoni për falje nëse keni shumë ego. Është shumë e rëndësishme. Sepse nëse keni shumë ego çfarë do të thotë? Që e keni përkëdhelur shumë. Do të thotë që e keni shfrytëzuar shumë. Keni dominuar njerëzit dhe prandaj keni kaq shumë ego. Nëse keni kaq shumë ego duhet që gjatë gjithë kohës të përukeni në zemër. Tani në zemër qëndron shpirti. Ego, shumë ego në një person ju largon gjithmonë nga shpirti. Prandaj thonë "Përukeni në zemrën tënde". Arsyeja është se në zemër është ajo pjesë e jotja që nëse fshihet ose harrohet njëherë ju filloni përkëdhelni egon tuaj. Por ego ka kufijtë e veta, mbaron me budallallëk dhe idiotësi. Shikoni një person që është egoistic dhe që I bie vetëm fyellit të vet. Do e kuptoni menjëherë se ai do jetë budalla. Pa e kuptuar se ç'po bën, ai do bëjë kaq budallallëqe sa ju do filloni të pyesni, sidomos fëmijët " Si është puna me këtë djalë, është mjaft qesharak?". Dhe më pas shihni budallallëkun që kap këtë person, e më pas ai e sheh edhe vetë. "O zot! Si u bëra kaq budalla?" Budallallëku vjen tek ju sepse ju harroni ekzistencën e Zotit dhe marrëdhënien tuaj me gjithësinë. Ju mendoni, "Jam vetëm. Pse duhet ta bëj këtë? Çfarë është gabim me këtë, çfarë është gabim me atë? Duhet t'li bëj këto gjëra." E kam fjalën për mënyrën si luftojnë njerëzit për gjërat në këtë vend. Them se duhet, them secili, vendet e ashtuquajtura të zhvilluara nuk mund të kuptojnë se çfarë po u ndodh këtyre njerëzve. Sepse dje dhëndri im Lav po lexonte një artikull ku njerëzit pyesnin tani a lejohet martesja midis dhëndrit dhe vjehrrës. Dhe ai s'po mund të kuptonte si njerëzit mund të ngatërrohen dhe të pyesin për një gjë kaq absurde. Ajo është nëna juaj. Si mund ta mendoni? Them se është dicka e pamundur për njerëzit, njerëzit normalë të mendojnë kështu. Që dhëndri mund të martohet me vjehrrën. E pse duhet të bëhet një ligj për të dhe për të folur për të. Është një gjë shumë e vështirë. Gjithë gjërat idiote që jemi duke bërë në këtë vend, që bëjnë vërtet gjithkënd për të qeshur me të madhe. Është prej shoqërisë së Zotit Ego. Nuk është e lehtë të kuptosh se si na marros, na marros gjithë kohës dhe më pas mendojmë çfarë nuk shkon? Një 80 vjeçar që shkon pas një vajzë 20 vjeçare. Dhe një vajzë 20 vjeçare e budalleps këtë burrë 80 vjeçar, supozojmë që ky të jetë një burrë shteti dhe statuja e tij të jetë ngritur diku atje. Si është e mundur? Është vetëm ego që ju bën të bëni gjithë këto gjëra pa kuptim dhe idiotësi. Kur jeni në Sahaja Yoga ndonjëherë nuk dini si të kontrolloni të qeshurën për njerëzit budallenj, jashtëzakonisht budallenj. Dhe kjo është ajo që është, përfundon në marrëzi absolute. Them se edhe nëse doni të shkruani një roman nuk do të gjeni karaktere kaq të bukur sa ata përreth jush. Kur I dëgjoni ndiheni I shokuar, Oh Zot ç'është kjo që po ndodh dhe kaq e sikletshme. Jashtëzakonisht e sikletshme dhe shndërrohen në kaq budallenj me egon e tyre sa që nuk mund të kuptosh se ç'po mendon, sepse duke menduar krijon egon bëhesh budalla. Nuk ka dituri në njerëz ego e të cilëve është e zhvilluar kështu tërësisht. Nëse dikush ka një ego të tillë nuk ka Dije tek ai. Mund të shihni që nuk e di se ç'është dituria. Sillet në mënyrë të papjekur. Mund të jetë njeri I moshuar,

gjysh I mrekullueshëm apo dikush por me të hapur gojën ju habiteni prej tij. Mendoni nga ka ardhur ky shakaxhi? I mungon komplet matura. Dje dikush më tha Mua: "Nënë si ka mundësi që prindërit tanë janë kaq budallenj kurse ne po shikojmë për Zotin? Njerëzit e moshuar janë kaq mendjelehtë ndërsa ne kërkojmë Zotin", më pas I thashë, "Jo mbase prej luftës prindërit janë të shqetësuar, kupton". Shumica e prindërve janë të shqetësuar prej luftës dhe thonë "Pjesa më e madhe e tyre janë kështu, dhe njerëzit më të rinj janë më të zgjuar dhe po kërkojnë Zotin dhe nuk dijmë si të bëjmë kompromis me ta sepse nuk janë në kërkim të Zotit (perëndisë). Pse ata nuk e kërkojnë Zotin ndërsa ne po? Edhe nëse ka disa kërkues ata janë shumë të pakët". Tani unë them që kjo është për shkak të luftës por dikush thotë "Atëherë po Amerika? Ja në Amerikë njerëzit nuk janë përballur me luftëra kaq shumë, budallallëku që kanë ndonjëherë është I habitshëm". Është tamam ajo që kam thënë, është zhvillimi I egos në një qenie njerëzorë. Tani ego është ajo që ju bën të mendoni rreth gjithçkaje. Për shembull, tani duhet të themi shko nga këtu në Birmingham, në rregull. Pra tani të mendojmë si do të shkoj? Rruga e lehtë është që të marr një tren ose të marr një makinë e të nisem. Nëse nuk nevojitet rezervim Thjesht do hipi në tren ose do shkoj me makinë. Nëse makina është e disponueshme do të shkoj me makinë ose me tren, mbaroi. Çfarë ka për të vrarë mendjen? Por jo, më pas duhet të planifikoni "Unë jam programuar, tani duhet të shkoj". Shkoni në stacion dhe shihni që treni nuk është aty sepse ka ndodhur një aksident dhe treni s'leviz dot. Kështu që jeni tërësisht I shqetësuar sepse mendoni që treni iku, çfarë të bësh. Në këtë shqetësim e sipër ju as që mendoni se keni një makinë dhe që mund të shkoni me makinë. Tani që gjithçka ju shqetëson sepse plani ishte që të shkonit me tren, ishte planifikuar gjithçka tani nuk mund të mbërrini dot pra ç'do të ndodhë? Rrini ulur dhe pyesni si? Nëse një person do ishte spontan ç'do të bënte? Varet, unë mund të shkoj me tren ose me makinë si ta ndiej momentin. Ai që është I lidhur me trenin, shkon tek treni, sheh nëse është aty. Nëse është qetë nëse ka vend futet në të. Nëse treni s'është I disponueshëm, në rregull, kthehet në shtëpi merr makinën dhe niset. Pra tani keni njoftuar njerëzit që duhet të takoheni në këtë ose atë vënd. Ju gjithashtu e dini këtë vënd. Pra njerëzit janë duke u sjellë lart e poshtë e do të takoheni në stacion. Shkoni me tren e I takoni atje. Pse duhet të shqetësoheni kaq shumë për këtë? Kuptoni që mund ti kontaktoni gjithmonë. Por me mënyrën si shqetësohemi kemi prishur gjithë programin e vajtjes në Birmigham, që është një program I bukur që kemi ndërmarrë. Do të takojmë njerëz, do të takojmë shumë njerëz, duhet të kënaqemi. Gjithçka mbaroi sepse kemi planifikuar diçka dhe nuk funksionoi, jemi të mbaruar. Gjithë këto na bëjnë një njeri të mjerë. Dhe jemi kaq të mjerë dhe kaq qejfprishur dhe të mërziqshëm sa që ata që janë pranë nesh ngopen me ne e thonë: "Tani mbylle. Nëse nuk do të shkosh në Birmigham, nëse nuk do të shkosh mos shko. Por mos më çaj kokën tani", është një eksperiencë e zakonshme për të gjithë. Nëse ky Z.Ego është kështu, ai nuk do që të jesh I lumtur. Ai nuk do që ju të jeni të qetë. Ai ju jep gjithë kohës idera dhe ju thotë: "Bëj këtë e bëj atë dhe duhet të bëni këtë e atë. Më mirë ta informosh atë person, ji I përpiktë me të", dhe do të futesh në kaq detaje sa çdo gjë do dështojë dhe do jesh I mbaruar sepse I ke nervat të mbaruara dhe shpartalluara. Çdo gjë madje edhe një pikë pakënaqsie që vjen tek ju apo edhe një fije shqetësimi ju jeni të mbaruar. Dhe kështu çdokush është I vrullshëm, "Ne kemi tension. Ne kemi problem" Pse? Cili është përfitimi I të bërit të gjithë këtyre gjërave? S'ka përfitim ju e dini këtë. Por pse e bëni? Sepse keni një ego të madhe që nuk ju lejon të pushoni. Çfarëdo të provoni nuk ju lejon. Pra cila është zgjidhja? Nga mëngjesi deri në darkë kërko falje nga Zoti. Shtypini të dy anët e veshëve dhe thoni: "Oh Zot, më fal. Oh Zot, më fal. Dhe Oh Zot, më fal." Kështu që ky balon I egos shfryhet pak. Kujtojeni Atë në mëngjes, në darkë, çdo herë. Duke kujtuar Krishtin e ulni shumë egon tuaj. Ai bëri gjithçka që të bënte të mundur që ju mos të zhvillonit egon. Gjithçka ishte e mundur. Ai u lind si djali I një zdruktartari të zakonshëm. Jetoj në kushtet më të zakonshme. E mbajti Vetën pas gjithë skenës. Mund të kishte lindur si një Perandor Romak. Mund të kish qenë gjithkush aty. Por jo Ai u lind si Vetja. Ju e dini që ai u lind në një vend ku as njerëzit e zakonshëm nuk lindin. Por aty ishte gjithashtu edhe drita. Kudo që Ai lindi pati dritë dhe gëzim. Dhe kjo është ajo që duhet të dijmë, që ne kemi humbur gëzimin sepse kemi harruar Zotin e Plotëfuqishëm. Kur harruam Atë, Ai që është dashuria dhe Ai që është gëzimi, natyrisht që edhe gëzimi harrohet. Dhe më pas shohim njerëz që nuk janë aspak të lumtur. Kanë pasuri, kanë para, kanë gjithçka por prapë nuk janë të lumtur. Gjithë kohës janë kaq të rrëmuqshëm sa nuk di si t'u flasësh. Nëse u thua këtë fjalë inatosen, nëse u thua atë fjalë inatosen, nuk janë aspak qenie normale njerëzore. Ata janë njerëz të sëmurë. Të sëmurë me egon e tyre. Është një gjë shumë e Thjeshtë të kërkosh falje. Sa herë e bëjmë këtë? As edhe një herë në ditë, as edhe një herë në muaj, madje as edhe një herë në vit. Madje në ditën e Krishtlindjeve nëse do të thonim : "Na fal o Zot për çfarëdo kemi bërë deri tani", do të funksiononte. Por atë ditë na duhet shampanjë të falim Atë më shumë. Duhet të bëjmë thashetheme dhe duhet të kemi gjithë gjërat arrogante për kohën kur Krishtlindjet mbarojnë. Kjo ego, ana e verdhë, është ajo që e shtyn egon vërtet shumë. E bën. E shtyn kaq shumë ndonjëherë sa një person harron se të tjerët lëndohen nga ato që thuhet. Edhe më tepër gjejnë mënyra si të thonë gjëra që të prekin, të lëndojnë, që janë të dhimshme për të tjerët. Thonë kështu gjërash gjithë kohës. Të themi vjen dikush nga fshati dhe kur sheh mendon: "A janë duke u grindur, çfarë po bëjnë? Pra gjithë diskutimi, madje edhe në parlament jam habitur nga mënyra si flasin me njëri-tjetrin, as një dem nuk e trajton demin tjetër kështu. Madje edhe një qen normalisht nuk I leh tjetrit. Asnjë kafshë në botë nuk I leh gjithë kohës shokut. Asnjë kafshë në botë po ju them nuk bën kaq

shumë. Vetëm qëniet njerëzore nëse janë dy persona kalojnë gjithën kohën bashkë do bëjnë ham ham ham. Si është e mundur? Ego e tij, ego e saj apo mbase e të dyve janë duke u ndeshur tek njëri tjetri. Është një lloj ndjenje qesharake të cilën unë e kam zotëruar, e kam marrë, e kam kuptuar. E kam provuar. Por me këtë kam gjithçka të bukur dhe të gëzueshme brenda meje. Në fakt një person I ndjeshëm do të lejë vënd kur dy persona janë duke diskutuar. Diskutimi është një shenjë marrëzie. Deri tani nuk kam parë një argument që të ketë fund. Nëse është kjo atëherë në rregull. Por nuk mbaron asnjëherë. Sepse të themi, ju më pyesni Mua dhe unë ju përgjigjem, në rregull. Nëse nuk ju pëlqen përgjigja hiqni dorë. Por nëse diskutoni me Mua akoma dhe unë me ju, atëherë kur do të mbarojë? Argumenti nuk ju drejton drejt ndonjë njohurie (dije) por drejt një ego shumë të tmerrshme që zhvillohet brenda jush. I gjithë koncepti modern është orientim egoje. Gjithë vendet perëndimore janë me orientim egoje. Ata duan të zhvillojnë dhe përkedhelin egon tuaj. Këtë e bëjnë me shumë mënyra. Arsyeja që flas me shumë për të është se të gjithë jemi të supozuar të jemi perëndimorë dhe njerëz të pasur. Mendohet të jemi shumë të zgjuar dhe të drejtojmë apo keqdrejtojmë, nuk I njoh këto vende të zhvilluara. Prandaj duhet të njohim veten ku jemi derisa kuptimi I gjërave na shqetëson. Përkedhelja e egos brenda nesh është një metodë me shkallë të gjerë. Ata punojnë me egon tënde që të ketë gjithë këto të ashtuquajtura ndërmarje. Psh një gruajë do ti thonë: "Oh ju duhet të keni një bel si ky dhe një fytyrë si kjo, dhe ju duhet të keni...", për një burrë: "Ju duhet këtë trup. Duhet të jeni Mister Universi ose duhet të bëni diçka", kështu burri fillon menjëherë të punojë. Duhet të keni parë shumë njerëz që vrapojnë rrugëve në të ftohtë, unë kam parë dhe nuk e kuptoj. Vrapojnë si të çmendur dhe disa prej tyre janë antarë të Parlamentit. Qëndrojnë zgjuar gjithë natën ndërsa gjithë ditën vrapojnë. Çfarë po bëni ? Ç'është nevoja ta bëni këtë? Për të mbajtur shëndet të mirë. Që të keni shëndet të mirë mos punoni si të çmendur, jini njeri I ndjeshëm dhe I ditur. Duhet të kërkojë diturinë që të kesh shëndet të mirë, të jesh mirë dhe kjo lloj egoje e çmendur ndaj gjërave. Prandaj një mënyrë është të kënaqësh egon me fizikun tënd. Më pas keni një ego tjetër të kesh një makinë të madhe. Shikoni njerëz që duan të duken me pasuritë e tyre. Keni një makinë të madhe dhe të tjerët do e duan. E kam fjalën mua ata vërtet më duken si jokers (kloun) kështu janë. Dakort e kuptoj që makina është diçka që duhet dhe nëse dikush e përballon duhet të ketë një makinë të cilësisë së mirë, sepse një makinë e keqe të hap telashe. Deri këtu në rregull. Por që të blesh një makinë për tu dukur I madh, mund të mos kesh ushqim në shtëpi por duhet të kesh një makinë të mirë. - pra këto lloj nderash ju vijnë. Sepse ata do ju reklamojnë, ja shikoni kjo do të ishte një makinë shumë e mirë për ju. Çfarë është për ju? S'është asgjë Thjesht ju përkedhelin egon. Gjithë këto reklama nuk janë asgjë por me to ego juaj përkëdhelet. Ata po trajtohen për këto gjëra. Tani nëse shkon në Amerikë çdo gjë duhet të jetë e ndryshme. Çdo gjë duhet të jetë e ndryshme (e veçantë). Pse kaq ndryshim në çdo gjë? Pse duhet të keni çdo gjë ndryshe. Mendoni së është dicka estetike? S'është farë estetike Thjesht është egoja juaj që përkëdhelet. Edhe ata të ashtuquajturit Njohësit e Artit s'janë asgjë veç përkedhelës egoje. Koleksionet tuaja firmato, kjo ajo, gjithë kjo s'është gjë tjetër veç përkedhelje egoje. Dhe sa humbje kohe duke menduar vetëm për këtë. Kjo lloj egoje futet brenda nesh sepse siç e thashë para së gjithash ne jemi, supozojmë të jemi perëndimorë, dhe jetesa është shumë e vështirë. Duhet të luftosh me natyrën, dhe kur të duhet të luftosh natyrën ego zhvillohet brenda teje. Dhe me të filluar vrulli brenda jush është shumë e vështirë ta mundësh. Është një sëmundje kaq e madhe sa njerëzit kanë filluar ta shohin si të mirëqenë si pjesë e jetës së tyre. Ju nuk jeni ego juaj. Nuk jeni. Kur them se duhet t'ia dorëzoni veten Zotit, ata mendojnë Nënë pse duhet të dorëzohemi? Vetën - e kam fjalën ajo ego me të cilën identifikoheni. Nuk them të dorëzoni dijen. Ose mund të themi dorëzoni veten tek Dija juaj. Por është kaq e vështirë të heqësh dorë sepse kemi mësuar të jetojmë me të, identifikohemi me të. Ne Thjesht s'mund të mendojmë për jetën pa egon tonë, s'mundemi. Dhe kjo shkon deri në atë masë sa që ju nuk e kuptoni sa larg ka shkuar mizoria juaj. Si "Më pëlqen në këtë mënyrë, më pëlqen në atë mënyrë". Shkoni në shtëpinë e dikujt dhe shprehni kështu. Është e papërshtatshme të flasësh kështu. Është vulgare të shprehësh "Më pëlqen", Kush je ti? JE Zoti? Unë dua këtë. Jam shumë I veçantë në lidhje me këtë. Jam shumë, kush je ti? Thjesht pyesni veten "Kush jam unë? Unë jam Shpirti. Jam ajo qenie e përjetshme. A jam bërë I tillë? Përkundrazi jeni duke lënduar Shpirtin e gjithkujt me egon tuaj. Në çdo moment kur flasim me të tjerët jemi duke I lënduar. Në fakt njerëzit e kanë humbur besimin tek Zoti, sepse ata që janë në krye të Zotit (institucionet fetare) janë aq arrogantë dhe aq egoistikë sa është bërë e pamundur për dikë të mendojë për Zotin. Do habiteni, ego është tërësisht artificiale si filluskat. Është si një balon, që mund të shpërthejë kështu. Duhet të ikë, duhet të ikë që ju të mund të ngriheni. Ajo duhet të zhduket në mënyrë që vëmendja të rritet në Shpirtin tuaj. Dhe shihni të gjithë botën si ajo pjesë e Shpirtit që jeni. Ky është kufiri që duhet të kalojmë dhe për këtë duhet të marrim ndihmë nga Krishti. Krishti kryqëzoi veten. Pse? Çfarë bëri Ai? A I placiti njerëzit Ai? Sot kemi mijëra nga këta banditët që vijnë e ju plaçkisin. Askush nuk I kryqëzon ata. Çfarë bëri Ai? Ai Thjesht sfidoi egon e Romakëve dhe Hebrenjve, atyre që ishin të inatosur me Atë, dhe për këtë Ai u sakrifiku. Ndërsa ne duhet që tani të kryqëzojmë egon tonë nëpërmjet kryqit të Tij. Përndryshe do të bëjmë të njëjtën gjë përsëri, dmth që në qënien tonë do të kryqëzojmë Krishtin prej egos sonë. Është një gjest shumë simbolik I Krishtit, lindja e Tij në vendin më të përlulur, në një vend të humbur. Ai u lind në Optik thalamus, mund të themi është vendi ku ndodhet truri, ku vijnë gjithë aktivitetet dhe tërë llojet e problemeve ju sfidojnë, dhe Ai jeton aty, juve ju duhet

vetëm ta zgjoni Atë e kështu ego e juaj kryqëzohet një herë e përgjithmonë. Por nuk mendoj të luftoni egon sepse ta luftoni nuk është ë rëndësishme. Ju po luftoni me hijen tuaj. Keni hije që quhen si ego të cilat nuk duhet t'luftoni dhe të konsumoheni, mos e harxhoni energjinë tuaj me të. Thjesht s'duhet të luftoni, një gjë nëse qëndroni në qendër të dritës nuk do të shihni asnjë hije. Është e Thjeshtë fare. Nëse qëndroni në qendër të dritës që është Krishti nuk do të shihni asnjë hije. Por kur unë them këtë mund të tingëllojë si të tjerët kur japin predikime : "Qëndroni në hijen e Krishtit ose qëndroni në dritën e Krishtit". Çfarë do të thotë kjo? Ku është kjo dritë apo ku është vendi në të cilin të qëndroni? Ky vend është këtu - në qendër të optic thalamus (qendër të ballit) ku nuk ka mendime. Duhet të qëndroni në vetëdijen pa mendime. Shumë njerëz që kanë patur problem me Agnya, shumë njerëz (biseda ndërpritet).....mendimet do të ndalojnë dhe do të jenë përtej mendimit. Dhe kjo është një Cakra shumë shumë e rëndësishme për Sahaja Yogis sepse kur Kundalini ngrihet lart, mbi Cakrën Agnya menjëherë s'ka mendime. Nuk keni mendime as nga ego as nga superego. Por është një luhatje (dridhje) në Agnya për shkak të mënyrave të paekuilibruara. Dhe mënyrat e paekuilibruara ndodhin pasi ndonjëherë jeni në ego ose në superego. Kjo u ka ndodhur njerëzve tanë në Perëndim sepse kemi patur kaq shumë saqë jemi lodhur prej saj. Jemi frikësuar prej saj. Më pas filluam ti drejtohem drogës dhe gjërave për të ngritur superegon. Por të bësh këtë është të biesh nga shiu në breshër (ikim nga një fund duke rënë në një fund tjetër) dhe kështu luhatemi me egon dhe superegon duke mos e ndihmuar hiç veten tonë. Pra ajo që njeriu duhet të bëjë është të ngrihet brenda vetes deri në pikën e Agnyas dhe të përpiqet të qëndrojë në Angyan e vet.Ka shumë veta që më bënë pyetjen. Si të qëndrosh në Agnya? Agnya ndodhet në vëndin e kryqëzimit të nervave dhe optic thalamus tonë. Tani thuhet se nëse ke sy që të dridhen ke Agnya që dridhet. Duhet të keni sy të qëndrueshëm. Duhet t'luftoni ato. Një gjë të tillë tani është e dalë kohe, e vjetër, e lashtë dhe gjithë llojet e emrave që mund të quani. Por ju duhet ti mbani të qëndrueshëm sytë, ti mbani ato në një mënyrë që është shumë zbutëse për sytë tuaj. Ajo që është më zbutëse për sytë është bari jeshil. Nëse mund ta shihni barin e gjelbër me sytë tuaj do të thotë që ecni me sy nëpër bar. Sytë do ju zbuten, Agnya juaj do të jetë në rregull. Prandaj Krishti tha: "Do ju tregoj për sytë tradhtarë (shkelës kurore)". Ai foli për sytë tradhtarë. Sytë me të cilët tradhtoni. Është diçka krejt e zakonshme në ditët tona. Një burrë duhet të shohë çdo grua. Një grua duhet të shohë çdo burrë. Sikur kjo të jetë gjëja më e rëndësishme. Nëse nuk ke parë një grua je i mbaruar. Kjo është të jesh modern. Por unë jam një grua me të vjetrën. Në kohën e Krishtit ai tha: "Nuk duhet të keni sy tradhtarë". Dhe ata që kanë sy tradhtarë jo më shumë se çdokush tjetër janë të krishterët tanë perëndimorë, të cilët gjithë kohës madje edhe në kishë, madje edhe kur janë duke dhënë predikime i rrotullojnë sytë me tradhëti. Këta sy duhet të jenë shumë shumë të pastër, shumë të thellë dhe shumë të dashur nëse doni të keni në rregull Agnyan tuaj. Sepse nëpërmjet syve ju merrni. Nëse ju i keni sytë të mbyllur nuk e keni mendjen në asgjë sepse sytë i keni të mbyllur. Nuk i shtoni më mendime vetes. Por nëse sytë i keni të hapur i shtoni shumë më tepër mendimet sepse ku shkojnë sytë shkon edhe mendja, dhe ju shihni gjëra dhe krijoni mendime mbi to. Vëmëndja juaj duhet të shkojë tek Shpirti, duhet të shkojë tek Zoti, duhet të ndriçojë nëpërmjet dritares së Hyjnore. Kjo bukuri është rrënuar nga mënyra si i përdorim sytë dhe mosrespektimi i saj (hyjnore). Nuk ka asgjë më të pastër dhe bukur se bari në tokë ose vetë toka, që prek këmbët tona, që na mban, që kujdeset për ne, na pasuron. Duhet ti drejtojmë sytë tek Nëna Tokë në vend që të shohim çdo person. Por nga këndvështrimi i Sahaja Yoga shumë prej jush e dinë se ç'u ndodh syve tuaj kur shikoni tek dikush. Mbase një subjekt mund t'ju hyjë në sy. Dhe ndodh që ju do habiteni që është një lojë e subjektit që e dimë si të ashtuquajturin flirtim. Kam folur edhe më parë për të dhe njerëzve nuk u pëlqeu. Por kam parë që gjëra të tilla të hyjnë nga syri në sy. Ka njerëz të Thjeshtë që vijnë në vende të tilla të themi festa, në festa njerëzit shkëmbejnë shikime. Pasi kalon një person ngul shikimin në një tjetër. Dhe më pas i treti shikon një person tjetër. Gjithë kohës vëmëndja devijohet. Dhe ndjeni se tërhiqet pas diçkaje, por nuk e dini ç'është. Tani shenja të caktuara bëhen edhe kështu. Po e shtojmë edhe më shumë problemin kur shihni që gjithë shoqëria funksionon kështu: "Që ju duhet të keni një paraqitje të tillë që t'ju shohin të gjithë. Çdo grua ti ketë sytë tek ty? Pse?C'dobi sjell? E zëmë unë ju shoh çfarë fitoj? Ç'marr kur shoh dikë? Cili është përfitimi nga ky shikim? Harxhojmë gjithë këtë energji për këtë?". Në të njëjtën mënyrë nëse po ecni rrugës shikoni shumë gjëra të bukura. Nëse ju duhet të bleni dicka ok vazhdo, shikoj këto, çfarëdo që të zgjedhësh në rregull. Por ta bësh këtë gjithë kohës vetëm se sytë e tu janë të tillë, ta bësh pa e kuptuar arsyen pse gjithë kohës sytë janë të lëvizshëm. Dhe kjo me siguri është një shenjë e qartë se një person po çmendet. Absolutisht është një shenjë e sigurtë, kështu ju e kuptoni kur një njeri është i çmendur. Nëse e shihni në sy irisi është gjithnjë në lëvizje. Nuk mund të qëndrojë palëvizur. Ose edhe kur janë të sëmurë mund të shihni që sytë e tyre janë gjithë kohës duke u dridhur. Nuk kanë qëndrueshmëri. Jo vetëm kaq por që kur njerëzit vijnë në Sahaja Yoga, kur mbyllin sytë kuptojnë që i dridhen. Qepallat i lëvizin. Kjo tregon që ka një lloj problemi në ngritjen e Kundalinit. I gjithë tensioni nëse do e quajmë 100 të paktën 8 % e tij vjen nëpërmjet syve tanë. Atëherë sa e rëndësishme është të mbrojmë sytë nga të gjitha llojet e aktiviteteve të kota që bëjmë? Krishti, jeta e Krishtit na tregon më shumë si të respektojmë të tjerët. Por një nga këto aspekte që është keqpërdorur është ajo e prostitutës. Ai shpëtoi një prostitutë, Ai padyshim e shpëtoi atë. Ndërsa ju i llastoni këto prostituta. Një grua të mirë e shndërroni në prostitutë. I jepni ide me të cilat ajo bëhet një prostitutë. Një shtëpiakë e mirë kthehet në një

prostitutë prej një burri egoist. Vajza të reja të vogla që janë virgjëresha po shkatërrohen prej shikimeve tuaja të pista. E kuptoni këtë? Që po bëni krejt të kundërtën e asaj që bëri Krishti? Dhe ju thoni që Ai (Krishti) e shpëtoi, pra edhe nëse ne jemi prostituta ai do të na shpëtojë. Por pse të jeni prostituta? Është një mënyrë kaq idiote të të menduarit. Që ne duhet të bëhemi prostituta që Krishti të na shpëtojë. Dikush duhet ti mendojë të gjitha këto në dritën e duhur të Sahaja Yoga. Vetëm dhe derisa ju të jeni realizuar bisedat e Mia janë të kota për ju. Por kur jeni të realizuar do të dini që kur të shikoni dikë mund të ndjeni papritur një dhimbje pas koke, sikur ju është futur një shigjetë apo po ndodh dicka. Mund t'ju duket sikur jeni verbuar me fytyrën e dikujt dhe do të përjetoni gjithë llojet e eksperiencave prej të cilave do të kuptoni sa të rëndësishëm janë sytë tuaj. Nervozismi dhe çdo gjë tjetër mund të shërohet nëse keni sy të pastër. Por është si një rreth vicioz sepse nëpërmjet syve ju përmbliidhni gjithë të këqijat dhe kjo akumulohet në Agnya dhe ju duhet të pastroni Agnya për ti bërë sytë të qartë. Është një rreth vicioz. Por duhet të fillojë në një pikë, siç ju thashë duhet të kërkojmë për falje. Së dyti duhet të sjellim Krishtin në cakrën tonë Agnya. Së treti duhet të heqim dorë nga gjithë drogërat, dehjet dhe duhanpirja. Kjo ndodh automatikisht kur jeni një Sahaja Yogi, funksionon. Por sytë shprehin gjithë qënien tuaj, trupin, trupin, gjymtyrët gjithçka. Dhe nëse Agnya juaj është në rregull atëherë edhe sytë tuaj do të jenë në rregull. Rrezatojnë veç dashuri kudo që shohin. Vetëm me një shikim të syve ju mund të ngrini Kundalinin. Vetëm me një shikim mund të kuroni njerëz. Kështu që këto sy që shihni janë dritarja e qënies suaj, e zemrës suaj. Kur Shpirti shprehet nëpërmjet syve tuaj, duhet ta keni vënë re tek vetja që kur Kundalini ngrihet atëherë sytë zgjerohen. Dhe një shpirt I realizuar ka sy të errët sepse këta sy janë zmadhuar. Të paktën kur unë I shoh ata janë të gjithë sy të zinj të mëdhenj. Përveç kësaj një shpirt I realizuar mund të përbëhet edhe nga sy shkëlqyes. Janë të shkëlqyeshëm si diamantë. Shkëlqejnë gjithë kohës dhe mund ta kuptosh nga këta sy që ky person është një shpirt I realizuar. Ka një diferencë të tmerrshme midis syve të një shpirti të përealizuar dhe syve të një shpirti të realizuar. Kështu mund ta imagjinoni se si Shpirti sheh nëpërmjet syve tuaj. Por nëse sytë nuk janë të pastër ai (shpirti) nuk qëndron gjatë aty. Pra nëse na duhet të kuptojmë Krishtin fizikisht duhet të respektojmë sytë tanë. Mendërisht duhet të heqim dorë nga gjithçka që është e papastër në mendjen tonë. Tani erdhëm tek papastërtia e mendjes. Dhe papastërtitë e mendjes ekzistojnë, ju e dini ka kaq shumë helme. E kam fjalën ka libra dhe të shkruar me helm, dhe supozohet që psikologët të na e heqim gjithë këtë helm. Nuk e di nëse mund të na e heqin të gjithin. Por ata kanë Agnya më të keqe. Gjithë këta psikologë kanë Agnya më të keqe dhe nuk mendoj se janë të aftë apo tu japin vërtet çlirim njerëzve nga vuajtja mendore. Vuajtjet mendore janë dy llojesh. Është e njëjta gjë ....NËNA THOTË VEÇ: vibrimet janë të shumta, nuk I përballoj dot. Një lloj I problemeve mendore është kur njerëzit të shtypin shumë (të bëjnë presion), ju shihni veten duke mbajtur kryqin. Kjo është një ide e gabuar që njerëzit kanë për Krishtin. Të mbash kryqin nuk do të thotë që kushdo që provon t'ju shtypë ju duhet të skllavëroni veten. Nuk keni pse ti skllavëroni askujt. Duhet t'ia mohoni kategorikisht çdokujt që përpiqet t'ju skllavërojë. Duhet të thoni Ham - Unë jam. Kush je ti që të më dominosh mua? Çdokush qoftë lëkurëzinj, lëkurëkuq apo lëkurëverdhe askush në botë s'ka të drejtë të dominojë. Dhe nëse ndokush e bën këtë: "Oh ç'të bësh, në fund të fundit ju e shihni jemi njerëz të varfër, apo jemi kështu ose ai është mbështetës" e gjithë këto. Më pas largohen nga detyra ndaj vetes. Këta njerëz nuk mund të marrin Vetërealizim. Skllëvërit nuk bëhen mbrëtër. Kështu që ngatërrimi I skllavërisë me mbajtjen e kryqit është një tjetër konfuzion në kohët moderne. Na duhet të ngrihemi në Vetë-respektimin tonë. Dhe duhet të kuptojmë që askush në këtë botë nuk ka të drejtë të dominojë mbi ne. Por atëherë për çfarë është mbajtja e kryqit? Para së gjithash njerëz të nivelit të Tij nuk vuajnë asnjëherë. Është Thjesht një shaka që vazhdon. Është Leela, është një lojë që vazhdon për ta. Ata s'vuajnë asnjëherë, edhe nëse ata po themi sillen sikur vuajnë e bëjnë sepse duan ta bëjnë. Nuk janë të pashpresë. Nuk janë skllëvër. Dhe ata që mendojnë se të mbajnë dhe të vuajnë do të shndërrohen në Kristianë duhet ta dinë që janë raste psikologjike. Dhe nëse janë duke u qarë dhe jargavitur e gjithë kohës thonë: "Ç'të bësh, ju e shihni që jam I dashuruar, dhe I (e) dashuri më torturon". Nuk jeni as në dashuri nuk keni as të dashur. Është një lloj grupimi psikologjik. Ai është një njeri dominues dhe juve ju pëlqen dominimi I tij, prandaj jeni bashkë. Është fakt I Thjeshtë. Pra çdo qenie njerëzore ka vetë-respektin e tij. Dhe ai duhet të respektojë veten që është Shpirti brenda tij. Dhe asgjë s'duhet ta dominojë, nëse I përkisni këtij apo atij vendi, kësaj apo asaj teorie. E gjithë kjo do të bjerë. Sipas ligjit të Zotit askush s'ka të drejtë të dominojë Shpirtin e ndokujt. Por kur ju jepet liri ju shkoni në anën tjetër që është Z.Ego. Nuk dini si të përdorni lirinë tuaj. Provoni të dominoni të tjerët. Me lirinë tuaj është në rrezik liria e të gjithëve. Jeni në majë të gjithëve, dhe torturoni shpirtin e secilit. Dhe ju jeni të dominuar nga toka dhe pasuritë apo zotërimet, pra në këtë mënyrë apo atë mënyrë, nëse jeni mendërisht kjo apo ajo kategori ju jeni kundër vetes. Thjesht jini në qendër dhe shihni për veten. Thjesht shikoni. A jeni duke rrezatuar dashuri drejt një personi tjetër? Nëse jeni skllav si mund të doni? Nuk mundeni. Nëse jeni I lirë dhe I braktisur si mund të doni? Dashuria ka robëritë e veta shumë të ëmbla dhe të bukura. Duhet të jetoni me to. Duhet ta shijoni këtë robëri (skllavëri). Një fëmijë I vogël që vjen në shtëpinë tuaj pa dyshim që do e bëjë rrëmujë, dhe duhet ta bëjë. Dhe ju duhet ta shijoni këtë llastim. Nëse liria juaj sfidohet nga e qara e një fëmijë të vogël atëherë nuk jeni njeri I zgjuar. Kjo është braktisje. Ose mund të them është vetmi. Është të shkëputesh nga e hershmja, nga e madhja, nga më e madhja gjë që jeni, që të thotë të jesh I aftë të tolerosh lirinë e të tjerëve,

një fëmijë që nuk ka liri të qajë në shtëpi? Ç'loj lirie konceptoni. Një nënë që nuk ka të drejtë të thotë atë që do për fëmijën e vet, gjë që është detyra e saj t'i thotë atij ç'është e drejtë apo e gabuar. Nëse djali nuk ka të drejtë të hajë atë që do në shtëpinë e familjës së tij atëherë c'loj lirie keni? Është një gjë kaq e ngatërruar. Prandaj kjo lloj lirie është Thjesht e kundërta dhe ekstremi i skllavërisë. Por në qendër është dashuria ku ju jeni i lidhur (detyruar) me secilin. Unë jam e lidhur me fëmijët e Mij. Po jam. Jam krenarë për ta. Ata më lidhin mua dhe unë gjithashtu i lidh ata. Është një lidhje e përbashkët të cilën e shijojmë mes vetes. Ka kaq shumë dhenie dhe marrje kur është kjo lidhje dashurie. Por a e kuptojmë rëndësinë e kësaj lidhjeje dashurie? Në pretekstin më të vogël ne e presim. E zëmë se gruaja thotë: "Do më pëlqente të dilnim sot". Burri thotë "Pse? Nuk e kupton që jam shumë i lodhur sot?". Ose nëse burri thotë: "Sikur më hahet diçka", ose ndonjë lloj të veçantë si petulla ose ndonjë gjë të vogël. "Oh jam shumë e lodhur" sa herë që pyet. Nëse ajo mund të mendonte të bënte këtë gjë të vogël ai do të ishte shumë i lumtur. Ajo duhet të vdesë të marrë vesh çfarë don ai. Ai duhet të vdesë të marrë vesh çfarë don ajo. Dhe më pas të shijojnë shoqërinë e njëri-tjetrit ose jeni duke shkuar kot gjithë vlerën që keni si qenie njerëzore. Nuk e kuptoni se sa humbni nga njëri tjetri. Çdo moment është i mbushur me kaq lidhje të bukura që shkëmben. Çfarë fitoni? Mënyrën si luftoni. Ajo për të cilën luftoni. Çfarë keni fituar më lini ta shoh? Kur të vdisni duhet të lajmëroni në gazetë që XYZ ka vdekur dhe do kuptoni që nuk do gjeni asnjëri. Dhe do ju duhet të paguani njerëz që t'ju përcjellin kur të vdisni. Kjo është çështja sot. Ekziston kaq thatësi, kaq boshllëk, kaq vetmi. Ç'keni arritur me këtë. Keni kaq lidhje për të krijuar, dhe s'është çështje sakrifice. Duhet të sakrifikoni për familjen, Çfarë po sakrifikoni? E kam fjalën nëse paguani për familjen ju po merrni gëzim prej saj. Prandaj e bëni. Nëse duhet të jetoni një jetë të mirë të këndshme nuk jeni duke sakrifikuar gjithçka por jeni duke e fituar atë, duke bërë një jetë të mirë. Nëse gruaja juaj thotë "Mos shko në pub", dhe nëse nuk shkoni atëherë s'duhet të thoni është ortodokse, me të vjetrën, këtë atë e kështu me rradhë. Por në vend të kësaj duhet të falenderoni yjet që në këtë kohë moderne keni gjetur një njeri që ju thotë të vërtetën. Sepse gjithçka është ngritur tashmë, mendoni se nuk duhet të thuhet e vërteta? E gjithë kjo është një gënjeshtëri në të cilën jetoni. Dhe nëse doni të jeni të lumtur zbrisni në realitet. Miqtë, e njëjta gjë. Me miqtë, ç'loj raportesh kemi me miqtë tanë? Çfarë presim prej tyre? U dërgojmë një kartolinë për Krishtlindje, dhe nëse nuk na e kthejnë ndjehemi keq. Nuk ka lidhje më të fortë të përjetuar me ta. Nëse e lejoni veten të lidheni me ta, ata do të lidhen me ty. Më mirë provojeni këtë. Përpiquni të lidheni me ta. Mos u frikësoni nga askush. Thjesht provoni të lidheni me të tjerët dhe do të habiteni se sa shumë ata do ju japin juve. Unë jam një shembull i gjallë i kësaj. Po ju them që jam një shembull i gjallë i kësaj. Ndihem e lidhur me të gjithë ju. Nëse dikush më thotë: "Nënë kur do të na lësh? Jo nuk mundem. Unë s'mundem. Thjesht jam e lidhur me ju. Thjesht nuk dua t'ju lë juvë sepse ju dua kaq shumë. Si mund t'ju lë? Është e pamundur për Mua. Po pastaj, ç'fitoj prej kësaj jetë? Gjithçka ka kjo botë. Çfarë doni ju të marr Unë? Unë as që mund të numëroj çfarë mund të marr prej saj. E pafundme, oqean. Unë jam shndërruar Vetë në oqean. Të ndryshosh idetë rreth lirisë personale dhe çlirimit tuaj, është të çlirosh inteligjencën tuaj. Ju po çlironi dijen tuaj. Dhe ëmbëlsia e bukuria nuk prishet kurrë edhe nëse je i ri apo i vjetër. Kjo do të jetë e juaja. Por ju lutem largojini këto helme që janë vendosur brenda dhe jashtë jush. Këto janë helme mendore. Mund t'i hiqni nëpërmjet Agnyas. Do e kuptoni që kjo është një hapje nga ku dalin shumë gjëra. Përpiquni që të funksionojë. Shikojeni pemën me dashuri dhe do kuptoni që vetë pema po ju jep gëzimin e krijesës së saj. Sepse ju bëheni pa mendime. Dhe krijuesi që ka bërë këtë pemë të mrekullueshme do të derdhë gjithë atë gëzim që është brenda tij, brenda jush. Çdo qenie njerëzore është një depo gëzimi. Në çdo prag, në çdo vend ka bukuri, mos e humbni atë. Por nëse keni ndjenjë zotërimi për të, apo tradhtie (shkelje kurore) atëherë nuk mund ta shijosh kurrë. Asnjëherë s'mund ta shijosh atë bukuri, atë depozitim, atë pasuri që është tek çdo njëri e që në çdo moment është duke flluskuar. Për Agnya është gjë e mirë që po afrojnë Krishtlindjet. Është koha në të cilën unë duhet t'ju uroj Gëzuar Krishtlindjet, është ky rast që jam duke u folur për Cakrën Agnya në të cilën, ajo që thashë është Agnya bën që dikush duhet të dijë ç'urdhër të japë dhe si të bindet. Bindjuni Hyjnore. Bindjuni të moshuarve, bindjuni vetes dhe jo egos suaj. Dhe më pas mund edhe të urdhëroni. Jo vetëm qëniet njerëzore por ju mund të urdhëroni madje edhe diellin edhe hënën, erërat dhe çdo gjë në botë. Mund të kontrolloni gjithçka, gjithçka me këtë Agnya. Ai nuk do ta bëjë, provojeni. Kjo është një hile ju them për ata që janë shpirta të realizuar jo për ata që nuk janë ende të vetërealizuar, por ata që janë të realizuar mund ta provojnë. Nëse një person është duke gabuar ju mund ta provoni me Agnya tuaj. Çfarë do ti thoni Agnya suaj do të respektohet për saj (Agnya). Dhe ju vërtet që do të bëheni mjeshtër (master) i vetes e më pas mund të zotëroni shumë gjëra. Dhe sot në këtë ditë të mrekullueshme kur po ju uroj Gëzuar Krishtlindjet, uroj të keni Agnya më të fuqishme, që kur njerëzit t'ju shohin ballin duhet të kuptojnë që Krishti ka rilindur përsëri brenda jush. Zoti ju bekoftë! [1] e ka fjalën për hemisferat[2] Chakra e parë. Do të thotë "rrënja që mban". [3] Qendra e ballit. [4] Njeqelizore. [5] e kufizuar

## 1981-0207, Introduction to Nabhi-Void, New Delhi 1981

View [online](#).

Programi Publik, New Delhi (India) 7 Shkurt 1981

Ju lutem uluni në mënyrë të rehatshme, është shumë e rëndësishme. Nuk duhet të keni tendosje në ndonjë pjesë të trupit, si për shëmbull kur qëndroni ulur ndonjëherë këmbët mund ti ndjeni pak të mpira në pjesën e poshtëme të tyre. Ju mund ta ndryshoni qëndrimin tuaj dhe nuk duhet të vazhdoni të qëndroni të sforcuar dhe jo rehat me veten. Kjo është gjëja e parë që duhet të mbani mend.

Për më tepër disa njerëz mbajnë pozicione të tendosura duke i shtrirë duart shumë drejt ose ndonjëherë duke i përkulur ato shumë. Uluni shumë rehat me të dyja duart në prehër në një mënyrë shumë të rehatshme. Nuk duhet të ketë asgjë ekstreme për tu bërë nga jashtë.

Ne duhet të kuptojmë parimin e procesit jetësor dhe pastaj ju do të kuptoni pse unë ju thashë se nuk është e nevojshme të bëjmë gjëra ekstreme për të arritur qëllimin tonë. Parimi është kështu, duke supozuar se kjo dhomë është e tëra e papastër ose është në kaos ose ndoshta është në errësirë totale, ju nuk mund të shikoni asgjë, kështu ju hyni brenda dhomës, qëllimi që duhet të arrini është arritja e ndricimit shpirtëror. Disa njerëz do të thoshin le të pastrojmë njëherë dhomën në errësirë duke mos parë, ju do të filloni të pastroni trupin tuaj, ju nuk e dini se çfarë duhet të pastroni kështu që nuk është e nevojshme të mërziteni në lidhje me pastrimin kur ju jeni i verbuar. Disa njerëz mendojnë se nëse ju pastroni mëndjen tuaj përpara realizimit do të ishte më mirë. Ju i keni provuar të gjitha këto por duke bërë kështu ju keni shkuar në ekstreme. Është errësirë e plotë, e gjithë puna juaj është bërë në errësirë, aty nuk ka ndricim. Fillimisht ju duhet të gjeni ndricimin tuaj, kjo është ajo që unë kam kuptuar. Deri në momentin kur qënjet njerëzore të kenë arritur ndricimin e tyre shpirtëror ata nuk do të mund të pastrojnë veten e tyre sic duhet. Ata nuk mund ta kuptojnë SahajaYogën. Ata nuk mund ta kuptojnë Zotin. Ata nuk mund ta kuptojnë, apo ndjejnë shpirtin e tyre. Asgjë nuk është e mundur derisa dhe kur ata do të ndricohen shpirtërisht. Ka mundësi që kur të arrini ndricimin, mund të shihni se drita nuk ka ardhur sic duhet, mund të ketë luhatje të saj, luhatje të hijes ndoshta dhoma ju duket e papastër dhe ju nuk mund ti shihni gjërat qartë, ndoshta ju nuk mund të shihni imazhin tuaj në pasqyrë, sytë tuaj janë të dobët, për të gjitha këto ju keni nevojë për një dritë të ndritshme. Por pa gjetur vetë dritën, pa e ditur dicka në lidhje me çfarë keni brënda vetes, si do të arrini të pastroni veten? Sigurisht drita mund të jetë e zbehtë, por prapë ju mund të shikoni se cili është problemi, çfarë duhet bërë, çfarë duhet të pastrohet. Kjo është arsyeja pse ndricimi është gjëja e parë që duhet të arrihet.

Për këtë, edhe nëse ju pastroni të tërë dhomën, e keni mbaruar të gjithë atë, ju nuk e keni bërë punën të plotë, përkundrazi ju mund të thyni disa gjëra, mund të prishni disa gjëra, mund të gaboni, cdo gjë mund të ndodhë në errësirë. Kjo është ajo që ndodh tek njerëzit kur ata bëjnë ndonjë sadhna[1] të verbër. Mbas ndricimit tuaj ju e dini rrugën tuaj, ju dini se si të ecësh në të dhe ju kuptoni cdogjë.

Një tjetër mit që ne kemi është që nëse ne qartësojmë mëndjen tonë në mund të arrijmë spiritualitetin tonë. Ne nuk do të mundnim edhe nëse kjo dhomë do të ishte e pastër, derisa të ketë dritë atje nuk do të mund të ketë ndricim, kështu më e rëndësishmja është të keni ndricimin.

Unë kam njohur njerëz që bëjnë një jetë të mirë dhe vërtetë të pastër. Kur ata arrijnë ndricimin ata e arrijnë atë shumë shpejt dhe e kanë atë të stabilizuar këndshëm, shumë me lehtësi ai është atje. Por disa njerëz të cilët bëjnë një jetë të mirë dhe të rregullt, e kanë mbi bërë atë aq të shumë sa ata kanë krijuar ego rreth asaj. Ata thonë «Unë nuk kam nevojë për asgjë, Unë jam i përkryer, Unë nuk bëj gabime, Unë nuk kam asnjë problem, Unë jam një person shumë i lumtur». Të tillë njerëz bllokohen sepse ata nuk i duan gjërat më të larta të jetës. Ata nuk duan që shpirti i tyre të ndricohet kështu kjo ndonjëherë bëhet shumë frenuese.

Tani në Sahaja Yoga ju duhet të dini se ju keni fuqinë brenda jush. Ajo është aty, ajo ekziston aty, ajo duhet vetëm të zgjohet në disa njerëz. Ajo mund të kërkojë kohë të zgjohet në mijra njerëz. Unë e kam parë që ajo nuk kërkon kohë, ajo që unë sygjeroj është të mbani mëndjen tuaj të hapur dhe mos u bëni kokëfortë në lidhje me gjërat. Nëse ju jeni një person kokëfortë Kundalini

është edhe më kokëfortë. Mos u bëni kokëfortë, vetëm mbajeni veten të hapur mos e argumentoni atë, duke argumentuar ose duke menduar atë, Kundalini nuk do të zgjohet , përkundrazi kur Kundalini është zgjuar brenda jush mendimet tuaja qetësohen aq shumë sa ju ndjeni se asnjë mendim nuk është duke ardhur tek ju nga nënvetëdija ose nga mbivetëdija juaj. Kështu që mundohuni ta mbani veten tuaj absolutisht të hapur dhe mos u mërzisni edhe nëse vibrimet tuaja nuk janë mirë. Parimi është se drita është dritë dhe dhoma është dhomë, drita nuk ka asnjë lidhje me dhomën, kur drita është e ndricuar ajo ndricon dhomën, dhoma ka dicka për të bërë me dritën ndërsa drita nuk ka asgjë për të bërë me dhomën. Panvarësisht se dhoma është aty apo jo drita ekziston, në të njëjtën mënyrë ne duhet të kuptojmë që mardhënjen e atmës tonë me trupin , e shpirtit me mendjen, egon dhe superegon tone.

Shumë prej jush duhet të keni bërë shumë « tapasyas » dhe shumë gjëra të cilat nuk duheshin bërë, duke menduar se ju keni bërë kaq shumë « teerath yatra », ju keni bërë kaq shumë peligrinazhe, dhe të gjithë keto peligrinazhe dhe të gjithë këto vende, që sipas jush duhet të ishin bekuese për ju, por aktualisht ndërkohë që shkoni atje, ju nuk dini se si të marri bekimin nga nga këto tempuj, këto vende të cilat janë të shenjta aktualisht në natyrë por janë të rrethuara nga njerëz të cilët janë aktualisht negativ dhe për shkak të këtij miksi atje në vend të marrësh bekimin ajo që merrni është vetëm një dhimbje koke.

Sot ne do të diskutojmë për Void –in. Ajo që ne quajmë Void në Sahaja Yoga është ndryshe nga mënyra se si njerëzit flasin për Void-in, zgavrën e totalisht të thellë e cila është quajtur në gjuhën e Sahaja Yogës si Bhavasagara se paar utaroo.Çfarë është Bhavasagara[2] ? Ky është një simbol apo është reflektimi i të gjithë universit që është krijuar. I gjithë ky univers është krijuar nga Brahmadeva[3], ai është i vetmi i cili është krijuesi .....rachivata e kësaj bote i cili krijoi këtë univers të bukur, gjatë kësaj ai vecanërisht krijoi nënën tokë, ai vendosi hënën dhe diellin në të dy anët e nënës tokë, ajo përfaqëson tek ju nënën tokë brenda jush, e cila është Kundanini në çakrën mooladhara.. Tani ky univers që ekziston brenda nesh dhe është bhavasagara e cila ekziston në shumë etapa të formës së saj të evolucionit dhe sot është etapa kalyuga[4] në këtë bhavasagara. Unë dua të them është një agim i satayuga-s në fund të kalyuga. Bhavasagara është vendosur në qendër të Nabhit dhe rreth kësaj çakre lëviz qendra e çakrës Swadishthana, Nabhi çakra sic ju e dini është e udhëhequr nga Shri Lakshmi si nj fuqi e Shri Vishnu dheSwadishthana lëvis rreth tij, e cila përcakton personalitetin tonë, e cila krijon të gjithë këto yje të ndryshëm brenda nesh dhe planetet brenda nesh. Në këtë hapsirë, Void, kanë lindur mishërimet e mjeshtërit të hershëmi cili është quajtur Dattatreya. Dattatreya është pafajsia e Shivës (vibrime itne hai) i Brahmadevës dhe Shri Vishnu, Brahma, Vishnu, Mahesh, thelbi i tyre, pafajsia e tyre është trupëzuar në formën e Dattatraya -së që është mësuesi i hershëm. Pra këta mjeshta që janë lindur në këtë tokë janë më të pafajshmit, të integruar të gjithë së bashku. Këta mjeshttra janë mishëruar në këtë tokë më së shumti dhjetë herë por ka patur edhe mishërime të tjera, ka patur përsëritje, thjesht për të korrigjuar vetveten. Siç ju thashë dje Mohammed Saab dhe Nanaka të dy janë i njëti personalitet i Dattatraya-s . Shembulli jepet në jetën e Guru Nananka -së, ndërsa ai flinte njerëzit i thonin që këmbët e tua janë në drejtim të Mekës Kaaba, ai tha në rregull do ti lëviz këmbët dhe do ti vendos nga do të thoni ju, më pas ata i vendosën këmbët e tij në drejtimin tjetër por, përsëri panë që këmbët e tij drejtoheshin nga Kaaba. Atëherë ai tha më tregoni vendin ku nuk ka Kaaba dhe unë do ti vendos këmbët, por ata nuk mundën ta arrinin këtë sepse kudo që ai vendoste këmbët e tij ishte si një Maya dhe gjithmonë ata shihnin që këmbët ishin në drejtim të Kaabe-s.

Tani Kaaba është një vend ku ju keni një Shivalinga të bukur e cila quhet Mekkaeshwar Shiva në puranas[5], që nga kohët e lashta është përmendur se aty është një pinda e cila është apsolutisht e vibruar dhe e cila ndodhet aty.

Mohammad Saab në mënyrë religjioze shmangu të folurën rreth saj. Ai vetëm tha « Nëse ky gur mund të jetë kaq i mirë, pse qenjet njerëzore të mos jenë ? ».Por ai nuk e shpjegoi mirë për arsye se sa herë që ai përpiqej ta shpjegonte njerëzit ishin aq të pandjeshëm, aq mizorë sa u përpoqën ta vrisnin atë shumë herë, ata e helmuan atë, së fundmi ai vdiq në një gjendje shumë të keqe, ata e torturuan jetën e tij, ata ishin njerëz të çmendur, ata jetojnë në fise, shumë të ashpër nga natyra. Ai u përpoq me të mirën e tij për të thënë që ekziston Zoti, Zoti është mbi të gjitha, dhe unë jam lajmëtar i Perëndisë, po ata nuk donin ta dëgjonin atë. Pastaj erdhën , ju e dini Nanaka i cili predikoi se nuk duhet të ketë armiqësi midis Hinduve dhe Myslimanëve, ai predikoi sepse, ai pa Myslimanët të silleshin në një mënyrë, ata ishin aq fanatikë, dhe ata ishin bërë aq qesharak dhe ai nuk po e kuptonte si kishte ndodhur kjo?Këta janë njerëzit që unë i kam bërë Myslimanë dhe cfarë janë duke bërë ata këtu ? Aktualisht Mysliman do të thotë njeriu që është i realizuar dhe Peer është personi realizimi i të cilit është i stabilizuar aq shumë kështu që ai tha ata që janë bërë Musalaman duhet të varrosen dhe jo të digjen sepse ai mendonte se ata janë të gjithë shpirttra të realizuar, por realizimi mbaroi me dhëndrin e tij dhe vajzën e tij, pas kësaj ai pati dy djem të cilët ishin dy shpirttra të mrekullueshëm, të cilët janë vërtet



rimishërimi i Lov dhe Kush.

Tani ndoshta ne nuk e dimë cfarë ndodhi me Lov dhe Kush kur ata u lindën. Lov dhe Kush kur nëna e tyre u zhduk në nënën tokë dhe babai, ata u mërzitën me të dhe shkuan në Veri, njeri shkoi në Kokacious dhe tjetri shkoi në Kinë. Lov shkoi në Kokacious dhe që aty ai u bë një mbret i fuqishëm në Rusi. Rusët gjithmonë e përdorin gjuhën Sanskritishte, ne nuk e dimë sa sa shumë Sanskritisht ata përdorin , për shembull ata do të thoshin kharoshou që do të thotë Harushivaye vetë Pravada-n fjala Pravada vda është si të thuash Pra që do të thotë i ndricuar. E shihni gjuha e tyre, është plot me fjalë në Sanskritisht, praktikisht është absolutisht e bazuar në Sanskritisht dhe ju do të thoni njerëzit sllavë ....slavs, kështu lov sla.....

Lov drejtoi atje për shumë vite, reth katërqind vite më parë, dhe pasardhësit e tij të vërtetë u shpërngulën që aty dhe shkuan në Iran, aty ku ndodhej një Perëndeshë , tempulli i Perëndeshës Hindolika ndodhet atje e cila është e tëra e përshkruar në Puranas, ku ata adhuronin Perëndinë Hindolika, që aty ata zbritën poshtë dhu u shpërndanë gjithë andej, është një histori e gjatë. Ndërsa Kush shkoi në Kinë , kjo është pse ju keni Kushan në Kine dhe supriuuese në se i dëgjoni ata të flasin , për shembull ata thonë ; Ma tza tum, tza është vetëm në gjuhën Marathi, ata përdorin këtë fjalë tza, ne nuk themi asnjëherë në Hindisht tza ose në ndonjë gjuhë tjetër nuk do të gjeni fjalën tza vetëm në gjuhën Kineze dhe në gjuhën Marathi ata e kanë këtë flalën tza. Është shumë interesante të shikosh se si spiritualiteti është shpërndarë në këto vende dhe pastaj se si u shua. Të gjitha këto ndodhën , por pastaj ata u lindën përsëri dhe përsëri, ata u lindën si Mahavira dhe Buddha, ata janë të njëjtët, ata kanë lindur si Markendeya, ata kanë lindur si kabira[6], si Adishankaracharya, ishte Buddha ai që lindi si Adishankaracharya vetëm për të korrigjuar vetveten. Buddha u trondit për rrugën që njerëzit po ndiqnin, pastaj ishte Nirakara[7] i cili do të lindte përsëri si Shankaracharya për tu treguar njerëzve, Oh Zot! Çfarë jeni duke bërë? Ishte vetë Buddha i cili erdhi për të korrigjuar vetveten si Shankaracharya. Është shumë surprizuese që njerëzit janë duke luftuar, Budistët dhe Hindut janë armiq të mëdhenj të njëri tjetrit, por ata nuk e dinë që personi që vërtet themeloi Hinduizmin ishte i njëti që themeloi Budizmin.

Kështu imagjinoni i njëti personalitet që vjen përsëri dhe përsëri në këtë Tokë që përpiket të korrigjojë dishepujt e tij përsëri gjen se janë dy grupe që ai i ka krijuar, ky është një problem i madh.

Mahavira gjithashtu ishte njëri nga ata, i cili u lind përsëri e përsëri dhe ai ishte Markendeya dhe ai ishte Kabira, nga mënyra se si Kabira ndëshkoi njerëzit mund të kuptoni se ai ishte i madh, ai është si Bhairava[8] dhe fuqia e Bhairaves, Kabira u përdor në gjuhën e tij, por për poetët Hindu ishte Sadhukadi dhe ata u tallën me të. Gjëja më e mirë tek një njeri i cili nuk do të përballet me realitetin është të tallet me cdo njeri, kjo është rruga më e mirë, ato thoshin cfarë është kjo e folur Ida, Pingala, Sushumna ? Kush ishte ai ? Çfarë mendonte ai për vetveten ? Por ai ishte i vlerësuar shumë nga të shenjtët dhe vecanërisht nga Guru Nanaka, i cili përfshiu të gjithë poezitë e tij në Grantha Sahib –in e tij. Ai është i përfshirë në kaq shumë poezi, të tëra nga shpirta të realizuar nga Maharashtra[9] gjithashtu. Por unë pyes veten sa shumë Sikhs e dinin se kjo ishte për të dhënë vetërealizimin, ai mendonte nëse ju shkruani një upanishad, .....ata përpiqen të korrigjojnë gjithshka vetëm që të bëjnë njerëzit të kuptojnë që ju duhet të përfshihen në të. Së pari ata mendojnë se nëse ju shkruani Gita, ata do e mbajnë mend përmendësh, më pas ata menduan se do të ishte më mirë që ju të shkruani diçka prej shpirtave të realizuar, të bashkuara , kështu që kjo është një Grantha e fuqishme nëpërmjet të cilës kur njerëzit e lexojnë atë ata marrin vibrime dhe ata do të rrinë me to, por nuk është kështu, edhe aty njerëzit ishin vetëm duke e lexuar atë. Unë nuk e di se si ? Gradualisht ne jemi duke u xhiruar në të njëtin vend, ne jemi duke humbur ndjeshmërinë tonë. Të paktën në kohën e Ramës njerëzit e dinin se ai ishte një rimishërim. Në kohën e Krishnës ata e dinin që ai ishte një rimishërim. Shumë njerëz e dinë, pa dyshim, Raksasha e dinte gjithashtu se ata ishin rimishërim. Raksashat edhe në ditët e sotme e dinë se rimishërimet e kujt janë shumë të sigurtë për këtë dhe ata janë vetëm të friksuar prej tyre. Por në ditët e sotme edhe njerëzit e zakonshëm e dinë se kush është i rimishëruar. Tani ndjeshmëria midis qenjeve njerëzore ka filluar të pakësohet dhe të pakësohet dhe ata e gjejnë veten të përfshirë në fanatizëm, në të gjitha llojet e tantrismit që janë përhapur në vendin tuaj, në vendet e tjera gjithashtu, lëvizje të papara janë bërë atje vetëm për të krijuar fanaticism, dhe gjithë këta fanatikë janë njerëz të sëmurë, ata janë të sëmurë, ata janë aktualisht njerëzit që janë të posesuar, apsolutisht të posesuar, ata nuk janë njerëz normal, kur ata flasin , ju çuditëni, si mundën ata të flasin kështu? Kur ata nuk dinë asgjë rreth saj, por falë Zotit sot , fanatizmi ka arritur një stad që të rinjtë janë duke e kuptuar absurden e saj. Është një shans shumë i mirë për Sahaja Yoga –n për tu lartësuar. Në Sahaja Yoga, e bukura është se ju nuk mundëni të formoni një kult, në momentin që ju do të provoni ti bëni këto gjëra ju do të humbisni vibrimet tuaja, nëse ju provoni ndonjë nga këto truke, përpiqeni të bëheni fanatik ju do të humbisni të gjitha vibrimet tuaja, cfardo truku të provoni në Sahaja Yoga , e para ju do të humbisni vibrimet tuaja, ju nuk do ta pëlqeni atë, ju

nuk do të jeni të lumtur me këtë, ju do të doni të vazhdoni të mbani vibrimet tuaja , të buta, të qeta, të këndshme dhe ju ndiheni apsolutisht të lumtur me to dhe të gëzuar, por nëse ndokush provon ndonjë truk apo hile me Sahaja Yogën do të futet në probleme.

Tani këta Guru kanë ardhur në këtë Tokë për të larguar fanatizmin, i fundit i tyre erdhi si Shirdi Sai Nath, ai është i vetmi që e ka thënë qartë, tek Marathi ai ka thënë , që të flasësh keq për ndonjë besim tjetër është mëkat, është mëkat

asgjë nuk mund të jetë më e fuqishme se kjo. Ka shumë njerëz që e adhurojnë Sai Nath , shumë njerëz, por ata pijnë alkol. Ai ishte kundër të pirit, të gjithë ishin kundër të pirit, pse ishin kundër të pirit, sepse vetëdija është përhapur në Voidin tuaj. Vetëdija, Chitta , vëmendja është në Voidin tuaj dhe ushqehet nga mëlcia.

Mëlcia nxjerr të gjithë helmin nga vetëdija juaj, nga shëndeti i keq, nga mendja e sëmurë, nga cdo efekt i keq ose negativitet dhe më pas vetëpastrohet ashtu sic ju tregova dje. Pra kjo vetëdije brenda jush, ju dini që vetëdija jonë, vetëdija njerëzore humbet nëpërmjet të pirit. Këta njerëz predikuan që ju nuk duhet të pini, e kam fjalën që e vetmja gjë që të gjithë ata predikuan ishte që nuk duket të pini alkol. Në kohën e Mohammad Saab nuk pihej duhan, edhe në kohën e mjeshtër Nanakës gjithashtu, por në këtë kohë shikonit njerëz me llulla shumë të mëdha, ai tha për hir të Zotit mos tymosni sepse sipas tyre është thënë vetëm mos pini alkol, kështu që ne do të tymosim tani.

Si në Angli ku njerëzit pyesin ctë keqe ka droga ? Drogërat nuk janë të ndaluara nga të shenjtët kështu që ne mund ti marrim, prandaj është në detyrën time që tu themi atyre që me drogën ndodh e njëjta gjë. Cdo gjë që është kundër vetëdijes nuk është e mirë. E kam fjalën që s'është dicka që i keni thënë 'JO' sepse ata ishin të marrë, cfarëdo që kanë thënë e kanë thënë sepse ishte e vërteta. Nëse pini pije të cdolloji, alkolike, apo të kësaj të natyre, cdo gjë që ju largon nga vetëdija juaj është e gabuar, sepse vetëdija juaj duhet të ndricohet si vetëdija e juaj, dhe nëse kjo vetëdije që duhet të ndricohet është plot alkol si mund të ndricohet? Si mund ta bëjmë ?

Por të flasësh kundër alkolit këto ditë, një person më pyeti (nënë keni ndërment të bëheni ministre e lejimit? Domethënë është e pa mundur të flasësh rreth këtyre gjërave delikate me njerëzit. Madje nëse shkon në një festë do të thonë pse nuk pi? Ti duhet të pish, po humb një gjë të madhe, ke humbur kaq shumë nga jeta jote. I thashë që kam pirë që nga fëmijëria, mos më jepni asgjë për të cilën nuk kam nevojë, por të gjithë ata më detyronin duhet të pish. Ju e shihni si një gjë të vecantë, ajo është një gjë edhe kaq. Ata nuk kanë turp prej saj fare. Ata mendojnë se po përpiqen të jenë të sjellshëm dhe nëse ti i thua atyre pse pini ? Mbaroi, ti je një cështje e humbur, nuk ke mirësjellje. Ti je njeriu më i pasjellshëm. Si guxon ti ti thuash një gjë të tillë dikujt? Shiko tek këto qënje njerëzore , kaq ..... unë nuk di si të sillem më ta me ta? Ata mendojnë se unë duhet tu them në rregull « vazhdoni pini, vrisni veten » Si mund të jeni shenjtor duke u lejuar të pini? Më thoni kur ata e dinë që kjo është kundër vetëdijes së tyre, sigurisht këta banditë do të thonë « në rregull, pini sa të doni, bëni c'tju pëlqejë, mbani dhjetë gra ose bëni atë që ju pëlqen vetëm më jepni kuletën tuaj » sepse ky është interesi që kanë ndaj jush.

Ata janë të interesuar vetëm për kuletën tuaj, sa para keni në kuletë? Cfarë pune jeni duke bërë? Ose ka raste nëse jeni zyrtar do të thonë më gjej punë për djalën ose për dikë. Duhet të kuptoni që shenjtori nuk friksohet nga askush, nuk mund të jetë, është i pa trembur, tërësisht apsolutisht i pa trembur, nuk friksohet nga askush sepse qëndron në të vërtetën, vetë e vërteta ju jep forcën të thoni të vërtetën, por unë kam marë disa mësimë në jetët e mija të shkuara që qënjet njerëzore nuk e pëlqejnë të vërtetën, mos ja thuani atyre, nëse ja thua ata do të kryqëzojnë menjëherë. Ju nuk duhet t'ja thoni direkt, duhet ti krijoni atyre probleme në këtë mënyrë që ata do të dalin vetë në përfundim. Nëse ja thoni atyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë, mos bëni diçka ata mund t'ju kryqëzojnë mbas disa kohësh nëse ju i thoni atyre që nuk duhet të pini, është kaq keq këto ditë. Të pirit në Angli është është vërtet problem, tani ata Anglezë që përpara kishin zakon të pinin shumë pak tani janë duke pirë me shishe, duke filluar që nga mëngjesi. Në moshën e tretë ju rëndoheni shumë. Cfarë ka ndodhur me Indianët që kanë vajtur atje? Edhe Sikhs-te të cilëve i është thënë të mos pinë, pinë më shumë se sa Skocezët. Është një gjë shumë e turpshme dhe ata mund të mbrohen se ne nuk do të vëmë një kokore në kokë për të mbrojtur kokën tonë ndërsa ecim me motorr. Është e shkruar në ndonjë Grantha Sahib të jesh idiot dhe budalla? Po ata do të luftojnë, por mos luftoni për këtë, por që asnjë Sikh të mos pijë. Nëse ju keni veshur këtë pagadi, ju nuk keni punë me të pirin. Ata nuk mendojnë që thelbi i besimit është më i rëndësishme se të gjithë gjërat e pakuptimta që ju mendoni se jeni duke bërë. Sa fe madhështore Islami! Sa besim madhështor është Sikhism! Sa besim madhështor është

Hinduizmi! Sa besim madhështor është Kristianizmi! Cdo gjë ka shkuar kot, sepse të kotët kanë ardhur tek ajo. Ata nuk e kanë sensin e masës, ata nuk dinë se si të respektojnë Guru-të e tyre.....në mënyrën e duhur duke i vendosur ata në zemrën e tyre dhe në sjelljen e tyre. Kjo është ajo që ata duhet të bënin. Ata duhet vetëm ti bindeshin Guru-ve të tyre. Nuk ishte e nevojshme të qëndronit me kokë poshtë dhe të merrnit mantrat nga këta banditë duke i paguar ata. Nuk ishte aspak e nevojshme të bënit të gjitha këto gjëra, por jo ata mendonin që këtu ne jemi duke bërë para të pista, le të ngremë disa tempuj të mëdhenj kështu që atje do të ketë Hindu të mrekullueshëm, tempuj të mëdhej ndërtohen dhe vazhdon tregu i parave të zeza. Këtu Myslimanët janë duke vrarë kaq shumë njerëz, kështu që ata mund të thonë që jemi duke e bërë këtë në emër të Zotit, bukur shumë. Muhameti ka folur për Rehmat dhe Rahim, gjatë gjithë kohës ka folur për Rehmat dhe Rahim, ta dini ata ishin gati duke e vrarë atë në cdo moment kudo që ai shkonte, ishte një situatë kaq e rrezikshme, po jetonte fshehurazi dhe i duhej të mbronte veten. Kështu ne tani duhet të mbrojmë veten tonë nga këta njerëz, në vend që këta njerëz të mbrojnë veten e tyre. Nuk është një mbrojtje, është një sulm, këta njerëz janë duke vrarë të tjerët dhe ata mendojnë se janë duke bërë një shërbim shumë shumë të madh njerëzve. Pastaj të Krishterët, ata janë nga fanatikët më të këqinj. Fanatikët më të këqinj janë të Krishterët. Nuk mund të ketë fanatizëm më të keq se Krishtërimi. Krishtërimi është një besim i cili është shumë i zgjuar dhe dinak, asnjë nuk mund ti mund ata. Për shëmbull ata do të bëjnë të gjithë punët misionare mund të thonë ha ha ha sa njerëz të këndshëm. Puna misionare, ata janë duke u kujdesur për njerëzit e varfër. Njerëz shumë të këndshëm, njerëz të mrekullueshëm dhe bujarë dhe ata janë duke konvertuar njerëzit. Për çfarë jeni duke i konvertuar ata? E keni ju fuqinë e realizimit? A e keni ju fuqinë për ta thirrur veten i Krishterë? A jeni ju i pagëzuar në kuptimin e vërtetë? Kjo është mënyra se si të Krishterët janë duke u sjellë kudo. Ata kanë ndërtuar një shfaqje kaq të madhe, kjo nuk është puna e Zotit, të marrësh njerëz që janë duke vdekur nga rruga dhe ti vendosësh në dhomë dhe të kujdesësh për ta. A është kjo punë e Zotit? Është kjo punë e qënjeve njerëzore? Puna e Zotit është vetëm të ngrejë Kundalinin, kjo është puna e Zotit. Nuk është punë e Perëndisë të ketë spitale, shkolle apo të tjera të kësaj natyre. Kjo nuk është një punë e Zotit, kjo është puna juaj, kjo është ajo që ju jeni duke bërë, por ata janë duke përdorur emërin e Zotit për të fituar para. Në emër të Zotit më jep mua para. Të tillë lypsa, mund tju them të kategorisë së parë. Të lypurën njeriu, i cili beson në Zot, nuk do ta bënte kurrë. Cfarë të lypësh? Pse të kërkosh para? Ditët e sotme do rrijnë rrugëve të Oksfordit, Hare Rama dhe Hare Krishna dhe lypin para në emër të Zotit.

A mund të ketë mëkatues më të mëdhenj se ata që lypin në emër të Zotit dhe marrin para nga të tjerët dhe jetojnë me paratë e të tjerëve? Gjithë kohës si parazitë. Kjo është që ajo kanë bërë nga besimi, apo ritualizmi duke shkuar nëpër tempuj, atje gjendet një prift i cili ju jep Ghanta, ai bën dicka, vendos dicka mbi kokën tënde, një Zot e di nëse ai njollos chakrën tuaj Agnya apo çfarë bën ai? Dhe ju mendoni « unë kam qënë tek ky tempull unë kam qënë tek ai tempull, unë kam qënë tek ky Teerath tek ai Teerath dhe unë kam qënë një njeri shumë besimtar ». Unë ju them juve se këto ide ekstreme rreth Zotit na kanë verbuar totalisht nga realiteti.

Nëse ju doni realitetin, ju duhet të dini që Zoti duket të gjeni brenda zemrës tuaj dhe jo në ato vende. Deri sa ta gjeni atë brenda zemrës tuaj atëherë do ta dini se ku ndodhet Zoti i vërtetë në cilin tempull dhe si ti afroheni. Tani nëse unë ju pyes ju, në Delhi sa tempuj janë vërtet jaagrut, përveç Sahaja yogistëve askush nuk mund ta thotë, ju shikoni një gur e falenderoni, një tjetër gur i cili mund të jetë sjellë nga disa banjo e falenderoni edhe atë. Është ky një Jaagrut i vërtetë? Është thënë në Bibël se çfarëdo që është krijuar nga Nëna Tokë dhe nga Qielli nuk duhet të rikrijohet, tani çfarë është ajo që është krijuar? Çfarë është ajo që është krijuar nga Nëna Tokë? Ne Indianët e dimë që ato janë Hyjnit Jaagrut të cilat janë krijuar nga Nëna Tokë, këto janë Hyjnitë Jaagrut dhe ato duhet të adhurohen dhe jo të bëni Ganapati[10] në ndonjë vend për dy rupi, stërgjyshërit e mij ma kanë dhënë mua kështu unë jam duke e mbajtur. Unë duhet të bëj Puxhën e tyre ndoshta paraardhësit e mij janë ulur mbi të. Ju nuk do ta besoni, është një zotëri në Bombay, i cili erdhi tek Unë, për të më takuar, emëri i tij është Zt. Shah, ai tha « Nënë shumë gjëra janë duke ndodhur, nuk e di se si? » E pyeta Cka ndodhur? « Në shtëpinë time unë jam duke gjetur disa hyjni të vjetra nga diku, vetëm vijmë në shtëpinë time nga ndonjë vend, unë nuk e di se nga ku janë duke ardhur? Ndonjëherë unë i mbaj dritaret hapur natën dhe në mëngjes aty është një hyjni në argjend, ndonjëherë ka diamantë në hundën e hyjnisë Lakshmi dhe unë jam shumë i cuditur se si po më ndodh kjo? » Dhe burri nuk ishte aq i pasur për të patur të gjitha këto gjëra, ai mi tregoi mua dhe më tha tani çfarë duhet të bëj? Unë i thashë, hidhi ato të gjitha në det, kjo është ajo që ato meritojnë. Ai tha nga kanë ardhur ato? Këta janë njerëz të cilët kanë zakonet e adhurimit të këtyre hyjnive shumë seriozisht, pa kuptuar se këto hyjni kanë vibrime apo jo, nëse janë Jaagrut apo jo, nëse janë në rregull apo jo. Edhe plastike ata mund ti bëjnë, ata mund ti bëjnë prej alumini. Unë nuk e di tani se çfarë do të përdorin më pas për të bërë një hyjni dhe ata do ta mbajnë atë. Nuk ka vlerë, nuk ka kuptim, nuk ka respekt. Kështu njerëzit të cilët i zotërojnë ato, do ti sjellin ato, njerëzit e moshuar dhe do ti vendosin ato në shtëpinë tënde, kështu më mirë hidhi ato në det, përndryshe ato nuk do të kenë Mukti -në e tyre dhe ky djalë do të ketë lakmi. Ai gjithmonë është duke patur një chakkar me këto gjëra. Ai tha « Çfarë është duke më ndodhur? » Ky femijë është duke u futur në telashe, gruaja e tij është duke u

larguar nga shtëpia. Të gjitha llojet e problemeve janë duke ndodhur, humbi të gjithë paratë e tij, të gjitha llojet e problemeve po i vijnë, dhe kjo hyjni është duke ardhur dhe ai thotë, A mund ti shes ato dhe të marr ca para ? Unë i thashë të lutem mos e bëj atë, gjithkujt që do tja shesësh, ti do ti shesësh asubah. Këto janë duke ardhur nga disa njerëz të vdekur duke përdorur këtë bhanawati, ata janë duke i sjellë ato këtu. Por atje ku, ai më tha, mijra njerëz dëshironin vetëm të preknin këmbët e këtyre bhootas. Ata mendojnë se të tillë bhootas nuk mund ti sjellin këto hyjni dhe që duhet të jetë Zoti që ka ardhur në këtë formë. Edhe nëse në këtë gjënë është shkruar gjithashtu, është prodhuar afër Mumbadevi kështu dhe ashtu. Ju doni të thoni që Zoti është ulur aty dhe ka bërë ato statuja? Ne edhe trurin tonë nuk e përdorim, kur bëhet fjalë për Zotin. Unë dua të them besimi është i nevojshme pa dyshim, por kjo është pas vetrealizimit, përpara vetrealizimit është një besim i verbër, i cili mund të jetë cdo gjë e pakuptimtë.

Unë kam parë kaq njerëz të cmendur që vetëm sa shkojnë dhe shkulin flokët e tyre dhe thonë se janë duke e bërë atë në emër të Zotit, vërtetë? Pse zoti ja u dha këto flokë ? Nëse ai do donte që ti shkulin ato, të uleshit nga mëngjesi deri në darkë duke i shkukur flokët, do bëheshin kaq nervozë sa që nëse nuk janë vërtet të vetëdijshëm ata do të fillojnë të shkulin edhe flokët tuaja gjithashtu. Është një situatë kaq e rrezikshme në këtë besim të verbër, sa ju krijoni disa zakone. Ju e dini se njerëzit kanë një ide kur përdorin mala- ne, kjo sepse Kabira ka thënë « kar kamana ka chade de manna ka de manna ka pher ». Kështu ata gjithashtu do të thonë, ata do ta kenë atë, « kar kamana man ka chade de manna ka manna ka pher » mbaroi. Edhe fëmijët e kanë kuptuar lojën, kjo është ajo që ne jemi duke bërë, që kur i thuhet se ju duhet ta keni Zotin në zemërën tuaj dhe mos i bëni këto rituale, ju mund ti gjeni këta njerëz të përdorin ruzare në një masë të tillë , që nëse ata janë duke folur ata nuk e kanë atë, ata nuk mund të ulen drejt , është si një nervozizëm brenda tyre, është një nervozizëm me të cilën ato vazhdojnë me (aur main to hamesha mala japti houn 108 dhe falaana) dhe ju ndjeni që ky person është gati për tu ngritur në disa azile të cmendurish me numrin 108. Mënyra se si njerëzit janë marrosur nëpër fe i bënë njerëzit vërtet ateistë, ata i shohin këta njerëz të marrë, çfarë janë duke bërë ata është fe? Në këtë fe, ku njerëzit e shesin atë, ju shkoni në cdo tempull? Dikur ne blemë pak Am rood , Guavas dhe shkuam në tempull dhe ne po mendonim se ne do të merrnim prej tyre, pastaj ne ishim shumë të rinj, dhe ne ishim shumë motra dhe vëllezër ne ishim poshtë në tempull dhe ne menduam se pas parjes së tempullit ne do të shkonim jashtë mbas tij dhe ne do të hanim gjërat aq shpejtë sapo të arrinin atje, Pujari na i morri pakot nga dora, ju e dini, të gjithë fëmijët, të varfër, ishin duke mbajtur tre apo katër pako që kishim, dhe ata na i morën të gjitha që kishim, ne po duke i parë ata, pse na i morën të gjitha dhe na dhanë secilit nga ne wa wa !

Ne ishim gati të qanim, por motra ime më e vogël nuk duroj dot dhe tha : » pse mi morët të gjitha uavas-it e mij të lutem mi ktheni. Por kjo ishte një lloj e drejtë e tyre që duhet të jetonin me paratë e të tjerëve parazitë.

Në emër të Zotit këta parazitë, jeni ju ata që po i ushqeni, thjesht i jepni para, është më mirë tua jepni lypësve se sa këtyre lypsave të tmerrshëm të sofistifikuar që ulen nëpër tempuj apo kisha. Ju jeni njerëzit përgjegjës për krijimin e një rrëmuje të tillë sepse gjysma e njerëzve janë indiferentë: ata që sjanë indiferentë janë bhagvaan ke naam pe, gjysma e tyre janë si të shkosh tek një Sidhi Vinayak mandir dhe Mangalwaar ditën e (martë), do shihni që rradha ndonjëherë është dy milje në Bombay, ku njerëzit nuk kanë kohë për asgjë. Njerëzit lëvizin me ritmin e një milingone, një inch (cm) në orë, ka njerëz që fillojnë natën dhe vazhdojnë, shkojnë me naariyal dhe me naariyals e tyre, vijnë nga ana tjetër dhe shesin përsëri muajin tjetër.

Ata dinë këtë: derisa thonë që kemi bërë këtë me bhakti[11] dhe Ganesha do të na japë atë që duam. Ganesha do ju japë juve vetëm dituri, do të doja që ai të mundej, do doja që mund t'ju jepte dituri dhe mirëkuptim për fenë (religjonin). Kjo është një rrëmuje që e kemi bërë nga feja, cdo fe, cdo fe jo vetëm Hinduizmi, Islami, apo Kristianizmi ose Sikhizmi. Ne e kemi vrarë vërtet fenë me indiferencën tonë, ose nga shumë indulgjencia, besim i verbër qorrazi, besim në këta njerëz të tmerrshëm, që pretendojnë se janë njerëz fetarë, në c'kuptim janë? Shkoni shihni mënyrën e tyre të jetesës. Shkoni shihni c'lloj njerëzish janë. Po ju them se disa prej tyre janë raksasha, kur shkova në Vrindavan ndjeva gjithë anucharaas e Kansa janë fundas e tyre. Në të gjithë ata nuk gjeta një human, janë kaq njerëz të tmerrshëm dhe mënyra si ju torturojnë e prapë ju shkoni pas fesë.

Duhet të kuptoni që Zoti qëndron në pastërtinë e Tij, Ai është një qenie e pastër dhe Ai pëlqen diturinë tonë. Nuk i pëlqejnë njerëzit budallenj e të marrë. Ai pëlqen njerëzit e mencur, të mencur...si Prahlad, Prahlad ishte një djalë 8 vjecar, kur babai i tij Hiranyakashipu[12] e sfidoi, Shri Vishnu u shfaq në një kolonë (shtyll), e dini në një avatar Narsimha dhe vrau të atin e pyeti djalin e vogël 8 vjecar Prahlad, i tha: "fëmija im, ithtari (besimtari) im, çfarë dëshiron?". Mund të kishte kërkuar për gjithcka, Sakshaat

Vishnu ishte aty, por ajo cka tha ishte: "Tav charna arvinde pritii" Më jep dashuri në këmbët e tua lotus, O Zoti im kjo gjithcka dua. Të të dua ty dhe këmbët e tua lotus. Nëse ke dashuri të pastër për Zotin Ai do të japë mencuri. Nëse nuk ke pastërti do shkosh të kërkosh këtë apo atë; Më jep një transferim, sidomos shërbyesit e shtetit, nuk janë kurrë të kënaqur, duan të transferohen gjithë kohës; Më jep këtë ngritje në detyrë; Më jep një djalë, kur merrni një djalë më jep një punë për djalin tim. Kur ai gjen punë, më jep një grua për të, e gjora Ganesha duhet të lodhet. Kjo është ajo që është, nuk është religjion (besim), kjo nuk është Zoti, kjo nuk ka fare të bëjë me spiritualizmin, ju duhet të kërkoni për një gjë "Tav charna arvinde pritii"

Oh zot më ler të jem tek këmbët e tua lotus që një ditë Kundalini im të mundë të zgjohet dhe që atma[13] ime të mund të ndricohet brenda vetëdijes sime. Më lër ta kem jetën kaq të bukur "Ye chaadar rishi muni jann odhi, Odhi ke meli kini chadariya, Daas Kabir jatan se odhi, Jaisi ki taisi rakh dini chadariya."

Kjo është ajo që duhet të bëjmë, në vend që të shkojmë në këtë hile Tan, këtë bhajji, atë Pundit ji, atë Paney ji, apo disa Paadri ji të tjerë ose sic I quani lloj tjetër njerëzish ata Aullah ji's dhe gjithë llojet e Mau Lana ji's dhe Pri's dhe gjithë llojet e gjërave, por çfarë merrni? Një Agnya të keqe. Ato nuk kanë të drejtë të jenë aty, janë aty sepse duan të bëjnë biznes prej Zotit.

Fola sot për këtë sepse është e rëndësishme të kuptohet, C'është besimi? Sidomos në Indi kam parë njerëz që pendohen në emër të Zotit, që është një gjë shumë e mirë, por pse të bësh pendesë, për çfarë të vuash? Pse e bëni trupin tuaj të vuajë kaq shumë? Mbajeni trupin si duhet, mos e mbingarkoni, bëni një jetë të moderuar, ndiqni një jetë normale, kjo është ajo që u ka thënë Buddha, s'është nevoja të shkoni për cdo gjë në ekstreme, por edhe budistët kanë vajtur në një tjetër ekstrem. Pra ai duhet të vijë në këtë Tokë si Shankaracharya tu tregojë njerëzve c'gabim po bëjnë? Kur e kam thënë këtë? Më pas u lind si djali I Fatimabai [14] që ishte askush tjetër vec Janaki dhe ata ishin djemtë e saj Hassan dhe Hussein, që kishin predikuar jo dhunë dhe kishin parë njerëzit që përpiqeshin të ruanin buburreca dhe mushkonja. E dini që ka disa kulte qesharake ku ne jemi në mënyrë të vecantë në mushkonja e buburreca dhe të gjithë llojet e krimbave, nuk jemi aspak të vecantë si qenie njerëzore, ata, unë nuk e di se c'mund të bëj me buburrecat? A do ju jap atyre realizim? Edhe pulave...a do ju jap atyre realizim. Unë duhet tu jap realizim qënieve njerëzore. C'është nevoja tu japësh kaq shumë rëndësi këtyre gjërave pa kuptim? Të ruash buburreca dhe mushkonja e ti bësh ato të pickojnë Bahmin dhe tu paguash atyre para, sepse ata mendojnë se kanë bërë një kalyana të madhe në buburreca. Ndoshta ata në jetët e shkuara kanë qenë buburreca përderisa interesohen në këto insekte. Tani, lindën këta të dy si Hassan dhe Hussein dhe për t'u çliruar nga këto ide të jo-dhunës patën këtë Karbala, në të cilën luftuan dhe vdiqën si shuras (luftëtarë) të mëdhenj.

Kjo është një histori e rimishërimit të madh në këtë Tokë. Ka shumë nga ata që u lindën, nuk kam kohë t'ju tregoj por Sokrati ishte I njëjtë, nxënësi (dishepulli) I tij ishte një nga këta të dy Abraham, Moses[15], që I propagandojnë Cifutëve fenë e tyre (jo e qartë\_\_\_\_) njerëzit kanë një tjetër cmenduri, mund t'ju them të tjerë njerëz të cmëndur këta cifutë, Zoti I shpëtoftë ata prej çmendurisë së tyre, ata do të bëjnë një përmbledhje të librave të tyre të quajtur Todhat (jo e qartë\_\_\_\_), I bëjnë mikroskopike, sa më e vogël të jetë aq më shpirtërore është dhe e lidhin këtu lart, as mund ta lexosh dot, duhet të përdorësh një xham magjik që të lexosh atë, në fakt nuk e lexojnë kurrë, është e lidhur këtu. Sipas tyre, nëse është zburuar me diamante, atëherë je një person shpirtëror akoma më I madh, e shikoni që ata janë njerëz shumë të pasur, kështu që e lidhin këtu lart dhe shkojnë para një muri vajtimi dhe si të cmëndur përplasnin kokat e qajnë për ato që kanë bërë. E kam fjalën që nuk ka fund cmenduria e njerëzve.

Mund ta kuptosh që kjo nuk është fe. Dje vjen tek Unë një Arya samiji, s'mund të merrte realizimin; duhet t'ju them që këta janë një tjetër tip fanatikësh që kemi, arya samaji, kanë qenë të aftë të futen në shpirtin e tyre? Ata thjesht shqetësohen për konvertimin e njerëzve, të martojnë njerëz ose të ngrejnë ndërtesa dhe të thonë, jo ne nuk besojmë në Zot, nuk besojmë në këtë Zot. Ne nuk besojmë në të. Kujt I intereson nëse besoni apo jo, kush jeni ju? C'të drejtë keni ta thoni këtë? Është sikur një majmun të ngrihet e të thotë "Unë nuk besoj në këtë qeveri, nuk besoj në këtë qeveri". E kush e vret mendjen për këta njerëz që flasin kështu. Kush janë ata? C'autoritë kanë ata të thonë c'është e mirë apo e keqe. A e dini se c'është e mirë apo e keqe?

Të thuash për gjëra të tilla unë nuk besoj në këtë, nuk besoj në atë. Themeloria për ne është të dimë që fillimisht të njohim veten, le të marrim dritën tonë të shndritur dhe në këtë dritë të shohim të vërtetën sic është, s'mund të kërkosh të vërtetën që të jetë kështu. Nuk mund të organizosh Zotin. Ai është Ai që është, Ai qëndron sic është, nuk mund ta transformosh Atë. E vetmja gjë që mund të bësh është të bëhesh një me TË. Ajo që mund të bësh është të bindësh Atë, ta ndjesh Atë, të jesh, kjo është ajo që mund

të jesh, por nuk mund ta bësh Zotin ashtu sic të pëlqen, Ai është Ai që është sic ju kam thënë, dhe gjëja më e mirë është të jeni të përlurur si Prahllad, të thoni "Tav charna arvinde priti" Kush jemi ne të kritikojmë këto rimishërime të mjeshtërve të Hershem? Cfarë kemi bërë? Si një herë dikush Më kritikoi, një nga dishepujt e mi e thirra Bardaf, eja këtu, eja këtu sa njerëzve u ke dhënë realizim? Ai tha asnjërit. Cfarë bën kështu? Ai thotë Unë jam berber, më mirë të jesh berber. Për çfarë po flasim këtu? Me ç'të drejtë? Cila është gjëndja juaj për ti thënë këto? Por në këtë Kalyuga, edhe një person që nuk njuh një fjalë për fenë, për Zotin, që nuk ka zgjim, që nuk është i realizuar, të flasë për Zotin. Kjo është ghour kalyuga, ata nuk kanë frikë, s'kanë frikë, të bësh para në emër të Zotit është mëkati më i madh, mëkati më i madh, po ju them të bësh para në emër të Zotit dhe të prishësh Kundalinin e dikujt, sic po bëjnë këta Guru false. Duke përdorur aty bhoot vidya nuk e dinë që do të shkojnë përgjithmonë në ferr, absolutisht do jenë aty përgjithmonë pa mundur të kthehen. U janë dhanë shumë shanse përpara, por nuk ka më për ta.

Ne jemi njerëzit që duhet ti korrigjojmë, duhet të qëndrojmë së bashku dhe tu themi, jo të bëjmë, kemi disa njerëz në Bombay që janë Brahmins, që janë Brahmins, që janë Brahmins të urdhërit të lartë nëse mund ti quajmë kështu, dhe kanë arritur realizimin e tyre. Tani ata duhet të marrin detyrën mbi vete të hedhin poshtë gjithë këta njerëz të tmerrshëm që janë duke bërë para nga publiku. Kështu njëri nga këta është mësues dhe i tha një Brahmini në familjen e tij, sepse kishte ngecur aty përgjithmonë, e shihni Në Brahmins ngjirim tek familjet. Ai thotë "Ime", "Unë duhet të bëj Shard për babin tim, kur do të vini brenda Pitrupaksh? Ai i thotë mund të vij vetëm të Mërkurën apo dicka e tillë. I thotë a jeni i sigurtë që ka një Muhrata për këtë? Po i thotë ky, po jam shumë i sigurtë për këtë. Pastaj ai shkoi tek një tjetër mik, mori Panchanga, Maharashtrians. Ju dini mjaft për këto gjëra si Panchanga e tjerë, dhe ai hapi Panchangan studio aty dhe kuptoi që aty nuk kishte Muhrata, në çfarëdo Panchanga.

Ka tre Panchanga që ne përdorim, nuk e di nëse kemi dijeni për të, ai i pa të gjitha ato, dhe në përputhje me rrethanat muhrata ishte të Martën që ai e festoi. Më pas erdhi miku, "rehne dijiye, rehne dijiye, baad mein le lenge rehne do", erdhi dhe tha "Unë kam ardhur tashmë, eja me ne të kesh shard", Ai tha "Nuk të jap as edhe një filxhan çaj sot", Pse pyeti ai? Më thirret për Shard dhe supozohet që të ha në vendin tuaj, ai thotë jo, nuk kemi gatuar asgjë dhe nëse nuk është dita Muhrata nuk të jap as edhe një filxhan çaj. E thotë këtë në bazë të Tilak Panchanga, i thotë që kam studiuar edhe Tilak Panchanga, kam studiuar këto gjëra kështu që dil jashtë. E gjora nënë thotë "si mund ta bësh këtë, është zakoni yne i vjetër", ai thotë "ky është i vetmi shans që kam për tu çliruar nga ky budalla i vjetër" dhe i thotë dil jashtë nuk do të qëndrosh në këtë shtëpi dhe nuk të jap as edhe një filxhan çaj.

Në tempullin Punduranga ka, e dini për Vitthhalla Panderpur jo qartësisht por kemi njerëz që shkojnë atje dhe kur i pashë mbeta e habitur, ishin të gjithë të cmëndur të gjerët për një muaj këndonin këngë hanin pak (nasha of tobacco) dhe vazhdonin të këndonin me muaj, së bashku shkonin të shihnin Panduranga dhe këta njerëz që jetonin atje quheshin si Badwe, emrat iu përshtateshin absolutisht, si në Kolapur quhen Bhootis, mund ta imagjinoni? Brahmins quhen Bhootis dhe ata quhen si Badwe, dhe këta njerëz pyetën: Si ka mundësi, që keni marrë të cara në koka? I thotë që ky është Naral, ky naariyal ose ju mund ta quani arrë kokosi u ca në këmbët lotus te Panduranga, i thashë si? Nuk mund ta kuptoja, këta Badwe ishin duke bërë këtë punë dhe kur thashë që këta Badwe duhet të dijnë që nëse nuk sillen si duhet do të kenë kohë të vështira, të gjithë u tronditën, por ju do cuditeni që brenda tetë ditësh qeveria mori në kontroll vendin dhe po funksionon, gjuha e tyre tani ka ndryshuar por në këtë mënyrë këta njerëz na kanë turbulluar. Tani ne kemi katër Brahmins, katër Brahmins që jetojnë në Panderpur që kujdesen për fytin e tyre dhe shkojnë u thonë njerëzve në tempuj që mos dëgjoni (e paqartë) dhe propagandojnë e thonë nëse doni ndonjë gjë na e kërkoni neve, por mos u jepni as edhe një Pai këtyre Badwa që s'janë për asgjë, të padobishëm, çfarëdo gjëje që doni të bëni bëjeni për hyjnitë e mos i prekni këta njerëz, trajtojini si të paprekshëm njerëzit që e filluan këtë. Jemi ne që mund të ndryshojmë botën.

Me të marrë realizimin transformimi fillon zë vend brenda nesh. Kur zë vend transformimi personi bëhet i patrembur. Nuk tundohej lehtë nga gjërat, p.sh kam njohur njerëz që dikur merrnin rryshfete hoqën dorë nga marrja e tyre sepse kushtet financiare iu përmirësuan, Lakshim tattwa e tyre është zgjuar dhe nuk marrin rryshfet, Dharma e tyre është jaagrut, nuk pijnë, shumë njerëz që ishin pijanecë hoqën dorë nga të pirët, sepse Dharma e tyre u zgjua përbrenda, thjesht nuk e durojnë dot. Ashtu si një qenie njerëzore nuk mund ta durojë pisllekun por ama kafsha po. Në të njëjtën mënyrë ndodh me ju, thjesht nuk e duroni, nuk doni ta keni më. Në të njëjtën mënyrë, situata juaj politike do të përmirësohet, sepse cili është problemi që keni sot, cili është? Nëse keni zbritur poshtë në Maharashtra dhe aty njerëzit thonë se kemi problem sheqeri, jua them pse, prodhoni shumë sheqer, ai tha se ka një shok të njohur si mbreti i Sheqerit, ai ka grumbulluar gjithë Sheqerin. Vërtet, i thashë pse nuk informoni policinë për këtë? Thanë që kur qeveria Janta ishte atje ai u dha para, tani qeveria është këtu ai u jep para, u jep para gjithë

policëve, ai l drejton të gjithë dhe na korrupton dhe na bën të gjithëve të votojmë për njerëz të caktuar, që l ka nën kontroll. Atëherë l thashë ju jeni përgjegjës për këtë.

Ju merrni realizimin tuaj dhe herën tjetër votoni apo qëndroni me një shpirt të realizuar. Mos votoni për asnjë që nuk është një shpirt l realizuar dhe do shikoni që ky vend do ndryshojë, e gjithë situata do ndryshojë. Jeni ju që l keqpërdorni votat tuaja, në fshatra qoftë edhe për njëherë kanë nevojë për votat tuaja. Si mund ti përmirësoni njerëzit tuaj? Si mund ta ndalni këtë përkeqësim - vetëm nga parivartani[16] juaj, nga transformimi juaj, kjo është e mundur vetëm nëpërmjet zgjimit të Kundalinit.

Kur vendoset zgjimi l Kundalinit njeriu njih vlerën e tij, qëndron si një qenie njerëzore dhe nuk sillet si një qen, që vrapon pas cdo pozicioni që gjen, cdo paraje që gjen, "më jep, më jep". Nuk është kështu. Qëndron me dinjitet dhe askush nuk e poshtëron dot. Kjo është ajo që është; Sahaja Yoga është si një bekim, për të gjithë ne, në të gjithë botën, kudo ku ka kaos, është kudo tani dhe në kaq shume drejtime, edhe për Samaj Karya, Në Samaj sidomos në veri do shihni kushtet janë shumë të këqija, gratë trajtohen me përbuzje, thonë që është ndikim l fesë Muslimane apo cfarëdo. Por nëse shkon në Turqi, do habiteni që njerëzit l trajtojnë gratë me shumë respekt dhe mirëkuptim. Në shkrimet tona shkruhet që, "Yatra naariya puujante,Tatra ram ante devata" do të thotë atje ku gruaja respektohet atje qëndrojnë Zotat, por gruaja duhet të jetë gjithashtu e respektueshme, nëse ajo nuk është e respektueshme s'ka kuptim ta respektoj atë. Është e dyanshme, por mënyra që trajtojmë gruan tonë, në fshat, sidomos në Veri, si Bihar, U.P, Punjab, Punjabi është më mirë tani, gratë kanë më tepër përgjegjësi. Por nuk duhet të jetë rasti, gratë duhet të qëndrojnë gra dhe burrat me patjetër ti respektojnë ato. Ajo që du atë them është që gratë duhet të respektohen për atë që janë dhe burrat duhet të respektohen për atë që janë. Nuk duhet të ndryshojnë vendet, por në këto zona, në gjithë Bengalit e dini vetë, në këtë vend gratë kryejnë vetëvrasje se nuk mund të martohen dhe poshtërohen. Nëse nuk mund të martohesh ca problemi ka? Të duhet të japësh pajë, nëse nuk jep pajë nuk mund të martohesh.

Gjithë llojet e problemeve, një burrë që vjen l dehur, që rreh gruan sepse ka rënë në dashuri me një grua tjetër, shkon tek një tjetër. Gruaja duhet t'ia dalë si një grua që nuk ka burrë, të gjithë do e trajtojnë kështu. Ka gjithë këto gjëra, pse? Sepse nuk e kuptojnë që gruaja është Shakti. Në të qëndron Shakti, duhet ta respektojmë gruan.

Kur gratë nuk respektohen ai vend shkon për dhjamë qeni dhe gratë duhet ta dinë që ato janë Shakti dhe duhet të respektohen dhe jo të jenë të lira dhe qesharake (jo serioze) në mënyrën që gratë Indiane po përfshihen në jetën perëndimore, jam vërtet e tronditur kjo tregon që traditat tona nuk kanë thellësi. Kjo është mënyra që kemi pranuar gjithë këto vlera të pakuptimta prej Perëndimit, ku Perëndimi ka shkuar për dhjamë qeni dhe ne po shkojmë për dhjamë qeni, për këtë ngarkoj me përgjegjësi gratë që sillen kaq lirë nëpër rrugë, zyra dhe shtëpira. Është gruaja ajo që duhet të mbajë Dharman. Tani me këtë. Është shumë e dukshme, ajo që po ndodh, nëse mamaja nuk respektohet në shtëpi, trajtohet si shërbyese nuk ka vend në familje, burri vjen nga zyra dhe l bërtet, fëmijët nuk e respektojnë, nuk disiplinohen nëse nëna nuk respektohet. Fëmijët tuaj nuk mund të jenë kurrë të disiplinuar.

Hidhini sytë flisni për mosdisiplinë, mosdisiplinë kudo. Kujtoj kur isha e re, nuk mund të bënin as edhe një gjë pa pyetur mamanë. Nëse do kishim baba do na thoshte: "A e pyete mamanë? Shko pyet nënën". Në familje, në shtëpi ajo ishte Grahalakshmi, kishte gjithë celsat dhe paratë, as edhe një qindarkë nuk harxhohej pa pyetur atë. Por në këto kohë, gratë janë bërë ose shumë dorështrënguar ose ngarkesë e madhe (rimorkio) dhe burrat nuk dijnë c'të bëjnë me to. Në të dyja anët gratë duhet të jenë të mëncura, ato jane Dhuri boshti l shoqërisë, kjo është e mundur vetëm kur ato janë të realizuara, papritur kam parë që femra shumë rebele janë shndërruar në kaq të bukura, kaq të bukura dhe kaq femërore, të ëmbla, gjuha e tyre e gjithë sjellja cdo gjë ndryshon kaq hijshëm, është surprizuese madje e kam parë edhe tek gratë perëndimore që zakonisht ecin si kuaj.

Vërtet po ti shihni ecin si kuaj, por ndryshojnë fustanet e gjithcka të tyren dhe bëhen kaq femërore,kaq të ëmbla, në të folur në gjithcka, më pas c'ndodh me gratë indiane? Burrat duhet të mësojnë të respektojnë gratë, nëse do përpiqen ti dominojnë gratë e tyre ato më pas do të shndërrohen si gratë perëndimore dhe nuk do dinë c'të bëjnë me veten. Nëse gruaja vendos të jetë e keqe, nuk ka fund marrëzia që bën. Pra le ti biem shkurt dhe le të kuptojmë që për Sahaja Yoga është e rëndësishme respektimi l gruas. Pra që të ketë disiplinë, duhet tu japësh gjithë respektin grave indiane, pavarësisht gjithë këtyre, pavarësisht gjithkaje, të gjithë burrat kanë ndryshuar veshjet janë shndërruar në Anglezë, gratë indiane kanë mbajtur ende veshjet dhe disiplinën e tyre. Burrat tanë mendojnë akoma se jane anglezë të mëdhenj, por gratë tona Indiane nuk dëshirojnë ta pranojnë këtë situatë.

Nuk po them që është gabim të jesh Angles, por nëse jeni Indianë duhet të jeni Indianë, nëse ata janë angleze duhet të jenë anglezë dhe të njëjtën gjë me jetën tonë, aty ku ka realizim, një grua bëhet tërësisht një grua dhe një burrë tërësisht burrë. Dhe një burrë I kompletuar është para nesh Shri Rama, si e deshi ai gruan e tij, në largësi dhe afër, si e deshi ai he pavarësisht gjithë dashurisë tyre sa shumë vuajtën. Kemi para nesh Shri Ramën që e respektonte gruan e tij. Është një Seashell (guackë) për burrin të kuptojë që ju jeni Indiane dhe duhet të silleni si të tilla. Nuk e njihni madhësitinë e grave tona Indiane. Nëse nuk I trajtoni ato mirë ju siguroj që do vijë një ditë që do jenë të lira e të ndyra dhe ato që ju I quani gra djallëzore do lindin këtu dhe mezi do ju lënë të hyni në shtëpitë tuaja. Do qëndroni jashtë, rrugëve. Kështu që jini të kujdesshëm dhe për atë që keni mbartur, siç trajtoni gruan tuaj ashtu do të trajtohet edhe vajza juaj madje edhe më keq, më pas do kuptoni çfarë keni bërë, kështu që jini të sjellshëm me të sepse ajo është martuar me ty, nuk është skllavja jote. Është shumë e rëndësishme. Në Indinë veriore më shumë, pasi mendojnë se në Indinë jugore gratë indiane të jugut dhe gratë Maharashtra I sundojnë burrat. Pasi sipas tyre burrat sundoen nga gratë nëse nuk I rrahin ato.

Duhet të hiqet dorë nga këto ide, por kjo bëhet e mundur vetëm kur merr realimin tënd, gëzimin e vërtetë e të drejtuarit të një jetë martesore të lumtur jashtë mase të bukur, jetë martesore me një dashuri dhe mirëkuptim të përbashkët dhe kam parë që ndodh kaq shumë përmirësimi I mardhënieve mes njerëzve, midis prindërve dhe fëmijëve duke përmirësuar gjithçka, duke e shndërruar kaq të gëzueshme kaq të bukur jetën, dhe fëmijët bëhen kaq të bindur e të ëmbël, është një gjë kaq e bukur kështu që kur atmosfera është kaq aromatizuese me shpirtin tuaj e gjithë aroma, e gjithë atmosfera mund të themi është e gjitha e magjepsur, absolutisht e magjepsur nga jeta juaj paqësore. Kjo është lumturia që duhet të shohim.

Fola sot për këto gjëra sepse Voldi është një gjë shumë e rëndësishme për ne ku të gjitha problemet tona sociale, samajic, politike, rajkiya dhe gjithashtu shpirtërore mund të zgjidhen.

Përvec kësaj dje ju fola për problemet tona fizike nesër do ju flas për cakra të tjera, shpresoj të keni kuptuar leksionin e sotëm. Unë flas në një mënyrë argëtuese por duhet të dini që gjithë ky argëtim duhet të shkojë në brendinë tuaj, duhet ta mbani me veten, nuk është për të tjerët sa më shpejt të thoni është për të tjerët, gratë do hedhin sytë tek burrat dhe burrat tek gratë. Ata nuk e dinë që kjo është e për ju e jo për të tjerët. Të gjithë ju do të filloni, jam duke bërë këtë, jam duke bërë atë, përpiquni të korrigjoni veten, duhet të jeni burra të denjë dhe gra të denja dhe do më pëlqente të shihja cifte të martuarish shumë të lumtur midis Sahaja Yogis, kur të ndodhë kjo atëhere do të lindin shpirta të mëdhenj në këtë tokë, do të shihni që do të lindin njerëz të mëdhenj.

Mjaft Sahaja Yogis tashmë kanë sjellë në jetë shpirta shumë shumë të mëdhenj. Do habiteni që ata e njohin Kundalinin që nga fëmijëria e tyre, jam e sigurtë që kjo do të ndodhë, do vijë një ditë që të gjithë shpirtrat që duan të lindin do të lindin në këtë tokë, sidomos në Indi.

Tashmë Kam parë shpirta të mëdhenj edhe në Angli, nëse shkoj shoh edhe në Australi jam e sigurt që po ndodh gjithandej. Por nëse jeni shpirta të realizuar ju vërtet bëheni prindër perfektë dhe vërtet që ftoni (sillni) shpirta të mëdhenj në këtë tokë që funksionojnë.

Faleminderit!

[1] Praktikë devotshmërie (përkushtimi)



[2] Oqean i ekzistencës kësaj bote apo oqeani i iluzionit, ajo që Ajshtani iu referua si Relativiteti.

[3] Hyu I Swadistan Cakra, Zoti I Trinitrisë Hindu që krijoi universin. Ai u mishërua vetëm njëherë në formën njerëzore, si Hazreti Ali.

[4] Yuga-Periudhë kohe, mijëra vjet e gjatë, që ndodh në një progresion ciklik apo spiral. me gërma kapitale, kur je duke iu referuar një YUGA të veçantë, të tillë si Kali YUGA.

[5] Tekst I shenjtë, zakonisht në Sanskritisht.

[6] Shenjt I Realizuar nga Bihar. I përdorur shpesh si term në Këngët e Sahaja.

[7] Pa formë.

[8] Kryeëngjëlli Mikael.

[9] Një shtet në perëndim të Indisë, ku parimi Ganesha është shumë i fortë. Emëruar prej konceptit të Maharashtra-desha/dharma sqaruar (shpjeguar) nga Shën Ramdasa.

[10] Shefi I ëngjëjve, Lord Ganesha.

[11] Devotshmeri, perkushtim.

[12] Mbreti Djall qe sundoi zonen e Afganistanit dhe nje pjese te Egjiptit. Shri Vishnu u rimisherua si Narasinha per te vrare Hiranykashiu dhe per te shpetuar Prahlad.

[13] Shpirti

[14] (shënimi I redaktorit duhet te verifikohet: John Noyce verifikoi që ky është shqiptimi I saktë)

[15] I lindur nëEgjypt në vitin 1300 para erës sonë. Një nga dhjetë mësuesit e lashtë. Në malin Sinai, Zoti i shpalli Dhjetë Urdhëresat Moisiut. Këto janë dhjetë pikat mbështetëse tek njeriu që përfaqësojnë dhjetë petalet e Cakrës Nabhi.

[16] Transformim.

## 1981-0325, Mooladhara and Swadishthan, Sydney 1981

View [online](#).

Mooladhara dhe Swadishthan. Sidnej (Australi), 25 Mars 1981.

I përulëm të gjithë kërkuesve të së vërtetës.

Heren e kaluar ju tregova pak rreth qendres së parë, të quajtur si Çakra Mooladhara dhe Kundalini e cila është ndërgjëgjja e vendosur në kockën trekëndëshe e quajtur kërbisht. Ashtu siç ju thashë kjo është fuqia e dëshires se pastër e cila nuk është zgjuar ende dhe nuk është shfaqur ende brenda jush, e cila qëndron këtu duke pritur momentin për tu ngritur dhe për t'ju dhene juve lindjen e dytë, pagezimin që ju jep paqe. Ju jep Vetë-Realizimin.

Kjo dëshirë e pastër duhet të jetë një me shpirtin tuaj. Deri në momentin që kjo të përmbushet ata që janë duke kërkuar nuk do të kënaqen. Kjo qender është shumë e rëndësishme sepse kjo ishte qendra e parë që u krijua kur Qënia Pramidale filloi ta bente kete punë. Kjo është qendra e pafajësisë e cila është shenjtëri. Gjëja e parë që u krijua në këtë tokë ishte shenjtëria. Kjo qender është shumë e rëndësishme në të gjitha qëniet njerëzore, kafshët kanë pafajësi, ato nuk e kanë humbur atë ndërkohë që në e kemi... ose mund të themi që ne kemi lirinë për ta braktisur atë. Ne mund ta bëjmë kete, në një farë mënyre ne mund ta shkatërrojmë atë nëpërmjet të ashtuquajturave ide të lirisë.

Kjo qender ka një fuqinë që na jep ne mënjuri. Mënjuria është një fjalë e cila nuk mund të shpjegohet. Mënjuri është kur ne kuptojmë se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe. Atje ku ju vërtet kuptoni se çfarë është e mirë për ju, për shpirtin tuaj, është mënjuria, dhe kur kjo qender është e gjallë dhe nuk është e shkatërruar atëherë ju vërtet e dini çfarë është mënjuria. Për shëmbull, një person i cili e ka këtë qender ne gjendje shume te mire mund t'ju tregojë juve se nga është veriu apo jugu, për shkak të magnetizmit që gjendet në Tokën Nënë. Kjo qender është krijuar nga elementi i Tokës Nënë. Kështu që magnetizmi që gjendet në Tokën Nënë është prezent në këtë qender. Kur zogjtë fluturojnë që nga Siberia deri në Australi, kjo bëhet me ndihmën e kësaj qendre, sepse ata e dinë nese po shtegtojnë drejt veriut apo jugut. Ata kanë një dituri të lindur për të ditur se nga duhet të lëvizin dhe për këtë arsye duhet të dimë se kjo qender është edhe brenda nesh por e ka humbur sensin e gjykimit sepse ne kemi humbur magnetizmin brenda nesh.

Një person i pafajshëm është njësoj si një magnet që të tërheq, ai i tërheq njerëzit drejt vetes së tij, ashtu si një lule që tërheq blëtët drejt saj. Ka disa peshq në të cilët kanë gjetur fushë magnetike dhe në disa prej tyre ata madje kanë gjetur një magnet të mirfillte me ane të cilat ata kuptojnë nese po shkojnë në veri, jug, lindje apo perëndim. Kjo qender brenda nesh mund të shkatërrohet në menyra të ndryshme siç ju tregova herën e fundit. Tani nese ju shikoni mire gjendet një vije blu që zbret nga lart poshte. Kjo është fuqia e dëshirës tonë me ane të se ciles ne dëshirojmë, është ana emocionale e një qënieje njerëzore. Kur një person e shpërfill anën e tij emocionale ose nuk e respekton anën emocionale, atëherë kjo qender humbet. Ajo shkatërrohet shume. Ana emocionale në këto kohë moderne nuk kuptohet mirë nga qëniet njerëzore. Më vjen keq që po e them por është shumë e vërtetë se kur ju shkatërroni këtë qender, gjëja e parë që shfaqet është impotencia ose veprimtaria e tepërt si përdhunimi dhe të gjitha gjërat që janë krijuar për shkak të neglizhencës së kësaj qendre.

Të dyja gjërat janë të njëjta në sytë e Zotit, çdo ekstrem është i gabuar. Ata njëherë që thonë se mund të ndricoheni nëpërmjet seksit janë vërtetë..., nuk di si ti quaj ata, sepse Ajo është Nëna juaj ulur atje, ajo është vetëm Nëna juaj, Ajo nuk ka fëmijë tjetër dhe Ajo është më e shënjtja e te shenjtëve. Ajo është Shpirti i shenjtë brenda jush, dhe nese doni të beni seks me Nenen tuaj, nuk e di nese njerezit ketu arrijne ta kuptojne këtë. Në Indi është e pamundur, ne nuk mund ta kuptojmë këtë gjë absurde. Pra është e njëjta fyerje ndaj Nënës suaj. Ashtu si shumë njerëz që përpiqen të fyejnë Nënë Maria duke e vendosur Krishtin në një situatë shumë të pahijshme me Të. Është dicka që mund të themi se ndodh kur fillojmë dhe flasim në këtë mënyrë. Është një mëkat i rëndë ti bësh dicka të tillë Nënës tënde, e cila është Kundalini dhe për këtë arsye ju tregova herën e kaluar, kam parë që disa njerëz kanë një Kundalini që gjatë gjithë kohës është duke tundur kokën e duke perthyer gjithë trupin e Saj dhe ndjehet kaq e pashprese ngaqë Ajo është bërë kaq e dobët sepse shenjtëria është zhdukur nga personi. Ideja jonë e shenjtërisë është bere kaq perverse, dhe për më tepër ne kemi sot mjeshtër guru që na tregojnë se kjo është dicka shume e mire, ju do të shkoni në parajsë.

Në fakt ata janë shumë të singertë, ata thonë do të shkoni në një pus pa fund dhe ky pus pa fund do të thotë ferr.

Pse ju nevojitet një mjeshtër guru për këtë kur ju jeni bere mjeshtër në këtë art? Dua të them se kur isha në Angli ata flasin vetëm rreth seksit, seksit dhe seksit nga mëngjesi deri në darkë. U habita shumë, nuk i kuptoj. Kështu pra ata flasin vec per seksin, nuk ka asgjë pervec seksit, dhe kjo gje është kaq e ndyrë, kaq e neveritshme. Ata flasin për seksin me kafshët, për seksin me fëmijët. Nuk e kuptoj se ç'po ndodh me qëniet njerëzore, si mund të bëhen kaq të ndyrë? Nuk do të habitësja nëse pas disa kohësh do t'i kemi banjot tona brenda dhomës së pritjes. Si mund të flisni rreth këtyre gjërave, si mund t'i diskutoni këto gjëra kur janë kaq private, dhe kaq të shenjta, dhe në këtë mënyrë ju ose i humbni ato, ose humbni në to.

Kjo është një nga gjërat që po na ndodh neve sepse Zoti na ka dhënë neve lirinë brenda nesh, ne mund të bëjmë çfarë na pëlqen. Por ne kemi humbur mënjurinë tonë, ne e kemi humbur atë. Nuk e di a është për shkak të këtij Revolucionit Industrial, ose nuk di kë të fajësoj, por ne kemi humbur mënjurinë tonë për të kuptuar se këto gjëra janë të dëmshme. Nëse nuk është kështu, mund të themi llogjikisht, atehere përse po shfaqen gjithë këto sëmundje. Me seks të lirë, të gjithë marinarët, sipas ligjit, ne cdo port duhet të marrin injeksione për të gjitha llojet e komplikimeve që ata mund të kenë nga jeta seksuale. Pse ju nuk ndjeheni i shëndetshëm çdo minutë? Ju do të humbisni shëndetin tuaj, i gjithë sharmi juaj do t'ju ikë nga fytyra dhe do të dukeni shumë i frikshëm. Është një shenjë e mirë, tamam tani shikoni se si natyra reagon ndaj kësaj. Kështu duhet të bëheni të mcur për të kuptuar se Zoti na e ka dhënë neve këtë gjë jo për tu fyer por për të bere një jetë të mirë martesore, normale, dhe jo të harxhojmë energjinë tonë me këto lloj gjërash.

Por kur njerëzit fillojnë dhe mendojnë për të është akoma dhe më keq. Më pas çfarë ndodh? Ajo zhvendos prej aty vëmendjen mbi anën tjetër dhe shkon në anën e verdhë, shkon në tru. Kur ju filloni të mendoni rreth seksit, është e sigurtë se ju do të bëheni pa dyshim një i rritur në një fazë tepër të hershme. Sepse kjo është spontane, e pakontrolluar. Dhe kur ju filloni të mendoni rreth tij, kur sytë tuaj fillojnë të bredhin andej-ketej, atëherë te jeni të sigurtë se vëmendja juaj ka shkuar diku në një vend shumë të kufizuar, gje që ndodh vetëm atëherë kur ju jeni në një spontanitet të caktuar emocional. Është jashtë mode të flasësh me njerëzit për këto gjëra por nëse ju nuk jeni të kujdesshëm rreth kesaj juve... do t'ju duhet të zbuloni statistikat e te rinjve amerikanëve të rinj dhe do të habiteni se sa shumë prej tyre vuajnë nga sëmundje të tmerrshme. Kur unë shkova në Amerikë, zbulova se nëntë nga dhjetë të rinj që erdhën tek unë vuanin nga keto sëmundje të tmerrshme dhe shumica e tyre ishin impotente. Është një e vërtetë tronditëse. Duhet ta pranoni ashtu siç është dhe jo të thoni "Jam në rregull, jam në rregull". Nuk është kjo mënyra se si duhen parë gjërat. Ne duhet të shikojmë statistikat që kemi para syve, dhe të dimë se dicka nuk shkon dhe me mënjurinë tuaj të nxirri konkluzione të caktuara rreth kesaj.

Tani qendra e dytë, të cilën unë e quaj Çakra Swadishthana, është gjithashtu një qender shumë e rëndësishme brenda nesh. Qendra e parë kujdeset për të gjitha sekretimet tona. Ajo ka katër petale të njeta në pleksusin e legenit, i cili manifestohet nga ato, ai është një pleksus i madh brenda nesh, dhe ka gjithashtu katër nën-pleksuse. Një tjetër qender që kemi është Qendra Swadishthana, e cila është qendra e dytë. Qendra e dytë ka gjashtë petale, dhe ajo furnizon ose shfaq pergjithesisht Pleksusin Aortik, i cili ka gjithashtu gjashtë nën-pleksuse. Kjo qender është shumë e rëndësishme për ne në kohët moderne, është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe mendoj se shpërfillja e kësaj qendre mund të krijojë shumë probleme.

Kjo qender, nëse shihni, është e lidhur me trurin dhe është përgjegjëse për veprimet tona, është qendra e kreativitetit tonë. Atehere kur ne mendojmë për të ardhmen, kur ne bëjmë çdo lloj pune fizike, ne përdorim këtë qender për këtë qëllim dhe duhet të kuptojmë që në këto ditë ne po behemi prapë e shumë sëmundjeve sepse nuk kemi kuptuar se cili është funksioni i kësaj qendre.

Funksioni më kryesor i kësaj qendre është të shperbeje qelizat yndyrore për t'i përdorur truri. Kur ne mendojmë gjatë gjithë kohës për të ardhmen që ne planifikojmë, ne planifikojmë çdo detaj dhe ajo çfarë ndodh është se kjo qender e shkrete duhet të punojë shumë që të prodhojë qeliza të reja njëra pas tjetres për t'i përdorur truri juaj.

Përveç kësaj duhet të kryejë edhe shume funksione të tjera. Duhet të kujdeset për mëlcinë tuaj, duhet të kujdeset për shprekën tuaj, duhet të kujdeset për pankreasin tuaj, për veshkat tuaja dhe gjithashtu për mitren tek femrat. Nëse ju filloni të mendoni gjatë gjithë kohës, nëse ju nuk ndaloni dot së menduari, truri fillon një proces të menduari pa kontrollin tuaj, më pas kjo qender e gjore duhet ta përpunojë të gjithë këtë, mëlcia juaj lodhet shume.

Dhe duhet të dini se mëlcia është një nga gjërat më të rëndësishme brenda nesh sepse ajo ushqen vëmendjen tonë, Chitta-n. Kjo vëmendje kurdo që është prishur është prishur sepse ekzistojnë disa helme brenda nesh. Mund të jenë helme fizike, mund të jenë helme mendore, mund të jenë helme emocionale, çfarëdo lloj helmi. Janë sidomos helmet fizike ose emocionale që shkojnë tek mëlcia, e cila i filtron. Ky pra është funksioni i melcise.

Por kur ju nuk i jepni energjinë e mjaftueshme dhe jeni duke humbur në mendime, kjo qender e gjore është lënë pas dore, nuk ka asnjë ushqim, askush nuk kujdeset për të e atehere ajo plogeshtohet e punon ngadale. Kur ajo bëhet e ngadalte e gjithë nxehtësia mblihet në mëlci, dhe nje person i tille nuk ka fare temperaturë deri në momentin që ai bëhet me cerozë dhe vdes. Kur njerëzit mendojnë shumë ata lodhen duke menduar shumë, shumë. Kështu ata mendojnë, "Le të marrim dicka që të na largojë nga i menduari, që të na nxjerre nga kjo gjendje". Kështu ata marrin drogë, pije, alkool e gjera te tilla.

Të gjithë shënjtoret në botë kanë thënë se alkoli është shumë i rrezikshëm për jetën. Arsyeja është se ai vepron kundër vetëdijes tonë, ky është një fakt. Ju e dini se pasi merrni një pije vetëdija jonë bëhet e megjulluar ose e ngacmuar. Kjo nuk është normale dhe kjo është arsyeja që ata thonë "Jo". Në Sahaja Yoga unë nuk them te mos bëni këtë dhe atë. Unë vetëm dua që ju të vini te Sahaja Yoga, të arrini Realizimin tuaj dhe më pas ju nuk do të pyesni për këtë. Kjo është një rrugë më e mirë për ta bërë këtë. Për shembull, nese lexoni Moisiun, Moisiu e ka thënë qartë se keto jane pije të forta, shumë qartë. Unë nuk e di nëse njerëzit e kane lexuar kete por ata duhet te ruhen. Nuk e di nese hebrejte veprojne keshtu. Ato pije nuk duhet të merren, ai e ka thënë shumë qartë. Abrahami ka thënë të njëjtën gjë që pijet nuk janë të mira.

Pse të gjithë këta profete kanë folur rreth kësaj? Sepse të gjithë ata kanë lindur në kete ngastren tone te gjelberuar, të gjithë ata janë të vendosur në këtë copë tokë të gjelbëruar ku ne marrim energjite tona ushqyese, te cilat jane dhjete. Ne kemi dhjetë energji ushqyese brenda nesh, ashtu si ari ka një vecori qe nuk nxihet si bronxi., po ashtu edhe qeniët njerëzore kanë dhjetë vlera ushqyese. Dhe këto dhjetë vlera na jane prezantuar nga profetë te mëdhenj. I pari është quajtur si Mjeshtri Adi, në gjuhën e sanskrite, Mjeshtri Fillestar. Ai është rimishëruar në këtë tokë si Abrahami, Moisiu, Lao Tse, Konfuci, Sokrati[1] së fundmi ai ka qenë si Sai Nath i Shirdi-t, jo ai tjetri, dhe njerëz te tjerë të mëdhenj si Nanaka, Janaka. Të gjithë këta profete kanë ardhur në këtë tokë për të na treguar se si të jetojme ne ekuilibër, si të jetojme ne ekuilibër, si të ruajme vlerat tona, si të bëhemi qenie njerëzore. Ashtu si karboni ka katër valenca, edhe ne kemi dhjete valenca. Ne duhet ti mirëmbajmë këto dhjetë valenca brenda nesh, kete kane ardhur te na thone ata.

Por ju e kuptoni qe nëse dikush ju thotë tani te mos pini, gjysma e sallës do të boshatiset. Nëse ju themi se nuk mund të bëni seks të lirë pesë njerëz do të dalin prej këtu. Ky është problemi, këtu askush nuk dëshiron të dijë asgjë rreth tij, por është dicka e rrezikshme. Sidoqoftë ju duhet te mbani ekuilibrin. Ju duhet të jeni në qendër dhe mënyra se si ta mbani këtë ekuilibër është të mos shkoni në ekstrem, te bëheni të matur, dhe jeta e matur është rruga më e mirë. Por edhe nëse nuk keni qene nuk ka rëndësi.

Në këtë pikë Kundalini është në një forcë që çfarëdo të keni bërë, ju mund ta arrini vete realizimin pa problem. Pra është një pikë e ndryshme, por ajo çfarë po mundohem t'ju them është se pse keta njerëz kane thene kështu.

Profeti Mohammed është një person tjetër që ka thënë mos pini, ai është nje nga ata, është njësoj, nuk ka ndryshime, nuk ka diferencime midis Moisiut dhe Mohammedit. Unë mund t'jua vërtetoj kete me ane te vibrimeve. Ju vetë mund ta kuptoni me ane te vibrimeve që ata ishin njerëz të njëjtë, dhe kane thënë të njëjtat gjëra, pa kurrfare diference. Megjithate njerëzit grinden, nuk e di pse, thjesht nuk kuptoj se çfarë ka per t'u grindur midis këtyre të dy popujve. Ata ishin plotesisht të njëjtë, predikuan të njëjtën gjë. Dhe kur Moisiu duhet te kalonte detin e deti u hap qe ai dhe hebrejtë qe ishin me te te kalonin, ai rrip toke ku ata kaluan ishte simboli i Kundalinit që na ben të kalojme këtë zbrazëti brenda nesh.

Është shumë simbolike, ata kanë punuar shumë për t'ju treguar juve se çfarë është energjia ushqyese, ku duhet të jemi në qendër sepse nëse ju jeni ne nivelin ushqyes siç tha ai vetëm një fije e këtij Kundalini ngrihet. Nuk është vetëm një fije që duhet të rritet, në fakt unë kam parë në shumë njerëz që e gjitha ngrihet dhe qëndron atje tek shume njerëz por shqetesim rritet sepse ajo nuk ka hapësirë për tu ngritur. Ne i kemi lare hesapet me Swadishthana dhe me një Çakra tjetër qe është në qendër, e cila është

qendra e quajtur Çakra Nabhi që do të thotë qendra e kërthizës.

Kështu që kur keni një bllokim në kete qendër, natyrisht kundalini, megjithëse ngrihet me gjithë forcën e saj, të gjitha fijet bien poshtë dhe vetëm njëri ngrihet sipër dhe hap Sahasraran, duke menduar se të paktën nëse unë hap ate e më pas të tjerat, hiri i Zotit do të bjerë dhe ndoshta do të hapet më shumë. Pra ky është problemi, prandaj ata predikuan që ju bëni një jetë e cila të jete e rregullt dhe e permbajtur. Tani të shohim se çfarë ndodh kur ne shkojmë në ekstrem. Në qendër, ashtu siç e pamë, ndodhet vlera ushqyese brenda nesh. Nëse ju përqipeni të anoni nga njera apo nga tjetra ane çfarë ndodh? Ta shohim.

Përtej kësaj ane është nënvetedija. Nëse shkoni andej ju hyni brenda kësaj nënvetedije kolektive. Nëse përqipeni të shkoni nga ana tjetër atje është mbivetedija dhe ju hyni brenda mbivetedijes kolektive. Në zonën e nënvetedijes gjenden të gjithë njerëzit e anës së majtë, njerëzit të cilët janë ende të pakënaqur, shumë dinakë, njerëz të keqin që kanë vdekur, të cilët nuk duan të rilindin dhe të cilët ende duan t'i torturojnë njerëzit me cdo kusht. Këta janë ngaterrestare, ata mund t'ju zotërojnë ju. Ndersa në zonën e mbivetedijes janë njerëzit e anës së djathtë, ka njerëz si Hitleri të cilët janë shumë ambiciozë, të cilët kanë vdekur prej ambicieve të tyre por ata ende ekzistojnë atje. Edhe sikur të hyni në njeren anë, edhe sikur të hyni në anën tjetër, kur ju shkoni në ekstrem ju do të zoteroheni nga shpirtra të tjerë. Në kete mënyrë do të hyni në një fushë shumë e rrezikshme.

Kohët e fundit po shikoja një program tek BBC-ja dhe disa doktorë kishin zbuluar një gjë shumë interesante. Ata thanë se kanceri shkaktohet, degjojeni me shumë vëmendje kete, pra thanë se shkaktohet nga njëfarë proteine që ata e quajnë proteina 56 apo dicka e tillë. Këto proteina na sulmojnë nga disa zona të panjohura që janë ndertuar brenda nesh qysh nga krijimi ynë. Këto zona janë ato që po mundohem t'ju tregoj për disa vjet me rradhe pra ana e majtë dhe ana e djathtë, dy ekstremet.

Çfarë bëjmë ne kur shkojmë në anën e djathtë? Ana e djathtë është zona ku ne mendojmë shumë, ku ne e imagjinojmë veten në të ardhmen tonë. Ne vazhdojmë kështu dhe fillojmë të bëhemi persona më tepër të interesuar për të ardhmen se sa për të tashmen. Qendra është e tashmja. Ne fillojmë ta dergojmë mendjen tonë në të ardhmen, fillojmë të lëvizim brenda kësaj ane. Për kete arsye ka njerëz që mendojnë se do të ishte më mirë të benin një jetë të rrepte prej beqari e plot gjera të pakuptimta. Nëse bëjmë një jetë beqarie kjo nuk do të na ndihmojë aspak, perkundrazi bëhemi një personalitet jashtëzakonisht i thatë dhe në fund mund të vdesim nga ataku në zemër. Një person i tillë është aq kokeforte, aq nervoz, sa ju duhet të merrni një shkop me vete përpara se të takoni një person të tillë. Ata janë tipi i njeriut që mallkon. Dua të them se ata nuk e vrasin mendjen fare për shendetin e njerëzve të tjerë, etj, aq saqë mund të mallkojnë kedo. Kjo është puna e tyre, të mallkojnë njerin e të mallkojnë tjetrin. Këta janë njerëz jashtëzakonisht të thatë, ata mund të jepen pas punës sociale në emër të Zotit ose mund të punojnë shumë për të varfërit dhe mendojnë se po shpëtojnë të varfërit dhe ndërkohë nëse ju i shihni ata në një moment tjetër do të siguroheni që një person i tillë është absolutisht duke u djegur me zjarr.

Ata kanë një mëlcë në gjendje shumë të keqe, një karakter të vrazhdë, nuk kanë asnjë grimce ëmbëlsie, tek ata nuk ka asnjë grimce magnetizmi, të gjithë njerëzit largohen nga ata, janë si lakër e zierë, njerëz antipatike. "Bëjeni këtë! Bëjeni atë! Ju nuk keni bërë kete. Çfarë po bëni?", ata nuk flenë vete dhe nuk lejojnë askënd të flejë, ata mendojnë se çdo person duhet të punojë nën urdhrat e tyre dhe këta janë njerëzit të cilët janë të orientuar pas egos së tyre sic ju tregova me parë, ata janë njerëz të cilët shkojnë drejt anës së djathtë.

Çdo ide e ashpër rreth fesë mund t'ju cojë ju në këtë anë dhe kjo ashpërsi është shumë e rrezikshme për qëniet njerëzore sepse ju ndan nga e gjitha. Një person i tillë mund të jetë i poseduar nga një personalitet i tillë në anën e djathtë. Njoh një grua e cila është shumë e njohur në Indi dhe e cila ka marrë një cmim të madh për punën e saj sociale. Më ndodhi ta shikoja për herë të parë në avion kur nuk kishte marrë asnjë cmim dhe dëshironte të ulej në sediljen përballë. Atehere stjuardesa i tha "Më vjen keq! Kjo është e rezervuar për fëmijë të sëmurë prandaj nuk mund t'ju japim juve këtë vend". Ajo filloi të grindej dhe hidhej sa andej këndeje dhe nuk lejonte që avioni të nisej dhe për gjysëm orë ajo vetëm grindej e grindej për t'u ulur aty dhe une u habita shumë me gjithë ato fjale ofenduese që i tha stjuardesës.

Dhe kësaj gruaje duhej t'i jepej një cmim paqeje apo dicka e tillë! Nuk e di, nuk kishte fare paqe në fytyrën e saj apo në gjithë qënien e saj dhe të gjithë u shqetësuan me mënyrën se si u soll ajo. Ishte vërtet shumë shokuese të shikoja këtë personalitet kaq të vrazhdë dhe pedant duke debatuar me stjuardesën se kjo ishte sedilja e saj e keshtu e ashtu. Falë Zotit më pas ata e nxorën

atë jashtë dhe avioni u nis, por po ju them se persona të tillë mund të bëhen cmendurisht të ashper dhe mund të bëhen të pavetëdijshëm rreth prezencës tënde prandaj duhet të keni shumë, shumë kujdes me persona të tillë.

Persona të tillë mund të duken shumë, shumë të sukseshëm në jetë por mjafton pak kohë për të kuptuar se i gjithi ky është një budallallëk.

Ky lloj orientimi drejt egos nuk mund t'ju cojë askund përveç budallallëkut. Një person mund të jetë jashtëzakonisht budalla dhe nuk e di që ka qenë i tillë, se sa budalla ka qenë. Një zoteri erdhi tek ne dhe ai kishte një grua. Ajo ishte një gjashtëmbëdhjetë vjecare dhe burri ishte tetëdhjetë vjec. Normalisht une mendova se ai ishte gjyshi i saj dhe duke menduar kështu i thashë "Mbesa juaj është ajo?" Por burri im i rrudhur në fytyrë më thotë "Është gruaja e tij". Unë thashë "Vërtet?" Unë thashë "Më falni, nuk e dija që ishte gruaja juaj". Ai tha "Çfarë te keqe ka? Unë mund të kem një grua shumë te re, çfarë ka këtu që nuk shkon?" Unë thashë "Asgjë, s'ka asgjë që nuk shkon, vetem se njerëzit do te qeshin me ju, kaq".

Njerëzit bëjnë lloj-lloj budallalleqesh në këtë botë dhe mendojnë "Çfarë te keqe ka?" Kjo është mënyra më e mirë për tu ndjere rehat me budallallëkun tend, derisa të zbulosh që je personi më budalla që ekziston. Ky budallallëk vjen nga egoja, shfaqet dhe e perfshin trurin tuaj totalisht. Ju nuk mund të shikoni asgjë tjetër, shikoni vetem veten tuaj, dhomën tuaj, shtëpinë tuaj, tuaj, tuaj, tuaj. Ju nuk mund të shikoni se atje gjenden të tjerë, që duhet te keni marrdhënie me të tjerët, që duhet të jeni i sjellshëm me të tjerët, që duhet të ndani gjera me të tjerët, ju gjithë kohës mendoni për veten tuaj dhe persona të tillë pushtohen nga stili i mbivetëdijës. Çfarë ndodh me spiritualitetin në persona të tillë? Ata fillojnë të ndjejnë se trupi i tyre qendron shtrire ketu dhe shkojnë e ulen në një pemë, ata mendojnë se është realizim ose ndricim. Kjo nuk është asgjë tjetër por një shpirt i mbivetëdijshëm ka hyrë dhe ka larguar trupin e tyre duke e vendosur atë atje.

Ju kam treguar që erdhen tek une njehere tre Amerikanë nga Amerika qe njiheshin si shkencëtarë të medhenj. Ata erdhën për të më takuar dhe me thanë "Nënë, duhet të na mësosh dicka". Unë thashë "Çfarë?". Dhe ata "Ne duam të fluturojmë". Unë thashë "Ju po fluturoni tashme (me avion), për çfarë doni të fluturoni?. Ata thanë "Jo, por ne duam të fluturojmë me ESP (perceptime jashteshqisore)", unë thashë "Ju nuk duhet ta bëni këtë sepse nëse ju e bëni këtë më pas do jeni të skllavëruar nga shpirtat. Do te dëshironit ta bënit këtë, të skllavëroheni nga këta shpirta?". "Po, çfarëdo të jetë, skllavërim ose çdo gjë tjetër, ne duam ta kemi këtë aftesi për të fluturuar". Unë thashë "Pse?". Ata thanë "Sepse Rusia është duke e bërë këtë, dhe Rusët janë duke bërë eksperimente me ESP. Kështu qe edhe ne duhet ta bëjmë". Unë thashë, "Nëse Rusët shkojnë në Ferr edhe ju do të shkonit në Ferr?" Ata thanë, "Po, çfarë te keqe ka?" Unë thashë, "Asgjë s'ka te keqe, shkonit fare kollaj, ju mund të shkonit shumë shpejt atje, por persa me perket mua une nuk jam për këtë, nuk do t'ju dënoj për jete te jeteve". Kështu unë pyeta "Kush ju ka dërguar ju tek unë?" Dhe ata thanë "Njëfare Patanjali". Eshtë një gazetar i quajtur Patanjali, dhe unë thashë "Ky Patanjali ju ka dërguar ju?". "Po, ai na ka dërguar ne tek ju. Ai është nje person i cili largohej nga trupi i tij dhe shkante në cdo vend qe donte. Ai ishte një gazetar dhe i merrte lajmet përpara të tjerëve, dhe ai ja mbathte nga shtëpia dhe gruaja e tij ngeli shumë e habitur kur një ditë ai solli në shtëpi pak rërë dhe tha "A e di ku isha dje? Isha në plazh, nga atje solla këtë rërën për ty." Ajo u tremb dhe burri dridhej para çdo fotografie të Zotit apo të Krishtit apo çdokujt tjetër. "Ky burrë po dridhet, nuk e di se c'po ndodh. Nuk e di se c'po ndodh. Natën ai zhduket. Unë kyc çdo gjë dhe ai përsëri zhduket. Nuk di se çfarë të bëj. Eshtë shumë shokuese." Ai tha "Ndonjëherë shkoj ulem mbi një pemë." Unë i thashë "Vërtet?" Atehere une i thashe "Ti je i pushtuar nga nje tjetër shpirt." Ai tha "Nënë, të lutem largojë atë. Nuk e dua këtë gjë të pakuptimtë. Nuk e di se ku do te perfundoj nesër. Unë mund të jem kudo, edhe duke ndenjur pezull në ajër. Nuk dua ta bëj më këtë, ndoshta trupi im nuk do kthehet më."

Kjo është ajo që bëjnë njerëzit tani, nxjerrin shpirtat. Kur ata nxjerrin shpirtin nga një person e mbajnë ate me vete. Si fëmijët. Fëmijët e vegjël vdesin duke fjetur. Nëse një nënë është këtu dhe ajo ka një fëmije në Amërikë, dhe ajo thotë së dëshiron të flase me fëmijën e saj nëpërmjet një mediumi (person me aftesi për te komunikuar me shpirtat ne rruge paranormale), është një gjë shumë e rrezikshme. Mos luani kurrë me këta mediume, eshte shumë të rrezikshme. Njoh një nënë të tillë në Zvicër. Ajo ia bëri këtë femijes se saj dhe fëmija vdiq në Amërikë duke fjetur. Sepse distanca është e tillë qe kur ne Zvicër është ditë, në Amërike është natë. Ajo po e bënte këtë gjatë ditës ndërsa fëmija po flinte. Ajo foli me fëmijën, ajo i dëgjoi zërin atij, ajo bëri çdo gjë... dhe fëmija vdiq.

Asnjëherë mos shkonit pranë këtyre njerëzve që merren me shpirtat, kjo është thënë nga të gjithë njerëzit e mëdhenj të botës, por

ne perseri nuk e vrasim mendjen per kete. Themi "Cfare ka te keqe?" Në shkojmë te shpirtrat, te ESP, te paraardhesit tanë të cilët kanë vdekur, te vëllezërit dhe motrat tona. Pse t'i mërzisim ata tani që kanë vdekur, le t'i leme ata të lirë. Ju i torturovat kur ata jetuan në këtë bote. Pse nuk i lini rehat? Lërimi të shkojnë dhe te rilindin. Por njerëzit nuk janë të kënaqur. Ata thonë "Jo, ne duhet të flasim me to". Njerëzit kapen dore per dore, thërrasin shpirtrat, etj.

Por a e dini se c'ndodh me ta? Pikë së pari nuk arrijne dot realizim. Shumë e vështirë për persona të tillë. Edhe nese ju arrini realizimin, perseri keni shumë probleme. Kam parë një rrez që kanë kaluar në marrëzi, sepse këto shpirtra janë gjëra të pista. Të supozojmë se ju më keni thirrur mua, unë jam Indiane, kështu që ju tani jeni lene ne Indi. Ju duhet ta dini që jeni lene ne Indi dhe që nuk keni asnjë kontroll mbi njerëzit që vijnë nga këto zona dhe ju jeni thjesht i pushtuar. Ata ju pushtojnë ju, familjen tuaj, çdo gjë, dhe është një fakt që këta njerëz te keqin që veprojnë ose që thërrasin ose që përpiqen të tregojnë se po ju ndihmojnë, janë njerëzit të cilët thjesht po marrin para nga ju. Por ata kanë për tu dënuar shume më keq se ju. Njerëzit të cilët janë medime, që janë parashikues, i kanë perdorur keto gjera.

Askush që ka një shpirt të realizuar nuk do hynte kurre tek trupi i askujt. Asnjë Mjeshtër nuk mund të hyjë te askush, sepse ata e dinë vlerën e lirisë. Ata nuk do ta bënin kurrë atë. Është një gjë shumë e keqe ndaj atyre që kanë vdekur dhe ndaj vetes tënde që po jeton. Ndersa liria është një gjë kaq e bukur e krijuar nga Zoti. Ju pushtoheni nga të gjitha gjërat e pakuptimta dhe magjitet e zeza dhe nuk e di se si ju njerëz të arsimuar jepeni pas ketyre gjerave. Mbase ngaqë jeni shumë naivë, do te thoja, ju jeni naivë. Sepse në Indi ne e dimë këtë, ne e dimë të gjithë këtë, ne i dimë të gjitha keto punet e materializimit, etj. I dimë shumë mirë.

Sigurisht, dua të them se jo të gjithë njerëzit e rinj e dinë këtë, sepse unë jam një njeri i vjetër, ne të gjithë i dinim këto gjera, ne e quajmë atë Branumati Vidya[2], Pret Smashan Vidya, Bhoot Vidya, ka shume libra rreth këtyre ceshtjeve, se çfarë janë këto gjëra. Ekzistojnë magji të zeza, voodoo, dhe të gjitha llojet e gjërave që ju i quani të tilla, por ju nuk keni asnjë njohuri rreth tyre. Për shembull, ne i vendosim të gjithë trupat e të vdekurve tane në kishë. Nuk e di kush na ka thene, ku është shkruajtur në Bibël, nuk e kuptoj. Pse duhet t'i vendosni trupat e të vdekurve tuaj në kishë. Në rregull, nëse dëshironi të keni një kishë për trupat e vdekur, lërimi vetem per kete pune. Ju jeni një rrez që jetoni, pse uleni mbi trupat e të vdekurve dhe keni të gjithë djajtë që vijnë tek ju të ulur sipër kokës tuaj?

Vetëm një shpirt i realizuar është nje person që duhet varrosur në kishë, vetëm një shpirt i realizuar. Në Indi, është një zakon që të gjithë njerëzit digjen përveç një shpirti të realizuar, sepse ata kurrë nuk përpiqen të pushtojnë dikë, ata kurrë nuk shqetësojne dikë, përkundrazi, ata na ndihmojne në shumë mënyra, ata nuk janë personat që do vijnë për të na shqetësuar apo të na inkurajojne. Ndonjëherë ju ndjeheni shumë të lumtur nga ky inkurajim sepse ju ndjeni që përgjegjësia juaj ka kaluar mbi dike tjetër, ata kanë marrë përgjegjësinë tuaj dhe ju ndjeheni shume te lehtësuar. Në fillim ju ndjeheni shume kendshem, është një ndjenjë e mirë. Ju mendoni "Oh, unë ndiej paqe", sepse dikush tjetër ka ardhur në shtëpinë tuaj dhe ai do te përdore shtëpinë tuaj dhe ju do liheni mënjane. Dhe më pas ju bëheni qesharake. Në disa persona ju do gjeni që ata i vendosin rrobat e tyre në gojë, dhe ata janë shumë të frikësuar dhe të trembur.

Sigurisht ata dridhen kur janë para meje, ndodhin plot gjera. Ekziston një prirje tjetër rreth kësaj, se nëse ju thoni se këta janë njerëz të pushtuar, etj, etj, pra ata te anes se majtë janë edhe më keq. Ata te anes se majtë janë ata që hyjne shume ne punet e shpirtit. Por ka dy lloje të punëve te shpirtit. Njëri mund t'ju japë mbivetedije, dhe tjetri mund t'ju japë nenvetedije, dhe nenvetedija është shume lehtë e disponueshme sepse të gjitha këta shpirtra janë trupa të zënë, dhe në fushën e nenvetedijes ata janë ngaterrestare dhe njerëz shumë të këqinj, dinake dhe të ndyre.

Për shembull një grua vdes e re pa u martuar. Ajo do te dëshironte të shqetësonte një grua të martuar. Ajo është xheloze. Dhe prandaj ekzistojnë disa rregulla dhe ligje në jetën tonë. Duhet të kuptoni se pse duhet ti shmangemi këtyre gjërave. Merrni një psikolog. Psikologët nuk e dinë se me çfarë po përballen. Ata trajtojnë njerëzit e cmendur. Ju kam treguar për Frojdit. Ai ishte gjysëm i pjekur sepse ai dinte vetëm rreth kësaj dëshire. Forca e dëshirës të cilën ai e quajti kushtëzimi dhe të gjitha këto. Por ai nuk e dinte se ishte dhe dicka tjetër, egoja jonë, kështu ai tha nxirreni të gjithë kushtëzimin tuaj, mos kini asnjë lloj kushtëzimi. Pra ku shkoni ju? Ju perfundoni tek ajo "Çfarë ka te keqe?", i orientuar drejt Egos. Më pas ju formoni nje tjetër kult duke thene që duhet të shkatërrojmë kultin tone. Ju filloni t'i thoni vetes "Nuk je i afte për asgjë, je i padobishëm", gjithë kohen vrisni egon tuaj, ju bëheni i mbyllur brenda vetes, këto dy gjëra ndodhin me ekstremet e levizjes se kesaj qendre. Nëpërmjet kësaj qendre ju



shkoni majtas ose djathtas.

Ajo çfarë është reale është qendra e këtij kreativiteti. Kreativiteti dhe njohuria e Hyjnore. Njohuria e hyjnore është kur ju arrini realizimin. Ju merrni vibrimet e fresketa të Shpirtit të Shenjtë. Duhet të dini se si të ngrini Kundalinin e të tjerëve dhe duhet të dini se si të korrigjoni veten tuaj. Ju duhet të dini se si te njihni te gjitha keto qendra dhe gjithashtu të gjeni pergjigje per të gjitha pyetjet që keni në mëndjen tuaj.

Kjo ka për t'ju ndodhur juve. Ky realizim do të ndodhë sepse është e drejta juaj ta keni. Tani ju jeni një qenie njerëzore dhe do t'ju duhet të bëheni një qenie mbinjerëzore. Une nuk po bëj asgjë për këtë, siç ju kam thënë, thjesht po ju arkëtoj llogarinë tuaj bankare. Por nëse llogaritë bankare janë shumë në të majtë ose në të djathtë, është e vështirë. Do t'ju duhet të jepni shumë shenja mirësie sepse aty ka shume llogari te zbuluara. Kështu duhet të kuptoni që është më mirë të jeni në qendër. Jo të shkoni tek këto gjëra. Pse, pse, për çfarë? Çfarë do të fitoni prej ketyre gjerave? A do te shkoni tek shpirti juaj? A do të bëheni vetvetja? Pse për një lojë të vogël këtu dhe një lojë të vogël atje?

Pse jeni duke shkuar tek këta njerëz të keqinj? Ata do t'ju cojnë në një ekstrem të tmerrshëm nga ku ndoshta nuk do jeni në gjëndje të ktheheni. Në Londër u habita, ishte një doktor të cilin e njihja dhe ai erdhi te me takonte e më tha "I kam humbur të gjitha punët, çdo gjë, sepse jam shumë në depresion dhe nuk mund të punoj. Nuk e di se çfarë më ndodh. Jam jashtëzakonisht i depresionuar. Kam humbur zellin për të punuar. Nuk ndjej asgjë, jam thjesht i mbaruar. Jam shumë i depresionuar. Dhe sa herë që përpiqem të punoj hyj përsëri në depresion. Jam shumë i lodhur." E pyeta nëse kishte shkuar ndonjëherë në ndonje tantrik apo dicka te ngjashme dhe ai tha "Kurrë. Por gjyshi im ishte tantric." Ai bente magji të zezë dhe tani nipi i tij po vuante për shkak të tij. Më pas ai u kurua.

Ne kemi një Australian këtu i cili ishte një doktor ne Rusi. Gjyshja e tij kishte një zakon që, kur ky kishte qene femije fare i vogel, e merrte me vete në varreza. Ai e kujton shumë mirë atë dhe pas ca kohësh u bë shumë i depresionuar, humbi punën, dua të them që ai nuk mund të punonte. Filloi të kishte dhimbje koke dhe të gjitha llojet e gjerave filluan t'i ndodhnin. Filloi të kishtë ngërce në duar. Kur ai erdhi tek unë u kurua por u desh ca kohë sepse të gjitha gjurmët e shpirtrave kishin ngelur nga fëmijëria e tij.

Kështu ju duhet të kuptoni se si ti mbani larg të vdekurit nga vetja juaj. Ju duhet të jeni në të tashmen dhe jo me të vdekurit. Ai që ka vdekur ka mbaruar. Keni parë ndonjëherë një majmun? Nëse fëmija i nje majmuni vdes, para se te vdese majmuni nena do të bërtasë dhe të bëjë gjithfare xhestesh qe shprehin shqetesimin e saj. Sapo femija vdes ajo largohet. Nuk e vret me mendjen. E njëjta gjë me qentë apo kafshet e tjera, nuk e vrasin mendjen me për të, e dine që ka ikur. Prandaj thuhet se nëse dikush vdes, mendoni për Zotin dhe këndon këngë dhe gjëra të tilla, mos u merrni aq shume me ate pune. Por ne i kemi harruar këto gjëra dhe mënyra me te cilen ne i trajtojmë gjërat e vdekura ndonjëherë eshte kaq e tepruar sa shpesh ne jetojmë vetem ne te shkuaren. Ne jetojmë ne të shkuarën dhe njerëz të tillë shohin fantazma dhe disa prej tyre që janë kështu, janë dridhur para meje. Të gjithë ata dridhen, ata nuk mund të qendrojnë drejt, gjithë kohës trupi i tyre dridhet, ata nuk kanë asnjë kontroll mbi trupin e tyre.

Pra duhet të kuptoni se këto gjëra janë shumë të rrezikshme për qëniet njerëzore. Ne jemi qenie njerëzore, nuk jemi trupa të vdekur. Por gjëja më e keqe është se ata që kënaqen me këto gjëra preken nga keto 56 proteinat per të cilat flasin doktorët. Por ato nuk janë asgjë përveçse shpirtra të vdekur. Ata thonë proteina sepse nuk kuptojnë. Këto janë shpirtra të vdekur, kanceri është i shkaktuar vetëm prej sulmit të shpirtrave të vdekur. Unë nuk kam hasur asnje rast te vetem nga ato qe kam trajtuar, dhe unë kam trajtuar shumë, i cili nuk ka pasur infektim te shpirtit. Në realizim, kur ju arrini realizimin tuaj ju kapeni ne këtë ose ne atë, keto jane dy Swadishthanat të cilat janë makuar.

Tani shpresoj ti keni vënë duart kështu (dhe ajo tregon menyren se si duhen mbajtur). Ju do ta arrini realizimin ndërkohë që unë flas. Kështu ju lutem gjithashtu vendosni këmbët drejt në tokë, pikërisht kështu. Tani unë po ju tregoj se kur ju i vini duart kështu, fillimisht filladi i fresket fillon dhe rrjedh brenda. Por kur ju arrini realizimin tuaj dhe ju i vendosni duar tek dikush tjetër për ta provuar atë, ju kundalini juaj pengohet ne kete pjese. Kjo tregon se ajo është nje pune e paautorizuar. Puna e paautorizuar e Hyjnise mund të jetë zona e nenveteditjes, mund të jetë mbiveteditje. Psikologët ose çdokush tjetër mund te kapet atje. Kur ju punoni me mendjen tuaj. Mendja juaj është superegoja. Atje, bluja është mendja dhe kur ju keni shkuar tek ndonje nga keta njerez ose keni te beni me ndonje magji të zezë vete ju, atëherë ju kapeni tek ky gisht (gishti i madh i majtë).

Është Swadishthana e majtë, siç ne e quajmë dhe kur ju kapeni në këtë qender duhet të thoni se besoni në punën e Hyjnisë - në punën e pastër të Hyjnisë dhe kjo është quajtur si Nirmala Vidya. Nirmala Vidya do të thotë dija e pastër dija e teknikës se si të ngrini kundalinin tuaj. Kur ju e thoni këtë, shpirtat largohen. Ka shumë njerëz që kanë ardhur tek unë të cilët kanë qenë të cmëndur, dhe ata kanë thënë "Si i kuroni ju njerëzit e cmëndur nëpërmjet Kundalinit?" Çfarë bëj unë për këtë? Asgjë, unë thjesht u zgjoj atyre Kundalinin. Më pas kur Kundalini zgjohet, kur Ajo shkon në këtë qender, ne qendren e dytë brenda nesh, atëherë ndodh ndricimi. Hyjnia e kreativitetit zgjohet dhe me dritën e saj kjo errësirë brenda jush thjesht zhduket. Thjesht largohet.

Epilepsia mund të shërohet. Nëse dikush është duke vuajtur nga Epilepsia ekziston një metodë shumë e lehtë për ta kuruar atë person. Jashtëzakonisht e lehtë. Kur ju të vini herën tjetër do ju tregoj se si kurohet një person me epilepsi. Është shumë e thjeshtë.

Sahaja Yoga është një metodë spontane e të jetuarit me ane te se ciles ju mund të kuroni njerëz me ane te zgjimit te Kundalinit të tyre. Une nuk jam këtu si një shëruese dhe të them "Më jepni dhjetë dollarë për shërim". Nuk është kjo, është thjesht se kur Kundalini zgjohet ju shëroheni. Ju bëheni të shëndetshëm sepse Kundalini kalon nëpërmjet kësaj qendre, e cila është pergjegjese për anën fizike. Nëse ana juaj fizike është në rregull atëherë edhe shëndeti juaj është në rregull. Por ka gjëra të tjera brenda jush. Ekziston edhe ana emocionale dhe gjithashtu është edhe ana mendore. Të gjitha këto gjëra duhet të ndricohen nëpërmjet zgjimit të kundalinit. Gjëja e parë që ju ndodh është se shëndeti juaj përmirësohet, pa dyshim. Të gjitha gjërat si paraliza, kanceri, diabeti (diabeti është i kurueshëm nga Sahaja Yoga). Duhet t'ju shpjegoj se si kurohet diabeti.

Diabeti shfaqet tek njerëzit që mendojnë shumë. Kështu që kjo qender duhet të punojë shumë dhe ajo nuk mund ti japë vëmendje të mjaftueshme pankreasit i cili është në anën e dorës së majtë. Për shkak të kësaj ana e majtë ngrin dhe ana e djathtë punon shumë. Tani si shërohet diabeti. E vetmja rrugë është nëse ju jeni një person i realizuar ju i jepni vibrime pankreasit dhe i jepni një balancim personit. Ka një mënyrë për ta balancuar atë. Nëse mund ta balancojnë këtë gjë njerëzit e mënjanojnë diabetin perfundimisht. Edhe artriti gjithashtu mund të kurohet, por tani duhet t'ju flas rreth shpretkës. Është një gjë shumë e rëndësishme brenda nesh dhe mendoj se çdokush prej nesh duhet ta kuptojë atë totalisht.

Ne nuk e dimë se sa e rëndësishme është shpretkë brenda nesh. Ajo është shpejtësimatësi. Ajo kujdeset për shpejtësinë që ne kemi. Ne jemi shume te shpejte. Mënyra se si ne po nxitojme ne keto kohe. Ne realisht jemi duke ekzagjeruar, ne flasim ne menyre te ekzagjeruar, ne ecim ne menyre te ekzagjeruar. Në jemi njerëz shumë shumë të shpejtë. Dhe nese kemi aktivitet kaq intensiv shpretkë cakordohet. Si çakordohet shpretkë? Është shumë e thjeshtë. Shpretkë ndodhet aty për të krijuar rruaza të reja gjaku, rruaza të kuqe për të goditur të gjitha emergjencat me te cilat perballeni! Për shembull: ju jeni duke ngrënë ushqim dhe kjo është një emergjencë. Juve ju duhen më shumë rruaza të kuqe gjaku. Kështu kjo shpretkë fillon të prodhojë këto rruaza të kuqe gjaku. Por tani keni lajmet e orës 9 dhe dëgjoni dicka të tmerrshme dhe kjo krijon një emergjencë tjetër. Më pas papritur ju hani ushqimin tuaj dhe vraponi. Kështu është krijuar emergjencia e tretë.

Shpretkë e shkretë çmendet absolutisht. Ajo nuk e di se kur duhet të prodhojë qeliza gjaku. Ajo nuk e di se c'duhet të bëjë me ju sepse papritur ju keni tre ose katër gjëra bashkë, po hani mëngjesin, duke futur një këmbë në marshin e makinës, po flisni me dikë. Dhe e gjithë kjo shkon njëherësh. E shkreta shpretkë nuk e di se nga të shkojë. Ajo çmendet. Dhe më pas vjen sulmi. Shfaqet kanceri në gjak. Kanceri në gjak është rezultati i kesaj shpejtësie i ketij nxitimi. Prandaj duhet të jeni të kujdesshëm që shpretkë juaj të jetë në rregull. Po ju paralajmëroj si një Nënë. Unë i di këto probleme. Ne e kemi shëruar kancerin në gjak por është një sëmundje e tmerrshme dhe sapo ajo shfaqet, brenda një jave thonë që merr fund. Ne kemi kuruar shumë raste të kancerit në gjak të cilët ishin të deklaruar për të vdekur pas tetë ditësh. E shikoni? Ata japin vetëm një diagnoze. Pas tetë ditësh ose pas një muaji nga kjo diagnoze që merrni në spital, ju vdisni.

Por me Sahaja Joga ne mund të përpiqemi ta shërojmë atë. Ata janë shëruar dhe kur kanë shkuar tek doktorët, doktorët kanë thënë "E di, shumë e jashtëzakonshme por nuk mund ta besojmë që ka ndodhur prej Sahaja Joges". Edhe kur nje doktor është shëruar ata perseri kanë thënë "Ky doktor qenka çmendur. Si ka mundesi te flase nga keto gjera?" Ata i kishin thënë këtij personi që do vdiste pas tetë ditësh dhe ai është ende i fortë edhe pas dy vjetësh. Ata do të thoshin se duhet të ketë dicka por nuk duan

ta pranojnë që ka ndodhur prej Sahaja Joges sepse kjo sfidon njohuritë e tyre. Por unë nuk jam këtu për t'u marre punen atyre. Ata mund të kenë shumë pacientë. Unë nuk jam këtu për të shëruar njerëz. Vetëm se kërkuesit që vijnë tek unë për realizim janë të bekuar nga mirësia e Hyjnisë dhe ata kanë një shëndet të mirë. Ata shërohen sepse ata janë kërkues. Ata janë njerëzit e Zotit, ata duhet të behen profetë. Dhe kur ata të bëhen profetë në këtë epokë, ata duhet t'i kthejnë të tjerët në të njëjtën mënyrë dhe kështu edhe ata do të bëhen profetë.

Është thënë nga William Blake para rreth njëqind vitesh. Ai i ka shpjeguar të gjitha këto gjëra në librin e tij Milton. Ju do të befasoneni. Ai ka shkuar në limitin e një profecie, ai ishte aq parashikues sa që kishte përshkruar se ku jetoja unë, në Surrey Hills. Feneri i parë do të ndizet në Surrey Hills, dhe gjithashtu ai ka thënë se ashrami yne do të jete në rrenoja, sepse ne nuk kishim para, kështu ata blenë një vend të rrënuar në rrënoja. Themelet do të hidhen në Lambeth Way dhe ja ku është. Ashrami jonë ka ardhur në Lambeth Way dhe këtu është... ky do të behet Jeruzalemi. Thjesht imagjinoni një person njëqind vite më parë që parashikonte të ardhmen. Ai ishte shume parashikues. Ai ka shkruajtur gjithcka rreth saj por qëniet njerëzore nuk janë të ndjeshme ndaj gjërave. Unë shkova për të parë ekspozitën e tij. Ai ishte një artist i madh. U habita që ata po shikonin se si ai kishte treguar gra të zhveshura në ferr. A shkua ju për ta parë këtë? Dua të them se është njësoj si të shkosh për të parë një shfaqje me lule dhe ju zgjidhni të gjitha ndyrësitat. Kjo është mënyra për të parë gjërat e bukura? Shikoni të bukurën dhe mendoni për të bukurën dhe më pas ju bëheni të bukur. Pse duhet të dëshironi këto gjëra të shëmtuara në jetë? Pse nuk duhet të dëshironi dicka kaq të bukur? Dhe ky është Shpirti juaj.

Kjo është qendra e dytë që ju kam treguar. Kjo është ajo që perkufizon, që perkufizon fenë tonë në kuptimin e ekzistences tone. Jo fene në mënyrën që kuptoni ju. Sepse të gjitha këto fe janë si lulet nën një pemë të vetme. Ato janë këputur nga njerëzit dhe ata thonë "Kjo është e imja. Kjo është e imja. Kjo është e imja!" Dhe ata i kanë shëmtuar këto lule dhe me pas ato janë kalbur.

E gjithë vëmendja duhet të jetë që te beheni Shpirti. Nëse nuk është kështu pjesa tjetër e saj nuk është punë e Zotit. Puna e Zotit është thjesht të zgjojë Kundalinin tuaj. Është punë e jetësore sepse nëse Ai është Zoti jetesor Ai duhet të bëjë punët jetësore. Puna e tij është të transformojë një lule të vogël në një frut, të cilën ju nuk mund ta bëni. Në të njëjtën mënyrë ju nuk mund ta bëni të pulsoje Kundalinin por ajo do të pulsoje kur ju të vini në Sahaja Yoga. Ju do ta shihni me sy të lire ngritjen e pulsit dhe mund të shikoni pagezimin tuaj duke ndodhur. Është e shkruar nga shumë njerëz, siç ka thënë Kalidasa. Ne kemi pasur një poet të madh Kalidasa i cili ka përshkruar Sahaja Yogën rreth tre ose katër qind vjet më parë.

Ne kemi pasur dhe Adi Shankaracharya[3] i cili ka folur shume qarte për gjithë këto gjëra që unë po ju tregoj juve, por kjo ka qenë një njohuri e kufizuar vetëm për disa persona. Edhe Krishna i ka folur dikujt, Arjunës. Krishti i ka folur disa turmave dhe ata e kryqëzuan Atë sepse ata nuk mundën ta kuptonin Atë, se çfarë Ai po thoshte. Pse duhej ta kryqëzonin? Ata nuk e njohën Atë. Moisiu, sa njerëz e njohën atë? Abrahami, sa njerëz e njohën atë? Ata nuk u njohën kurrë, nuk u kuptuan kurrë, ky ishte problemi, dhe këtë duhet të kuptoni ju. Koha tani ka ardhur të njohim, të kuptojmë. Njiheni veten se ju jeni Shpirti, jo ky trup, jo kjo mendje, jo kjo ego, asgjë, por ju jeni Shpirti. Dhe jo te ashtëquajturit Mjeshtër Guru. Ai që nuk ju jep juve realizimin shpirtëror nuk është një Mjeshtër Guru. Ju duhet ta kuptoni këtë. Ju duhet të kuptoni që kjo është detyra e një Guru.

Mjeshtri Fillestar i cili ju thote të jeni në qendër, i cili ju tregon të gjitha gjërat që duhen bërë në emër të fesë. Në emër të fesë çdokush ka thënë të njëjtën gjë. Tani unë nuk them asgjë të tillë sepse unë e di si ta kontrolloj situatën. Ne kishim një doktor në Londër i cili ishte një i alkolizuar dhe erdhi tek unë. Ai e arriti Realizimin e tij dhe ditën tjetër ai hoqi dorë. Ai Thjesht nuk donte ta kishtë atë. Ai tha "Tani unë po kenaqem. Nuk jam i mërëzitur dhe as që e kujtoj atë." Por ai shkoi në Gjermani dhe tha se pas dy ose tre muajsh po pëlqente një verë dhe dëshironte ta provonte se si ishte. Kështu ai e provoi verën. Kur ai e provoi atë ndjeu sikur do të villo.

Dhe unë nuk kam pse t'ju them juve mos vidhni, mos flisni më fjalë të pista, mos bëni këtë, asgjë. Ashtu si vajza ime ka një vajzë, unë kam një mbesë, e cila është një shpirt i realizuar. Dy fëmijë, dy mbesa janë shpirtë të realizuar dhe njëra prej tyre erdhi një ditë tek unë dhe tha, "Gjyshe, a e lexove këtë gjënë e shëmtuar të quajtur shkenca morale?" Unë thashë, "Jo, pse?" "Sa budallallek, ë?! Ata na thone të mos gënjejmë, të mos vjedhim, dua të them pse duhet të tregojmë gënjeshtër, pse ata duhet të na i thone këto gjëra. Nuk më pëlqen." Atehere motra e vogël tha "Këta janë njerëz budallenj, si mund të flasin kështu, pse duhet t'i bekemi ne keto?" Aty nuk ka joshje, nuk ka tundim. Ju nuk mund të tundoheni dot nese jeni të zgjuar. Dharma juaj është aty. Energjia juaj

jetesore eshte zgjuar.

Ne jemi qenie njerëzore. Nëse do na duhet të kalojmë nëpër një rrugë të qelbur do ta kishim shumë të vështirë. Ne i mbylhim hundët, ndjejmë aromën e ndyrësisë dhe papastërtisë dhe ndihemi keq. Por provoni të merrni një kalë, ai do të kalojë qetë fare, nuk bezdiset fare, nuk shqetësohet. Në të njëjtën mënyrë ndërgjegja juaj ndricohet. Më pas çfarëdo gjëje që është mëkat, ju nuk e pëlqeni. Ju thjesht nuk e pëlqeni. Çfarëdo që ju largon nga Shpirti ju nuk e pëlqeni sepse humbni dridhjet tuaja. Tani një qender tjetër është gjithashtu e rëndësishme. Është për mirëqënien tonë, quhet Çakra Nabhi. Rreth kësaj do t'ju tregoj herës tjetër sepse pothuajse ju kam treguar çdo gjë me detaje. Për më tepër do të dëshiroja të kisha pyetje nga ju sot, por si herën e fundit, mos bëni pyetje pa fund dhe te mos pyese vetëm një person. Një person duhet të bëjë vetëm një pyetje dhe një pyetje me kuptim sepse ju jeni kërkues, mos e humbisni kohën tuaj dhe kohën e të tjerëve. Në rregull?

Faleminderit shumë!

1\* Një nga dhjetë gurutë e lashtë (viti 469 para erës sonë). Filozof grek, i cili ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në fushat e etikës, logjikës, dhe epistemologji.

[2] Vidya- njohuri, dituri.

[3] (788-820) Shenjtor Indian, filozof dhe poet që shkroi "Saundarya Lahiri", cdo varg i te cilit është një mantra në nderim të Nenes.

## 1982-0704, Guru Puja, Establishing the Guru Principle

View [online](#).

Guru Puja, "Establishing the Guru Principle" Nightingale Lane Ashram, London (UK), July 4th, 1982

Ne kohen me hyjnore qe quhet si Krita Yuga, jemi mbledhur te gjithë ketu per te kuptuar menytrat dhe metodat e krijimit te Principit tone si Mjeshter.

Krita Yuga. "Krita Yuga" do te thote koha kur juve ju duhet te beni dicka " "krita: kur kjo eshte kryer." Keshtu ju jeni kanalet e ketij veprimi, te berit e punes se Zotit. Ju jeni kanalet e Zotit te Plotefuqishem dhe Fuqise se Tij. Nga nje ane duhet te mbani dinjitetin, lavdine, dhe supozimin qe ju jeni guru. Nga ana tjeter ju duhet te jeni plotesisht te dorezuar. Zotit tuaj te Plotefuqishem. I gjithë dinjiteti dhe autoriteti juaj vjen prej Tij. Dhe gjeja e trete eshte qe menyra qe Ai ka krijuar universin dhe ju, ne nje gjendje loje (drame), ju duhet ta shihni kete pjese. Pra nje lloj gjendje qe eshte plotgezim duhet vertet te gurgulloje nepermjet jush.

Deri tani idea e guru-se ishte qe nje person i tille kurre nuk qesh, kurre nuk buzeqesh, gjithmone gjaknxehet. Kjo ishte e drejte per gurute qe nuk kane kontakt me publikun, . por lidhin veten me nje litar diku ne Himalaja. Por ja ku jemi, duke perballur gjithë universin qe duhet te marre rrjedhat gurgulluese te dashurise suaj. Por kjo nuk do te thote qe ju duhet te jeni mendjelehte. sepse nuk mund te jeni. Loja hyjnore nuk eshte mendjelehte. eshte plotgezim, dhe gezimi nuk e ka ate dyzim. Prandaj per te patur krijimin e Principit tuaj te Guruse, fillimisht duhet te kuptojme si eshte shkaterruar. Sic eshte, cdo gje per te cilen nuk ka kujdesje ose mirembajtje shkatërrohet.

Nese nuk i beni kujdes, te themi ketyre luleve te bukura ketu, do te prishen. Edhe ceshtja qe nuk ndiqet mund te shkatërrohet. Prandaj para se gjithash, duhet te dijme qe duhet te jemi te vemendshem dhe vigjilente qe nese nuk mund te mirembajme veten tone, do te shkatërrohemi. Sepse mirembajtja s'eshte per hir te mirembajtjes, eshte per te ndalur shkatërrimin e Principit tuaj te Guruse. Kur jemi neglizhente apo dembele per te, ne jemi pergjegjes per shkatërrimin e Principit tone te Guruse. Keshtu qe vemendja qe kemi eshte per t'i dhene mirembajte ketij Principit te Guruse. Gurute kane aftesine te mirembajne veten e tyre dhe te mirembajne te tjeret. Ne fillim, kur gurute provuan te krijojne kete parim te mirembajtjes, vendosen ligje dhe rregulla shume shume te forte. Nese lexoni Biblen ne kapitullin Levi, do gjeni te pershkruar te gjithë sheriatet aty, qe ndiqen tani ne Riad ose ne shtetet Arabike. Per te mbajtur kete parim brenda jush, .

eshte shkruar ne gjuhe kaq te forte, si "Nje person i tille qe nuk e ben kete duhet te vritet per vdekje. Nje person i tille qe ben gabim te ketij lloji duhet te vritet me gure." Keshtu ishte ne fillim fare, pra njerezit . ne ate stad te zhvillimit kerkuan kete lloj frike. Por kjo s'do te thoshte qe ne asnje menyre te fyeje dhe lendoje, apo ti hiqje lirine nje qenieje njerezore. Por u tha per njerezit qe t'u jepnin nje ide te madhe rendesise . Principit te Guruse brenda vetes. Ne ate periudhe ata perdoren metodat frikesuese, Mund te them " kohe tmerresisht te rrezikshme. Dhe gjithashtu njerezit bindeshin ne ate kohe. Me pas nje tjeter stad i zhvillimit zuri vend ku nje etape nisi, njerezit menduan se duhet te jene te rrepte, dhe filluan te kene brenda vetes nje rreptesi te madhe.

Pra ishte e vete-projektuar; nuk ishte projektuar drejt te tjereve, por projektuar drejt vetes se tyre. Mund te themi qe vala e pare filloi kur Guruja, Guruja i Hershem tha qe nese nuk e beni kete, atehere ju do te vriteni. Etapa e dyte ishte kur dishepujt (nxenesit) e pranuan kete brenda vete, dhe filluan ti thone vetes qe nese nuk e bejme kete do te vrasim veten. Rreptesia filloi ne bazen e diturise, dhe jo te kokefortesise. Por me pas u be edhe me fanatike, keshtu kaloi ne ekstrem. Filloi me idene e mirembajtjes. Filloi me idene e mirembajtjes. Por vete mirembajtja u be e pamundur, a mbase ata menduan qe nuk po jane te afte ta mbajne, dhe u hutuan, dhe per ta ligjet dhe rregullat u bene me te rendesishme se mirembajta ne vetvete. Keshtu qe do shihni qe ata shkatërruan veten. Dituria ose thelbi i Guru Tattwa eshte ekuilibri.

. Sikur mban nje bime, nese nuk i hedh uje do te thahet. Nese i hedh shume uje do te kalbet. Pra dija qendron ne te kuptuarit sa uje duhet ti japesh bimes, keshtu ajo rritet me se miri. Tani dija duhet te arrihet nepermjet vetedijes suaj te vibruar. Ju ndodhni ne rrethanat me me fat, qe jeni shpirtra te realizuar para se Guru Tattwa e juaj te jete teresisht e stabilizuar. Ju keni gjithë fuqite qe nje guru mund te aspiroje, pa patur stabilizimin e Guru Tattwa. Vecanerisht ju jeni teresisht nen mbulesen e reve te dashurise

se Nenes suaj . Por ne asnje menyre dashuria e Nenes s'do ju lejoje te shkaterroni Principin tuaj te Guruse.

Sic ju thashe Principi i Guruse eshte nje gje shume delikate, . dhe shkatërrohet nese ju vete nuk perpiqeni ta mbani. Para se gjithash, shkatërimi fillon qe nga burimi thelle brenda qenies sone. Dua te them qe qenia juaj eshte krijuar nga pese elemente, . dhe te peste elementet kane nje aftesi te shkatërrohen gjithë kohes. Secili prej ketyre elementeve nese nuk merrneni me to . shkatërrohen. Kjo eshte aftesia ndertuese e elementeve . ose e lendes, si mund te thoni. Pra te mbani kete eshte e rendesishme.

Disa njerez kane idene se me tu bere guru . s'eshte nevoja te mbani asgje, mbahet vete nga vetja e vet. . Nuk eshte keshtu. Dakort qe shpirti padyshim rrit bukurine dhe shendetin e ketyre elementeve; por ne nivelin njerezor eshte gjithmone nje force me e madhe qe perpiqet ta shkatërroje. Pra ende ne duhet te behemi teresisht shpirti, ka gjithmone nje shans qe ky shkatërim te funksionojë. . Dikush mund te thojë, pse nevojitet ky ekuilibër? Dhe kjo eshte nje ceshtje e rendesishme per te cilen ne duhet te jemi te afte ti pergjigjemi gjithë njerezve qe na pyesin. Pa ekuilibër nuk mund te ngriheni.

Nese nuk mund te ngriheni, cila eshte dobia e te shnderruarit ne qenie njerezore? Per shembull, cdo gje eshte Zoti, por askush s'eshte i vetedijshem. Tek niveli njerezor ju beheni te vetedijshem: do te thote cdo gje ekziston, gjithcka eshte aty, por s'eshte ne dijeni. . Te themi, atje eshte nje gur, edhe ai eshte Zoti, por nuk ka akoma dijeni. Sic themi, kjo zone eshte plotesisht e erret dhe ne jemi te verber. Nuk ka cfare te shohesh, te ndjesh apo te provosh kur je ne te tilla kushte. Ne fakt dikush mendon se ertesira eshte e verteta, qe padija eshte e verteta. . Por kur dielli ngrihet lart dhe hyn drita dhe syte ju hapen, filloni te shihni gjithcka.

Ju filloni te beheni te vetedijshem. Pra ne nivelin njerezor ju jeni te vetedijshem tek pika me e larte. Tani kjo vetedije duhet te behet . vetedija e shpirtit. Kjo duhet t'ju ndodhe juve " ju keni ndjere shpirtin. Por ekuilibri nuk eshte akoma aty. Nena Juaj ju ka nxjerre dhe ju beri keshtu, . por ende brenda jush eshte nje disekuilibër. Nese shkoni pak te majte ju mund te shkatërroheni; shkoni ne te djathte, ju do te shkatërroheni. Prandaj duhet t'i provoni te dyja sic ju kam treguar metodat, te cilat do jua shpjegoj.

Para se gjithash ju duhet te jeni te rrepte me veten. Thjesht ndani veten nga vetja... Ndajeni veten si nje shpirt, dhe vereni egon dhe super egon tuaj. Tani filloni shikoni, filloni shikoni egon dhe superegon. Mos e mbani ato. " ato jane forca shkatërruese. Tani kur ju shihni lojen si deshmitare te ketyre forcave shkatërruese, do te dini si ta mbani edhe veten me mire. . Te ndani veten eshte me e lehte kur merrni masa shtrenguese. . Gjeja me e keqe qe elementet ju kane bere eshte qe ju keni formuar zakone, .

te gjithë llojet e varesive. Disa njerez jane te dhenes pas te larit (dushit), disa njerez nuk jane te dhene pas te larit. Disa njerez jane te dhene pas te ngriturit heret ne mengjes, ora kater, te kendojne dhe te zgjojne te gjithë, dhe disa jane gjumashe deri ne oren 10. Disa pelqejne veshje me ngjyra shume te lehta, disa pelqejne veshje me ngjyra shume te forta. Nese jeni Anglez, atehere deshiron te kesh cdo gje stil Anglez, ushqim tmerresisht pa shije! Nese je Francez, deshiron te kesh vere, pak. Nese je Italian deshiron te kesh karbohidrate, teper. Nese je Spanjoll, deshiron te kesh me shume yndyrna. Nese je Indian, deshiron te kesh shume djegesa (pikante). Pra qe te ndryshosh kete zakon, se pari duhet te shkoni ne ekstremet e asaj qe pelqeni.

Tani nese thoni qe "Me pelqen ushqimi i bute" ushqim i lehte " atehere duhet te thoni "Une duhet te ha shume pikantet." Nese thoni " Me pelqejne ngjyrat e zbehta," atehere vishni shume te ndezuara. . Fillojeni duke shkuar nga nje ekstrem ne ekstremin tjeter. Por kam pare njerez, qe kur shkojne nga nje ekstrem ata mbesin te mberthyer edhe ne anen tjeter. Prandaj duhet te jemi ne qender, jo ne ekstreme. . Njeriu qe eshte nje avadhuta, ai qe eshte mjeshter i madh, . asnjehere s'mund te varet nga varesite. Nuk mund te zoterohet nga idea qe " Me pelqen kjo."

Ai sheh bukuri ne gjelberimin e harlisur, dhe sheh bukurine tek pemet . qe nuk kane gjethe fare. . Tani prirja drejt kursimit apo masave shtrenguese ne menyre qesharake ka filluar ne Perendim. . Si nese kreh floket, atehere nuk je i mire; nese nuk bie ere trupi, atehere nuk je i mire; nese nuk dukesh si derr, atehere nuk je i mire; Gjithe lloj lloj idesh qesharake vertiten ne mendje, . sepse shkojne ne ekstremin tjeter. Por neve na duhet te mesojme nga natyra. Natyra vesh veten kur i duhet te pershendese pranveren, dhe kur eshte dimer ajo zhvishet komplet. Mund te them, .

sepse gjetheve u duhet te shkojne tek Nena Toke, dhe qe diellit i duhet te arrije Nenen Toke. Nuk eshte e ngjitur pas asgjeje. . Cuditerisht eshte shume me thelbesore se sa jemi ne; . ndersa ne qe jemi shpirtërore s'duhet te jemi te ngjitur (te varur) Por kjo

ide ishte gjithashtu nje ide mendore, qe ishte varesia me e madhe. Eshte nje varesi qesharake qe Mua me ben per te qeshur, kjo ishte shakaja me e madhe qe kam pare, qe njerezit behen te varur pas ideve mendore. Eshte si te besosh qe cfaredo qe te mendosh intelektualisht thjeshte do ju ndodhe. Te themi, nje personi mendor i duhet te shkoje ne piknik, menderisht do kete ne mendje qe do te marre . kete ate, ate e ate. Mund te kete hapur nje leter e ta shkruaje kete "Do te marr me vete kete dhe kete."

Dhe kur shkon ne piknik eshte i pashprese, sepse nuk ka marre asgje me vete, gjithcka eshte ne fleten e tij! Nene Juaj eshte e mire ne fjalime dhe Ajo ju flet juve, por kjo nuk duhet te jete varesi mendore. Si " Po, thote Nena keshtu," dhe cdokush diskuton me nje entuziasem te madh, kjo eshte ajo; por nuk eshte bere pjese perberese e qenies suaj. Por eshte nje varesi shume e zakonshme ne ditet tona, . me te gjitha njerezit qe dine gjithcka dhe nuk kane asgje. Kjo varesi mendore duhet sulmuar me te vertete. Te behesh eshte te shohesh, te behesh eshte te provosh; te shnderrohesh eshte duke pare, eshte duke perjetuar. Si psh une kam ardhur ne kete vend, Une duhet te vij dhe ta shoh. . Sikur te kem mendime dhe ide mendore rreth tij, imagjinate mendore, nuk eshte mire.

Une mund " s'eshte e imja, s'eshte e verteta. . Pra kur beheni te vetedijshem, ne fakt ajo qe ndodh, e shihni tek vetja. " pra le ta shohim. Dilni prej konceptit mendor qe tashme dini per te. . Ju nuk e dini, sepse ajo qe dini eshte thjesht mendore. Ajo duhet te jete pjese perberese e qenies suaj. Tani si ta bejme kete? Dikush mund te thote qe "Ne thjesht do te vazhdojme te jemi te rrepte me te."

Atehere perseri kjo do te behet nje tjetër mani. . Disa do thone, "Ne rregull, Nena ka thene ne duhet te gezojme, pra ne thjesht do te gezojme." Si te arrijme ekuilibrin eshte problemi i madh, por s'duhet te rrini me njerezit, qe kane vetedije vibruese. Ju mund te fiksoheni me kete. . Kam pare njerez qe flasin sikur jane te gjitha Sahaja Yogiste te medhenj dhe mgjse nuk kishte vibrime, dhe thonin qe po merrnin vibrime. Eshte kaq mashtruese. . Pra duhet te mendojme se duhet te rritemi me tej .

dhe te shohim gjithnje me shume, dhe te dijme rreth saj. Por nese pyesni nje Francez " Si jeni?" me pas nen ndikimin e saj, ata do thone keshtu: qe do te thote se jane gjithmone ne disekuiliber. . Pyesni nje Anglez, ai do te thote, "S'e di." Ose thone "E di" " nuk ka asgje ne mes Tani ne duhet te kuptojme qe ne jemi duke mbajtur driten ne duart tona, . dhe drita nuk duhet te dridhet. . Ne duhet ta mbajme driten fort, dhe duhet te kemi nje vemendje te perqendruar ndaj mbajtjes se drites. Dhe me pas ju ti thoni vetes qe duhet te shohesh, jo thjesht te kuptosh menderisht.

Ne fakt eshte te jesh i vetedijshem; sepse jeni teresisht ndryshe, jeni pjese perberese e gjithesise " ju jeni. Por e vetmja gje, qe ju nuk e keni pare akoma. E keni pranuar menderisht, . por nuk jeni bere akoma. Sepse projektimi mendor vjen nga mendimi; kjo do te thote se ju jeni ne nivelin e mendimit. Duhet te beheni pamendime. Por nese jeton ne bazen e mendimit atehere perseri i perket Cakres Agnya. Pra fillimisht duhet te ndalojme valen e mendimeve, dhe duhet te themi qe "Ne rregull, le te shohim si." Pra nga Cakra Nabhi ju ngjiteni te Cakra Agnya. Pastaj mbi te vjen problemi i trete shkaterrues, eshte emocional.

Emocionali eshte shume delikat. . Si disa njerez, Sahaja yogistet, do te ulen me nje kitare dhe do te fillojne te kendojne si te ishin zogj dashurie, kuptoni! C'eshte kjo? C'eshte kjo? Eja afer. Eja, eja... C'po ndodh? . Pse, pse qani? Ejani tek Une, ejani tek une.

Mire. Thjesht hiqeni. Ajo ka ngerce. Pra gjeja me delikate eshte ajo emocionalja. Ky njeri emocional eshte nje kolektiv i maskuar (kamufliar). Psh, kur takohen Sahaja Yogis, ata perqafohen mes tyre, puthin njeri-tjetrin, dhe jane shume te mire ndaj njeri tjetrit, kuptoni, dhe ulen e kendojne kenge si hipite. Merr kitaren ne dore dhe luan ne ritmin e dashurise. Ne drejtimin e kolektivitetit kjo eshte Vishuddhi, dhe sigurisht qe kjo eshte shume e veshtire per t'u cliruar, sepse ju jep nje ndjenje te madhe qetesia. Dhe njerezit hutohen nga emocionet, mendojne se eshte gezim. Gezimi mund te arkivohet nepermjet shkeputjes totale, shkeputjes qe eshte pa-ego dhe pa-superego.

. Por tani, problemi qe qeniet njerezore fillojne te perballin eshte supozimi qe ata jane guru. . Fillojne te flasin per Sahaja Yoga, . te flasin per Sahaja Yoga, dhe fillojne te mendojne qe ata jane bere tashme Shri Krishna. Ata madje kane edhe nje ego me te madhe se . personi qe eshte ne fakt i paditur rreth Sahaja Yoga. . Ata fillojne te flasin me nje ego kaq te madhe saqe une Vete frikesohem prej tyre: Sa dine rreth Sahaja Yoga, Mendoj une ndonjehere? Dhe fillojne ta pohojne ate aq shume sa behet e frikeshme.

E gjithë kjo mund edhe të thuhet, që atyre i duket se protokollin nuk është si duhet dhe duhet të jete një protokoll i pershtatshëm, pra në kujdesimi për protokollin, në jemi roje të protokollit, e gjithë këto gjera. Tani ata që janë në anën emocionale shohin egon e të tjerëve, ndërsa ata që janë në anën e egos shohin emocionet e të tjerëve. Pra njëri kritikon tjetrin, por ata nuk shohin veten e tyre që janë duke rënë në një kurth në një nga ekstremet. . Pra përveç dhe derisa të jeni të shkeputur, ju s'mund ta kuptoni. . S'do të them që bera, kështu një gabim, por ndodh që të jete gabim. Për tre vitet e para të Sahaja Yoga nuk foli kurrë për butësi (fantazma). Mendova se do ia dilja të menaxhoja. Por një grua që ishte e poseduar erdhi në Sahaja Yoga dhe i provoi gjithë hilet tantrike, ndaj mu desh të tregoja.

Tani çdo Sahaja Yogi është një pako fantazmash! Pyesni çdo Sahaja yoga, "Pse e bëtë këtë?" "Mund të jete një fantazmë." Nëse ju thonë që "Si ka mundësi që ke bërë një gjë të tillë?" atëherë ata do thonë që "Nuk e di, është fantazmë që e bëri." Kurrë s'jane aty " gjithë fantazmat janë aty. Tani unë s'e kuptoj si të merrem, edhe si Guri, sepse nëse nxenesit e Mij janë aty mund të tregoj, por nëse janë fantazma, çfarë tu them atyre? Mund të flas Sahaja Yogistëve por jo fantazmave, ato nuk do më degjojnë. Pra ky është shpëtimi më i madh që Sahaja Yogistët kanë gjetur tani, që është më e keqja, që s'ishte kurrë më parë. Kështu që ndonjëherë ndjej se ishte një gabim që unë paraqita këto fjale "fantazmë."

Ata e justifikojnë veten duke thënë, . "Nënë, ka negativitet." Nëse dhe derisa ka dicka tek ju që mban negativitet, si mund të ketë negativitet? Nëse jeni të shkeputur, si guret, atëherë s'mund të mbani këto ujë negativ në vetëvetë, në të. Nuk beheni me negativiteti, më shumë beheni një guru. Tani, kur ju them që nuk duhet të jeni negativ " të themi nën rrethana të tilla ju s'duhet të jeni një fantazmë, duhet të jeni vetëvetja " më pas fillojnë të ndihen fajtorë. Pra gjithë llojet hileve anti-guru do funksionojnë. Unë jam Guruja juaj, dhe është Anti-Guruja juaj, . të luash këto truke mbi veten. .

Tani që i luani këto truke me Mua, c'është dobia? Ju duhet të fitoni dicka, dhe po bëni hile kundër vetes, sikur po luani kundër Meje. . Duhet të jeni më të vetëdijshëm. Nuk duhet të shkaterroheni. Përveç kësaj ju duhet të shpetoni të tjerët. Si do ta bëni, në rast se ju nuk pranoni që është privilegji juaj, . që është fati juaj, që ju jeni zgjedhur të jeni medium (instrument) i punës së Zotit? Ndonjëherë ndjej gjithë fantazmat kanë ardhur tek unë. për realizim, dhe tani unë do të behem .

Vetë një fantazmë! "Fantazmë" do të thotë edhe "Bhootnath" është emri i Shri Shankara, Shri Shiva, sepse ai shkon pas fantazmave gjithë kohës. . Por ju duhet të jeni në të tashmen dhe jo në fantazmë " "fantazmë" do të thotë e shkuara. . Më pas c'duhet të dijme? Ju beheni. Atëherë ju beheni e tashmja, thjesht filloni të beheni, zhvilloheni, lulezoheni. Përpikuni të jeni në të tashmen. Mos i ikni të tashmës, përballuni me të.

Mos u ndjeni fajtorë dhe mos fajtoni fantazmen; të dyja do ju çojnë juve larg se tashmës. Tani thjesht shihni gjithë natyrën, gjithë Fuqinë hyjnore, dëshirën e zjarrtë të moshës " çdo gjë është në anën tuaj. Ka ardhur koha. Thjesht jeni aty. C'duhet të bëni? Thjesht rrini në qendër, . të boshtëve. Përpikuni të mbani veten në boshtë, dhe nëse shihni levizje periferike, mos e vrisni mendjen, . Kur shihni që në një farë mënyre nuk po silleni mirë, . denojeni veten.

Më mirë të denoni veten se sa Hyjnorja t"ju denojë juve, sepse është një denim i ashpër. Por mos u ndjeni fajtorë sepse nuk keni bërë asnjë gabim, është fantazmë që e ka bërë! Pra vijmë në një pikë që duhet të kuptojmë që jemi guru dhe jo fantazmë. Duhet të ndryshojmë edhe anën tonë të jashtme, që të behemi guru të mirë. Për shembull, duhet të mesojmë manierat e mira. Më pas këto manira behen natyra juaj. . Ndonjëherë, njerezit që janë të dhënë pas ushqimit të mirë, u them gjithmone që duhet të agjerojnë. . Pas çfarëdo gjëje që jeni të dhënë, përpikuni të hiqni dorë.

Përpikuni të kapërcëni semundjen tuaj të varesisë (ngjitjes), zakonet tuaja. Kur Guru Tattwa e juaj është krijuar, ju do të pranoheni si guru. Më pas nuk do të keni nevojë të thonë që jeni një guru, njerezit do ta dijnë që jeni. Nuk duhet të shkruani në ballin tuaj . që jeni guru, njerezit do ta kuptojnë ky është një guru që ecen; shihni që hyjnorja po ecen, mund të shihni që dinjiteti po ecen, lavdia ngrihet. Duhet të ndryshoni nga brenda, dhe drita e atij ndricimi të brendshëm do shfaqet jashtë. Por nuk duhet të jete një ide mentale apo emocionale, por duhet të jete ndodhia, . shndërrimi, vetëdija. Duhet të provojmë, mbi veten nepermjet eksperimentimit tonë. Edhe unë e bëj këtë.



Kur s'mund t'ju arrij nga nje fund sepse jeni nje fantazme, ju arrij nga tjetri. Nese dikur thote qe eshte nje fantazme, atehere shoh qe ai vuan pak dhe perballon, fantazmen brenda tij. Per shembull, I them dikujt qe "Te lutem bej kete" dhe ai e harron komplet, dhe thote qe e ka bere fantazma. . Me vone ai humbet kuletën dhe pastaj thote, . "Fantazma duhet te ma kete marre kuletën!" Por une eksperimentoj me Vetën. Fillimisht shoh si mund t'ju afrohem. Nese nuk funksionon provoj dicka tjeter brenda Vetes, sepse kjo eshte nje kohe shume e nderlikuar ne te cilen jemi. Nese do kishim ndjekur sheriatin ne kapitullin e Levit, nuk do ishin ketu gjithë fantazmat.

Mbase nuk do kishte mbetur asnje Sahaja yogis Dhe ky projektim mental eshte nje gje kaq e pergjithshme sa eshte e veshtire ti shkeputesh njerezit, . por e vetmja rruge qe te luaj hile me ju eshte eksperimentimi i Vetes tek ju. Ne te njejten menyre duhet te luani me veten, . dhe perpiquni te vini veten tuaj ne nje kuti eksperimentale. Sot eshte dita e Guru Puja, e dites qe duhet adhuroni Gurune tuaj. Jeni vertet me fat qe keni nje Guru qe eshte Nene. Dhe Nena Ime dhe guruja eshte Nena Toke, qe Me meson si te merrem me qeniet njerezore. Dhe ajo eshte ajo qe edhe ne cdo faze te veshtiresive Me ndihmon te korrigoj Menyrat e mia te nirmala vidya. Ajo ka qene nje mama kaq e dashur dhe nje guru i mire per mua. Dhe ajo eshte nje personalitet kaq qetesues.

Kjo, i gjithë ky gjelberim, edhe pse sic thone i eshte dhene asaj nga dielli, eshte thjesht per te na qetesuar ne te gjithëve. Ajo vesh gjelberim mbi vete, dhe jeshilja eshte Pricipi i Guruse. Eshte personalitet i shkeputur. Ajo eshte magnetizmi, ajo terheq. Kur njerezit ecin mbi te, ajo kujdeset per ta. Ajo krijon prej swayambus-it te saj, veten " cfare duhet te themi per swayambhu? " ah, po, guri i vete-shfaqur. Shikoni, terheqja dhe shqetesimi i saj eshte aq i madh sa pa te ne do te ishim te varur ne ajer. Dhe ajo Me mban mua si mburoje bronzi, thone " ndaj realitetit. Nese do te doja mund te isha thjesht Shpirti, dhe mos t'ia dija per asnje tjeter.

Menyra si ajo duron mekatet tona, menyra si ajo gjithmone kujdeset per ne dhe na ushqen, pavaresisht difekteve tona te shumta: ne te njejten menyre duhet te veproje nje guru . Ajo eshte jashtezakonisht falese; por shperthen si nje termet, dhe ndonjehere kalcium i nxehte dhe potasium i nxehte del prej saj. Ajo prodhon sqfure per ju, per sherimin tuaj. Nese dheu i Anglise vibrohet . atehere ky dhe mund te perdoret per mjekesi. Ne Indi njerezit perdorin balten per mjekesi, per cdo lloj trajtimi. Te kuptuarit e Guru Tattwa njeriu mund ta kete nga Nena Toke, pra le te prekim Nenen Toke dhe ti perulemi asaj. Zoti ju bekoftë. Ajo eshte delikate! Ne Kundalini Shastra, Nena Toke eshte Kundalini.

Mooladhara eshte, eshte Nena Toke. Pra Kundalini eshte gjeja me e rendesishme per ne. Nuk duhet te shqetesohemi per cfare kane folur ata ne Levi, qe ju s'duhet te vidhni, s'duhet te genjeni; ajo qe duhet te shqetesohemi eshte te mbajme kundalinin lart. Pra guru duhet te behet nje person qe eshte absolutisht praktik. Ai duhet absolutisht te kete sens te perbashket dhe praktik, nuk mund te jete nje person jo praktik. Nje person qe s'eshte praktik nuk eshte guru. Por praktikiteti ne menyre te pergjithshme eshte kuptuar si nje njeri qe eshte dinak, qe di si te devijojë nga rruga e drejte e gjithë keto " kjo eshte gjeja me jopraktike per tu bere. Dicka absurde, dicka nga hici, s'eshte rruga ne te cilen guruja duhet te ece. Duhet te kete nje sens te perbashket qe te drejtoje nje guru te si te merret me nje person, dhe sensi i perbashket eshte nje gje e cila s'eshte dinake pa dyshim. Burimi i sensit te perbashket eshte shpirti.

Shprehja e nje guruje eshte shume, shume paradoksale " paradoksale. Per shembull, nje guru do jete ekstremisht praktik, supozojme ai duhet te ndertoje shtepine e vet, ose nje shtepi apo ashram or cdo gje " do jete ekstremisht praktik, Do jete shume ekonomik, ai do krijojë dicka nga hici; njerezit do habiten si e ka bere kete ne menyre kaq praktike. Por ai do jete kaq i shkeputur sa nese ky ashram do i dhurohej dikujt, do e dhuroje ne nje sekonde. Per te pervetesuar " themi per shembull, per te pervetesuar nje llambe, guruja do jete shume praktik, do gjeje me te miren dhe me te liren dhe me te bukuren. Dhe ai do jete shume intensiv me te. Por kur vjen puna tek dhenia (dhuruarit), do jete edhe me intensive; qe kur ta jape, do e jape me te njejtin intensitet. Ai do te gjeje gjithë menyrat praktike si ta dhuroje, apo edhe te heqe dore. Pra pervetesimi i tij ne fakt eshte te jape. Ai perveteson qe te jape, prandaj ai eshte me praktiku. Ju e dini qe ne s'mund te marrim asgje me vete.

Vetem guruja mund te marre dicka me vete, askush tjeter. Vetem guruja ka gjithë dishepujt dhe dishepujt, dishepujt dhe dishepujt per vite, te cilet kendojne lavde. Nuk ka marrdhenie tjeter te perjetshme. Vazhdon te reflektojë per vite e vite te tera. Eshte nje vale qe bie e pastaj zhduket; ne gjithçka qe beni cdo vale eshte zhdukur, por jo vala e dijes nga nje guru, Madje eshte

edhe me e madhe se Principi Hyjnor, sepse shpjegon. Principi Hyjnor s'mund te shpjegoje, . " eshte guruja qe shpjegon. Jo se manifestohet, por shpjegohet dhe funksionon, pra ai eshte mjeshter I Fuqise Hyjnore. Keshtu ne nje fare menyre Fuqia Hyjnore ka kuptimin e guruse. Ashtu si fjala ka kuptim, dhe fjala " Me fal, fjala ka kuptim, dhe fjala i sherben kuptimit.

Por ne Principin e Guruse, Hyjnorja i sherben guruse. Gjithcka eshte ne sherbimin tuaj. Gjithcka eshte ne sherbimin tuaj. Kur jeni nje guru, gjithë cakat tuaja jane ne sherbimin tuaj. I gjithë universi eshte ne sherbimin tuaj, sepse ju jeni guruja. Eshte si rregjisori i shfaqes, " njeriu i skenes, zoteria qe merret me detyren e ndricimit, zoteria qe merret me detyren e altoparlanteve, gjithkush duhet ti sherbeje rregjizorit, sepse ai por stervit aktoret. Por Principi Guruse duhet te jete kaq i pakundershtueshem. Duhet te jete e nje aftesie te tille saqe askush mos ta kundershtojte, duhet te jete nje personalitet me kaq aftesi saqe askush te mos i jete i zoti te kundershtojte gurune. Vetem kjo do te funksionojte me pas. Keshtu qe ju duhet te punoni ne nje menyre te tille qe te jeni absolutisht te pakundershtueshem (pasfidueshem).

Dhe jeni vecanerisht me fat qe mund te shihni veten dhe te korrigjoni veten, gje qe askush s'mund ta bente me pare " ju jeni guru i vetes. Kjo situatë nuk ka ndodhur kurre, kurre. Ju jeni guru i vetes " dhe Me lini te jem Nena juaj. Qe do jete me e mira per Mua. Pra sot eshte dita qe njeriu duhet te percaktojte pike se pari,sa larg jeni guru. Duhet te merrni nje zotim qe ju do te krijoni Principin tuaj te Guruse, pika e dyte. Se treti, duhet te zotoheni qe do te krijoni Principin e Guruse tek te tjeret. Se katerti, duhet te dini qe atje ka nje pengese te vogel, qe Guruja juaj eshte nje Nene. Ajo eshte shume e mire per te qene guru, shume e bute per te qene guru, dhe ekstremisht tolerante. Pra eshte me mire qe te jeni strikt me veten tuaj, dhe te kujdeseni per veten.

Zoti ju bekoftë. Pra ju beheni guru i vetes. Ne cdo dite te Guruse une kam nje problem, dhe nje nga problemet eshte " mund te perkthesh,Gregoire, edhe pak, nese s'e ke problem " Ne cdo dite te Guru PUja mendoj se duhet te behem teresisht nje Guru, dhe te pakten ne nje dite une mund te mos jem nje Nene. Por sa here qe i provoj keto hile Me kthehet kunder! Vitin e shkuar ne Indi u tregova atyre "Kete here do te jem thjesht Guru, dhe ju duhet te Me jepni nje shall dhe nuk do te marr asnje sari, e asgje si Nene." Dhe isha shume e ashper me ta, dhe u thashe, "Ne asnje menyre nuk do te marr ndonje sari, cfaredo qe te beni." Ata ishin shume te palumtur sepse kishin blere per Mua nje sari, dhe thane, "Ne kemi qepur edhe nje bluze dhe nje zhupon, dhe Nene, ju duhet ti pranoni. Ju jeni edhe Nena jone." Une u thashe, "Do te jem shume e ashper si nje guru, dhe hiqni dore, sot asgje nuk do te Me binde." Sepse nese prape behesh Nene, atehere gjithesia behet perseri ajo pune e bute!

[Yogi: Nene, nuk mund ta perkthej kete!] Me mire t'ua thuash! Pra shkova te hap, nje rubinet " sepse ne Indi nuk u besojme pellgjeve lares, kuptoni " per te lare duart. Dhe sic jane rubinetet Indiane, . u hap fort edhe une u laga komplet. Une dola e u thashe, "Ju lutem, Me jepni te vesh sarin!" Sot kam vendosur te jem nje guru i vertete, dhe shume i ashper. Me pas vjen Warren e me thote qe "Nene, dikush ka blere nje sari, e kjo eshte keshtu e ashtu." Ai dha shume argumente. Dhe Rustom me Warren po provonin, e dini te Me ulnin ne vendin Tim.

Por me pas perdoren argumentin me te bukur per te Ma kaluar (zgjuarsi) . Fillimisht thane, " Sari eshte i bukur," kjo, ajo " Isha ne rregull. Por me pas thane, "Vibrimet jane gjithshu te mira. Kishte vibrime edhe para se te hapnin sarin." Pra gjithë perpjekjet e mira deshtuan! Kjo eshte loja e butesise (embelsise) se Hyjnores, ajo qe quhet madhurya. "Madhurya" do te thote embelsia, butesia Dhe kjo eshte ajo qe eshte si kukafshehti i gezimit te jetes, dhe ajo qe une e kam pranuar. Pra ne fillim do te kemi Pujan e Nenes. Shri Ganeshia Puja. Sot fillimisht eshte Shri Ganeshia dhe me pas Gauri Puja; per shkak te Guru Puja ne do te kemi Gauri Puja.

[Yogistet: Te gjithë ata qe s'kane lare ndonjehere kembet e Shri Mataji dhe do te pelqenin ta benin, te kene kete privilegj te madhe, duhet te vijne perpara te bejne puja.] Me mire t'iu pelqejte! Mos e ler ne dore te tyre, me mire ta pelqejte! Nese e le ne lirine e tyre" Dikush te Me thote emrat e tyre, kuptoni; Do me pelqente te dija emrat e tyre, do jete mire, te dija emrat e te gjithë atyre qe po me lajne kembet. Nese jeni ne ate ane, do jete me mire keshtu"

## 1983-0131, Nabhi Chakra, Delhi 1983

View [online](#).

Nabhi Cakra, Delhi (India) 31 Janar 1983

Muzika ishte shumë e bukur dhe ngritëse për të gjithë ju. Ndikimi i muzikës në Sahaja Yoga është i pamasë, dhe nëse një Sahaja Yogi këndon këngë është kaq e fuqishme sa vëpron si një matra në qënien Time. Kështu që i jam shumë mirënjohëse Znj. Venogopalan për këndimin e një kënge kaq të bukur sot. Ajo më trazoi tërësisht. Më pas Gavin Brown ishte shumë i ëmbël. Ai është një anglez shumë i sjellshëm dhe një Sahaja Yogi mjaft i qëndrueshëm. Është një ndër të parët Sahaja Yogis perëndimorë që kam takuar.

Sot do ju tregoj rreth Cakrës Nabhi që merret me ndershmërinë e të kërkuarit. Cakra Nabhi është qendra që kontrollon apo që shfaqet jashtë si Pleksusi Diellor[1]. Cakra Nabhi ka dy anë: njëra në të majtë, tjetra në të djathtë, dhe sigurisht një në qendër. Kështu në krahun e majtë është Gruha Lakshmi, në të djathtë është Raja Lakshmi ose Gaja Lakshmi dhe në qendër është Lakshmi që ngrihet në Mahalakshmi.

Kur fillon kërkimi, një qenie njerëzore së pari fillon të kërkojë ushqim. Ushqimi është shumë i rëndësishëm për gjithë kafshët. Nëse nuk kanë ushqim nuk jetojnë dot. Pra kërkimi fillon me ushqim, dhe pasi është caktuar streha, ata përpiqen të gjejnë ujë.

Pra kjo qendër përbëhet nga uji dhe në këtë qendër ndodhet Hyjnia e Shri Vishnu[2] ose Narayana; dhe fuqia e Tij siç ju kam thënë është Lakshmi dhe më pas Mahalakshmi. Do kuptoni në Sahaja Yoga që gradualisht ju filloni të zhvilloni një fuqi e pastaj një tjetër.

Çdokush që vjen në Sahaja Yoga, nëse janë plotbesim dhe të papërfshirë në ndonjë gjë të gabuar, atëherë pa dyshim ndihmohen nga Lakshmi Tattwa[3], që do të thotë se kujdeset për mirëqënien e tyre. Ashtu si ka thënë Krishna, "yogakshema vahaamyā." Pra Ai kujdeset për pjesën Kshema të tij. Çdokush që ka qenë në Sahaja Yoga është ndihmuar mrekullisht edhe nga Lakshmi Tattwa, që do të thotë materialisht. Ata ndihmohen në kaq mënyra, sa që dikush duhet Thjesht të shohë për veten e tij si ndodhin këto mrekullira.

Shembull është një fshatar që kishte në pronësi një tokë të vogël dhe nxirrte me të veç kafshatën e gojës. Kur erdhi tek Unë, pas ca kohësh vura re që sillte një kurorë, një kurorë të madhe për Mua çdo mbrëmje dhe ndiqte çdo ditë programim tim duke qenë larg në fshat. Isha mjaft e cuditur si mund ta përballonte këtë, dhe e pyeta: "Si mund të më sjellësh një kurorë çdo ditë? Nuk duhet të ma sjellësh, nuk duhet."

Por ai tha: "Nënë, Ti di gjithcka." I them: "Pse, c'ka ndodhur?" Ai thotë: "Unë kam një ngastër tokë pranë times që nuk e përdorim asnjëherë sepse është tërësisht djerrë - pak a shumë jo tokë e madhe por një pjesë e vogël tokë. Pas Vetërealizimit gjithmonë shëtitja këmbëzbathur mbi të duke e pluguar këtë copë të vogël toke. Pas disa kohësh kur vija këtu, një burrë vjen ta shohë dhe thotë: "Kjo copë tokë që ke është shumë ë vlëfshme."

I them: "Si është puna?" Thotë që: "Kam një furrë pjekje për tulla, dhe kam vënë re rastësisht -Sahaja- nëse përziejmë pak baltë nga ky dhe, nga kjo ngastër tokë që ke, pamë që tullat e tua u bënë kaq të mira dhe të forta sa që do donim të blenim këtë baltë me cmimin e tregut." Në këtë mënyrë ai filloi të kishte para mjaftueshëm për vete dhe u përmirësua edhe më pas.

Por duhet të kujtoni që në Sahaja Yoga s' duhet të shkoni në ekstreme, në çdo parim. Kjo është gjëja që duhet të dini, mos shkoni në ekstreme. Nuk do të bëheni shumë të pasur. Kam parë njerëz shumë të pasur që kur vijnë në Sahaja Yoga kthehen në dhimbje koke, oh bëhen vërtet një dhimbje e madhe koke. Nëse janë të sëmurë, nëse i kuron problemet e zembrës atëherë përpiqen të zotërojnë ty. Menjëherë fillojnë të flasin rreth kurave të tyre me gjithkënd, e publikojnë në gazeta, kjo e ajo, është e pamundur. Dhe Thjesht përpiqen të mbizotërojnë ty. Pa asnjë kërkesë për takim ata mbërrijnë dhe presin që ti takosh ata menjëherë, është e tmerrshme. Dhe më pas të dërgojnë gjithë të afërmit për kurim dhe të duhet të jesh i durueshëm, gjithë miqtë pra bëhen si

agjentë. Gjithë pacientët, gjithë të afërmit, gjithë miqtë duan ti detyrojnë dhe s'kanë as dashuri, as ngrohtësi asgjë tjetër.

Sahaja Yogis nëse provojnë të thonë që: "JO, nuk duhet të veprosh kështu apo ashtu" ndihen të fyer. Dhe të gjithë përpiqen të kurojnë shumë më shpejt se kushdo tjetër. Ata vetë janë të dobët, edhe vetë janë njerëz të sëmurë, pacientë me zemër, ky apo ai pacient, por nëse ti i thua: "Mos shëro(kuro)" do të ndihën keq, nëse nuk i thua që ata mund të sëmuren vetë dhe do të kenë një tjetër problem. Asnjëherë nuk provojnë ta kuptojnë Sahaja Yogën në mënyrën e saj të plotë (të madhe). Thjesht duan ta shohin në përputhje me egon e tyre që e kanë akumuluar me paratë e tyre, dhe nuk e dinë asnjëherë si i lëndojnë të tjerët duke më mbizotëruar Mua gjithë kohës.

Është e cuditshme, sa herë që kuroj një njëri të pasur, kam dashur gjithmonë t'ia mbath nga ky person. Nuk do shkoja kurrë në shtëpitë e tyre, nuk do doja të haja në shtëpi. Është një gjë shumë e keqe. Prandaj shumë pasuri nuk është mirë sepse të jep një ego të pamasë që nuk ju lë të shihni veten, dhe çdokush që provon t'ju thotë të mbron veten do të ndihet i fyer ose i poshtëruar. Jo vetëm kjo por ata përpiqen të më mbajnë Mua dhe të mbajnë gjithë këtë sipas mënyrave të tyre të biznesit, që është e pamundur.

Më kuptoni, ata duhet të fitojnë para, kanë një tjetër qëndrim (sjellje) sepse janë të mjerë. Mua nuk më duhet të fitoj para apo ndonjë gjë. Nëse jam duke bërë çdo gjë, e bëj vërtet në një mënyrë. Jam e obliguar, apo jo? Por ata do ushtrojnë mbi Mua ligjet dhe rregullat e tyre, pa marrë parasysht disiplinimin e vet.

Duhet të them se deri tani njerëz kaq të pasur kanë qenë vërtetë problematikë në Sahaja Yoga për Mua dhe për gjithë organizatën. Janë shumë mëndjengushtë. Nuk mund të shohin vizionin e madh që është para Meje.

Çfarëdo idesh të vogla që kanë për veten dhe mënyrën e tyre të të menduarit, lexuarit, do të përpiqen të shtyjnë në Sahaja Yoga. Nuk është përvoja ime, por ndodh shpesh. Më pas disi apo tërësisht ndodh që e braktisin.

Pra shumë pasuri ju jep ego të pamasë, do thosha shumë më tepër se një bulldog. Për një njeri të pasur është e pamundur të shohë që gjithë këto vlera (pasuri) janë jashtë tij. Nuk janë brenda tij. Ai duhet të jetë i pasur në zemër që të kuptojë dhembshurinë. Dhembshuri nuk do të thotë që ti japësh tjetrit lëmoshë, apo ti japësh para, nuk është kjo. Përkundrazi, ti Thjesht lyp duk e bërë këtë. Dhembshuria është ajo punë, dhembshuria është ajo rrjedhë, është ajo shfaqje. Nuk është dhembshuria aty ku ti e matërializon atë, "Shumë mirë, hajde këtu do të jap nja njëqind rupi". Përkundrazi, ti japësh dikujt 100 rupi është gjëja më e keqe. E kam provuar këtë me disa Sahaja Yogis që ishin me Mua. U dhashë disa para njëherë meqë ishin shumë të varfër. U bënë të frikshëm. Disa prej tyre filluan të pinin, disa të tjerë gjetën mënyra të ndryshme e u shndërruan të varur ndaj parave. Ishte e pamundur. Dhe u përpoqën të prishin sa më shumë Sahaja Yogis që të mundnin.

Pra nëse vijnë njerëz të tillë është e pamundur ti menaxhosh. Ata nuk janë Sahaja Yogis sepse janë Asahaja[4]. Janë akoma të lidhur pas idesë që kanë kaq shumë para, që janë kaq të pasur dhe dhe që mund të mbizotërojnë me para. Jo Mua, më falni. Por e vetmja gjë që më vjen keq për ta është që nuk mund të shkojnë tek Zoti. Nuk mund të kërkosh ndershmëri tek ta, nuk mund të gjesh ndershmëri. Elitës së njerëzve të cilëve u kam adresuar kaq shumë vende si këto, sepse disa njerëz të cilët i kam kuruar donin nga Unë që të adresoja të ashtuquajturën elitë. Mendoj se janë të ngazëllyer ndaj meje për atë që janë. Ata s'duan të jenë në Sahaja Yoga. Ndonjëherë ndjej se tashmë ata janë eliminuar. Kam humbur kohën Time me mijëra prej tyre që kam adresuar. Nuk janë për asgjë, tërësisht njerëz bosh. Janë shumë të lumtur sepse kanë ca makina, ca shtëpi ose gjëra të tilla. Edhe unë i kam këto gjëra, nëse do quhesha e pasur. Por këtë e kam parë me syrin e Babait Tim dhe të Burrit Tim. Nuk e kuptoj c'të bën të ndihesh krenar për këtë boshllëk. Por qëniet njerëzore janë si një enë, ena bosh jep një tingull të fortë, në të njëjtën mënyrë një njeri i pasur por bosh bën një zhurmë të madhe.

Jo se shumë të varfërit janë patjetër të mirë, sepse ata që janë jashtëzakonisht të varfër janë të zënë me problemet e tyre të ushqimit. Kanë probleme të vogla të vogla dhe vlerat e tyre duhet akoma të vijnë në një pikë. Është vetëm mesatarja që mund të punojë më mirë në Sahaja Yoga. Ata që janë jashtëzakonisht të pasur dhe krenarë nuk mund të vijnë në Sahaja Yoga. Dhe ata që janë shumë të varfër nuk mund të vijnë në Sahaja Yoga.

Por kur kjo pjesë e mesit të lumit pasurohet dhe fillon të rrjedhë, atëherë shpërndahet në anët dhe mund t'i gllabërojë ato. Por nuk mund ta filloni këtë nga anët rrethëqark. E kam provuar. I kam provuar të dyja rrugët dhe ju thashë si shkoi. Atyre që u dhashë para, atyre që u përpoqa ti ndihmoja nëpërmjet parave u kthyen në tersllëk, të padobishëm, njerëz jo seriozë, humbën në Sahaja Yoga. Dhe ata për të cilët mendova se kanë para dhe janë njerëz të kënaqur patën një tjetër rol, të më zotëronin Mua gjithë kohës, të më përdornin Mua gjithë kohës sa herë të donin, për çfarëdo qëllimi që kishin të Më shfrytëzonin.

Dhe ata duhet ta dinë që nuk mund të më zotërojnë Mua, nuk mund të më zotërosh Mua, por ajo injorancë që është ende në mëndjet e tyre është që ata mund të zotërojnë Zotin, mund të zotërojnë gjithcka. Për njerëz të tillë nuk ka kuptim të vijmë në Sahaja Yoga për të qenë të sinqertë. Dhe edhe nëse vijmë në Sahaja Yoga duhet të njohin të dinë që për pasurin e zemrës së Nënës mirëkuptimi i Sahaja Yogës, përujta, moszotërimi janë shumë të rëndësishme.

Në këtë ngritje tuajën, paratë nuk janë fare të rëndësishme. Qofsh I pasur apo I varfër ti merr Realizimin tënd. Për shembull, isha në Marashtra, shumica e tyre mund të them njerëz shumë të varfër në kuptimin që nuk janë aspak klasë e mesme. Nuk janë të arsimuar, shpesh janë punëtorë fabrike ose kanë prona të vogla. Jo shumë të pasur. Por janë Sahaja Yogis shumë të mirë, të shkëlqyer. Kanë kaq sy të bukur, kaq ndjenja të bukura dhe kaq dhembshuri saqë Lakshmi Tattwa është komplet e ekuilibruar në ta. Ju e dini që Lakshmi shfaqet si një grua, një grua që është nënë. Nënës nuk I intereson nëse je I pasur apo I varfër. Nëse ka një djalë të pasur dhe një të varfër do I kushtojë më shumë vëmendje të varfërit dhe do I kërkojë të pasurit ti japë ca para. Ajo nuk e ka problem. Nëse dikush është në nevojë do jetë e para ta ndihmojë këtë person.

Tani kjo është një gjë shpirtërore në një jetë shpirtërore. Personi që është një kërkues I vërtetë, që është një kërkues I besueshëm, Nëna do ta gjejë një mënyrë që të jetë me këtë person. Dhe ata që nuk janë të ndershëm për këtë, Nëna do ta gjejë një mënyrë për tu shkëputur prej tyre. Problemi që kanë qëniet njerëzore është se ata nuk e dinë se çfarë duan. Mendojnë se para së gjithash duan para. Por ata që kanë para, mendojnë se duhet të kenë fuqi. Nëse kanë shumë para, mendojnë se duhet të merren me politikë se nuk kanë aq shumë fuqi. Pasi dështojnë në politikë, apo të themi përfshihen shumë në politikë çfarëdoqoftë, më pas duan dashurinë e fëmijëve të cilën nuk mund ta kenë sepse janë shumë të zënë apo dicka e tillë. Kështu pra që nuk e dinë se çfarë duan. Ata që besojnë se të kesh para është më mirë, bëjnë mirë të dëgjojnë njerëzit që vijmë nga shtete të pasura të cilët do ju tregojnë si shkojnë punët. Si janë keqësuar gjërat atje, sa njerëz janë rrënuar, çfarë problemesh ka, ata janë vërtet në një gjendje të keqe. Nuk mund ti quash qenie njerëzore sepse janë kaq mizorë, madje mund të vrasin dhe fëmijën e vet, dhe shoqëria I lejon njerëz të tillë.

Nëse dëgjon në Indi që dikush vret një fëmijë, në 60 vitet e jetës Sime nuk kam dëgjuar asnjëherë, por të supozojmë se dëgjon që dikush ka vlarë vajzën apo djalin e tij, askush nuk do I hedhë sytë. Nuk do të lejohet në shoqëri, askush nuk do I japë apo marrë për martesë djalin apo vajzën. Do jetë tërësisht I përjashtuar nga shoqëria. Asnjëri nuk mund të mendojë një marrdhënie të tillë midis fëmijëve dhe prindërve.

Ka edhe marrdhënie të çuditshme pastaj, është kaq absurde, në të dy anët e mizorisë dhe të moralit, janë kaq absude të pamunduar për tu kuptuar.

Pra paraja u ka dhënë këtë ego, dhe thonë, "C'të keqë ka? C'të keqë ka?". Është tërësisht sjellje e keqe (e ligë). Kur thua: "C'të keqe ka?" do të thotë që nuk do të mbash marrdhënien me gjithësinë. Nuk don të mbash marrdhënien më Atë Të Hershmin, Atë që të ka ty, të gjithë brenda Vetes së Tij. Ju jeni pjesë përbërëse e gjithësisë ndaj si mund të thuash: "C'të keqe ka? Unë bëj atë që më pëlqen." Thjesht shndërrohemi në një qelizë malinj. Prandaj tek Cakra Nabhi njeriu duhet të dijë që s'duhet të jetë I etur pas parave. Tani ata që dëshirohen shumë pas parave, mund të zhvillojnë më shumë anën e djathtë, mund të kenë para pa dyshim. Por do iu mungojë ana e majtë. Ana e majtë është Gruha Lakshmi, ata nuk kanë Gruha Lakshmi[5] në shtëpitë e tyre. Janë njerëz shumë të ethshëm, gjithmonë në nxitim, si në një garë minjsh, me atakë në zemër nëse nuk kanë atak në zemër do të kenë leucemi, diabet, mëlci apo çdo gjë tjetër sepse vëmendja tyre është drejtuar drejt parave dhe jo Zotit.

Pra qofshi në të djathtë apo në të majtë. Ata që janë shumë emocionalë, jashtëzakonisht emocionalë, në merak për familjen, për ta familja është gjithcka, mardheniet janë gjithcka, dukë qenë kështu nuk kanë shumë Lakshmi sepse ata shpërndajnë gjithë

Lakshmin. Por përsëri janë njerëz më të mirë. Por ndonjëherë njerëz të tillë që sakrifikojnë shumë për të tjerët, që heqin dorë nga gjithçka kanë, mund të çmenden sepse ndjejnë që njerëzit nuk janë reciproke, nuk ua kthejnë dashurinë, nuk e kuptojnë se çfarë kanë bërë. Prandaj të ndihmohet të tjerët në ekstrem mund të shkaktojë problem tek një person që e bën këtë, dhe gjithashtu problem tek njerëzit që kanë marrë para prej tij, sepse nëse u jep njerëzve para çfarë do ndodhë?

Po ju jap një shembull të Thjeshtë të Amerikës që ndihmoi Indinë. Kur amerikanët ndihmuan Indinë, menduan se po i bënë një nder të madh Indisë, por ishte gabim. Sepse çfarëdo të kenë bërë e humbën me egërsinë që treguan. Askush s'e detyroi, ishin të lirë. Por duke dhënë ata treguan përbuzje, dhe kur dhanë grurë dhe oriz nuk kishte bamirësi në të sepse, sepse vunë një lloj fare që krijoi shumë gjëra të tmerrshme në fshatra. Njëri u quajt bar kongresi sepse vinte nga Amerika. Ndërsa tjetri u quajt akacia e cmendur, Babool ne e quajmë Babool i çmendur. Këto pemë janë rritur kaq shumë në fshatra sa nuk dijnë c'të bëjnë me to. Kanë kaq ferra të mëdha sa që kushdo që gërvishet nga to mund edhe të vdesë. Janë shumë helmuese dhe nëse fëmijët preken prej tyre kanë kaq shumë problem helmimi sa zor të kurohen. Ja pra si na ka ndihmuar qeveria Amerikane. Tani kush do i thotë atyre pse keni bërë një gjë kaq të turpshme?

Më mirë të ngordh urie se të marr ndihmë prej ndonjërit. Shumë kohë më parë kam thënë që është më mirë të ngordhësh urie në këtë vend se sa të marrësh ndihmë nga këto vende perëndimore të mjerë dhe të tmerrshëm që nuk e mendojnë ndonjëherë fundin e tyre. Ju Thjesht përkedheln egon e tyre për hicgjë. E çfarë fituan ata? Thjesht një pasuri plastike (e ka fjalën të thyeshme). Por kjo që vjen nga paratë i bën kaq budallenj sa nuk kuptojnë se c'ndodh në vetë vendin e tyre. Si vendi i tyre po zhytet gjithnjë në çdo anë. Si njerëzit e tyre po fundosën, qofshin të frikësuar apo të braktisur. Nëse shkon në këto vende e kam fjalën nuk mund të ulesh kështu kudo e të flasësh jashtë, dikush mund të vijë e të vrasë ndonjë. Nëse ecën natën mund të vrasin, në Amerikë, në qytetin e Nju York-ut i quajtur një vend i përparuar.

Pra këtë lloj të pasurish po përpiqemi të aspirojmë, sidomos njerëzit në Delhi që janë tërë anketë për të siguruar para. Nuk e di pse Punjabis, Gujaratis dhe Maarwadis kanë arritur këtu. Maarwadis janë të një tjetër stili. Pse Punjabis dhe Gujaratis po përpiqen të sigurojnë para. Dhe kur i shoh jashtë nuk e kuptoj nëse kanë ndonjë afërsi me Indinë. Njerëz të tmerrshëm. Nuk u ka mbetur asgjë nga kultura indiane. Janë tërësisht të jashtëm. Nuk e mendojnë ndonjëherë fundin e tyre, mendojnë se kanë kapur parajsën. Nëse sheh Cakrën e tyre Nabhi, do cuditeni, të gjithë vuajnë nga mëlçia, tension i lartë i gjakut, diabeti, atake në zemër dhe pijnë si peshqit, sidomos Sardarjis.

Mbeta e habitur, ata që supozohen të ekzistojnë në emër të Zotit, pijnë si peshqit. Janë shumë të kujdesshëm për të veshur një Puggadi dhe një Dhari, ndërsa për të pirët nuk e cajnë kokën. Tek çdo Sardarji që të shkosh duhet të ketë një bar të madh në shtëpi, ku edhe një pasanik (lord) në Angli nuk e ka sepse shihet si mjaft vulgare.

Pa mësuar estetikën e këtij vendi, ata shndërrohen Thjesht në bujq- nuk kanë kulturë. Është fakt. Kjo është ajo që u ka bërë paraja, nuk kanë respekt për veten. Pra duhet të ekuilibrohet ky Lakshmi Tattwa. E njëjta gjë për Gujaratis kush ka ikur. Një lloj tjetër jeton këtu, Maarwadis. Pak thuhet për të mirën e këtyre Marawadis. Nuk mendoj se ndonjëri prej tyre do arrijë Realizimin apo një vend në Mbretërinë e Zotit.

Ata janë gjakpirës. Nuk janë qenie njerëzore. Për hir të parave ata të thithin gjakun si lëng, thithin gjakun dhe kënaqen.

Kjo nuk është një botë për ju që të thithni para. Ju keni ardhur në këtë vend (tokë) si qenie njerëzore për të parë Zotin, të kërkonte Shpirtin tuaj, të jeni një me veten, të jeni në atë vend paqësor që është Mbretëria e zotit, që është Mbretëria e Parajsës, dhe jo të hidheni në baltë që duket shumë e bukur por në fakt nuk është. Është sfilitëse, terrorizuese.

Njerëzit nuk mund të flenë kur kanë shumë para, sepse nuk dinë c'të bëjnë me to. Edhe ata që janë bërë me para, nuk dinë kur do i vijnë taksat mbi të ardhurat. Unë e kam zgjidhur problemin e taksës mbi të ardhurat duke mos pasur fare të ardhura. Pa të ardhura nuk kam taksë mbi të ardhurat, kështu që nuk merakosem për Komisionerin e Taksës mbi të Ardhurat. Ai nuk Më kontroll dot. E mira është të mos kesh aq të ardhura sa të kesh taksë (taksohesh), përndryshe do ju duhet të keni një avokat taksash për të ardhurat siç është vëllai IM.

I thashë atij, "Unë nuk kam fare nevojë për ty, për gjithë jetën, faleminderit shumë."

Bëhesh tërësisht I lirë, në majë të botës nëse nuk ke të ardhura. Është sikur t'ju duhet të zgjidhni një problem të makinës, mos mëso makinën. Dikush do ju shoqërojë ose hiç, mund të lëvizni në këmbë.

Akumulimi I gjithë këtyre gjëravë të parëndësishme ka shkaktuar këtë tension të quajtur: "Sa duhet të paguajmë, c'është taksa mbi të ardhurat, nesër policia do vijë në shtëpinë time?". Nëse do vijë t'kë Unë do u them, "Mirë merrni çdo gjë të mundni. Nuk ka asgjë, disa fatura që s'i kam paguar, kaq." Lëri të paguajnë. Njeriu duhet të jetojë tërësisht I lirë në këtë botë. Dhe për të arritur lirinë, duhet të dijë që të jetë në rregull me prioritetet. Nëse paraja është prioriteti juaj, e keni.

Jo Unë jo. Nëse doni të Më jepni para, "Jo Zotëri." Nuk I dua për asgjë. Mund të Më japësh lule, këtë, atë në rregull, por aspak para. Nuk dua t'ia di fare për para, është një dhimbje koke për mua.

Në të njëjtën mënyrë, nuk e kuptojmë që pasja e marrdhënieve – vëlla, motër dhe bir, kjo e ajo – është një tjetër kokëçarje. Kjo s'do të thotë që duhet t'i rrihni, por njerëzit mund të shesin vendin për hir të fëmijëve. Është një gjë shumë e rrezikshme, e tmerrshme, kjo lloj lidhjeje Mamatva (fjalë indianë që do të thotë ndjenjë pronësie).

Ky është djali im, mbaroi. Nëse është djali juaj mund të vrisni këdo nëse duhet, bëni çfarë doni sepse është djali juaj. A nuk është djalë I dikujt ai që ju po vrisni? Kjo Mamatva që vjen "Burri Im". Sidomos tek gratë indianë "Burri Im" menjëherë fillon problemi.

Gjithcka vjen nga injoranca. Sigurisht ka edhe dashuri. Por dashuria nuk bën asnjëherë të lidhur, sepse është e mençur, është dituri. Supozojmë në një pemë llogorja (limfa) shkon dhe ngjitet me një frut sepse e do "Është e imja". Ç'ndodh më pas me pjesën tjetër të pemës? Vdes, dhe gjithashtu edhe fruti që ajo do vdes. Kështu që kjo mamatve duhet të hiqet. Por nuk ikën vetëm duke I thënë, apo duke e këshilluar. Edhe nëse vuani, kam parë kaq njerëz që vijnë tek Unë, "Babai im më mashtroi. Djali im më mashtroi." I them "Cili është I joti? Ai që të mashtroi nuk është I Joti."

"Burri Im." Ka disa femra që Më hanë kokën për burrat e tyre. "Burri im bëri këtë, burri im bëri këtë, burri im bëri këtë."

Bla bla, pse nuk e qëllon njëherë fort e mbaron? Por është kaq e pranueshme, kjo mamatva, kjo lidhje (varësi). Lidhje pas parave, lidhje pas njërezve, lidhje pas këtyre s'është gjë veçse një grep që ju pëshkon në nivele më të ulta. Ju duhet të ngriheni lart, dhe më pas të shijoni me të vërtetë bukurinë e pasurisë. Siç ju thashë një ditë më parë, shoh gjithë këto gjëra të bukura. E bukura është se unë nuk I zotëroj këto. Ja këto tapete janë hapur këtu. Nëse do ishin të mitë do merakosesha "Zot shpresoj mos të prishen. Shpresoj mos të shkeli njëri mbi to. Shpresoj të jeni të sigurtë që askush mos ti marrë." Por kur nuk Më përkasim, I gëzoj më shumë. Gjëja e tjetrit është një ide më e mirë. Ky mit na mban në një masë të tillë marrëzie sa që ndonjëherë ndjej nëse këto qenie njerëzore nuk janë humane, por janë zotërime të tyre. Shpirti tyre ka humbur, çdo gjë ka humbur, nuk mërzhiten hiç. Por nëse pozita e tyre e vogël humbet qajnë e vajtojnë sikur të kenë vdekur, etërit e tyre kanë vdekur qindra herë.

Por njerëzit si Unë janë Thjesht batchas, perandorë. Nuk mërzhiten. Nuk ndikohen nga rehatia, nuk kanë nevojë për rehati. Nëse ke rehati ajo zvarriset pas jush dhe ju bën rob. Nëse kërkon rehati je drejt robërimit, ta dini prej Meje. Çdo lloj rehatie. Vetëm qëniet njerëzore mund të çmenden kështu. Asnjë kafshë nuk bëhet.

Ka edhe tip tjetër rehatie, është ajo ide mendore që çdokush duhet ta pranojë, dhe që duhet të jesh I aftë ti tejkalosh të tjerët. Mendoj se kjo vjen gjithashtu nga Nabhi Cakra. Është një lloj ndjenjë që duhet të jesh I aftë të tejkalosh shumë njerëz, ata duhet të shikojnë ty.

Këto ditë në Londër ka gra që vuajnë nga një sëmundje qesharake e quajtur anoreksi, Thjesht nuk hanë. Gratë nuk hanë se duhet të jenë të holla lëkurë. Për çfarë? Pse duhet të jesh e hollë kockë e lëkurë? Sepse dukesh tërheqëse, por për çfarë? Nuk besoj se ka gjasa që njerëzit e hollë të duken tërheqës. Janë të tmerrshëm. Të krijojnë mëshirë dhe ndjen pështirë ndaj gjithë kësaj.

Njëherë një mbretëreshë e bukur erdhi tek Unë. Mendova se ishte një paciente e T.B dhe I them, “dukeni shumë mirë por shoh se jeni një pacient I T.B’.

Ajo thotë, “Jo Nënë, kam marrë një çmim bukurie.” “Po” Cilët ishin njerëzit? Doktorët duhet ta kenë dhënë këtë sepse duan pacientët”. Ky është një problem, ne largohemi nga udha dhe shqetësojmë Nabhin tonë, duke mos ngrënë duke agjëruar. Nëse do të agjërosh në këtë jetë, jetën tjetër nuk do kesh fare ushqim. Faleminderit shumë. Jo ushqim. Agjërim? Në rregull, do të keni një agjërim të përhershëm. Ç’më thoni?

Nuk duhet të bëni asnjë agjërim. Pse doni të agjëroni? Nëse doni të agjëroni sepse doni të ndryshoni regjimin apo për hir të shëndetit, në rregull. Por pse në emër të Zotit doni të më lëndoni Mua? Keni çdo gjë për të ngrënë dhe s’doni të hani. Ata që kanë ushqim për të ngrënë ata nuk duan të hanë. Jetën tjetër bëhen të varfër dhe fajësojnë të pasurit.

Por në jetën e shkuar keni dashur të agjëroni, kështu që në këtë jetë nuk u jepet ushqim sepse kërkuat për këtë.

Kështu që kur agjëroni si të çmendur ndodh që Cakra Nabhi shtrembërohet. Nuk është nevoja të agjëroni në emër të Zotit. Zoti ju ka dhënë gjithë mirëqënien, bukurinë, gjithë dashurinë. Në të vërtetë në Sahaja Yoga nëse ju agjëroni në emrin Tim, mendoj se është e tmerrshme sepse nëse doni të trondisni Nënë tuaj apo ta shqetësoni Atë, apo të hakmerreni ndaj Saj, atëherë thoni, “Nënë, unë nuk do ha ushqimin tim.” Nëna mbaron. Kjo është mënyra më e mira për ta mposhtur Atë. Do thotë “Nënë nuk do ha ushqimin tim.”

Prandaj ky lloj agjërimi I çmendur është gjithashtu shumë I keq për Nabhin tuaj dhe kur e bëni këtë keni një problem se jeni të pushtuar nga ana juaj e majtë, që e quajmë përtej Ida Nadi[6], ju keni ndërgjyegjen kolektive; dhe pushtoheni prej tyre. Dhe jeni në telashe fizikisht, mendërisht, emocionalisht.

Dhe përgjithësisht njerëzit që agjërojnë janë mjaft gjaknxehtë. Në ditën që agjërojnë mos iu afroni asnjëherë. Sepse janë tashmë duke planifikuar se çfarë do të hanë. Planifikojnë dhe në mëngjes por nuk kanë, kështu që ndihen të inatosur për këtë pjesë.

Gjithë këto gjëra asahaja nuk iu ndihmojnë. Duhet të jeni njerëz normalë. Nuk duhet të tensionoheni për të qenë në Sahaja Yoga, fare. Jini normalë. Jini njerëz të mirë. Mos torturoni veten. Ka një pikë në Nabhi në anën e majtë dhe në të djathtë: mos u fusni në indulgjënca[7]. Mos përkëdhelni veten.

Të dy këto gjëra janë njëlloj për Sahaja Yogën. Nëse jeni të uritur apo të mbingopur, është njësoj. Nuk ka ndryshime mes të dyjave, sepse nëse nuk jeni në ndenjësë nëse bini në të majtë apo në të djathtë ka ndonjë ndryshim?

Prandaj të jesh në ndenjësë (karrige) është bekim I Shri Lakshmi. Dhe ju kam shpjeguar që Shri Lakshmi është një zonjë dhe në dorën e majtë të Saj ka dy lotuse dhe në të djathtë një lotus, dhe një tjetër në majë që tregon se personi është duke u ekuilibruar. Po ekuilibrohet në një lotus. Imagjinojeni. Është duke qëndruar në një lotus, që do të thotë se Ajo është duke u ekuilibruar. Është duke u ekuilibruar, Ajo qëndron aty edhe mban dy lotuse në duart e Saja duke treguar se Ajo është si një lotus. Një person që është njeri I pasur, Lakshmi Pati,[8] duhet të jetë si një lotus, I ngrohtë, I shkëlqyeshëm, I ngrohtë. Dhe jo një gjë e tmerrshme si grerëz. Nuk e di si e quani në Angli, mbase nuk ka. Ne kemi një grerëz shumë të zezë, më kuptoni që është e fortë si një arrë me këmbë këndorë të mprehta. Kjo gjë e zezë që vjen nuk është e mirë për asgjë, por vjen për të gjetur strehë si ashraya, lotusi e mban atë në majë të kurorës së lules, që është një gjë shumë e butë, plot dashuri. Dhe natën mbyllet që insekti I gjorë që është si arrë të mos ketë shqetësime nga klima e jashtme. Si një nënë që merr fëmijën në kraharor, kjo dashuri duhet të jetë për një Lakshmi Pati. Sa Lakshmi Pati të tillë janë? Keni parë ndonjë?

Nëse shohin dikë që vjen me propozim për paratë, atëherë mund ti hapin dyert. Përndryshe s’kanë dashuri për askënd. Nuk ekzistojnë për ata që vijnë për ashrayas, apo për ndihmë.

Nga ana tjetër janë njerëzit që janë kaq të pështirë. Ata s’janë si lotusi. Nuk kanë aromë. Janë njerëz të mjerë që kutërbojnë



mizerje. Ndërsa lotusi lëshon aromën e tij në baltë, në atë gjë të tmerrshme ku edhe krimbat e vegjël zvarriten mbi ato petale të lotusit që kanë një aromë kaq të bukur. Kështu duhet të jetë. Duhet të japë. Duhet të jetë e bukur. Duhet të jetë komode. Duhet të jetë mikpritëse.

Më pas dora tjetër jep. Lakshmi jep gjithmonë. Ajo nuk merr; Ajo Thjesht jep. Nëse jeni vërtet një Lakshmi Pati nuk doni të merrni asgjë nga të tjerët. Nuk merrni. Nëse jeni vërtet I pasur, kush mund t'ju pasurojë më shumë? Ç'mund ti japësh një personi që është tërësisht I pasur? Nuk ka rrugë për të hyrë në të, tani është plot deri në grykë. Ai është I pasur deri në grykë. Atëherë ç'ti jepni? S'mund t'i jepni asgjë. Por kur keni për ti dhënë do të thotë që ai është lypës - është akoma një lypës. Të gjithë këta të ashtuquajtur njerëz të pasur që janë akoma të etur për para janë përsëri lypës, nuk janë të pasur, mund të gënjejnë veten. Jane si Enët bosh, nuk janë të pasur se janë ende duke pritur para.

Prandaj është e rëndësishme të kuptojmë, paraja nuk është rruga. Paraja na largon nga dharmja. Na largon nga Zoti. Na largon nga realiteti. Të mbyll sytë. Nuk mendojmë se duhet duhet të ndjekim rrugën e drejtësisë dhe virtutit sepse mendojmë se jemi të pasur, Zoti do të ketë frikë nga ne, madje ne edhe mund ta blejmë Atë dhe mund ta menaxhojmë Atë duke I dhënë ca rryshfete. Nuk është kështu. Duhet të përballeni me veten. Duhet të përballeni me veten. Nuk është paraja që do ju japë atë ngazëllim, atë jetë më të lartë, por është dashuria e Zotit, ndershmëria e të kërkuarit, ndershmëria.

Kjo është cilësia e kësaj cakre është Satya, Vishnu, është Satya. Ai është Narayana. Narayana do të thotë Satya. Pra nuk mund të ketë Satya Narayan, apo jo? Narayan është Satya, atëherë si mund të jetë Satya Narayan?

Por ne kemi shumë Puja Satya Narayana. Në gjithë këto Satya Narayanas nuk supozohet të shkojnë Sahaja Yogis-tët. Mund të shkojnë vetëm në Narayana PUja sepse Satya Narayana është ajo rrugë që I është shtuar për kamuflazh, menduar për ata Brahmins[9] të tmerrshëm që ju bëjnë të paguani. Për çfarë? Sahaja Yogis nuk lejohen të shkojnë në Satya Narayana Puja. Mund të kenë Narayana Puja. Dhe ç'është bërë së fundmi Narayana? Në çakrën Nabhi Narayana ekziston qëkur Ai është krijuar nga Devi. Dhe kujdeset për Kërkimin, ushqen kërkimin si një baba, dhe më pas rimishërohet përsëri e përsëri e përsëri për të ndihmuar kërkimin në një pozicion më të lartë dhe më të lartë derisa arrin një pikë ku ju filloni të kërkoni Zotin e Plotfuqishëm.

Më pas ju hidheni në Shaktin e Mahalakshmit. Pastaj jeni në duart e Mahalakshmi Shakti. Nënkupton që Lakshmi transformohet në principin e Mahalakshmit.

Tani ky parim I MahaLakshmit qëndron në rrugën qëndrore të Sushumna. Dhe kjo rrugë qëndrore e Sushumna është tërësisht e krijuar dhe e zgjuar kur ngrihet Kundalini. Kur Kundalini nuk ngrihet, ky shteg (rrugë) mbetet absolutisht I zi. Është absolutisht I zi, nuk ka asgjë në të përveç hyjnive që qëndrojnë aty pa dritë. Kur Kundalini ngrihet, atëherë vetëm këto hyjni zgjohen dhe kur zgjohen kjo rrugë Sushumna, kjo rrugë qëndrore e Mahalakshmit fillon të veprojë si fuqi ekuilibruese, si fillim në çakrën Nabhi.

Kështu që çakra Nabhi rrethohet nga dhjetë Guru, Profetë që ju japin ekuilibër, që vijnë në këtë tokë përsëri e përsëri t'ju japin ekuilibër në jetë. Ata ju thonë, "mos bëni këtë, mos bëni atë". Por ne nuk I dëgjojmë, nuk e pranojmë këtë.

Mund të themi që ndjekim këtë apo atë guru. Siç janë Muslimanët. Ata thonë "Në ndjekim Muhamed Sahib." Tani nëse Muhamed Sahib ka thënë ndonjë gjë ajo është mos pini. Por duhet akoma rrugë që dikush mos të pijë. Ata mund të mos pijnë në Riyadh sepse mund të vriten. Por nëse vijnë në Londër, ata pijnë. Faktikisht kur burri Im vajti në Arabinë Saudite I thanë, "Ti je I vetmi Musliman që ke ardhur". Është e vërtetë. Çfarë do që u është thënë, ata bëjnë të kundërtën. Në atë kohë nuk kishte cigare e duhan kështu që Ai s'tha gjë për të kështu që ata gjetën një shteg. Muslimanët pijnë duhan, nuk ka problem se Muhamed Sahib nuk tha gjë.

Muhamed Sahib duhet të lindë edhe një herë si Guru Nanaka[10] tu thotë atyre "Oh Zot.Tani që po pini këtë gjë të tmerrshme të sapoardhur, tani mos pini." Por kush do pranojë që Nanka dhe Muhamed Sahib ishin të njëjtët njerëz? Pa dallim. Ishte e njëjta gjë. Këtë mund ta provojmë në Sahaja Yoga. Mund ta provojmë, sa e rëndësishme është të dijme që ata ishin të gjithë njëloj, dhe qëndruan për të njëjtën gjë por për një periudhë.

Tani ju keni ganja, unë nuk l di emrat e gjithë këtyre gjërave që pini, Zoti e di. Qëniet njerëzore janë vërtet të zgjuara të gjejnë çdo gjë që mund t'ju shkatërrojë. Është si ti thuash një demi "hajde më gjuaj". Kështu. Nëse nuk ka dëm atëherë do l kërkoni një kau "hajde më qëlllo". S'gjetet kau në rregull, do l kërkoni një elefanti "hajde më shtyp". Kështu. Qëniet njerëzore janë budallaqe. Të supozojmë tani, nëse shkruaj një listë të të gjithë gjërave që pini e tymosni, nuk e di sa gjëra ka në këtë botë, më pas do të gjeni edhe një gjë të tretë pasi të vdes dhe do thoni "Mataji nuk e ka thënë këtë". Kështu kemi për të bërë. Të zgjuar shumë. Gjithë kohës duke shkatërruar rrugën tuaj qëndrore, dhe dukë u menaxhuar nëpërmjet saj. A keni ndonjë mundësi të shkoni tek Zoti në këtë mënyrë? Kjo është rruga që po ndiqni rimishërimet e mëdha që erdhën në këtë tokë?

Pra ekuilibri vjen nëpërmjet Nabhi dhe Nabhi kujdeset për ju dhe ju mëson si të silleni. Për shëmbull, Nabhi juaj l majtë është Gruha Lakshmi. Gruha Lakshmi është Hyjnia e familjes.

Por nëse ju jeni tip shumë l jashtëm, atëherë mund të çmendeni. Kështu që ngrihuni në mëngjes herët, lexoni gazetatat. Përsëri është kundër Sahaja Yoga. Nuk duhet të lexoni gazeta në mëngjes. Mund ti lexoni në darkë por jo në mëngjes. Sepse nëse l lexoni në mëngjes do të mërzhiteni dhe dobësoni shpretkën që l duhet të hedhë më shumë rruaza gjaku të kuqe, bëhet e cmendur dhe dëmtohet.

Përkundrazi në mëngjes bisedoni me gruan, me fëmijët, kujdesuni për Gruha Lakshmi Tattwa. Siç ju thashë dhe gruaja duhet të jetë një Gruha Lakshmi.

Më pas duhet të keni një ushqim të mirë. Të uleni dhe të hani si duhet. Por jo që pas kësaj të shqetësoni Nabhin tuaj, të hipni në makinë, të merrni mëngjesin në dorë duke e ngrënë rrugës, të shurdhoni njerëzit me bori, të inatoseni me ta, gruaja që të thërrët "Eja të hash mëngjesin!". S'bëni asgjë. Jeni rrugës për një punën tuaj të veçantë, dhe përfundoni me të paktën leuçemi, minimumi l minimumit, nëse nuk ju kap ndonjë atak zemre.

Leucemia vjen nga Nabhi l majtë, kur Gruha Lakshmi l juaj është rrënuar. Hyjnia e Gruha Lakshmi është Fatimabai[11], vajza e Muhamed Sahib, ndërsa vajza e motrës së Nanani Sahib është në Vishuddhin e majtë. Po ta shikoni. Nanaki.

Tani ne s'kemi menduar asnjëherë për këtë aspekt të jetës. Kur sëmureni me leuçemi, atëherë vini tek Nëna, "Të lutem më shëro". Dhe nëse jeni të pasur, do shikoni që unë e kuroj atë person. Nëse nuk e kuroj do uleni në kokën Time. Do më rri si çekan mbi kokën Time derisa t'ju kem shëruar nga leuçemia. Por nëse ju them, "Biri im, mos u mërzhit, jeta nuk është për të dhënë fatkeqësi. Çfarë ke fituar nga gjithë ky nxitim? Asgjë. Përveç këtij Nabhi të tmerrshëm prej të cilit ju po vuani, vuajnë edhe njerëzit e familjes suaj. Vetëm personi që ka fituar është doktori ose doktorët e spitaleve". Ata nuk dëgjojnë. Dhe e dini që leukemia është një sëmundje e kancerit që zhvillohet kaq shpejt sa që dikush mund të vdesë brenda një muaji, doktorët do ju thonë që së paku keni jetë edhe një muaj, kaq. Do ju marrin gjithë paratë për t'ju dhënë këtë certifikatë, shumë bukur. Po pse ta keni këtë? Jini l duruar me veten. Jini të sjellshëm me Nabhin tuaj, kujdesuni për Gruha Lakshmi.

Gjithë llojët e sëmundjës së stomakut vijnë nga disëkuilibri, nga kjo apo ajo mënyrë. Të gjithë këta guru të mëdhenj erdhën në tokë për të na dhënë ekuilibër, të na mësojnë ekuilibrin dhe të na thonë, "Mos e bëj këtë dhe atë". Të 10 Urdherësat. Por për ne këto 10 Urdherësa nuk kanë kuptim.

Tani do prek një temë (pikë) që është vërtet e rëndësishme për ju njerëz që të kuptoni rreth jovegjetarizmit dhe vegjetarizmit. Kam dashur ta shtoj këtë temë, sepse për ata që janë vegjetarianë nuk mund ta durojnë të shohin që Nëna thotë se nuk ka rëndësi nëse je një jovegjetariane, sepse kjo nuk shkon kundër vetëdijes suaj. Nuk shkon. Por të pirët po. Të pirët alkool shkon kundër vetëdijes sonë, por jo të ngrënit ose jo mish këtë duhet ta kuptoni. Tani dikush më tha Mua që në Gita shkruhet që ata që hanë mish janë Tamo Gunis. Jam çuditur vetë tek Gita. Sepse Vetë Shri Krishna në fillim, ka thënë Arjuna që ju duhet të shkoni ti vrisni këta njerëz, madje edhe të afërmit, vritini, tamam vrisni qëniet njerëzore. Të afërmit dhe guruja juaj duhen vrarë gjithashtu, sepse unë l kam vrarë tashmë. Askush s'duhet të vritet nga ju sepse ata janë tashmë të vrarë. Dhe Ai dha kaq shumë shpjegime që kjo nuk duhet bërë, por Ai tha, "JO ju them, duhet të shkoni të vrisni. Dorëzoheni veten tek Unë dhe unë do kujdesem për ata."

Por se si Ai e predikoi këtë në Gita unë nuk e kuptoj. Tani kjo duket të jetë një paraqitje e re që njerëzit që hanë mish janë Tamo Gunis. Ata nuk janë, asnjëherë. Ata janë Rajo Gunis.

Nëse ti han mish ti bëhesh Rajo Gunis jo Tamo Gunis. Tamo Gunis janë njerëzit që hanë karbohidrate, I kemi parë në Sahaja Yoga.

Kemi dy lloje sëmundjesh, njëra është e organeve të përgjumur (letargjik) dhe tjetra e organeve aktivë. Dhe ndërsa ju thoni për shembull "Ne duhet të ndjekim Gita", mendoj se dikush ka gabuar e ka shkruar në Gita ashtu edhe si në Bibël dicka jo si duhet, e kanë shkruar në çdo libër.

Do ju them më vonë se çfarë kanë shkruar gabim në Bibël apo për Krishtin. Mendoj se disa njerëz e kanë vendosur aty për kundërshti.

Nëse ju hani shumë mish merrni Raj Gunis dhe më Raj Gunis bëheni siç ju kam thënë person I anës së djathtë, bëheni shumë agresivë dhe ahamkaris dhe mund të lëndoheni.

Por njerëzit që hanë vetëm jeshilliqe bëhen të përgjumur, tërësisht të përgjumur.

Do të kenë një zemër të përgjumur ose aspak aktive, dhe mund të kenë edhe atak zemrë. Do të kenë zorrë të fjetura me të cilat gjatë gjithë kohës do të kenë vështirsi të tmerrshme për të nxjerrë jashtëqitjet nga feçe, s'do të jenë kurrë të aftë të tresin gjithë ushqimet do jenë njerëz shumë të dobët. Kështu që ata njerëz që kanë një zemër të përgjumur apo një mëlçi të përgjumur a zorrë të përgjumura duhet të marrin proteina. Nuk po them mishëra, por proteina. Por një vegetarian nuk merr shumë proteina. Është më e lehtë të marrësh mish, nuk ka dëm. Por ata që janë njerëz aktivë duhet të marrin më shumë jeshillëqe. Ndeshmëria. Guru Nanaka hante gjithë atë mish, ishte njeri I keq ai? Këta Maarwadis që supozohen të jenë tërësisht pa hudhra dhe qepë. A është Ai më I keq se të tjerët? Po rreth Buddha, Ai Vetë? Ai hëngri mish, sepse e dimë që vdiq nga të ngrënit mish të gjallë, Vetë Ai.

I vetmi mish të cilin nuk duhet ta hani është ai I kafshëve më të mëdha se ju, dhe jo të një lope që është lopë Indiane. Sidomos lopët indiane. Gjithashtu lopët më të mëdha nuk janë të mira sepse ju japin problem më dhëmbët. Por kafshë më të vogla, madje edhe në Jainisëm thuhet se duhet të ruani demat, lopët, dhe duhet ti ruani kafshët e tjera, por ata nuk thanë kurrë që duhet të ruani dhitë apo pulat. Sepse Mahavira[12] e dinte që ne nuk mund t'ju japim Realizim pulave.

Cila është dobia e ruajtjes së pulave dhe mushkonjave apo e tartabiqëve? Sigurisht që do bëjnë kështu. Disa njerëz Jain I ruajnë tartabiqët (çimka, shushunja) I vënë mbi qëniet njerëzore, thithin gjakun e njerëzve dhe paguhen për këtë. Është absurde por e bëjnë këtë. Për ata shushunjat janë më të rëndësishme se qëniet njerëzore. Billiona e biliona tartabiqë nuk mund të bëjnë një qenie njerëzore.

Kemi gjithë këto ide absurde në këtë vend. Pra kur ju them që nuk duhet të jeni vegetarian apo jovegetarianë, ju duhet të shihni çfarë ju nevojitet dhe ta hani.

Por nëse gjithë kohës vëmendja është tek ushqimi nuk është mirë. Prandaj njerëz nuk është mirë për ju të futeni në problemet e vegetarizmit apo jovegetarizmit. Sigurisht në shtetet perëndimore njerëzit duhet të marrin ushqim vegetarian, jo tërësisht, por duhet të kenë më shumë të tillë, ndërsa njerëzit këtu në Indi të cilët janë vegetarianë duhet që tani e tutje të marrin mish, përndryshe do të kenë zemër të përgjumur. Edhe nëse I kuroj ata do të kenë përsëri problem, më pas do I duhet të bëjnë by-pass. Të kurseni para? Nuk mundeni.

Do të keni zorrë të përgjumura, më pas do keni mëlçi të përgjumur. Do të keni të gjitha llojet e cerozës, a mbase në duar mund të keni të gjitha llojet e skuqjeve, alergjive, gjithë problemet mund të vijnë. Dhe së fundmi njerëz të tillë duken kaq të qetë sepse kur I shihni janë si lakra. Po. Nëse dikush është si lakër atëherë si mund ti japësh Realizim? Nuk mund t'u japësh Realizim lakrave, mundeni? Ne duhet të kemi këtu njerëz kalorsiakë, trima, luftëtarë. Ju duhet të luftoni forcat e djallit, e çfarë mund të bëjnë për

këtë këta njerëz që janë lakra? Njeriu duhet të kuptojë zemrën, realitetin dhe jo duke vënë konceptin (idetë e tij). Sepse jeni rritur një familje Jain dhe prandaj doni që secili të hajë jeshillëqe, gabim. Njeriu duhet të marrë proteina hajë proteina.

Tani c'është ushqimi për njerëzit Sattvic? S'mund të jetoni pa të? Pra ç'hani? Channa. A mund të jetoni me Channa? Është frut. Channa, ose mund të hani mish. Por jo çdo mish të rëndë, mish pa dhjamë, gjalpë të shkrirë, dhe ajo që unë ha më shumë është mjalti. Ky është ushqimi Im. Haj mjaltë, e dini pi mjaltë. Por nuk mund të jetoni me këtë, mundeni? Pra ju duhet të hani pak karbohidrate. Nuk ka problem, por ju ekuilibroni veten në Cakran Nabhi.

Por nuk duhet të ketë aspak vëmendje tek ushqimi. Në fakt nëse më pyesni se çfarë hëngra sot në mëngjes nuk e them dot. Vërtet jam shumë keq sepse nuk kam vëmendje në të. Çfarëdo të marrësh haje dhe nëse nuk të hahet mos e ha.

Ajo që është e rëndësishme është të shijosh çdo moment të jetës. Nëse një person është nazeli për ushqimin, sidomos Indianët janë shumë, është vërtet e dëmshme për Cakrën Nabhi.

Sepse ata që çmenden pas ushqimit dhe Cakrës Nabhi mendoj se janë jashtëzakonisht gjaknxehtë. Nuk e di fjalën në Anglisht por në Hindi e quajmë chichode, irrituese, dhe këto chichode do t'bejnë jetët e grave të tyre të mjerueshme. Do vijmë t'ju thonë, "Në këtë shtëpi hëngra arra shumë të mira kerri". Kështu që ajo grua e gjorë do vrapojë pas arrave kerri. Ne indianët jemi shumë llupësa (mëndjen tek ushqimi). S'mund ta imagjinoni, s'do ta besojnë por do t'dukemi si njerëz të uritur.

Por jemi kaq me mendje tek ushqimi sa që për këto Bengalit u hamendësua të ishin Mukha Bengalit, duhet t'ju tregoj rreth tyre. Kishin mish të gjallë që e morën nga India Qendrore njerëzit nuk mund të zinin peshk kështu që ishin të uritur. Prandaj njerëzit e Bombay shumë të njerëzishëm t'ërguan atyre një anije me peshk, unë e di sepse isha pjesë e saj, pra një akt t'hiqshëm për të bërë të mundur që njerëzit e Bengalit të hanin peshk.

Ata thanë, "Çfarë? Ne nuk do hamë peshk deti, ne jemi Bangladeshë". I hodhën gjithë peshqit në det. U kalb t'gjithi dhe u hodh në det. A e imagjinoni? Askush nuk do ta besojë në Perëndim, kështu po agjërojmë ne dhe prandaj jemi njerëz të varfër. A ia del një t'varfër të hedhë një anije me peshk në det sepse duan peshk të papërpunuar? Jemi kaq me mendje tek ushqimi sa Nabhi-ët tonë janë gjithmonë kështu. Dhe gratë tona duhet të fajësohen se dijnë si t'i kontrollojnë burrat, e në fakt po t'illatojnë.

Puna e një gruaje është të jetë një Gruha Lakshmi. Të ketë ideale mbi familjen, mbi burrin, të ketë ideale mbi fëmijët. Shtëpia duhet të jetë ideale, duhet të jetë një shtëpi e ngrohtë ku çdokush është t'mirëpritur. Puna e një gruaje është të mbajë mirë Nabhin e saj, Nabhin e fëmijëve, të burrit dhe të gjithë njerëzve që vijnë në shtëpinë e saj. Duhet të bëjë një jetë të ngritjes, mirësisë, me natyre religjioze. Duhet të jetë një grua me natyre të butë. Por këto gjëra mungojnë, e vetmja gjë që e merakos është si të kënaqë burrin. Sepse kjo është një nga punët e mëdha për të.

Pra që të mbajmë si duhet Nabhin ne si Sahaja Yogistë duhet të kuptojmë që nuk duhet t'i kushtojmë kaq shumë vëmendje ushqimit. Kjo s'do të thotë të hash ushqim të pisët. Por përfundimisht do të thotë që kur ha ushqim, duhet të shohësh vibrimet e ushqimit. Duhet gjithmonë tu japësh vibrime ushqimit. Hani ushqime që janë të vibruara.

Ushqime të caktuara, psh supozojmë që unë duhet të ha ushqim në një hotel me pesë yje, më pas do të vjellë, gjithmonë vjell. Nëse dikush më fton në hotel, do mendoj që në fillim, "Bobo, tani kam një sprovë", sepse nuk është gatuar me dashuri.

Kështu thuhet (Marathi[13]), "Ai pëlqen manaferrat e vogla të Shabari" (përsëri Marathi). Kjo do të thotë që dashuria që shprehet në ushqim është ajo për të cilën duhet të kujdesemi, dhe jo për bollëkun, jo për pamjen e saj dhe aspak për shijen tuaj, por shija e ushqimit duhet të jetë që të ketë dashuri. Lëreni gjuhën tuaj të ndjejë dashurinë. Kjo është shija më e mirë, dhe sidoqë të jetë gatuar - më dashuri gjithmonë ka shije të mirë. Prandaj kur të gatuar, gatuar me dashuri. Kur hani, hani me dashuri. Fjalë të mira personit që e ka gatuar me dashuri dhe mbi të gjitha, thoni bekimet, thoni bekimet tuaja dhe mendoni për të tjerët që mund të mos kenë ushqim sot.

Kjo është Lakshmi Tattwa, është kur dora është kështu, ku jep dhe atje është dora që u jep mbrojtje njerëzve që kanë nevojë për

para. Por jo në mënyrën që e bëjmë ne, në mënyrën që amerikanët apo rusët e bëjnë. Ne e bëjmë si Lakshmi, që kjo mbrojtje nuk del nga dora. Jepni pa e treguar më. Thjesht sepse keni për të dhënë dhe në fakt e bëni këtë. Nëse I keni dhënë, siç tha babai Im, dikujt një rupi, vrapo nga ky person sa më shpejt të mundësh me shpejtësinë e 1 milje. Por nëse I ke dhënë 5 rupi, largohu prej tij me shpejtësinë e 500 miljeve. Është shumë praktikë. Kështu duhet të japim.

Kjo është Lakshmi Tattwa, është Cakra Nabhi për të cilën ju kam treguar. Është një Cakra shumë e rëndësishme, sepse sot ju jeni këtu sepse në Cakran tuaj, Mahalakshmi Tattwa ishte zgjuar sepse ju donit të shikonit Zotin. Sepse donit të vinit tek Zoti. Nuk keni ardhur këtu për para. Nuk keni ardhur këtu për asgjë tjetër veç Zotit. Kërkimi juaj është në Zot. Doni të dini të vërtetën rreth Zotit dhe doni të keni Zotin. Ju nuk I vini idetë mbi të, por doni të shihni si Nëna dëshiron për ne të marrim bekimet e Zotit. Pra ju bëheni kështu kur kërkoni dashurinë e Zotit, mëshirën e Zotit.

Lakshmi duhet të jetë I hijshëm dhe Mahalakshmi është Ai që është gruaja e hirshme, është hijeshia tek ju. Hijeshia që duhet të zhvillohet në personalitetin tuaj. Brenda kësaj hijeshie (mirësie) ai ndjen etjen e Babait. Babai, Narayana. Ai don të ketë bekimet e Tij, dhe kështu fillimisht, e vërteta, kërkimi I të vërtetës ngrihet tek ju, dhe kështu ndershmëria e të kërkuarit bekohet kur Kundalini ngrihet. Ajo në fillim ju jep - gjëja e para që ju merrni është e vërteta, duke ndriçuar trurin tuaj.

Kur t'ju tregoj për Sahasrara dhe për Agnya, do ju them si ky tru bëhet një receptor I të vërtetës së fundme, si përhapet e vërteta, ti fillon të marrësh njohuri të vërtetës absolute. Si ky tru kur ndricohet ju jep fuqinë të dini të vërtetën dhe çfarë nuk është e vërtetë, dhe nuk ka alternativë.

Këtë do u them më vonë kur Kundalini do jua përshkruaj në nivelin e trurit. Por për sot mendoj Cakra Nabhi është shumë mirë.

Për të gjithë ne, sidomos për Indinë, Cakra Nabhi është shumë e rëndësishme, se ne duhet të dijmë që Zoti I Plotëfuqishëm, Narayana, Vishnu, është Ai që jep Kshema pas Yoga. Ai thotë "Yoga Kshema Mahatmyam" Ai jep kshema.

Dhe ne mëkatojmë kundër Zotit kur nuk e besojmë se jeta e drejtë, e ndershme dhe e virtutshme do të na japë Kshema-n e premtuar nga Zoti I Plotëfuqishëm. Ti mëkaton kundër Babait tënd, ndërsa në Perëndim ata janë duke mëkatuar kundër Nënës në anën e krahut të majtë, sepse kanë harruar që jeta imorale është një fyerje ndaj Fuqisë Mëmësore të Zotit. Pra të dyja gjërat janë të rëndësishme, qoftë në Perëndim apo Lindje, është e rëndësishme që ne nuk duhet të mëkatojmë kundër Babait dhe kundër Nënës.

Shpresoj që kam provuar t'ju them gjithcka në mënyrë të tillë që ju të mos lëndoheni. Sepse ju të gjithë vini nga vende të ndryshme, lloje të ndryshme jetese, koncepte krejt të ndryshëm, guru tepër të ndryshëm dhe mund të hutoheni. Pra në Sahaja Yoga duhet të lejoni që kjo të funksionojë. Të lejoni dritën t'ju vijë dhe të mos hutoheni, të mos shqetësoheni. Jeni këtu për të kërkuar Zotin dhe jo Thjesht të përsërisni ato që keni ditur deri tani, apo që I keni dëgjuar më parë, apo çfarëdo që keni gjetur. Sepse kjo sidoqoftë nuk ju ka dhënë asgjë. Ashtu si një nga nxënësit e Mi që është oficer madhor Më tha një ditë "Nënë, nuk di asgjë për Gita, nuk di për Rama[14], Krishna, për asnjë. Unë di për Ty sepse Ti je Ai që më dha Realizimin". Sigurisht pasi të më njohësh Mua do I njihni edhe ata. Por është më mirë të më njihni Mua tani, sepse Ata nuk janë më këtu. Pra jam Unë Ajo që jam ulur këtu, kështu që më mirë më njihni Mua më parë, dhe më pas do I njihni Ata më mirë se sa I keni njohur.

Pra le të biem në ujdin për këtë pikë: që ju të përpiqeni të kuptoni nëpërmjet Sahaja Yoga. Çdo gjë mund të provohet. Çfarëdo që ju kam thënë është e vërteta absolute, asgjë veç të vërtetës. Por duhet të mos e lejoni veten të detyroheni (kufizoheni) nga ndonjë ide e mëparshme dhe koncept I mëparshëm. Pra jeni mëndje hapur të shihni atë që kam thënë, është Thjesht një hipotezë, le të bëhet një ligj.

Kur e shihni vetë, kur shndërrohet në zemrën tuaj, në vibrimet, kur ju kuptoni dhe gjykoni atë që kam thënë, do të habiteni që Cakra Nabhi do e ndjeni në këto gishta, madje edhe fëmijët do e tregojnë.

Zoti ju bëkoftë të gjithëve!

Faleminderit!

[1] Celiac plexus ose coeliac plexus, I njohur gjithashtu edhe si solar plexus për shkak të rrezatimit të fibrave nervore është një rrjet kompleks nervash vendosur në stomak, në nivelin e mesit të vertebrës së parë.

[2] Aspekt i Zotit si Evoluim (zhvillim).

[3]Tattwa - një element, esenca, parimi, faktor.

[4] Kunder Sahaja Yoga.

[5] Hyjnesha e Nabhit të majtë. Gruha Lakshmi përfaqson gjithashtu edhe shtëpiaken.

[6] Kanali I majtë

[7] Mënyra për t'iu afruar Zotit. Në mesjetë patën përdorim të gjerë sidomos nga Kisha Katolike.

[8] Pati - do të thotë bashkëshort.

[9] Fjalë për fjalë, njeri i cili është lindur dy herë dhe mund të ndjejë brahmananda, apo lumturinë hyjnore. Gjithashtu, kastat më të larta në rangun e kastave të shoqërisë indiane.

[10] Një nga gurutë e hershëm, mësuesi themelues i fesë Sikh- (1469A-1539) Punjab, India.

[11] Vajza e profetit Muhamed, mishërim i parimit të Gruha Lakshmit.

[12] Mishërimi i superegos së Zotit.

[13] Gjuhë e folur nga Shri Mataji.

[14] Mishërimi i shtate i Shri Vishnu.

## 1983-0202, The Vishuddhi Chakra, Delhi 1983

View [online](#).

Programi Publik mbi Vishuddhi Çakra, Delhi (India), 2 Shkurt 1983.

Profetët kanë lindur dhe kanë krijuar një dallgezim në vetëdijen tonë, një dimension të ri të kuptimit tonë rreth fesë, dharmës, e cila duhet të asimilohet dhe të kuptohet se, çfarëdo gjëje të kenë thënë profetët e mëparshëm, duhet të kulmojë në diçka tjetër.

Kështu siç mund të themi profeti Muhamed ka thënë se të gjithë këta profetë që kanë ardhur në tokë kanë krijuar një dallgezim të ri dhe gjithashtu i ka ushqyer qenjet njerëzore me një evolucion me të ri. Ideja e qënive njerëzore për risinë është se ne duhet të heqim dorë nga të gjitha që janë të vjetra dhe ne duhet të bëhemi të rinj. Ose ata mendojnë se risia është absolutisht një kusht ballafaqimi në të cilin njeriu duhet të rritet dhe ky është shkaku i marrëzisë së shumë njerëzve në Perëndim si edhe në Lindje

Kurdo që një temë e re ka filluar, siç mund të themi që ne fillim një shenjt i madh erdhi në këtë tokë dhe i gjeti njerëzit duke adhuruar idhujt në një rrugë krejt të gabuar, sepse në bibël është thënë që çfarëdo që është krijuar nga toka mëmë nuk duhet të riprodhohet dhe të adhurohet.

Kështu që prej saj ata krijuan një fe tjetër ekstreme duke thënë se asgjë nuk duhet adhuruar, por është thënë se çdogjë që riprodhohet nga nëna tokë.

Pra ka shumë gjëra në të gjithë botën të cilat janë krijuar nga nëna tokë. Kështu ato nuk duhen adhuruar duke i riprodhuar ato dhe të bësh imazhe me to. Kur profeti vdiq duke thene : " Kjo nuk duhet bërë, një person nuk duhet të adhurojë imazhe', filloi ana tjetër e saj, ekstremi, duke shkuar në ekstrem se nuk duhet të ketë adhurime edhe nese i ka krijuar nëna tokë. Kështu të gjitha qëniet njerëzore u ndane në kushte ekstreme.

Një situatë e tillë ndodh kur vjen dikush dhe thotë se,"Kjo nuk duhet bërë." Kështu njerëzit e marrin atë ceshtje dhe fillojnë të ndërtojnë mbi të duke thënë: "kjo nuk duhet bërë se ka thënë profeti."

Natyrisht pas vdekjes së profetit; kur profeti jeton askush nuk e dëgjon. Të gjithë ata e torturojnë atë, e mërzisnin, i bëjnë të gjitha gjërat dhe në fund ata edhe mund ta vrasin. Një ceshtje tjetër pastaj është: çdo profet ka lindur në një periudhë të ndryshme kështu duke u varur nga periudha e kohës që ai ka lindur ai flet për një problem të caktuar. Për shembull kur lindi Muhamedi, Ai e tha shumë qartë: "Ju nuk duhet të pini"; Kështu njerëzit thane: "Në rregull, ne nuk do pimë, por ne mund të pimë cigare". Kështu atij iu desh të korrigjonte veten. Ai pati thënë: "Unë jam profeti i fundit". Por zbuloi se nuk ishte kështu. Kështu ai erdhi përsëri si Nanaka për t'u thene njerëzve: "mos pini as cigare."

Kështu një person ose një grup personash që ndjekin një mishërim shkojnë në një ekstrem tjetër dhe përipiqen të rrezojnë të gjitha traditat, gjithçka që është ndërtuar deri më tani. Si të presësh të gjithë pemën dhe të fillosh me pemën tende personale. E cila është artificiale. Më pas grindja filloi kur profeti Muhamed po drejtohej në një nivel tjetër dhe më pas dishepujt e Nanakas po drejtoheshin në një nivel tjetër, ku ata thjesht mendonin se nuk kishin lidhje me njëri tjetrin. Por kjo nuk është e vërtetë.

Me vone gjithashtu ju e dini sa shume gjera te tilla kanë ndodhur në këtë botë, mund të shohim se ne çdo ringjallje që fillon, njerëzit shkojnë në ekstrem të saj dhe pastaj shkatërrohen plotësisht

Ne Krishterim ju do të shihni te ndodhin te njetat gjera, kur Krishti erdhi këtu, Ai foli për problemet me të cilat u perball. Por gjëja më kryesore Ai duhet të fliste për ringjalljen, për ngjytjen dhe Ai foli për ngjytjen. Ai foli për shpirtin dhe me ringjalljen e Tij Ai tregoi se Ai u ngjiti. Por njerëzit nuk qendruan në atë pikë. Ata kurrë nuk menduan se duhet të ngjiten. Askush nuk shqetesohet që ju të ngjiteni. Ata morën një gjë të vogël nga diku. Gjithashtu më pas erdhi një person i quajtur Shen Pauli i cili nuk kishte të bente fare me Krishtin. Ai nisi një fe të Kristianizmit e cila ishte e gjitha absurde, kundër Krishtit, anti-Krisht.



Asnjë nga këta profetë nuk ka hedhur poshte profetet që kane ardhur perpara tyre.

Tani problemi eshte se njeriu duhet te plotesohet dhe profeti Muhammed e dinte se do vinte një ditë kur ky problemi i plotesimit, permbledhjes dhe bashkimit do të vinte dhe ai foli shumë rreth Sahaja Yoges në nje fare menyre, ai tha kur ringjallja të vijë. Gjeja me e habtshme eshte se Ai foli më shumë rreth Ringjalljes se sa rreth Gjyqit te Fundit. Ne lidhje me Kyama Ai foli shumë pak. Ai foli për kohen e Ringjalljes, sepse ajo ishte problem. Ata folën rreth problemit me te cilin ata u përballën.

Ju kam treguar se si Buddha foli vetëm për Atma Sakshatkar[1] dhe jo për Zotin sepse ata njerëz që shkuan tek Zoti, ose menduan për Zotin, ose thjesht studjuan Zotin menduan se do beheshn vete Zota. Kështu ai tha, "Ju duhet të arrini Vetërealizimin."

Më pas Mahavira që foli për Ferrin ku njerëzit mund të shkojnë, sepse kjo ishte puna e tij, pjesë e saj. Këto janë aspektet e ndryshme të qënieve njerëzore te cilat ata duhet te zgjonin. Aspekte të ndryshme. Kur profeti Muhamed filloi te mësonte njerëzit për të falur Namaz-in[2] njerëzit qeshen me të. Çfarë po ben ai? Përse kërkon që ne t'i vendosim duart kështu? Përse ai kerkon te ulemi ose të vendosim duart mbi gjunjë? Tani ju e kuptoni si Sahaja Yogis-t se cfare do te thote kjo, se ai donte qe ne te permiresonim fillimisht Nabhin tonë, fillimisht Dharmën tonë. E gjithë kjo lëvizje ishte për ti dhene një hov Kundalinit, por pa qenë realizimi aty Namazi nuk do të funksiononte, edhe sikur të thyni gjunjët e të bëni çfarë të doni.

Por njerëzit ekstremiste u kapen pas saj dhe jo pas realitetit. Dhe ata bene bujë me te dhe krijuan organizata të mëdha dhe keshtu ajo u demtua. Kështu kur ai tha se Allahu Akbar duhet thënë me gishtat të vendosur në vesh, ju të gjithë thoni se nuk është keshtu? Të gjithë Sahaja Yogist -et thonë me këte gisht në veshët e tyre Allah ho Akbar. Sepse ju e dini qe ky është gishti që përfaqëson Vishuddhin dhe hyjnia chakrës Vishuddhi Shri Krishna bëhet Virata[3] me Akbar. Kështu kur doni te thoni Akbar ju duhet ti vendosni gishtat tuaj në vesh dhe duhet të thoni Allah ho Akbar.

E gjithë marrdhënia dhe çdo gjë nuk u kuptua asnjëherë. Për Indianët Shri Krishna ishte Omkara e tyre. Për njerëzit perëndimorë Krishti ishte Omkara i tyre. Për njerëzit e tjerë të Arabisë Mohammed ishte Omkara i tyre. Si mund te ndodh kjo? Ata jane te gjithe te lidhur me njeri tjetrin. Dhe se si te lidhen me njeri tjetrin eshte problemi i Sahaja Yoges. Kur ata vijne nga komunitete te ndryshme dhe ide fikse te ndryshme eshte e pamundur t'i perziesh ata dhe tu thuash "Ju jeni te gjithe nje". Per shembull te flasim per unitetin Hindu-Mysliman. Profeti Muhamed nuk e dinte qe do te kishte probleme te tilla por Nanaka ka thene ne kemi ardhur te sjellim unitetin midis Hinduve dhe Myslimanve.

Por nga jashtë nëse ju praktikoni unitetin Myslimane-Hindu apo çdo unitet, nuk do te funksionoje. Ajo nuk funksionon në marrdhëniet e jashtme. Edhe vëllai juaj nuk mund të bëhet vëllai yt, nëse funksionon nga jashte. Por nëse shpirti është i zgjuar brenda jush, atëherë shpirti është e ai qe ben lidhjen me gjithësinë me Viraten. Me Akbar. Qe Akbar te ndihet ju duhet te keni realizimin tuaj përndryshe ju thjesht jeni duke folur në ajër. Ju nuk e dini se kush është ky Akbar. Ju duhet të lidheni me kete Virata dhe kjo Virata është Qenia Fillestare. Ne në fakt jemi totalisht te shthurur sepse ne kemi mishërime të ndryshme. Edhe nese nuk jeni absolutisht ateistë, edhe nese nuk thoni qe nuk besoni në Zot ose besoni në diçka tjetër që është anti-Zot. Edhe nëse besoni në Zot, ju besoni në Zot ne fragmente, në aspekte të ndryshme te Tij, por ju nuk e shihni Atë te permbledhur ne teresi. Ju duhet të shihni se Ai është një Zot i vetem.

Çdonjeri thotë se Ai është një Zot i vetem. Natyrisht Ai është një Zot i vetem. Unë jam një njeri por unë gjithashtu jam një bashkeshorte, unë duhet të bëj punë shtëpie. Unë jam gjithashtu motra e dikujt. Unë jam gjithashtu nëna juaj dhe nëna e fëmijëve të mi dhe gjithashtu një gjyshe. Kështu unë kam shumë aspekte të ndryshme të punës që bëj. Një njeri i vetem duhet ti bëjë ato.

Kur në flasim për Zotin si një te vetem ne mendojmë se Ai është Shkëmbi i Gjibraltarit, vetëm një pjese. Edhe shkëmbi i Gjibrartarit nese shkoni dhe e shihni ate nuk eshte i perbere nga nje cope e vetme. Per asgje ne kete bote nuk mund te thoni qe eshte vetem nje cope. Ajo duhet të jetë përzierje apo perberes i diçkaje. Keshtu si eshte e mundur qe Zoti te jete vetem nje cope, duke qendruar në qiell si një cope e vetme si nje Zot qe është një, ne kete menyre ne nuk do kemi asnjë aspekt tjetër të Zotit. Zoti ka shumë aspekte te cilat ne duhet ti kuptojmë.

Kështu qe une e ndiej se ka dy koncepte të cilat funksionojnë në këtë botë. Njëra është ajo që ata besojne se Zoti është një dhe nuk mund të ketë disa aspekte të Zotit. E cila është gabim. Krishti ka thënë: "Ata që nuk janë kundër meje janë me mua". Kështu ky lloj koncepti mendon rreth Zotit, se ai është thjesht si Shkëmbi i Gjibraltarit. Shikoni tani këtë shandan që ju keni bërë - aty ka kaq shumë drita, ato të gjitha janë duke na dhënë nje drite te gjithëve ne. Ato nuk japin ndriçime të ndara, apo jo? Si jane duke u ndeshur ato me njëra-tjetrën? Cila ndeshje po vazhdon? Ato po i shtohen të njëjtimit ndriçim. Ky është një shandan por ne kemi shumë drita. Ne nuk mund tja dalim me një dritë.

Ne perjudha te ndryshme një person duhet te linde. Çdo periudhe nje njeri duhet te linde per te ndriçuar një aspekt të vetedijes dhe ndergjegjes humane. Duhet te kete shumellojshmeri sepse qëniet njerëzore janë të ndryshme. Dhe shumellojshmeria është se duke supozuar qe ju po mbështesni anen e djathte te dikujt, më pas do të jetë dikush tjetër që do vijë te mbështesë anen e majte te tij.

Dhe eshte bere e gjitha kaq mire brenda nesh, por qënia njerëzore me injorancën dhe kokefortesine e saj nuk e sheh dot. Ne të gjithë jemi bërë në të njëjtën mënyrë nëse shihni tere botën. Natyrisht ka shumellojshmeri ne paraqitjet. Ndoshta një Indian duket si Indian – por vetem në Indi ju shihni se Indianët kanë aq shumë fytyra te ndryshme. Ju mund te gjeni te gjitha ngjyrat dhe te gjithë llojet e tipareve ne fytyrat e tyre. India është i vetmi vend ku ju mund të gjeni të gjithë llojet e njerëzve. Ju mund te gjeni njerez te ngjashem me Ruset, ju mund te gjeni njerëz te ngjashem me Japonezët, Kinezët, ju mund te gjeni njerez te ngjashem me Afrikanët. Të gjithë llojet e njerëzve janë në këtë shtet për të treguar se të gjithë njerëzit mund të quhen si një racë si Indianë.

Tani nuk është gjithmonë injoranca që i bën njerëzit të harrojnë se ne të gjithë jemi një. Çdo qenie njerëzore qesh në të njëjtën mënyrë. A qesh ai në një mënyrë tjetër? Nëse ai duhet të hajë ushqim ai përtypet në të njëjtën mënyrë. Ai qan në të njëjtën mënyrë. Kur ai qan e qara e tij është e njëjtë. Veprimet e tij janë në të njëjtën mënyrë. Nëse një grua është e mërzhitur me burrin e saj..... dje pashë programin (ëmri) me vëllain tim dhe u habita se sa universal jemi ne në shprehitë tona. Ai tregonte se si një grua nervozohet me burrin e saj dhe se si silllet ajo. Nëse ju i shihni këto veprime të cilat janë të përsëkrutuara ju do të habiteni sepse ato behen nga të gjitha gratë ne te gjithë boten. Dhe reagimi i burrave nëse doni ti shihni të gjithë burrat reagojnë në të njëjtën mënyrë.

Burri im ishte sekretar i Shastriji. Ju e dini që ai shkoi me Lal Bahadur Shastri në Tashkent herën e tij të fundit, por ai gjithashtu shkoi një herë në Jugosllavi dhe atje gruaja e Gjeneralit Tito, u miqësua shumë me Znj. Shastri. Të dyja ishin shumë mike. Kështu Shastriji e paralajmëroi gruan e tij: "Shiko! Ju jeni shoqe të mira por tani mos fillo të qash si një grua Indiane kur te largohesh." Kështu e shkreta ishte duke kontrolluar lotët e saj gjithë kohës. Por ajo më tha Mua: "Unë po e kontrolloja veten por ishte ajo që filloi të qante shume, shumë. Dhe më pas filloi të qantë me zë të lartë, duke më përçafuar. Kështu unë nuk e kontrollova me dot veten. Unë gjithashtu u dorëzova, dhe fillova të qaj. Dhe të dy bashkshortët filluan të shihnin token"

Kështu në themel të gjitha gratë, të gjithë burrat në botë reagojnë në të njëjtën mënyrë në një situatë. Dhe mund ti shihni reagimet e tyre shume qarte dhe kur behet fjale per femijet. Ata të gjithë veprojnë në të njëjtën mënyrë.

Të supozojmë se ata dëgjojnë se dy fëmijë i kane kapur diku ose diçka po i ndodh atyre. E gjithë bota do të shqetësohet se si ti shpëtoje. Duhet bërë diçka për ti shpëtuar ata. E gjithë bota do ti lutet Zotit: "O Zot të lutem shpëtoji këta dy fëmijë që i kane kapur." Te gjithë do shqetësoheshin sikur të ishte vete femija i tyre atje. Edhe kur behet fjale per vdekjen unë kam parë qe, kur pati një turbullire ajrore, avioni po ulej dhe njerëzit ishin të shqetësuar se ata mund të mos shpetonin, une e di se në çdo masjid, në çdo tempull, në çdo kishë, kudo, ata vertet ishin Amerikanë; askush nuk mendoi për Amerikanët, çfarë feje kane apo gjera te tjera. Për ata ishin një pjesë e qënieve njerëzore. Lidhja njerëzore filloi të veprojë. Në atë kohë ata kurrë nuk menduan se te çfarë shteti ishin, se çfarë Amerikanët u kishin bërë Indianëve, asgjë të tillë. Ata Thjesht menduan: "Oh Zot të lutem shpëtoji ata". Te gjithë u lutën për ta, iu lutën Zotit, dhe u lutën për ta, që ata të shpëtonin.

Në atë kohë çfarë na kishte ndodhur? Si harruam? Ne prekëm realitetin në atë kohë dhe kaq. Kur Hebrenjtë perndiqeshin nga Hitleri, simpatia e çdokujt ishte me ta. Por kur këta Hebrenj filluan të sulmonin Myslimanet më pas simpatia e çdokujt ishte me

Myslimanet. Atëherë pse nuk i mendoni të gjitha fetë? Edhe Hebrenjtë paten simpati për Myslimanët. Atehere ne nuk menduam se çfarë ndryshimi kemi me ta. Askend prej njerëzve nuk dëgjova të thotë: "Shume mire po ua bejne". As Hebrenjtë. Kështu pjesa që është brenda nesh e cila është humane bëhet absolutisht e shqetësuar kur ne shohim disa qenie njerëzore të tjera që torturohen.

Natyrisht nëpërmjet këtyre ideve të tmerrshme të fanatizmit ose ndoshta frikë ose ndoshta agresivitet ose çfarëdo që të jetë, ne mund të përpiqemi të jemi të ashpër. Nëse pyesni gjermanet se si ndjehen për masakrën, ata ulin kokën. Ata thonë: "Nuk e dimë. Nuk kemi qene ne vete. Nuk e dimë se si e bëmë. Nuk e dimë se si ndodhi." Kështu kur dhuna ka marre fund, thjesht filloni të ndjeni: "Oh Zot, unë jam një qenie njerëzore, ata ishin qenie njerëzore." Kështu ky unifikim hyn brenda, ndjenja e ndërgjegjshmërisë hyn brenda. Nuk ndodh kështu tek kafshët. Nëse ata duhet të punojnë, nëse ata duhet të bëhen aktivë, ata rrine bashkë por nëse dicka vdes ata nuk bezdisen. Edhe nëse pjella e një majmuni është sëmurë nëna shqetësohet për të. Ajo do të ulërasë, bërtasë, por nëse kelyshi ka ngordhur ajo thjesht do hedhe tutje pjellën dhe do ngrihet. Janë vetëm qeniet njerëzore që kanë ndjenjën e unitetit.

Kështu ndërgjegja jonë... kjo na është dhënë neve nëpërmjet ardhjes së Shri Krishna. Ai na dha ndërgjegjen njerëzore, ose Ai e mban atë ndërgjëgjje brenda nesh. Ne duhet ta pranojmë Atë si një person që na jep neve ndërgjegjen e marrdhenies humane.

Dhe kurdo që kanë ndodhur probleme si dikush që më tregoi se ne [SOMNAT] njerëzit besojnë se Shri Krishna erdhi si profeti Muhamed për të dhënë mësim. Shumë Hindu besuan se ishte Shri Krishna që erdhi si profeti Muhamed për ti dhënë një mësim këtyre Brahminëve të keqinj të cilët po fitonin para prej këtij tempulli. Shumë Hindu besuan se, për të dënuar këta Brahminë të keqinj që po fitonin para ai duhej të vinte si profeti Muhamed për të thyer këtë idhull i cili po u jepte këtyre shumë para dhe ata po bënin të gjitha llojet e zhvatjeve nga të devotshmit e varfër të cilët ishin të devotshëm ndaj atij tempulli. Vetem ai mund ta bente kete.

Kështu ne duhet të kuptojme se kur ne nuk jemi të shkrirë ne nje, ne nuk mund ta ndjejmë shkrirjen e qënies sone. Ne nuk jemi të shkrirë ne nje, kete duhet ta kuptojme. Mendja jonë punon në një menyre, zemra jonë punon në një rrugë tjetër, mëlçia jonë punon në një rrugë tjetër. Siç ju a thashë jam tepër e habitur që kur ata na thane: "mos pini", ata njerëz që ndjekin këto fe vazhdojnë te pinë.

Por përveç asaj feje harroje atë. Duke shkuar në pijetore, ata shohin një burrë duke dale duke u lekundur e duke u rrezuar, ata perseri hyjnë brenda për tu gjendur në të njëjtën situatë. Pse? Sepse mendja u thote atyre te mos e bejne, mendja thotë: "Mos shko!", truri thotë: "Mos shko!" por zemra e tyre është e dobët. Ata nuk munden ta kundërshtojne ate.

Veset. Të gjitha veset vijnë nëpërmjet kësaj shthurrije. Ne jemi kaq të shthurur e te shperbere brenda vetes sonë, sa që nëse një person dëshiron të bëjë diçka ai bën të kundërtën e saj dhe kjo është arsyeja se pse ne pranojmë këtë lloj ballafaqimi në jetë, çfarë është treguar nga Ai për muzikën dhe për çdo gjë. Muzika ka ardhur nga dashuria e Zotit. Asgjë që nuk është për dashurinë ë Zotit nuk është muzikë.

Do ju jap një shembull. Ishte një vajze që bënte një lloj kawali dhe unë isha në komisionin e kritikës. E kritikova kawalin e saj dhe i thashë: "Kjo nuk është kawali" Ajo tha: "Pse?" Unë i thashë: "Kjo quhet [MUJARAT] Kjo është tmerrësisht e pshndjellese, eshte diçka e tmerrshme, është një fyerje ndaj Zotit. Ju nuk mund të këndonit kështu." Kështu ajo tha: "Jo, kjo është kawali.". Unë i thashë: "A e dini që kawali nuk është kënduar kurrë nga një grua dhe nuk është bërë kurrë në këtë stil të pisët në mënyrën e një prostitute siç po e këndonit ju këtë kawali?"

Gjithmomë muzika ka qene per lartësimin e Zotit. Dhe prandaj profeti Muhamed ka thënë se muzika duhet të jetë në lavderimin e lartësimin e Zotit. Kështu ne kishim diçka tjetër si [NATH] dhe të gjitha këto. Por edhe në kohën e Shri Krishnas e gjithë muzika bëhej për [RA-S]. Ra. Ra është energji. [S] do të thotë [E NJËJTË ? ]Ata po luanin bashke me Radha[4], po luanin Rasa dhe kështu ata po bënin qarkullimin e energjisë për të shkrirë veten e tyre dhe këndonin muzikë. Për këtë është.

Por ju zbuloni se njerëzit nuk e kuptojnë. Ata e përdorin muzikën për ndjeshmërinë e pshore. Është Anti-Zot. Kjo fuqi e muzikës ka

ardhur tek ne për te madheruar Zotin dhe kaq. Për asgjë tjetër. Jo për të bërë të gjitha llojet e gjërave të pista dhe për te kënduar të gjitha llojet e gjërave qesharake.

Kur Ai tha se gjithë muzika duhej te ishte në emër të Zotit, ne kemi një person si [???]... i cili nuk ishte i dhene pas asnje muzike. Ai ishte një i ri i patundur dhe Myslimanët e tjerë që erdhën nuk këndonin asgjë që është kawali ose diçka tjetër, do këndonin gazalë të keqij të cilat thjesht përshkruajne ndarjen e një gruaje dhe një burri dhe të gjitha llojet e gjërave të pista. Me keto temperamente te shthurura njerëzit u dhane pas çdo gjëje që erdhi tek ta vetem për te kenaqur veten e tyre.

Le te flasim per Omar Khajam-in. Kush është ai? Ai është nje njeri absolutisht Anti-Zot. Por njerëzit e vlerësojnë shumë. Pse? Sepse pjesa e shthurur e zemrës së tyre pëlqen Omar Khajam-in kur ai këndon: "Oh, ne duhet të pimë këtu. Çfarë ka në këtë jetë? Ne nuk e dimë se çfarë do te ketë atje". Sepse profeti Muhamed ka thënë të mos pimë, ai duhet te këndoje një këngë të tillë.

Kjo është poezia e Z. Omar Khajam, i cili respektohet shumë kudo. Dhe ai është cilësuar si një poet i madh në Iran ku sot Khomeini është një burrë i madh e i tmerrshëm dhe ai ende respekton këtë Omar Khajam; Nuk e di se si ai e respekton atë. Çfarë kontrasti që është, thjesht shikoni, çfarë kontrasti ben ky Omar Khajam qe këndon këngë të pista. Ato nuk janë për madherimin e Zotit. Muzika që nuk është në madherimin e Zotit nuk është muzikë. Është [ASHLEED]. Është ndyrësi. Është fëlliqësi.

Muzika jonë klasike në Indi është bazuar në AUM[5]. Edhe Kundalini kur arrin këtu tek vishuddhi Çakra nxjerr të gjithë tingujt:

(Shri Mataji këtu krijon tingujt zanorë të gjashtëmbëdhjetë tingujve - Kërkoj ndjesë që nuk mund të kap sekuencën e duhur të zanoreve me veshët e mi! Këto më pas janë të kopjuara nga Interneti: AM, AAM, EM, EEM, UM, OOM, RIM, REEM, LRIM, LREEM, AYE, AYEE, AO, AOU, ANG, AH)

Shri Mataji: Të gjitha këto gjashtëmbëdhjetë zanore vijnë nga gjashtëmbëdhjetë Çakra ose nën-Çakra ose petalet e këtij vishuddhi Çakra. Këto janë Bija mantras[6] të vishuddhi çakra. Të gjitha zanoret vijnë nga këtu dhe kur ne këndojmë këngë të pista e dëmtojmë këtë çakra vishuddhi.

Prandaj të gjithë njerëzit që këndojnë këto këngë të pista duhet te jepen pas pijes, sepse unë mendoj se ata nuk mund te durojne, ata nuk mund ti këndojnë këto këngë të këqija nese nuk zgjedhin një lloj arratisje totale nga Zoti. Kështu muzika dhe pija filluan te shkojne dore per dorë me njera-tjetren. Në përfundim muzika theu të gjitha traditat e saj sepse ata nuk kishin asnje ndjesi te mbetur në veten e tyre për të njohur se muzika është vetëm për Zotin. Vetëm për himnet që duhen kënduar në emër të Zotit. E gjithë muzika duhet bërë në lavdi të Zotit. Të gjitha ragat duhen bërë në lavdi të Zotit.

Ne nuk kemi sistem Namazi ne kohë të ndryshme, por ne kemi një sistem të muzikës në kohë të ndryshme. Në kohë të ndryshme një muzikë e caktuar duhet të luhet aty ku ju përshkruani një frymezim. Dhe të gjitha frymezimet që përshkruhen duhet te lidhen me Zotin. Nuk ka asnjë frymezim tjetër që është i kendshem per shpirtin që nuk lidhet me Zotin. Nuk ka asnjë frymezim tjetër qe mund te na jape kenaqesi te vertete.

Edhe Bhivatsa, frymezimi i Bhivatsa është grotesk. Edhe ai frymezim qe dike e kenaq, dikush mund të shohe ne te ndyresine dhe felliqesine. Sistemi jonë muzikor është jashtëzakonisht shkencor, sepse ai ka marrë formën e muzikës me Kundalinin duke lëvizur në Sapta Swaras të ndryshme. Këto shtatë Swaras janë ndërtuar në shtatë çakrat tona: Sa, Re, Ga, Ma – Nënë, Pa, Dha, Ni.

Edhe emri im gjithashtu fillon me Ni. Këto shtatë Swaras janë të ndërtuara me shtatë nota dhe aty ka [VRIKRUTIS. VRIKRUT Swaras] të cilat janë pjesa tjetër që ju e quani Çakra që ne duhet të bëjmë rreth dymbëdhjetë Swaras. Por askush nuk e kuptoi kuptimin e vërtetë të muzikës. [SHARADA]Përfundësia Saraswati është ajo që mban mesazhin e Viratas brenda dhe na tregon neve se si duhet të këndojmë.

Ajo na tregon se çfarë i pëlqen Zotit. Thjesht mendoni se si këto Raga janë krijuar. Sepse fillimisht ata zgjedhin notat [ARROHA] të [ROHAS] te shkuarit lart dhe poshtë, te cilat i pëlqejne Zotit. Kështu krijohen meloditë. Meloditë janë të fiksuara. Ju nuk mund të ndryshoni meloditë, notat, sepse ata zbuluan se në këtë pikë shpirti zgjohej. Tek vibrimet që ata zbuluan. Ata zbuluan se kur

ata kënduan në këtë mënyrë kjo funksionoi. Veena[7] që ata luajtën dhe zbuluan Swarat ekzakte. Swarat ekzakte te cilat do t'ju bënin vërtet të ndjeheshit mirë.

Tani ju e dini që këta njerëz që vijnë nga Perëndimi nuk kuptojnë asnjë muzikë Indiane në nivelin mendor. Por ata e kuptojnë në nivelin shpirtëror sepse shpirti i tyre mbushet me gëzim dhe vibrimet fillojnë të rrjedhin. Kuptimi i muzikës, ky përshkrim i muzikës është bërë nga Shri Krishna. Është ai që na mësoi Tala-n.

Natyrisht ne mund të themi se Shiva është Ai që kërcen Tala-n, por ai që e përshkroi atë për qëniet njerëzore i cili dha mesazhin në të gjithë botën se si Tala duhet të jetë, është Shri Krishna nëpërmjet lëvizjeve të tij vallëzuese. Ai mbajti Tala-n gjatë gjithë kohës, ashtu si vete mënyra që Ai qendron na tregon se si Ai mbajti Talën. Dhe ai luajti [MUDLHI] gjithashtu për të treguar se muzika është dashuria e Zotit. Muzika e tij na tregon dashurinë e Zotit. Kjo ju lehtëson ju. Kjo ju pastron ju. Kjo ju bën ju të lumtur. Kjo ju jep juve gëzim. Prandaj ai na e tregoi këtë nëpërmjet kënges se tij, nëpërmjet muzikës së tij. Ai kurrë nuk shkruajti poezi apo jo? Ai kurrë nuk shkruajti poezi të mirfillte, por kur ai foli, kur foli në [GUDRIA] në prozë ajo u bë Gita. Pikërisht kur ai foli kjo u bë Gita.

Natyrisht njerëzit janë përpjekur ta dëmtojnë ritmin, gje te cilën unë ndonjëherë e ndjej kur njerëzit e recitojnë, por perseri ne duhet të themi se kur Ai realisht e krijoi atë, ishte qe qëniet njerëzore të krijonin poezi prej prozës. Prej prozës. Ai e bëri atë të komunikueshme. Sepse njerëzit fillimisht mund të kuptonin vetëm muzikën, ritmin e muzikës. Ata nuk kuptonin shumë fjalë dhe gjëra por Ai e bëri atë të mundshme.

Edhe në Kuran, nëse e lexoni, pak fjalë para fillimit të cdo kapitulli askush nuk i kupton. Ato nuk janë asgjë përveçse mantra bijas, por ata e vendosën atë atje. Ata e dinin se njerëzit nuk do ta kuptonin, por Ai e vendosi atë atje sepse njerëzit do e kuptonin.

Të gjitha këto gjëra ju mund të mos i kuptoni. Ju mund të mos më kuptoni as Mua, por çfarëdo që ata bënë ishte për [HEETHA/HITHA] tuaj. Kjo është ajo që ndodhi, në kohën e Shri Krishna-s që Ai krijoi konceptin e [HEETH], sepse është thënë se ju duhet të thoni të vërtetën dhe duhet të thoni atë që është e ëmbël, Prita...

Ishte mesazhi i Shri Krishna që ju duhet të flisni ëmbëlsisht. Ata njerëz që kanë një Vishuddhi Çakra te rregullt flasin shumë ëmbël. Zëri i tyre ka metodën magjepëse për të kapur zemrën e njerëzve dhe jo ti përuli ata, por ti ngrëjë ata. Kështu Ai tha se ju duhet ta bëni këtë ëmbëlsisht. Kjo ishte tema e Tij kryesore. Ai e bëri çdo gjë kaq ëmbëlsisht sa që krijoi një Leela prej veprave të tij. Ishte një Leela ajo që bëri. Ai tha se kjo botë nuk është një vend ku ju duhet të jeni seriozë, ku duhet të jeni i mprehtë, ku duhet të jeni i tensionuar, por ajo është një Leela.

Thjesht shikoni Leela-n, dramën. E gjitha është një dramë. Pra e gjithë kjo është shumë e ëmbël. Nëse e shikoni të gjithë botën si një dramë ajo bëhet një gjë e ëmbël. Ëmbëlsia e saj, edhe nëse shikoni një person duke u përpjekur të beje ndonje prapesi, ju merrni kenaqesi prej kesaj. Nëse e dini që ajo është një dramë ju nuk mërzeniteni nëse dikush vjen dhe vret dike, sepse e dini që e gjitha është falco, është një dramë.

Është një dramë që vazhdon dhe kjo është ajo që Ai u tregoi njerëzve se e gjitha kjo është një Leela, qe njerëzit të mos merziten por të fillojnë të luajnë në dramë. Psh, ju caktoni dikë si [SWAJEMARRAS] dhe është dikush që vjen nga ana tjetër, merr një shpatë dhe me të vërtete qëllon djaloshin dhe ju thoni se ky [SWAJEMARRAS] aktor nuk është i mirë; ai përfshihet plotësisht në këte gjë dhe qëllon personin tjetër.

Pra është një dramë dhe Ai e bëri atë një Leela. Leela sepse është një dramë pa dyshim. Por kur ju realizoheni ju filloni të shikoni dramën dhe lojën, dhe ju duhet të keni parë që shumica e Sahaja Yogisteve janë gjithmonë duke qeshur, sepse ata shohin mënyrën se si gjërat janë duke ndodhur. Edhe kur ata shohin një mjeshtër guru duke u sjellë keq atyre thjesht u vjen për te qeshur me absurditetin e asaj qe ai ben.

Psh, dikush erdhi sot tek unë për të folur dhe më tha: "Nënë, kam qenë në të gjitha llojet e gjërave të pakuptimta." Dhe po qeshte. Ai tha: "Qesh tani me ato që kam bërë." Ai tha: "Unë shkova tek një mjeshtër guru i cili u vinte emra njerëzve; thuaj këtë [NAMA]

që [NAM]. Bëra disa përpjekje, shkova tek njerëzit, që rekomanduan çështjen time." Sepse ai nuk ishte shumë i pasur, kështu ai kurrë nuk bleu emrin dhe po thoshte: "Më jep emrin! Duhet të kem emrin!"

Dhe mjeshtri po thoshte; "Jo, jo, jo, jo. Ju duhet të prisni tre..." Ai tha: "Derdha shumë para në [SAIVAPITTI] e tij të cilat ishin të mëdha. Bëra gjithcka, por ai nuk po më jepte mua një emër dhe në fund kur puna u be kështu ai tha: "Në rregull, do të të jap një emër", dhe ai më dha një emër të cilin unë fillova ta marr. U bëra vërtet i çmendur pas kesaj. Fillova të ndjej dhimbje koke. Më pas ai tha: "Në rregull, ju duhet të vuani. Nëse nuk vuani ju duhet ta kaloni këtë. Ju kerkuat emrin, pra ja ku e keni."

Dhe kur ai erdhi tek Unë, ai dukej si mos me keq. Ai erdhi tek unë në një gjendje shume qesharake, por tani ai është plotësisht i shëruar. Unë madje nuk e njoha dot ditën tjetër kur e pashë. I thashë: "Oh Zot! A je ti i njëjti person?" Kështu ai tha: "Nënë tani unë qesh me të gjitha ato gjëra dhe tani po e shoh se sa budallenj jane njerëzit që shkojnë tek këta njerëz mashtrues, ndjekin ide te rreme dhe koncepte te rreme dhe se sa kot po ia fusin. Dhe ai më bëri Mua një pyetje: "A duhet ata të shkojnë në atë limit shkatërimi për të ardhur tek Ju?" Unë i thashë: "Nuk e di për ata se çfarë kanë vendosur." Por është e vërtetë se njerëzit janë kaq budallenj saqë jepen pas gjithë këtyre ideve dhe këtyre gjërave negative më lehtë se sa pas gjërave pozitive, për shkak se Vishuddhi Çakra e tyre është dëmtuar.

Nëse Vishuddhi Çakra juaj nuk është dëmtuar, duart tuaja punojnë më mirë. Shumë njerëz që arrijnë realizimin nuk ndjejnë vibrime në duar, sepse vishuddhi çakra e tyre nuk është në rregull. Tani çfarë do të thotë kjo që vishuddhi çakra juaj nuk është në rregull?

Mbi të gjitha ju nuk jeni një person kolektiv nga temperamentit. Ju nuk jeni një person te cilit i pelqen shume kolektiviteti. Si psh njerëzit që janë nazemedhenj. "E dua këtë. E dua atë. Dua të fle në një krevat te ketille. Duhet ta kem atë. Duhet ta bëj atë." Ata që kanë shumë "Unë" në veten e tyre sepse edhe egoja edhe superegoja fillojnë nga Vishuddhi Çakra. Sic e shihni, dikush që është një person egoist nuk është i aftë të shohe te mirat e kolektivitetit sepse ai është i ndarë nga pjesa tjetër e tyre. [OMKARA] e tij mbulon qënien e tij kaq shumë sa që ai nuk mund të ndjeje kenaqesine e kolektivitetit. Por me ke e shikoni Shri Krishna-n të jetojë? Me djem të vegjël. Ai ruante lopët e tij. Thjesht ruante lopet tij.

Asnjë nga këto mishërime nuk ishte i interesuar në njerëz të pasur. Ai shkoi dhe qëndroi me njerëz që ishin shumë te zakonshem nga pikëpamja e kesaj bote, atje Ai luajti dhe atje Ai bëri gjithë këto marifete ëmbëlsie. Ai vidhte gjalpin. Ai vidhte gjalpin, dhe shumë njerëz që e kritikojnë thonë: "Oh, Ai ishte një hajdut. Po, Ai ishte një hajdut. Ai ishte hajdut i hajdutëve." Dhe plot gjera te tjera thone. Ai vidhte gjalpin, sepse ky gjalpë dergohej ne Mathura nga grate për të fituar para. Dhe kjo i jepte ndihmë të gjithë këtyre rakshasave të keqinj që ishin në Mathura. Kështu qe ai nuk donte qe ky gjalpe të shkonte tek ata dhe tu jepte atyre shëndet të mirë.

Gjëja më e mirë ishte të vidhte gjalpin qe ata te mos e hanin dhe te kishin mangësi të vitaminës A dhe D, si pasoje te vuanin nga fyti dhe te mos kishin forcë në duart e tyre kur perdornin shpatat. Kështu pra kjo ishte mënyra për t'i goditur ata qe ata te mos mundeshin të luftonin forcat e te mirës.

Kështu qe me këtë Ai vërtetoi se një qëllim i lartë duhet arritur duke hequr dore nga qëllime me të vogla [HEETHA].[HEETHA] është gjëja kryesore, sepse kur Ai tha: "Mos thoni të vërtetën, perndryshe njerëzit do të lëndoheshin." Në rregull, pra çfarë duhet të bëni ju? Te mos thoni te verteten per te mos lënduar njerëzit apo te thoni te verteten e t'i lëndoni njerëzit? Pra të dyja nuk shkojnë bashkë. Sikur t'i them dikujt: "Ti je shume i keq" ai person do te lëndohej. Por nëse unë nuk ia them këtë ai person do te ishte i humbur. Pra çfarë të bëjmë?

Ai e gjeti zgjidhjen dhe tha: "[Priyam vateeth?]" Ai vuri fjalën midis si [HEETHA] .Fjala [HEETHA] do të thotë "I mirë për shpirtin tend; çfarëdo që të jetë e mirë për shpirtin tend". Nuk ka të bëjë fare me gjëra materiale. Ajo do të thotë për shpirtin tënd. Për shembull, nëse i them dikujt: "Ti nuk duhet ta bësh këtë", ai mund të ndjehet keq sot, por nëse ai kupton se: "Nëna po ma thotë mua këtë për të mirën time", ai do ta bëjë atë dhe ai do fitojë nëpërmjet asaj në [HEETHA] e tij.

Ose nëse ai nuk e bën këtë, më vonë - të supozojmë se unë nuk i them gje atij dhe nëse ai nuk di gjë për këtë, ose edhe pse ia

them ai persei nuk e ben, ai do te ndjehet keq.

Pra nuk është priya për shpirtin e tij. Nuk është priya për të. Pra nëse ju bëni diçka që është [HEETHA] e një personi, ndonjëherë ju duhet t'i thoni një personi, ndonjëherë mund të duket shumë, shumë e dhimbshme.

Diten tjetër i thashe dikujt: "Ju nuk shëroni askënd sepse ju nuk jeni i fortë mjaftueshëm për të shëruar dikë." Ai u lëndua shumë. Kështu më pas unë i thashë: "Në rregull vazhdo. Është më mirë të shërosh të tjerët, por mos u kthe tek unë." Me vonë ai do shkojë në çmendi. Por kur ai të shkojë në çmendi atehere çfarë do të thotë? A ishte kjo që thashe unë për [HEETHA] e tij? A do të nxehet ai atehere? Kështu përfundimisht nëse ju thoni [HEETHA], thuajeni. Të thuash është ceshtja. Jo ta bësh. Ta thuash. Ju thoni [HEETHA] me Vishuddhi Çakran tuaj, më pas përfundimisht ajo bëhet priya. Do të thotë që është dritë.

Pra duhet te thoni diçka që është e mirë për shpirtin. Në të kundërt mos e thoni. Por njerëzit ua thonë të tjerëve për ti korigjuar ata, sepse ata janë agresivë. Kjo duhet bërë me dashuri. [HEETHA] do të thotë "të bësh dicka me dashuri". Nëse dëshironi ti thoni diçka dikujt dhe ju e ndjeni se është e nevojshme atehere kushti i tretë është se duhet të keni [ADIKARA]. Duhet të keni të drejtën t'ia thoni atë personit. Nëse nuk e keni të drejtën me mire mos flisni. Lërjani Zotit të merret me ate pune. Ju nuk jeni përgjegjës për askënd. Por nëse keni për ti thënë dikujt dicka me dashuri dhe nëse keni një [ADIKARA] atëherë duhet t'ia thoni. Nëse ju nuk keni [ADIKARA] nuk duhet të thoni asgjë askujt deri sa të jetë absolutisht priya personit që është përfshirë në [HEETHA] e tij.

Kjo është ajo që Ai vendosi, që ju nuk duhet të bëni asgjë të paautorizuar. Sikur te me vije dikush e te me pyese: "Ku është ai personi që unë dua ta vras?" Atehere si duhet te veproj unë? A duhet ti them atij: "Në rregull, kjo është e vërteta. Shko dhe vrite atë person." Sipas ligjeve te qeverise kjo mund të bëhet. Nuk e di tamam nese behet. Nuk i kuptoj ligjet qeveritare apo ligjet njerëzore. Por kjo nuk duhet te behet. Atehere çfarë duhet t'i thoni ju atij? Ju thjesht nuk duhet te flisni. Ai nuk ka asnjë Adikara. Ai s'ka asnjë të drejtë t'ju pyesë apo të marrë këtë informacion nga ju. Thjesht mos flisni. Unë e bëj. Më pas ai mund t'ju godase, mund t'ju beje lloj lloj gjërash. Ju Thjesht thoni: "Nuk e di." Është Adikara.

Është bërë shumë herë. Njerëz që janë, të themi, nacionalistë të mëdhenj të cilët luftojnë për atdheun e tyre dhe njerëz te tjere duan të nxjerrin informacione nga ata. Ata vuajnë. Vuajnë. Por ata nuk e japin informacionin. Jo nga frika, por nga dashuria per shoket e tyre të cilët po luftojne për lirinë e atdheut. Kjo ka ndodhur shpesh në vendin tonë. Pra ju nuk duhet te tregoni diçka që nuk është [ADIKARA] e atij që pyet. Ai nuk ka asnjë të drejtë ta bëjë këtë pyetje.

Njeriu duhet te jete shume i matur dhe kjo është ajo që Shri Krishna na ka dhënë neve, maturinë e Tij. Shumë njerëz më pyesin: "Nënë, çfarë duhet të bëj unë ne kete suate? Cfarë duhet të bëj ne ate suate?" Kjo do të thotë se ai person nuk ka zhvilluar një Vishuddhi Çakra për të qenë i matur. Ai nuk ka evoluar. Ai nuk është i pjekur sa duhet.

Ai akoma më bën pyetje. Në gjendjen e Nirvikalpa[8] ju nuk duhet te më bëni asnjë pyetje Mua. Ju duhet ta dini ekzaktësisht se çfarë duhet bërë. Kur duhet t'i bërtisni dikujt. Kur duhet të jeni të qetë. Kur duhet të rri në heshtur. Kur duhet të thoni diçka dhe deri ku duhet të shkoni. Të gjitha këto cilësi zhvillohen nëpërmjet nje Vishuddhi Çakra te rregullt, sepse ju po e bëni atë për [HEETHA] e një personi tjetër.

Ndonjëherë të leverdis më shumë të heshtesh. Kete na ka mësuar ai. Jo vetëm që na ka mësuar por ai ka vendosur brenda nesh pjesën e maturisë në Vishuddhi Çakran tonë. Ai ka vendosur brenda nesh fuqinë për të dëshmuar dramën. Për të qenë të shkeputur. Ai ishte Yogeshwara[9]. Ai ishte Yogeshwara. Ai ishte Ishwara i jogës. Ishte Ai që na e dha jogen. Natyrisht, sepse Shiva është Ai tek i cili duhet arritur. Por Ai që na ndihmon është Ai. Është Akbar. Është Mahalakshmi tattwa, është rruga qëndrore që ju çon tek Shiva. Pra ai është Ai që na çon ne atje. Është ai që mbështetet nga të gjithë profetët. Ai e bën këtë të funksionojë për ju. Këtë punë të madhe të evolimit.

Kështu dikush mund ta kuptojë shumë qartë se nëse Vishuddhi Çakra jonë është në rregull, ne zhvillojmë plotësisht maturinë tone në Sahaja Yoga. Ne ndertojme një metodë nëpërmjet së cilës ne flasim aq shumë sa i bëjmë njerëzit të ndjehen priya që ata vlerësojnë, ata e pëlqejne. Priya. Është e përzemërt dhe gjithashtu ajo bën [HEETHA] e tyre.

Por ndonjëherë ju duhet të thoni dicka që është e ashpër ose ndoshta heshtja juaj i bën ata të ndjehen pak të ashpër. Nuk ka rëndësi. Ajo do t'u japë atyre në fund [HEETHA] e tyre. Kështu qëllimi perfundimtar është [HEETHA] Kjo është ajo që Krishna kishte në mendjen e Tij për të bërë [HEETHA]. Kështu Samhara Shakti e tij te cilën Ai gjithashtu e kishte, vrasjen. Shumë njerëz e kritikojnë Atë për këtë. Si Jainet për shembull.

Në kohën e Shri Krishna Ai kishte një kushëri të quajtur [NEMINATH dhe NEMINATH] nuk ishte Shri Krishna. Ai ishte Thjesht një qenie njerëzore e zakonshme i cili kishte arritur disa nivele në evolucion. Ai u mbush me një lloj ndjenje refuzimi rreth vrasjes së kafshëve. Natyrisht të vrasësishëm nuk është një gjë shumë e mirë, por ai nuk po vriste dhe kjo duhej bërë për martesën e tij. Kështu ai zhvilloi një ndjenje të fortë rreth kesaj gjeje sa filloi një gjë të ndryshme nga Jainizmi i vërtetë. Një lloj rruge tjetër, në të cilën ai tha se kafshet nuk duhen vrare.

Kjo punë u bë aq qesharake, sa arriti në një fazë ku pleshtat u bënë më të rëndësishëm se qëniet njerëzore, madje dhe mushkonjat ishin më të rëndësishme. Ju i shikoni ata njerëz duke ecur me këtë gjënë që u mbulon fytyrat. Plot e plot gjera të pakuptimita. Ndersa Shri Krishna ju jep maturi dhe kjo ishte shumë, shumë, shumë, shumë, shumë, shumë e rëndësishme sepse të gjitha problemet tona të shthurrjes zhduken kur ne kemi maturi.

Por në të shumtën e rasteve njerëzit nuk e kanë vishuddhin e tyre në rregull. Në njërin anë është një vishuddhi e djathtë e cila na jep neve agresivitet. Me të folurën tonë në sulmojmë të tjerët. Shumica e politikanëve e kanë këtë lloj kapaciteti. Ja psh Hitleri. Ai mësoi se si të mbizoteronte ndërgjegjen e njerëzve nga disa lama Tibetianë të cilët ia mësuuan të gjitha keto hile të pista. Ai mundi të vendoste disa shpirta të atillë brenda tyre, sa që ata vranë mijëra dhe mijëra dhe mijëra dhe mijëra qenie njerëzore.

Vishuddhi i majtë është një problem tjetër. Njerëzit me probleme në vishuddhin e majtë gjithashtu nuk kanë një ndjenje kolektive sepse ata janë të frikësuar nga të tjerët. Ata shohin gjithmone anën negative të një personi tjetër. Unë kam parë njerëz që vijnë dhe më thonë rreth çdo Sahaja Yogi: "Ky Sahaja Yogi është në gabim. Ai Sahaja Yogi është në gabim. Edhe ai tjetri...." Asnjë gjë e mirë nuk u terheq vëmendjen. Ata shohin vetëm gjërat negative. Kështu ata nuk kanë ndjenja kolektive. Ata kanë gjithmonë frikë. Gjithë kohës ata kanë frikë nga të tjerët sepse ka diçka brenda tyre që i frikëson ata. Pra ata e kanë Vishuddhin e tyre të majtë shumë keq të kapur sepse ata janë fajtorë. Veçanërisht në Perëndim, ju do të habiteni, të cilët janë njerëz shumë agresivë. Ata kanë një vishuddhi të majtë të tmerrshëm, sepse ata me veprat e tyre, ndërtojnë një faj të madh brenda vetes së tyre. Ata shohin se si janë sjelle. Se si është sjelle populli i tyre. Se si është sjelle shteti i tyre.

Ata zhvillojnë një faj të madh në mendjet e tyre. Për më tepër, ashtu siç ju tregoi Brajani, rrënjët janë të prera dhe ju filloni të silleni në një mënyrë anti-Zot pa vënë re që ajo është absolutisht e gabuar. Është e vërtetë. Vishuddhi i majtë shfaqet sepse ata ndjejnë faj, përveç gjërave që bëjnë gabim me idenë që po bëjnë gjënë e duhur. Ata ndjejnë faj sepse ndërgjegjja e një personi e perpunon dhe pak nga pak e ben pjese te se pavetedijshmes dhe faji grumbullohet megjithëse ju mund ta mohoni këtë, por ana e majtë vazhdon të bllokohet, dhe ata kanë një Vishuddhi të majtë të demtuar.

Kështu dikush do të thotë: "Nënë, unë nuk jam fajtor". Është një anë tjetër e egos ku reagimi i egos fsheh veten e tij në Vishuddhin e majtë. Dhe për këtë arsye ata fillojnë të ndjejnë faj: "Nuk duhej ta kisha bërë atë." Të dyja qëndrimet janë të gabuara. Kur ju jeni në anën e majtë ju sulmoni dhe torturoni veten tuaj dhe kur ju jeni në anën e djathtë ju torturoni dhe sulmoni të tjerët. Kështu të jeni në qendër është e mundshme vetëm nëse Vishuddhi çakra juaj është në rregull. Në të kundërt nuk mundeni.

Ju keni parë shumë njerëz kur ata arrijnë realizimin por nuk ndjejnë vibrime njësoj në të dyja duart. Arsyeja është se ata nuk kanë balancë. Ajo duket tek duart. Ata nuk kanë balancë. Duart kanë rëndësi shumë të madhe tek qëniet njerëzore pas Sahaja Yoga-s. Nëse duart tuaja nuk kanë vibrime të barabarta, atëherë ka diçka që nuk shkon me ju.

Cilado anë që s'ka dridhje, të themi, nëse ana juaj e djathtë nuk ka dridhje ose ndjeni që ana e djathtë është e rëndë, ose është e nxehtë, atëherë definitivisht ju jeni person i anes së djathtë. Në raste të tilla ana e majtë mbase është absolutisht e mpirë. Njerëzit që kanë anën e majtë të mpirë do të thotë gjithashtu se janë njerëz të anes së djathtë. Ose nese keni shume vibrime ne



doren e majte dhe ne doren e djathte nuk keni fare, edhe kjo domethene se jeni nje person i anes se djathte. Dhe nese ju ndodh e kunderta atehere jeni nje person i anes se majte.

Kjo do të thotë se tek ju nuk ka balance. Duart tuaja thonë se duhet të ketë balancë. Kështu ju duhet të dini se ju nuk do të dilni prej telasheve vetëm duke medituar në Sahaja Yoga ju duhet të punoni me duart tuaja.

Siç ju thashë ju nuk mund të ngisni makinën vetëm duke menduar, ju duhet të përdorni duart tuaja. Ju duhet të përdorni duart tuaj me dijeni te plote se ku jeni, çfarë jeni dhe se çfarë këto dridhje duan të thonë. Ju duhet të përdorni duart tuaja. Tani kur ju filloni të përdorni duart tuaja për të gjitha qëllimet praktike njerëzit e tjerë mund të fillojnë të mendojnë: “Këta njerëz janë çmendur. Ata po përdorin duart e tyre.” Por të njëjtën gjë menduan edhe kur profeti Muhamed i mësoi ata të përdornin duart. Ata të gjithë qeshën me Të por tani asnjë njëri nuk është i turpëruar prej kesaj, askush nuk qesh me të por ata janë duke e bërë gjithcka ne menyre mekanike, jo në menyren që tha Ai.

Pra fillimisht përdorini duart tuaja për qëllimin tuaj vetjak. Për veten tuaj. Këto duar mund t’ju ndihmojnë. Tani Kundalini është zgjuar, pra ai është duke kaluar në të gjitha qendrat në një rrugë shumë të hollë ndoshta, por ai është atje. Pra në fillim ngriheni atë sa më shumë. Ju mund ta bëni atë me duart tuaja. Kur duart tuaja ngrihen ajo fillon të rrjedhe më shumë në duart tuaja. Vetëm duart tuaja mund ta ngrejnë atë. Ajo fillon te rrjedhe në duart tuaja duke ju dhënë një Bandhan ose nje ngritje te vetes tuaj, nje ngritje te Kundalinit tuaj. Mësojini të gjitha këto metoda me kujdes.

Duart tuaja janë shumë të rëndësishme. Nëse duart tuaja nuk funksionojnë, tregoni kujdes per kete. Ju duhet të ndjeni vibrimet në duart tuaja që të filloni. Disa njerëz që kanë pasur probleme me duart e tyre, për shkak të jetës së tyre të mëparshme, ata i ndjejnë çakrat në vëndin e tyre. Pas ca kohe ju do filloni t’i ndjeni chakrat tuaja në tru. Nuk ka rëndësi. Ju kurrë nuk do ndjeni ndonje bezdi prej kesaj. Ju do jeni të aftë ta kontrolloni. Pas kesaj ju nuk do keni nevojë t’i ndjeni fare çakrat. Ju nuk ndjeni asgjë. Ju thjesht thoni; “Kjo ishte.” Mbaroi. Ata thjesht e dinë që edhe “dija” vjen nëpërmjet vishuddhi-t tuaj dhe ju thjesht e thoni atë, përsëri e thoni atë.

Funksioni më i rëndësishëm i Vishuddhi Çakra-s është se ajo duhet të jetë e pastër sepse nëse ju duhet të thoni mantrat Vishuddhi juaj duhet të jete i paster. Të gjitha mantrat duhet të kenë ndihmën e Vishuddhit. Kur një mjeshtër guru jep një mantra, gjëja e parë që ju zbuloni eshte se ai do të ketë një Vishuddhi të majtë të bllokuar, çfarëdo lloj çakre që mjeshtri ka goditur. Por fillimisht do të jetë në Vishuddhin e majtë prandaj për këtë ne përdorim mantrën e [MANTRASIDDHI]

[MANTRASIDDHI] i vjen një personi kur Vishuddhi i tij është në rregull në të kundërt ai nuk mund të jetë [MANTRASIDDHI]. Çfarëdo lloj mantrë ata të thonë është e gjitha mekanike. Vishuddhi juaj i majtë duhet të jetë në rregull nëse ju duhet të thoni mantrat në mënyrën e duhur për t’u bërë efektive, për të pasur Çakrat të ndriçuara. Edhe Allahu Ekber nuk ka asnjë kuptim nëse vishuddhi juaj i majtë nuk është në rregull.

Pra ju do të shikoni se sa i rëndësishëm është Vishuddhi i majtë ne Sahaja Yoga dhe se sa i rëndësishëm është Vishuddhi i djathtë per vibrimet. Pra Vishuddhi Çakra luan një rol të rëndësishëm në Sahaja Yoga sepse ajo ju lidh ju me Viraten, me të gjithën. Me të gjithë Akbarin. Ju lidheni me Të. Raporti vendoset nëpërmjet Vishuddhi Çakra-s dhe ju mund ta ndjeni atë.

Edhe nese duart tuaja janë të prera, perseri ju mund ta arrini realizimin tuaj. Shumë persona e arrijnë atë. Por nëse ju nuk i keni duart të plota, atëherë komunikimi është i dobët. Më pas ndoshta në chakrat tuaja ju do filloni të zhvilloni komunikimin më vonë. Por kjo është rruga më e lehtë për të ndërjerë komunikimin në duart tuaja, nëse duart tuaja janë të ndjeshme.

Pra problemi eshte se çfarë duhet të bëjmë ne për ta mbajtur ne rregull Vishuddhi Çakrën. Më thanë se duhet ta kisha mbaruar leksionin tim shpejt dhe të largohesha sa me pare, por mendoj se duhet ta mbaroj këtë sot rreth Vishuddhi çakre-s. Çfarë duhet të bëjmë ne që ta mbajmë Çakrën Vishuddhi në rregull? Të vjedhim gjalpe dhe ta hamë atë. Ju duhet të hani gjalpë sepse ai ka vitamin A dhe D veçanërisht. Vitaminën D veçanërisht. Kështu qe kalciumi rritet në trupin tuaj. Pra ju do të bëheni një njeri i fortë.

Nëse ju merrni kalcium thjesht pa ngrënë gjalpë atëherë ka një problem. Pra përpiquni të merrni gjalpë kurdo që keni problem te

vishuddhi çakra, për anën fizike. Ju mund të merrni pak gjalpë në ujë, në ujë të nxehtë, shpërndajeni atë dhe merreni. Vishuddhi Çakra kujdeset për anën freskuese.

Sepse mëlçia kur është e nxehtë, jep nxehtësi dhe trupi nxehet. Dhe e vetmja gjë që e freskon atë është Vishuddhi Çakra dhe kur ju keni një problem me tharjen e qelizës epiteliale, atëherë gjëja më e mirë është të merrni pak gjalpë në ujë, ose të hani pak gjalpë gjatë verës. Por pa karbohidrate në të. Pa karbohidrate. Atëherë ju nuk do të shtoni në peshë. Hani sa të doni gjalpë. Ju nuk do të shtoni në peshë. Nëse ju rreshtni së ngrëni karbohidrate plotësisht ju do të keni absolutisht [Satvikraharya]. Ju nuk duhet t'i prekni karbonhidratet dhe ju do të habiteni kur të keni [e njëjta fjalë sanskritisht].

Merrni gjalpë dhe proteinë. Merrni të gjitha yndyrnat, kremërat, çdo gjë. Asgjë e keqe nuk do t'ju gjeje. Ju mund të merrni si proteine të gjitha frutat e thata, çdo gjë dhe merreni vetem mjaltë për ëmbëlsirë. Asnjë karbohidrat. Por këto ditë siç e dini mjaltin po e bëjnë nga sheqeri. Pra nëse ju mund ti shmangni karbonhidratet dhe të merrni vetem këto gjëra shëndeti juaj do jetë në rregull. Por ne kemi pacientë. Ne kemi të gjitha llojet e mosbalancimeve. Prandaj them, "Në rregull, nëse keni një mëlci merrni sheqer."

Por nëse e lini sheqerin kjo nuk do t'ju ndihmojë. Në fillim duhet të rregulloni mëlcinë tuaj dhe më pas mund ta ndaloni sheqerin me lehtësi. Asnjë problem. Por jo përpara kësaj. Sic thonë të gjithë doktorët në përgjithësi: "Mos hani sheqer." Yndyra del jashtë trupit thjesht duke bere lubrifikimin e trupit, butësinë, dhe del jashtë trupit. Nuk qëndron sepse nëse nuk ka karbohidrate nuk mund të mbetet në trup.

Mund ta shihni në shtëpi. Vendosni pak gjalpë në duart tuaja. Në rregull? Dhe lajini ato. Nuk do të lahet. Gjalpi do të ngjitet atje. Nuk do të ketë asnjë efekt, asgjë, por thjesht do të ngjitet atje. Nuk mund të konsumohet. Por nëse vendosni pak karbonhidrat të themi pak ....ose diçka tjetër, ju mund ta hiqni. Ajo tretet. Nuk mund të tretet nëse nuk merrni karbonhidrate. Por kjo është për njerëzit që nuk kanë mosbalancime në trup, që janë persosmerisht në rregull, ata mund ta bëjnë atë. Unë mund ta bëj por nuk më lejoni askush. Te gjithë më ushqejne njesoj si te isha një kosh plehërash.

(Qeshje) Njerëzit kembengulin te me japin te ha shume gjera, duke u perpjekur te me kenaqin ne kete menyre. Une nuk kam nevojë për këtë në fakt. Njerëzit duhet ta kuptojnë natyrën time. Unë thjesht ha pak. Kaq me mjafton. Nuk është nevoja që unë të ha fare karbohidrate. Nuk kam nevojë për karbohidrate. Por njerëzit me thonë: "Nënë unë e kam bërë këtë. Të lutem merre. Nënë unë kam bërë këtë laddhus. Të lutem merre. Nënë unë kam bere.." Kështu unë them: "Në rregull, tani une duhet të vuaj qe t'ju bej qejfin juve".

Kjo është shume e thjeshte per ta kuptuar, ju nuk duhet të më detyroni të ha. Fare. Nuk është nevoja të më detyroni. Mos detyroni askënd të hajë, megjithëse unë detyroj ca njerëz te hanë sepse e di që ata kanë nevojë. Por ju nuk mund ta bëni atë. Ju nuk keni maturi. Kur te keni maturi, se kë duhet të detyroni dhe kë nuk duhet të detyroni, atëherë në rregull. Gjithashtu kur ju të detyroni dikë duhet të dini se ushqimi duhet të mbarte vibrime. Nëse nuk është ushqim qe mbart vibrime dhe ju e detyroni personin ta haje, ai do të ketë shqetësime.

Tani për të gjithë ju që të kuptoni rëndësinë e Vishuddhi Çakra-s, gjëja e parë dhe më kryesore eshte qe kur flisni, te flisni rreth Sahaja Yoga-s dhe asgjëje tjetër. Kam njohur shumë Sahaja Yogiste që janë ende anëtarë të kësaj organizate, anëtarë të asaj organizate, anëtarë organizatash te keqija që janë anti Zot. Le te themi tani për shembull që organizata Hari Rama Hari Krishna është anti Krisht, anti. Natyrisht është hapur fare anti Krisht dhe në kuptimin e vërtetë është anti Krishna. Absolutisht anti Krishna. Çdo person që shkon atje dhe lyp në emër të Zotit ka një vishuddhi të keqe dhe ata të gjithë vuajnë përfundimisht nga shqetësime të Vishuddhit; cancer, etj, dhe vdesin.

Dhe fytyra e një personi që ka një Vishuddhi të mirë është e celur, e gjerë, e plote si një hënë e plotë. Dhe nëse ju keni një fytyre e cila është e vrenjtur do të thotë që vishuddhi juaj nuk është në rregull. Nëse Vishuddhi funksionon atehere duhet të ketë nje skuqje te lehte në fytyrë. Fytyra duhet të jetë e plotë, e ushqyer dhe rrezellitese. Dhe sytë duhet të jenë plot shkelqim sepse Vishuddhi çakra kujdeset për syte. Kujdeset për qafën. Kujdeset për veshët. Kujdeset për hundën. Nëse Vishuddhi Çakra juaj është e demtuar ju keni probleme më të gjitha gjërat E.N.T.

Pra ata mendojnë se po bëjnë Hari Rama Hari Krishna. Në fakt ata janë duke bërë aktivitete absolutisht anti, anti Krishna. Absolutisht. Ju nuk keni asnjë të drejtë të thërrisni emrin e Krishnas në këtë mënyrë, si të çmendur, duke qëndruar përpara të gjithë njerëzve të veshur me këto gjëra të tmerrshme të dhoti dhe kurtas të cilat janë të bëra absolutisht në një mënyrë shumë qesharake. Ata nuk e dinë se si ta veshin atë, gratë që veshin sarin e tyre dhe burrat që blejnë këto [BHODIS] dhe i vendosin ato në koke dhe që rruajnë koken.

A e rruante Krishna kokën? E ka rruajtur ndonjëherë kokën? Koka, flokët janë në fakt pjesë e dhuntisë së Krishnas. Perkundrazi, flokët e Tij përshkruhen gjithmonë. Gjithmonë të përshkruara në poezi. Është një histori rreth një poeti të madh Jordanez i cili ishte me origjinë Indian, i cili ishte Hindu, por poeti Jordanez dhe disa fanatikë e sfiduan atë. Pra ata i thanë atij: "Përfundoje këtë." Dhe ai tha: "[FJALË JORDANEZE]"

Pra ai e përfundoi atë kështu: "[FJALË JORDANEZE?]" Flokët e tij janë të përshkruara në çdo poezi. Këtu ata po rruajnë koken, vendosin këto [BHODIS] në koke dhe sillen perqark. Kur ka pasur Krishna kokë të rruar? A ka pasur ai kokë të rruar? Ai është Yogeshwara me gjashtëmbëdhjetë mijë gra, do të thotë gjashtëmbëdhjetë mijë fuqi. Ai nuk i vinte Sahaja Yogistet te punonin jashtë, kështu që ai i mori ato si gra. Ato ishin të gjitha yoginis brenda. Ai krijoi gjithë këtë dramë dhe Ai i mori ato si gra sepse një burrë, nëse ai ka ndonjë grua si dishepull, atëherë ai fajsohet natyrshëm dhe si një burrë ai duhet të ketë pushtet mbi gratë. Gratë janë gjithmonë fuqia - shakti. Pra ato erdhen si gratë e Tij dhe Ai u bë burri i gjashtëmbëdhjetë mijë grave dhe pesë Ranis. Ai ka pasur pesë elementët brenda tij. Ai i luajti të gjitha marifetet. Ai krijoi...ju, ju, e ku dini gje ju rreth Tij? Sa larg mund të shkoni ju për ta kuptuar Atë?

Pra këta njerëz përipiqen të thërrasin Shri Krishnën çdo moment, çdo minutë, duke qëndruar nëpër rrugë dhe duke u lypur në emër të Tij. Në të gjitha vendet duke lypur si lypsarë. Krishna nuk e duronte dot fare lypjen. Kurrë. Ai besonte në pasjen e se drejtes për dicka. Ai më mirë vidhte se sa të lypte. Gjithë këta lypsarë të krijuar në emër të Zotit.

Unë mendoj se është një nga mëkatet më të mëdhaja të lypesh në emër të Zotit. E kam parë këtë të ndodhë përpara tempujve dhe mendoja; "Përpara tempullit përballë Zotit të qëndrosh dhe të lypesh. Të bëhesh një fakir do të thotë të lypesh. Çfarë është kjo? A është kjo shenja e një [BASHA]. Shri Krishna ishte një [BASHAWA] Yogeshwara dhe këta lypsarë, a janë këta ndjekësit e Shri Krishnas?" Gjëra të tmerrshme. Ata duken kaq të mjere dhe janë tamam si lakra dhe shumë njerëz mendojnë se ata janë në paqe. Natyrisht nëse ju jetoni në një [SMASHANA] ju jeni në paqe, në një gjendje të vdekur.

Dhe vendi ynë, i cili është një vend i varfër, mban të gjithë lypsarët këtu. Gjithë te pasurit tane u kanë dhënë atyre para dhe toka. Pse, në kurrizin tone do të jetojnë këta lama që na zbresin nga kushedi se ku?! Të gjithë njerëzit që nuk mund të punojnë. Shumë këndshëm të vish këtu dhe të thuash: "Hari Rama hari Krishn", të lexosh Gitën dhe të thuash disa fjalë permendesh dhe fiton jetesën tënde këtu, dhe një jetesë të mire.

Në çdo fshat gjen një ose dy që rrinë ulur e lypin. Mund ta besoni këtë? Dhe qeverinë tone nuk e bezdis kjo gje, për të zbuluar se kush janë këta njerëz, pse kanë ardhur këtu? Pse ata lypin në këtë mënyrë në emër të Zotit? Pse te mos i mbledhin ata dhe ti ndihmojnë në vend që ndihmojnë këta njerëz të ndyre?

E shikoni pra që njerëzit bëjnë aktivitete anti Zot dhe aktivitete anti Krishna. Kur ju e perdorni kot emrin e Zotit, Vishuddhi bllokohet. Kam njohur njerëz të ulur "[WARGURU WARGURU WARGURU]". A është se profeti Nanak është kaq i rendomte sa që duhet të vazhdojmë të marrim emrin e Tij "[WARGURU WARGURU WARGURU] Ata do marrin [MALA] në duar gjithë kohës. Ç'është kjo punë kështu? Çfarë e kujtoni Zotin ju? Dicka që ta mbani në xhep? A mendoni se ju vihet në dispozicion kaq lehtë sa që të shkoni dhe të bëni këto gjëra? Pse?

Ju e demtoni Vishuddhin tuaj totalisht. Duhet ta kuptoni këtë. Kur... ju habiteni... Thuhet se: [FRAZË NË GJUHËN INDIANE ]"

Njerëzit perseri fillojnë ta bëjnë atë. Cfarë do të thotë [KARAKA ?]? Vishuddhi çakra. Kështu e demtoni ju vishuddhi çakran tuaj.

Kështu e dëmtoni ju chakrën kryesore të arritjes së realizimit.

Pra nëse do t'ju duhet të bëheni një me të gjithën, ju lutem mundohuni të mbani Vishuddhi çakran tuaj të pastër. Marrin te ftohte sepse në këto ditë ne Indi veçanërisht... grate kane një tendencë për të mos mbuluar trupin sepse duan te duken si moderne apo ku di une se cfare .

Kane filluar te veshin rroba te ngushta e te shkurtra. Kjo e gjitha është anti Zot në të dyja mënyrat. Fillimisht është pa kuptim të tregosh trupin tënd. Prandaj profeti Muhamed ka thënë (dhe ju e shikoni se Ai ka punuar kaq shumë per vishuddhi çakran) që gratë duhet të mbulojnë trupin e tyre. Dhe unë mendoj që është një gjë shumë e mirë.

Kjo modë e pakuptimtë ka shkuar aq larg saqë pas disa kohësh ju do të shihni të gjitha këto mushkonja duke u sjelle verdalle lakuriq. Kjo është e fundit. Kjo është një shenjë e njerëzve që nuk jane njerëz por kafshe. Sepse kafshet bejne ashtu.

Ju duhet të kuptoni që duhet të bëni kujdes për fytin tuaj. Moda dhe të gjitha këto gjëra nuk janë shumë të rëndësishme. Ajo çfarë është e rëndësishme është shëndeti juaj. Nëse ju dëmtoni vishuddhin tuaj është një gjë shumë e gabuar dhe ju duhet të kujdeseni per vishuddhin gjithë kohës dhe të gjithë ju duhet të përpiqeni të kujdeseni per vishuddhin e njëri tjetrit. Sepse mua nuk më pëlqeu ideja e të pasurit te këtij pendali këtu dhe u thashe organizatorëve që kjo ishte një gjë e gabuar. Dhe ata thanë: "Ju thatë se seminari duhet te mbahet jashte" Unë thashë: "Nuk po them të shkoni në Himalaja." Ju duhet të përdorni maturi, mase. Kjo është ajo qe mungon. Ju duhet të keni mase. T'u jepni njerëzve në mes te dimrit një vend si ky!

Duhet të them qe ju njerëz jeni kërkues të mëdhenj te se vertetes derisa keni ardhur këtu. Kjo nuk është gjeja e duhur për ta bërë. Kështu organizatorët, njerëzit që po merren me organizimin, duhet të dinë se ata duhet të bëjnë diçka për të mbrojtur fytin e njerëzve, për të mbrojtur vishuddhi chakrën.

Është shumë e rëndësishme. Shumë e rëndësishme dhe ju të gjithë e dini se sa kujdesem unë për vishuddhi chakrën tuaj; per vishuddhi cakren e te gjithëve. Sepse unë e di se sa e rëndësishme është. Sepse ajo do ju bëjë ju absolutisht të shthurur dhe do të dëmtojë të gjithë punën e Kundalinit dhe Kundalini i gJORë do të vuajë shumë. Pra eshte ne doren tone që të mbajme vishuddhi chakrën të pastër. Ne duhet te pastrojmë veten tone sic duhet, duhet te pastrojmë fytin çdo mëngjes, duhet te bejme gargare dhe duhet te kujdesemi për vishuddhi chakrën. Duket shumë e zakonshme por për një Nënë gjërat e zakonshme janë aq të rëndësishme saç jane edhe gjerat e larta. Sepse po te mos kete vishuddhi çakra çfarë dobie do te kishte të vinit ne Sahaja Yoga me një vishuddhi çakra të keqe?

Pra ju lutem përpiquni të kujdeseni për vishuddhi çakran tuaj. Mundohuni ta vendosni Yogeshwara atje. Mundohuni ta ngrini Shri Krishnan atje, përpiquni të bëheni si Ai.

Fiksojeni mire ne koke se ju jeni këtu per të dëshmuar dramën e Zotit dhe të bëheni [MURELEE] i Shri Krishna-s për të parë melodinë e bukur që rrjedh permes jush.

Zoti ju bëkoftë të gjithë ju!

Sot gjithashtu ata nuk duan qe ndonjeri të preke këmbët e Mia. Shpresoj se sot do të bindeni pa asnjë përjashtim. Dje u përpoqëm por kishte përjashtime por sot nuk duhet të ketë asnjë [FJALË INDIANE ?]. Një ditë ne nuk duhet t'i prekim këmbët e Nënës. S'ka rëndësi. Ju të gjithë mund t'i prekni nga atje dhe ka një mënyrë per t'i prekur kolektivisht këmbët e Nënës. Eshtë mënyra që ne bëjmë gjithmonë. Ju të gjithë mund ta bëni tamam tani por tani në fakt nuk kemi nevojë te prekemi, por në fakt ju jeni duke prekur. Edhe duke prekur Tokën meme ju jeni duke prekur. Thjesht prekni tokën meme dhe kaq. Thjesht prekni tokën meme dhe Kundalini do të ngrihet.

Nuk më keni bërë asnjë pyetje dhe ata që kanë pyetje duhet ti shkruajnë në letër dhe të ma japin letrën mua, sepse sapo të largohem unë ju do të thoni: "Nëna nuk na lejoji ti bënim asnjë pyetje." Une thashe që ka..... [Shpjegimet vazhdojne në gjuhën Indiane]

[1] Vetë Realizimin

[2] Lutje në Islam.

[3] Qenia e hershme e madhe. Manifestim I Zotit.

[4] Shakti I Krishnas.

[5] Fjala e shenjtë e parashtruar dhe prapashtruar në mantrat e Vedas që simbolizojnë Zotin e Plotëfuqishëm.

[6] Tinguj krijuar nga Kundalini kur ngrihet dhe kalon neper cakra.

[7] Instrument muzikor me tela i Indisë që vibron në Cakrën Swadishthan. Shri Saraswati është përshkruar në përgjithësi që mban një Veena.

[8] Vetëdije pa mendime dhe dyshime.

[9] Shri Krishna, Ishwara (Zoti) i yoga

## 1983-0204, Sahasrara Chakra, Delhi, 1983

View [online](#).

Sahasrara Çakra. Rruga Hanuman, New Delhi (India), 4 Shkurt 1983.

Sot do ju tregoj rreth qendrës së fundit, Sahasrarës...

Pra kjo qendër e fundit, Sahasrara ndodhet në zonën limbike të trurit. Koka jonë është si një pemë kokosi. Kokosi ka flokët, dhe një arrë të fortë dhe më pas një mbulesë të fortë dhe brenda është guacka e bardhë e fortë e kokosit dhe brenda hapësirës, uji. Në të njëjtën mënyrë, është ndërtuar truri ynë. Prandaj kokosi është quajtur si "Shriphal". Është fryti i fuqisë, është Shri. Fuqia Shri është fuqia e anës së djathtë dhe e anës së majtë është fuqia Lalita. Pra, ne kemi dy Cakra - e majta, këtu, është Lalita dhe ana e djathtë është Shri Cakra. Këto dy Cakra punojnë rreth anës së djathtë të fuqisë Mahasaraswati dhe anës së majtë të Fuqisë së Mahakali.

Tani fuqia qëndrore është Kundalini që duhet të ngrihet dhe të depërtojë nëpërmjet Cakrave të ndryshme, të hyjë në zonën limbike dhe të ndriçojë të Shtatë vendet e Pitave të këtyre shtatë cakrave. Pra ajo penetron përmes gjashtë Cakrave, hyn në zonën limbike, ndriçon të gjitha shtatë Pitat në tru, që ndodhen në mesvijën e zonës limbike. Pra fillojmë nga prapa, është këtu pas koke Cakra Mooladhara, rreth saj është Swadishthan, më pas Nabhi, më pas Anahatta (Zemra), më pas Vishuddhi dhe Agnya. Pra të gjitha këto gjashtë qendra janë kombinuar që të bëjnë Cakrën e shtatë. Kjo është një pikë shumë e rëndësishme që duhet ta njohim Tani, Shri Cakra punon në anën e djathtë & dhe Lalita Cakra punon në anën e majtë. Pra kur Kundalini nuk ngrihet ne bëjmë me anën tonë të djathtë aktivitetet fizike dhe mendore, kështu që truri ynë është duke kryer aktivitetet të anës së djathtë prandaj truri është si "Shriphal".

Aktualisht Sahasrara është bashkimi i gjashtë Cakrave dhe është një hapësirë boshe, në anët e së cilës ka me mijëra Nadis (nerva). Dhe kur drita depërton në zonën limbike, atëherë ndodh ndriçimi i këtyre Nadis dhe mund ti shohësh ato si flakë, flakë shumë të buta që digjen dhe këto flakë kanë të gjitha shtatë ngjyrat që shihen në VIBGYOR. Por e fundit fare, bëhet përsëri e integruar dhe është një flakë e pastër kristali. Gjithë këto shtatë drita në fund bëhen Kristal i pastër.

Pra keni Sahasrara me një mijëpetale, siç e quajmë, por nëse e prisni trurin në seksion transversal ose seksion horizontal, do jeni të aftë të shihni se gjithë këto nerva janë ndërtuar kështu përgjatë zonës limbike, të gjitha janë si petalet, dhe nëse i pret vertikalisht do gjeni aty shumë nerva në secilin grup nervi, Pra kur ndriçohet, mund ta shihni Sahasrarën si një grusht flakësh që digjen.

Është një temë shumë delikate. Kështu kur ndodh ndriçimi i Kundalinit në tru, atëherë e vërteta perceptohet nëpër tru. Prandaj është quajtur si "Sayakhand", që do të thotë të fillosh të shohësh perceptimin e së vërtetës nga truri yt sepse deri tani çfarëdo të shihni nëpërmjet trurit tuaj, nuk është e vërteta. Ajo që shihni është Thjesht ana e jashtme, të themi, ju mund të shihni ngjyrat. Mund të shihni trajta të ndryshme të ngjyrave. Mund të shihni cilësinë e gjërave. Por nuk mund të shihni nëse ky qilim është përdorur nga ndonjë shenjt. Nuk mund të thoni nëse është bërë nga djalli apo një person hyjnor. Ky zotëri, nuk mund të thoni nëse ky zotëri është një person i mirë apo djallëzor. Nuk mund të thoni nëse ky Hyjni ka dalë nga Nëna Tokë apo jo. Gjithashtu nuk mund të thoni rreth asnjë personi, që është i afërm i juaj, nëse është i afërm i mirë ose i keq apo çfarë lloj personi është, nëse rri me njerëz të mirë apo të këqinj, nëse ka lidhje me anën e mirë apo atë të gabuarën. Këtu e mira do të thotë Hyjnore. Pra aktualisht ju nuk dini asgjë rreth hyjnore në mendjen tuaj. Asgjë - është e pamundur për ju të gjykoni një person në lidhje me hyjninë e tij përveç dhe kur KUNDALINI arrin të paktën këtë pjesë, që është zona limbike. Nuk mund të kuptoni nëse një person është i vërtetë ose jo, nëse një Guru është i vërtetë ose jo. Sepse hyjnorja nuk mund të perceptohet nga truri juaj, përveç dhe deri kur kjo dritë e Shpirtit tuaj të ndriçojë brenda jush.

Tani, Shpirti është i shprehur në zemër, është reflektuar në zemër. Qendra e Shpirtit, mund të themi është Zemra. Por në fakt vendi i Shpirtit është mbi këtu, mbi kokë dhe ky është Shpirti ose mund ta quajmë Zoti i Plotëfuqishëm, dikush e quan Pavardigar, mund ta quash Sadashiva[1] ose mund ta quash Atë Rahim dhe mund ta quash Atë me shumë emra që janë përmendur nga

Lordi që është Zoti I Plotëfuqishëm Niranjan, e quajnë Nirankar, çdo lloj fjalë që fillon me "Nir", "Nihi". Tani, në çdo qendër të trupit ju merrni një lloj të ndryshëm gëzimi. Çdo qendër ka një tip të ndryshëm të gëzimit. Dhe ka shumë emra për secilin nga këto lloje të gëzimit që ju merrni në çdo qendër kur ngrihet Kundalini. Por kur Kundalini vjen në Sahasrara, atëherë gëzimi që ju merrni quhet "Niranand", Niranand "NI" nuk do të thotë asgjë më shumë se Anand (Joy). Niranand!

Për habi gjithashtu emri im është Neera, në familje jam quajtur si Neera. Dhe "Neera" gjithashtu do të thotë Mary, Marium, sepse do të thotë Marinë, Neea është ujë. "Neer" do të thotë ujë në gjuhën sanskrite. Në tru quhet "Niranand".

Dhe kjo fazë së fundmi shpaloet. Fillimisht ajo që dini është Satya, është e Vërteta - ajo nga e cila vuante një tjetër zotëri, gjë që e shihni në gishtat tuaj. Fillimisht shihni gishtat tuaj. Me vëmendjen tuaj, ju dini cilat Cakra, cilët gishta ju tërheqin vëmendjen. Atëherë me trurin tuaj mund të përshkruani cilat cakra po kapin. Sepse nëse thoni ky gisht, nuk do të thotë që është Cakra Vishuddhi. Por truri juaj mund të thotë që është Vishuddhi. Dhe ky përshkrim tregon që është duke vuajtur nga shqetësime të cakrës Vishuddhi. Por Satyakhand ose Sahasrara e shpalos veten edhe më shumë, nuk ju duhet të mendoni, Thjesht thuajeni. Më pas nuk ka më ndryshim midis Vëmendjes (CHITTA) suaj dhe të Vërtetës (SAT) suaj. Chitta e ndriçuar dhe truri I ndriçuar bëhen një. Nuk ka më asnjë problem për persona të tillë. Nuk ka nevojë të shohësh, në gishta, s'është nevoja të thuash asgjë tek gishtat dhe atëherë përshkruaje atë me tru, gjë që e keni mësuar në Sahaja Yoga që nëse gjeni dicka të gabuar aty, do të thotë Agnya- nuk ka nevojë ju Thjesht thoni Agnya. E thoni këtë dhe ajo është aty.

Më pas ajo shpaloet më shumë. Në fillim është e integruar siç e thashë me Vëmendjen (Chitta). Më pas kur bëhet tërësisht e integruar me Shpirtin, atëherë çfarëdo që të thuash, është e vërteta. Thjesht e thoni, siç është. Kjo është se si truri shpaloet në 3 dimensione. Fillimisht përshkruan të vërtetën nëpërmjet konkluzioneve logjike. Dhe më pas, kur pyet një person "A ke ndonjë problem këtu?". Ai thotë: "Po", Atëherë ju besoni tek UNË dhe më pas ju besoni, që kjo është cakra Vishuddhi, që është duke u shfaqur, është e vërtetë. Ky është konkluzioni logjik në mënyrën që ju keni eksperimentuar, ju jeni duke parë dhe akoma jeni duke dyshuar nëse Nëna thotë të vërtetën ose jo. Dhe më pas jeni I sigurtë, "Po, kështu është, ne kemi parë që kjo është Cakra Vishuddhi". Pra e vërteta bëhet logjikisht e pranueshme për këtë tru. Por akoma truri është duke punuar në nivelin e tij bruto.

Në fazën e dytë, siç ju thashë, kur ju besoni, e dini me siguri që do të thotë cakra Vishuddhi, s'ka më dyshime. Atëherë ne themi që "Nirvikalpa" ka nisur, kur nuk ka dyshim mbi Mua ose Sahaja Yogën. Por më pas shpaloet e re fillon brenda jush. Për këtë, I duhet të bëjë meditim. Me përlësi I duhet të bëjë meditim. Dhe gjithashtu më pas, për këtë dimension të ri, kur vëmendja (Chitta) juaj shkrihet vetë në trurin tuaj ose brenda trurit të ndriçuar, për këtë njeriut I duhet të dorëzohet më shumë ndershmëri dhe përlësi ndaj Sahaja Yogës.

Tani çfarë bëjmë kur kemi vibrimet tona. Ne kemi reaksione vërtet të ndryshme. Disa njerëz as nuk e kuptojmë vlerën e vibrimeve. Disa njerëz përpiqen të mësojnë se çdo të thotë. Dhe disa njerëz, mendojnë papritur: "O, tani ata janë shpirtit të realizuar, ata mund të vazhdojnë të japin realizime, këtë e atë". Ata fillojnë një udhëtim të egos. Kur nisin udhëtimin e Egos, do kuptojnë që kanë gabuar dhe që I duhet të kthehen mbrapsht, që nga fillimi fare kur e nisën. Është si loja e Gjarprit & Shkallës. Pra reagimi ndaj vibrimeve duhet të jetë shumë I përlulur, reagim I hapur.

Tani në nivelin bruto, sepse siç ju thashë që truri është ai që mban në të Babain. Kështu nëse kryen ndonjë mëkat kundër Babait, atëherë kjo shpaloet në tru kërkon kohë. Kështu ne nisim lexojmë libra. Dhe pse njerëzve u është thënë në fillim shihni vibrimet dhe më pas lexoni librat, ende ne themi "O pse gabim, ne duhet të lexojmë libra të tjerë", Ju mund të vazhdoni si gjarpri me shkallët siç ju thashë. Kjo është e gjarprit, ne mendojmë "Ç'është nevoja të bëjmë meditim, nuk kam kohë, kam këtë gjë, atë gjë" Ju nuk përparoni.

Pika tjetër që është shumë e trashë. Ka gjithashtu edhe disa njerëz trashanikë në Sahaja Yoga që hyjnë në të. Nuk ka problem. Por gjëja e parë që duhet të dini "duhet të jeni të ndershem, shumë të ndershem në Sahaja Yoga". Ndershmëria është sikur unë të kem parë njerëz. Nëse kemi një darkë, psh për një ceremoni martesë, ata do të vijnë aty pa patur vetërespekt, pa patur asnjë shenjë mirëkuptimi se kush do të paguajë për gjithë këto? Do të sjellin gjithë familjen, do vijnë e ulen. Ata janë njerëz që shmangen për të paguar paratë që duhen paguar për Sahaja Yoga. Supozojmë ata janë duke ngrënë ose janë duke udhëtuar ose janë duke ardhur nga jashtë, ata duhet të paguajnë para për udhëtimin dhe ushqimin e tyre. Dhe ndonjëherë e dini më duhet të



paguaj shumë para. Nuk ka problem, s'më vjen keq. Por nuk është mirë për ju. Gjëja kryesore është trazim për ju. Pra si silleni ndaj Sahaja Yogës derisa paratë përbëjnë shqetësim, është shumë e rëndësishme dhe pse duket dicka trashanike. Por mund të japë një shqetësim goxha të madh në shpalosje për shkak të ngërçit (infektimit) të Nabhit, dhe siç e dini nëse Nabhi kapet mund ta përhapë sipër në të gjithë Voidin: dhe nëse kapet Void, Ekadasha[2] Rudra që ndodhet këtu ngrihet si forcë shkatërruese.

Pra para se të vini në Sahaja Yoga ishte në rregull, ju ishit duke bërë gjithë llojet e gjërave dhe mundet të kishit shkuar qetësisht në ferr pa ndonjë vështirësi. Është shumë e Thjeshtë të shkosh në ferr. Me dy hedhje të shpejta e shkoni në ferr. Pjesën tjetër duhet të shihni. Por të shkosh në ferr është gjëja më e Thjeshtë, nuk ju duhet të punoni shumë apo të bëni asgjë për këtë. Por kur ju jeni duke u ngjitur, duke ngritur, atëherë është pak e vështirë. Duhet të jeni të kujdesshëm që të mos lëkundeni, të mos bini dhe që jeni duke u ngjitur. Pra duhet të jeni vigjilent ndaj vetes që nuk do të dështoni(bini) në të njëjtat zakone që keni patur.

Disa njerëz kanë zakon të ruajnë para në kurriz të Sahaja Yoga. Disa kanë zakon të bëjnë para në kurriz të Sahaja Yoga. Disa njerëz kanë zakonin e të mos dhënit të shumës së duhur, e gjëra si këto. Është si mashtrim. Të gjithë dalin nga Sahaja Yoga përnjëherë. Mund të duken liderë të mëdhenj në fillim por dalin jashtë ashtu siç ju thashë dhe shumë herë njerëzit më thonë "Pse nuk mban një llogari bankare". Por në Sahaja Yoga, nuk duhet të mbaj asnjë llogari bankare, asgjë. Sepse kontabilistët e mij janë Sahaja Yogis. Nëse përiqesh të bësh truke me Sahaja Yoga, menjëherë përjashtohesh; në vetëdijën tënde, në çakrën tënde Nabhi nuk do të kesh - mund të bësh me mijëra Rupies(para) këtu, por do të humbësh me mijëra të tjerë, mund të futesh në telashe. Do të keni gjithë ato lloj problemesh që nuk mund t'ua them dot dhe më pas do pyesni veten si e mora këtë problem. Pra Nabhi Cakra nëse nuk jeni të ndershëm në kërkimin tuaj. Ndershmëria e të kërkuarit nuk do të thotë vetëm "Unë dua të kërkoj". Ajo do të thotë gjithashtu cila është sjellja jote, ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve. Duhet të jeni të ndershëm me veten, prandaj uluni kur të meditoni, përiquni të përmirësoni Antar - Yogën tuaj, përiquni të keni Vetëdijen pa Mendime, këtë ndjenjë pamendime gjithnjë e më të gjërë. Provoni të arrini atë gjëndje ku të ndiheni vërtet pa mendime. Kështu ndershmëria jua shpërblen dhe ngriheni lart e më lart, thellë e më thellë brenda qënies suaj. Fillimisht ju vareni nga Unë që "Në fund të fundit, Nëna do të bëjë gjithcka. Kur unë shkoj tek Nëna, Sahasrara imë hapet. Ndodhi kjo e ndodhi ajo". Por sikur ju të bëni dicka që ju ndihmon të hapni Sahasrarën tuaj. Pra hapja e Sahasrarës është shumë e rëndësishme:

Tani, çuditërisht është përcaktuar që Sahasrara e ka Brahmarandhra[3] në nivelin që është, e kam fjalën në pikën ku është Çakra e Zemrës. Pra ne duhet të dimë që Brahmarandhra është e lidhur direkt me zemrat tuaja. Nëse nuk bëhet me zemër, të bërit Sahaja Yoga në mënyrë sipërfaqësore nuk mund të shkoni dot lart. Duhet të vini gjithë zemrën - kjo është gjëja kryesore. Si njerëz që vijnë në Sahaja Yoga dhe gumëzhijnë prapa, "Kjo duhet të ishte kështu, duhet të ishte ashtu", e kështu me rradhë. Këta lloj njerëzish janë siç I quan Krishti, shpirtra të zhurmshëm. Ai tha që tregohu I kujdesshëm rreth këtyre shpirtrave të zhurmshëm - ata të cilët gumëzhijnë mbrapa dhe përfitojnë, gjoja janë duke shpëtuar të tjerët. Këta lloj njerëzish gjithashtu, mund të vuajnë shumë. Sepse janë duke bërë lojë të dyfishtë. Dhe një lojë e tillë e dyfishtë është shumë e rrëzikshme kur hyn në mbretërinë e Zotit. Anëtar I kujtdo mbretërie të jesh, çfarëdo mbretërie, nëse je I pabesë ndaj saj je I ndërshkuar. Por në mbretërinë e Zotit, është kaq e hareshme, absolutisht e hareshme, gjithë lumturia derdhet tek ju, absolutisht me shëndet të plotë, mirëqënie mendore, emocionale - gjithë llojet e prosperitetit ju mund t'i gjeni në Sahaja Yoga pa asnjë dyshim. Por kur je kaq I bekuar, je gjithashtu I falur, dhe I falur dhe është një litar I gjatë që të jepet për tu kapur, dhe ti e kap tërësisht. Nuk është gjysëm ruge.

Kështu ata njerëz që mendojnë se mund të mos jenë të ndershëm me Sahaja Yoga duhet të kenë kujdes, ju lutem mos e bëni. Nëse nuk ju pëlqen të jeni në Sahaja Yoga, më mirë largohuni, është më mirë; sipas këndvështrimit tuaj dhe këndvështrimit tonë gjithashtu. Sepse në rast se jeni I pandershëm, ju po provoni të luani truke dhe lojëra, dhe do vuani do dukeni qesharakë dhe të çuditshëm; atëherë njerëzit do thonë, "Çfarë nuk shkon me Sahaja Yoga? Pra ne do vuajmë pa qenë nevoja. Sepse ne s'mund t'ju tregojmë në pasqyrë që ky njeri ka qenë vërtet I padrejtë. Nuk mund ta tregojmë këtë: pra para së gjithash do sjellë emër të keq për ne. Dhe së dyti, do dëmtoheni nga kjo lloj gjëje. Nëse ju dëmtoheni atëherë ne do të kemi një emër të keq se si mundi të ndodhë kjo. Por nëse je I ndershëm ndaj Sahaja Yoga dhe kërkimit tuaj, nuk e keni idenë se sa Zoti kujdeset për ju. Çdokush që përiqet t'ju dëmtojë do të dëmtohet shumë më rëndë dhe do largohet nga rruga juaj. Zoti ju mbron dhe kujdeset për ju me vëmendje të plotë dhe merak të madh. Ai është kaq I përzemërt sa përshkrimi I dhembshurisë së tij nuk mund të jepet me fjalë por vetëm mund të ndjehet dhe të kuptohet.

Tani problem është që njerëzit nuk janë të ndershëm për shkak të mjedit të tyre shoqëror, ndonjëherë prej edukimit, prej rritjes së

tyre ose për shkak se janë frikacakë. Por ka edhe një gjë tjetër që ju bën të pandershëm – është “Poorva-janmas” jeta juaj e mëparshme, dhe kështu ju lindni dhe krijohet Kundalini juaj.

Por pas realizimit, ata njerëz që janë me vlera të mëdha dhe forcë ngjiten kaq shpejt sa gjithë problemet e yjeve, gjithë problemet e Nakashatras suaj (Lindjes së Yjeve) etj, Konstalacionet çdo gjë zhduket dhe ju bëheni një Sahaja Yogis, që do të thotë I rilindur - tërësisht një personalitet ndryshe, nuk ka lidhje fare me atë që ke qenë. Ashtu si një vezë që bëhet një zog I bukur.

Pra ky Kundalini kur arrin këtu, pengesa e parë që ka është të hyjë në Sahasrara, është “Ekadasha Rudra”. Këtu janë 11 shakti, 11 shakti shkatërrues ndodhen këtu. Pesë nga kjo anë, pesë nga ana tjetër dhe një në qendër. Këto janë pengesa brenda nesh, ngritur nga dy tipe mëkatesh të kryera. Nëse nderojmë tipe të gabuar të Guruve dhe paraqesim veten në rrugën e tyre vicioze, atëherë zhvillojmë Rudra- probleme në anën e djathtë të dorës këta të pestë ikin. Nëse I jeni përkulur (nderuar) sepse unë nuk I përulem njeriut të gabuar, dikujt që s’është njeri I mirë dhe është Kundër Zotit, atëherë problemi vjen në këtë anë të çështjes, në anën e djathtë. Nëse keni përshtypjen se “Unë mund të kujdesem për veten, jam mësues I vetes, e mësoj vetë veten time, nuk dua të dëgjoj asnjë dhe nuk besoj në Zot, Kush është Zoti? Nuk dua t’ia di për Zotin! Nëse I keni gjithë këto ndjenja atëherë nuk ju kap ana e djathtë por ana e majtë. Sepse ana e djathtë lëviz në këtë anë dhe ana e majtë në këtë anë. Pra këto dhjetë gjëra dhe njëra është Virata Vishnu, sepse ne kemi gjithashtu në stomak 10 Guru Sthanas (vende) dhe një nga këto Vishnu. Pra edhe kërkimi është gabim, edhe 10 Gurutë janë jashtë. Më pas ju zhvilloni këtë Ekadasha Rudra. Kur kjo gjë vendoset brenda jush, siç ju kam thënë një në këtë anë dhe një në atë anë. Kështu ata njerëz që iu janë përuleur njerëzve të gabuar zhvillojnë një temperament ose një lloj personaliteti që është shumë I ndjeshëm për sëmundje të pashërueshme si kanceri e gjithë këto. Mund t’ju krijohet kancer ose gjëra të tilla - atyre që iu përulen njerëzve të gabuar.

Tani ata që mendojnë “Jam më I mirë se gjithë të tjerët. Nuk dua t’ia di për Zotin, nuk e dua Zotin, nuk më duhet fare” gjithë këta njerëz zhvillojnë një anë të majtë Ekadasha. Dhe ana e majtë Ekadasha është gjithashtu shumë e rrëzikshme. Sepse njerëz të tillë zhvillojnë probleme të anës së djathtë të atakut të zemrës, fizikisht e kam fjalën, dhe gjithë problemet e tjera të anës së djathtë. Kështu një nga pengesat më të mëdha për të hyrë në Sahasrara është Ekadasha Rudra, që vjen nga Void, dhe që mbulon “Medha”(pllaka e trurit) dhe prej kësaj nuk mund të hyjë në zonën limbike. Edhe ata që janë me gurutë e gabuar, nëse kanë arritur Konkluzionin e duhur dhe I janë dorëzuar Sahaja Yogës, duke pranuar gabimet e tyre dhe duke thënë “Unë jam Guruja (mësuesi) vetes sime” mund të shërohen. Dhe ata që kanë thënë që “Unë jam mbi të gjithë, nuk besoj në Zot, kush është Zoti, nuk besoj në asnjë profet ose çdo gjë çfarëdo gjëje kundër Zotit ose profetëve është I njëjti personalitet anti-Zot që kur flet kështu krijonë probleme. Ai bëhet mirë nëse përulet dhe pranon “Sahaja Yogën si të vetmen rrugë për të hyrë në mbivetëdijen”.

Kam parë njerëz që kanë qenë Tantrikas, dhe janë shpëtuar. Kam parë njerëz që kanë bërë gjithë llojet e gabimeve dhe janë shpëtuar. Këta njerëz që ishin anëtarë të organizatave shumë qesharake e të çuditshme janë shpëtuar. Por është shumë e vështirë të bindësh këdo që çfarëdo që janë duke bërë është gabim dhe duhet të vijnë në rrugën e duhur.

Kështu një I njohur (star) erdhi të luante pjesën e tij me Pluto, dhe doli që ky yll solli sëmundjen e kancerit sepse Pluto është ai që kuron kancer ose gjithë llojet e sëmundjeve të pashërueshme. Kështu ata njerëz që janë futur gati 90% në rrugën e gabuar, vuajnë nga shqetësime të çuditshme të zemrës, rrahje zemre, pagjumësi, të përziera (të vjella) marrje mendsh, gjithë llojet mund ta themi e parëndësishme. Është vërtet diçka serioze të shkosh dhe t’I përulesh Gurusë ( mësuesit) të gabuar. Për një person të tillë Sahasrara bëhet një zonë e mbyllur. Personat që janë kundër Sahaja Yoga, kanë një Sahasrarë shumë të fortë, si një arrë, në kuptimin që është një guackë e fortë të cilën nuk mund ta thyesh - lëvozhgë e fortë si një arrë e fortë. Edhe sikur të duash të përdorësh një çekiç, nuk mund ta thyesh. Sot ka ardhur koha që ju të njihni Sahaja Yogën, duhet. Nuk keni njohur asnjë shenjtor asnjë profet, asnjë rimishërim. Por sot gjëndja është e tillë që duhet të njihni një. Nëse ju nuk e njihni atë, Sahasrara juaj nuk mund të hapet sepse kjo është koha kur Sahasrara është e hapur dhe ju duhet të keni realizimin tuaj. Është një gjë shumë e rëndësishme që ju “duhet” të njihni Sahaja Yogën. Ka shumë njerëz që thonë ‘Nënë’ ju mund të jeni ‘Nëna’ ime. Në rregull, s’ka rëndësi. Por ju nuk mund të arrini realizimin tuaj. Dhe edhe nëse e arrini nuk mund ta mbani. Ju duhet të njihni; NJOHJA (pranimi) është “Vetëm adhurimi I Njohjes së Sahaja Yogës është I vetmi adhurim kur ti dëshiron të njohësh Zotin në Sahaja Yoga. Të gjitha Gana[4]s e tjera, DEVATAS, Zotat, Shaktis janë një në unison në Sahaja Yoga. Dhe çdokush që nuk e njeh Sahaja Yogën, Thjesht nuk është i shqetësuar për ty, ç’lloj personi je ti. Psh. një njëri që adhuron Shiva-n vjen tek unë dhe shikoj që zemra e tij është e infektuar (ka ngërç)- E papritur! Ai thotë “Nënë unë adhuroj Shiva-, si ka mundësi që ka ngërç zemra ime? I thashë, “Ti

duhet të njohësh Sahaja Yogën, Thjesht kërko Shiva-n". Dhe kur ai I bëri pyetjen Shivës, atëherë filluan të shpërthejnë vetëm vibrimet. Pra Sahasrara merr përsipër t'ju bëjë juve të njihni dhe gjithashtu të bindni veten, ajo dëshmon për ju. Dhe nga ky të provuar, nëse nuk jeni duke e njohur ende atëherë ju nuk mund të arrini realizimin tuaj.

Por edhe ata që e njohin pjesërisht, ata marrin liritë, sillen në një mënyrë qesharake pa e kuptuar se Kush është ky "Person" që është këtu? Po ju them se shumë herë kam parë njerëz që Thjesht ngrenë duart lart, duke ngritur Kundanin; ata Thjesht flasin, bisedë fëmijësh - jam habitur. Sepse nëse e keni njohur atëherë duhet të dini se cilin keni përballë. Sepse nuk është për Zotin tim; unë nuk kam ç'të humbas. Vetëm se ju në ngritjen tuaj nuk e keni njohur. Kjo tregon që nuk e keni njohur akoma. Dhe mënyra si disa njerëz me monopolizojnë Mua është tërësisht e gabuar. Nuk është nevoja të më monopolizoni Mua; "askush" s'mund të më monopolizojë Mua. Ka disa njerëz që thonë se "Nënë mund të na kesh keqkuptuar". Unë nuk keqkuptoj kurrë; pa diskutim. Ose disa njerëz përpiqen të më thonë "Bëj këtë, bëj atë"- edhe kjo nuk është e nevojshme. "Provoni të hapni veten ndaj këtij protokollit gjë që është shumë e rëndësishme në Sahaja Yoga, gjëja e parë për të cilën ju fola sot, që ju duhet të PROVONI TË NJIHNI NË MËNYRË TË PLOTË. Dhe nëse nuk I njihni, më vjen keq, nuk mund t'ju jap juve realizimin që do ju mbështesë - mund të fillojë por jo të mbështesë. Pra kjo është rruga më e Thjeshtë për të arritur lartësinë tuaj, çështja është të njihni gradualisht të njihni gradualisht. Është shumë e vështirë ti thuash çdokujt nëse diçka nuk shkon me të - e pamundur. Pas Sahaja Yogës, mund t'ju them kjo Cakra ju kap, ajo Cakra ju kap. Por ju dini edhe çfarë do të thotë kjo Cakra, mund të vini tek unë "Jo jo Nënë, shiko se nuk është kështu. Nuk jam unë. Nuk është kështu". Pse duhet t'ju them që jeni infektuar? Duhet të pastroni veten me ndershmëri të plotë, por gjëja e parë është të "Njihni" me përluljen dhe mirëkuptimin e plotë. Me të njohur, gradualisht ju do bëni çdo gjë që duhet të bëni "e dini atë që duhet bërë".

Tani thelbi I Sahasrarës është integrimi. Në Sahasrara gjithë Cakrat janë aty, kështu që të gjitha Hyjnitë integrohen. Dhe ju mund ta ndjeni integritetin e tyre. Kjo do të thotë, kur ju keni Kundalinin në Sahasrara "Qënia" juaj mendore, emocionale, dhe shpirtërore, gjithçka bëhet një. Edhe qënia juaj fizike bashkohet me të. Atëherë nuk keni më problem, si për "Po unë e dua Nënë, por më fal unë duhet të vjedh këto para". "Po, unë e njoh, e pranoj Nënë, Po unë e di që Ajo është e mrekullueshme por nuk mund të rri pa I thënë gënjeshtër Asaj" ose "Më duhet ta bëj këtë gabim, sepse në fund të fundit nuk rri dot pa e bërë". Nuk ka kompromis me Mua. Duhet të jetë plotësisht I integruar. Dharma juaj duhet të korrigjohet. Nuk mund të bëni çdo gjë gabim e pastaj të thoni "Unë jam Sahaja Yogist". NUK MUNDENI.

Por për këtë forca vjen nga brenda jush. Shpirti juaj ju forcon. Thjesht duhet ta dëshironi këtë forcë, që "Po, Lejoje Shpirtin tim të veprojë". Dhe atëherë ju filloni të veproni sipas Shpirtit. Me të filluar të veproni sipas Shpirtit, do kuptoni që nuk ndjeheni skllav I asgjëje. Ju shndërroheni në "Samartha" që ka të njëjtin kuptim si Sam + Artha; gjithashtu "Samartha" do të thotë personalitet I fuqishëm. Pra ju zhvilloni këtë personalitet të fuqishëm që nuk ka tundime, që "nuk" ka ide të gabuara, që "nuk" ka infeksione (ngërçe), "nuk" ka probleme. Njerëzit "Swarthi (EGOISTË)" që përpiqen të bëjnë hile janë duke e dëmtuar vërtet vetveten, jo Sahaja Yoga. Sahaja Yoga është duke u përforcuar. Edhe nëse janë dhjetë njerëz në varkë, Zoti nuk mërzhitet. Është vetëm mërzhitja "Ime" si Nënë. Si një Nënë, unë dua që njerëzit e mij të hipin në varkë. Por mos provoni të hidheni prapa duke bërë gjithë këto gjëra të pandershme.

Pra kjo është ajo që është - e Thjeshtë, më pas ju jeni të integruar. Me integrimin, ju fitoni fuqi të bëni atë që kuptoni, dhe keni fuqinë të ndjeheni I lumtur me atë që kuptoni. Kështu ju vini në një fazë ku zhvilloni këtë "Niranand". Dhe këtë "Niranand" e zhvilloni kur jeni plotësisht Shpirti. Në gjëndjen "Niranand" nuk ka mbetur dualitet - është Adwaita (PA DUALITET), është një personalitet. Kjo është, ju jeni tërësisht I integruar dhe gëzimi nuk është më I shtypur - është I plotë. Ai s'ka marrë një aspekt lumturie dhe pikëllimi, por është Thjesht Gëzim. Gëzimi nuk është se qeshni me të madhe, Gëzimi nuk është se ju buzëqeshni gjithë kohës. Jo. Është heshtja, qetësia brenda vetes suaj, paqja e qënies suaj, e shpirtit tuaj, që pohon veten në vibracionet që ndjeni, kur ju e ndjeni atë paqe, kur ndjeni sikur drita e diellit, gjithë rrezet e kësaj bukurie përhapen.

Por para së gjithash ne jemi goditur nga idetë tona personale, egoiste dhe të kota. HIDHINI TUTJE ATO. Ne I kemi ato (idetë), sepse jemi të pasigurtë, sepse kemi ide të gabuara, hidhini ato tutje. Thjesht rrini me një Zot. Dhe do kuptoni që gjithë kjo frikë ishte e padobishme. Pastërtia jonë është shumë e rëndësishme, dhe kjo pastërti vjen vetëm kur ju e praktikoni realisht pastrimin siç thuhet në Sahaja Yoga.

Sahasrara është bekimi i qiellit, do të thoja. Ka funksionuar kaq mirë. Është shumë e vështirë të thyesh Sahasraran dhe kur unë e theve vërtet nuk e dija që do ishte kaq e suksesshme. Së pari mendova se është ende e parakohshme sepse akoma ka shumë "Rakshasas (DEMONË)" nëpër rrugë, duke shitur mallrat e tyre; dhe ka shumë fanatikë që janë duke munduar veten nga të ashtuquajturat besime, janë duke ndjekur besimin jo të duhur të Atma. Por gradualisht ka zënë rrënjët e saj. Tani lejojeni këtë të vërtetë të zërë rrënjë brenda vetes suaj nëpërmjet Sahasrarës suaj dhe sapo, kjo e vërtetë bëhet drita absolute që të drejton ty, drita që të ushqen, drita që të ndricon dhe të jep një personalitet që ka dritë, atëherë vetëm ti duhet ta dish që Sahasrara jotë është tërësisht e ndriçuar nga Shpirti yt. Fytyra juaj duhet të jetë e tillë që njerëzit të kuptojnë se kanë një personalitet përballë që është "Drita". Kështu duhet të konsiderohet Sahasrara më pas.

Për tu kujdesur për Sahasrarën është e rëndësishme që të mbulon kokën gjatë kohës së dimrit. Është më mirë që ta keni të mbuluar kokën gjatë dimrit që të mos mbërdhijë truri, sepse edhe truri përbëhet nga "Mëdha" që do të thotë i shëndoshë, pra nuk duhet të ngrijë. Për më tepër nuk duhet të keni shumë nxehtësi në tru. Që të mbani në rregull trurin nuk duhet të uleni në diell gjithë kohës siç bëjnë disa perëndimorë, pasi truri shkrin dhe bëheni një person i marrë (çmendur) - është shenjë se një person po çmendet - është një gjë që jua kam thënë shumë herë që mos merrni shumë nxehtësi në kokë. Edhe nëse jeni ulur në diell mbajeni kokën të mbuluar. Mbulimi i kokës është shumë i rëndësishëm. Por mbulimi i kokës duhet bërë me rastë, jo gjatë gjithë kohës sepse nëse vini një kapele shumë të rëndë në kokë, atëherë qarkullimi zvogëlohet dhe mund të keni shqetësime nga qarkullimi i keq. Pra është me raste nxjerrja e kokës në diell dhe në hënë, me raste. Përndryshe, ju do uleni në hënë dhe qëndroni në çmendinë. Gjithçka që ju them është që duhet të dini se në Sahaja Yoga nuk ju duhet të shkoni tek asnjë "Ati" (ekstrem). Edhe nëse uleni në ujë, disa mund të rrijnë për 3 orë. Asnjëherë nuk kam thënë kështu. Vetëm për dhjetë minuta ju duhet të uleni, por me zemër. Nëse u them atyre diçka, ata do vazhdojnë ta bëjnë këtë për 4 orë; s'është nevoja. Bëjeni për dhjetë minuta. Jepini trupit tuaj një mënyrë tjetër të ndryshme trajtimi, jo gjithë kohës të njëjtën gjë. Trupi mërzitet ose mbingarkohet. Tani i thua dikujt, kjo është mantra jote; në rregull; duhet të përdoret derisa të çlirohesh (shërohesh) nga Çakra jote, mbaroi. Supozoni duhet të vihen disa vida këtu; në rregull; ajo që bëni vini vidat që të fiksojnë, nuk keni pse të vidhosni kur është fiksuar. Do vazhdoni të vidhosni akoma më shumë derisa e gjitha të prishet (spanohet)? Është më mirë të përdorni dijen tuaj. Dhe për këtë dije, ju duhet të dini që Shri Ganesha ose Jezu Krishti janë të vendosur në të dyja anët. Këtu është Mahaganesha (prapa kokës) dhe këtu Jezu (përpara). Të dy ju ndihmojnë të korrigjoni vizionin tuaj, të kuptuarit dhe ju japin dituri. Pra dija (Dituria) nuk qëndron e ngjitur në diçka. Sahaja Yogistët janë njerëz të shkëputur nga trazirat. Nëse janë të mbërthyer nuk përparojnë. Nuk duhet të mbërtheheni nga idetë tuaja dhe nga njerëzit. Ju duhet të jeni gjithë kohës duke lëvizur dhe në lëvizje, kjo s'do të thotë që ju duhet të bini diku dhe njerëzit të mendojnë se "0", ne jemi duke mësuar shumë, sepse jemi duke rënë". Ju duhet të ngriheni jo të bini.

Prandaj, kur ju jeni duke arritur diçka në Sahaja Yoga, së pari të gjithë ju duhet të shihni që shëndeti juaj të jetë në rregull. Mendja juaj duhet të jetë normale. Duhet të jeni një person normal. Nëse ju ende vazhdoni t'u bërtisni (lehni) njerëzve, atëherë dijeni se diçka nuk shkon tek ju. Ose nëse ju rrëzoheni, rrini me turinj dhe përdorni tantrat[5] dhe akoma jeni në gjëndje të keqe, atëherë mendoj se ju nuk jeni akoma një Sahaja Yogi. Mund ta gjykoni veten, nëse jeni të lirë si një zog atëherë në rregull. Por kjo s'do të thotë se ju në rrugë filloni të këndon si një zog e të hidheni nëpër pemë. Pra e shikoni ç'lloj përjasje i jap një njeriu budalla, ai mund të sillet në mënyrë idiote. Por një njeri i zgjuar, qartësisht e përdor atë për qëllimin e duhur. Pra dikush duhet të kuptojë që Sahaja Yoga është e njohur për qartësinë - një person i qartë.

Tani ajo që ndodh në fakt ju ngecni në një gjë, që është "Atma (SHPIRTI)" juaj dhe e gjithë qenia juaj shket (pluskon) siç bën një "Patang (TRAP)", një trap që pluskon, shkon në të gjitha vendet, kudo por ju jeni të mbërthyer pas një gjëje që është Shpirti juaj. Dhe nëse vërtet mund ta bëni këtë, sinqerisht dhe me ndershmëri mos e vrisni shumë mendjen rreth parave; Thjesht jepini një bandhan. Nëse nuk ecën, nuk ecën kaq mbaroi. Cili është problemi? Nëse funksionon, ok në rregull. Jo se dëshira juaj është e rëndësishme, por "U bëftë vullneti yt". Në fillim thoni "U bëftë vullneti yt"- është kaq surprizuese sa vullneti dhe dëshirat tuaja ndryshojnë dhe çfarëdo të thoni, kryhet. Por edhe kur u del kjo, njerëzit zhvillojnë një ego ndaj jini të kujdesshëm. E gjitha është bërë nga Shakti dhe jo nga ju, nga Atma (SHPIRTI) juaj dhe jo nga ju.

Ju duhet të jeni Atma (SHPIRTI) dhe me tu bërë "Atma" ju shndërroheni në "Akarm" (PERTËJ PUNËVË TË MIRA DHE TË KEQIJAVE), ku ju nuk dini atë që po bëni, Thjesht funksionon, nuk ndjeni nuk jeni të vetëdijshëm.

Dëshiroj, që pas gjithë këtyre leksioneve, shumica e Çakrave tuaja të jenë hapur, Por kjo është e gjitha puna Ime. Duhet të bëni disa punë shtëpie. Dhe ju duhet të punoni gjithashtu dhe të shihni vetë. Jini vigjilente. Provoni të përballni veten tuaj në pasqyrë dhe të shihni veten. Sa të ndershëm keni qenë, Sa të pastër keni qenë, Sa miqësorë jeni në kolektivitet - gjë që është shumë e rëndësishme në Sahaja Yoga. Nëse nuk jeni kolektiv, nëse nuk jeni gazmorë, nëse jeni të çuditshëm, nëse nuk mund të komunikoni me të tjerët atëherë diçka nuk shkon. Atëherë duhet të përballeni me veten siç jeni dhe të përpiqeni të korrighoheni Sepse, ju ndaheni nga vetja juaj siç ndaj unë Sarin nga Vetja dhe përpiqem ta pastroj. Në të njëjtën mënyrë, ju e ndani veten nga vetja juaj dhe e pastroni. Kjo është rruga që Sahaja Yogis do të ngrihen. Kur Sahaja Yogis do të ngrihen, pjesa tjetër e gjërave do të ngrihet. Shumë Sahaja Yogis të këtij lloji do të habisin shumë njerëz saqë këta do të duan të ngrihen edhe vetë. Kështu që e Gjitha mund të ngrihet shumë shpejt. Por njerëzit që ngrihen më lart duhet të provojnë të ngrihen më lart pa qenë të vetëdijshëm për këtë - kjo është shumë e rëndësishme. Ata që mendojnë se të tjerët janë më lart se ta janë gjithashtu duke gabuar trishtueshëm, sepse nuk është kështu. Sepse është e gjitha që po ngrihet. Askush nuk duhet të ndihet në këtë mënyrë inferiore ose në një anë më të ulët ose të ndihet I fyer që dikush mendon se ai është I ulët. Çdokush të mendojë ç'të dojë, punë e madhe, Hyjnorja nuk mendon kështu. Pra gjithë këto gjëra të vogla, duhet të bëni kujdes ndaj tyre, pasi shumë lehtë në këtë Krita -Yoga do të arrini qëllimin e fundit të Atma Sakshatkar (VETËREALIZIMIT).

Mendoj se sot ju kam folur mjaft për Sahasrarën.

Zoti ju Bekofte!

[1] Zoti I Plotëfuqishëm.

[2] 11 fuqitë shkatërruese të Shri Kalki.

[3] Kulmi (maja) e trurit.

[4] Ëngjëjt.

[5] Instrument. Mekanizëm i sistemit delikat. Gjithashtu një tekst me udhëzime për ngritjen shpirtërore, si në Hevajra Tantra. Për fat të keq kjo fjalë është keqpërcaktuar shpesh me Tantriks që besojnë se Kundalini është një fuqi seksuale. Ky besim është në kundërshtim me Sahaja Yoga.



## 1985-0317, Birthday Puja, Our maryadas

View [online](#).

Birthday Puja. Melbourne (Australia), 17 March 1985.

Jam shume e gezuar sot t'ju shoh ju te gjithë duke festuar ditelindjen Time dhe per me teper kemi dhe programin nacional ne te njeten dite.

Eshte nje kombinim i mire qe kemi ne muajin Mars Perkon me stinen e pranveres ne Indi, Madhumas kjo eshte ajo qe ju kendoni, Madhumas Sic e dini, njezete e nje Marsi eshte ekuinoksi eshte nje lloj balance dhe gjithashtu eshte qendra e te gjitha shenjave te horoskopit qe ju keni Kaq shume qendra une duhej te arrija dhe gjithashtu une linda ne Tropikun e Gaforres ashtu sic ju jeni ne Tropikun e Bricjapit dhe shkembu Ayers eshte ne Tropikun e Bricjapit tamam ne qender te tij. Keshtu shume kombinime duhet te funksiononin. Keshtu principi i ngritjes . eshte te jesh ne qender, te jesh ne balance, te jesh ne kufijte e sjelljes se drejte te qendres. Te jesh ne kufijte e qendres eshte principi. Keshtu cfare ndodh kur ne nuk qendrojme ne kufijte e sjelljes se drejte? Atehere ne bllokohemi Nese ne qendrojme ne kufijte e sjelljes se drejte ne asnjehere nuk mund te bllokohemi Shume njerez thone, Pse ti kemi maryadat? Thone ne i kemi maryadat, kufijte e ketij ashrami te bukur ketu dhe dikush eshte duke ju sulmuar nga te gjitha drejtimet nga te gjitha drejtimet e void-it, keshtu nese ju dilni nga Void ju bllokoheni Kjo eshte perse ju duhet te qendroni brenda kufijve dhe te qendroni brenda kufijve eshte e veshtire. Kur ju keni dy probleme: njeri eshte ego, tjetri eshte superego. Tani ndersa ne Perendim Superego nuk eshte ndonje problem Ego eshte problemi, dhe ajo ka shume, shume implikime delikate tani, Une mund te shoh stilet e komplikuara te Egos qe ne kemi Njeri eshte madheshtia, e ngjashme me stilin Khomeini, i cili eshte i thate eshte i dukshem, evident, cdokush mund ta denoj .

Ky eshte njeri, Ai ose korrigojohet ose shkatërrohet plotesisht. Por ego, nese ajo eshte e nje personi budalla ateherë ai sillet vetem ne kete menyre, dhe ai nuk di si ta fsheh egon e tij nepermjet sofistikimit. Por ego lindore eshte ekstremisht e sofistikuar, gjuha, cdogje eshte shume e sofistikuar. Si ne gjuhen Angleze une do te thoja, "Me vjen keq por une duhet t'ju qelloj me shuplake". "Me vjen keq por une duhet t'ju vras". Eshte nje gje kaq dinake, e shihni, sapo thate "me vjen keq", kjo do te thote qe ju keni vendosur nje cokollate ne maje te saj. A nuk eshte keshtu? Te tille kamufli, duhet ta kuptoni E shihni, ne duhet te perballemi ashtu sic jemi. ne nuk mund te perballim dicka tjeter. Dhe kjo eshte saktesisht cfare ndodh me sofistikimin, keshtu ne shmangim te perballim veten tone.

Sot edhe pse eshte dite festimi, gjithë humor ne duhet te kuptojme cfare eshte kjo gje budallaqe qe quhet ego. Me humor, jo me seriozitet, sepse une nuk dua qe ju perseri te ndiheni fajtor. Tani, sic po e shpjegoja edhe ne mengjes se si ego behet Vishuddhi i majte. Une dua te them madje perpara se te shkonim ne holl, vemendja ime ishte ne holl, Une pata nje gunge te madhe ketu, tamam, tamam nje dhimbje e temerrshme, torturuese. Dhe dua te them gjate gjithë kohes ka qene aty qe kur kam qene ne Perendim. A mund ta imagjini? Ajo nuk eshte zhdukur asnjehere. Keshtu kjo chaker eshte gjate gjithë kohes duke punuar, e shkreta eshte kaq e lodhur tani, Vishnumaya chakra. Keshtu cfare ndodh realisht. ne duhet te shohim anen fizike te saj, eshte shume e rendesishme ta kuptosh, Sic e dini qe nga femijeria nese jeni ambjentuar, ne nje shoqeri te tille si kjo, ne te cilen ju jeni i hapur, .

ju duhet te arrini dicka. ndonje sukses, kete apo ate, pastaj ideja e fortesise eshte dhene tek ju, kjo eshte dobesia per te toleruar dicka. Imagjini ne shtetet Kristiane kjo eshte pjesa me e mire e saj, "Me vjen keq", Une do t'ju vras, gjera te tilla. Ne vendet Kristiane, sic e dini, ata i kane keto gjera, teori qe eshte dobesi nese ju toleroni dicka, . Eshte dobesi nese ju dominoheni nga dokush. Ju asnjehere nuk mund te jeni i suksesshem nese beni keshtu. Keshtu pervec dhe derisa ju te jeni i posesuar. ju asnjehere nuk mund te beheni te bindur. Ky eshte fakti Dikush duhet t'ju posesoje ju, absolutisht t'ju posesoje ju, si Hitleri, pastaj ju mund te beheni te bindur, perndryshe cdonjeri ka nje ego te madhe. Sic ju pata treguar historine e pastresit te plehrave.

Keshtu cdonjeri ka nje ego shume, shume te madhe, cdonjeri kerkon te kete menyren e tij, dhe nga femijeria ju i llastoni femijet tuaj shume, ju i llastoni ata, i llastoni plotesisht ata, Gjate gjithë kohes i perqafoni ata, i mbani ata, ju beni shume, femijet llastohen. Mendojne pa fund per veten e tyre dhe ne fund te kesaj nese i thoni atyre se ju nuk do te toleroni cdogje, ata behen te

pabindur. Keshtu ju nuk dini se si ti bindeni te tjerve ne ndonje menyre. Ego nuk di si te bindet, sepse kjo eshte dobesi, bindja eshte dobesi. Keshtu kjo gje e shkrete ego ka nje kufizim, eshte e kufizuar. Qe eshte, kjo ego ka nje balone, e cila eshte e kufizuar. Por ajo shperthen kur ju bllokoheni dhe me te gjitha keto gjera, ajo shperthen, por ajo eshte fleksibel gjithashtu. Keshtu kur ego fillon te shkoje shume lart ne maje te superegos, atehere superego mund te ngrihet ne nje pike, ajo eshte gjithashtu atje. Keshtu per te shpetuar nga ego njerezit fillojne te pijne droga vetem qe ta shtyjne ate mbrapa keshtu, ngrini superegon ne kete menyre do te zbrese poshte ego, Keshtu ju jeni duke luajtuar midis te dyjave, pastaj ju keni dhimbje koke, pastaj vazhdon ne kete menyre, e shihni, si funksionon. Kjo eshte zgjidhja moderne qe ata kane gjetur per egon.

. Perndryshe ego eshte shume. Keshtu kur dikush te thote dicka, ne vend qe te perballesh me te supozojme se ju nuk keni mundur te thoni, gjej nje gote per mua, nje gje e thjeshte e tille, konsideroheni ate ne kete menyre. Ju ndiheni keq. Pse? Pse ju duhet te ndiheni keq per kete? Sepse eshte edhe nje vend tjeter ku kjo ego mund te shkoje ajo vjen rreth e qark, . Ju e shihni ajo kryqezohet ketu tek Vishuddhi, keshtu kur ajo shtypet nga ana tjeter ajo shkon brenda pjeses se Vishuddhit Keshtu pastaj ju bllokoheni ne Vishuddhin e majte nuk eshte asgje tjeter pervecese nje ego e paster. Me besoni, eshte ego e paster. sepse nuk ka rruge tjeter per te shkuar, ajo shkon atje dhe kjo eshte pse ju ndiheni keq dhe mendoni.

Duke menduar keshtu ego juaj shtohet, ju mbushni anen tuaj te majte dhe ndiheni keq, asnjehere nuk perballeni. Tani, ana praktike rruga qendrore eshte krijuar duke qene ne realitet. Tani me forcen e zakonit ju duhet ta zhvilloni. Supozojme se dicka ka shkuar jo mire, thuani vetes, Po ka shkuar keq, sepse une gabova. Ne rregull, pse gabova ? Per shkak te keasj, keshtu heren tjeter nuk do ta bej. Por shume e lehte, te shmangesh gjithshka, vini tek kjo dhe gezoni egon tuaj duke u ndier keq. Eshte nje privilegj. Dhe te tjeret e ndiejne gjithashtu, Ndihet "Me vjen keq" une te vrava ty, e shikon. Ai ndihet keq per ate.

Po e kam pare, ka shkuar kaq larg ne mendjet e njerezve perendimore, atje ka ligje te cilat realisht i falin njerezit. Kush nuk duhet falur asnjehere? Ata gjithashtu provojne ti falin njerezit per shkak te ketj Vishuddhi te majte absurd, i cili plotesohet ne anen e majte, ju ndjeni simpati per te tille njerez, kush nuk duhet falur kurre, skurse ishte nje djale i cili kishte vrare kaq shume njerez, duke i vendosur ata ne dhoma me gaz. Ai eshte arrestuar tani. Ai ka nje detyrim tani, nje detyrim te madh si i burgosur i mbajtur diku, sepse ata duhet te mbajne cdogje shume te mbyllur, dhe keshtu dhe ashtu. Keshtu per te ruajtur te tille qen atje ishte shume e veshtire per Anglezet, por ata jane duke u kujdesur per kete te burgosur. Une ja kam harruar emrin, djale i temerrshem kushdo qofte ai. Tani ai ka qendruar atje, ai eshte i moshuar. duke e lene ate te vdese atje, per cfare duhet te keni meshire per te? Vareni ate dhe jepini fund, ai ka vrare kaq shume njerez.

Jo, por si mund ta beni ju kete, Ju duhet ta mbani kete qen atje. edhe pse ai eshte duke konsumuar parate e gjithte njerezve, edhe pse ai ka vrare mijra dhe mijra dhe mijra ne dhoma me gaz. Ai ka qene nje djale kaq i temerrshem, nuk duhet te kete simpati per te, ne ligjet hyjnore ai duhet te mbaronte me kohe. Ai eshte duke u vanitur cdo dite, por dhe tani, une lexova artikuj qe e simpatizonin ate. Tani cfare eshte duke bere ai gabim? Pse te merremi me te? Kjo eshte se si ju luani ne duart e njerezve te temerrshem nga Vishuddhi juaj i majte, se pari Keshtu ky Vishuddhi i majte nuk eshte asgje pervec thjesht, thjesht ego dhe kur ju e perkulni koken keshtu, ju ecni keshtu. Tani me kete Vishuddhin e majte ju keni shume, shume probleme fizike, por me e keqja e te gjithave do te jete cmendura. Diten qe kaloi dikush, me tha qe tani ne Amerike ne moshen e te dyzetave, njerezit papritur jane duke u bere te cmendur, dhe kjo eshte nje semundje shume e madhe, njesoj sikurse ata kane ate semundjen te temerrshme te quajtur AIDS, ne ate menyre eshte duke u perhapur. Tani une duhet tju them ju si Nena juaj, shume qarte, se kjo eshte pjesa ku ky Vishuddh i temerrshem eshte duke luajtur, Mos u kenaqni ne te.

Nese ju keni ego, kjo eshte arsyeja pse ju keni Vishuddhin e majte, perballuni me veten. Si sot ideja e Warrenit ishte, ai erdhi dhe me tha qe Kur shkojme ne Indi, ne mendojme qe, njerezit cfaredo qe ne sygjerojme si fillim fillojne me jo, jo. Keshtu aktualisht ju e shihni kete Jo,jo, kjo sepse ne kemi sjelle nje menyre tjeter, e shihni te perballesh me te, ne kemi ardhur tek kjo. Kjo eshte pse Indianet asnjehere nuk ndihen fajtor. Nese ata ndihen fajtor kjo eshte sepse ata jane perendimezuar. Ata asnjehere nuk ndihen fajtor. Keshtu tani ne momentin kur ata thone Jo per dicka, nentedhjet e nente perqind, jo njerezit qe qendrojne neper qytete, ata jane te te njetit stil sepse ju i keni bekuar ata miresisht, por ne fshatra. E shihni ata i thone vetes, Jo, jo, Si mund ta kem bere kete? . Ne rregull, nese une e kam bere kete, une duhet ta korrigjoj ate me mire.

No, jo Ajo fillon me jo jo. Por nje perendimor mund ta degjoj kete jo,jo, dhe te mendoje, ai vetem do te ndeshkoje egon time.



Sepse akoma kjo ego eshte aty per te dominuar te tjeret, akoma kjo ego mendon se ata jane organizatore me te mire akoma ajo mendon se ata jane me te paster se te tjeret, se ata jane me lart se njerezit e tjere. E gjithë kjo ego mendon keshtu, e shihni, dhe ju ngre ju lart dhe jeten tuaj ne maje, e shihni, si nje balone ose unaze e cila eshte e bllokuar . ju qendroni ne siperfaqe, dhe kjo eshte pse ju nuk doni qe ajri te dale jashte, sepse ju e dini, ju do te zhyteni brenda vetes. Keshtu dikush jeton me kete dhe ju filloni te mendoni se ju e dini ate me mire, askush nuk ju thote ndonje gje, dikush ndihet i lenduar perseri Vishuddhi i majte. Nese Nena thote ndonje gje, perseri Vishuddhi i majte. Keshtu tashme ju e keni krijuar nje xhep aty duke qendruar ne perendim; ne duhet te perballemi me ate qe jemi. Tani ai xhep eshte aty per cfaredo qe Une te them, edhe nese une jam duke e thene tani, ju nuk duhet te ndiheni fajtor. Le ta shohim, mos u ndjeni fajtor.

Qendroni ne shpirtin tuaj, keshtu ju e shihni vete dhe ju mund ta qartesonini ate. 253 Nese ju shihni me syte e shpirtit ju qartesonini kjo eshte ajo qe ju keni akumuluar prej kohesh, Po ju them se sot Vishuddhi i majte eshte problemi i njerezve perendimore. Te gjitha keto probleme jane duke ardhur nga vishuddhi i majte, por e cila nuk eshte ne asnje menyre se ata jane te ndrydhur, perkundrazi ne cdo moment ky Vishuddhi i majte mund te ngrihet me furi brenda egos. E shihni, Une e kam pare kete ne perendim shume te zakonshme, njerezit jane duke cuar drejt perpara cdogje, ne rregull. Edhe ne qytetet e Indise jam duke e pare kete ju i merrni ata ne kujdestari, papritmas ata kercejne mbi kale. Une thashe, nga ku kerccyen ata mbi kale, nga ku erdhi kjo ego? Kjo e gjitha ishte depozituar ketu lart e shihni, aq shpejt sa ata merren ne kujdestari e tere gjeja kthehet mbrapsht dhe ata qendrojne te ulur si John Gilpin ne nje kale duke shkuar shpejt dhe une fillova te shikoj per ta, ku jane duke shkuar ata? Ata ishin pikersht aty, te zhdukur, truke te vanitjes. Vertet nuk e kuptoj pse ajo ndodh. Por mbas penetrimin ne problem, sepse e shoh, vetem duke shkuar ne holl ju merrni Vishuddhin e majte.

Askush nuk mund të shikojë brenda jush përveç Nënës tuaj. Edhe unë gjithashtu, vetëm i ndjej Mooladhara-t tuaja.... Për të qenë shumë e sigurtë me ju, kjo është e vetmja qender që nuk arrij ta ndjej unë vete. Arsyeja është se unë kam një Mooladhara shumë shumë të fortë, e cila nuk është kaq e ndjeshme, do të thoja. Ajo nuk shqetesohet. Vëmendja e Mooladhara-s time nuk i afrohet asnjë Mooladhare tjetër. Ajo thjesht tërhiqet mbrapsht, ky është veprimi që ajo ben gjate gjithë kohes. Kështu unë nuk e ndjej atë vec dhe derisa ajo te jete keq fare, dua të them që personi është shumë afër meje, pastaj unë e ndjej Mooladhare-n shumë fort. Por ende nuk mundem. Të supozojmë se ju më jepni dicka mua, një gjë është e përdorur nga ju, unë mund ta ndjej atë menjëherë. Kështu korrigjimi Mooladhara-s varet plotësisht nga ju. Dhe pa pasur një Mooladhara të fortë ju nuk mund të ngriheni lart, bëni çfarë ju pëlqen.

Tani për njerëzit që janë Indianë, ata të cilët kanë respektuar Mooladhara-t e tyre, ekzistojnë shumë metoda dhe rrugë të dhëna se si të rrisin fuqinë e Mooladhara-s. Por kjo nuk do të funksionojë me njerëzit Përëndimorë, Mooladhara e tyre është e shkatëruar. Është një Mooladhara vertet e shkatëruar dhe jo se nuk funksionon nga ana fizike e saj, por ana emocionale e saj siç e quajmë në Mana, ana e majtë.

Kështu, edhe pse ju nuk mund të flisni në atë mënyrë, por mendja juaj është ende në atë drejtim. Dhe ju akoma mendoni në atë drejtim. Edhe mendërisht, ju jeni atje. Ose ju jeni duke parë gjëra, duke dashur të shihni këto gjera, dëshira për të gëzuar të tilla gjera. Kjo tërheqje përgjuese është ende atje. Mooladhara juaj nuk mund të ngrihet. Dhe ne duhet të kuptojmë, unë po flas për njerëzit përëndimorë. Nuk do të thoja të njëjtën gjë për njerëzit nga India.

Tani ne duhet të punojmë shumë. Ne duhet ta shikojmë veten nga jashtë dhe të negociojmë me te. Ky është më tepër është një aktivitet mendor, mendor, që do të thotë ana emocionale. Ju duhet ta vëzhgoni mendjen tuaj. Në Anglisht është një fjalë vertet gazmore "Mind". Por Mana, nëpërmjet së cilës ne kujdesemi për anën tonë emocionale, për dëshirat tona, ku është duke shkuar? Ku është ky veprimi i mendjes tonë? Çfarë është duke bërë? Ju duhet të jeni kundër mendjes tuaj, te të jeni kundër dëshirave tuaja, ose ju mund të përballeni me te dhe të shihni qarte për veten tuaj se çfarë është duke ndodhur,

Ju takon juve të vendosni. Askush do të vij tju korrigjojë në këtë pikë. E di, ju njerëz më jeni rrëfyer, unë asnjehere nuk i kam lexuar letrat tuaja, për të qenë shume e sigurtë. Çfarëdo letrash të më dërgoni, unë nuk do të lexoj ato. Çfarëdo rrëfimi që ju keni bërë, i dogja të gjitha ato letra. Nuk kam pasur asnjë ide se çfarë keni shkruar. Dhe as dua t'ja di për te. Nuk është ky qëllimi im.

Qëllimi është që tani të mos jetojmë më të njëjtat ide në të njëjtin nivel. Ose në çfarëdo lloj niveli, mund të themi.

Ne gjendjen pa mendime ju mund t'i luftoni mendimet që vijnë tek ju nga lloje te gabuar te Mooladhara-s. Ndoshta disa prej jush kanë pasur demon në Mooladhara-n tuaj. Dhe ne kemi disa trajtime fizike për të till demon te cilat do t'ja tregoj Gavin-it, te cilin ju mund ta pyesni ndonjëherë. Por ju nuk mund të thoni gjithmonë kete. Është demoni dhe une jam në rregull. Une jam larg nga demoni. Ju nuk jeni. Sa here që ju te thoni une kam demon, do te thote ju vetja ju jeni ulur me demonin.

Ju e shikoni një person si Sakshi[1] (në gjendjen e deshmitarit), që do të thotë që ju e shihni personin por ju nuk arrini reagimin, i cili është vrasesi i gëzimit. Ju vetë mund ta ndjeni Mooladhara-n tuaj shumë mirë. Ju mund ta ndjeni atë ne gishtat tuaj gjithashtu. Dhe behuni te vemendshem ne lidhje me te. Nëse doni të bëheni e kendshme për veten tuaj duhet ta dini që ju duhet të drejtoni vëmendjen tuaj drejt një jete martesore të shendetshme. Por edhe kjo gjithashtu nuk duhet të jetë me tepri. Sepse ajo që une kam mësuar tani, është ajo që njerëzit Përëndimorë kanë shpikur metoda të transferimit të vëmendjes nga një person në tjetrin. Akrobaci mendore të llojeve nga me të ndryshme kanë shpikur për të shkatërruar vëmendjen e tyre të pastër. Mos luani me kete.

Ka edhe shumë gjëra të tjera me të cilat ne shprehim se jemi akoma nën kurthin e Mooladhara-s së keqe. Mënyra se si ju visheni, mënyra se si ecni, mënyra se si uleni, mënyra se si flisni, mënyra se si ju silleni, për të impresionuar njerëzit e tjerë. Unë duhet te impresionohem nga te tjere njerez ne vete Sahaja Yoga. I vetmi Impresion qe duhet vertet te funksionojë është lartësia e ngritjes shpirtore që të tjerët kanë arritur. Ju mund ta bëni atë, nuk është e vështirë. Kur Kundalini arrin te ngrihet me te gjithë keto Mooladhara te shkatërruara, jam e sigurtë që ju mund ta shëroni Mooladhara-n tuaj plotësisht. Por pyetja juaj mbi të gjitha është te forconi Mooladharen tuaj, për të cilën unë mendoj që ju të gjithë duhet të shkoni ne nje lloj tapasya[2](pendese).

Kjo është pse une them ndonjëherë se njerëzit Përëndimorë duhet të hanë më pak mish, sidomos mishin e kuq dhe mishin e lopës, kalit, dhe qenit - dhe nuk di se çfarë lloji tjetër ju hani. Hani më shumë ushqime vegjetariane. Nuk po them të bëheni vegjetarianë, ju e kuptoni këtë. Hani më tepër gjëra që nuk ju japin kaq shume nxehtësi. Edhe peshku është shumë i nxehtë. Kështu beni një jetë e cila është ne nje lloj menyre asketike, por mos merrni nga ato ushqimet e shpifura "ushqime të shëndetshme". Unë nuk mund t'i toleroj ato, po ja u them. Ato nuk janë krijuar për qëniet njerëzore, por për kafshët mendoj. Ato e trazojnë stomakun tuaj teresisht dhe kjo është e tmerrshme. Dyqanet e ketyre vendeve mbajnë te tilla gjera, unë mora nje here dhe thashë – mjafton me kaq. Dyqanet e ketyre vendeve dhe te gjithë keto vende ishin brenda ne stomakun tim. Kështu për ju njerëz, ku te shkoni? Ata që janë duke vuajtur nga Mooladhara duhet të dini së ushqimi ben dallimin, në fuqitë e Mooladhara-s. Kështu nëse juve doni ta sheroni ate, ne fillim ju duhet ta qetesoni ate, ajo është e mbi-ngacmuar, e mbi-ngacmuar. Çdo mashkull që ju prekni, çdo femër që prekni, çdo grua që shikoni..... unë thjesht nuk e kuptoj, është më keq se majmunët! Ju duhet ta qetesoni ate, ta freskoni ate, ne kete menyre Ganesha derdh bekimin e saj mbi Mooladhara-n tuaj. Nuk ka miresi. Por nuk është kaq e jashtme unë mund te them, "ju duhet të respektoni veten".Nuk mund të funksionojë me keto fjale unë e di

Ju duhet të uleni, të bëni meditim dhe perpiquni te qetesoheni. Une do te diskutoj me Gavin dhe ti them atij se çfarë gjërash mund të bëhen ne lidhje me te, sepse unë nuk mund t'ju a them juve keshtu kaq hapur. Por akoma kjo është e tera fizike. Mendërisht ju duhet të jeni ne kohe për te pare se ku kjo mendje shkon - në gjërat e pista. Pse ajo gjithmone shkon ne keto ndjesi? Shikoni zogjtë, shikoni lulet, shikoni natyrën, shikoni njerëzit e bukur, vetem shikojini.

Nje tjetër gje e tmerrshme në përëndim është se grate duhet të ekspozojnë trupin e tyre për të eksituar meshkujt. Burrat bëjnë të njëjtën gjë. Ata gjithmonë përpiqen të eksitojnë njëri tjetrin dhe jetojnë në një eksitim budallepsës.

Juve ju duhet të ekspozoni gjëra të bukura, si lulet, stoli të bukura, në rregull. Por ju nuk jeni një send! Ajo është prona juaj private. Ju nuk e vendosni të gjithë arin tuaj në rrugë, e beni ju? Provoni këtë, ndonjëherë. Do te keni parasysh se si njerëzit do te grabisin arin tuaj, por ju nuk e keni problem qe dëlirësia juaj po plackitet! Te gjithë ju shikojne ju me sy te ndyre! Ju nuk ndjeheni i ofenduar! Kjo sepse egoja është një gjë e pisët. Ajo nuk e ka problem. Ajo ndihet e lumtur qe njerëzit jane duke ju pare. Ata jane duke ju plackitur, ata jane duke grabitur diresine tuaj. Por Sahaja Yogistet nuk janë te tille. Por sërish më duhet t'ju them se duhet të pastroni zemrat tuaja, pastroni mëndjet tuaja, mbajeni veten jashte kesaj.

Mëndjet janë të vendosura ne menyre shume qesharake dhe kjo është pse komplikimet me te medha jane aty - në trurin e njerëzve. Ata janë shumë konfuzë. Shumë njerëz konfuzë, behen personalitete te orjentuara vetem nga seksi. Aktualisht është

vetem rruga tjetër për qark. Nëse ju jeni i dhënë pas parasë, ju dëshironi të ruani para, nëse ju jeni të dhënë ndaj posedimit, ju doni ta ruani atë, nëse ju gjeni një cope të vogël antike ju dëshironi ta ruani atë, dhe pse jo kjo pasuri e juaja e cila është me e larta e të gjithave, për tu ruajtur, për tu zbuluar, për tu adhuruar?

Jam mjaft e shqetësuar në pikën që keta njerëz të fshehtë kënaqen me këto gjëra. Dhe ata janë hipokritë ndonjëherë, ata nuk e kanë problem të bëhen hipokritë në lidhje me te. Ata janë Sahaja Yogist, në rregull, por për këto çështje ata mendojnë se mund të vazhdojnë rrugën që ata pëlqejnë. Dhe ndonjëherë disa prej tyre thonë që Nëna ka thënë është në rregull. Unë kurrë nuk kam thënë kështu! Kjo është një pike me të cilën unë asnjëherë nuk mund të bie në kompromis. Ju duhet të keni botëkuptim të matur drejt vetes tuaj, drejt jetes tuaj, drejt qenjes tuaj, drejt personalitetit tuaj. Ju jeni të shenjtë. Dhe nëse një i shenjtë nuk ka një karakter të mirë, unë e quaj atë karakteri, thelbi i karakterit - nuk është i shenjtë.

Kështu kjo pastërti duhet të mirëmbahet, nuk mund të bëhet ndonjë "kompromis" me këte. Ju nuk mund të godisni në rrënjën e cdogjeje. Nëse funksionon, në një mënyrë kolektive, askush nuk do të mashtrij veten, askush nuk do të gënjejë veten. Dhe e vendos mendjen në gjurmët e drejta të ngritjes.

Duke menduar për ngritjen, si ju do të ngriheni, duke menduar momentet e gezuara, duke menduar ditën kur ju më takuat mua për herë të parë, duke menduar për të gjitha gjërat e tjera të bukura dhe hyjnore, mendja juaj mund të pastrohet. Dhe sa here që ndonjë mendim të vij, ju duhet të thoni, jo këte, jo këte. Është më tepër mendore se sa fizike, E di që është e vështirë, por nëse ju arrini realizimin pse këte jo?

Ju të gjithë duhet të kuptoni se "nuk" ka asnjë kompromis me këtë. Dhe do të vijë dita, nëse ju vazhdoni me të, ju do të pastroheni plotësisht, sikurse ndonjë djall tjetër është hedhur tutje. Pra "nuk" ka kompromis. Thuaj vetes, mos e mashtroni veten, mos e gënjeni veten. Ju nuk mund të ngriheni nëse ka ndonjë gjë që përgjon brenda jush. Ju do të zvarriteni poshtë, përshkak të dobësisë tuaj, dhe ju do të bëheni i dobët, dhe i dobët dhe më i dobët.

Pyetja e vetme është ku është vëmendja juaj? Devijojeni atë. Devijojeni vëmendjen tuaj. Në fillim do ju duhen disa ushtrime, disa përpjekje, dhe pastaj ajo do të vijë automatikisht. Ju nuk duhet të perpiqeni, ju nuk duhet të shqetësoheni, përkundrazi, do të behet e pamundur po të jete ndryshe. Ka qaq shumë kushtezime. Ne jemi duke luajtur në duart e kushtezimeve, ne jemi duke renuar veten tonë. Ky kushtezim është me i rrafinuar, me i vështirë, dhe me i keq i të gjithave. Ai është i pamundur të luftohet në Sahaja Yoga, deri në momentin kur ju 'individualisht' merrni përgjegjësinë për tu marrë me te.

Mooladhara është një nga Çakrat më delikate dhe më të fuqishme. Ka shumë degezime dhe ka qaq shumë dimensione. Nëse Mooladhara juaj nuk është në rregull atëherë kujtesa juaj do të dobësohet. Nëse Mooladhara juaj nuk është në rregull, mënçuria juaj do të dobësohet, ju nuk do të keni sensin e drejtimit. Marrëzia që është duke u zvarritur tani në Amerikë përpara se ata të mbushnin dyzet vjet si shtet është sepse Mooladharat e tyre nuk funksionojnë. Shumë prej sëmundjeve të cilat janë të pashërueshme vijnë për arsye të Mooladharas së dobët, nga ana ana fizike. Nga ana mendore, shumica prej problemeve mendore që ne pamë këtu, mund të them 90% janë për shkak të Mooladhara-s se dobet. Nëse një person ka një Mooladhar të fortë, një Mooladhar të fuqishme, nuk futet në telashe. Sepse ju e dini që është një mbështetje e fortë e Mooladhara-s në pjesën e mbrapme kokes. Dhe kur mendja juaj nuk funksionon me, ju fajësoni trurin. Nuk është truri, me se shumti është Mooladhara. Kështu për sigurinë tuaj fizike dhe për sigurinë tuaj emocionale gjithashtu, ju duhet të keni një qëndrim me karakter të shëndoshe kundrejt Mooladhares. Prandaj jam shumë në ankth për t'ju thënë që ju të gjithë duhet të martoheni, dhe pas martesës, disa dite me pas, zbuloni së vëmendja juaj fillon të zhvendoset në problemet e tjera të jetes se perditshme martesore.

Por jo nëse ju nuk jeni Sahaja Yogist, sepse të berit buje është bërë tema kryesore e jetës moderne. Dhe ju jeni hidheni në detit e trazuar të gjithë këtyre veprimeve të qellimshme të njerëzve. Media, librat, idete, çdo gjë, krijon këtë temperamentin e tmerrshëm ngacmues brenda jush.

Një person i tillë nuk ka fare durim, nuk është aspak i ballancuar. Aktualisht ai është hipokrit, dhe ka një Vishuddhi shumë të renduar. Ka qaq shumë komplikacione tek ai përpara realizimit. Harrojeni të kaluarën! Çfarëdo të keni bërë harrojeni. Vetem mos u merzisni. Por mbani mend një gjë, se ju e "keni" dëmtuar Mooladharen tuaj, kështu do ju duhet që ta sillni në normalitet. Ju duhet ta bëni atë të shëndetshme, një qender të balancuar, kështu Shri Ganesha mund të vendoset mbi të. Duke folur rreth Shri

Ganeshes, ju e dini, vibrimet behen shume te forta tek une.

Ne flasim për pafajsinë, por qe të zgjojme pafajsinë brenda vetes tonë ne duhet të jemi ne vezhgim te plotë, të kemi vigjilence te plote te mendjes tonë. Çfarë eshte ajo duke menduar? Ku eshte duke shkuar ajo? Ku eshte duke shkuar kjo vjedhese? Eshte ajo duke u munduar te bej ndonje hile? Eshte ajo duke bere ndonje hile? Në rregull! Ju duhet të jeni vigjilent, shume vigjilent.

Jam menduar per nje kohe te gjate per te folur rreth saj. Por tani dua t'ju them një gjë. Qe ju do të ekspozoheni. Kjo është një tjetër cilësi e Mahamaya-s. Ajo do t'ju ekspozojë ju. Ju do të ekspozoheni! Nëse ju perpiqeni të me mashtroni mua. Me mua dote thote me Kundalinin tuaj. Nëse ju perpiqeni te mashtroni Kundalinin tuaj atëherë ju do të ekspozoheni. Dhe ju do t'ju vij turp nga vetja. Kështu ju lutem bëni kujdes, shumë kujdes ne lidhje me të. Dhe përsëri, bejeni Mooladharen tuaj shumë të shendetshme, dhe të fuqishme.

Zoti ju bekoftë!

Kështu lutjet tona duhet të jene qe te mundesojne Mooladharan tonë të jetë e shendetshme dhe e fortë. Kjo është e gjitha. Le të lutemi.

Ka disa ushtrime për Mooladhara-n. Do t'ia shpjegoj Gavin-it I cili është lideri juaj në Angli. Dhe më pas ai do t'ja u shpjegoj ju. Ato duhet te shpjegohen verbalisht. Nuk mund te shkruhen. Liderët e ashrams dhe e vendeve të tjera duhet të vijnë dhe të më takojne çdo muaj ndonjehere dhe duhet të flasim për këto gjëra. Sepse është sekret, nuk eshte per tu diskutuar hapur, është një sekret, midis jush dhe vetes tuaj. Ai nuk duhet te shkruhet në ndonjevend. Ai nuk duhet te përmendet. Por duhet të vihet ne funksionim nga të gjithë ju, në te till mënyrë ne te cilen ju gezoni bekimin e Shri Ganeshesha. Është më tepër për zonjat, mund te them, se sa për burrat. Sepse burrat vuajnë më tepër se sa grate. Dhe kjo eshte pse grate duhet të jenë më të kujdesshme. Ndertoni nje mardhenje te shendetshme me vëllezërit tuaj. Derisa ju vertet te stabilizoni karakterin tuaj me te lartë, meshkujt nuk mund të permiresohen.

Ju e keni pare se në Indi femrat nuk pelqenje nese dikush perpiqet ti shikojte ato, ose perpiqet ti preke ato. Atyre nuk i pelqen kjo. Grate e kanë vuarë veten , e kanë djegur veten -mijëra prej tyre - sepse ato mendonin se disa njëzëz të tjerë mund te vinin dhe të preknin trupin e tyre. Eshte kaq e lidhur me me Atmen[3] tuaj, me shpirtin tuaj. Dhe sikurse trupi juaj – pafajësia është trupi i shpirtit tuaj. Ju të gjitha mund ta beni kete, sepse ju të gjitha jeni bërë Sahaja yogiste tani. Ato ( grate Indiane) nuk ishin Sahaja yogiste, por ato dinin nje gje - fuqinë e dëlirësisë se tyre. Është më tepër për zonjat, dhe ato duhet të perpiqen te gjenerojne ndjenjën e dinjitetit, te dëlirësisë, te hynores rreth tyre, shenjtërisë përreth tyre, kështu qe vete burrat do t'i respektojnë ato dhe do të zhvillojne këto ndjenja brenda tyre.

Faleminderit shumë!

[1] Dëshmitar.

[2] Pendesë, Asketizëm.

[3] Shpirtin

## 1985-0804, Shri Ganesha Puja, The Importance of Chastity

View [online](#).

Shri Ganesha Puja. Brighton (UK), 4 August 1985.

Jemi mbledhur sot ketu per rastin e duhur e nje dite shume te favorshme (ngritese) per te adhuruar Shri Ganeshen.

Shri Ganesha eshte Hyjnia e pare qe u krijua keshtu qe tere gjithesia eshte e mbushur me mbaresi, me paqe, lumturi dhe spiritualitet. Ai eshte burimi. Eshte burimi i spiritualizmit. Per kete arsye gjithe gjerat e tjera e ndjekin. Sikur eshte shi dhe fryn ere ndjen freskine ne atmosfere. Ne te njejten menyre kur Shri Ganesha perhap Fuqine e Tij i ndejme gjithe keto tre gjerat brenda dhe jashte. Por ka qene kaq e pafat, sidomos ne Perendim, qe Hyjnia me thelbesore dhe e rendesishme ka qene jo vetem teresisht e neglizhuar, por e fyer dhe kryqezuar. Pra sot edhe pse nuk dua te them asgje per t'ju merzitur ju njerez, duhet t'ju them qe te adhurosh Shri Ganeshan do te thote qe duhet te kete nje spastrim teresor brenda jush. Kur adhuron Shri Ganeshan kini mendjen e paster, kini zemren e paster, kini qenien tuaj te paster - jo t'ju vijne mendime epshi dhe lakmie. Ne fakt kur Kundalini ngrihet Ganesha duhet te zgjohet brenda nesh, "pafajesia duhet te vije" qe te fshije gjithe keto ide degraduese brenda nesh.

Nese ngritja duhet te arrihet, duhet te kuptojme qe duhet te maturohemi. Tani njerezit jane semure. Gjithcka mbi jeten e perendimoreve ndihet e semure. E semure sepse ata nuk e kane njohur kurre Shri Ganeshan. Nese erdhi nje Frojd s'do te thote se duhet ta pranoni. Por ju e bete - sikur te ishte nje gje kaq e rendesishme per t'u bere; si te mos kishte gje me te rendesishme se kjo. Prandaj sot ne jemi perballur me fuqine tone ngritese dhe me fuqine e kushtezimeve qe kemi patur. Kur foli per kushtezimet Frojdi nuk e dinte se po vendoste nje tjetër lloj kushtezimi te tmerrshem tek ju, te tmerrshem. Seksi nuk eshte i rendesishem per qeniet njerezore, fare aspak i rendesishem. Eshte vetem kur ju duhet te beni femije ne fakt nje qenie njerezore qe eshte niveli me i larte do qe te kenaqet me seks.

Joshja, romanca, kjo paarsyeshmeri dhe gjithe keto s'ekziston ne nje mendje te paster; eshte e gjitha nje sajim njerezor. Dhe ky servilizem i njeriut eshte kaq shume surprizues, e vjen nga nje kategori shume e ulet brenda nesh. Vjen nga shkalla e ulet e qenieve njerezore dhe njeriu behet servil i tij. Ju duhet te jeni mjeshter i saj. Dhe sot kur shoh perreth Meje, ne Perendim, qe eshte gjithashtu pjese perberese e te njejtit krijim, kane ardhur shume shume semundje, jam vertet e tmerruar, si te kthej tani vemendjen tuaj drejt maturise se seksit. Kur seksi maturohet ju beheni nje baba, nje nene, dhe nje person i paster. Kur degjoni per nje grua nentehjete vjecare qe martohet me nje djale nentembedhete vjecar, Them, ju thjesht s'e kuptoni, kjo eshte - c'lloj shoqerie eshte krijuar ne kete bote, kjo lloj sjelljeje e marre? Duhet te maturojme veten tone. S'do te thote qe po ju them per rreptesi ne moshe te re, nuk do te thote kete. Eshte nje tjetër absurditet.

Por sigurisht ju duhet te maturoheni; ju nevojitet nje tapasya per kete. Gje e parendesishme qe behet e rendesishme dhe nje gje e tille e parendesishme eshte si cdo gje qe kemi, si pasja e flokeve. Edhe kur humb floket do te thote dicka. Por nese humb seksin, c'problem ka? Eshte shume mire. Heqje qafe e nje mbeturine te keqe. Humbje e kote energjie. Kaq shume interes, kaq shume vemendje e cmuar. Eshte harxhuar kaq shume favorizim per kete lloj gjeje te paarsyeshme. Pra qe te adhuroje Ganeshen njeriu duhet te kuptoje qe duhet te maturohemi.

Maturia duhet te vije nga brendia jone. Duhet te shkojme me thelle brenda vetes sone; vemendja jone duhet te shkoje me thelle brendise sone, spontanisht. Si mund te arrijme thellesine nese jemi ende si krimbat? Perkunder eshte nje lloj sakrifice e madhe ose presion tek njerezit. Keto etiketime dhe presione kane qene shume te kushtueshme ju kane kushtuar shume juve njerez. Keni paguar nga kjo kaq shume; keni shkuar kaq larg. Per cfare? Pra duhet te ndryshohen prioritetet nese do te adhurohet Shri Ganesha. Ajo qe do te adhurojme sot eshte pafajesia brenda nesh. Po adhurojme ate qe eshte hyjnore, qe eshte e pafajshme.

Pafajesia, qe eshte thelle brenda nesh - qe eshte karakteri yne, qe eshte natyra jone, qe eshte ajo me te cilen jemi lindur" eshte baza e gjithe ketij Krijimi; eshte thelbi i ketij Krijimi. Pra kur lenda behet aktive, fillon riprodhimi, vjen stadi i kafsheve, me pas vjen stadi i qenieve njerezore qe jane primitive, me pas vjen stadi kur qeniet njerezore zhvillohen. Jo ajo menyre qe ne kuptojme si bote e zhvilluar, e tmerrshme. Nuk do i quaja aspak te zhvilluara. Ajo qe eshte e zhvilluar s'eshte prej jashte. Duhet te shihni cfare



eshte zhvillimi i brendshem. Cfare kemi rritur brenda? Cfare kemi brenda vetes sone? Cdo gje bruto, e madhe eshte plastike, e ketij lloj. Qe nuk ka rritur asnje fuqi te brendshme, themi per shembull, une ju jap nje mango.

Them, "Mire, tani hajeni." Dhe ju shihni qe ka levizhjen e asgje brenda saj, c'do te hani? Do e hani ate gje plastike? Cdo gje qe rritet si kjo plastike, eshte e vdekur. Le te shohim, cfare substance eshte brenda. Cila eshte substanca brenda vetes sone? Kjo eshte ajo qe predikoi Krishti "ceshtja e moralit." Ishte kaq e rendesishme per te. Sepse pas dharmas, qe ishte balance, ku sigurisht morali eshte shume i rendesishem, por ishte e nevojshme per Krishtin te fliste per nje moral, te brendshem e te thelle, qe eshte pjese perberese e qenies, s'eshte e mesuar, e thene apo frikesuese sepse ka nje frike dhe zemerim te Zotit. Por duhet te jete drita juaj e brendshme, prandaj Krishti foli rreth saj.

Dhe i njejti Krisht u perdor per rrenimin e pafajshise. Dhe s'mund te them qe njerezit s'ishin te paralajmeruar. Frojdi s'ishte i vetmi person qe u lind. Nje dite me pare vajta ne Prado ne Spanje dhe pashe piktore pas piktore te ferrit. Dhe ne keto kohe moderne shohim keto sterhollime seksuale sorrollaten pa rroba, tipe njerezish qe shfaqen me gjithë keto gjera qesharake, duke bere budallalleqe. Ky ishte Bosch, U habita nje gjerman, Bosch, qe shfaqti gjithë kete pakuptuesmeri, shume qarte - rruga drejt ferrit, me pas sulmi i vdekjes, keshtu. Do thoja qe eshte nje person pak a shume i tanishem, Nese e quani Blake te krisur, po Bosch-in? Gjithkush eshte i krisur, me perjashtim te njerezve budallenj te padobishem. Kaq shume paralajmerime na kane ardhur. Per shembull, mund te themi, prej kohesh e dime per ferrin.

Mahavira e te gjithë personave shkroi kaq qarte per ferrin. Ky eshte ferri. Por ne Perendim prioritetet jane absolutisht kokeposhte. Cila eshte fuqia juaj? Thjesht mendojeni. Mendojeni brenda vetes. Eshte fuqia mendore e rendesishme? Ju kam thene qe fuqia mendore s'ka te beje fare, sepse eshte thjesht lineare, leviz ne nje drejtim, bie, kthehet tek ju. Nuk ka substance ne te. Eshte thjesht nje projektion mendor, plastik.

Cila eshte fuqia juaj emocionale? Ku ju kane cuar emocionet qe keni patur? Shikoni per ke keni emocione, edhe kur keni emocione te mira. Te themi, ju e doni shume gruan tuaj. Ku ju con kjo? Ishte nje poet i quajtur Tulsidasa qe e donte shume gruan dhe ajo kishte vajtur ne shtepine e nenes se saj. Keshtu ai s'mund ta duronte kete dhe shkoi ta shihte dhe ai ngjitet ne balkonin e saj ku ajo lemeriset. Ajo e pyet, "Si u ngjite ketu?" Ai i thote, "Ti kishe vene nje litar atje." Ajo thote, "Jo."

Dhe pane qe ishte nje gjarper i madh i varur. E ajo thote, "Kjo sasi dashurie qe ke per mua, nese do e kishe per Zotin, ku do te ishe?" Pra ku ju cojne keto emocione - ne zhgenjim, palumturi, drejt shkaterrimit tone. Forca mendore ju jep nje gje te tmerrshme te quajtur ego, e cila i shkaterron te tjeret. Dhe forca emocionale s'ju jep asgje vec te qara, ankesa dhe ndiheni gjithmone te palumtur, "Oh, kam investuar kaq shume emocionalisht. . ne kaq e kaq persona e cfare kam marre?" Pra s'eshte absolute, eshte relative. Dhe menderisht jeni zero nese s'mund te shkaterroni te tjeret. Emocionalisht jeni zero sepse s'mund te mbifuqizoni njerez me emocionet tuaja.

Pra cila eshte forca juaj? Ku qendron forca juaj? Qendron tek Shpirti. Por edhe para se te arrini tek Shpirti, cila eshte forca juaj? Eshte Kundalini? Ajo eshte duke fjetur. Atehere cila eshte forca juaj? Eshte dliresia juaj. Nese njeriu eshte i dliret, ka temperament te dliret dhe qendron ne dliresine e tij, ajo vepron, punon. Por para se gjithash dliresia jep fryte ne te mire te shendetit.

Nga fytyra e nje personi mund te thoni nese ky person eshte i dliret. Si Shastras qe e perdorim per te thene Shenjt apo brahmachari, ai qe nuk ka bere kurre seks ne jete, gjithë ndricim ne fytyre. Dhe sic themi qe brahmachari me i madh ishte Shri Krishna qe kishte kaq shume gra. Sepse s'ka harxhim te energjise, as te vemendjes ne te. Pra e gjithë energjia eshte brenda. Po ju them qe kur erdha sot me makine ishte duke rene shi, kishte ere dhe ishte shume ftohte, por ne ishim ne makine, asgje s'na prekte, sepse ishim mjaft ngrohte brenda makines, Kaluam permes gjithckaje, asgje s'na preku, asgje s'na bezdisi, erdhem, cdo gje per bukuri. Si? Sepse ne ndenjëm ne makinën tone dhe mjeti qe kemi ne eshte dliresia jone. Jemi kaq te vecante sa te tjeret duhet te na respektojme, te tjeret duhet te na nderojne, perndryshe ne merzitemi. E keni respektuar veten?

E respektoni veten tuaj? Ndonjehere njerezve Perendimore u duket sikur Nena perpiqet shume te predikojë rreth kultures Indiane. Shume njerez e mendojne keshtu. Por une them qe njeriu duhet te mesoje shkencen prej Perendimit. Mire. Duhet te mesoje gjera

te tjera nga Perendimi, sigurisht, estetikën. Pikturën dhe artin, mbase skemen e ngjyrave. Por me mire që kulturën ta mesoni nga Indianët. Shoh që ka pisllek kulturre, aspak kulturre. C'është kjo kulturre që gruaja duhet të ekspozojë trupin e saj?

Është një kulturre prostitute, e thjeshtë fare. Perballuni. Kur një grua supozohet të mos respektojë pjesët e saj private, nuk është fare kulturre në estetikën e Hyjnës. Kaq shumë sa tani janë duke bërë një film ku e shfaqin Marine si një prostitute. Dua të them, deri këtu keni arritur. Nëse e thoni këtë në Indi do ju rrahin mire - gjithkush, qoftë Mysliman, Hindu, Kristian. E kam fjalën, tronditese të degjosh si flasin për Krishtin. Ju them që për një Indian është shokuese. Si mund të flasësh, sepse kur ti ke hequr dorë nga dliresia jote nuk mund ta kuptosh që dikush mund të jetë absolutisht i dlirët. Për një hajdut çdokush është hajdut.

Sepse kur nuk ke respekt për dliresinë tendë s'mund të perfytyrosh çfarë mund të ketë qene Krishti. Nuk mund të imagjini, s'mund të pranoni. Gjera të padurueshme janë thënë për Krishtin. Po ju them, të padurueshme. Nuk e di. Une e kam hasur kryqezimin e tij, që ishte i padurueshëm. Por të thuash një gjë të tillë për dike; nëse i ve një njollë të tillë një gruajë indiane, një gruajë të zakonshme indiane, ajo mund të bëjë vetevrasje. Kur s'është e thënë që të vijë dikush e të thotë, "Dukesh shumë e bukur." Është e drejtë, nëse ja thua nënës tendë, "Dukesh shumë mire", në rregull, është ndryshe. Por s'duhet t'i thuash asnjë gruajë ashtu.

Duhet ta ktheni nga vetja. Dhe kjo është një nga arsyt pse njerezit janë gjaknxehtë. Magneti brenda jush është Shri Ganesha. Shumë njerez e dine që une kam një sens të mirë të drejtimit. Kjo vjen nga ky manjet që është perfekt. Ky manjet është ai që ju mban të qendrueshëm ose të pershtatur ose gjithë kohës të drejtuar drejt Shpirtit. Nëse nuk keni sensin e dliresisë do perkundeni në këtë e atë mënyrë. Papritur beheni një Sahaja Yogi shumë i mirë, të nesermen beheni një djall" sepse s'ka asgjë që ju mban të lidhur ndaj idesë së madhe të Shpirtit. Le të perballemi me këtë. Tani ka ardhur koha për të gjithë ne, të gjithë Sahaja Yogistet, që gjeja me e madhe brenda nesh s'është seksi, por dliresia.

Dhe kjo është ajo që do ju maturojë juve. Është e habitshme si disa njerez po silleshin në Bordi, Kur e mora vesh, mbeta e habitur, si mundeshin ata të silleshin kështu ndaj fshatareve të Bordit, që janë të pafajshëm, njerez të thjeshtë? Por pjesa më e bukur e saj kur kenaqeni me sjellje të lehtë dhe të pakuptimta, duke fyer dliresinë tuaj, ju realisht mbeteni në veprimin e saj. Si nëse shkoni kot benzinen, makina s'leviz dot, është kështu, ju ndodh dicka. Gjithë kohën duke ngacmuar (pickuar) njerezit duke mashtruar me fjale njeri tjetrin, c'është nevoja e të gjithë kesaj, une thjesht s'e kuptoj. E me pas mbaron në ceshtje divorci. Një here vajta tek Selfridges (linjë dyqanesh) Do ju tregoj një histori interesante. Dhe në atë turmë ishin dy njerez, burrë dhe grua, duke u puthur gjithë kohës, duke bezdisur edhe njerezit e tjere që po shkonin në të njëjtën shkallë levizese. Në shkallë po putheshin, në atë gjë po putheshin, Them, duke torturuar gjithë Indianët që ishin aty apo edhe njerezit e tjere, Kineze apo për shembull Egjiptiane. Po jepej një shfaqje e tillë.

Dhe kur i pashe herën tjetër, Nuk po putheshin. U them, "C'ndodhi?" "U divorcuam." U them, "Pse po putheshit aq shumë atë ditë?" Me thone, "Sepse po divorcohem dhe , donim të kishim grimen e fundit të saj." Çfarë niveli është kjo. Imagjini çfarë niveli. Çfarë dashurie, c'ndjenjë keni për këdo, asgjë të ketij lloji. Gjithë kohës duke u grindur me njeri-tjetrin, duke perfunduar në ceshtje divorci dhe duke i nxjerrë keto sheshit. Çdo person i thellë nuk i tregon keto gjera.

Sigurisht, me kanë thënë që këtu në shkollën publike thuhet që kur nuk duhet t'i shfaqësh emocionet. Por nga ana tjetër mund të tregosh çdo gjë tjetër, qesharake apo të paturpshme. Por jo emocionet tuaja. C'vënd absurd është ky. I keni pranuar gjithë keto vlera, thjesht si dele, pa menduar rreth tyre. Si kur isha në France, një vajzë vjen tek une duke qarë. Ajo thotë, "Une jam - e tmerruar, tmerruar, Nuk do të shkoj kurë tek këta psikiatër." Une e pyes, "Pse?" "Ata thone gjera të shemtuar për babain tim." Imagjini.

Dhe njerezit i pranuan keto idete të ketij Frojdi të tmerrshëm. Është gabim që në themel. Nëse është historikisht kështu, apo çfaredoqoftë është me mirë të hiqni dorë. Çfaredo gabimi është gabim, në Hyjnoren. Çfaredo e drejtë është e drejtë, në Hyjnoren. Por verëhet një kundërshti e vertetë tani, që njerezit kur shkojnë jashtë, burrë e grua e kështu e ashtu, puthen me njeri-tjetrin e ngacmohen me njeri-tjetrin. C'është nevoja? Ti puth këtë person e vjen e Me flet kunder ketij personi, E kam parë këtë. Nëse duhet të ketë vete-ruajtje, kjo duhet të jetë dliresia juaj, privatesia juaj. Kjo është arsyeja që s'keni vullnet të bëni asgjë, pa vullnet.

Le t'ju vijne disa shoke budallenj e t'ju thene budallalleqe, ju do thoni, "Ne rregull. Ne pranojme." Cila eshte esenca e personalitetit tuaj? Dliresia juaj. Dhe ne Sahaja Yoga mund te ri-stabilizosh cdo gje mundesh, cfaredo qe ke humbur. Kjo eshte arsyeja pse mungon thellesia. Dhe kjo eshte arsyeja pse nuk ka logjike (konsistence) ne temperamentin e njerezve, s'ka lidhje logjike - konsistence. Tani mund te gjesh njezet njerez per leksionet e mia dhe te nesermen as edhe nje, humbur te gjithe. Sepse e dini nuk ka baze. Si nje lidhje e humbur.

Nuk ka lidhje, pika e lidhjes eshte dliresia tuaj. Pra nuk ka konsistence, sthaapayati nuk eshte aty. Nese u thua, "Duhet te ngriheni ne mengjes, beni banje, beni pak puja, "Kjo eshte shume per ata". Por nese u thua, te themi nje grua Indiane apo une, nese thua "qe vish kete ose ate veshje," Une thjesht s'mundem, thjesht s'mundem, jo s'eshte e mundur, s'eshte. Mund te rri gjithe naten zgjuar, por kete gje s'mund ta bej, thjesht s'mund ta bej. Pra prioritetet ndryshuan per shkak te vendndodhjes se vemendjes suaj. Keni gjithcka brenda jush. Ju jeni depoja e dliresise, qe eshte fuqia juaj. Gjithcka brenda jush, asgje s'ka ikur jashte, eshte aty e gjitha. E gjitha kjo arome eshte brenda jush.

Eshte e gjitha e ruajtur. mos denoni veten. Dhe ju jeni kaq fatlume Jam ketu per t'u treguar gjithcka rreth saj. Jeni kaq me fat Une jam me ju. E kuptoni kete pike? S'ju duhet te shkoni ne Himalaja; s'ju duhet te rri kokeposhte. S'ju duhet te beni asgje te tille. Dikur keta shenjtoreshin, e dini, s'do ta besoni, ne uje te ftohte te ngrire ose ne Himalaja ne vend te hapur uleshin se bashku per ore te tera Kjo tani s'eshte e nevojshme. Eshte bere shume e lehte. Por tani ndryshoni prioritetet tuaja.

Kur e gjitha vemendja shkon tek Shpirti juaj do habiteni qe i gjitha grafiku do te ndryshoje. Cila eshte gjeja me shume e rendesishme? Te meditoni cdo dite. Kam pare njerez qe duan te bejne kurse, te themi, per shembull, U thashe "Me mire beni disa kurse." Cdo dite do te shkojne ne kurs ti bashkohen klases dhe do te punojne shume e do ta kalojne kursin do ia dalin e do e mbarojne. Por nuk mund te bejne rregullisht meditimin. Por duhet te kuptoni tani qe ka nje shteg te vogel, qe sapo merr ngjyren e ketij gezimi qe eshte i perjetshem, ne fillojme levizim drejt saj gjithnje e me shume, gjithnje e me shume duke e stabilizuar veten tone ne oqeanin e ketij gezimi. Nga pak, e dini, kur dikush ju kerkon te notoni, e ju jeni te frikesuar, nuk doni ta beni, jeni shume te lumtur ne bregun e gjere, e nuk doni te notoni. Dikush ju shtyn, po ju perseri ktheheni, "Jo baba, s'mund ta bej." Por me te mesuar notin ju e shijoni te notuarit.

Dhe kur ju pelqen me pas doni ta beni cdo dite, rregullisht, me besim. Pra eshte nje shteg (hapesire) te cilen duhet ta arrime. Pika e dyte eshte se sic ju kam thene gjithmone, ju jeni lotuse, por nen balte. Dhe ju e dini c'eshte balta, ndersa India eshte oqeani, pra eshte shume e lehte per lotusin te dale mbi uje. Por te dalesh mbi balte eshte shume e veshtire. Te themi, dikush bie ne balte. Nese e shkelmon, shkon me thelle. Nese perpiqesh te besh ndonje gje shkon me thelle. Gjeja me e mire eshte ta shohesh dhe te rrish i qete. Dhe kjo eshte menyra me e mire "eshte te deshmosh veten."

Por si te deshmosh, kur vemendja juaj nuk eshte ne rregull? Vemendja eshte: dikush shkon ne kete ane" kete person do te shikoni. Nje person tjetër shkon andej" ate person shikoni, duhet te shihni cdo person. Por ju nuk shikoni lulet, nuk shikoni pemet, nuk shikoni Nenen Toke, ju s'shikoni asgje. Ajo qe shihni eshte dicka e keqe e pashprese, me keq se ju. Thuhet se sot eshte dita qe nuk duhet te shihet hena. Nese shikon henen behet e pafat dhe merr emer te keq. Thone se Shri Krishna e pa henen dhe Ai mori emer te keq; Ai ishte ranchordas, do te thote Ai duhej te largohej (mbathte) nga fushe beteja. Por kjo ishte hileja e Tij, Ai duhet t'ia mbathte. Pra supozohet qe ju s'duhet ta shikoni henen.

Arsyeja pse u tha kjo eshte, se sot duhet te shohim Shri Ganeshen, qe eshte Nena Toke, qe vepron nepermjet Nenes Toke. Shumica e gjerave qe kemi jane prej Nenes Toke. Pra kete radhe duhet te shikoni Nenen Toke, Kundalinin dhe Shri Ganeshan, sot. Nena Toke ka krijuar Shri Ganeshan. Pra ju s'shikoni asgje jashte, madje s'shikoni as henen. Thjesht shikoni Nenen Toke. Sepse Nena Toke ne dashurine e Saj dhe dhembshurine ka bere kaq shume per ne, Kundalini juaj ka bere kaq shume per ju. Dhe Biri i Saj, i Cili eshte pafajesia brenda nesh, eshte per t'u adhuruar sot sepse Ai ka bere maksimumin. Perkunder gjitha fyerjeve qe kemi bere ndaj Tij, gjitha talljet, gjitha ndyresite, gjitha llojet e pakuptimita, Ai qendron ende si nje femije i vogel qe na zbavit. Nese Shri Ganeshia eshte brenda jush ju beheni si nje femije, pafajesi femijnore, nuk zemeroheni me asnje Sic leh nje qen; ka disa Sahaja Yogiste qe njoh qe lehin gjitha kohes, tamam si qente apo lypesit ne Indi.

Por beheni si nje femije qe eshte shume i embel, qe gjithmone perpiqet t'ju zbavise, gjithmone provon te thote gjera te kendshme, gjithmone provon t'ju beje te lumtur. Burim i nje gezimi te tille. Dhe keshtu ju beheni burimi i gezimit, burimi i lumturise, burim i permbushjes. Gjithe kohes duke pluskuar ne te qeshura dhe lumturi, pluskuar me gjera te mrekullueshme. Sic ju zbavisin femijet, vetem shikoni e vereni. Si sillen rrotull me duart e vogla fare, si ia dalin. Si e dine cila eshte gjeja e duhur. Nje femije qe eshte nje shpirt i Realizuar eshte me i ndjeshem se nje person i rritur, e kam pare kete. Si mbesa ime me e vogel, mendoj se ishte rreth 3 vjece dhe sherbyesja po paloste sarin Tim dhe gabimisht e vuri ne toke. Ky femije s'mundi ta duronte dot.

Vetem sa e ngriti sarin, e vuri ne koken e saj dhe me pas ne divan. Ajo thote, "Cfare do te thote ta vesh sarin ne toke, cfare di ti per Gjyshen time? Ajo eshte Zoti i Zotave dhe ti ve sarin e Saj ne toke. Qente do te hane ty tani, " i thote, " Kij kujdes. " Dhe shkoi perseri vuri sarin, e puthi dhe puthi ate, dhe tha, "Nene fale ate, Gjyshe, te lutem, fale kete grua, ajo nuk e di cfare te ka bere Ty. " Por ndjeshmeria e madhe vjen nga thellesia e dlirese suaj. Degjojini femijet dhe do mbeteni te habitur si flasin dhe cfare thone, si sillen, si ata provojne t'ju zbavisin. Dua te them, ne Perendim femijet jane shume te llastuar, ta themi, ata nuk te zbavisin dhe aq, ju trazojne shume. Sepse perseri e perseri e njejta gje. Nese babai dhe nena nuk kane dlirese, femijet nuk ndihen mire, nuk jane te qete, do te behen te shqetesuar, dhe me pas zhvillojne te njejtin shqetesim brenda vetes.

Nje njeri i dlire nuk mund te zoterohet kurre, ta kini nga Une, s'mund te zoterohet kurre. Mund te jeni shume inteligjent, mund te jeni gjithcka, mund te jeni nje shkrimtar i madh, por mund te zoteroheni. Por nje njeri i dlire, nje njeri i zakonshem i dlire nuk mund te zoterohet kurre. Fantazmat frikesohen nga njerezit e dlire. Nese rruges ecen nje njeri i dlire, gjithsej fantazmat largohen. Ato vetem largohen. Di shume raste e disa mund t'ua them edhe juve, qe ishin tre prej tyre, qe zakonisht dilnin me motociklete neteve neper rruge rreth ores 12. Dhe disa njerez qe ishin te zoteruar Me shkruanin letra, duke me thene qe "Ju lutem mos i lejoni ato te dalin naten, sepse ku te shkojme e te rrim?" Mbeta e habitur. Keta jane njerezit te zoteruar nga disa lloj fantazmash te tmerrshme qe shkonin zakonisht te pushonin nen keto peme gjate nates ku keta persona zakonisht shkonin me motorr dhe ne fakt ata Me shkruajtën leter.

Njerez shume te zoteruar, e dija, me thane qe, "Kerkoji atyre mos te vijne ne kete rruge, po ne ku te jetojme?" Dhe jane si te cmendur, njerez te vetecmendur. U them, "Pse me shkruat keshtu?" Thane, "Keta njerez shkonin nga kjo rruge dhe na shqetesonin." Negativiteti brenda nesh zhduket me driten e Shri Ganeshes. Mund ta shohesh kaq qarte ne personin tjetër. Nese nuk ke dlirese nuk mund te shohesh kurre kush eshte i dlire ose i padlire, ju mundesh. Gjithsecili njesoj, "Shume i mire, shume i mire, shume njeri i kendshem, shume njeri i mire". Pra njerez vertet te zoteruar etiketohen si njerez shume te mire, ndonjehere edhe ne Sahaja Yoga dhe filloj te pyes, "Cfare po ndodh, c'eshte kjo? Si mundet qe keta njerez jane te etiketuar keshtu?

S'mund ta ndejne kete?" Nuk ka drite. Edhe nese merr Realizimin tend, edhe nese Shpirti yt funksionon me ndergjegjen tende kolektive, edhe nese je duke u dhene Vete Realizim te tjereve, nuk je asgjekundi nese nuk ke dlirese. Eshte si nje gote e thyer qe po provon te reflektoje dicka; s'mundet kurre te jape pamjen e duhur. Eshte kaq e rendesishme. Dhe me duhet t'ju them juve tani. Ka ardhur koha qe Une t'ju tregoj "kjo eshte nje pengese ne jeten tuaj." Gjeja e pare qe njerezit pyesin, "Me ke do te martohem?" C'eshte me kaq nxitim? Sigurisht qe martesën e quaj nje gje me fat, duhet te kete martesë, duhet te kete nje sanksion kolektiv, cdo gje, por per cfare?

Te admirojme dlirese brenda nesh. Me pas martohen, pastaj behen me femije. Me pas duan te kene nje shtepi, pastaj duan te kene kete. Gjendet gjithsej ky biznes i izoluar qe vazhdon e vazhdon, dhe drita e jetes suaj nuk perhapet. Por kam njohur njerez qe ishin tamam ne ferr qe dolen jashte dhe perhapen driten, arriten meteore te larte te bukur. Kam pare njerez te tille. Pra sot keni ardhur te adhuron Shri Ganeshen - brenda vetes suaj. Se cfare jam Une qe te adhurohem si Shri Ganeshen nuk e kuptoj. Sepse une jam Kjo. Kur me adhuron Mua ju doni te keni te zgjuar brenda Shri Ganeshen.

Le te zgjohet ajo brenda jush. Le te shnderrohet ne mantra e zgjimit brenda jush ajo qe them une, qe ju si femijet te Mij te gezoni lumturine e dlirese sic kam shijuar gjithsej jeten Time njerezore dhe gjithsej jeten e Mia hyjnore. Ju shijoni te njejten sasi, kjo eshte ajo qe dua. Te pakten ju duhet te keni shijen e saj. Do ju tregoj rreth dickaje te cilen mund te mos e keni degjuar me pare. Por ju nuk keni degjuar as per Kundalinin gjithashtu. Nuk keni degjuar kurre keshtu per Vete Realizimin. Por mendoj se per fat sot, teresisht ne menyren e Sahaja, eshte organizuar kjo Puja. Isha per ta bere ne Bombay kete Puja. Qe e organizuar e gjitha; gjithsej

njerezit po deshironin te shkonin atje, per te bere kete puja.

Dua te them, Ganesha Puja ne Angli ose ne Perendim eshte kaq e rendesishme e mendova me mire ta kemi nje, jo ne kohen e duhur ne Rome, e cila eshte nje nga gjerat baze qe ka rrenuar dlireesine e qenieve njerezore. E filluan Romaket dhe te tjeret e vazhduan. Por duhet te ishte ketu ne Brajton ne Kembet Lotus te Sadashiva. Por Anglezet duhet ta dine qe kane nje toke kaq te pruar sa nuk e meritojne ate. Ata duhet ta meritojne. Imagjinoni, ju po jetoni ne token e Sadashiva ku "pikat (rruazat) e ujit dhe bora gjithashtu " jane si uje i distiluar, e paster, e kulluar, e bardhe. Ku Shri Ganesha eshte Ai qe lan kembet e Babait te Tij. Ku dlireesia vete qendron si Nena juaj. Dhe ju duhet ta meritoni kete pozite te lakmuar. Sahaja Yogistet angleze duhet te jene shume te hapur.

Krejtisist e kunderta e Anglezeve ketu. Te ardhur prej tokes se Sadashiva-s krejt e kunderta. Arrogance e tmerrshme, arrogance kaq e tmerrshme, sa dikush s'mund ta mendoje ne vendin e Shivas. Gjithe njerezit e padlire (pamoralshem) jane arrogante. Perndryshe, si mund ta falin veten? Po te flisni me nje prostitute, ne dy minuta do e kuptoni qe ajo eshte nje prostitute sepse eshte ekstremisht arrogante, "C'problem ka? Jam nje prostitute, e pastaj?" Arroganca eshte shenje e nje personaliteti te pamoralshem. Dhe nje person i tille behet edhe i izoluar se eshte i turperuar, i turperuar te perballat me te tjeret. Por nje personaliteti i dlire eshte i hapur, pse duhet te frikesohet nga dikush?

Cdokujt i flet mire, i mire me gjithkend ne gjithe pafajesine dhe thjeshtesine pa rene ne dashuri me cdo person te trete qe i kalon afer. Dhe kete, duhet te kuptoni, qe ky vend iu eshte dhene juve per nje qellim dhe nese nuk arrini te dilni ne kete nivel, do te hidheni tutje. Pra duke respektuar dlireesine tuaj eshte vertet respektim ndaj Meje, sepse une qendroj brenda jush si dlireesia. Nese Shri Ganesha eshte mbaseesia (ngritja shpirtore), Une qendroj brenda jush si dlireesia. Dlireesia nuk eshte kurre agresive, s'eshte kurre e ashper, sepse e dini nuk ka nevojte. S'ka nevojte, ju jeni kaq te plotefuqishem, kaq te plotefuqishem, sa s'eshte nevoja te jeni agresive me askend. Pse te jeni agresive, s'keni frike nga askush. Eshte kaq bujare, eshte kaq e kendshme, eshte e bukur, gjithmone e fresket dhe e re, ende kaq sublime dhe dinjitoze. Kane kaluar 12 vjet qe kur kam qene ketu. Edhe dy vjet me shume, nevojitet pune shume intensive, brenda dhe jashte.

Brenda duhet te punojme shume keto dy vjet, shume pune, duhet te futemi vertet ne tapasya te gjithe ne, qofshim burre apo grua. Dhe me pas do te shohim. Mund ta them kete, qe kemi bere nje pune te mire, me pak shtyse, guxim dhe besim ne mund te arrijme shume. Kini besim ne veten tuaj. Jo besim mendor por dlireesia faktike eshte besim. Dlireesia eshte konsolidimi i besimit tuaj. Kur ke besim ne Zot, je i dlire. Kur ke besim ne veten tende je i dliret. Ke besim ne gruan tende, je i dliret. Pse duhet te kesh besim ne gruan tende?

Sepse ti je nje person i moralshem, si mundet ajo te jete e pamoralshme? Besimi tek femija juaj - ne dlireesi sepse je i dliret, si mundet femija juaj te jete dicka tjeter? Forma kristaline e besimit eshte dlireesia. Dhe kete mund ta keni edhe para Realizimit. Shume e kane. Ashtu si kamfuri, i cili, e dini, eshte i paqendrueshem dhe avullohet ne arome, mund te themi qe ne njeiten menyre dlireesia vepron tek besimi. Nese nuk ke dlireesi nuk mund te kesh besim, ne asgje. Sepse ka te beje edhe me emocionet tuaja qe ju jeni te varur (ngjitur) emocionalisht ndaj Meje ose mbase menderisht ndaj Meje. Por nese keni sensin e dlireesise besimi do jete i dukshem. Nuk keni pse te keni besim brenda vetes, "Nene tani une do te kem besim brenda vetes."

S'mundeni. Besimi eshte dicka, qe eshte i paqendrueshem dhe aroma e paqendrueshme vjen nga dlireesia. Pra sot ne s'do te shohim yjet apo henen, por ju do te shikoni tek Nena Toke. Ajo qe perfaqson ne Univers Kundalinin, s'eshte asgje tjeter por dlireesia. Eshte vetem dlireesia. Mund ta besoni? Cfare fuqie. Memesia, gjithcka eshte dlireesi. Atesia, cdo mardhenie eshte dlireesia. Pastertia eshte perseri aroma e dlireesise.

Miresise, dhembshurise, cdo gje vjen nga dlireesia, nje sens i dlireesise, qe s'eshte mendor. Nese jeni menderisht i dlire, mund te jeni i tmerrshem. Sic jane disa murgesha apo disa nga ata njerez qe jane te rrepte, jo keta. Dlireesia eshte Kundalini brendshem i ngritur brenda jush, qe vepron sepse Me kupton Mua. Ajo me kupton Mua, Ajo me njeh Mua, Eshte pjese perberese e Imja, eshte reflektimi Im. Prandaj forcojeni Kundalinin tuaj duke qene te dlire. Njerezit provojne te bejne gjera per tu dukur terheqes dhe kete e ate. Mos e harxhoni keshtu energjine tuaj; ju jeni shenjtoze, jetoni si shenjtoze. Tradicionalisht jetojme, duhet te jetojme ne kete menyre, dhe te evoluojme prej tradites; mos te bejme dicka te re, dicka absurde, pa kuptim. Nuk duhet te terheqim askend.

Dliresia eshte aroma e lules, qe terheq bletet, eshte mjalti i lules, eshte thelbi i ekzistences suaj. Pra ne kete kohe ju te gjithë jeni duke ardhur ne Indi, Une ju kerkoj juve te Me respektoni duke mos u sjelle keq, Jo sjellje femijnore ne menyren qe shihet ne foto apo filma e keto gjera te pakuptimta. Ju jeni mbi gjithcka. Vemendja, arritjet duhet te shihen prej vendit te dliresise suaj. Ne s'mund te leme vendet (karriget) tona, nese duartrokitemi ose jo, nuk ben asnje ndryshim. Nuk mund te leme vendin (karrigen) tone. Ashtu si gjithë keto avadhootas do thone, takiya sodaa sana - do te thote qe nuk i leshojme vendet tona. Ne jemi ulur ne vendin (karrigen) tone. Kjo eshte karrigia jone, ne lotus. Ne s'mund ta leme lotusin.

Ne jemi ulur ne lotus. Ky eshte vendi yne. Pastaj gjithë keto gjera te pakuptimta qe keni pervetesuar do te bien poshte. Do e shihni qe do te beheni nje qenie e bukur. Gjithë fantazmat do te largohen, do largohen gjithë ngercet. Por nuk eshte rreptesia, po jua them perseri e perseri. Eshte respekti per Qenien tuaj. Sic me respektoni Mua nga jashte, Me respektoni prej se brendshmi. Thjesht fare. Sot eshte nje dite e madhe per ne qe te adhurojme Shri Ganesha.

Ai eshte i pari dhe me i rendesishmi per te adhuruar. Dhe kur te adhuron Ate, ju duhet te kuptoni qe ju po adhuron gjithashtu edhe manifestimin e Tij, qe eshte i Krishtit. Cdokush qe flet me percmim per Krishtin, ju duhet te neveriteni prej ketij personi. Ju nuk duhet te intelektualizoni Krishtin. Cilido qe e ben kete, s'ka lidhje fare me kete person. Krishti eshte pafajesia. Nese nuk keni thellesine e dliresise suaj s'mund ta kuptoni Ate. S'mund ta adhuron Ate. Me e mira qe ata mund te bejne, ti japin fund dliresise suaj qe ju te mos e njihni kurre Ate. E gjithë kjo vjen nepermjet perpjekjeve tuaja medituese.

Tani perpjekja duhet te jete qe ju duhet te jeni meditative. Kjo eshte e gjitha. Vazhdoni me meditim tuaj (mbajeni ate). Perpiquni te jeni meditative. Shikojini gjerat. Gjendja e deshmitarit s'eshte gje tjeter vetem qe ju jeni meditative. Prandaj vendosa qe do i takoj njerezit e Brajtonit edhe neses ne mengjes ketu dhe do te takoj gjithë njerezit Angleze nese eshte e mundur edhe pasneser mbrema per t'u thene se sa e rendesishme eshte per ata te arrijne kete gjendje te pastertise. Mendoj se eshte duke funksionuar. Une punoj vertet shume, nuk e keni idene se sa rende punoj. Por thone qe kjo eshte edhe ideja qe, eshte nje ide qe njerezit mendojne se te tjeret duhet te bejne punen e tyre.

Kjo eshte si te kursesh qindarkat, kete ruaje, edhe kete ruaje dhe gjithashtu kursim pune. Lereni Nenen te beje punen per ne. Nena kujdeset per ne. Ajo duhet te ngrihet ne mengjes. Ajo duhet te beje meditim. Nuk ka kursim. Mund te kurseni cdo gje tjeter nese do dinit si te kursenit Shpirtin. Vetem ngritja juaj eshte e rendesishme. Kur te ngriheni, cdo gje eshte e ruajtur. Por fillimisht kurseni (ruani) veteveten.

Per kete ju duhet te perpiqeni. Ju duhet te punoni fort. Duhet te shkoni thelle vetes suaj, evoluoni veten. Jeni te mjaft te afte per kete. Mos fajsoni askend; mos fajsoni gruan tuaj, nenen, babain, vendin, askend. Gjithkush mund t'ia dale. Mos shikoni te tjeret, shihni veten tuaj, "Sa larg kam vajtur? Cfare kontributi kam dhene? Le t'i shkoj ne krye kesaj." Gjithkush prej jush.

Jam shume mirenjohese per gjithë njerezit qe kane ardhur anembane Anglise. Ne nje fare menyre ishte gjeja e duhur per t'u bere, por ky vend duhet te krijohet ne ate nivel qe te shnderrohet ne pelegrinazh per secilin qe te vije ketu. S'duhet te ndodhe e kunderta qe me te ardhur ne Angli, paskesaj ata mos te vijne me kurre ne Sahaja Yoga. Mund te ndodhe, mund te ndodhe me arrogancen qe kane njerezit, mund te ndodhe edhe keshtu, qe kur te vijne ketu ata do te thone, "Jo me Sahaja Yoga, pata mjaft prej saj." Tjeter drejtim me Indine, kur ata vijne ne Indi ata ngecin aty. Kam njohur disa njerez qe erdhen ne Angli dhe menyra se si ata, disa nga Sahaja Yogistet u sollen dhe disa drejtoheshin, ata ja mbathen direkt. "Nene s'kemi c'te bejme, nuk do te rrimë me ne Sahaja Yoga pasi pame Sahaja Yogistet e zhvilluar te Anglise ku ju keni punuar per njezet vjet." Pra sot ne jemi ulur ne kete toke te bukur te Anglise dhe kemi sigurisht borxhe per te paguar, qe kemi lindur ne kete vend, dhe borxhi eshte se ne duhet te jemi Sahaja Yogiste shume te mire. Mund ta kuptoni shume lehte, cili eshte nje Sahaja Yogi i mire. Kur ju thoni qe, "Mbylleni ate dritare," do shihni qe shumica do rrine te ulur duke pare tek te tjeret.

Nuk po them qe te gjithë ata jane Angleze por mund te jene. Ti besh te tjeret te punojne nuk eshte zgjidhja. Duhet te jeni vertet te dedikuar. Ju nuk jeni te atij niveli, Me besoni nuk jeni te atij niveli. Mos shikoni tek personat e tjere qe jane ketu. Ju jeni tipe shume te ndryshem njerezish. Ju jeni njerez te vecante. Perpiquni te jeni vigjilente, respektoni veten sepse jeni Angleze dhe per

kete keni nje pergjegjesi te vecante. Pra Zoti ju bekoftë. E gjithë rruga qe ai solli ujin e Lumit Godhvari qe rrjedh ne Nasik, ne lumin, Nasik.

Shikoni ju e dini qe Shri Rama dhe Shri Sita dhe Lakshmana te gjithë jetuan atje ne Nasik. Dhe ky lume eshte quajtur si Gangu i jugut. Godhvari. Ai merr ujin nga Godhvari. Shikojini si vershojne vibrimet. Ne vendet ku edhe lumenjte jane mantra, emrat e tyre jane mantra - e gjithë merita u shkon shenjtove, njerezve qe jetojne me besim dhe kaq shume pasterti keta lumenj, edhe nese u thua emrat sjellin vibrime. Shikoni? Pse mos te behet keshtu nje dite Tamizi (lumi Londres)? Duhet te jete nepermjet punyas tuaj. Cdo grimce e kesaj toke duhet te jete e vibruar vetem nepermjet punyas tuaj.

Tani duhet te shohim (kuptojme) gjendjen e Shri Ganeshas. Njerezit qe duhet te adhurojme, duhet te kuptojme cilet jane njerezit qe duhet te adhurojme. Situate shume e veshtire.

## 1985-0901, Shri Vishnumaya Puja

View [online](#).

Shri Vishnumaya Puja. Wimbledon, London (UK), 1 September 1985.

Puja e sotme eshte e Vishnumaya, qe ishte motra e Shri Krishnas, s'ishte planifikuar si nje puja nderkombetare qe ne bejme.

Por thone se per dashurine e Zotit kur te gjithë adhuresit mblidhen, Zoti gjithashtu duhet te thyeje shume rregulla, dhe keshtu u pranua te behej kjo puja. Mendoj se te pakten duhej bere nje here, ishte ide e mire. Prej dashurise suaj dhe perkushtimit tuaj u deshira, dhe keshtu kjo puja do te performohet. Eshte thjesht spontane qe ndodhi qe une te jem ne kete kohe ne Angli, sepse nese do te ndodhte ndonjehere kjo puja, duhej te ndodhte ne Indi. Sepse kjo eshte puja per nje hyjni, Vishnumaya, fara e se ciles nuk eshte e lehte te mbillet ne vendet perendimore. Tani i gjithë programimi shakti eshte kryer ne nje menyre te tille qe ne kemi Nenen si Shakti sa per fillim, Pastaj kemi tre shakti qe dalin prej Saj, sic e dini - Mahakali, Mahalakshmi, Mahasaraswati. Dhe me pas kemi femije prej tyre: motra dhe vellezer. Pra para se fuqia e asaj qe ne e quajme gruaja ose bashkeshortja te krijohet, ishte fuqia e motres qe u krijua. Pra, sic e dini qe u linden Brahma, Vishnu, Mahesha per keto tre Shakti, dhe te gjithë kishin motra. Dhe motrat e tyre ishin te martuara - si Motra e Vishnus eshte Parvati dhe Ajo ishte e martuar me Shiva.

Nenen e Hershme. Eshte shume e rendesishme per tu kuptuar qe keto tre lloj fuqish gjithmone luajne ne cakra. Dhe nese ju i kuptoni keto tre fuqi, si ato luajne, atehere do te kuptoni cila eshte rendesia e Vishnumaya. Vishnumaya eshte cilesia e motres ne nje familje. Pra femra eshte fuqia. dhe mashkulli eshte fuqia kinetike qe thekson fuqite e ketyre tre fuqive qe e rrethojne ate. Pra kur vjen fuqia mashkullore, gjithë keto fuqi behen bashkepunterore te dobishme ne veprim me ate fuqi. Tani fuqia e Vishnumaya eshte shume e rendesishme per t'u kuptuar, sepse fuqia e Nenes eshte per te mbrojtur pafajesine tuaj, sepse kjo eshte gjeja me e rendesishme. Fuqia e Nenes eshte per te mbrojtur pafajesine tuaj. Tani, fuqia e Vishnumayas eshte per te mbrojtur dliresine tuaj.

Ndonjehere ju s'e kuptoni cfare eshte dliresia dhe cfare eshte pafajesia. Pafajesia eshte nje fuqi e cila nuk eshte e aktivizuar. Sic kemi elektricitetin ne shtepine tone, elektreciteti ekziston si pafajesia qe gjendet brenda nesh; por miratimi (dekretimi) i saj eshte bere permes dliresise. Nje person mund te thote, "E bera shume pafajesisht"- jo s'mundet. Sepse cfaredo te beni nese eshte e pafajshme, s'mund te jete e demshme per karakterin tuaj, per pafajesine tuaj ose per drejtesine tuaj. Pra keta njerez qe thone keshtu, qe "E bera pafajesisht" e kane gabim, sepse nese ben ndonje gje pafajesisht ajo shnderrohet ne dliresi. Pra kur pafajesia eshte e praktikuar shnderrohet ne dliresi. Ju duhet te keni respekt per dliresine tuaj. Dliresia eshte ajo qe eshte fuqia e Vishnumaya brenda nesh, fuqia e Gauri, eshte virgjeri e paster. Ajo nuk martohet.

Sic e dini qe kur Vishnumaya u krijua, sapo pas lindjes se Saj Ajo u vra nga Kamsa. Tani per te kuptuar rendesine e dliresie brenda nesh, ne duhet te dime qe dliresia eshte themeli i te gjithë dharmave. Vetem dhe derisa te keni sensin e dliresise ju s'mund te keni dharna. Dharna eshte e pamundur sepse ajo eshte themeli. Do te jete nje shtepi e kartave; nese nuk keni themelin e dliresise ajo thjesht do te rrezohet. Pra dliresia eshte nje shume shume e rendesishme e qe ka qene e sfiduar gjate ne Perendim, dhe prandaj po them qe eshte e veshtire per te mbjelle faren e dliresise ne kete vend. Dhe kjo duhet te ndodhe, mendoj duhet te kete nje plan hyjnor, qe po ndodh qe kjo puja e madhe duhej te jepej ketu. Nuk eshte nje puja e lehte per t'u bere - eshte per t'u bere nga njerez qe jane te pafajshem, per t'u bere nga njerez qe kane ndjekur nje jete shume religjioze; ata te cilet kane qene shume te dliret, qe e kane respektuar dliresine e tyre. Por tani meqe ju jeni shenjtor, cdo gje para jush eshte e paster dhe e mire, sepse tani ju keni ndjekur nje jete shenjtori. Prandaj dliresia eshte zgjuar brenda jush, dhe dliresia punon tek ju si Gauri, si kundalini juaj.

Pra nese vini ne thelbin e jetes religjioze, e jetes se drejte, e jetes Sahaja Yoga, eshte dliresi. Nuk mund ta tjetersosh ate. Tani kjo dliresi ju jep juve maryadas, do te thote ju cakton kufijte. (i drejtohet dikujt ne publik- Pse jeni ulur ketu? Shkoni me tej, eshte me mire te jeni ne balle. Kjo eshte - ju nuk jeni duke bere puja. Nese jeni duke bere puja, atehere uluni ketu. Perndryshe, me mire uluni. Me mire t'i merrni vibrimet e Mia atje, ne balle. Ketu, ejani.)



Pra dliesia eshte ajo qe ju jep maryadas, ju jep kufij. Si ju jep kufij? Si, ne qiell ka vetetime. Kur dy rete, qe mund te themi jane si Sahaja yogis, dalin nga deti dhe kane uje te paster atje ne, keto re, dhe ato duhet ta derdhin; kur afrohen se bashku dhe kapercenje limitet e egos se tyre, ose luftojne me njera tjetren apo ne nje menyre perplasen, eshte, aty ka dliesi, ne kete vetetime qe bie. Kjo drite e cila te thote qe "E ke gabim. Pse je duke luftuar nder vete? Pse jeni duke kaluar egon e njeri-tjetrit?" Kjo eshte puna e motres. Dje kemi patur shume motra. Tani detyra e motres nuk eshte te mbaje anen, por per te treguar nese i kalon kufijte e tu te vellazerise, ateher do te kete nje vetetime(drite).

Tani kjo fuqi e vetetimes eshte pjese e fuqise se Shri Krishna te cilen Ai e nxorri nga Vetja e Tij. Prandaj Ai u be kaq i embel, misherim i bute (ndjeshem). Ai e nxorri. Ai tha, "Tani ti je bere motra Ime, dhe sa here qe ata sillen keq me ty ben mire ta perdoresh. Keshtu Shri Krishna u be kaq i sjellshem dhe shume, sic e quajne misherim romantik; sepse Ai nxorri vecmas pjesen moterore dhe e vuri ne pune. Por ajo ishte gjithmone me Te dhe Ajo punoi me Te; sepse ne familje motra duhet te kuptoje te mos zihet me vellezerit, se duhet te kujdeset per ta, qe ata te mos sfidohen (kundershohen) nga te tjeret, pra ajo u jep atyre maryadas sa larg te shkojne - sa larg te shkojne. Tani eshte shume e rendesishme, shume, shume e rendesishme per te gjithë ne te kuptojme qe Frojdi dhe gjithë njerezit e paarsyeshem nxorren teorite per te sfiduar Vishnumaya, qe ne ke te kemi gjithë keto lloje qesharake marrdheniesh, e cila eshte e pamundur, eshte dicka e gabuar. Tani nese ka nje marrdhenie te tille midis vellait dhe motres, familja vuan per shtate breza nga semundje te tmerrshme - shtate brezash. Por nese ka nje tjetër marrdhenie te stilit Frojd, ateher familjes i duhet te vuaje per katermbedhete breza. Pra forcat kufizuese te Vishnumaya jane te tilla qe egoja juaj eshte e kontrolluar, superegoja juaj eshte e kontrolluar, familja juaj eshte e kontrolluar.

Cdokush eshte nen kontroll, nen drejtimin e kesaj fuqie te paster te Vishnumaya qe ndodhet brenda secilit prej nesh. Dhe pjesa me e trishtueshme eshte qe ne te gjitha vendet Perendimore Vishnumaya eshte e semure, absolutisht e semure. Dua te them, madje kam humbur edhe Degjimin, ka ardhur deri ne kete pike, ne anen e majte, sepse ndjenja e dliesise mungon teresisht. Tani duhet t'i harrojme njerezit qe nuk kane fare arsye, tani ne jemi Sahaja yogis. Pra te vijme ne piken e duhur, ne duhet te themi qe, akoma shume njerez kane mbetur me ide qesharake, si "Kam marrdhenie te mire me ate zoteri" ose "Jam shume miqesore me kete apo ate zoteri" dhe gjithë keto. Pra nuk eshte nje maryada. Ju s'mund te keni miqesi me - ndermjet nje burri dhe gruaje, s'mundeni, eshte absurde absolutisht. Ne Perendim e gjithë kultura eshte qesharake; sepse nese shkon ne nje darke supozohet te uleni me burrin e dikujt ne te dyja anet - e tmerrshme! Por ne Lindje, nuk behet, sepse Vishnumaya eshte kunder ketyre gjerave. Ajo do shohe qe gra e burra ulen se bashku.

Tani ketu, ju e dini qe pjesa e dliesise mungon kaq shume sa Vishudhet tuaja te majta po kapen (kane ngerce). Dhe kur flas rreth tij, kap edhe me shume. Tani kur ju thoni nuk jam fajtor, ju ne fakt po e pranoni ndaj Vishnumayas, ndaj motres suaj, duke i thene "Une nuk jam fajtor." Por Ajo nuk pelqen te kete faj mbi ju. Gruas mund t'i pelqeje qe ju te keni faj Asaj mund t'i pelqeje qe ju ta keni fajin, sepse mendon qe po i sfidohet fuqia dhe qe ka dike qe eshte kundershitari i saj. Por jo Vishnumaya, jo; motra nuk e thote kete. Por nje vella e moter nuk jane kurre miq. Tani jemi ulur grup ketu. Keshtu, ne cdo grup ka nje moter e vella, ata e dine qe jane (ekzistojne) si vellezer e motra por ata nuk kapen pas nje personi, ata nuk i flasin ndonje personi, ata s'behen miqesore me ate moter. Si dikur ne patem nje fat te madh me keta te Krishtere, Kujtoj qe mund te kem patur te pakten tridhete kusherira dhe kater, pese vellezer ne ate kohe.

Dhe shkuam ne ate ngjarje, dhe midis indianeve te krishtere ne kemi te Krishtere prej gjithë llojeve te shtresave. Keshtu atje ishin disa vagabonde, ato hodhen ca fjale rreth nesh, ne motrave, kuptoni. Ne s'e dinim qe kishim kaq shume kusherinj. Ata kerccyen perpjete, si me suste (jack-in-the-box lloj lodre) i nxorren te gjithë e nisen t'i rrihnin ata djem. Ateher e kuptuam se sa shume kusherinj kishim. Ndryshe nuk do ta dinim kurre; ata ishin diku, ne s'u folem shume atyre, po flisnim me njera-tjetren, miqve tane, vajza qe flisnin me njera-tjetren. Papritur kuptuam sa shume kusherinj kishim dhe sa vellezer. Ishte mjaft e papritur qe ne te kishim kaq shume kusherinj atje dhe ne s'e dinim. Menjehere ata u hodhen ne mbrojtje te dliesise se motres se tyre, sepse ajo eshte baza e dliesise se tyre. Por normalisht ju nuk i flisni shume vellait, as vellai nuk ju flet ju shume, ju nuk beheni miqesore.

Por ne kohen e veshtiresive, ne kohen e maryadas, ne kohen e te konsultuarit per dicka qe eshte e shtrenjte ne familje, vjen motra. Kohet e fundit vellaim Im, me i vogel, Me shkroi nje leter sepse kishte nje problem ne familje. Tani nena Ime s'eshte atje, dhe normal qe nje moter eshte me mire sepse ajo eshte me lehte e gatshme ndaj teje se mamaja. Nena eshte kaq e zene me te

gjithe familjen, gjithë punen, ju e dini çfare ben. Keshtu qe ndjenja moterore eshte shume e rendesishme. Tani vetem mendoni qe Vishuddhi jone i majte eshte shume keq. Sigurisht qe eshte, sepse nuk jemi kujdesur kurre per dliresine tone, nuk e kemi respektuar dliresine tone. Ne Indi nuk ndodh keshtu. Gra dhe burra e respektojne shume dliresine e tyre. Dhe pyeta disa djem qe kishin shkuar jashte, thane qe "Pavaresisht se ishim duke gabuar ne ato qe po benim, gjithë kohes ne e dinim disi qe po gabonim."

I them, "Si keshtu?" Ai thote, "Ka dicka si marrdhenie me motren." Por mund te them tani qe burrat Indiane jane bere tamam si ju, dhe e kane humbur fuqine e tyre per te mbajtur dliresine e tyre. Burrat duhet ta ruajne dliresine e tyre, sepse ata mendojne se nuk i detyrohen asgje dliresise. Dhe nese thelbi i ekzistences suaj shpirtore nuk ekziston, ju do humbisni ne kohe. Prandaj e kam thene shume here qe vijeni vemendjen tek Nena Toke, gjelberim. Gjelberimi eshte ngjyra, nese e vini vemendjen tek ajo me pas do te shpetoheni nga keto gabime te shkeljes se kurores gjithë kohes, shikoni motrat e te tjereve, grate e te tjereve, vajzat e te tjereve. Pra marrdhenia qe po shprehet tani, sic e dini, eshte e nje vajze, e nje motre dhe e nje nene, qe eshte nje marrdhenie shume shume e paster. Kaq shume sa tani, supozojme qe po e perdorni trurin shume, atehere pse ju kap ngerci ne zemer - e keni menduar kete? Pse ju kap zemra kur perdorni kaq shume anen tuaj te djathte?

Cili eshte shkaku i ngercimit te zemres suaj? Duhet te kuptoni kete, eshte e njejta gje. Marrdhenia e te themi e Shiva ndaj Vishnus eshte ne dy menyra. Se pari Vishnu - grua, motra. Ai ishte martuar. Mire? Pastaj kush eshte motra e Shivas? Motra e Shivas eshte Saraswati. Nese punon shume tek Saraswati, zemra ka ngerc. Ajo ka maryadas.

Keshtu zune vend martesat e brendshme, prej se ciles marrdhenia e motres ka funksionuar per te mbajtur maryadat e cakrave tuaja. Nese e kalon kete, ju papritur shkoni ne te majte ose ne te djathte sepse keni kaluar maryadat e tyre. Tani kjo marrdhenie moterore ka ekzistuar edhe ne misherime te tjera; si Muhamedi pati nje marrdhenie moterore me - ne fakt duhet ta themi kete Motra e tij eshte gruaja e Aliut, por Ajo i lindi atij si nje vajze. Pra mund te lindin si vajze ose si moter. Ajo u lind si motra e Nanakes, Nanaki. Ajo u lind si vajza e Muhamedit. Pra mund te jete misherimi i nje motre ose i nje vajze. Por vajza dhe motra jane te pafajshme, dliresi e paster. Tani mendoni kete, qe keta njerez te cilet s'mund te kuptojne rendesine e dliresise, si mund te flasin per ligje çfaredoqofte? - sepse "ligje" do te thote maryadas, dhe merr kuptimin e duhur nepermjet fuqise se Vishnumaya.

Tani ju mund te thoni qe te mos vjedhesh gjene e tjetrit, eshte edhe e padrejte, i perket dikujt tjetër. Por kush do iu a thote juve? Kush eshte ai qe do ju thote qe kjo eshte gabim? Sigurisht, ka police, por kush e ka thene? Ligjberesit. Ajo pjese e te pandergjegjshmes qe ka luajtur eshte Vishnumaya; sepse sapo ju vidhni dicka ndiheni fajtores. Edhe ne ligj eshte perdorur fjala "fajtor". Dhe faji vjen nga ana e majte, eshte Vishnumaya. Pra sa e rendesishme eshte te kemi kuptimin (sensen) e dliresise. Por ne jemi njerez shume te ndare (percare), ne ata qe kane dliresi morale dhe ne ata qe mund te mos kene dliresi materiale.

Ata qe kane dliresi materiale mund te mos kene dliresi morale. E para vjen dliresia Morale kjo eshte shume e rendesishme, sepse eshte e lindur. Dhe nese dliresia juaj morale eshte ushqyer persosmerisht, atehere automatikisht vjen dliresia materiale. Por efekti eshte i njejte. Nese beni para duke mashtruar ne Sahaja Yoga ose nese mashtroni moralisht, do te kape Vishuddhi i majte, dhe i gjithë problemi do te filloje me Vishuddhin e majte. Tani te supozojme qe dikush provon te mashtroje ne Sahaja Yoga, do te marre parate e Sahaja Yoga ose dicka te tille. Menjehere do te kete ngerce ne Vishuddhin e majte. Sapo te kapet Vishuddhi i majte ai do te filloje te sillet ne nje menyre qesharake, do te tregohet i gjithë ngerci, Edhe nese do te behesh imoral do te kapet Vishuddhi i majte. Tani e gjithë pjesa e fajit vjen nga ketu. Mekat ndaj Nenes mund te jete gjithashtu edhe nje fyerje, ne çfaredo pergjigje ndaj Nenes.

Kam pare shume njerez qe e kane zakon te thone, "Jo, Nene." S'duhet te thuhet kurre "Jo", sepse nese thua "jo" kjo do te thote te shkosh ne Vishuddhin e majte. Fuqia e Vishnumaya nuk do e toleroje "Jo-ne" tuaj per asgje. Shume njerez qe e kane zakon te thone, "Jo, Nene." Nuk duhet bere, sepse me tu kapur Vishuddhi juaj i majte gjithë cakat tuaja te majta behen te dobeta, per shkak se dliresia qe eshte baza e te gjitha cakrave eshte e dobet. Ja pra sa e rendesishme eshte te kuptosh vleren e Vishuddhit te majte. Te gjithë ne te kapur ne Vishuddhin e majte, dhe nuk mendojme se eshte ndonje gje aq e rendesishme. Por ne themi, "Oh, Vishuddhi i majte po kap do te thote qe ndihem fajtor." Ne nuk e kuptojme si "Çfare kam bere? Kam kaluar kufijtë, prandaj po shfaqet ketu.

Kam neglizhuar ndonje lloj morali. Kam shkuar ne rrugen e gabuar kunder Nenes dhe Babait, prandaj po me kap Vishuddhi i majte." Vishuddhi i majte eshte treguesi i gabimeve, te keqijave, i mekateve. Ne s'mund ta lejojme qe te kemi Vishuddhin e majte, Sahaja yogis s'mund te perballojne te kene Vishuddhin e majte. Si shqetesime shtese, ata pijne duhan, marrin gjithë llojet te gjerave. Ne Indi ata marrin ate qe ju e quani tamakhu, eshte nje lloj- cfare gjethesh jane keto? gjethe duhani, dhe mendojne se nuk kane gabuar. Por i kap Vishuddhi i majte. Ne nje fare menyre Vishuddhi i majte eshte kyçi (porta) i te gjitha llojeve te problemeve per veten tuaj, ndaj jini te kujdesshem te mos ndiheni fajtores per asgje. Me shume se kjo eshte shume vicioze, rreth vicioz i madh.

Per shembull, dikush ka bere dicka te keqe. Kam vendosur t'ua them atyre ne fytyre i pelqefte ose jo, kjo eshte gabim, me shume mundesi. Sigurisht, ndonjehere perpiqem te luaj ndonje truk me ta qe ta kuptojne, nese ata s'e kuptojne te thenen Time atehere - vijme ne nje pike. Dhe une them qe "Tani me mire dilni jashte. S'mund t'ju kem ne trupin Tim me shume." Pra i nxjerr ata jashte Sahaja Yoges. Me t'i nxjerre ata nga Sahaja Yoga te pakten mbaron dhimbja lme e kokes. Tani kam pare qe kur fillon te veproje ky negativitet, njerezit, ne vend qe te perballojne gabimet qe "Une jam gabim, nuk duhet ta kisha bere kete, eshte gje e keqe per tu bere," fillojne japin shpjegime. Kur ju filloni te jepni shpjegime, ky Vishuddhi i majte fillon te behet si nje gunge e madhe e fryre, dhe atehere nuk ka me mundesi te sherimit, s'ka mundesi te pastrimit. Pra njerezit fillojne japin shpjegime, "Pse e bera kete, pse e bera ate."

Kur thuhet eshte gabim, eshte gabim; Duhet te pranohet, "Mire, heres tjetër nuk do ta bej, Me vjen shume keq." Por "me fal" duket nje fjale shume e veshtire, te pakten per Sahaja yogistet Perendimore por gjithashtu edhe per disa Sahaja yogiste indiane, te thone, "Me fal, Me vjen shume keq." Indianet kurre s'ndihen fajtores, eshte ide e mire, por ata kurre nuk thone me fal, pra eshte njesoj. Tani dikush duhet te kuptoje qe kur ju keni kryer nje gabim, ju jeni nje qenie njerezore: te gabosh eshte njerezore dhe te falesh, hyjnore. Por duhet te dini qe keni gabuar. Nese vazhdoni te jepni shpjegime atehere nje gje eshte caktuar, ju s'kuptoni qe Zoti di gjithcka. Nese Ai thote ju keni vepruar gabim, atehere eshte gabim. Si mund te sfidosh, si mund te thuash, "E bera per kete arsye. Kjo eshte arsyeja" - kete gje duhet te kuptojme. Sepse kjo eshte fuqia e elektricitetit, duhet ta kuptoni, ju trondit.

Ju godet. Dhe me pas ju kuptoni qe "Kam bere nje gabim." Keshtu qe mos krijoni tronditje per veten tuaj. Mos u sillni ne menyre qe ne fund te fundit te perfundoje me tronditje (goditje). Sigurisht, forca e Nenes eshte kaq falese, Forca e Sadashiva-s eshte kaq falese se ju jeni te lejuar, te lejuar dhe te lejuar per te vazhduar me ate qe po beni, per nje kohe. Por eshte thene, ju eshte shpjeguar qe eshte gabim. Supozojme qe kaperceni limitet tuaja absolutisht, pastaj papritur shfaqet Vishnumaya dhe e gjithë gjeja ekspozohet. Ne Sahaja Yoga ju ekspozoheni. Pra duhet te dini se edhe pse ky pushtet eshte kaq i dobishem, kaq udhezues, kaq permiresues, ushqyes dhe mbrojtës, prape - deri ne nje pike. Perndryshe Ajo vetem ju ekspozon ju, sepse Ajo s'mund te duroje me shume kete absurditet prej jush.

Pra nese vazhdoni keshtu, Ajo vetem do te shohe qe Ajo eshte e ekspozuar. Keni pare njerez qe kane kryer gjithë llojet e gjerave te papastra. Kam njohur shume kryeministra e gjithë ata presidente e keta e ata, kur vdesin - ekspozohen. Askush nuk thote qe ky e ai person ishte nje person i dliret. Shume pak lidere kombesh e kane marre kete certifikate qe ishin njerez shume shume te dliret. Dliresia eshte nje certifikate shume shume e rralle qe marrin. Sepse kur ne jete merrni nje fuqi mendoni se keni dore te lire, mund te jeni e te beni cfare t'ju pelqeje. Mund te jeni nje person i dliret, mund te jeni sidoqofte i padliret, mund te beni c'tju pelqeje. Ju beheni nje lloj mbizoteruesi me kete ide qe "I kam te gjitha fuqite, tani jam vertet i mire vendosur (pozicionuar)." Dhe kjo shnderrohet ne nje zhgenjim te plote ndaj jush, dhe harroni qe dliresia eshte kaq e rendesishme.

Pra sa me lart te jete nje njeri ne jete, te zere pozicion me te larte, me e larte behet ajo qe e quani ego- merr perkedhelje, me shume e shtyn poshte ne Vishuddhin e majte. Pra nje person i tille arratiset ne Vishuddhin e majte, sepse thelle ne zemer, ne ndergjegjen e tij ai ndihet fajtor. Dhe e gjitha vazhdon si nje faj, faj ne Vishuddhin e majte. Dhe kur shkon si faj ne Vishuddhin e majte behet nje situatë e veshtire, sepse nje person i tille, behet ekstremisht i ndjeshem. Nje gje ti thuash dhe ai do te ndihet fajtor. Ti perpiqesh te kurosh Vishuddhin e tij te majte, pastaj ai behet edhe me keq. Eshte nje situatë shume e keqe me njerezit e Vishuddhit te majte, dhe ka njerez qe jane te Vishuddhit te majte te cilet japin gjithmone shpjegime. Nje person qe ka Vishuddhin e djathte do jete arrogant, njerezit e Vishuddhit te majte kane nje metode shume dinake te kthimit te pergjigjes dhe shpjegimeve per cdo gje. Cfare do thoni, ata do te thone, "Jo Nene, kjo eshte keshtu, kjo eshte keshtu." Kjo eshte nje gje.

Jo vetem kjo, s'mbaron ketu, ju jep sarkazem. Kjo eshte arsyeja pse njerezit ne Perendim nuk flasin hapur, gjithmone jane sarkastike. Ata mendojne se eshte budallallek te flasesh hapur, s'eshte inteligjente, nese dhe derisa te flasesh ne menyre shume sarkastike qe e dini ndonjehere eshte shume e veshtire per tu arritur. Kjo eshte menyra e shtrember se si ata flasin. Dhe kjo pandershmeri vjen prej ketij problemi te Vishuddhit te majte. Nese Vishuddhi i majte eshte kaq keq, nuk mund te arrini asgje qe eshte e embel, qe eshte e bukur, qe eshte e vlefshme. Vishuddhi i majte nuk do te vleresoje kurre. Ata qe vuajne nga Vishuddhi i majte s'mund ta vleresojne kurre personin tjetër, s'munden kurre. Do te kete fjalen e vet, do te mendoje, "Une jam me i miri" sepse i duhet te ekzistojte, se problemi duhet te ekzistojte, pra si? Eshte nje lloj i egos se semure qe nuk do te pranoje qe dikush mund te jete me i mire se une, qe me duhet te ndjek dike, qe me duhet te mesoj nga dikush tjetër.

Kam pasur shume shembuj; E shoh sidomos tek njerezit qe jane me Mua, Gjej se ata futen ne Vishuddhin e majte shume shpejt per shkak te mungeses se protokollit. Kur fillojne te kene mungese protokollit ata shkojne ne Vishuddhin e majte. Pra te jeni me Mua eshte bekim, pa dyshim, por gjithashtu duhet te jesh shume shume i kujdesshem qe te mos e kaloni protokollin. Mos u mundoni te hidheni me perpara, vetem te krekoseni. Disa njerez e kane zakon te kapercenje kufijte dhe sapo ju te kaloni kufijte krijohet Vishuddhi i majte. Nuk duhet te kete frike per Nenen tuaj, duhet te kete respekt per Nenen tuaj, gje qe ruhet nga Vishuddhi juaj i majte. Tani kjo eshte nje fuqi shume e fshehur e Shri Ganeshes. Ajo qe e quani se eshte fuqia e Ganeshes eshte Vishuddhi i majte duke vepruar si dlirezia. Fuqite e Ganeshes jane shprehur te gjitha nepermjet Vishuddhit te majte. Pra ata qe besojne ne Ganesha, ne pafajsine e paster, duhet te dijne qe ne sjelljen tuaj te perditeshme, ne veprimet e perditeshme, duhet te kete dlirezi.

Ganesha eshte shfaqur si lulet e dlirezise. Dhe vetem shihni, nese ne ligjin e hyjnore nuk ka dlirezi, si i kufizoni (caktoni kufijte) njerezit, si i beni mire, si i pastroni ata, si i beni ata te evoluojne? Supozojme nje peme po rritet dhe nuk ka kufij ne te, ajo vetem rritet si nje gje e eger, nuk ka ku kufij, me pas cfare do dale nga ajo? Asgje. Pra per te bere nje person sa me te larte, duhet ta kufizoni ate (caktoni kufijte). Babai im jepte nje shembull te mire te kesaj, nese merr pak grure, fara gruri dhe . Ne doni te dilni jashte dilni, por mos shqetesoni njerezit, duke levizur perreth.) Shikoni, edhe kjo eshte nje gje tjetër. Gjithe keto gjera s'jane asgje por turbullira te Vishuddhit te majte. Kuptoni, gjithë keto shqetesime te reklamuar ose perpjekje per mbizoterim, ose nje person shume i hedhur apo i fryre (mendjemadh) te gjitha keto vijne nga Vishuddhi i majte, sepse ju doni te kaperceni Vishuddhin tuaj te majte prandaj e beni.

Me pas i shtohet edhe kjo. Sa me shume provoni ta kaperceni, aq me shume iu shtohet juve. Tani duhet t'ju tregoj historine e babait, ai tha qe nese keni grurin dhe e shperndani (hidhni pa kriter) ate, (Dikujt ne salle - Ju lutem mos me shqetesoni. ai vetem shkon kot sic ndodh me vemendjen. Por nese e vini ne nje torbe pelhure, ne nje cante, ju mund ta mblidhni grumbull (tog) dhe ai mund te arrije lartesi. Ne te njejten menyre, nese e shkon kot vemendjen tende pa dlirezi, ajo shperndahet; nuk ka kufij, nuk ka forma, nuk ka trajte. Por nese ti e kufizoni ate, atehere ju beheni me i larte me i larte me i larte, dhe mund te ngrihesh me lart ne jeten tende shpirtore. Meqe ju jeni njerez qe doni te keni nje jete shume shpirtore, duhet te kuptoni qe Vishuddhi i majte duhet te korrigojehet. Tani, si e korrigjoni Vishuddhin e majte? Ndonjehere lodhem shume me ta, ndihem vertet- lodhem shume, Thjesht heq dore prej tyre.

Sepse nese ato po ju kapin (ngercet). dhe ju u thoni " Po me kapni" ato behen edhe me keq. C'rreth vicioz qe eshte. Cila eshte kura per kete? Si ta thyejme kete rreth vicioz?- duke e perballur ate. Duhet te themi, "Cfare, po ndihesh fajtor per cfare? Po beni te njejtin gabim perseri e perseri, dhe ende jeni duke e bere." Duhet ti beni te gjitha injeksionet vetes. Por ne vend te kesaj fillojne te Me thone, "Jo, Nene. Jo, Nene.

Jo, Nene." I thoni vetes, "Jo, une vete." Sot kam bere kete, neser do te bej kete, te pasnesermen do te bej kete. Ndal tani, ndal." Dhe ndalo ne kete pike. Atje ju ushtroni fuqine e Vishnumaya. Fuqia e Vishnumaya duhet te neutralizohet, nese eshte keshtu, prej gabimeve tuaja; por nese do ti duhet tju ktheje ne fuqite e saj ju duhet te perdorni fuqite e Vishnumaya duke i dhene vetes goditje. Vetem ju mund ta beni kete. Pra ne kete pike, ne piken e Vishnumaya Une vertet deshtoj ndaj jush. Ju duhet ta beni kete.

Dhe prandaj une po mendoja per kete puja qe kur ju njerez te benit kete puja ndaj Meje, nese them ndonje gje do te krijoj me

shume Vishnumaya tek ju. Por kjo eshte gjeja me e lehte te menaxhosh gjerat, me kuptoni - "Po ndihem fajtor" - jeni te mbaruar. "E mora ndeshkimin, e quajta veten fajtor." Eshte si ne gjyq juria ju thote qe jeni fajtor - mire, e pranoj, "Une jam fajtor," por jo ndeshkimin, pa marre ndeshkim. Nese ke vepruar gabim, atehere ndeshkoje veten. Ka dy menyra per te ndeshkuar njerezit. Njera eshte qe disa ndeshkohen duke thene qe "Nuk do te kem ushqim." Por ata njerez qe kane zakonin e te mos pasurit ushqim e keto gjera, mund edhe te behen agresive me kete lloj zakoni te trazojne te tjeret per te mos ngrene ushqim. Them, qeniet njerezore jane shume te pasinqerta. Dijne si ta vrasin veten me nje thike tinzare gjithë kohes.

Pra nuk ka menyre si ta korrigjosh veten. Nese te duhet te korrigjosh veten, atehere duhet ta perballesh veten ne menyren e duhur. Te supozojme keni bere dicka gabim, atehere duhet te beni dicka qe do ju pelqeje ta beni normalisht, dhe te ndeshkoni veten. Ju duhet, ju duhet, me vjen keq, ju nuk duhet te beni dicka qe normalisht do ju pelqente ta benit. Ashtu si te korrigjosh veten; te themi qe dikush eshte shume i dhene ndaj lulishteve, luleve. Kur beni gabime per pak kohe nuk shihni lule, vetem mbyllni syte tuaj per lule. Ka njerez, te supozojme, qe jane te dhene pas te kenduarit, keshtu nese beni gabime direkt ndalojne se kenduarit. Keshtu ju duhet te godisni. Duhet ta dini qe Vishnumaya eshte nje rrufe, dhe leksioni duhet te jete i tille. Nuk mund te jete aq i bute, sic ishte Shri Krishna.

Po ju them qe eshte nje gje shume e fuqishme, dhe mundte Zoti te zgjoje ate fuqi te brendshme te Vishnumaya Eshte gjeja me e fuqishme qe nje qenie njerezore mund te kete, eshte gjeja me fatlume; ju beheni nje personalitet i shenjte. Kjo eshte nje nga menyrat e gjetjes se realizimit te Zotit. Kjo ishte nje pyetje e bukur e pyetur me vend, tamam ne kohe dje, te stabilizoni dlire sine tuaj - por jo duke dhene bandhan, duke marre vibrime nga Nena dhe me pas t'i humbisni, jo ne kete menyre: ju vete te korrigjoni veten nga mengjesi ne darke, dhe te perballni veten pa u ndjere fajtoje, dhe te mesoni gjera te reja. Gjithë kohes eshte motra qe ju meson, gjithë kohes, si te jeni me mire dhe me mire dhe me mire, jo Nena; sepse Nenes mund ti thoni, "Jo, Nene." Nese i thoni nje motre - elektricitet, ne rregull? Futini gishtat ne prize dhe do te kuptoni - pa shpjegime! Me kete mirekuptim, per stabilizimin e dlire sine suaj, dlire si te emocioneve tona dhe dlire si te mendjes sone. Cfare do te keni bere deri tani, harrojoni, harrojoni te shkuaren. Kjo eshte shume e rendesishme gjithashtu, te harrosh te shkuaren, sepse kuptoni qe eshte nje menyre shume e mire e te shpjeguarit, "Ngaqe pata kete, prandaj me ndodhi. Nena ime ishte keshtu, edhe babai im ishte keshtu "Nene, baba, harroni gjithkënd tani, ju i perkisni kesaj familje, qe eshte nje familje e shenjte.

Njerezit qe jane shenjtoje ndodhen te ulur ketu, ju jeni midis tyre. Dhe automatikisht keto ligje do fillojne te punojne, dhe nuk do na duhet t'ju themi nese duhet te jeni miqesor me kete person ne do te bejme sot puja ose jo miqesor me ate person. Shikoni, interesimi ne seksin e kunder gjithë kohes nuk eshte shenje e dlire sine. Dua te them, eshte i frikshem, absolutisht qesharak, ju beheni budalla. Si disa burra qe dine caq shume gjera grash, parfume, kjo, ajo. C'dobi kane? Jeni skllever te grave, apo cfare? Ata behen eksperte ne gjera te paarsyeshme (pakuptimta). Ju jeni burra, jetoni si burra. Dhe grate duhet te kene ate ndjenje dlire sie brenda vetes tyre, sepse ato jane forcat (fuqite).

Pse doni te beheni si burrat? Dua te them, ju jeni fuqia prapa tyre. Dhe grate duhet te kujdesen per dlire sine e tyre. Per kete duhet te them, duhet t'i perulem grave Indiane, menyra si jane te perulura, menyra si jane te dlira, ju duhet te mesoni- sigurisht ka shume edhe shume qe s'jane te tilla- por perulja qe ato kane. Ka vetem nje kategori qe nuk duhet te kete perulje: qe eshte misherimet. Une s'mund te kem perulesi, keq ta them. Ka cilesi te caktuar qe ju keni dhe i gezoni e mbani, une s'mund ti kem. Une nuk mund te perul Vetem Time, s'mund ta bej, Me vjen keq - Une nuk duhet ta bej kete. Asnje misherim s'ishte i perulur; ata s'munden, sepse ata nuk kane asnje faj. Kam vene caq shume njerez fajtoje ne Vishuddhin Tim te majte saqe veshet e Mi po bllokohen duke u perpekur te pastrohen.

Nese mund te pastroni fajin tuaj veshet e Mi do te hapen, shqetesimi Im do te largohet. Ndaj ju lutem, ju kerkoj qe te mbani mire Vishuddhin tuaj te majte. Mos u ndjeni fajtor, jini ne qender. Jini ne qender, vezhgoni veten dhe perballuni me te, goditeni veten, korrigjoni veten. Vetem njerez te tille do te ngjiten. Nje rruge tjeter eshte meditimi. Me doren e majte drejt fotografise, me driten atje, dora e djathte ne Nenen Toke, mund t'ia dilni. Vendoseni driten ketu lart, jepini nje bandhan Vishuddhit tuaj te majte, mund t'ia dilni. Por keto mund te behen rituale nese nuk i beni me zemer. Pra para se gjithash perballuni me te, menderisht perballuni me te plotesisht, me pas bejeni me keto gjera.

Kuptojeni edhe emocionalisht, qe emocionet qe ju keni nuk duhet te kene faj ne to. Pra per te gjitha qellimet tona praktike ne s'do

te perdorim gjithë keto fjale te cilat tregojne fajin tone - por peruljen. Perulja eshte shume e ndryshme nga nje person fajtor. Personi fajtor eshte personi qe eshte nen presion, nen presion, por nje njeri i perulur eshte nje person i lire. Eshte i perulur ne vete lirine e tij, ne vete euforine e tij. Si pemet, kur ato jane te ngarkuara me fruta ato thjesht i perulen Nenes Toke. Njelloj, nese shkoni ne det, do shihni qe gjithë pemet rreth detit, vecanerisht pemet e kokosit, te gjitha kthehen drejt detit sepse deti u ka dhene atyre vecanesine. Uji qe eshte ne kokos vjen nga deti. Prandaj ato te gjitha kane kete respekt, ate perulje ndaj detit. Ne te njejten menyre nje person qe nuk eshte fajtor vetem do jete i perulur realisht, sepse njerezit fajtoresh, sic ju kam thene, jane agresive me sarkazmen e tyre, me fjalet e ndyra, me kthimpergjigjet e tyre, me shpjegimet e tyre.

Por nje person i perulur eshte nje person i lire, i lire per te qene i perulur, i lire per te qene i mire, i bute, i meshirshem. Dhe ky lloj Sahaja Yogis duhet te jeni, qe kur njerezit t'ju takojne te jene te impresionuar nga perulja juaj. Por perulesia nuk ka ndonje servilizem - pafajesi dhe perulesi. Une, mua me mungon kjo cilesi teresisht. Une s'mund te jem e perulur, dhe ju nuk duhet te perpiqeni te Me perulni, sepse kjo nuk duhet bere. Por askush s'mund te thote per sjelljen Time kur Me takojne qe nuk jam e perulur. Une veproj me perulje. Mund te veproj si njeri shume i perulur por per te qene e sinqerte, Une nuk kam asnje lloj perulesie brenda Meje, jo perulesi. Dhembshuria eshte shume ndryshe nga perulesia. Perulesia eshte nje cilesi njerezore, eshte nje cilesi e vecante qe vetem bhaktas e kane.

Vetem bhaktas e kane, eshte nje cilesi kaq e bukur te marresh rreke (dushe) te lumturise. Ai qe jep lumturi s'mund te jete i perulur sepse s'mund te marre asgje. Jane vetem qeniet njerezore ato qe jane te perulura, dhe mund ta kapin, arrijne dhe ta marrin ate. Dhe personi qe s'mund ta kape ate eshte kaq i vetmuar, kaq i vetmuar. Nje person i tille s'mund te kete shoqeri me asnje, sepse i duhet te jape, te jape e te jape. Eshte kaq i vetmuar dhe i duhet te perballoje cdo gje vetem. Ata qe jane te perulur vetem mund te behen miqesore me njeri tjetrin, mund te ndajne problemet e tyre me njeri tjetrin. Une s'mundem, sepse ju nuk keni asnje zgjidhje Me duhet te zgjidh problemet e Mia. Pra perulja vetem ju ndihmon te artikulonit dhe te keni raporte me miqte tuaj, me cdokend, ndani veshtiresite tuaja. Por perseri me duhet t'ju paralajmeroj sepse ndodh gjithmone, perulesia juaj s'duhet te jete e kendshme (argetuese).

Perulesia eshte nje person i shkeputur, eshte nje cilesi e shkeputur. S'eshte nje cilesi qe behet e ngjitur (varur) per nje person apo personi te dyte. Eshte nje stil i perulur jetese ku ju nuk jeni arrogant pa qene nevoja, nuk u bertisni njerezve. Por ne Indi ne themi lopa eshte nje kafshe shume e perulur. Jep qumeshtin e saj, siguron gjithcka, nuk sulmon asnje. Pra perulja eshte nje roje e tille per ju. Sigurisht, ndonjehere njerezit perfitojne nga njerezit e perulur, s'ka problem. Per sa kohe qe nuk e keni humbur perulesine tuaj, cdo gje eshte ne rregull. Por njerezit e humbin perulesine e tyre. Kur disa perpiqen ti shqetesojne ata ata behen Vishuddhe te majte dhe pastaj e humbin perulesine e tyre, dhe kjo eshte nje gje qe s'duhet humbur; sepse nese te duhet te mbash lidhjen me Hyjnoren duhet te jesh i perulur, S'ka rruge tjeter.

Nese nuk je nje person i perulur s'mund te mbash marredhenie. Kuptoni, dy cilesite, si spina dhe priza. Spina duhet te jete spine, priza duhet te jete prize. Njelloj nese duhet te merrni dicka prej Hyjnores, duhet te jeni person i perulur. Nepermjet arrogances s'mund te merrni asgje, nepermjet agresionit s'mund te merrni asgje, nepermjet asgjeje. Dhe disa njerez mund te ndejne qe "E dua Nenen," por kjo dashuri duhet te shprehet nepermjet perulesise se plote. Kjo eshte e vetmja menyre, ky eshte i vetmi kanal nepermjet te cilit ju mund te Me afroheni, s'ka rrugedalje. Pra e mbyllim sot ne nje faze shume te larte. Eshte fillimi i realizimit te Zotit. Por duhet te shpejtoni me Mua.

Nuk eshte e lehte te mbani shpejtesine me Mua, pra ju duhet te shpejtoni me Mua. Nese duhet te shkoni drejt realizimit te Zotit, fillimisht stabilizoni sensin tuaj te dliresise dhe perulesise. Zoti ju bekoftë.

## 1986-0101, Shri Mahaganesha Puja

View [online](#).

Shri Mahaganesha Puja. Ganapatipule (India), 1 January 1986.

Jemi mbledhur sot te gjithë ketu per ti kushtuar respektin tone Shri Ganeshes.

Ganapatipule ka nje domethenie te vecante sepse Ai eshte Mahaganesha. Ganesha tek Mooladhara behet Mahaganesha ne Virata, qe eshte truri. Kjo do te thote qe eshte vendi i Shri Ganesha. Qe do te thote se Shri Ganesha qeveris nga ky vend principin e pafajesise. Sic e dini mire eshte e vendosur prapa ne zonen e optic thalamus, lobi optik sic e quajne, dhe eshte dhenesi i pafajesise per syte tuaj. Kur Ai misheriohet si Krishti qe eshte ketu ne balle, tek Agnya Ai e tha shume qarte qe "Ju nuk duhet te keni sy tradhtare (kuroreshkeles)." Kjo eshte delikate per t'u thene, te cilen njerezit nuk e kuptojne cili eshte kuptimi i fjales "kuroreshkeles." "Kuroreshkeles" do te thote "papasterti" ne fjalen e pergjithme. Asnje papasterti ne sy "nuk duhet te keni" eshte shume e veshtire. Ne vend te thenies qe te merrni realizimin tuaj dhe pastroni Agnyan tuaj te mbrapme, ., Ai e ka thene ne nje forme shume te shkurter, "Ju nuk duhet te keni sy tradhtare (kuroreshkeles)."

Dhe njerezit menduan, eshte nje situatë e pamundur Sepse Ai nuk u lejua te jetonte gjate; ne fakt jeta e Tij publike eshte e kufizuar ne vetem 3 vjet e gjysem. Pra cfaredo te kete thene Ai ka nje domethenie te madhe, qe syte tuaj s'duhet te jene kuroreshkeles. 35 Aty ku ka pafajesi nuk ka tradhete: do te thote nuk ka papasterti. Per shembull, me syte tane shohim dicka dhe duam ta zoterojme ate. Fillojme te mendojme. Mendimi fillon si nje zinxhir, njeri pas tjetrit. Pastaj futemi ne rrjeten e mendimeve te tmerrshme, dhe me pas behemi skllever te ketyre mendimeve. Madje edhe njohuria jone, syte tane shkojne ndaj gjerave qe jane jane shume bruto dhe ju cojne ne renie. Sic ka thene Shri Krishna qe Pema e Ndergjegjesimit rritet koke poshte, qe rrenjet jane ne tru dhe deget rriten per poshte. Ata qe kane shkuar drejt materializmit jane rritur per poshte.

Ata qe kane shkuar drejt Hyjnore jane rritur per lart, pertej rrenjeve. Rrenja kryesore, qe e quajne taproot, rrenja kryesore eshte pafajesia, eshte Shri Ganesha. Dhe Ai behet Mahaganesha ne Ganapatipule. Ai eshte i rrethuar ketu nga Principi i Babait, Principi i Guruse se detit, oqeanit - Oqeanit Indian. Kjo eshte, ketu Ai behet nje Guru. Kur nje Sahaja yogi stabilizon Principin e tij te Shri Ganeshas, ai eshte ende nje femije. Sigurisht syte e tij fillojne te behen gjithnje e me te paster, te fuqishem dhe te shndritshem. Duhet ta keni pare qe kur kundalini ju jep realizimin me pas syte tuaj fillojne te shndrisin, sikur ka nje shkendije ne sy, mund te krijoni nje shkendije. Me ego ajo mbulohet, me ego verbohet. Me superego mbulohet nga lotet.

Por me pas kur qartesohen ju shikoni bukurine e syve, Shri Ganesha shkelqen nepermjet shikimeve tuaja. Tani vemendja fillon te rrjedhe prej dritares se tempullit te Shri Ganeshas. Por kur ju maturoheni, beheni Mahaganesha. Me pas Mahaganesha stabilizohet tek ju dhe ju beheni nje satguru, beheni nje guru hyjnor, mund t'i mesoni te tjeret. Edhe nje femije mund te jete i tille, por edhe nje person i rritur mund te jete budalla. Nuk ka lidhje me moshen, ngjyren, besimin (kredon) apo kasten, Eshte nje gjendje te cilen dikush mund ta arrije ne cdo kohe. Sic mund te themi ketu patem Gyaneshwara, qe ne nje moshe shume te re kompozoi te madhen Gyaneshwari. Sic e keni pare dje, ne moshen dymbedhete vjecare Gorakhnath stabilizoi Mahaganeshan e tij. Por nese nuk provoni te ngjiteni, atehere do mbeteni ne te njejten faze edhe kur te plakeni. Pra matura eshte treguesi.

Ketu, sic shihni ne Ganapatipule, Shri Ganesha eshte ne formen e saj te plote, te maturuar keshtu qe ne zhvillojme gjithashtu Mahaganeshan tone brenda vetes sone, dhe syte tane behen te paster, te fuqishem dhe hyjnore. Me punen e duhur, jam e sigurte qe ne mund te stabilizojme ate faze brenda vetes sone. Sot kemi ardhur ne Ganapatipule, ka nje domethenie te madhe, midis Asthavinayaka (tete Swayambhus te Shri Ganesha), Eshte vendi i Mahaganeshas. Mahaganesha eshte Pithadhish (Qeverises i te gjitha pitave) dhe duke u ulur ne kete pita, ai mbron gjithë Ganesha Swayambhus. Ai ka njohurine e te gjithë Omakara-ve, pasi ai ka arritur Guru Tattwa (Principin e Guruse ). Nese shohim rreth e rrotull, oqeani, kaq i bukur dhe i paster eshte duke lare kembet e ketij Ganapati, sepse oqeani perfaqeson Guru Tattwa, dhe me kete Guru Tattwa, ai lan kembet e Shri Ganeshas keshtu duhet te ndodhe me te gjithë Sahaja Yogis. Kur Ganesha Stuthi kryhet me pas Shri Ganesha eshte stabilizuar dhe pastaj me Mahalakshmi Tattwa ju duhet te beheni Mahaganeshas. Kjo faze mund te arrihet nga femije te vegjel dhe te medhenj, njerez te moshuar, gra dhe cdokush, nese ata mund te mbajne sjelljen e drejteperdrejte, te cilen e quajme si Saralya ne Marathi, ose sic thone Abhodita

ose pafajesine, kur eshte e pervesuar njehere tek ne, ne mund te arrijme Principin e Guruse. Cilido Guru, qe nuk ka kete natyre te drejteperdrejte dhe te pafajeshme, nuk mund te jete kurre nje Guru, ai eshte nje Aguru (Guru i rreme). Personi, vemendja e te cilit eshte gjithmone ne Fuqine Hyjnore, vetem ai behet nje Guru i vertete.

Vemendja e qenieve normale njerezore eshte zvetenuar, s'eshte e paster. Prandaj Krishti ka thene, qe s'duhet te kete tradheti (kuroreshkelje) ne syte tuaj, do te thote qe nese e con vemendjen ne dicka, ne fillojme te mendojme shume e ide te cuditshme vijne ne mendjen tone, se si mund ta fitoj kete gje dhe pse mos ta marr kete gje, dhe mendime te tjera si "pse?" dhe "pse jo?" Nese ne shohim dicka dhe fillojme te mendojme, atehere nuk e kemi kaluar akoma Cakran Agnya. Cfaredo objekti te shihni, duhet te beheni pamendime, sidomos ne vendbanimin e pasurise dhe prosperitetit aty ka Perendi dhe Perendesha te shumte te pakten duke pare ata, njeriu duhet te behet pamendime. Pasi te kemi arritur gjendjen e vetedijes pamenduar, nuk do te mbetet me asnje perversitet (zvetenim) ne vemendjen tone. Mendimet qe zvetenojne mendjen nuk do te vijne me, pra si do ndikoje mbi ju perversiteti? Nenkupton ate qe tha Krishti, nuk duhet te keni sy kuroreshkeles. Ata duhen te jene aq te paster, si rrezet e diellit, kur bien mbi peme, nuk e thithin pisllekun, ato ushqehen dhe i ushqejne ato, jo vetem kaq por u japin atyre edhe force. Ne te njejten menyre, Sahaja Yogis duhet te kene shkelqim te tille ne syte e tyre, qe te mund te krijojne nje atmosfere shume te paster ne gjithë boten.

Pastertia ne atmosfere eshte ajo qe duhet sot, kudo. ne menyre qe paqja, gezimi dhe fuqia hyjnore te zoteroje ne kete bote. Vetem duke i thurur lavde Shri Ganeshes mund te mos jete mjaftueshem, nevojitet qe Shri Ganeshi te jete zgjuar brenda nesh dhe ai duhet te zhvillohet ne fazen e Mahaganeshas. Vetem pasi te kemi arritur fazen e Mahaganeshas, mund te perfitoje vendi yne dhe gjithashtu permes vendit tone, vendet e tjera mund te perfitojne nga kjo faze. Ne do te drejtojmë te tjeret, por nese nuk do e marrim kete pergjegjesi, atehere s'e them dot se cfare do te ndodhe ne kete bote. Kam nje kerkese ndaj te gjithëve ju, te heqim gjithë tradhtine nga syte tane. Per kete ne kemi mantran e Nirvichara ne Sahaja Yoga. Mos lejoni mendimet t'ju dominojne, nese vijne mendimet, atehere thoni Yen Neti Neti Vachane (nuk ekziston) ose themi Kshama Keli, Kshama Keli (Une fal, une fal), keshtu ky mendim eshte shkaterruar dhe kur shkujdesja eshte arritur, atehere perversiteti i mendjes ndalon. Cdo kush duhet te beje nje perpjekje, qe syte tuaj mos te jene tradhtare (kuroreshkeles). "Nese ka perversitet ne mendjen time per shkak te syve, atehere nuk dua te kem sy te tille", tha Shenjti Tukaram, "atehere, eshte me mire te jesh i verber".

Nga nje ane, eshte me mire te jesh i verber, se te kesh perversitet ne mendje. Me mire te kesh sy te brendshem te shohesh Hyjnoren. Kur keto dy principe bashkohen si duhet, atehere mund te themi se Sahaja Yogi ka arritur Principin e Guruse. Ju bekoje te gjithëve, qe ketu ne Ganapatipule, vendin e Mahaganeshas, me hirin e tij te vecante, te gjithë mund te arrini Principin e Guruse sa me shpejt te jete e mundur.



## 1986-0713, Shri Kartikeya Puja

View [online](#).

Shri Kartikeya Puja. Grosshartpenning, Munich (Germany), 13 July 1986.

Me falni per vonesen.

Nuk e dija qe ky program eshte ne nje vend te bukur si ky. Dhe ketu shihni nje piktore te bukur te Mikelanxhos duke shprehur deshiren e Hyjnores, Babait tuaj, per t'ju shpetuar, per t'ju ndihmuar, dhe po funksionon. Ne Gjermani kemi patur ngjarje agresive te medha dhe kjo solli nje efekt shkaterrues per mbare jeten Perendimore. U thye sistemi i vlerave, idea e te drejtes (dharma) u prish, grate filluan te sillen si burrat dhe shume njerez vdiqen. Vdiqen njerez shume te rinj, shume shume te rinj. Gjithe deshirat e tyre nuk u permbushen, gjithe jeta nuk u dha per asgje vec lufte. Kjo ishte ardhja e nje vale te nxehte, duke shkaterruar gjithe gjerat delikate. Kur natyra gjen prehjen e saj apo inatoset, shkaterron vetem gjerat e medha por kur qeniet njerezore fillojne shkaterrrojne ata shkaterrrojne edhe gjerat delikate si sistemi i tyre i vlerave, karakteri juaj, dlirësia juaj, pafajesia juaj, vetepërmbajtja juaj. Keshtu qe tani lufta eshte mbi nivelin tuaj delikat. Duhet ta kuptojme tani qe gjithe keto gjera kane sjelle nje efekt kaq shkaterrimtar ne Perendim, ne personalitetin Perendimor. Pra perpjekja e pare qe dikush duhet te beje eshte ta riparoje ate, ta drejtoje, ta beje te qendroje ne kembet e veta.

Sepse njerezit humben personalitetin e tyre, traditen e tyre, ata s'kishin spirance, jo rrenje dhe filluan te levizin drej cdo gjeje qe ishte sjelle si nje lloj eksperience intelektuale. Grate u bene shume te panvarura dhe menduan se mund t'i zgjidhin vete problemet e tyre. Keshtu ato menduan se mund te behen si burrat. Ketu problemi filloi madje ne menyren me te keqe. Sepse gruaja eshte grua, dhe ka nje gje fare te vogel qe eshte, ta quajme, burre ne te dhe kur ajo provon te shmange ate qe ka (femren) dhe te zhvilloje dicka qe eshte shume e vogel ne te (burrin) atehere behet qesharake. Por ajo mund te zoterohet nga shume burra te vdekur, deshira e saj per t'u bere mashkullore mund te terheqe shume fantazma qe duan te hyjne ne mendjen e nje femre. Dhe kur hyjne ata kane petkun e nje gruaje dhe mendjen e nje djalli. Dhe gruaja mund te mos e shohe kete sepse mbase me keto gjera djallesore ne menyren e kesaj bote mund te jene te sukseshme. Ato mund te ndjehen me mire. Mbase mund te dominojne gjithkend, ato mund te behen te perpikta si burrat, fakt absolut, shume te zonja, te lara te pastra duke shmangur gjithe bukurine dhe embelsine, Se fundmi keto gra behen si vampire u mendua qe lufta mbaroi por po mendoj se vazhdon nepermjet grave te Gjermanise.

Pata degjuar qe ky sulm kish ardhur edhe me pare dhe ka gra qe quhen Amazona. Tani kjo histori po perserit veten prape. Dje kisha nje interviste me nje zonje Gjermane dhe u habita nga sjellja e saj se ndjeva qe ajo eshte ende nje Nazi, disa fantazma Nazi ishin ulur tek ajo. Ajo ishte nje personalitet i dyfishte, nga nje ane po fliste embelsisht, nga ana tjeter ishte nje Nazi dhe nje fashiste. Dhe kishin shume djallezi ne argumente. Gjeja e pare qe mund te bejne eshte te thone ne jemi mveshur (murosur) me njerezit e shtypur, si India. Indianet jane Ariane, ne jemi Ariane dhe ne jemi njerez qe i simpatizojme Arianet. Indianet jane njerez shpirtore dhe mendojne se jane si Indianet e keto gjera, a mund ta besoni kete? Cilesia e jetes duhet te permiresohet, kjo eshte ceshtja. Cilesia e burrave eshte e ndryshme nga e grave, Ju a kam thene shume here.

Dhe nese nje grua provon te jete mashkullore pasketaj s'mund te arrijne asgje si duhet. Kemi patur shume te tilla. E keni pare gruan e Mao-s. E keni pare zonjen e Chanka Sheik. Tani eshte kjo zonja e re te Carlos, Carlos eshte emri i saj? Marcos, Marcos. Kaq shume gra te tilla. Gjithmone shkaktojne rremuja kur perpiqen te jene mashkullore. Kemi shume gra ne histori. Ne Indi, grate jane te mirepajisura. Ne kemi patur gra si Jhansi ki Rani qe luftuan kunder Britanikeve.

Atij ju tha qe "Duhet te kontrollosh diellin."Si fillim Ai duhet te kontrollonte diellin, qe dielli tek njerezit, nese ka shume diell ne ta atehere Ai duhet te provoje ta kontrolloje ate dhe ta beje ate me te fresket, me te qete. Pra "Mbi te gjitha Ai qe nje femije, keshtu qe sapo lindi, kur Ai e dinte se duhej te kujdesej per diellin, Ai tha, "Pse te mos e gelltis?" Keshtu Ai iku, vrapoi lart ne trupin e Viratas dhe e hengri Suryan (diellin). Aty ju tha se ishte, "Jo,jo,jo,duhet ta kontrollosh Ate. Nuk duhet ta fusesh Ate brenda stomakut tend!" sepse Ai mendoi se ky diell do te kontrollohej me mire nese e fuste ne stomakun e Vet. Pra bukuria e karakterit te Tij eshte qe Ai eshte nje femije, dhe femija me sjellje si Shri Hanuman duhet te kontrolloje anen e djathte, nese ka nje nene apo baba te anes se majte. Normalisht njerezit e anes se majte s'kane femije, normalisht. Ata jane mbi-djathtiste, qe edhe kur kane femije, realisht nuk pelqehen nga femijet sepse nuk kane kohe per femijet, jane gjate gjithë kohes shume strikte me femijet, u bertasin atyre, u bertasin,nuk dine si t'ia dalin me femijet. Ose jane mbitolerues, sepse gjithmone mendojne qe "Une s'e kam pasur kurre kete, keshtu qe le t'ia plotesoje femijes."Pra keto lloje ekstreme njerezishqe jane te anes se djathte kane kete Hanumana, qe s'eshte asgje vec nje femije. Ai eshte shume i shqetesuar, shume e shqetesuar per te bere punen e Shri Ramas. Tani Shri Rama eshte nje karakter, do thoja qe eshte plotesisht i ekuilibruar, absolutisht. Ai eshte mbreti dashamires qe ka pershkruar Sokrati. Pra Atij i nevojitej dikush gjithë kohes me Te per te bere punen, ose te furnizonte Ate ose te ndihmonte Ate "mund ta quani Ate si sekretar" dhe Shri Hanumana ishte ai qe u krijua per kete qellim. Tani Shri Rama (mund ta kete fjalen per Shri Hanumana) ishte asistent i tille; Dua te them, s'mund te kesh nje fjale te tille per Te. Ne mund te themi qe Ai ishte nje sherbetor i Shri Rames "edhe sherbetoret, kuptoni, nuk kane kaq shume perkushtim ndaj mjeshtrove te tyre."Mund te themi si nje qen ose nje kale, por edhe ata nuk kane "kaq perkushtim per Shri Rama,me kalimin e kohes Ai u rrit dhe mori "nau" nente sidhis, navadha siddhis. Nente siddhis mori Ai. Keto siddhis jane keshtu, qe Ai mund te behet i madh, Mund te behet kaq i rende sa askush s'mund ta ngreje Ate; Ai mund te behet kaq sukshma sa askush s'mund ta shohe Ate, Mund te behet kaq delikat sa askush s'mund ta kuptoje. Jane nente siddhis qe mori Ai. Pra nje person qe ka shume anen e djathte tek vetja, Ai (Shri Hanumana) e kontroll ate me keto nente siddhis. Tani, si do e kontrolloje Ai nje njeri qe po vrapon shume shpejt ne jeten e tij? Ajo qe Ai ben eshte kontrolli i levizjes se tij,Ai e ben ate qe ne nje fare menyre i duhet te ngadalesoje shpejtesine e tij.I ben kembet e tij shume te renda; tani ai s'mund te nxitoje aq shume. Ose i ben duart e tij shume te renda, keshtu qe personi s'mund te punoje shume me duart e tij. Pra Ai mund t'i jape nje lloj te tmerrshem rendese letargjike nje personi qe eshte shume i anes se djathte. Ai ka te tjere siddhis qe jane shume interesante, Ai mund ta zgjeroje Vetem "Ai nuk ka shume arme,Ai ka vetem nje gadaa ne doren e Tij "dhe Ai mund ta zgjase bishtin e Tij ne cfaredo gjatesie, dhe mund te mbaje njerez me bishtin e Tij, Nuk i duhet te perdore duart e Tij. Duke u ulur ketu poshte, Ai mund ta vere bishtin kudo perreth. Nese do Ai mund te beje nje mal me bishtin e Tij dhe te ulet ne te. Ai ka gjithë keto truke majmuni sic i quani ju, kuptoni, as you're to call them, you see, dhe gjithë keto gjera qe Ai ka brenda Vetes se Tij jane per te kontrolluar nje person qe si fillim, eshte ekstremisht i anes se djathte. Me pas Ai mund te fluturoje ne ajer. Vetem se Ai nuk ka krahe, por Ai thjesht fluturon ne ajer. Kjo do te thote qe Ai mund te behet kaq i madh sa sasia e ajrit qe Ai zhvendos ka nje peshe shume me te madhe se vete pesha e Tij "i njejtë parim si i Arkimedit, nese e dini parimin e Arkimedit "qe Ai behet kaq i madh sa trupi i Tij fillon te lundroje ne ajer, si nje varke,e shihni, mund ta quani dhe Ai mund te fluturoje ne ajer, dhe duke fluturuar ne ajer Ai mund te mbaje mesazhet nga njeri tek tjetri, nepermjet eterit. Tani baza e eterit qe ne kemi eshte nen komanden e Shri Hanumana. Ai eshte ai qe kontrollon,ose Ai eshte Lordi (Zoti) i ketij eteri, baza e eterit, ose te themi, shkaktuesi i eterit; dhe nepermjet tij,ai komunikon. Gjithë komunikimet qe gjeni,sic kemi brenda vetes sone gjendra tiroide te cilat

i perdor hipofiza, gjendrat tiroide, eshte me ane te levizjes se Hanumanas; sepse Ai mund te futet ne nje nirakar, Ai mund te shkoje ne nje gjendje pa forme. Komunikimet gjithashtu, ne e perdorim per kete komunikim qe kemi, mbase mund te themi qe ka, qe ne kemi nje altoparlant, por kemi nje televizor, kemi radio dhe gjithë keto gjera. Ku kapemi ne eter, cdo gje eshte bekimi i plote i Hanumana, dhe jane ne dispozicion te njerezve qe jane te anes se djathte. Vetem njerezit e anes se djathte i zbulojne keto gjera te hapësirës, te cilat i quajme telefon pa tel ose nje gje pa gje 'ne kemi edhe telegrafe, ku nuk perdoret asgje tel. Pra pa ndonje lidhje, vetem nepermjet eterit, Ai mund ta menaxhoje. Pra gjithë keto lidhje eterale jane kryer nga ky inxhinier i madh, Shri Hanumana. Dhe eshte kaq perfekte, kaq perfekte sa nuk mund ta sfidosh ate, dhe s'mund te gjesh gabime ne te. Ndoshta instrumentet tuaja mund te mos jene ne rregull, por per sa kohe puna eterale e Tij eshte ne vijim, Ai eshte aty persosmerisht. Tani shkencetaret e zbulojne ate dhe mendojne qe eshte ne natyre, por kurre s'mendojne si mund te jete? Ne themi dicka ne eter dhe si eshte ai, eshte pranuar ne fund? Ata thjesht e marrin per te mireqene, keshtu ne themi dicka ketu ose transmetojme dicka ne televizion dhe shihet ne anen tjetër. Por ata kurre as nuk mendojne apo te kerkojne si eshte bere, cila eshte rruga. Dhe kjo eshte ajo qe eshte puna e Shri Hanumana, qe ka bere nje rrjet kaq te bukur, dhe nepermjet ketij rrjeti funksionojne te gjitha gjerat. Pra edhe ne anen e djathte. vibrimet qe marrim ne molekula, sic e dini qe ne marrim molekula si dioksidi i squfurit, nese keni squfuri, keni dy oksigjen, dhe oksigjeni vjen e pulson keshtu. Ata jane asimetrike, tipe simetrike te vibrimeve, te gjithë ju duhet te dini rreth kesaj. Pra gjithë keto gjera, vibracione simetrike dhe asimetrike jane krijuar prej cilit? Askush nuk do ta dije, askush s'deshiron ta zbuloje, pasi mbi te gjitha ne nje atom ose...

Pra imagjinoni, ne nje molekule, kete thelesi, kush e ben kete pune? Eshte bere nga Shri Hanuman, me menytrat delikate te Tij. Pra Ai ka nje tjetër te madh, siddhi te madh te cilen ne e quajme anima-shpirt. Anima, anu – "anu" do te thote nje molekule, dhe kjo do te thote qe mund te hyje ne nje molekule, ose "renu" eshte atomi. Mund te hyje ne nje molekule ose ne nja atom. Tani, shume shkencetare mendojne se kane, zbuluar ne keto kohe moderne molekulat. Nuk eshte keshtu, sepse eshte e ditur ne shkrimet tona te shenjta, pershkrimi i animas eshte aty, eshte i "anu", "renu" eshte aty, pra eshte tashme e pershkruar aty. Tani, cfaredo, cfaredo qe ju shihni forcat elektromagnetike qe punojne, funksionon nepermjet bekimit te Hanumanas. Ai eshte ai qe krijoi forcat elektromagnetike. Pra tani ne mund te shohim qe meqe Ganesha ka forcat magnetike ne Te "Ai eshte magneti, Ai eshte, Ai ka forcat magnetike "prandaj ne mund te themi qe elektromagnetizmi eshte, eshte ai qe ne e quajme forca e Hanumanas. ne anen materiale te tij. Por nga lenda Ai kalon lart ne tru. Pra Ai ngrihet nga Swadishthana lart ne tru, gjithashtu ne tru Ai krijoi bashke-marrdhenie te aneve te ndryshme te trurit tone. Pra sa shume qe na jep Ai. Dua te them, nese Ganesha na jep neve diturine, atehere Ai na jep fuqine e te menduarit. Ai edhe na mbron, per te mos menduar per gjerat e keqija. Kjo eshte, mund te themi qe, nese Ganesha na jep diturine, atehere Shri Hanumana na jep ndergjegjen. Shpresoj te kuptoni ndryshimin mes te dyjave. Dija eshte ku juve s'ju nevojitet ndergjegja edhe aq sepse ju jeni te zgjuar, e dini c'eshte e mire, c'eshte e keqe. Por ndergjegja eshte e nevojshme ne nje personalitet qe duhet te kontrollohet, dhe ky kontroll vjen nga Shri Hanumana, i cili eshte ndergjegja ne qenien njerezore. Tani kjo ndergjegje qe eshte Shri Hanumana eshte forma delikate e Tij qe na jep ne Sanskritisht quhet si "satasat vivekabuddhi": do te thote, "sat" e vertete, "asat" do te thote e pavertete, dhe "viveka" do te thote maturi, dhe "buddhi" do te thote inteligjence. Pra, inteligjenca qe te dallosh midis te vertetes dhe te pavertes na eshte dhene prej Shri Hanumana. Ne sistemin Sahaja Yoga, nese themi qe Shri Ganesha eshte ai qe na jep, Ai eshte adhyaksha, do te thote Ai eshte "Une e quaj Ate si kancelar te universitetit. Ai eshte ai qe ben gradimin (shkallezimin) "Ju keni kaluar kete cakra, ate cakra, ate cakra." Dhe Ai ndihmon te kuptojme ne cilen faze jemi. Pra Ganesha na jep, te themi nirvichara Samadhi te cilen mund ta quajme si vetedija pa mendime, dhe nirvikalpa samadhi. Na jep gjithë kete, dhe gjithashtu Ai na jep gezim.

Por te kuptuarit qe kjo eshte e mire, qe eshte per te miren tone, te kuptuarit mendor vjen tek ne prej Shri Hanumana. Dhe eshte shume e rendesishme per njerezit Perendimore sepse duhet te jete mendore, perndryshe ata s'mund ta kuptojne. Nese s'eshte mendore ata s'mund te futen ne abstrakten. Duhet te jete mendore. Dhe keshtu kuptimi mendor qofte i te mires apo te keqes na eshte dhene nga Shri Hanumana. Pa Te, edhe nese behesh nje shenjtor ti do te behesh "sigurisht, ti je nje shenjtor dhe do e gezosh shenjterine; por sidoqofte kjo shenjteri eshte mire nese jeton ne Himalaja, ose eshte ne rregull kur ti shkon permes njerezve tu japesh atyre realizim "gjithë ky hetim (skanim) ky vivekabuddhi, gjithë ky scanim, gjithë ky hetim, gjithë ky udhezim, gjithë kjo mbrojtje ju eshte dhene nga Shri Hanumana. Gjermania eshte nje shtet qe gjendet shume, po shume shume do thoja, ne themelin e anes se djathte; per shkak te ketij themeli ne anen e djathte, eshte e rendesishme te kemi mbrojtësin e anes se djathte ketu si te adhuroar. Por ne gjithë kete vivekabuddhi, ne kete hetim (shqyrtim) Ai di nje gje, qe Ai eshte absolutisht i nenshtruar nga Shri Rama. Tani cfare eshte Shri Rama?

Shri Rama eshte mbreti i mireqenies, Ai punon per mireqenien. Dhe Shri Rama Vete eshte nje mbret formal, si sankocha, ne e quajme ate "Dua te them, fjalet ne anglisht nuk jane shume te qarta per ta shpjeguar kete, por Shri Rama eshte ai qe eshte, ai qe nuk e shtyn Vetem perpara. Ai rrin mbrapa. Ai eshte shume i ekuilibruar, Ai eshte nje njeri shume i gatshem. Keshtu Hanumana, shikoni, Ai, Ai eshte ai qe eshte gjithmone i shqetesuar per te bere punen e Shri Rames, gjithmone. Nese Shri Rama thote, "Shko e merr ...I tha Atij, "shko dhe merr..."sanjeevani eshte nje lloj bari qe nevojitet per te sjelle ne jete Lakshmana "Ai shkoi atje dhe Ai solli gjithë malin me Vete, "Me mire ta kesh kete." Eshte si nje lloj personi, shihni, Ai e solli te gjithin "Kjo eshte nje sjelle femijore e Tij." Dhe shqyrtimi qe mund te besh mbi te eshte qe "Nese Shri Rama kerkon, cfaredo qe Ai te kerkoje, une do ta bej."Pra eshte nje maredhenie, do thoja,si e guruse me shishyan, Por edhe me shume se kjo, se shishya eshte vetem nje sherbetor servil, absolutisht i dorezuar ndaj Zotit, absolutisht i dorezuar ndaj Zotit, dhe gjeja kryesore e Tij eshte dorezimi. Tani shihni, qe vete ky dorezim tregon se te gjithë ata qe jane njerez te anes se djathte jane te dorezuar ndaj Zotit, jo dorezuar ndaj shefave te tyre. Me se shumti gjithë keta njerez te anes se djathte jane shume te dorezuar ndaj shefave te tyre, te dorezuar ndaj punerave te tyre, ndonjehere shume te dorezuar ndaj grave te tyre. Por ata jane sherbetore ndaj njerezve te gabuar,nuk kane liri. Do shihni gjithmone, qe ata nuk kane liri. Por nese merrni ndihmen e Hanumana, Ai do ju tregoj qe ju duhet te jeni te dorezuar ndaj Zotit te Plotefuqishem dhe askujt tjeter, ose Guruse suaj si Rama. Perndryshe ju nuk do jeni i dorezuar ndaj askujt. Dhe me pas ju jeni nje zog i lire, dhe ju keni te gjitha nente fuqite brenda vetes suaj. Gjithë gjeja e Hanumanas eshte te kunderhelmoje mbiaktivitetin tuaj, te kunderhelmoje te menduarit e tepert, te kunderhelmoje egon tuaj. Tani, si Ai i jep fund egos se njerezve eshte treguar embelsisht kur Ai dogji te gjithë Lankan "eshte kryeqyteti i Ravanas dhe menyra si e beri shaka me te. Sepse kur shikoni cdokend qe eshte egoistik, ju duhet te beni shaka me ate, atehere jeni ne rregull. Si Hanumana, kur ne fillim Ravana e pa ,i tha, "Kush jeni ju? Kush jeni Ju, majmuni?" Keshtu Ai thjesht vuri bishtin drejt tij, dhe gudulisi hunden me bishtin e Vet. Pra Ai eshte ai qe ben shaka me njerezit egoistike. Tani, nese dikush egoistik perpiqet t'ju shqetesojë, Ai eshte ai; Ai do te beje kaq shaka me te sa qe ju do habiteni se si ky shoku duke u hedhur, si Humpty-Dumpty ra poshte dhe theu kuroren e tij. Me kuptoni pra, kjo eshte puna e Hanumana t'ju mbroje nga njerezit egoistike. Dhe gjithashtu Ai mbron edhe njerezit egoistike duke u treguar "si le te themi Sadam. Ne rastin e Sadamit une thjesht i kerkova Hanumanas te beje punen, sepse e di qe Ai do ta beje. Ja se si e vuri Ai kete Sadamin ne rrethana te ndryshme, qe ai nuk di si t'ia beje, e nga t'ia mbaje. Sepse supozojme ai thote, "Ne rregull, une do te kem lufte"; keshtu gjithë Iraku do mbarojë, ai do te mbarojë, Kuwaiti do te mbarojë, gjithë nafta do te mbarojë, mire. Te gjithë do jene ne telashe. Po per te? "As ai s'do jete me." Sepse nese Amerikaneve do iu duhet te luftojne, ata do shkojne te luftojne ne vendin e tij. Ata s'do te luftojne ne Amerike, ai nuk ka per te shkuar ne Amerike te luftojë me ta. Pak Amerikane mund te vdesin. Pra, ne trurin e Sadamit edhe Hanumana eshte duke punuar e duke i thene, "Shiko tani, Zoteri, nese vepron keshtu, atehere do te ndodhe kjo."Ai punon ne trute e te gjithë politikaneve,e gjithë ketyre njerezve egoistike. Dhe pastaj, ata ndonjehere shtangen, ndonjehere ata ndryshojne politikat e tyre, sillen verdalle dhe keshtu menaxhojne. Gjithashtu nje tjeter cilesi e mrekullueshme e Hanumanas eshte qe Ai i ben njerezit "eshte si nje lloj arbitri Ai "Ai i ben njerezit te takohen me njeri-tjetrin. Dhe dy njerez egoistike, do i beje te takohen, e me pas do krijojë situata te tilla qe te dy do te behen miq dhe te bute. Pra i gjithë karakteri i Tij brenda nesh na ben te shohim egon tone, te vezhgojme qe "Oh kjo eshte ego ime qe po vepron," dhe me pas te ben si femije dhe te embel, gazmore dhe te lumtur. Ai eshte gjithmone ne nje gjendje kercimi, Ai eshte duke kercyer gjithë kohes, dhe gjithmone eshte i perulur para Ramas, dhe gjithmone deshiron te beje cfare do qofte deshira e Shri Rames. Pra nese Ganesha qendron pas Meje,

Hanumana qendron ketu tek kembet e Mia, dhe Ai eshte ketu. Ne te njejten menyre do thoja, nese Gjermania " sic Me tha Filipi qe nese Gjermania mund te behet si Hanumana "atehere sa force dinamike kemi, nese ata behen kaq te nenshtruar. Dhe natyra e nenshtruar e Hanumanas eshte pare ne nje mase te tille qe, sic e dini historine e Sitas kur Ajo i dha nje varese Atij sa Ai s'mundi ta vinte dot, sepse nuk kishte brenda Ram. Kur Sita e ndjeu qe Ai ishte rrotull gjithë kohes, dhe qe ne nje fare menyre Ai ishte duke prishur privatesine e Saj. I tha, "Tani, ti mund te jesh aty vetem per nje pune. S'eshte nevoja te besh cdo gje."Ai e kish zakon te bente cdo pune per Shri Rama. Ajo tha, "Duhet te jesh aty per nje pune. Zgjidh cfaredo pune qe Ti do te besh."Ai tha, "Shiko, mua do me pelqente vetem te jem me Shri Ram, qe kurdo qe Ai teshtin une te beja keshtu." Shikoni, ne Indi kur ne teshtijme, ne duhet te bejme keshtu me kete; sepse e teshtira eshte, me kuptoni, shmangie, te shmangesh gjithë negativitetin duke e nxjerre. Pra ne bejme keshtu nese teshtijme. Ose nese ndihesh pergjumesh ju gogezini, atehere edhe ne bejme keshtu, me se shumti. Pra Ai tha, "Kurdo qe Ai te gogesije, ju do te Me lejoni vetem te..." "ne e quajme kete si chutki, Nuk e di si e quani ju kete, chutki" "Me lejoni te bej kete."Sita i tha, "Kjo eshte nje pune shume e vogel, kuptoni, me pas kete djale s'do e kishte me para syve." Keshtu ai qendroi aty. Ajo i thote, "Po tani pse po qendron ketu?" "Une po pres per kete. Pra si mund te shkoj?" Dhe keshtu "Ajo i

dha, fillimisht Ajo i dha, "Mire, iu dha Juve kete pune," tani s'mund t'ua marre sepse Ajo ju a dha kete pune. Pra Ai eshte gjithmone aty ne kembe, thjesht per te bere kete ndaj Shri Ram. Dua te them, embelsia e gjithë kesaj eshte se ne cdo kohe, cdo minute Ai eshte i gatshem, eshte i kujdesshem, Ai eshte aty. Ne Sahaja Yoga gjithashtu une kam marrdhenie me ju si nje Guru, si nje Nene dhe s'e di, e pakufijshme. Por ne njohim ende keto dy marrdhenie, qe une jam Nena dhe Guruja juaj. Tani per Mua "si nje Guru, shqetesimi kryesor eshte qe duhet te dini gjithcka rreth Sahaja Yoges, ju duhet te beheni eksperte te Sahaja Yoga, dhe duhet te beheni guru te vetes suaj. Eshte i vetmi shqetesim qe kam. Por per kete, kerkohet dorezim i plote."Islam" do te thote te dorezohesh. Pra ju duhet te dorezoheni. Nese ju dorezoheni, vetem ateherë mund te mesoni cfare eshte, cila eshte menyra per te trajtuar Sahaja Yogan. Tani, edhe ky dorezim eshte bere nga Shri Hanumana. Ai eshte i vetmi qe ju meson si te dorezoheni ose ju ben te dorezoheni, sepse njerezit egoistike nuk dorezohen. Me pas Ai vuri disa lloj pengesash ose disa lloj mrekullish ose disa truke, prej te cilave nje dishepull e dorezon veten e tij ndaj Guruse. Perndryshe ai nuk dorezohet, e ka te veshtire te dorezohet, dhe fuqia qe vepron mbi te per ta bere te dorezohet ndaj Guruse edhe ajo eshte e Hanumanas. Pra jo vetem qe Ai eshte i dorezuar, por Ai i ben edhe te tjeret te jene te dorezuar. Sepse vetem "per shkak te egos ju s'mund te dorezoheni, keshtu Ai eshte ai qe lufton egon tuaj, dhe Ai e nenshtron ate dhe ju ben juve te dorezoheni. Pra ne shprehjen e Tij, Do te thoja qe Ai ka treguar qe gjendet nje zone shume e bukur e anes se djathte. Nese do te shijohet persosshmerisht ateherë ju do i jeni dorezuar plotesisht Guruse suaj, meqe ju jeni sherbetori i ketij Guruje. Cfare do qe ju duhet te beni per kete Guru, ju duhet ta beni. Sigurisht, ju duhet ta dini qe Guruja juaj duhet t'ju jape realizim, minimumi, perndryshe ky nuk eshte nje guru. Por cdokush qe ju ka dhene realizimin, ju duhet t'i dorezoheni se ju duhet te jeni tamam si nje servant, mos ndjeni turp ndaj tij. Sic do thoja une ndonjehere, une po shkoj, te themi, Une po shkoj me aeroplan, dhe ka raste qe s'mund te vesh kepuçet e Mia sepse jane shume te fryra. Pra normalisht do i merrja kepuçet ne duart e Mia dhe te ecja. Por kam pare Sahaja yogis, ata marrin edhe kepuçet e Mia dhe ecin me to, dhe nuk u vjen turp per kete. Ata thjesht ndihen krenare qe po mbajne kepuçet e Mia. Pra nuk ka pse "dikush te ndihet krenar qe eshte duke bere keto gjera, qe keni rastin t'i beni gjithë keto gjera Guruse suaj, dhe qe ju po i dorezoheni ketij Guruje; qe jeni absolutisht vetem i merakosur si ti sherbeni Guruse suaj, si ta kenaqni Gurune tuaj, dhe si te jeni sa me afer Guruse. Nuk do te thote ne afersine fizike por nje lloj raporti, nje lloj mirekuptimi. Madje edhe ata qe jane larg Meje mund te Me ndejne ne zemrat e tyre. Dhe kjo eshte ajo qe eshte, qe ju duhet te keni kete fuqi nga Shri Hanumana. Ai eshte gjithashtu ai qe mbron gjithë hyjnite. Ai mbron. Tani ka nje diference midis Tij dhe Shri Ganeshes. Shri Ganeshja jep energji shakti, por ai qe mbron eshte Shri Hanumana. Keshtu do te kuptoni qe kur Shri Krishna ishte karroca e luftimit te Arjuna, ne maje te karros ishte i ulur Hanumana, jo Shri Ganesh. Hanumana i ulur aty kujdesej per Te. Se ne nje menyre Vete Shri Rama shnderrohet ne Shri Vishnu, ndaj Ky duhet te kujdesej per Te. Ai eshte nje engjell, sic e dini: sipas Kristianeve, duhet te themi sipas Bibles, qe Ai eshte engjelli i quajtur Gabriel. Tani Gabrieli eshte ai qe solli mesazhin, sepse Ai eshte gjithmone nje lajmetar, per Marian, dhe ishin te cuditshme fjalet qe Ai perdori "Immaculata Salve" "ky eshte emri Im. Emri Im i pare eshte Nirmala, do te thote "Immaculata" dhe mbiemri eshte Salve. Ai i tha Asaj keto fjale. Edhe sot une u habita kur vjen te Me jape nje dhurate, ata gjeten nje komplet caji dhe komplet darke pjatash qe quhet "Maria." Keshtu Marias i duhet te beje shume me Hanumanan gjate gjithë jetes se Saj. Kjo do te thote qe Maria eshte Mahalakshmi. Mahalakshmi te qenurit Sita, Sita me pas Radha, Hanumana duhet te jete aty t'i sherbeje Asaj. Dhe prandaj, ndonjehere shihni njerez te thone, "Nene, si e dinit Ju? Nene, si e moret vesh JU? Nene, si derguat Ju nje mesazh? Nene, si e realizuat kete? "E imagjinoni dot? Kjo eshte kokecarja e Hanumanas, Ai e ben kete. Cfare do qe kalon ne mendjen Time, Ai thjesht e merr dhe kryhet (behet). Sepse sic ju thashe qe i gjithë organizimi i Tij eshte mbjellur kaq mire; gjithë keto lajme, nga i marrin? Shume njerez thone, "Nene, une thjesht te lutem Ty." Ishte nje zoteri nena e te cilit ishte shume e semure dhe ai shkoi ta shohe, ajo ishte gati duke vdekur nga kanceri. Thote, "Nuk dija cfare te beja, pra une thjesht Tu luta TY, "Nene, te lutem shpetoje nenen time." Tani sinqeritetit i ketij personi, thellesine e ketij personi si nje Sahaja yogi Hanumana e njohu. Ai kuptoi cila eshte pesha e ketij personi. Dhe menjehere, ju do te habiteni, brenda tre ditesh gruaja qe ishte duke vdekur mbijetoi, ajo u be shume mire. Ai e solli ate ne Bombay dhe doktori i tha, "Ajo nuk ka kancer." Shume gjera qe ju i quani mrekullira jane bere nga Shri Hanuman. Ai eshte ai qe eshte beresi i mrekullive. Ai i ben mrekullirat qe t'ju tregojë edhe sa budallenj jeni, sa qesharake jeni, sepse Ai eshte ne anen e djathte, shikoni ai shkon ne anen e djathte. Tani nje qenie njerezore me ego behet gjithmone budallaqe "kjo eshte, dua te them, e paevitueshme. Me ego ata behen kaq budallenj, "Oh, c'problem ka?" Dhe prandaj ju do te shihni shume njerez duke bere budallalleqe, ne s'mund te kuptojme pse e bejne kete. Ata thone, "C'problem ka?" "C'problem ka" eshte qe Hanumana s'e pelqen kete, kjo eshte puna, dhe pastaj terhiqet. Kur ata sillen si te marre terhiqet dhe me pas ata e dine qe kemi bere nje gabim kaq te madh, ose e gjitha ishte nje budallallek. Por ndonjehere mund te jete ekstremisht, ekstremisht e veshtire ta ripershkruash mbrapsht; si semundjet, sic i quaj semundje te yuppies, (sindroma e lodhjes kronike), e cila tani eshte e pamundur sepse Hanuman ka hequr forcën elektromagnetike nga keta njerez dhe kjo s'funktionon, nuk lidhet me mendjen tuaj te ndergjegjshme. Pra mendja juaj e ndergjegjshme s'mund te veproje, vetem del. Vetem ata njerez, nese adhurojne Hanumana me te njejtin

perkushtim, atehere mbase mund te shpetohen. Por s'eshte nje gje e thjeshte te bindesh keta te semure te marre, me kuptoni, per cdo gje. Thone, "Ne nuk besojme. E po pastaj?" Pra cfare, ju vdisni "Cfare tjetër? Ky eshte i vetmi kufi, e vetmja jete e mbetur per ju, bejeni kete. Ka kaq shume aspekte te Hanumanas qe mund t'ua kisha treguar; per shembull, per trupin e Tij, shikoni, si Shiva qe eshte mbuluar me gheru. Ajo qe quani gheru eshte nje, eshte nje lloj, gheru eshte nje lloj, eshte nje gur ngjyre i kuq qe eshte shume, shume, eshte shume i nxehte. Dhe supozojme me te ftohtin ndonjehere ju zhvilloni keto rashes, pra nese ju vini gheru keto rashes korrigjohen. Ose ndonjehere ju merrni, per shkak te badha, disa lloj semundjesh lekure qe kurohen me gheru; sepse eshte ai qe eshte shume i nxehte, dhe ju zbut. Perkundrazi Shri Ganesha eshte e mbuluar me oksid plumbi, me oksidin e verdhe te plumbit qe eshte, qe eshte ekstremisht i ftohte. Oksidi i plumbit eshte nje gje shume e ftohte. Nese prek plumbin, eshte nje gje shume e ftohte. Keshtu qe ky oksid plumbi perdoret per te mbuluar gjithë trupin e Tij eshte per te ekuilibruar nxehtesine qe Ai ka, ose efektin e nxehtesise qe ka. Ne gjuhen Sanskrite kete e quajme sindhura, dhe ne Marathi ose Hindi e quajme shindhura. Pra gjithmone do shohin qe kjo eshte ngjyra e kesaj gjeje; sa me fat qe mora kete sari ne Vjene, qe eshte shume i mire per kete rast. Pra Ai eshte gjithmone me kete ngjyre, ate cfare ju e quani ngjyre sindhur. Dhe oksidi plumbit, mendohet se shkakton kancer, njerezit thone se oksidi plumbit mund t'ju shkaktoje kancer; por eshte oksidi i plumbit qe eshte shume i ftohte, qe mund t'ju freskoje juve kaq shume sa ju mund te shkonin ne anen e majte. Dhe kanceri eshte nje semundje psikomatike, dhe kjo mund te jete arsyeja, mundet shkak, ne nje menyre shume te sforcuar mund te themi, mund t'ju shkaktoje kancer. Sepse nese eshte shume ftohte e keto gjera ju me pas kaloni ne anen e majte, dhe ne anen e majte ju mund te keni viruse, prej te cileve mund te futeni ne telashe. Keshtu, por i njejte oksid plumbi eshte shume mire per njerez qe jane shume te anes se djathte. Per ata nese e vene ne Agnyan e tyre i freskon, i freskon ata. Dhe eshte shume mire per ta qe ta vene ne Agnyan e tyre, keshtu prej saj ata qetesohen. Zemerimi i tyre ulet, temperamentin tyre ulet, dhe kjo eshte nje gje shume e mire. Pra Ai eshte ai qe kuron zemerimin tone, Ai eshte ai qe sheron nxitimin tone, shpejtesine tone, agresivitetin tone. Ai eshte ai qe e ben kete. Ai i luajti nje hile Hitlerit. Si? Hitleri po e perdorte Shri Ganeshan si simbol, pra kjo swastike u be ne kahun e ores. Me pas Hanumana luajti nje hile me te. Cfare beri Ai, Ai beri nje klishe te cilen ata po e perdornin per te bere, ate qe ju e quani, te berit e swastikas. Ai e vuri ate, ne nje menyre ose tjetër, shume nga "Dua te them, Ai e beri ne menyre te tille sa ata thane, "Ne duhet te perdorim anen tjetër." Sapo ata perdoren anen tjetër" Kjo ishte hileja e Hanumanas; lu sugjerova Atij, por e kam fjalën, Ai luajti hilen "ata filluan te perdorin Ganeshan nga ana tjetër. Ganesha e njejte per te cilen, Shri Hanumana shqetesohet si do te mundej Ai, te tejkalonte Shri Ganeshen, sepse Ai eshte me i madhi, dhe si mund te shkoje perteje Tij? Dhe Ai eshte hyjnia, por Hanumana eshte nje engjell. Pra sapo u luajti ky truk (hile), atehere te dy u vune bashke per te ndaluar fitoren e Hitlerit. Keshtu u luajti hileja. Pra gjithë keto hilet e vogla, te vogla fare jane aty. Kujtoj njehere kisha Pujan Time ne Gjermani; dhe Gjermania eshte vendi ku jane luajtur keto truke kaq shume nga Hanumana, sepse ju kam treguar qe ata jane ata qe e kerkojne Ate me shume. Pra ishte Gjermania, kishte nje puja atje, dhe ne puja gabimisht ata e vune ne krah te kundert gabimisht. Une s'e pashe, normalisht gjithmone shoh me shume kujdes, por nuk e di pse, ate dite nuk e pashe: duhet te kete qene edhe loja e Hanumanas. Dhe kur e pashe, thashe, "Oh Zot, ku do shkoje te lendoje tani? Ku do shkoje te veproje? Cilin vend do te godase?" Nuk goditi Gjermanine, goditi Angline. Sepse ne Angli, kam punuar kaq shume atje dhe ata kane qene kaq neglizhente ndaj Sahaja Yogas, kaq te pergjumur rreth saj, saqe thjesht shkoje e i goditi atje. Pra Ai eshte ai qe shkon si nje shi me rrebes, ose mund te shkoje si nje furtune e shpejte, shume e shpejte dhe te shkaktojte gjera. Pra Ai vepron me gjithë keto gjera nepermjet forcave te tij elektromagnetike. Pra e gjithë ceshtja, e gjithë puna eshte nen kontrollin e Tij. Gjithcka eshte nen kontrollin e Tij, dhe Ai eshte ai qe krijon shiun per ju, qe krijon diellin per ju, Ai krijon fllad per ju. Ai eshte ai qe i ben gjithë keto gjera vetem per te pasur nje puja si duhet, per te pasur nje takim si duhet, per cdo gje Ai vepron per bukuri. Dhe madje askush s'e di qe eshte Shri Hanumana ai qe i ka bere keto, dhe ne duhet gjithë kohes te falenderojme Shri Hanumanan. Per ceshtjen e sotme, dua te them, gjenden "Une, nese do me duhej te flisja rreth Tij, do duheshin ore te tera. Por e vetmja gje qe duhet te them eshte se eshte, kaq bekim, ndjej se e kemi kete ne kete pallat, Pujan e Shri Hanumanas. Sepse Ai qe gjithmone nje hyjni shume i madherishem ose nje engjell, dhe kjo ne nje vend qe eshte kaq madheshtor dhe kryer kaq bukur, gjithcka eshte aty, dhe Ai do e pelqente kete. Ai nuk eshte nje person i tipit sanyasi, Ai nuk eshte nje aksetik. Normalisht njerezit e anes se djathte jane aksetike, ata behen...ata do i bejne njerezit e anes se djathte, ata do te kene cdo gje vetem te thjeshte. Nese do ishte e mundur ata do te donin te rruanin edhe hundet e tyre, ne fytyrat! Pra e shihni, anasjallas, Hanumana nuk e ben.

Hanumana pelqen bukurine, Ai pelqen zbukurimet, dhe Ai i ben njerezit jo-aksetike, pra keto lloj gjerash ju jep Hanumana. Por shume njerez qe jane adhurues te Hanumanas gjithmone thone se keto gra kurre nuk duhet te shkojne dhe te marrin darshan te Hanumanas, sepse Hanumana eshte nje brahmachari "eshte ai, i cili nuk pelqen te shihet nga grate sepse ai nuk vesh rroba te plota "dhe ka shume pak rroba veshur tek Vetja, pra Ai nuk do qe grate ta shohin Ate. Por nese gruaja mendon se Ai eshte vetem

nje femije, atehere eshte njelloj. Por eshte kjo ide qe njerezit nuk e kane, qe Ai eshte nje femije. C'eshte per nje femije se sa rroba veshose nuk vesh? Dhe pastaj ai eshte nje majmun, dhe supozohet qe majmunet nuk veshin rroba. Pra cfaredo qe Ai vesh eshte shume, dhe madje as nuk ju jep ndjesine e kesaj Ne cdo menyre ai eshte lakuriq, por ju thjesht shihni nje forme te embel te Tij, forme kaq te embel. Do doja edhe qe ndonjehere te merrnit foton e tij, ashtu sic keni marre fotot e Shri Ganeshas. Me pas do te bini vertet ne dashuri me Te, Ai eshte kaq i embel. Dhe ta mendosh qe Ai eshte kaq gjigand dhe i madh dhe ta mendosh Ai ka thonj, por kur Ai kujdeset per kembet e Mia ai i fsheh thonjte. Ai eshte kaq i sjellshem, ekstremisht i sjellshem, dhe kujdeset me shume hijeshi per kembet e Mia. Dhe kam pare menyren se si Ai merret me cdo gje, ne menyra ekstremisht te sjellshme. Pra kjo eshte ajo qe ndjej, qe tani Gjermanet jane bere shume te sjellshem ne trajtimin e gjerave, ne trajtimin e njerezve. Ky ndryshim po vjen, dhe une mendoj eshte bekimi i Hanumanas tek ta. Pra Zoti Ju Bekofte.



## 1991-1206, Shri Raja Rajeshwari Puja

View [online](#).

Shri Raja Rajeshwari Puja 6 Dhjetor, 1991, Madras, Indi

Sot do te kemi Shri Ganesha Puja, te ndjekur nga Raja Rajeshwari.

Kaq shume emra jane pershkruar nga Perendite; sidomos Adi Shankaracharya e quante Rajan e Saj Rajeshwari, do te thote Ajo eshte Mbretresha e gjithë Mbretreshave. Edhe per Nenen Mari kane perdorur kete titull ne Perendim. Keto ide kane ardhur nga besimi pagan, sic ju kam thene me pare, dhe qe ata s'kane ardhur nga pershkrimi i Nenes Mari ne Bibel. Kjo tregon se ka patur shume ndryshime ne doreshkrimin e Bibles se Shenjte. Gjithashtu aty ka patur shume ndryshime ne doreshkrimin e shkrimeve te shenjta indiane, madje edhe ne Gita. Dhe keshtu filloi rrezimi (katastrofa) ne cdo fe. Dhe intelektualet perfituan nga kjo dhe filluan te projektojne idete e veta, duke thene gjera, pershkruar gjera te cilat ishin absolutisht kunder Fuqise hyjnore. Ju jeni te gjithë njerez shume me fat ne kete Toke qe keni zbuluar realitetin, dhe shikoni qe gjithë keto gjera qe ishin mitologjike jane te verteta; gjithë gjerat qe jane intelektuale s'jane te verteta; gjithashtu cfaredo e perdorur me qellimin per te ndare njerezit prej njeri-tjetrit nuk jane te verteta. Sepse ne besojme tek te gjitha besimet (fete), ja pse cdo person fetar, i ashtuquajtur, eshte kunder nesh; sepse ju jeni te supozuar te besoni vetem ne nje fe dhe te luftoni pjesen tjetere. Nese besoni ne te gjitha fete, kjo do te thote qe ju jeni absolutisht jo fetar "ky eshte koncepti.

Dhe kjo i shokon ata, qe ne besojme ne te gjithë besimet dhe ne respektojme te gjitha misherimet, dhe qe ne besojme ne integrimin e te gjitha ketyre hyjnive. Lidhur me Ganeshen, duhet te kete qene nje zbulim i madh per ju njerez qe vini nga vendet Perendimore. Madje edhe ne veri nuk e gjej Ganeshen kaq te adhuruar sa adhurohet ne jug, vecanerisht ne kete zone, dhe gjithashtu ne Maharashtra; sepse ne Maharashtra kemi tete swayambhu Ganeshas, dhe te gjithë besojne ne te. Tani thuhet se eshte e gjitha besim i verber, e keshtu e ashtu. Por tani ju keni pare Ganeshen duke qendruar pas Meje, brenda Meje: eshte vetem per t'ju provuar se ka nje hyjni qe quhet Ganesha. Do ju jepen ato foto ku Ganesha eshte ne gjysme te rruges ulur ketu, dhe pjesa tjetere eshte Sari im e keto. Por e gjitha kjo eshte per t'ju bindur juve qe ka nje hyjni qe eshte Shri Ganesh, dhe qe Ai vepron, punon nepermjet Mooladhara. Kjo njohuri ishte e ditur tek njerezit Indiane mijera vite me pare. Ky vallezim kuchipudi ka filluar shtate shekuj para Krishtit, pra ju mund te imagjinoni, koncepti i Ganeshes duhet te kete qene para mijera vjetesh. Keshtu njerezit ishin shume te evoluar shpirtarisht ne kete vend, dhe ata e dinin se cfare jane hyjnite, pamjen qe kane, cilat jane funksionet e tyre "edhe pse kjo ishte .

njohuri e fshehte per publikun e gjere. Por cfaredo te thonin shenjtoret ishte e pranueshme, sepse nuk kishte ego rreth saj. Jam perpjekur te gjej se pse ne Perendim njerezit e zhvillojne kaq shume egon. Ende nuk kam arritur te gjej arsyet thelbesore, pse vjen ky lloj agresiviteti nepermjet pjeses se egos. Dikush mund te thote prej konkuresces e gjithë keto, por kjo ka qene historia ne Perendim qe edhe njerezit te cilet ndiqnin Krishtin, qe s'ishte gje tjetere vec perulja absolute e shkruar me germa te medha kudo, ende keta njerez ishin kaq agresive. Tani perulja eshte gjeja kryesore qe dikush duhet te kuptoje. Dhe ju do te habiteni, perulja eshte quajtur si Vinay, . qe eshte cilesia e Shri Ganesha "Vinayaka. "Vidya vinayen shobhate." "Vidya" do te thote "Dituri eshte e zbuluar vetem me perulje."

Keshtu perulja qe pate dje tek ata artiste te medhenj, dhe gurute e medhenj qe ishin atje. Dhe gurute Me ftuan ne akademine e tyre, dhe ai beri gjithë llojet e ofertave (temenarave) sic do t'i benin ndaj nje Perendie. Isha kaq e mallengjyer, pranimi i gatshem i Imi dhe i Sahaja Yoga. Edhe ky Kalakshetra, qe dominohej nga Shoqeria Theosophical" edhe pse kjo zonje nuk e vriste shume mendjen per Shoqerine Theosophical" e kish krijuar kete auditor te madh e gjithë kete, dhe gjithcka ia dedikoi artit. Ajo nuk e lejoi Shoqerine Theosophical te hyje ne te. Pavaresisht kesaj, se si ata me pranuan Mua, te gjithë ata, mund ta shihni qarte devocionin dhe kuptueshmerine e tyre. Te jesh i perulur me nje shenjtor eshte absolutisht nje ligj i pashkruar ne kete vend. Dhe nje shenjtor nuk duhet te sfidohet, nuk duhet te dominohet. Cfaredo te thote shenjtor ju duhet ta pranoni. Pra cilesia e pare qe Ganesha duhet te na jape eshte vinay " "vinay" do te thote perulje.

Perulja nuk eshte siperfaqesore, si te shkosh te thuash "me fal" ose "me falni" ose "Druaj se"- jo ne kete menyre. Nuk eshte

watchik, s'eshte thjesht levizje buzesh, por nga brenda duhet te vijë perulja. Tani perulja, sigurisht qe eshte gjithmone e penguar nga ego dhe egoja thjesht ju mban ne det, dhe ju kurre s'kuptoni qe keni qene egoistik. Madje kur flas per egon, njerezit mendojne se Nena eshte duke folur per dike tjeter, s'mendojne kurre "jam une qe e kam kete ego." Pra Ganesha eshte vrasesi i egos, sepse perulja eshte e vetmja gje qe vertete mund te neutralizojë egon tuaj. Per te bere veten te perulur, duhet te shihni cfare? Per shembull, ju keni ardhur ne kete vend, shihni njerez shume te thjeshte, jetojne thjeshte fare, nuk kane gjithe keto gjera te sofistikuar rreth tyre; qe hane me duar, qe hane ne peme dhe gjethe. Dhe sipas disa zonjave qe kane jetuar ketu, Perendimoret, ato mendojne se te gjithë jane primitive. Por shikoni se si e kane zhvilluar kete ne art. Kjo lloj shpejtesie dhe ky lloj, madje kercimi kete lloj, ju s'mund ta arrini.

Tani, cila eshte arsyeja per kete lloj pune, eshte perulja ndaj artit. Arti duhet te respektohet. Nje guru duhet te respektohet. Respekti eshte e vetmja menyre per te mesuar dicka. Kjo eshte nje lloj rrenjosje ne gjakun Indian, mendoj, qe duhet t'i bindeni guruse suaj, pa dyshim, nenkuptohet. Dhe ky guru eshte duke trajnuar kaq shume njerez, ka kaq shume vajza atje, jo per gje por vetem per te shprehur artin e tij. Ai s'mund te fitoje shume para, mund ta shoh kete. Kane shume pak dispozita, dhe gjithashtu nuk ngarkohet shume. Por dedikimi qe ai ka eshte si dedikimi i Shri Ganeshas ndaj Nenes se Tij. Dhe menyra se si eshte zhytur teresisht ne te: gjithe gjerat e tjera jane te parendesishme.

Pra per peruljen tuaj duhet te terhiqni vemendjen tuaj nga gjerat e tjera. Kjo eshte nje gje ekstremisht e rëndesishme. Nese vemendja juaj shkon ne problemet e tjera, kjo, ajo, ose nese ju po perpiqeni te hyni ne Sahaja Yoga nepermjet kanaleve te tjera, nuk do te funksionojë. Duhet te jeni te perulur thelle ne zemren tuaj, absolutisht te perulur. Ai eshte i pafajshem, prandaj Ai eshte i perulur. Nese nuk jeni i pafajshem, atehere s'mund te jeni i perulur. Perulja eshte shenje e pafajesise. Nje femije i mire, nje femije i kendshem e i pafajshem eshte shume i bindur. Cfare do t'u thuash, ata do te binden. Shoh niperit e Mi " Njehere po shkonim ne Nepal, dhe ishte shume ftohte atje.

Nena e tyre thote, "Nuk duan te marrin asgje ne kokat e tyre." I them, "Do ta bej kete ne nje minute." I therras, u jap nga nje veshje te zakonshme. I them, "Duhet te mbuloni kokën tuaj". "Mire." Ata i vune ne koke, sic duhet, i fiksuan. Dukeshin pak te cuditshem, por nuk e cane kokën. Kjo eshte ajo qe mungonte, dhe prandaj shohim qe thellesia eshte me e paket. Jo thjesht vetem kushtezime" Nuk do te thoja kushtezime. Njerezit behen prej kushtezimeve; madje edhe Indianet jane bere te tille.

Eshte e veshtire per ta te jene te perulur, shume e veshtire. Mund ta quani ndikim Perendimore, ose mbase ata e kane harruar te shkuaren e tyre. Por perulja eshte kaq e rëndesishme. Duhet t'ju tregoj, prej femijerise sone, pavaresisht se isha lindur ne nje familje Kristiane, ne duhet te prekim Nenen Toke dhe fillimisht te kerkojme per falje, keshtu nguliteni ne kokën tuaj. Dhe prekni kembet e prinderve tuaj, dhe te gjithë te moshuarve te familjes suaj "a s'eshte keshtu? Prekni kembet e secilit qe eshte i moshuar ne familje. Madje edhe te disa sherbyesve te vjeter, qe jane kujdesur per vellezerit me te medhenj e keshtu "prekni edhe kembet e tyre. Por kjo perulesi mungon. Dhe dinjiteti qe duhet te kene te vjeterit nuk ekziston. Por sido qe te jete, ishte detyra jone te preknim kembet e cdokujt, e jo te diskutojme me te moshuarit.

Pra kjo do te krijojë nje atmosfere kaq te bukur ne Sahaja Yoga Nese kembengulni qe "A jam i perulur kur bej kete?" Thjesht beni nje pyetje, "A kam qene i perulur duke bere kete, apo duke thene kete?" Problemet tani jane ne kritikimin e lidereve. Ata jane lidere sepse e meritojne. Diten qe do shoh qe ata nuk jane te mire, do i nxjerr jashte" edhe ju e dini shume mire kete. Por nuk ka perulesi. Pasi perulesia eshte zevendesuar me egon, dhe kjo ego krijon nje ego tek lideret. Lideret behen egoistike, dhe kaq shume lidere jane perzene. Dua te them thjesht s'e di, kur duhet te vijë ekuilibri, nese duhet te fajesoje anetaret apo lideret. Pra Nena i ka emeruar ata si udheheqes, pra le te jemi te perulur.

Pas se gjithash, duhet te kete ndonje arsye pse Nena u ka kerkuar atyre te behen lidere. Pse duhet te perpiqemi te grindemi me ta, t'u gjejme gabimet? Ne formojme nje si bashkim. Pra Shri Ganesha, qe eshte kaq i perulur, dhe ganat e Tij ne nje fare menyre jane edhe me te perulura, sepse Ai nuk do te tolerojë asnje gana qe s'ka perulesi ndaj Nenes. Me nje levizje te vogel te syve jane aty per te luftuar, dhe te bejne cfaredo qe ju sugjerohet. Dhe ata kuptojne me cdo kend te syrit te Nenes se tyre, cfare duhet bere. Pra ky lloj dedikimi vetem mund t'ju beje vec me te thelle e me te thelle. Tani mund te jete kjo menyra se si e njohim kete ne Perendim, duhet ta perhapim me shume, ta reklamojme me shume, duhet te flasim rreth vetes me shume, duhet te krenohemi me shume per veten. Sa me shume ta beni, me te sukseshem do te jeni. Kjo eshte ajo qe shihni cdo dite.

Ata krenohen "Une besoj" kuptoni, kush jeni ju te besoni ose te mos besoni? Kush jeni ju qe e thoni kete? Por ky lloj imazhi i juaj duhet te duket si nje lloj njeriu me personalitet te larte, apo me nje lloj profili te madh. Ju krijoni nje profil; absolutisht artificial, te pakuptimte. Dhe shume e habitshme, nje profili te tille qe eshte kaq artificial, njerezit i perulen. Mbase edhe ata jane artificiale, prandaj u perulen ketyre njerezve artificiale. Habitem, dua te them, keta jane kriminele te njohur, pra njerezit e dine qe ata jane kriminele, kane bere nga te gjitha, per perseri do te bien permbyas para tyre. Mbase ngaqe duan ndonje lloj avantazhi material prej saj, nuk e di, ndonje lloj avantazhi artificial. Edhe pasja e nje fotografie me nje njeri te tille shihet si dicka e mrekullueshme. Pra gjithte keto ide duhet te shihen permes Sahaja yogistev.

Ata duhet te shohim permes kesaj shakaje, kesaj drame, cfare po ndodh, gjithashtu te reflektojne dhe te shohin brenda vetes e te kuptojne, "Shpresoj te mos e kem kete brenda meje," Ndonjehere qeshim me te tjeret por jemi edhe vete ne te. Pra kur fillojme shohim brenda vetes, kuptojme brendesine e vetes sone, "Po, kjo eshte aty." Ka disa Sahaja yogis ne disa vende, Me kane njoftuar gjithmone, qe papritur ata thone, "Nena me ka dhene fuqi speciale." ose ata thone, "Une jam Maha Mataji" ishte gjithashtu nje i tille, Maha Mataji. Madje as une s'kam thene qe jam Mataji. Ju njerez Me therrisni keshtu, une s'e kam thene kurre kete. Por ai tha, "Une jam Maha Mataji." Mund ta quani te cmendur, mund ta quani c'te doni, por eshte padyshim arroganca e tij e perparuar ne menyre te tille qe ai s'e kupton se per cfare po flet. Keshtu ju perkedhelni egon e lidereve (udheheqesve) tuaj, duke i sulmuar. Sa me shume e sulmoni ate, ai reagon dhe kur ai reagon, egoja e tij shkon e fryhet keshtu.

Sic ju kam thene, sot ne do te bejme adhurimin e Raja Rajeshwari. Nuk ua kam thene kurre me pare. S'ju kam kerkuar kurre te lexoni Guru Gita, per te njejten arsye. Asnjehere s'ju kam thene qe Ajo eshte Raja Rajeshwari, sepse perseri mund te shkoje pak brenda egos suaj, "Si mund te jete Ajo Mbreteresha e te gjitha Mbretereshave?" Sigurisht, Nena e Krishtit eshte ne rregull, por jo Mataji "eshte e tepert! Pra s'ju kam thene kurre kete. Une thashe, "Baba, Une jam nje Nene e perulur, kjo eshte e gjitha, Nena e shenjte", mbaroi. Krijohen vrime ketu, prandaj mund te jete kjo! Cfare do te jete, mund ta kuptoj cili ishte problemi, dhe ne nje menyre shume qesharake kemi menaxhuar shume gjera. Por perseri ndjej qe, shikoni se si jane artistet, se si jane njerezit, menyren si i krijojne gjerat" mund te mos kene lidhje me idete tuaja per zbkurimin, ose gjithcka.

Mund te thoni eshte mjaft e renduar, ose mbase kjo, ajo, sic eshte me kuptoni, gjithmone ne tru. "Mund te kishte qene shume me pak, mund te kishte dicka me me hapesire, "e gjithte keto. Ju mund te filloni te kritikoni, sepse kjo eshte nje nga cilesite e njerezve qe nuk jane te perulur, qe mendojne se kane aftesine te kritikojne gjithcka. "Oh s'me pelqen kjo ngjyre, nuk eshte e mire." Por artisti e ka bere ate me gjithte zemren e tij "vleresojeni ate!" Pra pika e dyte eshte te vleresosh. Vleresoni jeten tuaj; sido qofte, vleresojeni, pranohen. Por jo me hezitim. Gjithe keto ide mendore ne koke qe arti do te thote kete dhe arti do te thote ate, na ka sjelle ne kete situat qe "ne nuk po kemi me Rembrande as Michelangelo " mbaroi. Nuk eshte mendor, arti nuk eshte mendor.

Vjen nga brenda, dhe cfaredo qe vjen prej se brendshmi nuk mund te krahasohet me idete prej se jashtmi. Pra pjesa vleresuese "E kam fjalen, ju mund te thoni qe Indianet jugore veshin fustane shume shume te renda per stilin tone, Por sipas Meje jo. Disa mund te thone dicka tjeter. Gjithashtu kam vene re qe Indianet Veriore mund ti kritikojne Indianet e Jugut, Indianet e Jugut mund ti kritikojne Indianet e Veriut. Por sido qe te jete, cfaredo "askush nuk po merr ndonje gje te mire nga kjo." Eshte budallallek, eshte marrezi. Por te vleresosh dhe te pranosh, kete pervesojeni. Indianet e Veriut s'mund te pelqejne cfaredo te provoni, ata s'munden. Madje ata s'mund te pelqejne as muziken. Tani, a mund te imagjinoni gjithte Indine te ndare ne dy pjese, dhe Indianet e Jugut s'mund te pelqejne ushqimin e atyre te Veriut as vallezimin e Indianeve te Veriut" Dua te them, edhe ne vendin tone.

Jemi kaq te percare ne kete vend sa qe nje person nga Rameshvaram s'do te pelqeje ushqim nga Madras, nje person nga Madras s'do te pelqeje ushqimin nga Delhi. Pra gjithte keto metoda percarese kane ardhur midis jush duke mos patur perulesi te brendshme. Nese mund te shijoni secilin dhe gjithcka, atehere ju jeni te perulur. Nese mund te vleresoni secilin dhe cdo shprehje, atehere ju jeni te perulur. Kjo perulesi eshte nje karakter shume i thelle, sepse vjen prej Mooladhara. Dhe kjo eshte ajo cka eshte Shri Ganesha. Vetem imagjinoni, Ai ka nje mi te vogel mbi te cilin leviz, Ai nuk ka makina Impala apo Rolls Royces. Ai thjesht leviz, me gjithte stomakun e Tij te madh Ai leviz mbi miun e vogel. Asnje pohim i fuqive te Tij "Ai eshte kaq i perulur, Ai eshte kaq i embel. Dhe Ai eshte krijuesi i gjithte ritmeve (melodive) dhe gjerave dhe vibracioneve.

Pa Ate, une s'e di si mund te ishte kjo bote. Dhe kjo eshte ajo qe ne duhet te vleresojme kudo, ne vend te denancimit te kesaj, asaj. E kam fjalen, edhe ngjyren e kesaj dhome mund te mos e pelqeni, kete mund te mos e pelqeni. Dua te them, ka qaq shume gjera qe ju nuk i pelqeni. Atehere duhet t'ju pyes, "Cfare ju pelqen?" "Fasule te pjekura" "Shume mire! Ne duhet te hapim veten tone. Me perulesine ju hapeni, penetroni, perhapeni. Pa perulesi ju nuk mundeni, sepse ju po kundershtoni gjithcka, po ngrini nje mur. Vetem perulesia do ju beje te perhapeni.

Sot, ne ditën e pare te turit tone, Do ju kerkoj qe te jeni shume, shume te perulur. Te kuptoni qe perulesia eshte ekstremisht e thjeshte, dhe eshte e bukur. Ju e pate ate vajze te vogel te luante veyen, kaq i veshtire Adi Vadyam, instrument i hershem, i luajtur me kaq embelsi, me kaq shkathtesi, dhe kaq perulesi. Dhe ajo erdhi tek Une dhe me tha, "Nene, cfare privilegji ishte qe pata mundesine te luaja perpara Jush." Vetem imagjinoni "nje gjeni e tille." Nje tjetër qe Me takoi se fundmi ishte nje qe luante mandolinen rreth te njejtës moshe, mbase me i vogel. Tani ai eshte i njohur boterisht, por kur ai luajti para Meje, nuk deshi te pranonte asnje para, asgje, ai thjesht hyri ne ekstazi. Edhe kercimtarja, ajo Me tha qe hyri ne ekstazi kur Me pa, dhe ajo thjesht kerceu kaq mire e me kaq energji. Dhe ajo "ajo kishte temperature." Ajo tha, "Temperatura me iku, cdo gje.

Jam shume mire." Shikoni keta artiste. Ata kurre nuk me kane njohur Mua, ata nuk dine asgje rreth Sahaja Yoga. Por cfare mirekuptimi i perulur i Hyjnore" sepse ata jane te perulur. Hyjnora kurre s'e deklarën veten, nuk e propagandon veten, nuk ben zhurme te madhe. Pra ja ku jane tani. Afrohuni. Eshte Guido ai? Kane ardhur Italiane. Prandaj e vonova puja sot.

Guido eshte ai? Thirreni. Guido eshte shume i perulur qe te vije perpara. Eja, eja. Vetem leviz pak me perpara. Zoti ju bekoftë. Po prisja per ju! Ju lutem, ju lutem zini vend. Jo, jo, eja! Afrohu.

No, no, come! Come along. Mundeni "ju te gjithë te uleni perpara, ka hapesire atje. Can you – you can all sit in front, there is space. Ejani " Mund te uleni te gjithë atje. Just come .... you can all sit there. duhet ti kenaq ata, me kuptoni, I have to keep them pleased, you see, sepse Une po jetoj ne Itali! because I am living in Italy! Thjesht ejani".

Just come on .... It's all right, so they might get a part of it. Just come in front, there. Or you can sit in the middle, doesn't matter. You can sit there wherever you are, yes, you can. Come forward, come forward, there's space here. So I was telling them about Shri Ganesha, that His essential power comes through His humility; and that we all have to be extremely humble, extremely humble, appreciating everything. Of course, you must make them hear My lecture – they have already taped it – so they will know what I am saying today. But now we can have the puja. May God bless you.

## 1992-0531, Shri Buddha Puja, The Search for the Absolute

View [online](#).

Shri Buddha Puja. Shudy Camps, near Cambridge (England). 31 May 1992.

Jemi mbledhur sot ketu te bejme Shri Buda Puja.

Nuk e di sa prej jush kane lexuar jeten e Budas dhe si se fundmi Ai arriti iluminizmi (shkelqimin) e Tij. Nuk e di sa prej jush ne vertete kane pare Budiste apo i kane takuar ata, qe e quajne veten Budiste. Si ne cdo religjon (besim) te gjithë prej tyre humben ne nje lloj fundamentalizmi, sepse asnje prej tyre nuk e mori realizimin. Prandaj secili prej tyre krijoi stilin e vet te besimit, madje, mund ta themi edhe Tao i Lao-Tse, apo Zeni i Vidditama, te gjithë ata jane nga frutat e njejtë. Ne duhet te kuptojme si Ai e ndjeu ne fillim ate duhet te kerkojme dicka pertej jetes. Pasi ne jemi te kenaqur me cdo gje qe kemi sepse Ai ishte djale mbreti, Ai kishte nje grua shume te mire, Ai kishte nje djale dhe natyrisht, cdokush ne ate pozite do te ishte mjaft i kenaqur. Por nje dite Ai pa nje burra shume te semure, Ai pa nje lypsar, dhe pa gjithashtu nje njeri te vdekur dhe te gjithë po qanin per ate person te vdekur. Ai s'mund te kuptonte si kishte ardhur ky mjerim dhe c'eshte nevoja te kete kaq mjerim. Keshtu Ai hoqi dore nga familja e Tij, Hoqi dore nga luksi i jetes se tij, Ai hoqi dore nga gjithcka, e shkoi te kerkoje te verteten, sic e kane bere shume prej jush. Mund edhe te dilte i humbur, do te thoja, sepse Ai lexoi te gjithë Upanishads, dhe lexoi gjithë librat e mundshem per te, qe ti tregonin cila ishte e verteta.

Por Ai s'mundi te marre asgje. Ai mori nje sanyasa te plote, ne kuptimin, per aq sa ushqimi ishte nje shqetesim, per aq sa argetimi ishte nje shqetesim, Ai hoqi dore prej gjithckaje. Dhe se fundmi, Ai ishte duke ndenjur nen nje peme banyan, dhe papritur Adishakti i dha Atij veterealizimin sepse Ai ishte aq i vertete dhe ishte nje nga te shenjuarit per nje vend te vecante ne Virata. Ai duhej ta arrinte kete. Sigurisht, s'kam nevoje tu tregoj per jetet e Tij te meparshme, ndoshta, ne kaq shume leksione te Miat tashme mund te kem folur per kete, cila ishte jeta e Tij e meparshme dhe si Ai arriti shkelqimin (iluminizmin) e Tij per Vetën e Tij. Por ajo qe duhet te kuptojme nga jeta e Tij ishte qe Ai zbuloi dhe kuptoi Ai zbuloi dhe gjeti se deshira ishte arsyeja e te gjitha mizorive. Por Ai nuk e dinte, cila ishte nevoja (deshira) e vertete? Cila ishte nevoja e paster? Cfare ishte deshira e paster? Dhe prandaj Ai s'mundi tu shpjegoje njerezve qe ata duhet te marrin zgjimin e tyre nepermjet kundalinit te tyre.

Meqe Ai kishte ndjekur nje nje jete asketike (te rrepte), ky u be kodi per Budistet. Kur isha ne Tajlande, dje, po lexoja per Budan dhe u habita qe bhikkus, kuptimi i bhikku ishte ne fakt ne Sanskritisht do te thote bhikshyus, ishte ai qe kerkon lemoshe, ose mund ta quani nje lypes "por lypes fetar." Pra, Ai mbante mijera njerez me Vete, minimumi e pakta njemije kembezbathur, pa asnje sigurim ushqimi, pa asnje rregullim qendrimi, asgje, dhe supozohet qe ata ta rruanin koken plotesisht, pa mustaqe, pa floke fare ne trup. Per me shume, supozohet te kishin vetem nje veshje. Veshje te gjate qe duhej ta lidhnin keshtu per te mbuluar veten, qofte kohe e ftohte ose e ngrohte, cfaredo stine te ishte. Nuk lejoheshin te kendonin ose te kercenin, apo te argetonin veten me asgje. Dhe ushqimi thjesht mblidhej nga fshati, cilido qe vizitohej, cfaredo qe merrnin, shume minimale. Cfaredo qe merrnin, gatuhej prej tyre dhe fillimisht ia ofronin guruse se tyre e pastaj e hanin. Imagjinoni mijera njerez qe shkojne keshtu, kembezbathur, ne zheg te vapes . ose ne balte, apo ne shi.

Ne te gjitha stinet ata ecnin, duke hequr dore nga te gjitha marrdheniet familjare. Edhe nese burri dhe gruaja te dy i bashkoheshin sanghas, atehere supozohet te mos jetonin si burra e grua. Pra, te heqesh dore nga te gjitha nevojat e tjera fizike, nevoja mendore, nevoja emocionale ishin rruget qe u perpoqen te ndiqnin, se Ai tha nevoja (deshira) e krijon. Por nese shihni Budistet, ata bejne i gjithë keto gjera. Do habiteni qe edhe nese ishte mbret, e ben kete. Dhe shume mbreter iu bashkuan ne ate kohe, nje prej tyre ishte Ashoka, nga India. Ai vishej ashtu, ai u be si ata, nisi te udhetoje ne te njejtën menyre dhe u perpoq te ndjeke nje jete teresisht aksetike (te rrepte). Ishte nje jete shume e veshtire dhe ata menduan se duke e bere kete, ata do te arrinin realizimin e tyre. Thuhet se dy nga dishepujt e Tij e arriten, emrat e tyre jane Moggallana dhe Sariputta. Keta te dy moren realizimin e tyre.

Por e gjithë kjo gje ishte absolutisht nje jete, e thate dhe pa shije, pa asnje kenaqesi ne te, nuk lejoheshin femijet, nuk lejohej jeta familjare. Keshte qe u be nje jete shume e izoluar, shume e ashpër, mund te them nje jete shume e thate. Edhe pse u quajt

sangha, do te thote kolektivitet; por ne kete kolektivitet nuk kishte nje raport te tille sepse supozohej qe nuk duhej te flisje shume, ata supozohej qe nuk duhej te diskutonin per asgje, te themi politike ose ekonomi ose ndonje gje. Ata mund te flisnin vetem per meditim, per arritjen e jetes me te larte. Pra mund ta imagjinoni cfare lloj jete duhej te ndiqnin per t'u bere te ndricuar (iluminuar). Dhe kjo ide vazhdoi ne kaq shume besime (religjione) vecanerisht, me pas filloi t'i beje njerezit te marrin parate nga kryefamiljaret (amvisat) duke ju thene se ju duhet te hiqni dore nga cdo gje. Sigurisht, edhe ne kohen e Budas, ata duhej te hiqnin dore nga gjithcka dhe ti bashkoheshin sangha-s, por ketu kishte nje perpjekje te mirefillte nga Buda per te marre ndricimin, per t'i bere ata njerez qe te kishin njohuri rreth realiteteve absolute. Por kjo nuk ndodhi, dhe kjo eshte arsyeja pse gjejmë qe Budistet kane shkuar ne tipe te ndryshme te Budizmit qesharak. Per shembull, tani kemi disa Budiste, themi ne Japoni, ku nuk lejohet te vritet asnje kafshe. Pra, ata thone "Ne rregull, ne nuk lejohemi te vrasim asnje kafshe por ne mund te hame kafshe te vrara."

kuptoni. Ata gjeten nje zgjidhje prej kesaj. Ata madje, ata mundet qe te vrasin qenie njerezore, sepse nuk lejohet te vriten kafshet, por ne mund te vrasim qeniet njerezore. Pra Japonezet behen mjeshtra ne vrasjen e qenieve njerezore, kuptoni. Mund ta shihni shume qarte se si njerezit gjejne hapesira. Me pas erdhi nje tip i dyte i Budizmit, kur ky Lao-Tse mesoi rreth Tao-s. Por ne fakt Tao eshte Ai ishte i pari qe filloi te flase rreth Kundalinit. Tao eshte Kundalini. Por, edhe kjo, ishte shume per keta njerez. Ata thjesht s'munden te kuptonin per cfare po fliste Ai. Por menyra qe Ai shprehu Vetën e Tij ne piktura, dhe gjerat e tjera, vetem per t'u devijuar (shmangur) nga ky lloj i ashper i Budizmit.

Por ne nje fare menyre, pavaresisht kesaj, kurre nuk mori rrenjet e duhura, dhe kam takuar njerez qe kane ndjekur Tao-n dhe ju nuk kuptoni absolutisht se si keta njerez po ndjekin rrugen e Kundalinit. Gjendet nje lume qe quhet Yangtze (Jance) me te cilin kur ju udhetoni, gjeni gjera te ndryshme. Pas cdo pese minutash, skena ndryshon, ose malet e bukura marrin nje forme tjeter, dhe keni shume ujevara, dhe kjo eshte shume interesante. Kjo eshte Kundalini. Tao eshte ky lume. Por thuhet se ju nuk duhet ta devijoni vemendjen tuaj ndaj ketyre tundimeve qe jane jashte. Mund ti shihni ato, po jo te mallengjeheni. Kjo eshte ajo qe Tao eshte, qe Ai solli, por ata humben sepse filluan te pikturojne gjithë keto gjera dhe duke bere gjithë llojet, me shume ne art. Ne thelb, Buda kurre nuk mendoi per ndonje art, Asnjehere s'deshi te kete ndonje art, dhe s'deshi te bente ndonje gje me artin, Ai tha, gjeja e vetmja eshte qe ju duhet te te shikoni dhe te futeni thelle brenda vetes, dhe te gjeni cila eshte e verteta absolute. Pra gjithcka filloi te devijojë keshtu.

Me pas ky sistemi Zen ishte njesoj, i ngaterruar me Kundalinin, te cilin Vidditama, nje nga dishepujt e Tij, e filloi ne Japoni. Tani, ne sistemin Zen ata zakonisht vendosin, ndonjehere edhe godasin, pjesen e prapme te "asaj qe ju e quani" palca kurrizore, ne chakra dhe perpiqen te ngrjne kundalinin, gjithë llojet e gjerave te tmerrshme. Ne sistemin Zen, ata zhvillojne metoda shume te ashpra per ngritjen e Kundalinit. Ka arritur ne nje pike te tille qe kam takuar njerez qe kane thyer palcen kurrizore, ndaj Kundalini nuk do te ngrihet kurre nese palca kurrizore " "ju lutem kini vemendjen ketu. Nje grua del dhe vemendje del me te. Dua te them, nese vemendja juaj eshte kaq e varfer... Ju lutem kijeni vemendjen ketu, e kuptoni kete? Nese del nje person, vemendja juaj s'duhet te ike dhe ju lutem mos ejani brenda te na shqetesoni. Shikoni, problemi eshte qe ne duhet te kuptojme qe vemendja jone duhet te jete e qendrueshme. Nese vemendja juaj leviz kur cdo grua del jashte atehere kuptoni qe ju duhet te meditoni me shume. Ju lutem kini vemendje.

Pra, kjo Vidditama Zen mori gjithashtu nje forme shume te ndryshme. U takova me kreun e sistemit Vidditama Zen, dhe u habita sepse "Ata me thirren Mua se ai ishte shume i semure, keshtu ata thane qe "Nene, te lutem ndihmoje ate te sherohet." Por kuptova qe ai nuk ishte aspak nje shpirt i realizuar dhe s'dinte asnje fjale rreth Kundalinit. Pra i thashe, "Si jeni kreu, (kryetari) si mundet qe jeni bere kryetari kur ju nuk dini kuptimin e Kundalinit?" Keshtu ai tha, "C'eshte Kundalini?" Ai s'mund te kuptonte asgje. I them, "Cfare eshte Zen?" Zen eshte te meditosh, dhyana. I them "Mire, por per cfare eshte?" "Po, po eshte."

Dua te them kaq konfuz ishte. Me pas e pyes, "Ju nuk jeni nje shpirt i realizuar, atehere si jeni kryetari?" Ai tha, "Ne kurre nuk kemi patur nje shpirt te realizuar tani per tani, e prej kohesh. Vetem per gjashte shekuj kemi patur disa kashayapas" i quanin ata kashayapas. Dhe pastaj nuk kemi patur fare shpirt te realizuar." Pra, mendoni, nen cfare rrethanash keni marre realizimin tuaj. Pa sakrifikuar asgje, pa hequr dore nga asgje, pa vene ne pune asnje nga keto tapasyas" pendesa. Sepse Buda eshte Tapa. Keto tre Hyjni ne Cakren tuaj Agnya: Krishti, Mahavira dhe Buda. Tre prej tyre jane Tapa.

Tapa do te thote pendese. Ju duhet te beni pendese; dhe pendese, tani ne Sahaja Yoga, s'do te thote qe duhet te hiqni dore nga

gruaja juaj a te hiqni dore nga burri, femijet tuaj, te hiqni dore nga familja juaj. Por ketu Tapa do te thote meditim. Dhe per meditim, duhet te dini kur te ngriheni (zgjoheni), kjo duhet te jete gjeja me e rendesishme per nje Sahaja Yogi. Pjesa tjeter e gjerave automatikisht do te funksionoj, dhe ju do te kuptoni. Per te rritur thellesine tuaj ju duhet te meditoni, eshte nje gje absolutisht e thjeshte. S'duhet te rruani koken tuaj, s'keni pse te mohoni veten ( vdisni urije), s'keni pse te ecni kembezbathur, ju mund te kendoni, mund te kerceni, Dua te them, mund ta argetoni veten me muzike. Atje, nuk lejohen as per te pare nje drame apo nje loje, ose gjithcka te tille. Dua te them, kaq shume gjera nese sheh listen, ju do cmendeshit, se si mund te ekzistojne njerezit? Por kishte mijera njerez me Te, qe udhetonin me Te qe u varferuan kaq shume, vishnin vetem recka.

Se fundmi, nje tregtar i madh po kalonte andej dhe i pa e mendoi, "Sa njerez te varfer jane, lypsare. Zoti e di nese jane lebroze apo cfare?" Dhe pati nje ndjenje te madhe per ta. U dha atyre pak ushqim per te ngrene dhe gjithcka dhe perseri nuk e dinte qe ishte Tagata" . do te thote ishte Buda qe po shkonte. Pra gjeja kryesore e Budes, vete Buda do te thote boddh, nga boddha, dhe boddh do te thote: te njohesh realitetin ne sistemin tend qendror nervor, kjo eshte boddha. Tani te gjithë ju jeni bere Buddhas, pa hequr dore nga asgje sepse nga cfaredo qe Ai hoqi dore ishte e pakuptimte. Ishte nje mit. Nese ishte nje mit, c'eshte dobia e te hequrit dore nga miti? C'rendesi ka nese degjoni muzike, c'rendesi ka nese kerceni, s'ka rendesi fare.

Por keto ide shkuan kaq thelle tek keta njerez sa vertet ju ndjeni per ta kaq meshire dhe dhembshuri shikojini, ku kane humbur ata? Nuk hane ushqimin e tyre, kane ushqim vetem nje here ne kohe po vdesin urie, duken vertet me keq se pacientet e TB. Ndersa ju njerez dukeni faqekuqe te vertete, te gjithë duke shijuar jeten per bukuri dhe cdo gje ne te. Por ende duhet te dini qe duhet te keni principin e Budes brenda jush. Dhe cili eshte principi i Budas, eshte qe ne duhet te bejme tapa. Tapa s'do te thote - nuk them - qe duhet te vdisni urije. Por nese keni shume interes ne ushqim, eshte me mire te beni pak agjerim. Kurre nuk kam thene qe nuk duhet ta shijoni muziken, kurre. Pa diskutim, ju duhet ta shijoni. Por duhet te shijoni ate muzike qe eshte per emancipimin tuaj.

per zgjimin tuaj, per ngritjen tuaj. Une nuk them mos bej, sepse tani vete ju jeni nje Buda. Budes nuk i thuhej asgje, Ai i thoshte cdokujt, por Atij nuk i thuhej. Ne te njeten menyre, mua s'me duhet t'ju them. Vetem duhet te kuptoni. Por ndonjehere detyrohemi (kufizohemi) nga kaq shume kushtezime sa e gjej shume te veshtire per njerezit te kuptojne cfare eshte shpirti. Shpirti eshte i pakufisem. Eshte nje shprehje e lire e dashurise se Zotit. Pra kur eshte fjala per shprehjen e lire te dashurise se Zotit, dhembshurise, dashurise, na duhet te kuptojme, a e bejme ne kete apo jo? Edhe tani ka shume kushtezime qe ende veprojne tek ne.

Per shembull, disa prej jush jane te tille qe "Une i perkas kesaj kombesie, asaj kombesie, Une jam ky, jam ai. Jemi shume krenare per kete. Nuk mund te perzihemi me njerezit e tjere, jemi shume te larte per njerezit e tjere." apo dicka e tille. Tashme ju jeni bere nje qenie universale. Pra, ju "si mund te keni keto lloj kufizimesh idiote qe prape jane mitike." Pra, duhet te shihni, pyesni veten dhe te kuptoni nese jeni duke patur si eshte pune me te, largojeni ate Gjithashtu me femijet tuaj, duhet te shihni, kuptoni, eshte shume e rendesishme si sillen, nese jane agresive apo si sillen. Eshte shume e rendesishme sepse edhe ata jane Budas, edhe ata jane shpirtra te realizuar. Por kane disa kushtezime te caktuara brenda tyre dhe sillen sipas ketyre kushtezimeve. Ne mund te shohim nje drite brenda nesh.

Ajo qe ndodh eshte qe ne fillojme te shohim cfare nuk shkon me ne dhe thjesht e braktisim ate. Por edhe kur e shihni kete, nese nuk e braktisni dot atehere duhet te dini qe keni nevojë per me shume fuqi. Prandaj duhet te mesoni si te ngreni Kundalinin tuaj, si te lidheni me fuqine Hyjnore gjithë kohes, qe ju te jeni ne vetedijen pa mendime dhe keshtu ju rriteni brenda vetes ne thellesi. Kushtezimin e gjej akoma shume te fshehur (pergjues) ka "IM dhe E IMJA" ende ne Sahaja Yogiste. Ashtu sic kam degjuar para kesaj ne lidhje me, te themi njerezit Angleze apo te gjithë Perendimoret, sepse une po u flas njerezve Perendimore ketu, qe nuk e cajne koken per familjet e tyre, grate dhe femijet e tyre, cdo tre dite po divorcohen apo kater dite po ia mbathin me nje burre tjeter a dicka e tille. Tani shoh qe ngjisin, si zamke. Gruaja behet shume e rendesishme, burri behet shume i rendesishem. Shtepia ime behet shume e rendesishme, femijet e mij behen shume te rendesishem, dhe nese ne fillim nuk ishin te interesuar per femije, tani behen te ngjitur pas femijeve si, si me zamke. Eshte e pamundur per ata t'ua thuash, shikoni femijet i perkasin Sanghas, kolektivitetit. Mos mendoni se ky eshte femija juaj.

Po filluat te mendoni keshtu, atehere ju kufizoni veten dhe i futeni problemeve. Edhe ne vendet e mencura duhet te them

problemet po zvogelohen shume. Gjithashtu ne, nuk duam te jemi raciste, E di qe njerezit i urrejne ata qe jane raciste, ata duan ta zhdukun racismin. Si ne Indi, kam pare qe Sahaja Yogistet duan qe i gjithë sistemi i kastës të hiqet. Sepse janë vete-shkaterruese. Pra ne fillojme të shohim brenda vetes çfarë është vete-shkaterruese. Çfarë do të më shkaterroje; më pas çfarë do të shkaterroje familjen time; pastaj çfarë do të shkaterroje vendin dhe gjithë botën? Gjithë keto ndermarrje që janë në vet-kundershtim me jetën tuaj konstruktive, filloni të shihni, shihni daljen tuaj nga shinat, shihni që po shkoni drejt shkaterrimit, dhe mund ta ndaloni këtë dhe kjo është shumë e rëndësishme. E mundur vete nëse ju perpiqeni pyesni brenda vetes suaj dhe të meditoni dhe të kuptoni, A e kam këtë çilesi? Disa prej tyre janë shumë krenare për temperamentet e caktuara, si "Une kështu jam, çfarë të bëjë Nene?"

Une kështu jam." Jo më. Tani të gjithë çilesitë tuaja të bukura janë zgjuar nga Kundalini juaj. Tregon se asgjë s'ishte e vdekur, asgjë s'ish e mbaruar, ishin të gjitha aty të paprekura dhe kur Kundalini filloi të ngrihet, ajo thjesht zgjoi gjithë keto çilesi të bukura. Përveç kësaj, në Guru Puja, do ju tregoj gjithë çfarë ka ndodhur. Sigurisht, ju mund ta keni parë në Sahasrara Puja, ju tregova për veten, se ajo që keni arritur, s'e keni idenë për fuqitë që keni marrë. Por në Guru Puja, patjetër që do t'ju tregoj cila është gjeja që është Sahaja Yoga. Është një nga gjerat më të çmuara që një qenie njerezore ka njohur, prej shumë kohësh. S'është vetëm të flasësh për Zotin, s'është vetëm të thuash që hyjnorja është brenda teje por efektiviteti i saj. Pra s'keni nevojë për shkencë, keni një problem, mire, jepini një bandhan, mbaroi.

Kaq e thjeshtë. Nëse doni ndonjë gjë, vetëm jepni bandhan, është e mbaruar. Doni të jepni realizim, ngrijeni atë. Ky kundalini është i ngritur. Çdo gjë që mund ta bëni me shkencë, e bëni me Sahaja Yoga. Në jemi edhe kompjutera. Ndonjëherë them dicka, ju thonë "Nene, si e dini Ju?" "Jam një kompjuter, pa dyshim." Them une. Por të gjithë ju jeni kompjutera, vetëm një gjë që duhet të zhvilloni thellësinë tuaj.

Tani jeni në linjat e duhura, pra s'kemi nevojë për këtë shkencë që mund të na shkaterroje të gjithëve. Çdo gjë mund të bëhet nepermjet Sahaja Yoga. Dhe kjo është ajo që do ju shpjegoj në Guru Puja" si beheni kaq të afte. Pra, ju lutem kini vet-vlerësim. Duhet të keni vet-vlerësim dhe kuptoni që ju jeni një Sahaja Yogi. Se pari dhe më kryesorja, ju jeni një Sahaja Yogi dhe si Sahaja Yogi, duhet të arrini atë gjendje ku ju beheni absolutisht të afte për të bërë çfarëdo që shkenca bën, çfarëdo që dikush mund të bëjë, kjo është siddhi e vertetë, do të thotë ju beheni një trupezim i të gjithë fuqive. Ka disa njerez që vijne e më thonë, "Nene, Në s'mund të hapim zemrat tona." Kur them s'e kam fjalën zemer të hapur të prerë (operacion). Por të "hapësh zemrën" do të thotë thjesht të shohësh çfarë nuk shkon me ju. S'mund të ndjeni dhembshuri?

Por kam parë njerez që kanë zemrën e hapur për një qen, ose një mace. Por ndonjëherë ata nuk kanë zemer të hapur për femijet e tyre. Tani si mund të mos keni zemer të hapur në Sahaja Yoga? Është vendi i parë ku ekziston shpirti dhe rrezaton dritën e tij dhe kur e rrezaton dritën, ai është vendi i parë ku ju shikoni jetën e një personi që është plot dashuri. Pra si ka mundësi, që ka një problem të tillë "Nuk mund të hap zemrën time." Kjo vjen për arsye se ju keni vetëm ego dhe jo vet-vlerësim. Pra, Buda është ai që është vrasesi i egos. Ai është vrasesi i egos. Sic mund ta keni parë, Ai është, Ai është duke levizuar në Pingala Nadin tuaj dhe vjen e pastaj vendoset në këtë anë, anën e majtë. Ai është ai që kontrollon egon tuaj, dhe si ka provuar Ai të kompesojë këtë anë të djathtë.

Para se gjithash, ju duhet të keni parë Budan e qeshur. Është shumë i shëndoshe, dhe një person që është i anës së djathtë është shumë i dobët (holle), nuk qesh kurrë, madje as nuk buzëqesh. Edhe nëse e gudulis, nuk mundet. Pra, e kanë shfaqur Budan si një person, që ka shumë femijet të ulur në stomakun e Tij, në gjithë trupin e Tij dhe kudo, Ai do jete duke qeshur. Pra, vetëm shihni si e kanë treguar kompesimin e Budës, të atij që është kontrolluesi i anës sonë të djathtë. Pra, si e kontrollon Ai anën e djathtë, thjesht qesh prej saj. Ai qesh me Vetën e Tij, Ai qesh me çdo gjë. Çdo gjë që shohin, për shembull, tani sic ka thënë Ai "Mos bëni drama." Në rregull. Une them "Ju shihni çdo dramë."

Por në të ju shikoni më ndergjegjen tuaj të ndricuar, mund të kuptoni budallallekun e saj dhe të shijoni budallallekun. Për shembull, kjo zonja Elizabeta që martuar tete here a dicka e tillë, nëntë, Nuk e di sa here ishte martuar, e humba llogarinë. Pra keta njerez budallenj shkuan atje, tre, kater mijë, imagjinoni me shumë se ju, duke ndenjur rrotull, dhe kishte helikoptere që dergonin parashuta, kuptoni poshtë, dhe të gjithë ishin kaq shumë të dashuruar dhe parashutistat binin neper peme, ndonjëherë mbi njerez. Dhe e gjitha ishte në gazete, pra një lajm i madh për keta Amerikane, ndaj duhet të shihni marrezinë e kësaj. Nëse mund të shihni marrezinë, në rregull atëherë. Por nëse beheni një nga ata spektatore dhe mendoni, "Oh, çfarë gjeje është kjo..."



cfare fati qe isha i afte te shihja kete grua, nje person kaq te pafat, te shkoje per muaj mjalti." Me pas kuptoni, kuptoni cdo gje, te themi tani qe shkova ne Rio dhe ata Me treguan menyren si po benin karnavalet. Zot i madh. U ndjeva sikur po vjell, ishte kaq e peshtire. Por nese eshte dicka idiote, mund te shihni thelbin e saj; nese eshte dicka humoristike, mund te shihni thelbin e saj.

Pra c'ka ndodh me ate vemendje, ju shihni thelbin e te teres, lidhur me realitetin, krahasuar me realitetin, eshte budallallek. Ne driten e realitetit, eshte budallallek. Mund te jete mitike, mund te jete e rreme, mund te jete hipokrite, gjithë llojet e gjerave qe nuk jane realiteti. Por nese je nje Sahaja Yogi, do te jesh i afte ta shohesh ate dhe ta shijosh. Kam pare femijet ta bejne kete shume kollaj dhe ta kuptojne deri ne nje moshe te caktuar, pastaj nuk e di se c'u ndodh atyre. Por, kur pata femijet e Mij, ata e kishin zakon te shihnin Ram Leela, (pjese teatrale marre nga "Ramayana" epike fetare Hindu) Ishin shume te vegjel dhe e studionin ate ne shkolle. Do shkonin ta shihnin cdo dite me sherbyesin tone. Gjithe sherbyesit do kishin nje Ram Leela dhe do shkonin ta shihnin dhe do ktheheshin e do Me tregonin gjithë argetimin. Ata thonin, "Sot Dashratha dhe gruaja e tij, patem nje luftim te tille dhe papritur zbuluam qe ishin te dy burra qe luftonin, kuptoni. Po luftonin njeri-tjetrin."

Dicka te tille, dhe e kishin zakon qe cdo here me tregonin lojen e saj. Por sherbetori Im tha, "Shikoni tek..." "femija" ata i quanin keshtu. "femijet" Shihni si po kenaqen. Gjithe kohes duke qeshur, ata po e shijonin kete Ram Leela ashtu si ne." E kuptoni ndryshimin? Ato vajza po qeshnin me anen qesharake te teres, ndersa ky djale po mendonte qe, ato vertet po argetoheshin me te dhe gjithcka. Pra kjo eshte te kuptuarit. E njejta gje kur ju shihni cili eshte reagimi juaj. Kjo varet prej chittas suaj, vemendjes suaj, qe eshte e ndricuar. dhe vemendja e ndricuar vepron ne nje menyre shume ndryshe nga nje vemendje budallaqe, apo nje vemendje konfuze apo nje vemendje qe eshte plot negativitet.

Pra, duhet te gjykoni si reagoni (veproni). Si, pashe nje djale qesharak punk qe vjen tek Une I them, "Pse te pelqen keshtu?| Ne Sahaja Yogi me thote, "Nene, s'duhet t'i flasesh keshtu." I them, "Pse?" "Kjo eshte feja e tij, ne fund te fundit duhet ta kuptoni." I them, "Vertet, kjo eshte feja e tij." Keshtu djali thote, "C'a problemi ka?" I them, "Gabimi eshte qe ti nuk ke identitet. Nuk ke vet-vleresim, prandaj provon te lyesh veten dhe perpiqesh te tregosh qe ti je ky apo ai, e qe nuk je. Pse nuk behesh ai qe je?" Me vone ky djale u be nje Sahaja Yogi.

. Kjo eshte ajo qe duhet te shohim qe duhet te pranojme ate qe jemi dhe ne jemi shpirti. Nese jemi shpirti, atehere duhet te jetojme dhe ta shijojme dhe te bejme cfaredo qe te jete e nevojshme. Por ka kater gjera qe Buda i ka thene shume bukur, qe te gjithë ju duhet te thoni cdo mengjes, mendoj, te kuptoni. which all of you should say every morning, I think, to understand. Ne fillim Ai thote, "Buddham sharanam gacchami." Dorezoi veten tek Buda. Do te thote, "Dorezoi veten tek vemendja ime e zgjuar, tek ndergjegjia ime e zgjuar." Buddham sharanam gacchami Eshte shume e rendesishme te dime qe Ai tha kete perseri e perseri. Me pas Ai tha, "Dhammam sharanam gacchami."

Qe eshte, "Dorezoi veten tek dharma ime." Dharma s'eshte ajo qe gjendet jashte, keto fe qe jane mitike dhe qe jane futur ne nje lloj te ri te perversiteteve. Por feja (besimi) brenda vetes sime, feja e lindur, Dorezoi veten ndaj saj, qe eshte e drejte. te cilen une e njoh shume mire qe jane gjerat e verteta brenda nesh, qe na jep te gjithëve sistemin e vlerave. Me pas gjeja e trete qe Ai tha, "Sangham sharanam gacchami." Dorezoi veten ndaj kolektivitetit. Duhet te takoheni. Po provoj me te miren me nivelin Tim te gjej pak vend ku ju te takoheni, qofte edhe per hir te nje pikniku apo dicka, te pakten nje here ne muaj. "Sangham sharanam gacchami", eshte shume e rendesishme se pastaj do te dish qe je pjese perberese e gjithësisë; qe mikrokozmosi eshte bere makrokozmos; qe je pjese perberese e Virates qe je bere i vetedijshem per te. Dhe keshtu rregullohen gjerat shume shpejt, keshtu e ndihmojme njeri-tjetrin.

Keshtu e zbulojme nje person qe eshte negativ; keshtu zbulojme ate qe nuk eshte. Zbulojme nje person qe eshte egoist, qe nuk eshte egoist. Keshtu zbulojme njerezit nuk jane fare Sahaja Yogis, e pretendojne te jene Sahaja Yogis, dhe thjesht heqim dore prej tyre, i kuptojme. Pa hyre ne kolektivitet, pa qene kolektive, nuk mund te kuptoni kurre vleren e kolektivitetit. Eshte kaq e mrekullueshme, ju jep kaq force, ju jep kaq kenaqesi, kaq gezim, ndaj ne Sahaja Yoga fillimisht duhet ti kushtoni rendesi kolektivitetit. Edhe nese supozojme se mungon dicka, nuk ka rendesi. Ju thjesht beheni kolektive. Ndersa vini ne kolektivitet, nuk duhet t'i kritikoni te tjeret; s'duhet te thirrni emrat e te tjereve. Mos gjeni gabime tek ta.

Por pyesni brenda vetes dhe te dini qe "Pse, kur te gjithë po kenaqen me veten e tyre, pse jam une ai qe ulem e perpiqem te gjej

gabime? Duhet te kete ndonje gabim me mua." Nese ju thjesht do i kushtoni vemendje vetes, per sa kohe qe ju shqetesojne defektet, pastaj jam e sigurte qe do te beheni edhe me kolektiv, then l'm sure you will become much more collective, pastaj kur filloni te shihni defektet tek njerezit e tjere. than when you start seeing the defects in other people. Dhe s'ka dobi. S'ka dobi te kuptosh. Supozojme, kam nje pike ne Sarin Tim, me mire ta pastroj. Por nese keni nje njolle ne sarin tuaj, c'dobi ka ta shohesh> Une s'mund ta pastroj. Ju duhet ta beni kete vete. Eshte nje gje e thjeshte, shume praktike dhe ky lloj praktikiteti... A mund te Me degjoni te gjithë?

Duhet te behet nje gje kaq praktike per te kuptuar qe Sahaja Yoga eshte me praktikja; eshte me praktikja sepse eshte realiteti absolut. Pra, me gjithë keto fuqi, me gjithë kete kuptuesmeri, me gjithë kete dashuri te dhembshur, duhet te jeni te sigurt per veten dhe te dini qe jeni gjate gjithë kohes te mbrojtur, te udhezuar, te perkujdesur, ushqyer, dhe te ndihmuar per t'u rritur prej kesaj Fuqie hyjnore, qe eshte gjithë-perhapese. Zoti ju bekoftë te gjithëve.

## 1993-0411, Easter Puja

View [online](#).

Easter Puja. Magliano Sabina, Rome (Italy), 11 April 1993.

Jemi mbledhur te gjithë ketu ne maje te ketij mali te bukur, per te festuar ringjalljen e Krishtit.

Eshte shume domethenese per Sahaja yogis te kuptojne ngjarjen e madhe te ringjalljes se Tij, me te cilen Ai tregoi qe shpirti nuk vdes. Ai ishte "Ai ishte Omkara, Ai ishte Logos (Krishti) dhe Ai ishte Shpirti, prandaj Ai mund te ecte mbi uje. Dhe ne gjithashtu kemi bere nje film ku kemi treguar se si Mooladhara, qe shfaq atomin e karbonit, aq qarte sa nese e shikoni nga e djathta ne te majte, do gjeni tamam nje swastika aty; dhe nga e majta ne te djathte do shihni Omkara. Por kur shihni nga poshte lart, ajo qe shihni eshte alfa dhe omega. Kjo provon pertej dyshimit qe Krishti, sic Ai tha, "Une jam Alfa dhe une jam Omega," tregon qarte se Ai ishte misherimi i Shri Ganesh. Eshte nje prove shkencore qe ne kemi tani, dhe keshtu mund t'u themi njerezve qe eshte nje fakt. Une nuk e di ne kohen e Krishtit nese kjo alfa dhe omega ishin te njohura per matematikanet, por patjeter per Ate kur Ai tha, "Une jam Alfa dhe Omega," Ai ishte nje misherim shume i mrekullueshem, dhe shume i rendesishem per ngritjen tone. Nese Ai nuk do te kishte ringjallur Vetën, ne s'mund te kishim arritur aspak ngritjen tone. Pra eshte nje kontribut i madh. Ringjallja e Krishtit eshte evidente tani ne jeten tone: cfare ishit me pare dhe cfare jeni ju sot.

Eshte nje ndryshim i tille, nje diference e tille, nje transformim i tille. Eshte sakrifica e Tij ne kryq dhe ringjallja e bukur e Tij ka krijuar nje menyre per te gjithë ne per t'u futur ne nje gjendje te re transformimi. Ne kete gjendje eshte nje histori e ndryshme per qeniet njerezore, dhe e ndryshme per Krishtin. Krishti ishte Vetja e tij ishte shenjteria, ishte pastertia. Pra ringjallja e Tij s'eshte asgje por nje ngjarje fizike, mund te themi, sepse Ai s'kishte nevojë per transformimin, Ai nuk kishte pse te kalonte nepermjet ndonje pastrimi. Por ajo qe ndodhi ne rastin e Tij ishte qe Ai u ringjall nga vdekja "simbolizon jeten e qenieve njerezore pa spiritualitet" eshte si vdekja; sepse ata bejne gjithcka pa kuptuar asgje ne lidhje me teresine, ne lidhje me realitetin, me te verteten absolute. Se fundi cfaredo qe ata te bejne i con drejt shkaterrimit te tyre. Madje edhe fete qe jane krijuar prej ketyre misherimeve te medha jane ne renie (degradim) absolute. Nuk do te gjeni asnje gjurme te jetes religjioze tek te gjithë ata njerez te cilet pretendojne se jane ata qe mund t'i shfaqin (manifestojne) keto misherime. Nese e shihni ne nje menyre me te thelle eshte edhe shume e dhimbshme.

qe ne emer te gjithë ketyre misherimeve te medha gjerat qe njerezit po bejne, aktivitetet qe ata ndermarrin eshte dicka e pamundur, sepse nuk kane frike nga Zoti. Ne emer te Zotit jane duke bere gjithë keto gjera te tmerrshme ne mbare boten. Sigurisht qe ketu, mund te thoni qe Kisha Katolike ka qene ekspozuar. Gjithkund njerezit po shohin qe jane ekspozuar gjithë keto gjera false . Por gjithë keto gjera false ata i kane perdorur nen petkun e Zotit, spiritualizmit dhe bukurise. Kjo eshte menyra me e mire per ta fshehur. Gjithë mizoria, gjithë dhuna, gjithë shemtia "keshtu kane funksionuar ata." Dhe ka shkuar ne nje gjendje te tille sa ju nuk mund te gjeni as edhe nje nuance. te vogel te jetes fetare ne mesin e ketyre njerezve. Si te gjithë hajdutet e botes, gjithë kriminelet e botes dhe gjithë intriguesit e botes ta kene marre persiper.

Kjo ndodh sepse ajo qe eshte shkuar ne te gjithë librat dhe te gjithë shkrimet e shenjta qe keni kerkuar per veten, nuk jane bere kurre. "Te duhet te njohesh veten" nuk eshte bere kurre. Sa here ka thene Krishti, "Njih vetveten." Ai gjithashtu tha "Ju do te lindni perseri" "keshtu menjehere ata moren nje certifikate, "Une linda perseri" dhe filluan te perfitonin me kete lloj certifikate. Por faktikisht ata nuk mendojne cfare mireqenie iu eshte dhene. Me e shumta ata mund te kene bere ca para, me e shumta ata mund te kene patur disa fuqi siperfaqesore; por s'eshte bere asgje, nese e shikon nga natyra e lindur. Mund te misherosh cmendurine e tyre, per menyren si e kane marre jeten e Krishtit apo jeten e ndonje tjetri shume fisnik dhe me nje sistem me te larte vlerash, dhe po bejne gjera te nje shkalle shume te ulet. Tani ne Sahaja Yoga ju keni transformuar veten tuaj. Do te thoja qe kundalini juaj e ka bere punen. Por ende diference mes Krishtit dhe jush eshte kjo, qe ju po vini nga ai ambient, nga ai stil jete, nga ajo menyre e te menduarit qe ishte per te gjithë shkaterrimin tuaj.

Nese shikoni gjithcka tani eshte per shkaterrimin tuaj. Prandaj kur ju dilni prej saj, perseri keto gjera te bejne me dhimbje koke (dehin), perseri ju ndikoheni prej tyre. Edhe kur ju po ngriheni lart e me lart, ju duket papritur sikur po terhiqeni poshte perseri ne

disa lloj situatash qesharake, ne disa lloj gjerash degraduese. Sigurisht, ndonjehere tronditeni me veten tuaj; ndonjehere e pranoni gjithë kete. Pra per nje Sahaja yogi eshte shume e rendesishme qe pasi ka ardhur tek realizimi duhet te behet shume introspektiv (te shohe brenda vetes). Ne vend te qe te shohe gjerat e keqija te tjereve, ai duhet te provoje te shohe c'eshte e keqe brenda vetes se tij. Eshte shume e rendesishme qe ju duhet te dini se sa larg po shkoni drejt spiritualizmit tuaj. Sepse Krishti nuk kishte nevojë per kete, Ai madje nuk kishte pse te bente introspektive per Vetën e Tij. Ai ishte dicka qe ishte përtëj cdokorrupsioni, dhe per Te ishte thjesht nje transformim fizik, ne kuptimin qe, meqe Ai vdiq atehere Ai ringjalli Vetën. Por per ne eshte shume ndryshe.

Ne tani jemi Sahaja yogis, por ne jemi qenie te zakonshme njerezore. Ne s'kemi drite brenda nesh. Tani drita vjen brenda nesh dhe ne shohim driten, me pas çfare behemi? Ne duhet te behemi vete drita. Krishti ishte drita. Ai nuk duhej te behej. Pra ne duhet te behemi drita. Dhe tani ju duhet te ruani menyren qe kjo drite mund te trazohet, mund te reduktohet, ose mund te shuhet plotesisht. Pra mbajeni veten me kete drite, gjeja e pare ju duhet te dini qe nese ju shihni driten, nuk eshte e duhura "do te thote qe ju s'jeni drita. Ju duhet te beheni drita.

Kur ju jeni drita, atehere ne kete drite ju mund te shihni lehtesisht si punon mendja juaj, çfare idesh ju jep, çfare ndikon tek mendja juaj ndersa ju po ngriheni. Eshte ky shqetesimi apo eshte kjo pergjegjesia qe keni? Ose eshte kjo prej zakoneve te keqija qe keni patur, qe ka nje pengese ne rritjen tuaj si nje personalitet shpirtor? Pra ju duhet te ruani veten gjate gjithë kohes, dhe te shihni veten se si po procedoni. Eshte nje udhetim shume i bukur "udhetim shume shume i bukur. Dje isha shume e lumtur te degjoja kengen e Ruseve qe pershkruanin udhetimin, udhetim i kundalinit. Kjo eshte e vertete, pa dyshim, qe ju jeni shpirta te realizuar. Parimisht ju nuk ishit nje shpirt i realizuar, por tani ju jeni nje shpirt i realizuar. Ju jeni nje gjendje e zhvilluar. Tani ajo çfare mungon eshte idea qe ne jemi plotesisht mire dhe asgje s'mund te na demtoje, te na perule.

Nese ju zhvilloni nje ide te tille egoistike, nuk ka per t'ju ndihmuar aspak. Ajo qe ju duhet te beni eshte te beni introspektive ndaj vetes gjithë kohes. Per kete eshte meditimi, te shihni per veten si po e mbani lart ngritjen tuaj shpirtore. Askush tjetër s'mund ta beje, eshte puna juaj individuale. Sigurisht, nese shkoni ne kolektivitet, menjehere ata do te dine cilat cakra kane ngerce, pa asnje dyshim. Ata mund te mos e thone, ata mund te mos i referohen, por patjetër qe do te dijne qe kjo e ajo cakra eshte infektuar dhe ky person ka kete problem. Por ata nuk do te dijne per veten e tyre cilat cakra kane ngerce, cili eshte problemi i tyre. Keshtu nese dikush ju thote qe "Mendoj se kjo cakra ka ngerce tek ty," ju kurre, kurre nuk duhet te ndiheni keq per kete, sepse duke e mbajtur kete cakra te paprekur (patrajtuar) ju jeni duke rrenuar jeten tuaj. Pra ajo çfare duhet te beni eshte te shihni qe nese dikush ju thote juve qe "Une mendoj qe eshte kjo cakra, ka dicka qe nuk shkon," ju duhet ta falenderoni kete person, "Fale Zotit, qe me treguat." Si pasqyra "nese shiheni ne pasqyre dhe ka dicka qe s'shkon ne fytyren tuaj, ju mund ta korrigjoni ate menjehere.

Ne te njejten menyre nese dikush konstaton kete tek ju, duhet te jesh mjaft i matur qe te dish se ky eshte nje bekim i madh qe nje gje e tille eshte nxjerre (konstatuar) tek ty. Si dje qe kishte nje grindje midis dy liderve. Gjithmone "ku ka dy lidere, gjithmone ka grindje. Nuk duhet te kete. Eshte tamam si dy sy qe nuk ndeshen kurre, dy duar s'ndeshen kurre, dy kembe nuk ndeshen. Por nese ka dy lidere, ka gjithmone nje problem. Duhet te keni gjithmone nje lider, perndryshe problem i madh. Keshtu ata po debatonin mes vetes, shikoni, dy lidere qe po debatonin mes tyre, dhe erdhen tek Une. E pashe menjehere qe njeri prej tyre ishte i prekur. I thashe, "Veri duart kundrejt Meje."

Kur e vuri doren drejt Meje, e terhoqi menjehere mbrapsht. "Çfare ndodhi?" Ai tha, "Kam nje ndjesi djegie, Nene." I them, "Kjo eshte. Tani do te dish cili eshte problemi me ty?" Ai tha, "Une jam gjaknxehte, kete e di. Une jam shume egoistik. Nuk duhej te isha sjelle keshtu." Por ne te njejten kohe ai mund te jete ndjere shume keq, per shkak se ia thashe. Por ai nuk u ndje sepse eshte nje Sahaja yogi dhe ai e di cila eshte e mira per te, çfare eshte mire per te.

Ai nuk u ndje aspak keq. Perkundrazi, ai ishte kaq mirenjohes ndaj Meje "Nene, fale teje une munda ta kuptoja. Perndryshe une po e fshihja brenda zemres sime." Tani, problemi me ne eshte qe ne kemi arritur mjaft zhvillim brenda vetes, dhe ne e kemi konsoliduar ate. Gjithashtu, ne kemi nje fuqi te madhe kolektive, Mund ta shoh, ne cdo vend. Ne mund tu japim realizim shume veteve, dhe ne vertet mund te formojme gjithë keto te verteta ne jeten tona. Ne mund ta bejme kete. Gjithë kohes ne duhet t'i stabilizojme ato. Por ka nje pike ne te cilen njeriu duhet te jete shume i sigurte: qe ju keni arritur absolutisht te verteten e fundit. Duhet te jeni shume te kujdesshem ne kete pike, shume.

Kam pare njerez qe shkojne shume lart ne Sahaja Yoga, ngjiten shume lart, dhe papritur shkojne shume poshte. Me trishton shume, ekstremisht te trishtuar. Arsyeya eshte se ata nuk kane besim "besim tek vetja dhe besim ne Sahaj." Ky eshte besimi qe mungon. Ju duhet te keni besim tek vetja dhe besim tek Sahaj. Sahaj do te thote qe ka (gjendet) Fuqia hyjnore, dhe e gjithë kjo Fuqi perhapese kujdeset per ne. Edhe tani ndihet, ju e ndjete kete. Nuk eshte se vetem duke e thene ajo eshte aty "e keni ditur qe eshte keshtu." Por vetem duke e ditur kete, nuk eshte bere besim brenda jush. Por ky eshte besimi per te cilin foli Krishti.

Ky eshte besim me nje mendje te ndritur, jo besim i verber. Dhe me te verberin ju mund te beni gabime, ndersa me te ndriturin (ndricuarin) ju keni besim ju beheni ekstremisht te fuqishem, ekstremisht te fuqishem. Nuk mund te kete probleme nese besimi juaj eshte i ndritur. Pra tani, ju shihni ne Sahaja Yoga shume njerez qe jane shume te qendrueshem, qe jane te drejte, qe jane shume te vlefshem. Ata jane si njerezit qe e dine se po qendrojne ne shkembinj. Por ata te cilet nuk jane ende te qendrueshem jane njerezit, qe mendojne se jane duke u tkurrur ne disa lloj ujrash qesharake te kesaj jete. Shkembijnjte kane qene aty, ju po qendroni mbi shkembinj; dhe kjo gjithashtu ka ardhur prej besimit se asgje s'mund te na shqetesojë, kete besim, askush nuk na e trazon. Deri sa Krishti eshte i shqetesuar, natyrisht. E kam fjalen, Ai di gjithcka, pra Ai ishte i sigurte per kete. Ai kurre s'u merzit, Ai kurre nuk u tkurr, Ai kurre nuk dyshoi.

E dinte qe, qe Ai ishte Djali i Zotit, dhe ky ishte nje fakt qe Ai e dinte mjaft mire. Dhe Ai kurre nuk e sfidoi kete, Ai kurre nuk e dyshoi, fare. Keshtu eshte. Dhe prandaj Ai, them ishte duke qendruar mbi shkembinj; ndersa njerezit e tjere, edhe Sahaja yogis, duhet te behen si Krishti per aq sa ka te beje me besimin. Ky besim duhet te jete i kuptuar. Ky eshte nje besim i ndritur. Si Krishti "Ai shkoi ne kryqezim, Ai u fut ne gjithe llojet e gjerave, thjesht sepse Ai e dinte se ishte vetem nje drame (loje) dhe Ai ishte duke bere kete si nje loje duke luajtur," dhe nuk ka asgje serioze, asgje nuk ka rendesi, , dhe ia do te ringjalle Vetën e Tij. Ai luajti pjesen. Per Ate nuk ishte fare serioze. Ai pa njerez ta vinin ne loje Ate, ta tallni Ate.

Ai gjithashtu ne zemren e Vet dinte gjithcka qe "Keta njerez te cilet po me tallin nuk e dijne se kush jam." Por ne te njejten kohe, Ai ishte trpezimi i besimit: besim ne Vetën e tij dhe ne kete Fuqi gjithë perhapese. Kjo asnjehere nuk ju mposht, por per kete ju duhet te keni besim absolut. Supozojme se kam dike tek i cili kam besim, natyrisht qe do i jap atij gjithë punen, Do i besoj gjithcka, Do i mbaj celsat me te ose parate me te. asnje dyshim ndaj nje personi te tille. Ne te njejten menyre nese ke besim "Besim ne veten tuaj, besim ne Sahaja Yoga kur jeni te stabilizuar" do te habiteni si do fillojne gjerat te funksionojne, si do te permiresohet jeta dhe do te qendroni ne kembe mbi shkembinj, keshtu do te ndiheni. Nuk do te keni dyshime, nuk do te keni probleme, semundje. Pra, kjo eshte nje lloj gjendjeje "vetem besim." Por tani kete besim, si e fitoni? Problemi eshte, si te fitoni (keni) kete besim?

Nuk ka kurs per te, nuk ka literature per te, nuk ka leksione per te. Por ka nje zgjim brenda jush qe do jua kerkoje kete "Kush jam Une" ky zgjim, "Cfare jam Une? Cfare kam arritur?" Kuptoni, kete do pyesni "Cfare eshte ajo qe kam arritur? Cfare kam marre prej Sahaja Yoga?" Do ju vijne gjithë keto pyetje. Por nese ju keni besim, jo te verber por te ndritur qe eshte formuar prej shume mrekullish ne jete, shume gjera ne jete; do kuptoni qe gjera te vogla, vogla kane qene mrekullira, gjera te vogla te vogla. Ka patur mrekullira edhe ne gjera te medha, ne kaq gjera qe nuk e keni pritur kurre te ndodhin. Pra tani e dini, e zgjidhur mjaft mire, qe ju jeni shume te mire ne Sahaja Yoga. Per shembull, filloi te bjere shi.

Gjysma juaj mund te merzitet per kete, pse po bie shi, por ata do e dijne qe gjendet nje cati shume e bukur, s'mund te ndodhe asgje. Le te bjere shi sa te doje. Dhe atehere do te keni besimin qe nuk do te bjere shi, nuk do te na beje qulle (lage). Ne te njejten menyre ky besim brenda nesh duhet te jete absolutisht solid, dhe kjo ju ben ekstremisht te forte dhe ju ben pergjegjes per ringjalljen e mijerave dhe mijera e mijera e mijera njerezve. Kjo lloj jete qe kemi "qe vetem nga stabilizimi (formimi) yne, nga mirekuptimi yne, nga vezhgimi yne qe kemi vendosur brenda vetes sone, ne qendrojme ne Sahaja Yoga "eshte dicka e mrekullueshme, por do duhej, duhet te ndodhe, po ndodh, dhe duhet t'u ndodhe te gjithë juve. Te gjithë duhet te keni fatin te njihni shpirtin tuaj dhe te njihni veten. Pra njeriu duhet te kete besim tek vetja. Shoh qe disa Sahaja yoginis vijne gjithmone e thone, "Nene, nuk jam mire, Jam e padobishme, nuk po punoj. "Une jam nje kokerr dembele," apo cfaredo qofte. Ne rregull, ju e mendoni keshtu "kerkoni" per te.

Cfare doni? Edhe nese nuk kerkoni do te funksionoje, edhe nese nuk kerkoni. Edhe sikur vetem te mendoni per te, do te funksionoje. Edhe nese do i kushtoni vemendje do te funksionoje, sepse kjo Fuqi gjithë-perhapese eshte e vetmja fuqi e vertete. gjithë pjesa tjeter e fuqive eshte e padobishme. Dhe eshte kaq efikase, kaq e dhembshur qe ne ndarjen e sekondes mund te rregulloje gjerat. Dje patem dike nga Australia, dhe ishte mashtruar nga dikush duke blere nje toke dhe nje shtepi me nje cmim shume te tepruar, per te cilen ai nuk kishte para. Dhe ky shoku tha, "Nuk ka rendesi edhe sikur te mos kesh para, s'ka problem." Ai i besoi atij "pati besim te gabuar", Mund te them, dhe me pas tha, "Ne rregull." Ai pagoi gjithë parate qe kishte, vetem per ta rezervuar.

Dikush shkoi atje, ishte nje puja keshtu qe shkuan shume atje. Kaq shume puja, dhe ndodhen gjera, dhe erdhen kaq shume njerëz te shihnin gjithë kete. Por ky shoku ishte kaq i shqetesuar, shume i shqetesuar, nuk mund ta kuptonte, "Pse me ndodhi mua qe te vihem ne nje situatë te tille te veshtire?" Ai ishte mashtruar dhe ishte, e kam fjalen, absolutisht i befasuar. Ai nuk e kish idene se si mund te dilte nga kjo rremuje. Ai kish futur aty te gjithë parate, ishte perfshire me gjithëcka, dhe nese nuk do i paguante parate mund te futej ne burg. Une thjesht i shkrova "Ki besim tek vetja." Kjo eshte e gjithë "Ki besim." Dhe cfare mrekullie ndodhi, qe dikush tjeter ofroi per te nje cmim shume me te larte. Dhe shoku i kish thene, "Sigurisht une do te paguaj cfaredo qe te kam premtuar.

Do te kthej parate, dhe me shume se me duhet te paguaja." Eshte dicka e pabesueshme. Shkuan kaq shume atje, shume donin te zgjidhnin problemin, bene kete, u takuan me shokun dhe i thane se nuk mund te paguanin. Asgje nuk funksionoi, asgje "vetem besimi i tij." Dhe mund ta imagjinosh, tani ai do te behet nje njeri i pasur. Supozohet qe te shkonte ne burg, tani do te behet nje njeri i pasur. Ka shume mrekullira per kete, ka ndodhur. Kjo eshte ana financiare e saj, por e di ju e dini qe po ndodhin kaq shume mrekulli te tjera. Pas realizimit nese nuk keni besim, kjo tregon, E kam fjalen, ju jeni nje personalitet shume i mjere. Pas realizimit te pakten duhet te merrni besim.

Kjo eshte vertet dicka per tu habitur qe njerezit marrin (arrijne) realizimin e tyre dhe gjithëcka, dhe perseri nuk kane besim ne veten e tyre. Ata qe kane patur, kane arritur vertet shume. Tani, diferenca midis Krishtit dhe neve eshte qe besimi ishte pjese perberese e qenies se Tij. S'ishte se Ai duhet te kishte besim "Ai ishte besimi." Tani ne duhet ta kemi ate. Ne duhet te besojme ne veten tone. Ka kaq shume incidente qe mund t'ju jap te cilet edhe ju mund te Mi tregoni, kaq shume incidente ku vetem besimi ka ndihmuar. Nese ishit ne Rumani, mendoj se ndodhi qe kur nje grua erdhi ne skene, nuk mund te ecte, iu desh ta sillnin ne nje karrige me rrota. Dhe ajo tha, "Nene une e di qe ju mund te me sheroni. Askush s'mund te me sheroje; Une e di qe ju mund te me sheroni."

E tha kete tre here. I them, "Pra, ti beson se une mund te sheroj." "PO." I them, "Atehere cohu." Ajo thjesht u ngrit, dhe iku. Dhe pastaj filloi te vraponte gjithë rruges, dhe te gjithë filluan te qeshin. Ata thane, "Nene, Nene ajo nuk eshte nje Sahaja yogini!" I them, "Por shihni besimin e saj!" Sepse kur ekziston besimi gjithë hyjnite te marrin persiper: ato sfidohen, u duhet ta bejne kete. Ato kane treguar besim ne kete person.

Sic ju kam thene gjithmone, ne Sahaja Yoga ne u besojme njerezve, u besojme. Nje nder neqind mund te na mashtroje s'ka rendesi, ne besojme. Besimi qe ti ke tek ky person punon edhe ne mendjen e tij, qe "ata kane kaq besim tek une." Por cfare rreth hyjnive? Tregoni besim ndaj tyre dhe do te funksionoje, menjehere do te funksionojne. Sic Me tregoi Guido qe "Nene, ata thane qe do te kete shi te dendur per keto dy dite." I them, "Mire. Mos u merzit." Ku eshte shiu? Eshte zhdukur.

Ju mund te kontrolloni gjithëcka nese besimi eshte nen kontroll. Dhe kur flasim per besim, e dini, eshte sfida ndaj kesaj Fuqi gjithë-perhapese, qe organizon, qe din gjithëcka. qe eshte kaq inteligjente, efikase "mbi te gjithë, ajo ju do." Dhe atehere ju tregon besim. Ringjallja ne Sahaja Yoga eshte qe besimi juaj eshte solid. Kete duhet te arrini: besim solid. Me pas ata nuk ndihen keq, supozoni Une mund te mos i takoj ata, supozoni une mund te them, "Mire, eja. Shiko, kete here mund te mos jem ketu." Nuk ka rendesi, shikoni, edhe nese Nena ju takon ose jo, nese kjo gje ndodh ose jo. Cdo gje eshte per te miren tone, per mireqenien tone.

Supozojme ju keni humbur rrugen, e dini qe kjo duhet te jete rruga. Nese do te shihni jeten e Krishtit, Ai ishte per tu kryqezuar. Ai duhet te mbante kryqin, Ai duhet te bente gjithë keto gjera "cdo gje eshte ne rregull," sidoqofte. "Eshte fatkeq. Une do ta bej kete."

Ai kurre nuk u ankua, nuk u qa, Ai nuk deshë t'i ndante problemet e Tij me askend. Por ky besim në Te i dha Atij forca aq të mëdha. Ai mund të kish bërë gjithçka. Ai mund t'i kishte vrarë gjithë ata njëzë që ishin duke u përpjekur ta përndiqnin atë, kollaj "C'dem ka? Vetëm një shikim mund t'i vriste ata.

Por jo, Ai e dinte Ai duhet ta kalonte gjithë këte, Ai e kaloi atë. Se fundmi, Ai është ai që është fitimtari, Ai është ai që fitoi gjithçka. Në të njëjtën mënyrë, një Sahaja yogi duhet të shohë jetën e tij. Është shumë e shtrenjtë, jeta, është shumë e shtrenjtë në këte bote. Keto dite, sa Sahaja Yogis ka? Në procesin zhvillues (evoluiv)? sa do të behen Sahaja yogis, Une s'mund ta them. Se pari shihni botën, më pas do filloni të ndjeni që shumë prej saj po shkatërrohet ose po mbaron, shumica e njerëzve nuk do të jenë më. Jo se në s'jemi të gatshëm, por sepse ata nuk janë të destinuar të vijne në Sahaja Yoga, s'është e thënë të vijne në Sahaja Yoga. Pra, ju jeni kaq fatlume që keni arritur realizimin tuaj, rilindjen tuaj.

Por tani keni besim në këte rilindjen tuaj, në rilindjen tuaj që është qenia juaj tani. Dhe më këte ju do të dini sa të cmuar jeni ju për këte bote, dhe ajo që ju duhet të bëni s'është të mendoni për fitimin material, fizik apo fitime emocionale, por fitime shpirtërore. Çfarë kemi bërë për spiritualitetin, tonin dhe të tjerëve? Kjo është e vetmja gjë që duhet të mendoni, dhe do të habiteni, çdo gjë është organizuar, gjithçka funksionon. çdo gjë në kohën e vet tregon rezultatet e saja. Tani unë jam e sigurtë të paktën tetëdhjetë përqind prej jush besojnë në atë që po them "themi mbase, nëntëdhjetë përqind." Por mund të këte rreth dhjetë përqind që ende mendojnë që "Në rregull, Nënë thote kështu. Por pse ndodhi më pas, pse ndodhi kjo?" Si dje kisha një gazetar, person mjaft i njohur, ai tha, "Une s'mund të besoj në Zot." E pyes, "Pse?"

"Sepse si mund të këte kaq shumë mjerim në këte bote? Si mund të këte një femijë të verber, si mundet kjo e si mundet ajo?" Pastaj filloi të më jepte Mua rastë. "Në rregull tani," I them, "Më ke treguar gjithçka?" "Po". I them, "Tani, supozojmë të themi që ju jeni ulur në mbreterinë (fushën) e kongresit të qeverisë, apo qeveria juaj e Andreottit apo sidoqë e quani. Pra situata është e sqarueshme; ju nuk keni hyrë ende në mbreterinë (fushën) e Zotit. Nëse shkon në atë gjendje, dhe nëse e arrini atë dhe nëse ju stabilizoheni, atëherë Me thoni, a keni ndonjë problem? Asnjë." Them, "Pse shkonin anën negative?"

Tani nëse ju thoni që ka një rrugë dalje dhe që ka një zgjidhje, dhe që mund të vijë një kohë kur kjo racë e Sahaja Yogis nuk do të këte sëmundje, jo shqetësime, asgjë, asnjë problem; pse nuk e shkonin këte? Pse doni të shihni një djale që është i verber? Por s'shikni që i verberi behet mirë?" Por këte lloj sjelljeje negative mund ta kenë edhe Sahaja yogis. I kam parë: dikush është i sëmurë, ata do thënë, "Nënë, ai është sëmurë, Duhet ta sjellë atë tek Ty. Duhet të shkonin atë. "S'është nevoja fare." Ju mund të sheroni, besimi juaj mund të sherojë. E dini dikush kishte xhaxhain sëmurë, e nuk ishte një Sahaja Yogi. Ai shkoi ta vizitonte atë, dhe gruaja e tij i thote që "Ti je i aftë t'i lutesh Nenes.

Pse nuk i thua Asaj të më bëjë mirë burrin?" Ai ishte një i sëmurë me kancer në shtratin e vdekjes. Ai tha, "Në rregull." Ai vetëm u përul dhe u lut, "Nënë, të lutem sherojë xhaxhain tim." Diten tjetër ai doli nga spitali, dhe tani është duke bërë ne të gjithë botën. Megjithatë ai s'ishte një Sahaja yogi, perseri funksionoi. Sepse tani një Sahaja yogi po thote që, hyjnitë duhet ta zgjidhin. Nëse ai nuk është një Sahaja yogi, nuk ka rëndësi. Janë hyjnitë që janë më të. Dhe ky duhet të besojë këte vete, plotësisht, që nëse këto fuqi janë më në, pse mos t'i përdorim ato?

Pse të mos e zhvillojmë këte besim të plotë që në jemi tani Sahaja yogis, në jemi në Mbretërinë e Zotit, dhe që kjo Fuqi do të kujdeset për ne? Pastaj nuk do të kemi zgjedhje, nuk do të kemi hezitime. Nuk do e vrasim mendjen, nëse duhet të shkojmë, të themi, në Singapor ose duhet të shkojmë në Afrikë apo të shkojmë kudo "Edhe çfarë? Në jemi ende në Mbretërinë e Zotit kudo që të shkojmë, është krejtësisht në rregull. Dhe asnjë lloj shqetësimi. Në jemi skllever të shumë gjerave, të hapave të, në jemi skllever të kushtëzimeve, e gjerave të tilla. Çdo gjë kalon. S'ka rëndësi. Çfarë ka rëndësi? Asgjë s'është e rëndësishme.

Për sa kohë ti je më veten tënde, çdo gjë është në rregull. Sic Me thone njëzë, "Nënë, Ju udhëtoni kaq shumë. Si e bëni ju këte?" U them, "Une nuk udhëtoj asnjëherë. Mëqë jam e ulur këtu në karrige, Une jam e ulur aty në karrige, kjo është e gjitha; vetëm karrigia ndryshon. Kurre nuk mendoj se po udhëtoj. E ulur për bukuri, vendosur në vendin Tim, Une jam shumë mirë, pra s'jam e lodhur." Pra kur keni besimin e plotë në veten tuaj, atëherë nuk e vrisni mendjen. Shumë njëzë do duan të dijnë se nëse "Une shkoj atje" do të këte apo nuk do të këte banjo, ose do të këte vend për të fjetur ose jo?" Asgjë.

Ju po shikoni per komfortin e shpirtit tuaj. Nese behet me se miri, perndryshe ju mund te flini kudo. Asgje nuk ju lidh, asgje nuk ju shemb, asnje zakon nuk ju kthehet; sepse besimi do ju pastroje teresisht, do ju ndricoje, do ju ushqeje. Ky besim nuk eshte dicka qe mund te futet ne kokat tuaja ose mund te futet ne zemrat tuaja, s'mund te jete. Eshte nje gjendje te cilen duhet ta arrini, dhe te cilen mund ta arrini nepermjet Sahaja Yoga. Keshtu mundet qe rilindja juaj te jete e plote, te jete e qendrueshme, te jete efektive, dhe te jete nje model per te gjithë boten. Zoti ju bekoftë te gjithëve.



## 1999-0318, Gudi Padwa puja, 1999

View [online](#).

Gudi Padwa, traduit du hindi, Noida, India, 18/03/1999 « Aujourd'hui, c'est le jour de Gudi Padwa [le jour de l'an du shak Shalivahana]. Et il est célébré principalement dans le Maharashtra, mais maintenant dans d'autres endroits aussi. On dit que c'est une journée très propice. Quel que soit le travail accompli ce jour-là, il sera fructueux. Mais quelle qu'en soit la raison, c'est selon les croyances ordinaires. L'autre chose, c'est que dans la dynastie de Shalivahana, il y a eu un roi: Babruvahan. Il a vaincu le roi Vikramaditya. Après cela, il a commencé ce nouveau calendrier appelé Shalivahana Shak. Selon ce calendrier, c'est aujourd'hui le premier jour de l'année. Son importance est majeure au Maharashtra. Pour représenter les Shalivahanas, ils prennent une Kumbha [et un bâton] sur lequel ils mettent un châle – voilà le symbole des Shalivahanas. La Kumbha représente la Kundalini. Ils attachent un châle [au bâton] et gardent une Kumbha au-dessus. Le sens, c'est que le Kumbha représente également la spiritualité. La spiritualité est représentée par la Kumbha. Les Shalivahanas avaient l'habitude de s'appeler les sept véhicules. Ils croyaient vraiment à la Kundalini. Plus tard, ils ont commencé à donner un châle à la Devi. Ils étaient des adorateurs des Devi, ils se sont donc appelés les Shalivahanas. C'est ainsi que le nom a été changé. Les Shalivahanas qui étaient là, venaient du Mewar. Ils étaient les dirigeants du Mewar de la dynastie Sisodia. Leur fils, de la dynastie Sisodia, pour une raison quelconque, a eu un différent avec son oncle. Ainsi, il s'est enfui [de Mewar] et est allé au Maharashtra puis à Chennai. C'est ainsi que cela s'est passé et c'est l'histoire des Shalivahanas. Même moi, j'appartiens à la dynastie Shalivahana. Il y a des milliers d'années, ils sont arrivés au Maharashtra. Nous sommes également des descendants de la dynastie Shalivahan, donc notre nom est devenu Salve de Shalv [ou Salva]. La personne Shalv, qui avait combattu Bhishma, vous devez avoir entendu parlé de Shalv et de Bhishma. Il a aidé plus tard les Pandavas. Bhishma l'avait maudit: il avait fait une cage autour de lui. À cause de la cage, il ne pouvait pas sortir. Alors, il a maudit Bhishma en disant: "Vous aussi vous serez pris au piège dans une cage". C'est arrivé à Bhishma à la fin. Il est également d'une grande dynastie, mais vieille de plusieurs milliers d'années. Elle a été relancée plus tard. Il y avait un sage là-bas qui a rêvé de Shivaji disant: Faites de Bappa Rawal le roi de cet endroit. De là, la renaissance de la dynastie Shalivahan a eu lieu. Je ne sais pas comment de Shalv, c'est devenu Shalivahan. La reine Padmini était également de la même dynastie. Les gens de la ville de Meerut sont allés là-bas et ont découvert que les gens étaient très fidèles à leur parole, justes, et qu'ils vénéraient la Devi. Ils disent que: "Vous ne pouvez même pas trouver ce type de personnes là-bas". C'étaient des gens très différents. Toutes leurs possessions ont été détruites car ils n'ont pas fait de compromis. Mais les gens de Jaipur ont fait des compromis - d'abord avec les musulmans puis avec les Anglais. Alors là, il y a eu de la prospérité. Il ne faut pas juger les gens en fonction de leur prospérité mais en fonction de leur caractère. Aujourd'hui, cette journée a été commencée par ces Shalivahanas, par Babruvahan. Ainsi, il a été fait un peu plus tôt qu'à l'époque du Christ, à l'époque de Vikramaditya. Même maintenant, les gens du Maharashtra y croient beaucoup. Ici [dans le Nord], c'est le Vikram Samvat [le calendrier Vikram]. Dans le Maharashtra, c'est le Shalivahana Shak. Même nous, probablement parce que Je suis du Maharashtra, nous suivons le calendrier de Shalivahan. Selon lui, aujourd'hui est un jour important et tout ce que vous désirez sera réalisé. Plein de bénédictions à vous tous. »

## 2002-0317, Mahashivaratri Puja 2002

View [online](#).

Puxha e Shivaratrit, Pune, 17 Mars 2002

Sonte jemi mbledhur këtu për të bërë Puxhan e Shri Shivës. Vetëm ata që kanë zemër të pastër mund të bëjnë Puxhan e Shri Shivës. Ata me zemra të papastra nuk mund ta bëjnë Puxhan e Shivës. Është një parim i thjeshtë i Shri Shivaratrit. Siç e patë dje, ne kemi gjarpërinj, këta janë gjarpërinj të tmershëm që shoqërojnë Shiva Lingan. Domethënia është kjo: "Ata që kanë zemër të pastër, që janë plot me dashuri për të tjerët, janë gjithmonë të mbrojtur nga fuqia e Shivas, që janë gjarpërinjtë. Është diçka simbolike, shumë simbolike. Por duhet të them se kafshët e kuptojnë

forcën Hyjnore shumë më mirë se qeniet njerëzore, shumë më mirë. Sepse ato kanë një zemër të pastër. Cilido qoftë stili i tyre i jetesës i dhënë nga natyra, 21 ata e respektojnë. Por nuk ka ligësi, nuk ka xhelozë. Nuk janë gjithë këto gjëra të këqija në zemrat e tyre. Ata e bëjnë sepse ashtu duhet të jetë. Por veçoria e qenieve njerëzore është vetëm një kjo është se sa ata dashurojnë dhe falin. Mundësia për të dhënë dashuri e qenieve njerëzore është e atillë që i mposht të gjitha forcat

negative. Ata mund të shohin qartë se nuk është mirë të kesh gjithë këto veçori, ose ndoshta e kuptojnë se nuk është fisnike të kënaqesh me gjithë ato sjellje jo të njerëzishme. Ata nuk do të jepeshin pas këtyre gjërave. As nuk ua kërkon njeri, por papritur ata tundohen nga gjëra të tilla që kanë brenda urrejtje, lakmi e xhelozë. Shikoni se si jeton Shiva! Ai jeton në Himalaja.

Shikoni çfarë rrobash vesh, çfarë ha. Ai nuk ka nevojë për asgjë sepse Ai është i plotësuar, është i përsosur. Të tillë personalitet ka Shiva. Dhe nëse ju e adhuronit Atë. Duhet të zbuloni brenda zemrës suaj se çfarë lloj ndjenjash keni, çfarë ligësie keni. Në ditët tona në Indi, lakmia është në kulm. Njerëzit janë bërë shumë të poshtë e të ulët. Nuk arrij ta kuptoj dot se si mendojnë që paraja është gjithçka, gjë që nuk është aspak në kulturën Indiane. Në asnjë mënyrë! Por ata e kanë marrë këtë sëmundje në vende të huaja ndoshta dhe po përhapet shumë tani, që paraja është gjëja më e rëndësishme. Sillni në mend Shivën! Ai kurrë nuk mendoi për para. Ai kurrë nuk desh para. Ai kurrë nuk desh të mburrej. Ka një diferencë midis Shivës dhe Shaktit në gjithë qëndrimet e tyre. Sepse Shiva është një personalitet totalisht i çliruar Ai nuk mund të shqetësohet. Nëse dikush jepet pas gjërave të gabuara Ai e shkatërron dhe kaq. Ai nuk dëshiron të shërojë,

Ai nuk dëshiron të përmirësojë, asgjë të këtillë. Por për Shaktin kjo është e rëndësishme, sepse ky është fëmija i saj, ky univers është fëmija i saj. E gjithë kjo është krijuar prej saj. Pra natyrisht që Ajo shqetësohet dhe nuk i do njerëzit që jepen pas gjërave të këqija e të kota. Para së gjithash njerëzit nisën të rëndin pas fuqisë. Lëviznin nga një vend në tjetrin për të fuqizuar veten. Ku shkoi ajo fuqi? Mbaroi. Dhe ajo që ndodhi pas kësaj ishte se ata ua kaluan edhe të tjerëve

kulturën e tyre, dhe tani është shumë e zakonshme të shohësh njerëz paturpësisht lakmitarë. Zgjidhja për ta është Shiva. Gjithë këta do të shkatërrohen. Në fillim ata do të ekspozohen e më pas do të shkatërrohen. Nga i pari tek i fundit. Diçka tjetër është se Shiva respekton ata që kanë karakter të mirë, ata që kanë karakter të mirë. Dhe nëse dikush ka një karakter të keq ose jepet pas gjërave të këqija, Shiva nuk do ta kursejë. Pra, Shakti i krijon, i mbron, kujdeset, i rrit. Por Shiva qëndron aty vetëm për të shkatërruar. Ky shkatërrim është shumë i rëndësishëm, shumë i rëndësishëm. Shakti nuk tregon cilësi të tilla. Ajo mund të shkatërrojë disa rakshasa, por Ai mund të shkatërrojë kombe pas kombesh. Para së gjithash kush do ta shkatërrojë egon tuaj?

Përsëri Shiva. Shiva është në Sahasraran tuaj. Ai qëndron në Sahasrara; mbi gjithçka. Dje pashë një zotëri, një gazetar që transmetonte, që ishte shumë, shumë idiot dhe po fliste shumë ashpër. Dhe pashë Ekadasha Rudrën e tij. Thashë "O Zot, ky do të ketë probleme" Ekadasha janë 11 fuqitë e Shivës Ato krijohen këtu dhe ju sjellin gjithë llojet e sëmundjeve. Dhe më e keqja është kanceri. Dhe unë e kuptova që ky njeri do të kishte shumë probleme. Ai nuk është një Jogist Sahaxha, si mund t'ia shpjegoj? Si mund t'ia shpjegojë dikush? Por kjo vjen nga Ekadasha Rudra. Këto janë 11 fuqitë e Shivës, të përshkruara mjaft mirë. Këto fuqi nisin të veprojnë tek njerëzit, edhe tek jogistët Sahaxha, nëse nuk i ndjekin parimet e Sahaxha Jogës Më duhet të them se Ai sheh gjithçka. Ai sheh çdo pjesë të jetës sonë. Se si sillemi, çfarë bëjmë, cila është dharma jonë, Ai i sheh të gjitha. Dhe shumë shenjtëri ju kanë paralajmëruar, shumë mishërime ju kanë paralajmëruar, dhe unë ju them se nëse nuk i dëgjoni ata, Shiva nuk do

t'ju dëgjojë. Ai nuk dëgjon askënd. Nëse është i zëmëruar nuk mund të zbutet. Është jashtëzakonisht e vështirë të bindet nga lutjet për falje. Por cilësia e tij kryesore është falja. Cilësia e tij kryesore është falja.

Por nëse ai nuk fal, atëherë ke marrë fund. Deri në njëfarë shkalle edhe mund të falë, por përtej kësaj... është një situatë shumë, shumë e vështirë. Dhe unë shoh se njerëzit nuk e kuptojnë se çfarë është Shiva. Në jug ne kemi dy lloje adhuruesish. 1) Shaivaitët dhe 2) Vaishnavaitët. Ata kanë një përplasje të madhe midis tyre. Tani më pak se më parë, shumë më pak. Detyra e Vishnu-së është t'ju japë realizimin, çlirimin dhe zhvillimin e qenieve njerëzore. Por nëse dështoni në virtyt, në dharman tuaj atëherë Shiva vjen në jetën tuaj.

Duhet ta kuptojmë që jemi të gjithë të rrethuar nga fuqitë e tyre që jemi të gjithë të përbërë nga fuqitë e tyre. Është Shakti që ju mbron. Por deri në njëfarë mase. Ajo nuk mund të dalë mbi Shivën nuk mund ta pengojë Atë. Në ditët e sotme ka kaq shumë njerëz të dhënë pas politikës, Nëse përpiqen të bëjnë para' kjo nuk është politikë. Ata nuk i bëjnë asnjë të mirë popullit, as prej frikës e as prej braktisjes. Ata sillen si të mos kenë aspak frikë nga Zoti, Ata nuk kanë frikë se Ai po i vëzhgon. Ndoshta ata nuk e dinë që janë nën vëzhgimin e Shivës. Ai vëzhgon secilin nga ne pavarësisht nëse jemi Australianë, Anglezë apo Indianë.

Cilëndo fe që ndjekim ne Ai na vëzhgon. Këtë duhet ta kuptoni patjetër. Dhe pasi ta keni kuptuar këtë, do ta pranoni që duhet të jeni njerëz të mirë dhe dharmikë. Duhet të jeni njerëz me karakter të mirë. Pse flasim njerëzit për karakterin e mirë? Përpiquni ta kuptoni ! Është budallallëk që njerëzit sot nuk besojnë në të. Njerëzit po bëjnë gjithfarë gjërash. Po dehen me alkool e po luajnë bixhoz. Të gjitha po i bëjnë pa patur aspak frikë nga zemërimi i Zotit. Dhe ai zemërim vjen nga Shiva. Do të doja t'ju paralajmëroja të gjithëve, sepse jeni të gjithë fëmijët e mi: "Kini kujdes!"

Përpiquni të peshoni çdo hap që hidhni. Patjetër që unë jam këtu për t'ju ndihmuar, për t'ju mbështetur e për t'ju mbrojtur. Por jo mbi Shivën, Unë nuk mund të dal mbi Të. Shiva ka një fuqi të madhe, ka një autoritet të madh. Dhe të adhurosh Atë do të thotë të adhurosh virtytin. Virtyti mund të jetë dhëshuria, mund të jetë dashuria, mund të jetë falja, gjithçka. Ai pëlqen vetëm njerëzit e mirë. Dhe do të mbrojë vetëm njerëzit e mirë. Për shembull disa njerëz janë shumë të dhënë pas pushtetit, disa janë të dhënë pas parasë e disa të dhënë pas pushtetit. Dhe ata që duan pushtet shpesh e bëjnë këtë për para. Ky është qëllimi. Ata nuk do të qëndrojnë në Sahaxha. Ata do të largohen. Bëjnë kështu, e më pas vijnë të kërkojnë falje, "Oh Nënë, na fal! Ne e bëmë këtë."

Por përpiquni të mos bëni gjëra të tilla. Unë sigurisht që ju fal, por Shiva nuk do t'ju falë, nuk do t'ju falë. Ai do t'ju ndëshkojë dhe atëherë ju do të vini tek unë duke thënë: "Nënë, duhet të na shpëtosh!". Është shumë e vështirë. Nga kthetrat e tij është shumë e vështirë. Ai është një falës i madh. Ai ju fal shumë gjëra. Edhe për shkakun tim ai fal. Por kur vendos Ai nuk ka më lutje, nuk ka më shpëtim. Nuk dua t'ju tremb, por duhet t'ju them të vërtetën dhe kjo është e vërteta. Duhet të përpiqeni të jeni njerëz të mirë. Duhet të përpiqeni të jeni vërtet njerëz me karakter të mirë.

Më kanë thënë se ca njerëz që janë në Sahaxha Joga merren me pastrim parash etj. Disa nga ata kanë edhe veçori të tjera negative, bredhin pas femrave dhe plot gjëra të tjera. Veçanërisht kjo e ka prishur perëndimin. Edhe Indianët tanë po mësojnë nga këto gjëra. Pra ne duhet ta respektojmë veten. Nëse nuk e respektojmë veten dhe sillemi keq, unë mund t'ju ndihmoj vetëm me Kundalini-n tuaj. Por nëse e teproni shumë pa dyshim që Ekadasha Rudra do t'ju pengojë. Është një pengesë e madhe në ballin tuaj.

Eka-dasha Rudra, dhe është kaq e vërtetë këto ditë, kaq aktive. Gjithë këto sëmundje që po dalin sot, dhe janë të pashërueshme, janë për shkak të Ekadasha-s. Dhe gjithë ata që vuajnë nga posedimi i demonëve. Një ditë takova dikë që e kishin mbërthyer keq. Dhe Ekadasha po vepronte. Zbulova se ai ishte i influencuar me fanatizëm nga diçka. Nuk dua ta përmend këtu,

por këto ishin gjëra të gabuara. Në çdo fe ka njerëz që përhapin ide të pavërteta. Nëse nuk jeni të matur askush nuk mund t'ju ndihmojë. Duhet të keni shumë maturi për të gjykuar të drejtën nga e gabuara. Atëherë Shiva është me ju. Por nëse merreni me ato gjëra të pakuptimta, kjo është vetë-shkatëruese. Dhe ky shkatërim ndodh me fuqinë e Shivës. Ajo që këtu e quajmë Vete është forca e Shivës. Ai shkatëron në shumë mënyra, në shumë mënyra. Mund të humbisni respektin e njerëzve, mund të humbisni shëndetin, mund të humbisni pasurinë, gjithçka mund t'ju ndodhë, derisa të mbaroni krejtësisht e të ...? Kam njohur njerëz që edhe në shtratin e vdekjes të flisnin për para. "Çfarë do të marrë ajo, para?". "Si do t'i marrë ai paratë?", etj, etj. Në vend

që të flisnin për Zotin, për realizimin e Vetes, ata flasin për para. Kjo nuk është fisnike. Por nëse shikoni Shivën, Ai nuk posedon asgjë. Ai nuk dëshiron të ketë asgjë. Çfarëdo që i jepni Atij, për shembull një samarpana, etj. Ai nuk e pranon, dhe ia kalon Shaktit, duke i thënë "Bëj ç'të duash me të!" Është ajo që përpunon gjithçka në dobinë tuaj, për t'ju kënaqur ju. Ai nuk shqetësohet. Në këtë rast duhet ta kënaqni Shivën. Ai nuk do të përpiqet t'ju kënaqë ju, ju duhet të bëni të pamundurën ta kënaqni Atë. Shiva ka një personalitet shumë të vështirë.

Në Kuran nuk shkruhet veçan për Allahun apo për Shivën, nuk bëhet dallim. Sepse njerëzit me të cilët Ai duhet të merrej ishin të gjithë të pashkolluar, injorantë. Pra Ai nuk i dha të gjitha detajet që Zoti është në forma të ndryshme. Pra ata dinë se ka vetëm një Allah. Por ata nuk bëjnë asgjë për të treguar dallimet e funksioneve të tyre, është Shakti ajo që jep dashuri, e pranoj. Por edhe Ajo mund të zemërohet shumë. Dhe kur Ajo zemërohet nuk ka të ndalur. Tani duhet t'ju them, si jogistë Sahaxha, që duhet të zhvilloni cilësitë për të kënaqur Shivën. Ka shumë dëshira, shumë lakmi. Asgjë nga këto nuk është e nevojshme. Sigurisht që unë dua që ju të jetoni mirë e bukur, jo të jetoni nëpër xhungla si budallenj, apo të jetoni si hippy, nuk është puna aty. Puna është se lidhja me gjërat materiale duhet të largohet nga zemra juaj. Ata që janë Shiva Bakhti nuk duan t'ia dinë për paratë, nuk marrin vesh nga paratë. Janë njerëz shumë bujarë, ekstremisht. Janë thjesht bujarë. Njerëzit thonë për ta se janë budallenj për këtë arsye. Por unë nuk mendoj ashtu. Në asnjë mënyrë nuk mund të përshkruhen ashtu.

Ata njerëz që janë bhakta të Shivës nuk kanë interes për paratë, janë shumë bujarë. Gjithçka që ju u kërkoni, ata jua japin. Mahavira ishte i tillë. Mahavira kishte shkuar në kopshtin e tij për meditim dhe Vishnu, si Shri Krishna, erdhi dhe i foli kështu: "Më shiko, unë nuk kam rroba. Ti paske gjithë këtë rrobë, pse nuk ma jep gjysmën mua?" Ai tha "Në rregull, merre ti të gjithën! Por ai tha më pas "Unë këtu banoj, tani do të shkoj të vesh diçka tjetër" Ajo që ai bëri nuk ishte për të treguar se lakuriqësia është diçka e mirë. Por nëse shihni Jain-ët, çfarë bëjnë ata? Bëjnë statuja të mëdha të Mahavirës duke e treguar Atë krejt lakuriq. Dua të them se ky është shtrembërimi i mendjes njerëzore. Ne duhet ta dimë se pse e bëri Ai këtë. Ai ishte kaq i çliruar sa mund të falte edhe rrobat e trupit. Ku është e keqja këtu? Nuk e bëri për t'u mburrur apo diçka tjetër. Por bujarinë njerëzit nuk e kuptojnë. Dhe Jain-ët janë më pak bujarët. Pra cilësitë e gjithë këtyre mishërimeve të mëdha nuk janë kuptuar. Sepse ekziston një lloj iluzioni. Për shembull Shiva është gjithmonë me fare pak rroba, fare pak. Po çfarë ha Ai? Askush nuk e di.

Çfarë pëlqen e çfarë dëshiron Ai? Askush nuk e di. Një këngëtar i zoti mund të këndojë përpara Tij. Shumë mirë bën. Edhe një i çmendur mund të vijë të këndojë. Shumë mirë bën. Për Atë nuk ka rëndësi, nuk është i interesuar se si është muzika, çfarë notash ka, nëse është e bukur apo jo. Aspak. Ai është përtej gjithë këtyre. Ai është përtej gjithë formaliteteve që kemi ne për gjithçka, Ai është përtej. Ai është vetë spiritualiteti, Ai është përtej gjithë këtyre. Nuk ka rëndësi nëse je një muzikant apo jo, çfarëdo që të jesh Ai do të kënaqet. Ai do të kënaqet me gjithçka që është e thjeshtë, që jepet me gjithë zemër. Do të kënaqet. Ai do të kënaqet me gjithçka që shprehet me zemër. Ai nuk ka pretendime, se duhet të jetë moderne, se duhet të jetë kështu apo ashtu. Ai nuk ka pretendime. Ai nuk mendon si njerëzit që duan t'i bëjnë gjërat të përpikta, nëse përshtaten apo jo. Edhe për artin edhe për gjithçka që krijohet prej zemrës së dikujt, ata përpiqen ta dekurajojnë këtë njeri. Kam parë njerëz që janë kaq pedantë. Por Shiva nuk ka të tilla pretendime për asgjë. Prandaj edhe e quajnë mast-maulaa, sepse ai nuk ka fare pretendime. Nëse ju keni pretendime nuk mund të jeni një Shivabhakta. Dakord, duhet të visheni mirë, duhet të bëni këtë... por nuk duhet të mendoni se nëse nuk e bëni do të jeni jashtë mode, jashtë kësaj apo asaj, është shumë e vështirë për njerëzit të refuzojnë. Gjithë llojet e modërave po vijnë në ditët e sotme. U them "Ç'është kjo?" "Oh, kështu është moda." "A ka ndonjë Zot pas kësaj mode? A ka ndonjë hyjni që jua këshillon këto modëra?" Sot vjen e nesër do të zhduket. Pra ajo që po them është se nëse duhet të adhuron Shivan, duhet ta çlironi veten tuaj nga këto pretendime.

Ju po jetoni në botën e Sahasararës. Tani, dikush nuk është veshur siç duhet - I pavlerë. Dikush i ka rrobat shumë të zakonshme - I pavlerë. Qeniet njerëzore janë të afta të kritikojnë gjithkënd. Jo se kjo është gjithmonë e keqe, sepse nëse e bëni me vibrime tjetri mund ta pranojë. Por pa vibrime, vetëm se kjo nuk është në modë, se ajo nuk është në modë?! Më thoni, cila është moda e Shivës? A ndjek ai ndonjë modë? Çfarëdo që ju i jepni Ai kënaqet. Çfarëdo që ju i jepni Ai e ha. Ai vlerëson kaq shumë sepse Ai është personifikimi i gëzimit. Ai është paqe dhe gëzim. Nëse jeni adhurues të Shivës nuk duhet të keni asnjë lloj pretendimi. Unë zakonisht vesh një saris të thjeshtë, shumë të thjeshtë. Dhe ndodh që njerëzit mendojnë se jam një grua shumë e varfër. Unë jam e varfër, sepse nuk bëhem merak për paratë, nuk më interesojnë fare ato. Duhet ta dimë se Shiva është njeriu më i varfër, por Zoti më i pastër.

Ai nuk vesh alankara, Ai nuk vesh asgjë, por jeton vetëm me trupin e tij. Sepse ai është vetë mishërimi i gëzimit e kënaqësisë. Asgjë përveç formës së plotë të gëzimit e kënaqësisë. Pra një tjetër cilësi e një Shivabhakta duhet të jetë gëzimi. Duhet të gëzoheni për gjithçka, çfarëdo që shikoni, çfarëdolloj njeriu të keni përballë. Dhe mënyra e vetme për ta bërë këtë është të hiqni dorë nga tipari njerëzor i të kritikuarit, i të kritikuarit të të tjerëve. Për shembull, hyn një Anglez në një shtëpi Indiane dhe thotë "Nuk më pëlqen kjo." "Çfarë nuk të pëlqen?" "Nuk më pëlqeu tapeti." Shprehja "Nuk më pëlqen" është kundër Shaktit tuaj. Pastaj një Amerikan hyn në një shtëpi Angleze dhe thotë "Nuk më pëlqen". Kjo ndodh shumë shpesh. Të gjithë thonë "Nuk më pëlqen kjo." "Nuk më pëlqen ajo". Po kush je ti që të thuash "Kjo më pëlqen e kjo nuk më pëlqen"? Njerëzit nuk e kuptojnë që duke thënë gjithë këto gjëra tregojnë se nuk kanë parimet e Shivës brenda vetes. Unë e kuptoj dikë që nuk mund të ecë dhe përdor shkop për ta lehtësuar ecjen. Por nëse ai thotë "Nuk më pëlqen ai njeri sepse nuk mban shkop." Ai tregon se është një njeri shumë egoist. Meqë ai vetë përdor shkop kërkon t'u imponojë të tjerëve në një vend demokratik të ecin edhe ata me shkopinj në duar. Kjo është absurde. Në përdim është shumë e zakonshme të mbash këtë lloj kapeleje, të veshësh këtë lloj fustani, këto lloj pantallonash. Për gjithçka ka kushte. Në ditët tona modelet e flokëve të grave janë bërë shumë qesharake. Sepse nuk hedhin vaj në flokë. Ato nuk i lyejnë flokët me yndyrë. Nëse do të takohen me dikë ato i lajnë flokët. Nuk mendoj se duken bukur ashtu.

Sigurisht që nuk them se duhet t'i mbuloni fytyrat me vaj. Në jetë ka edhe diçka tjetër për të cilën ne kujdesemi shumë. Duam t'u bëjmë përshtypje njerëzve. Nëse veshim diçka duam të bëjmë përshtypje. Edhe nëse bëjmë përshtypje, po pastaj? Nëse vjen një gjarpër, ai do të të kafshojë, çfarëdo fustani të kesh veshur, prej cilitdo vend të jesh. Gjithë ky identifikim nuk i duhet një Shivabhakta-je. Një Shiva bhakta duhet të jetë totalisht i përhumbur në magjepsjen e gëzimit. Shumë kërkues për modelin e flokëve, shumë kërkues për veshjet, nuk e kuptojnë pse e bëjnë këtë. Çfarë fitojnë me gjithë këtë? Asgjë. A bëhen të famshëm? Dhe kjo lloj fame që është kaq sipërfaqësore për çfarë u shërben? Duhet të keni respekt, respekt për qenien tuaj. Jo vetëm si qenie njerëzore por si jogistë Sahaxha. Ju jeni jogistë Sahaxha. Ne jemi bhakta të Shivës, ne nuk bëhemi merak, ne nuk shqetësohemi. Sido që të jetë, Shiva është brenda nesh dhe ne ndriçojmë me forcën e Kundalinit brenda nesh. Mund të jesh i veshur shumë mirë, mund të jesh gjithçka, por nëse vibrimet i ke të këqija, çfarë dobie kanë të tjerat? A ka ndonjë vlerë t'i gjykoni njerëzit nga gjëra të pakuptimta si veshjet apo mustaqet nëse nuk mund t'i gjykoni ata nga vibrimet e tyre? Në Sahaxha Joga sistemi i vlerësimit tuaj duhet të jetë Sahaxh. Kam parë shumë njerëz që thonë : "Nuk më pëlqen shtëpia e tyre, nuk më pëlqen kjo..." Shprehja "Nuk më pëlqen" është nishidda, duhet të braktiset nga jogistët Sahaxha.

Nëse nuk të pëlqen diçka nuk je një jogist Sahaxha. Edhe nëse jeni anti-Sahaxh Cfarë do të fitonit duke thënë "Nuk më pëlqen"? Pse të lodhesh duke e thënë? Për shkak të kësaj, në Sahaxha Joga disa njerëz më kanë sjellë probleme, shumë probleme. Vetëm sepse janë shumë egoistë. "Ky është i keq, ajo është e keqe, ky kështu, ajo ashtu" Ndonjëherë habitem. Sepse kur këta njerëz vijnë tek unë, habitem se janë njerëz shumë të këndshëm. Por njerëzit janë edhe shumë egoistë. Për shembull kam parë njerëz që nuk vijnë nëpër takime, nëpër puxha. Sepse kanë punë. Gjithsej janë 11 puxha, por ata nuk vijnë. Sepse janë shumë të zënë. Të paktën në një puxha duhet të vini. Por ata që janë Shivabhakta marrin kënaqësi vetëm nga puxhat Asgjë tjetër. Gjithë qenia e tyre është totalisht e vibruar nga Shiva bhakti. Për ta kjo është gjëja më e rëndësishme.

Ka edhe njerëz në Sahaxha Joga që përpiqen të bëjnë para' me anë të Sahaxha Jogës. Shumë gabim, shumë gabim, shumë gabim. Sahaxha Joga është për t'ju dhënë puniat, për t'ju dhënë bekimet, dhe nëse nuk keni këtë në mendje, më mirë hiqni dorë nga Sahaxha Joga. Merruni me ndonjë biznes apo ndonjë gjë të ndaluar. Kjo është shumë e thjeshtë. Derisa të përfundoni në burg. Por për të shijuar fuqitë e shpirtit tuaj ju duhet të mësoni disa gjëra, dhe njëra nga ato është të mos keni pretendime. Shprehjet "Më pëlqen" "Nuk më pëlqen" duhet të zhduken nga gjuha juaj. Pëlqimet e mospëlqimet janë vetëm për njerëzit dritëshkurtër. Duhet të mësoni të vlerësoni. Fuqia juaj e vlerësimit do të tregojë se sa të pasur jeni shpirtërisht. Dhe fuqia juaj e vëzhgimit do të tregojë se çfarë vëzhgoni. Për shembull, vijnë ca njerëz tek unë e më thonë: "Nuk më pëlqeu ajo gruaja se kishte veshur një sari qesharak." "Ç'është kjo?! "Nuk më pëlqeu ajo se e vinte dorën mbi kokë". Po pastaj? Sepse ju krijoni imazhet tuaja për njerëzit dhe doni që të gjithë të jenë ashtu, përndryshe nuk ju pëlqejnë. Ju pëlqen apo nuk ju pëlqen juve, askush nuk do të ndryshojë. Pse lodheni kot? Ndonjëherë ka muzikantë që nuk janë aq të mirë. Më kujtohet njëherë që shkova dhe pyeta babanë "Si këndon ky këngëtar?" Ai tha "Ai është shumë me kurajë, shumë me kurajë." Unë thashë "Pse, si është puna?" Ai tha "Ai këndon pa e vrarë shumë mendjen dhe ndonjëherë edhe stonon, del jashtë taala-s, nuk ka problem, por përsëri këndon. Është shumë me kurajë, himmatuala" Pra kështu vlerësonte ai. Kur ky burri filloi të këndojë, unë e pashë që ishte ashtu, por im atë po thoshte "Ua-ua, ua-ua" dhe po e inkurajonte. I kam parë tek im atë këto cilësi hyjnore, se si ai toleronte, se si ai, jo thjesht

toleronte, por vlerësonte. Ai vlerësonte çdo lloj gjëje. Kështu pra, nëse jogistët Sahaxha kanë këtë lloj vlerësimi ata do të shijojnë e kënaqen me gjithçka. Sepse ju e vrisni kënaqësinë tuaj, a e dini këtë? Ju jeni gjithëfarë lloj njerëzish këtu, gjithëfarë lloj veshjesh, gjithëfarë lloj familjesh e shtetesh jeni këtu. Për mua nuk jeni asgjë tjetër veçse jogistë Sahaxha, bijtë e mi, kaq. Dhe unë nuk ju gjykoj ju prej modelit të flokëve apo prej veshjes suaj, jo. Gjithë gjërat moderne janë ekstremisht kushtëzuese. Dhe ato ju kushtëzojnë aq shumë sa bëheni të papërgjegjshëm. Bëheni jogistë Sahaxha të papërgjegjshëm. Përgjegjësia juaj kryesore është Sahaxha Joga. Sepse duhet ta dini se ç'punë është kjo. Është një punë shumë e madhe të ndryshosh gjithë botën; ky është vizioni im. Në këtë moshë të vjetër unë mendoj po njëlloj. Por nëse ky është vizioni im, cili duhet të jetë qëndrimi juaj? Që duhet të shkojmë e të përhapim Sahaxha Jogën. Kjo është gjëja kryesore. Unë ju thërras për këto puxha vetëm për t'ju ripërtërirë, për t'ju dhënë më shumë energji. Por nëse ju e merrni këtë thjesht si një bekim dhe mbylleni nëpër shtëpia, kjo nuk ka dobi. Ju duhet ta shpërndani Sahaxha Jogën. U habita kur më thanë se në Laknau ka vetëm 200 jogistë Sahaxha. Si ka mundësi? Herën e parë që kam shkuar në Laknau kishte të paktën 3000 jogistë Sahaxha dhe nuk kishim as sallë e asgjë. Dhe, e merrni me mend? Papritur gjëj kaq shumë njerëz. Si ka mundësi që tani ka vetëm 200 jogistë Sahaxha?

Ose po gënjeni ose jeni fare të paaftë. Pra përgjegjësia e çdo jogisti Sahaxha e çdo jogisti Sahaxha, detyra kryesore, është të përhapë Sahaxha Jogën. Sa njerëzve u keni dhënë realizim? Ku keni folur për Sahaxha Jogën? Më ka ndodhur që edhe gjatë udhëtimeve ndonjë pasagjer të më thotë "Guru im është ky, duhet ta njohësh, një guru i madh", etj, etj. Hapur, paturpësisht, për guru të tmerrshëm. Ndërsa ju jeni shumë të ndrojtur të flisni për Sahaxha Jogën. Asnjëherë publikisht nëse nuk keni një program, një program publik, etj, etj. Dhe nuk keni kohë për Sahaxha Jogën, jeni shumë të zënë. Pra nëse duhet të ndiqni Shivën dhe bekimet e Tij gjithë kohën, mbrojtjen e Tij për ju...atëherë duhet të jeni jogistë Sahaxha me cilësi shumë të larta. Kjo duket kur bëni gjithçka për të përhapur Sahaxha Jogën. Kjo është ajo që mungon. Jam shumë e lumtur që në Australi Sahaxha Joga është përhapur kaq shumë. Nuk e di se ç'ka ndodhur. Në një vend të largët si Australia. Në fillim kisha ca pengesa por tani është përhapur. Edhe në Austri është përhapur. Edhe në Itali. Por jo në vende të tjera. Si është puna? Puna është se udhëheqësit nuk po japin maksimumin.

Për shembull, Anglinë e kam shkelur pëllëmbë për pëllëmbë. Atje kemi jogistë Sahaxha shumë të varfër, shumë të varfër. Duhet të shkoni në universitete, tek të rinjtë. Kur përhapet hippizmi pse të mos përhapet Sahaxha Joga? Ai është përhapur si zjarr i tërbuar, pse jo Sahaxha Joga? Ka gjithë ato gjëra për të cilat duhet t'ju paralajmëroj. Kini kujdes! Nëse keni arritur Realizimin, keni përgjegjësinë tu jepni Realizim edhe të tjerëve, dhe të përhapni Sahaxha Jogën. Nëse nuk mund ta bëni, atëherë Zoti ju shpëtoftë!

Nuk kam ç'të them më. Duhet të pyesni veten, "Çfarë kam bërë për Sahaxha Jogën? Çfarë kam marrë nga Sahaxha Joga?" Dhe jam e sigurtë që pas kësaj puxhe të Shivës, do t'ia dedikoni veten parimeve të Shivës brenda jush. Parimet e Shivës nuk zbuten, janë shumë, shumë të ashpra, shumë të fuqishme. Duhet të dedikoheni dhe të dorëzoheni. Mbi çdo punë tjetër, mbi çdo detyrë tjetër, kjo është më e larta. Pra me këtë, i kërkoj Shivës t'ju japë bekime, bekime të plota, që ju të transformoheni në personalitetin e Shivës.

Zoti ju bekoftë të gjithëve!

## 2003-0320, Birthday Felicitations 2003

View [online](#).

Birthday përgëzim, Nirmal Dham, Delhi (Indi), 20 Mars 2003.

Sot të gjithë po përpiqen t'ju flasin Anglisht sepse, sipas meje, mendojnë se shumica prej jush flasin Anglisht. Doja t'ju them diçka për jetën. Jeta shkon përpara. Nuk ka rëndësi nëse jeni 80 apo 90 vjeç. E vetmja gjë e rëndësishme është se sa e keni përdorur dritën që keni marrë në Sahaxha Joga. Të gjithë ju jeni të ndriçuar tashmë në Sahaxha Joga, gjithë Kundalinet tuaja janë ngritur dhe besoj se ju tashmë keni plot dije. Por megjithatë është e rëndësishme se sa kohë i kushtoni ju çlirimit të qenieve njerëzore, për t'i ndihmuar ata të kuptojnë, në vend që t'i kritikoni, në vend që t'i dënoni. Detyra juaj është t'i vendosni ata në një pedestal më të lartë, që ata të respektojnë veten dhe të respektojnë Vetë Realizimin e tyre. Kjo është shumë e rëndësishme sepse kam takuar shumë jogistë Sahaxha që ishin shumë kritikues ndaj kolegëve dhe gjithçkaje tjetër. Por meqë e morën Realizimin atëherë ata e kanë për detyrë të ndihmojnë edhe njerëzit e tjerë të çlirohen. Atëherë nuk do të ketë asnjë lloj problemi. As probleme politike e as ekonomike, asnjë lloj problemi. Gjithë këto probleme krijohen nga mendja e cila, duhet të them se nuk është ende plotësisht e zhvilluar, dhe kur të jetë e zhvilluar ju nuk shqetësoheni më, nuk shqetësoheni për të tjerët, nuk shqetësoheni për çlirimin e të tjerëve. Kjo ndodh automatikisht. Nuk ka pse ta them unë. Por ju keni parë në jetën tuaj se si kanë ndryshuar qëndrimet tuaja për jetën dhe kjo është më e rëndësishme se gjithçka tjetër. Disa prej jush janë njerëz shumë të suksesshëm në politikë, në biznes, etj, etj. Por nuk mund të jeni të kënaqur derisa t'u jepni Realizim njerëzve, derisa t'i bëni të përsosur si veten tuaj. Jam shumë e lumtur që shoh kaq shumë njerëz që marrin dobi prej Sahaxha Jogës. Nuk e prisja kurrë që do ta shihja këtë gjatë jetës sime. Ka funksionuar për mrekulli, jam vërtet e habitur se si gjërat u rriten kaq shpejt dhe se si është përhapur në kaq shumë vende, në zemrat e kaq shumë njerëzve dhe sa janë dhënë ata pas Sahaxha Jogës. Ata po punojnë jo vetëm në vendet e tyre por edhe jashtë. Në fund të fundit unë nuk mund të shkoj kudo tani. Por megjithatë Sahaxha Joga po përhapet dhe kjo është shumë e mrekullueshme për mua. Nuk e keni idenë sa gëzohem kur dëgjoj që Sahaxha Joga ka shkuar në një vend e në një tjetër. Në fakt më thonë se në 43 vende Sahaxha Joga është përhapur gjerësisht, por edhe në shumë vende të tjera në një shkallë më të ulët. Por unë nuk e prisja kurrë që të ndodhte kaq shpejt. E gjitha kjo është falë jush, falë ju jogistëve Sahaxha që e arritët këtë mrekulli. Ju jam mirënjohëse të gjithëve ju, nga India apo jashtë saj, atyre që mbajtën flamurin e çlirimit dhe po shkojnë përpara në vend që të kritikojnë, në vend që t'i degradojnë të tjerët, se kjo nuk është ndonjë gjë e vështirë. Ju mund të ngriheni mbi gjithë këto e të bëni të ngrihen edhe të tjerët. Ne mund ta ndryshojmë gjithë botën, dhe ju nisni të kuptoni problemet e kësaj bote dhe mund t'i hiqni qafe ato me anë të zgjimit të Kundalinit tuaj. Po ju them se Kundalini është një gjë kaq e mrekullueshme sa i bën qeniet njerëzore diçka më të lartë, i bën të shenjtë. Por një jogist Sahaxha ka një fuqi të madhe dhe kjo fuqi është se ai mund të bëjë të tjerë jogistë Sahaxha mund t'u japë Realizim të tjerëve. Ata duhet t'i përdorin fuqitë e tyre dhe duhet të përpiqen të ndryshojnë gjithë botën. Kjo është dëshira ime. Nuk e di nëse do t'ia arrij gjatë jetës sime apo jo. Por ju të gjithë duhet të jeni të vendosur për këtë dhe unë jam e sigurtë se do të ndodhë.

Zoti ju bekoftë! Faleminderit shumë!

Faleminderit shumë!

## 2004-0215, Mahashivaratri Puja 2004

View [online](#).

Mahashivaratri Puja, Pune (Indi), 15 Shkurt 2004.

Sot jemi këtu për të bërë puxhën e Gurusë. Gurusë i këndohen lavde më shumë se Hyjnive dhe Zotave. Kush është ky Guru? Kush është shakti më i rëndësishëm këtu? Guruja tattua është Shiva. Formën e fuqisë së Shivës duhet ta konsiderojmë si fuqinë e Gurusë. Sepse kur marrim fuqitë nga shakti i Gurusë dhe kur shaktit vijnë brenda nesh edhe ne vetë bëhemi Guru. Dhe pas kësaj jemi të bekuar për gjithë jetën (Kaljan) Ai që i merr këto fuqi, duket se ka gjithë bekimet (kaljan). "Kaljan" është një fjalë që është shumë e vështirë të shpjegohet me pak fjalë. "Kaljan" do të thotë të jesh i bekuar nga të gjitha anët, të marrësh gëzim nga të gjitha anët. Ç'do të thotë kur dikush thotë se në bekime ju keni marrë Kaljanin? Çfarë është Kaljani? Kaljan do të thotë Atma Sakshatkar, Vetë Realizim. Pa Vetë-Realizimin nuk mund ta keni Kaljanin. Askush nuk mund ta kuptojë nëse nuk e ka. Të gjitha këto gjëra janë tek Kaljani. Prej kësaj njeriu merr gjithë gëzimin dhe bëhet rrezatues i tij. Nëse e keni këtë Kaljan, çfarëdo që duhet të bëni e keni bërë, çfarëdo përpjekjesh që duhet të bëni i keni bërë tashmë, besimin që duhet të keni ju tashmë e keni. Por kur jeni tamam në "Kaljanmarg" (rrugën e Kaljanit), kur ai ka dhënë mantrën për të patur Kaljanin, çfarë do të thotë kjo? Do të thotë se gjëja më kryesore brenda jush është samadhan (kënaqësia). Pas kësaj ju nuk keni pse të kërkoni asgjë më tepër, ju jeni bërë të gjithë Guru. Nuk keni pse të merrni gjëra të mëdha në këtë moment, përveç bekimeve të kësaj Samadhane që ju të gjithë mund t'i ndjeni brenda vetes, të gjithë mund t'i njihni brenda vetes, të gjithë mund t'i shijoni brenda vetes. Para së gjithash ju mund të shihni se sëmundjet e trupit, problemet e trupit, mund të zhduken prej këtij Kaljanmargu, gjithë problemet që keni brenda vetes dhe ju pengojnë të lulëzoni, mund të zhduken prej këtij Kaljanmargu. Kur ju të jepeni pas kësaj do të merrni Kaljanin dhe do të keni Vetë-Realizimin. Për këtë gjë ju ndihmon Shri Mahadeva. Kur kundalini hap sahasrarën Shri Mahadeva qëndron ulur aty. Dhe për këtë arsye ne e quajmë Atë Mahadeva. Do të thotë Zoti i gjithë Zotave, Mahadeva. Tek Kaljani ka shumë aspekte të rëndësishme. Gjëja e parë është shanti (paqja) Paqja mendore, paqja fizike dhe paqja në jetën familjare. Në jetën familjare ka shumë probleme, shumë pengesa, dhe të gjitha këto mund të zgjidhen prej Kaljanmargut. Pas kësaj as që mund ta ndjeni prezencën e ndonjë pengese.

Në këtë mënyrë mund të shohim shumë njerëz nëpër botë që marrin bekime nga ky Kaljanmarg, meditojnë për këtë dhe e shijojnë për gjithë jetën. Ky është Kaljani prej të cilit njerëzit mund të arrijnë ekuilibrat brenda tyre. Dhe për të arritur këtë ekuilibër, duhet të viresh nën mbrojtjen e Gurusë. Kur bëhesh besimtar i një Guruje merr ekuilibrin dhe gjithçka. Pas kësaj nuk keni nevojë për asgjë. Në këtë mënyrë e marrim ekuilibrin dhe dhe marrim fuqinë e dashurisë brenda vetes sonë. Kur njeriu e merr këtë, i gjithë trupi ngazëlletet. Kur arrini këtë gjendje, shaktit (fuqitë) i shkatërrojnë të gjitha problemet, shqetësimet në trup dhe në gjendjen fizike, dhe shumë njerëz përpiqen shumë ta marrin këtë shakti. Njeriu mund ta marrë shaktin vetëm nga një tjetër që është i vetë-realizuar. Dhe më pas ai vetë bëhet në formën e Zotit. Kjo është një temë që mund të shpjegohet vetëm në gjuhën Indiane, që thotë se këtë Guru Padh e merrni nga dikush tjetër. Por ai tjetri është pajisur me fuqinë e paqes së mendjes si fillim, por edhe fuqinë për të mposhtur çdo lloj problemi të kësaj bote, problemet mendore, problemet fizike. Gjithë këto probleme mund t'i zgjidhni me anë të ekuilibrit tuaj mendor dhe të bekimeve mendore nga Guruja juaj.

Kur të bëheni Guru, edhe ju vetë do të keni fuqinë të bekonit të tjerët. Me fuqinë e bekimit tuaj ju mund të krijoni Guru të tjerë. Dhe kur është krijuar një Guru që e ka këtë fuqi është shumë e këndshme. Kënaqësia është kaq e madhe sa nuk dëshironi asgjë tjetër. Kjo është fuqia e Shivës.

E keni parë Shivën, Ai nuk ka shumë rroba, nuk e zbukuron veten. Ai vetëm rri ulur në një gjendje meditimi gjithë kohës. Ai nuk dëshiron asgjë. Ai është aq i kënaqur me veten sa nuk dëshiron asgjë tjetër. Kjo pra është fuqia që merrni pas Vetë-Realizimit, nëse keni një Guru, dhe Guru të atij niveli e kalibri. Njeriu nuk duhet të përpiqet të bëhet Guru. Kjo nuk është fare praktike. Nëse përpiqesh të bëhesh, nuk do të bëhesh kurrë. Ajo duhet të vijë vetë tek ju, pa e kërkuar, pa asnjë përpjekje. Pra e vetmja mënyrë për të arritur aty është përmes Dhianës. Dhiana është meditimi. Kur mediton, vetëm mediton, dhe mediton, mos kërkoni asgjë. Vetë meditimi ju jep atë mjet që mund të mbartë këtë fuqi të madhe të një Guruje. Atëherë ju vetëvetiu ua jepni këtë fuqi të tjerëve. Nuk keni pse të përpiqeni. Thjesht me praninë tuaj njerëzit mund ta marrin këtë fuqi të kënaqësisë së plotë. Dhe në të ka shpëtim për ju dhe për të tjerët. Pra gjithë problemet që hasen në udhëtimin e ngjitjes zhduken dhe ju mbusheni me harenë e



paqes dhe gëzimit hyjnor. Prandaj quhet Kaivalja, dmth vetëm, vetëm bekimet. Nuk ka fjalë tjetër për ta përkthyer atë. Nuk ka mënyrë tjetër për ta shpjeguar atë. Është një gjendje. është një Stithi. Është një gjendje në të cilën duhet të ngjitesh dhe ju e dini që jeni në atë gjendje. Është një gjë e mrekullueshme që kur keni arritur në këtë gjendje, nuk keni pse kërkoni asgjë. I keni të gjitha dhe jeni shumë i kënaqur. Mund të vazhdoj të flas për këtë fuqi të veçantë por mendoj se është më mirë të meditonit për gjithçka që thashë. Dhe ju jeni të gjithë në gjendje të arrini aty. Në atë gjendje të paqes e gëzimit të plotë.

Zoti ju bekoftë!

## 2004-0606, Adi Shakti Puja, 2004

View [online](#).

Adi Shakti Puja, Cabella Ligure, Itali. 6 Qershor 2004.

Takimi i sotëm është shumë i veçantë. Është edhe një ditë shumë shumë e veçantë, ekstremisht e veçantë dhe shumë e lumtur. Arsyeja është se kjo ditë flet e këndon për Rendin e lindur, për Fuqinë e lindur, për Origjinalen, Adin, Fillestaren e lashtë.

Dhe ky është përgjegjës për krijimin e këtij universi të mrekullueshëm. Se pse filloi kjo dhe si funksionon është...ju tashmë e dini, nuk ka nevojë të flas për këtë. Por sot duhet të flasim për këtë Fuqi, e cila rri e fshehur në zemrat tuaja, me të cilën ju mund të bëni çfarë të doni për të krijuar një botë të re, një familje të re, standarde të reja, gjithçka që deri sot është e panjohur.

Kjo është shumë e mundur. Është shumë e mundur dhe po bëhet, por ajo që është e vështirë është se si t'i bëjmë njerëzit më të përshtatshëm me të aftë të merren vesh me njëri-tjetrin. Duket diçka e vështirë. Njerëzit ndihen mirë mes tyre, me miqtë e tyre, stilin e tyre të jetesës, etj.

Por t'i bësh ata tërësisht një (bashkë), njësh me njëri-tjetrin, në të njëjtën linjë, është shumë, shumë e vështirë dhe nuk duhet të bëhet. Nuk ka pse të jetë ashtu; ata nuk kanë pse të jenë ashtu, por duhet të funksionojë. Tani problemi është se kemi njerëz të bukur, shpirta të bukur, por ata nuk janë aq të unifikuar me njëri-tjetrin sa do duhej të ishin. Si ta zgjidhim këtë problem?

Shumë njerëz më kanë pyetur: "Nënë, si t'ia bëjmë me këtë problem?" Unë vetëm kam qeshur. Sepse nëse shihni idenë fillestare pse e nisëm ne këtë rreze X, pse e nisëm ne këtë lloj të ri arsyetimi, këtë lloj të ri depërtimi- sepse ne donim të zbulonim unitetin, risinë tek çdo person. Tani ju duhet të jeni shumë mirënjohës që jeni të gjithë një, një së brendshmi, nuk ka asgjë tjetër. Ka vetëm një dhe ajo kur flet dhe do të drejtojë diçka, ju do të habiteni që gjithçka bëhet njëlloj. Është e njëjta gjë dhe funksionon njëlloj. Nuk ka ndryshim e diferencë midis tyre. Megjithatë mendjet tona bredhin nëpër lloj-lloj problemesh që janë pa kuptim për Sahaxha Jogën. Problemi kryesor që kemi është se nuk e kuptojmë që nuk kemi asnjë problem. Ne nuk kemi probleme. Ne mendojmë se ka probleme dhe duhet të merremi me to por probleme nuk ka, unë nuk shoh ndonjë problem gjëkund.

Atyre që mendojnë se kanë probleme unë u kam kërkuar të m'i shkruajnë dhe unë do të përpiqem t'u përgjigjem dhe t'u them se ç'lloj problemi është ai. Por para se të bëj diçka, do të doja të them se jogistët tanë Sahaxha akoma nuk kanë arritur në atë nivel ku të kuptojnë njësimin, unitetin në zemrat e tyre. E gjitha kjo vjen nga brenda, jo nga jashtë, pra të gjitha përpjekjet e bëra së jashtmi janë të kota. Duhet të bëhemi pa përpjekje ajo që jemi. Aty do të kuptoni se nuk ka....asgjë. Nuk ka nevojë të keni një tjetër...një tjetër takim apo diçka tjetër të koduar, nuk ka nevojë; aty është gjithçka. Vetëm se duhet të jeni një, të bëheni një. Kjo është disi e vështirë për ta kuptuar njerëzit që kanë hundë të ndryshme, fytyra të ndryshme, gjithçka të ndryshme, që të bëhen njëlloj. Por ju jeni, ju jeni. Ju dukeni ndryshe sepse nuk e dini që jeni një. Pra unë duhet t'ju them diçka: Ju jeni një i vetëm. Një në kuptimin që gjithçka e juaja, çdo ngacmim, çdo ndjenjë, çdo arsyetim është i njëjtë. Vetëm se shfaqet në kohën e gabuar, në kohë të ndryshme, dhe ju jep përshtypjen e gabuar që është e ndryshme, por në fakt nuk është. Është vetëm një, një marrëdhënie, dhe kjo marrëdhënie është me Adi Shaktin -që ju jeni pjesë e Adi Shaktit; dhe sado që të përpiqemi nuk mund të ndahemi nga Adi Shakti. Ju keni lindur prej Saj dhe udhëhiqeni prej Saj. Ajo kujdeset për ju. Mua më duket sikur gjithçka është e unifikuar kurse ju mendoni se ka një tjetër linjë orientimi, linjë veprimi, por e keni gabim. Çfarëdo që unë them duhet të vërtetohet, përndryshe pse duhet të pranoni ju një deklaratë kaq të çuditshme?

Unë vetë jam një me ju dhe do të mbetem gjithmonë njëlloj me të gjithë ju. Për mua nuk ka ndryshim. Unë nuk shoh ndonjë ndryshim. Ndryshimi është jashtë, vetëm tek veshjet e stilet tuaja. Brenda, ndoshta, se çfarë temperamentit keni kjo varet nga temperamentit juaj. Nëse ky temperament ndryshon pak ju do të shihni njësimin midis jush dhe diferencat do të zhduken menjëherë. Sot pashë një njeri shumë të rezikshëm. Mendova se po të dojë mund të më vrasë.

Mund të bënte çfarë të donte. Por jo, nuk ndodhi ashtu. Pse? Sepse unë nuk e kisha kuptuar atë. Ai nuk ishte ashtu. Ai vetëm donte të më tregonte respektin. Ai nuk donte të më vriste apo ndonjë gjë tjetër të keqe. Është e habitshme se si e kuptoni

njëri-tjetrit. Derisa ta kuptoni siç duhet njëri-tjetrit nuk do të mund të arrini ndonjë gjë të kthjellët (jo e qartë), që është esenciale, që është e drejtë, që është e vërteta. Pra, e vërteta filloi shumë kohë më parë, shumë më parë se mund të mendojë ndonjëri nga ju. Më pas u përzje me plot gjëra që nuk ishin të vërteta dhe atëherë e vërteta u largua. Siç do të thosha se gjarpri lindi nga injoranca që nisën ta mbështesin gjarpërinjtë e tjerë. Gjarpër pas gjarpri ata nisën të shtohen e të mbushin gjithë universin me pandershmëri dhe me idera të gabuara. I besonin ato dhe nisën të luftojnë, të vrasin njëri-tjetrit. Por ata të gjithë ishin gjarpërinj. Pra sa duhet të besojë njeriu në marrëzitë e tyre? Sa duhet t'i pranojë njeriu marrëzitë e tyre? Sa duhet t'i ndjekë njeriu marrëzitë e tyre? është shumë e vështirë. Por përsëri pranohet shumë më lehtë se e vërteta. E vërteta nuk pranohet aq lehtë sa e pavërteta. Pse? -Sepse ne qëndrojmë mbi të pavërtetën.

Vetë arsyetimi ynë është e pavërteta dhe ne të gjithë duhet ta ndryshojmë arsyetimin tonë tek e vërteta, që nuk është e vështirë pasi ne jemi e vërteta. Ne jemi e vërteta.

Kur ne jemi e vërteta, pse duhet të jetë e vështirë të bëhemi ashtu? Nuk duhet të jetë, por edhe ndodh. Pra kjo do të thotë se diçka nuk shkon diku brenda nesh, që ne duhet ta zbulojmë se ç'është. Dhe ajo që nuk shkon brenda nesh është se ne nuk mund të përballemi me veten. Ne nuk mund të përballemi me veten. Ne përballemi me të tjerët, jo me veten. Kurrë nuk e shohim veten. Nuk e kemi idenë se si është gjendja jonë. Dhe për këtë ju duhej një Nënë - për t'ju treguar. Dhe kështu erdhi Nëna këtu në këtë botë për t'ju treguar se cili është problemi që keni brenda jush. Kjo duhet të pranohet. Ky parim duhet të praktikohet. Dhe ju do të habiteni se sa dije keni për veten tuaj dhe për mjedisin që ju rrethon. Nuk ka asgjë të veçantë, asgjë të jashtëzakonshme, e vetmja gjë është se duhet të jeni të pranueshëm për veten tuaj. Mendoj se njerëzit po bëhen jogistë Sahaxha por nuk është ashtu. Ata nuk janë jogistë Sahaxha por po përpiqen të bëhen. Përkundrazi, ata duhet ta dinë që janë jogistë Sahaxha dhe nuk kanë pse të bëhen të tillë. Atëherë nuk ka problem. Por kur keni pranuar se ka Sahaxha Joga të ndryshme, dhe që jogistët Sahaxha janë të ndryshëm dhe ju jeni të ndryshëm, atëherë si mund të bëheni jogistë Sahaxha? Puna është tek injoranca që kemi, që ne po sillemi si të huaj ndaj njëri-tjetrit. Injorancë e plotë. Ne duhet ta dimë se jemi të gjithë njëllë. Nuk ka nevojë të kemi asnjë lloj injorance. Dhe kur kjo të ndodhë, problemet e gjithë botës do të zgjidhen pa asnjë vështirësi. Puxha e sotme është e veçantë sepse ju po bëni puxhën e diçkaje që kurrë nuk ka pësuar ndonjë ndryshim, që nuk ka ndryshuar aspak; ishte e njëjta, ka mbetur e njëjta, ka lindur me të njëjtën dhe është akoma me të njëjtën. Çfarë duhet të them unë në një puxha të tillë? Pse duhet thënë diçka? Asgjë. Vetëm bëhuni një me veten tuaj.

Kjo është pika kryesore -që ne duhet të jemi një me veten tonë, dhe jo ta humbasim atë nëpër fjalë ose në atmosferë, ose në bredhjet e kota të trurit tonë. Sepse kjo është koha kur truri fillon të bredhë, dhe kur fillon të bredhë e humb kontrollin mbi veten. Si një gjarpër që nëse qëndron në follenë e tij nuk ka rrezik për të; por kur fillon të lëvizë atëherë mund të rrezikohet. Po ashtu, ne duhet ta dimë se mendja jonë është shumë shumë e vështirë dhe nuk duhet të shkojë në drejtime të gabuara. Për këtë ne duhet të bëjmë Puxhën e Nënës Fillestare sepse duhet të përpiqemi të jemi në linjën e Nënës Fillestare. Duhet ta mbajmë veten tonë me pastërtinë Fillestare. Duhet ta stërvitim Vetën tonë Fillestare, dhe jo ta ndryshojmë veten për ndonjë arsye.

Kjo do të ishte gjëja më e mirë nëse mund ta arrijmë. Jam e sigurt që mundemi, nuk ka asnjë problem. Vetëm se ne jemi kaq të ndërgjegjshëm se jemi Indianë, se jemi Anglezë, Europeanë dhe gjithë këto. Por nuk jemi. Ne jemi vetëm vetëvetja dhe këtë duhet të arrijmë këtë njësim me veten tonë.

Zoti ju bekoftë të gjithëve!